



**EHLUL-BEJTI A.S II**

**ALI IBN EBU TALIBI A.S**

DËSHMI DHE KUJTIME PËR UDHËHEQËSIN E BESIMTARËVE  
ALI IBN EBU TALIBIN A.S

EMIRUL MUËMININ  
ALI IBN EBU TALIBI A.S  
(Pjesa e parë)

PËRKUSHTIM:

« GJYSHIT TIM HAXHI HAFËZ IS'HAKUT  
I CILI ME URTËSINË DHE MENÇURINË E TIJ  
QYSH NË FËMIJËRI MË EDUKOI DHE MËKOI  
ME MËSIMET E PASTRA ISLAME DHE  
ATDHEDASHURINË E ZHARRTË ! »  
ALLAHU E PRANOFTËNË MESIN E ROBËRVE TË TIJ TË DASHUR, AMIN

*PËRKTHYESI.*

*Dituria është lumë,  
Urtësia det,  
Dijetarët rreth lumit përshkojnë,  
Të utrët mes detit notojnë,  
Ndërsa njohësit në anijet e  
shpëtimit lundrojnë.*

(Imam Ali ibn Ebu Talib)\*

\*Usul El- Kafi 2:70, ulema (dijetari) Kulejni (All-llahu) xh.sh e ndriçoftë varrin e tij)

Udhëzimi i qartë:

I dërguari i All-llahut xh.sh ka thënë:

„Shenjë e besimtarit të vërtetë është dashuria ndaj Ali ibn Ebu Talibit“\*

„Ai që dëshiron të jetoj jetën time, dhe të vdes siç vdiqa unë e të jetoj banorë i Kopshtit të Parajsës (Xhenetit) të cilin Zoti im e ka mbjellur, le ta ndjek Ali ibn Ebu Talibin dhe ata që e ndjekin atë, dhe le të ndjek imamët pas meje-ngase rrjedhin nga prejardhja ime, dhe zotërojnë mençuri dhe dituri. Keq do të kenë ata rrenacakë të ummetit tim që nuk do të pranojnë meritat dhe përparsitë e tyre(imamëve), ndërsa ata që me të do të shkëpusin lidhjet, kanë shkëputur lidhjet edhe me mua, All-llahu xh.sh ua shkëputtë të drejtën e shefa'atit tim.“ (Ndërmjetësimi i Pejgamberit a.s Ditën e Gjykimit)

---

\*Tarih Bagdad 4:40, ulema dhe halif Hatibi Bagdadit

\*\*Huljetul-Evlija 1:86 ulema dhe halif Ebu Nuajm El Aëali  
2:191, ulema El-Tusi

Përkushtim :

Nuk kam menduar të gjejë person tjetër më meritë të cilit do t'ia kisha përkushtuar këtë vepër se sa Emirul-Mumininit Ali ibn Ebu Talibit a.s bartësit të flamurit(bajrakut) të besnikërisë-lojalitetit ndaj të Dërguarit të All-llahut xh.sh,ngase imam Aliu është edhe bartës i flamurit(bajrakut) të xhihadit, zbatues i të Vërtetës së All-llahut xh.sh dhe baba i të gjithë imamëve të Ehlul-Bejtit a.s

„O Udhëheqës, edhe ne edhe fëmijët tanë na ka shtypur fatkeqësia; kemi sjell pak gjëra çmuara, por Ti na jep merita të shumta dhe na e lësho mëshirën, ngase vërtet All-llahu i shpërblen ata që ndajnë mëshirë”„

Ky libër është I vogël por megjithatë vepër e çmuar dhe njëherit paraqet edhe shenjë lojalitetit tim ndaj Emirul-Muëmininit Ali ibn Ebu Talibit a.s.

All-llahu xh.sh e pranofte, e bëftë mirë kabull dhe na dhashtë të mira në këtë botë dhe në ahiret, ngase All-llahu vërtet i shpërblen ata të cilët janë të dhënë (lojal) ndaj robërve të Tij besnikë!

S.A.K.

Zot! Bëje që vendimet tona të jenë në rrugë të mirë, le të jetë ndihma  
Yte e plotë!

Mos lejo që vetëm vetvetes t'i mbështetemi ngase ne nuk mundemi ta  
përmirsojmë atë që e prishim!

Zot, Ti je bujar dhe I realizon shpresat dhe të priturat e mia,

Mirësisë tënde ia zgjas duartë dhe vetëm Ty të drejtohem!

Secila shpresë bie thevabin(shpërblimin), të cilin vetëm Ti (Zot) e din,  
qoftë gjithnjë mbi (thevabin) tim, mbrojtaj Jote!

## **Parathënie**

-Vështirë është sot të shkruashë qoftë madje edhe në gjuhën arabe,diç të re për Ali ibn Ebu Talibin, halifin e katërt dhe kushëririn e afërt të të Dërguarit të Zotit, Muhamedit a.s. Mirëpo, nga ana tjetër,çdo vepër e re mbi halifin-Aliun, paraqet interesim të jashtëzakonshëm, madje edhe tek lexuesit e thjeshtë. Rast i këtillë do të jetë edhe me librin e Dr. Saadea Kansa-it, i cili ka përmbledhur(përzgjedhur) tekste të autorëve të ndryshëm arab, i ka përkthyer dhe përgatitur ato, dhe nëpërmjet tyre e ka prezentuar halifin-aliun drejt lexuesve tanë.

-Ali ibn Ebu Talibi a.s është i vetmi musliman i cili qysh nga fëmijëria i ka takuar fesë islame. Si gjastëvjecar ishte dëshmitar i Spalljes së parë, dhe që atëherë gjer e gjer në vdekjen e dhunshme, ai palodhshëm punoi për të mirën e përgjithshme të islamit dhe muslimanëve. Karakteristika e tij e përgjithshme njerëzore ishte e njohur nëpërmjet besimit të pakursyer në fe dhe përkushtimit absolut ndaj All-llahut xh.sh dhe pejgamberisë së të Dërguarit të Zotit, Muhamedit a.s. Detyrat, të cilat as-habët tjerë, **akëcilin** shkak, nuk mundënin t'i kryenin, ai i pranonte mbi supet e tij të njoma-djaloshare pa asnjëfarë hezitimi duke mos manifestuar kurrë pezëm. Ndoshta edhe më tepër se çdo as-hab tjetër i Muhamedit a.s me gjithë zemër dëshironte që çdo urdhëres kur'anore ta shëndroj në zbatim në jetën e përditshme, kështu duke e shëndruar islamin në fe të gjallë e të vërtetë.

- Ali ibn Ebu Talibi a.s edhepse i afërt me Muhamedin a.s si për nga fisi ashtu edhe për nga meritat, nuk ishte në rrethin e atyre sahabëve të cilët bashkë me Muhamedin a.s bënë vendime madhore për fatin e islamit dhe të shoqërisë islame.

Më tepër dëshironte të jetë zbatues i vendimeve dhe propagandues(davetxhi) I islamit. Po edhe përkundër natyrës së këtillë të tij, muslimanët e atëhershëm mu për përkushtimin e tij ndaj islamit dhe të të Dërguarit a.s lartë e çmonin dhe fuqishëm lidheshin me të emocionalisht.

- Në një rast i Dërguari Muhamedi a.s shkoi nën përcjelljen e as-habëve dhe bashkëpunorëve në Uhud, që t'i vizitojë varret e luftëtarëve, të cilët u vranë në luftë kundër mushrikëve mekas. Iu drejtua Omerit, Osmanit dhe Aliut duke ju thënë se vdekja e tyre do të jetë jonatyrore dhe tragjike.

E shikoi Aliun, i cili ishte paksa më i vjetër se njëzetvjeçar, dhe i cili nuk kuptoi gjer në fund fjalët e të Dërguarit të All-llahut ngase ishte i mahnitshëm me islamin dhe i entuziazmuar me ardhmërin e rendit të ri të drejtësisë.

- Ali ibn Ebu Talibi a.s kur nevojitej, në çaste ishte njeri i vendimeve dhe veprave të mëdha. Të përmendim vetëm rolin e tij gjatë kohës së tij të Hixhretit të Muhamedit a.s. Kur i Dërguari i All-llahut u paralajmërua gjatë shpalljes së sures Jasin se mushrikët në krye me Ebu Lehebin kuvendojnë në klubin e tyre pagan në Qabe,se si t'i japin fund jetës dhe pejgamberis e urdhëroi Aliun që të flej në shtratin e tij, ndërsa ai me rrëniën e territ të parë doli nga Meka dhe me shokun e tij dhe halifin e parë Ebu Bekrin, u nis rrugës me plot të papritura drejt Medinës. Rrallë kush do ta kishte pranuar një detyrë kaq të rëndë, përpos Aliut, që ti pret gjakatarët pagan në shtratin e atij të cilin e kishin dënuar me vdekje. Aliu këtë e bëri fare pa u shtrënguar dhe hamendur.

- Pasiqë u shpërngul në Medinë, vërsuljet e ushtarëve pagan ndaj Muhammedit a.s dhe muslimanëve ndodhnin përçdo vit. Cakun kryesor e kishin Muhammedin a.s ngase e dinin fare mirë se kur ta likuidojnë atë, me muslimanët do ta kenë më lehtë. Para luftës në Bedër, Muhammedi a.s e pyeti Aliun a do të pranonte detyrën e rëndë që në dyluftim me mushrikët ta përfaqësoj të Dërguarin e Zotit. Pa hamendje krejt I entuziazmuar e pranoi detyrën. Në disa nga ato dyluftime, Ali ibn Ebu Talibi vrau mushrikët më të

njohur ( më me famë). Shpata e tij me dy teha –Dhulfikkar e veshi me të zeza establishmentin pagan mekkas, dhe mu kjo më vonë, kur të gjithë kaluan në islam, kurrë nuk iu harua, dhe këtu pa mëdyshje duhet kërkuar shkakun e problemeve të tij me Muaviun dhe bashkëvendimtarët e tij, gjatë kohës së hilafetit të Aliut. Tepër i respektonte ata të cilët i respektonte Muhammedi a.s. Kurrë ndonjëherë nuk tregoi ndaj ndonjërit prej tyre mosdurim.

Edhe pse i ri, plot energji dhe emocione të forta, të gjithë as-habët ne mendimin se edhe vetëm shikimi i të Dërguarit të Zotit e kthjellonte dhe e kthente në realitetin e islamit.

- I Dërguari i Zotit, Muhammedi a.s shumë e donte. Kështuqë nga ky shkak kërkoi nga axha i tij i ati i Aliut, Ebu Talibi, që t'ia dorëzon atë, me qëllim ta përmbaj dhe edukoj në shtëpinë e vet, që njëherit edhe Ebu Talibit t'ia lehtësojë përkujdesjen ndaj anëtarëve të shumtë të familjes së tij.

- Gjatë kohës së udhëheqjes së pushtetit islam të tre para-ardhësve të tij, Ali ibn Ebu Talibi a.s plotësishtë përmbante dhe përmbushte çdo detyrë pa asnjë farë kundërshtimi. Në këtë kontekst vlen vetëm të përkujtojmë rolin e tij gjatë mbledhjes dhe kompletimit të Kur'anit në mus'hafin e parë në kohën e halifit Osman, ose rolin e tij në luftën kundër renegatëve islam (murtedëve) me në krye Musejlem Kedh-dhabiun, apo pjesëmarrjen e tij në fushatat luftarake të ushtrisë islame kundër Bizantit dhe Persisë.

- Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte njeri i shkencës. Falë mendjemprehtësis, në sot citojmë shumë të dhëna nga koha kur shkenca islame bënte hapat e saj të para të zhvillimit komentimet e tij të Kur'anit, thëniet e shumta të Muhammedit a.s të shëndruara në hadithe, komentimi i përcaktimeve të Sheriatit, gjithë këto janë meritë e halifit të katërtë Ali ibn Ebu Talibit a.s. Përshkrimi i tij bërë pamjes fizike të Muhammedit a.s është aq i fortë, sa që ne sot me vërtetësin më të madhe mund t'ia paraqesim vetvetes.

- Në tefsir, meritat e Aliut a.s janë tejet të jashtëzakonshme dhe të papërcaktuara.

- Me problemet më të mëdha jetësore, Ali ibn Ebu Talibi a.s u ballafaqua gjatë kohës së udhëheqjes së shtetit islam. Për shkak të trazirave në shtet, nuk pati mundësi t'i përkushtohet zgjerimit të kufijve të shtetit islam, siç patën mundësi paraardhësit e tij. Fort brengosej dhe vuante për shkak të ndasive brenda shtetit, ndërsa ndërgjegja e tij islame nuk i lejonte përdorimin e forcës kundër kundërshtarëve të tij. Shumëkush këtë e konsideronte si dobësi të tij, ndërsa besnikët e tij që nga koha e haxhit lamtumirës së të Dërguarit të Zotit, akoma e kishin të kthjellët në memorien e tyre, thënien e Muhammedit a.s kur i porositi muslimanët „Ju përbetoj (bëjë be) juvë që më kurrë të mos i lejoni vetvetes që të vriteni ndërmjet jush dhe kështu që ktheheni sërish në mosbesim. Ai (Aliu) më me ëndje pozicionohej për zgjidhje çfardoqoftë paqësore, gjë që të cilën fatkeqësishtë kundërshtarët e tij nuk e posedonin ose nuk donin apo nuk e kuptonin një gjë të tillë. Për shkak të kësaj „dobësie „, që sot paraqet vlerën më të madhe islame, Ali ibn Ebu Talibi a.s e dha edhe jetën.

- Gjatë kohës kur si imam e falte namazin e sabahut në mesxhidin e Kufes, atentatori (vrasësi) e masakroi me thikën e helmosur, duke realizuar kështu rrugën e komplotit të Haraxhinjëve. Bashkëluftëtarëve të tij që nga ai kërkonin jo mëshirën ndaj kundërshtarëve të tij.

- Dhe në fund t'i kthehemi mbi librin dhe përgatitësin e tij. Nuk ka dyshim se ki libër do ta zgjojë kërshërinë e atyre lexuesve të cilët dëshirojnë t'i njohin figurat historike madhore islame, e Aliu në mesin e tyre zë vendin më të lartë. Citatet e shumta, që Dr. Saade Konso i paraqet, në të vërtet janë dëshmi e e rolit madhor të Ali ibn Ebu Talibit a.s në fillimin e zhvillimit të islamit. Literatur e tillë në gjeneratat e hershme gjatë shekujve ka qenë më tepër prezente, se sa që është sot.

- Në koleksionin e Orientalistikësë HAZ në Zagreb, edhe sot e kësaj dite ekzistojnë disa vepra ne gjuhën turke, arabe dhe pesishte, të cilat i kanë shkruar paraardhësit tanë të mençur në Knin, Sinj, Hrvac, Gjakovo dhe Pozhegëmbi figurën e Ali ibn Ebu Talibit. (Literaturë e tillë shkruar në gjuhët orientale dhe atë shqipe për imam Aliun gjendet anekënd trojeve etnike shqiptare: vërejtje e përkthyesit) Kështuqë vepra e Dr.Saadea Kansa-s paraqet freski dhe retrispektivë të kujtimit dhe borxhit që kemi ndaj njërit prej njerëzve më meritore në islam.

Dr. Saade Kansa e hetoi nevojën e dhe dëshirën që nga veprat e shumta dhe autorët e ndryshëm të na ofrojë këto kujtime mbi Aliun a.s. Edhe pse me profesion mjek, ai (autori) këtë e bënte duke kujtuar thënien e Ali ibn Ebu Talibit, I cili pas luftës së Bedrit kur Muhammedi a.s e udhëhoqi fushatën e arsimimit të muslimanëve, iu drejtua robërve pagan mekas me fjalët“Kush nga ju ma mëson vetëm edhe një shkronjë të vetme, me plot dëshirë do ti bëhem shërbëtor“.

Myftiu Shevko Omerbashiq

President i Meshihatit të Bashkësisë  
Islame të Kroacisë

**Fjala e redaktorit**

Me emrin e All-llahut mëshiruesit, mëshirbërësit!

- Falënderuar qoftë All-llahu nga shikimi i të Cilit një qiell nuk mbulon qiellin tjetër, e as një tokë tjetrën!

-Përmbajtja e pasur e kësaj vepre paraqet karakteristikat themelore të personalitetit të Emirul-Muëmininit, Ali ibn Ebu Talibit a.s, njeriut më të lartësuar që e ka shënuar historia- kuptohet pas Pejgamberit të pastër Muhammedit a.s; në çështjen e imamit, devotshmërisë (takvallëkut), trimërisë, drejtësisë, diturisë, mirësisë, modestisë, shqaurjes dhe sakrificës në rrugën e të Dërguarit të Zotit. Cilësitë e tilla të rralla bënë që të jetë më i merituari në mesin e atyre që promovonin (paraqitnin) islamin në medrese (shkollën e pejgamberisë) dhe të cilët përjetuan edhe vuajtje edhe shpresë. Vuajti dhe u sakrifikua në rrugën e pejgamberisë me sakrificën më të madhe, gjer sa nuk u bë shembull i atyre që e shihnin personalitetin islam, i cili u brumos në frymën e të Dërguarit, Muhammedit a.s e që manifestohej në formën e ndërgjegjes, logjikës dhe udhëheqjes (sundimit).

Kjo vepër e ndriçon personalitetin e Emirul-Muëmininit Ali ibn Ebu Talibit a.s, anën e tij të ibadetit (adhurimit), e cila paraqet kushtin e parë të përkuljes (nënshtrimit) ndaj All-llahut xh.sh dhe në themelet e të së cilës realizohen detyrat e besimtarit të vërtet në besimin e drejtë pa asnjëfarë dileme dhe diskutimi. Gjithashtu, kjo vepër paraqet planet e tij të urta dhe udhëzimet e ndërgjegjshme në fushën e udhëheqjes, furnizimit dhe harxhimeve, si dhe përgaditja e planeve dhe rrugës së transetimeve të thirjes së Zotit dhe mbrojtjes së popullit.

- Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte pishtarë ndriçues i diturisë dhe margaritari i mendimeve, që ndiqte natyrën e kërkesave të jetës plotësisht në përputhshmëri me rregullativat e Sheriatit. Rruga jetësore dhe personaliteti i imam Ali ibn Ebu Talibit a.s ishin shembëlltjërë për të pastruar shpirtërat e besimtarëve dhe zemrat e të devotshmëve, të cilët rendin pas tij, si dhe paraqitën muzë(inspirim) për besimtarin islam.

- -Njohësi i shkencave të historisë silame vëren se Ehlul-Bejti a.s (Familja e të Dërguarit a.s), ithtarët e tij si dhe ata që ishin lojal ndaj tyre, janë përpara vëllezërve të tjerë muslimanë, sa u përket çështjeve të mbledhjes (koleksionimit) dhe komentimit të Kur'anit dhe diturisë të tij, si dhe rruajtjes së rregullave islame. Ndaj është krejt e natyrshme që imam Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte i parë që mblodhi, komentoi Kur'anin dhe shkroi rregullativat islame, gjë që do ta shohim më vonë në libër. I përshkruajti ngjarjet që do të pasojnë në të ardhmen e që ariti t'i njohë me anë të mençurisë së tij të thellë, të kuptuarit, dijes së jashtëzakonshme, zemrës së pastër, shpirtit të qetë, ndërkaq e tërë kjo ishte dhunti dhe inspirim nga i Madhi Zot.

- -Në fund le t'i ruajmë mësimet e tij, këshillat e urta, të cilat do t'i ndriçojnë breznitë e ardhshme dhe udhëzimet e tij do t'i udhëzojnë ata që do të obligohen në njëshmërinë e All-llahut dhe do të pranojnë që islami është fe e jetës.

- Caku ynë kryesor është që edhe gjeneratat tona si dhe të ardhshmet të fitojnë dobi të mirë, duke e lutur All-llahun e Lartëmadhëruar për ndyhmë ndaj nesh në qëndrueshmërinë tonë në rrugën e Tij si dhe në kërkimin e të së vërtetës së drejtë në historitë e islamit.

Duke marrë parasysh se rruga më e mirë e njohjes së shtigjeve të vërtetuara, në afrimin kah e vërteta mbi imamin Aliun a.s, vendosëm t'i ndjekim hulumtimin e jetës dhe veprës së tij. Kështuqë ky libër është një kombinim i shumë introduktave metodologjike.



Një pjesë e teksteve është vënë në përkthim, një pjesë është interpretim i veprave të ndryshme në funksion të shpjegimit më të gjërë, ndërsa një pjesë është si rrjedhim i gjykimeve dhe përfundimeve vetjake. Ndaj, nisur nga kjo, shënimet në fund të tri pjesëve, nuk janë strikt të vendosuar, siç ndodh rëndom sipas rregullave të shkruara të shkencës. Funkzioni primar i tyre-shënimeve, është që atyre të cilët eventualisht dëshirojnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre, t'u japin informacion mbi autorët dhe veprat të cilët kanë shkruajtur për këtë çështje. Prandaj, nisur nga kjo, lus lexuesit e nderuar, që mos të gjykojnë rreptë për lëshimet eventuale!

Veçantinë e tërësisë së pjesës së tretë të librit e përbëjnë citatet nga thëniet dhe hutbet e Aliut a.s sipas librit „Shtegu i Elokuencës“-“Nehxhul-Belaga“- në përkthim të Rusmir Muhametxhejahiqt, botim i B.I., Zagreb,1994. (përkatësishtë „ Shtegu i Elokuencës“- „Nehxhul-Belaga“, fjalimet, letrat, fjalët të urta- përkthyer dhe botuar nga Bashkësia Islame „ Ehli-Bejti „ ,Prizren, 1998, - vërejtje e përkthyesit).

-Rruga e imanit, anëtarit të Ehlul-Bejtit a.s, është rruga e të Dërguarit dhe shtegu i shpalljes së Zotit-Vahjit si dhe rruga e Melaqeve.

-Zot! Na bëjë neve të jemi të dashurit dhe pasuesit-ndjekësit e tyre në këtë botë, ndërsa në Ditën e Gjykimit lëshoje shefa'atin e tyre mbi ne!

## HYRJE E REDAKTORIT DHE PËRKTHYESIT

*Me Emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit*

- O Zot! Falënderimi qoftë mbi Ty, Madhërisë dhe Fuqisë së të cilës i janë të nënshtuar të gjitha zemrat, Ty që shikimet tona nuk mund të të arrijnë e që me fuqinë tënde mbisundon botën!
- Falënderimi qoftë mbi Ty Zot! Të madhërojmë për të mirat me të cilat na ke rrethuar dh epër Përkujdesjen që na ke ofruar! Bëje të kënaqur atë që të ofrohet, ashtu siç ke shpallur në Kur'anin e Shenjtë:“ Dhe u jep gjithçka nga Ai që kërkon, dhe sikur dhuntitë e All-lahut do t'i kishit numëruar, kurrë nuk do t'i kishit arritur t'i numëroni“.
- Falënderimi të takon Ty, ngase neve na ke pastruar nga papastërtia(ndytësia) e mosbesimit dhe na ke treguar-rrëfyer drejtimin e Udhëzimit dhe mënyrën se si të të nënshtrohemi, dhe kur na e dërgove Pejgamberin më famëmadh (Muhammedin a.s) e drejtove me Librin Tënd të Shenjtë-Kur'anin duke thënë:“ All-llahu I përfshin me mëshirën e Tij besimtarët, kur njërin nga mesi i tyre e dërgoi si Pejgamber, që fjalët e Tij, t'i rrëfej, t'i pastojë, dhe me Librin e urtësisë t'i mësojë, ngase para kësaj ishin në humbje të dukshme“.
- O i Lartësuar! Qofsh Falënderuar, që na ke rrethuar me dhuntitë e Tua, dhe plotësove fenë tonë, duke emëruar për Emirul-Muëminin Ali ibn Ebu Talibin a.s vëllain(jo në kuptim klasik të fjalës, vërejtje e përkthyesit) e Pejgamberit a.s dhe babain e pasardhësve të Pejgamberit, si dhe anëtarët e dalluar (famshëm) të Familjes së Pejgamberit a.s dhe pasardhësit e tij, kur na e zbritte ajetin kur'anor:“Sot jua kam përkryer fenë dhe kam plotësuar begatinë Time ndaj jush, dhe Jam i kënaqur që për ju islami të jetë fe“.(El Maide,3)
- O i Lartësuar! Falënderimi të takon Ty, që na ke bërë pasardhës-pasues të Pejgamberit Tënd të Zgjedhur dhe ndjekës të ndjekësit të tij në mësimet ummetit të tij. Na e dërgove Kur'anin e Shenjtë, na e preferove Pejgamberin a.s dhe Familjen e Tij, për të cilën na obligove ta nderojmë dhe duam, ashtu siç shpalle në Kur'anin e Shenjtë:“Nuk kërkoj prej jush asnjëfarë shpërblimi tjetër përpos atij që bën vepra të mira, ngase vërtet All-llahu shumë fal dhe i falënderuar është“.
- Njëra nga ngjarjet më vendimtare në Gadishullin Arab është paraqitja e të Dërguarit të All-llahut, e cila falë jetës shembullore të të Dërguarit-Muhammedit a.s dhe familje së Tij të pastër (a.s), udhëhoqën popullin e atëhershëm drejt jetës, qytetërimit dhe kulturës më të mirë. Jeta dhe rruga e tyre, e spikatur me madhësi dhe trimëri të pashiqe, pati rëndësi të madhe në histori, kështuqë si rrjedhojë-kjo histori u shëndrua në udhërrëfyes,mësuese dhe kujdestare e cila i nxorri njerëzit prej erësirës në dritë. Thyrrja e Pejgamberit a.s në islam pati përkrahjen e fortë të Benu Hashimëve (fisit të Pejgamberit a.s). Kjo thyrrje filloi në Gadisullin Arab, përkatësisht në Mekë-Shtëpinë e Zotit si qendër e thyrrjes së lartëmadhërueshme, pasi që shoqëria e atëhershme ishte e rrethuar nga idhujtaria, ndasitë etnike dhe përkatësia fisnore. Kjo mënyrë jetese, bëri që të humbet mësimi dhe ghurmët e njësmërisë së fesë së Ibrahimit, dhe që Shtëpia e Zotit të shëndrohet në qendër të idhujtarisë dhe t'i humbas çdo gjurmë e vlerës së Zotit, vlefshmëria dhe humaniteti. Në këto momente, kur netët e errëta dhe mugujt e paditurisë mbulonin qyellin mbi Tempullin e Zotit- Mekën, All-llahu xh.sh e dërgoi Pejgamberin e Tij të Shenjtë a.s që sërish të ftojë në njëshmërinë e Zotit: All-llahu Ekber!

- Jetërrëfimi i Pejgamberit a.s dhe Familjes së tij të nderuar a.s atyre të katërbëdhjetëve që erdhën njëri pas tjetrit, e shndërrisin(ndriçojnë) rrugën e islamit gjatë gjithë këtyre katërbëdhjet shekujve. Historiku I asaj Familjeje të nderuar, mbeti sikur ylli nriçues që i udhëheq njerëzit përmes natës së errtë, drejt rrugës së shpëtimit, të vërtetës dhe jetës së amshueshme. Kjo histori është e karakterizuar me dijen, imamin, devotshmërin (takvallëkun), xhihadin, pastërtinë dhe ndreshmërinë shpirtërore, ngase Ata ishin të vetmët udhërrëfyes që nuk u bënë lajka dhe nuk i trimëronin udhëheqësit e shtrembër, dhe të cilët në asnjë mënyr çfardo qoftë ajo nuk lajthitën nga udhëzimet dhe rruga e Zotit. Anëtarët e Ehlul-Bejtit a.s (Familja e Pejgamberit) ishin për njerëzit sikur anija në detin e xhahilijetit (injurancës), sikur që i nderuari Pejgamber-Muhammedi a.s tha :“Familja ime është sikur anija e Nuhit, kush noton në të- ka shpëtuar, ndërsa ai që e lëshon- do të përmbysset(zhytetit).“

- Numër i madhë dijetarësh kanë studiuar jetën e Ehlul-Bejtit a.s dhe kanë shkruar për jetën dhe veprat e tyre, të cilat karakterizoheshin në mirësinë, madhësinë, dhe fisnikërinë dhe mjeshtërisht e kanë përshkruar rolin dhe dijen e Tyre në ndërtimin e shpirtit sakrifikues të besimatrëve të drejtë. Caku i tyre parësor ishte mbrojtja e drejtësisë-pejgamberia burimore e Muhammedit a.s. Ja si Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s e ka parë të udhës se për ruajtjen e fesë së re islame është e nevojshme të sakrifikohesh. Që feja islame të jetë e mbrojtur, ekspozoi vetëvetën drejtë rrezikut dhe dëshirës për t’u sabufikuar. Kur fisi Kurejsh palnifikoi mbrojtjen e të Dërguarit, Muahmmedit a.s Imam Aliu a.s ishte shtrirë në shtratin e të Dërguarit a.s duke u paqëtur me caktimin e Zotit dhe i gatshëm i sulmuar. Përkitazi me këtë All-llahu xh.sh e zbriti ajetin e mëposhtëm kur’anor:“Ka nga njerëzit, i cili për hirë të All-llahut e flijon vetveten, e edhe All-llahu është shumë i mëshirshëm për robtë e vet.“ (El-Bekaretu, 207)

- Mes komenatorëve të Kur’anit dhe përcjellësve të hadithevem, është e njohur që ky ajet kutr’anor ka të bejë enkas për Imam Ali ibn Ebu Talibin a.s dhe rastin e mësipërpërmendur, përkatësisht shtrirjen në shtratin e Muhammedit a.s me qëllim që ai t’i ekspozoj sulmit në vend të Pejgamberit a.s\* Kështu Imam Aliu a.s vepronte edhe në të gjitha betejat në të cilat me Muhammedin a.s morri pjesë.

---

• El –Munakib 2:41, Ibn Sheher Eshvab.

Kur I Dërguari I Zotit a.s u shpërngul në ahiret, Imam Aliu a.s e hetoi (vërejti) nevojën e jashtëzakonshme për mbrojtjen e fesë islame dhe komentimin e Librit të All-llahut, ndaj nuk doli nga shtëpia e tij gjersa e tuboi tërë Kur’anin. Lidhur me këtë dëshmon thënja e Aliut a.s e cila është shënuar dhe përcillet gjer në ditët e sotme=„Unë u betova se nuk do ta lauj këmbën asnjë hap(nuk do të dal nga shtëpia) gjersa: të gjithë fletët e Kur’anit nuk i tubou në një tërësi“\*

- Pas kalimit të Pejgamberit a.s në ahiret, as-habët e Pejgamberit e morrën pushtetin, edhe pse Aliu a.s veten e tij e konsideronte për pasardhës të vërtetë të Muhammedit a.s. Mu për këtë, Imam Aliu a.s nuk iu betua (nuk i bej’at) Ebu Bekrit menjëherë, por këtë e bëri tek pas gjashtë muajsh. Për këtë vetë Imam Aliu a.s ka folur

kështu :“ E mbaja dorën shtrënguar, gjer sa fillova të shoh se shumë njerëz por largohën nga islami, duke u thirrur në shkatërrimin e fesë së Muhammedit a.s. Atëherë fillova të frikësohem, se nëse nuk e ndihmoj islamin dhe ndjekësit e tij, dhe në qoftë se në te (islamin, vërejtje e përkthyesit) paraqiten plasaritje dhe ndasi, e që për mua kjo do të paraqiste fatkeqësinë më të madhe se sa humbja e pushtetit që veçmë kishte ngjarë, e që parë nga çdo aspekt- është e shkurtër, pas së cilës gjithçka kalon ashtu siç kalon iluzioni (ajo që të paraqitet si fanitje), apo siç shkapërderdhet mjegulla. Ndaj edhe pranoj këtë që ndodhi, përderisa gënjestar nuk shkatërrohet e del shushazi dhe feja e arrin paqen dhe sigurinë.“

- I Dërguari i Zotit(a.s) në shumë raste ka përmenduar dhe rekomandaur Ehlul-Bejtin a.s për të cilën dëshmojnë shumë burime të vërteta e të verifikuara islame. Imam Muslimi në Sahihun e tij (4, hadithi nr. 1873, transmeton nga as-habi i Pejgamberit, Zejdi, biri i Arkames, si vijon:“ Një ditë Pejgamberi a.s në vendin e quajtur Khum, mes Mekës dhe Medines, mbajti një hutbe, dhe pasi që falënderoi All-llahun xh.sh tha :“Së shpejti do të thirrem dhe do të iki nga kjo botë në ahiret. Ua lë amanet dy vepra të rënda, Librin e All-llahut i cili përmban udhëzimet e dritën, dhe Familjen Time ndaj shikoni në to që të më ndiqni mua“.

- El-Hakim El- Nisaburi transmeton nga Zejdi i biri i Arkamit se Pejgamberi a.s ka thënë :“Së shpejti do të thirrem nag kjo botë për në ahiret. Ua lë amanet dy gjëra të rënda, njëra e përmbush tjetrën; Librin e All-llahut dhe Familjen Time, ndaj shikoni në to që të më ndiqni mua, ndërsa ata nuk do të ndahen( Libri i All-llahut dhe Familja Ime, vërejtje e përkthyesit) gjer në Ditën e Gjikimit.“ Pejgamberi a.s më pas shtoi „ All-llahu i Lartëmadhëruar është mbrojtësi im, ndërsa unë jam mbrurojë e çdo muslimani.“ Dhe pas këtyre fjalëve i Dërguari-Muhammedi a.s e mori dorën e Imam Aliut a.s dhe tha „ Mbrurojë e kujtë jam unë, edhe Aliu është mbrurojë e tij. O Zot! Bëhu mik i atij që është miku i Aliut, dhe armik i atij që është armiku i Aliut.“\*

-Dijetari Amin El-Nexhafi në veprën e tij voluminoze „ El-Gadir“ 10:278 transmeton dyzet thënie të Pejgamberit a.s mbi rëndësin dhe cilësit e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s :\*

---

\*El-Mustadrik në dy sahihët 3=109, alim El-Nisaburi

„ Aliu është Emirul-Muëminini (prijësi i besimtarëve), imami i të devotshmëve, udhëheqës i besimtarëve në xhennetin e botërave të Zotit. Do të shpëtojë ai që në të beson, ndërsa i shkatërruar do të jetë ai që nuk beson në të“.

„Kush më don mua, le ta dojë Aliun, e kush e urren Aliun, më ka urrejtur mua, ndërsa kush më urren mua, ka urrejtur ka All-llahun, e kush All-llahun e urren, All-llahu do ta hudhë në xhehennem.“

„Lum për atë që ty të do dhe në ty beson dhe mjerr për atë që ty të urren dhe të konsideron për gënjeshtar.“

-Cilësit e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s janë të shumënumërta dhe ato janë shkëndija të dritës, të së vërtetës, drejtësisë dhe udhëzimit, cilësi këto që e kanë karakterizuar personalitetin e Imam Aliut a.s.

-Dijetarët, Ibn Huxhr El-Askalani në veprën e tij „Tahzib El-Tahzib“ 10:42 dhe hafidh Xhemaluddin Jusuf El-Mezi në veprën e tij „ Tahzib al-Kamal“ 4:542 transmetojnë nga Ibn Abasi se Muhammedi a.s mbi cilësitë e Imam Aliut a.s ka thënë =„Sikur drunjtë lapsa të ishin, e deti ngjyrë, të gjithë xhinët të tubuar, ndërsa njerëzit shkrues, nuk do të ishin në gjendje t’i numërojnë kurrë cilësitë e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s“.

- Shumë dijetarë të rëndësishëm transmetojnë hadithin e Pejgamberit a.s në të cilin flitet për cilësitë e Imam Aliut a.s në të cilin thuhet:“ Vërtete All-llahu i Lartëmadhëruar e pajisi vëllaun tim Ali ibn Ebu Talibin me shumë cilësi të mira që nuk mund të numërohen. Kush e përmend një cilësi nga cilësitë e tij, duke e pranuar (atë cilësi, vërejtje e përkthyesit), All-llahu xh.sh para dhe pas do t’i falë mëkatet; kush e përshekruanë një cilësi nga cilësitë e tij, melaqet për të do të kërkojnë nga all-llahu xh.sh falje gjersa ai përshekrim të mbetet në letër; kush e dëgjon- rrespekton një nga cilësitë e tij, All-llahu xh.sh do t’ia falë mëkatet e bëra me anë të dëgjimit; ndërsa kush e shiqonë librin në të cilin gjenden cilësitë e Aliut, All-llahu xh.sh do t’ia fal mëkatet e bëra të të pamurit (syrit).“

- Mes transmetuesve të rëndësishëm të hadithit të sipërpërmendur janë edhe dijetarët: Ahtab El-havarizmi në veprën „ El- Manakib“ (El-Manakib :3, Ahtab El-Havarizmi), dijetari dhe muhadithi El- Xhuajn El- Horosani në veprën e tij,“Faraid El-Samtejn, “1:18; dijetari dhe hafidhi El-Kanxhi El-Shafi në veprën „ Kifajat El- Talib” : 252; dijetari El-Kanduzi në veprën e tij „ Janabin’ El-Mevada “:121 dh të tjerë. Sipas transmetuesve të njëjtë , i Dërguari Muahmmedi a.s ka thënë edhe këto fjalë: „Shikimi në Ali ibn Ebu Talibin është ibadet, të përmendurit e tij gjithëashtu është ibadet; ndërsa All-llahu xh.sh nuk do ta pranojë besimin(imanin) e robit të Tij, e as të robërve, nëse ato(robërit) nuk i kanë qëndruar lojal atij(Alit) dhe nuk janë distancuar nga armiqtë e tij“

-Dijetari Ahmedi ibn Hanbeli, Imami dhe themeluesi i medh-hebit hanbelit (vdekur në vitin 241 hixhri) transmeton Ibn Abasi i cili transmeton nga i Dërguari i All-llahut xh.sh i cili mbi cilësitë e Imam Aliut a.s ka thënë si vijon: „ Askush nga ashabët e Pejgamberit (a.s) nuk ka patur cilësi të çmuara aq sa ka patur Ali ibn Ebu Talibi. „ (Vakai’ El-Ajam 3: 474, Hajabani i cili e përcjell nga vepra“ El-Enver El-Bahija“ dhe „ Inshad El-Kulub” :21, të alimit Dejlemij.)

Dijetari Muhammed i biri i Idris Esh-Shafiut, Imamit dhe themeluesit të medh-hebit shafiit(vdekur më 304 hixhri), ishte mësuesi i Imam Ahmed ibn Hanbelit në lëminë e fikhut dhe hadithit.

-Kur Imam Shafiun e pyetën mbi cilësitë e Imam Aliut a.s ai tha:“Çfarë mund të them për cilësitë e tij, kur armiqtë e tij i kanë fshehur cilësitë e tij,për shkak të urrejtjes dhe zilisë, ndërsa pasuesit-ndjekësit e tij i kanë mbuluar cilësitë e tij, duke u frikësuar për veten e tyre nga përndjekjet dhe vuajtjet, mirëpo megjithatë për kundër këtyre dya fakteve, cilësitë e tij të çmuara prapëseprap dolën në shesh dhe e mbushën tërë botën.“

-Dijetari Ali Muahmmed Esh-Shafi, i cili është i njohur si alim Ibn Magazili Esh-Shafi në veprën e tij „Manakib Ali ibn Ebu Talibi a.s“ 468 thëniet e Pejgamberit a.s mbi cilësitë (vlerën) e Familjes së Tij a.s (Imam Aliun, hazrteti Fatimenë,Hasanin dhe Husejnin a.s ), e posaçërisht mbi cilësitë e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s transmeton si vijon:“ Abbasi biri i Fejruzit transmeton nga Enes ibn Maliku se Muhammedi a.s ka thënë:“Kush dëshiron ta njohë diturinë e Ademit a.s dhe fikhun e Nuhit a.s le ta shikojë Imam Ali ibn Ebu Talibin“(El-Bidaja Ve El-Nihaja, 7:357, Ulema Ibn Kethiri )

- Lisan El-Mizan 6:24, ulema ibn Hud El-Askalani

- Mizan El- I’tadal 4:99, ulema Muhammed El-Dhehebi

-Alimi Bejhekiu në „Sahihun“ e tij dhe Imam Ahmed ibn Hanbeli në „Musnedin“ e tij, ka thënë :“ Kush dëshiron ta njohë Nuhin a.s në vendoshmërinë e tij, Ademin a.s në në dijen e tij, Ibrahimin a.s në mirëbërësinë e tij, Musan a.s në urtësinë e tij, Isain a.s në thjeshtësinë (modestinë) e tij –le ta shohë Imam Ali ibn Ebu Talibin.“

-Me një rast Imam Aliu a.s fliste për vështirësitë edhe hekat të cilat i përjetoi gjatë jetës së tij si dhe rrëmuajt që do të pasojnë pas vdekjes së tij, e tha :“Askush nga ky ummet(popull) nuk ka nuk ka vuajtur aq sa kamë vuajtur unë.“

-Aliu, me ndihmën e All-llahut, devotshmërinë e tij të fortë si dhe vendos-shmërinë e pashoqe, arriti që drita(shkëlqimi) i tij, t’i kapërcejë të gjitha pengesat dhe muguajt e errësirës së atëhershme e të sotshme dhe kundër të gjithëve, ta shkëlqejë-shndërrisë botën, sikur që dielli shndërrit ditën e kthjellët.

-Duke e analizuar hadithin e Pejgamberit a.s të cilin e transmetojnë ulematë: Ahtab El-Havarizmi në veprën e tij « Manakib » fq 34 ; El-Kanduzi »Janabin El-Mevada » fq 149 ;150 Ibn Huxhr El-Askalani El-Shafi në veprën El-Isaba 1:541; për pozitën e Imam Aliut a.s dhe pasardhësit e tij të ndershëm ; do të kuptojmë se Pejgamberi a.s i ka konsideruar nga më të mençurit e ummetit, hadithi është si vijon : »Kush dëshiron të jetoj ashtu siç jetova unë dhe të vdesë siç vdiqa unë, e të hyjë në Xhennetin në të cilin mua ma ka premtuar All-llahu im, e që është Xhenneti i përhershëm ; le ta ndjek Aliun, ndërsa pas Aliut pasrdhësit e tij ; ngase ata juve nuk do t’ju zbrapsin nga udhëzimi i Drejtë e as që do t’ju shpiejnë në humbje. »

-Që Emirul-Muëminini-Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte i vetëdijshëm për pozitën e vet tek All-llahu xh.sh, dh tek Pejgamberi a.s. I nderuar, si dhe në zemrat e besimtarëve të devotshëm, e vërtetojnë fjalët në të cilat vet ai e përshkruajti pozitën e vet tek Pejgamberi a.s « Djeni, vërtetë vendi im është te Pejgamberi a.s nga fakti i farefnisë dhe pozitës posaçërisht. Kur isha fëmijë (Pejgamberi, vërejtje e përkthyesit) më merte në krahët e tij. E kishte për zakon të më merte (shtrëngonte) në krahërorin e tij dhe të më vendoste pranë tij në shtratin e vet. E ofronte trupin e tij pranë trupit tim kështu që më mundësonte të ndjejë aromën e tij të këndshme. Zakonishtë kur përtipte diçka, më jepte edhe mua kafshore pas kafshoreje. Asnjëherë nuk gjeti gënjestër në të folurit tim, e as dobësi në cilëndo nga veprimet e mija... Ndërsa unë e ndiqja ashtu siç ndjek vogëlushi gjurmët e mëmës së vet. Çdo ditë më tregonte, nëpërmjet diturisë së tij, disa nga cilësitë e tij dhe më urdhëronte t’i ndjek. Çdo vit shkonte e vetmohej në Hira (shpellau ku i’u shpall Vahji, vërejtje e përkthyesit) ku askush tjetër nuk e shihte, përveç meje. Atëbotë isami nuk ishte i pranishëm, në asnjë shtëpi, përveç në shtëpinë e të Dërguarit të Zotit a.s dhe Hadixhesë. Isha i treti pas tyre. E pashë shkëlqimin e Shpalljes dhe e thitha aromën e Pejgamberisë. » (*Manakibi i Imam Aliut a.s: 3; hafidhi dhe ulema Ali ibn Muhammed El-Shafi, i cili është i njohur si Ibn Magazili*)

Pamë se si Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e përshkruajti pozitën e vetqë kishte tek i Dërguari Muhammedi a.s. Ai në një fjalim, gjithashtu e përshkroi edhe pozitën e Familjes së Pejgamberit a.s; duke thënë: « Ne jemi trangu i Familjes, vendi i përhershëmi mesazhit, vendlëshimi për melaqet, mimëra të dijes, burimi i urtësisë. Ai i cili na ndyhmon dhe na donë neve le të presë mëshirë, ndërsa armiku ynë dhe ai që na urren, le të presë hidhërimin.

-Ne jemi mbrojtësit dhe ruajtja e portës së Ehlul-Bejtit. Në shtëpi hyhet vetëm nëpërmjet portës së tyre, kush tjetërfare hyn, e jo nëpërmjet portës, konsiderohet vjedhës. »

- Dijetari i nderuar dhe i madh, i cili i përket pasardhësve të Familjes së nderuar të Pejgamberit a.s dhe është shërbëtor i përhapjes së diturisë së saj : Sahibuldin Ebu El-

Ma'ali El-Husejni El-Marshi En-Naxhafi, All-llahu xh.sh ia ndriçoftë varrin e tij dhe e lartësoftë pozitën e tij në Ahiret; ka thënë : »Vërtetë cilësitë (vlerat) e imamit të të devotshmëve; Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s ; udhëheqësit të famshëm të të shtypurve dh të dobtëve, margaritarit të kurorës së islamit, babait të shpirtit të Pejgamberit a.s (Hasanit dhe Husejnit), vëllait të Pejgamberit a.s bashkëshoriti të hazreti Fatime Zehrasë, nderit të islamit dhe krenarisë ; janë të shumënumërta, të cilat kurrën e kurrës nuk do të zhduken. (*Shtegu i Elokuencës*)

- Ndërsa vetë Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s për vetveten dhe Familjen e Pejgamberit a.s ka thënë si vijon: »Pasha All-llahun! Fitova dituri në transmetimin e thirrjes(mesazhit), përmbushjen e premtimit dhe dëshmitë t'i vërtetojë. Ne Familja e Pejgamberit a.s ruajmë dyert e urtësisëdhe ndriçimin e pejgamberisë. Kini kujdes, vërtetë ligjet e fesë janë një, dhe rrugët e saj të drejta. Ai i cili i mban, arrinë dhe mbiarrinë, kurse ai i cili është larguar nga to, është i humbur dhe i bërë pishman. Ehlul-Bejti është jetë për diturinë dhe vdekje për injorancë. Ëmbëlsira e tyre ju flet për diturinë e tyre, ana e jashtme për brendësinë e tyre, ndërsa heshtja e tyre flet mbi urtësinë e të folurit të tyre. Nuk atakojnë të Vërtetën, e as që ndahen prej saj. Janë mbështetës të Islamit dhe strehim për të mbrojturit. Me ato E Vërteta është kthyer në pozitën e vet, kurse gënjeshtria është zhdukur nga vendsterhimi i vet, ndërsa gjuha e saj është prerë nga rrënjët. Ato e kanë kuptuar fenë me kujdes dhe vëmendje, e jo me anë të ruajtjes dhe transmetimit, ngase vërtetë transmetues të fesë ka plotë, por shumë pak ka mbrojtës së saj. (*Manakibi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s-komenti i Muhammed Baker El-Bahbudi-botuar në Bejrut në „ Dar El-Adva, viti 1983*)

- Vërtet cilësitë e Imamit të të devotshmëve dhe prijësit të besimtarëve Ali ibn Ebu Talibit a.s janë të mëdha dhe të shumta. Për to kanë shkruar dijetarët e mëdjenj të drejttimeve sunite dhe shiite.Nëse i shfletojmë librat e proviencës sunite, do të hasim mbi dyzet vepra për cilësitë dhe vlerën e Imam Aliut a.s mes autorëve të cilëve do vërejmë vetëm ca nga emrat e e njohur të ulemave siç janë: Ahmed ibn Hanbeli, Ahmedi i biri i Shuajb El-Nisaijut, Xhelaluddin Abdurrahman Et-Taberiu, Muhammedi i biri i Ibrahim El-Hamavinit, Ebu Nuajmi, Ahtab El-Havarizmi, Thabit ibn Kajjim El-Xhavziju, Kalani biri i Muhammed El-Balaki El-Kandusit, Muhammed Muëmin El-Shalabandi dhe ulema tjerë të njohur. Duke ia shtuar kësaj edhe përshkrimët e haditheve të Pejgamberit a.s në gjashtë Sahihët e botës islame, si dhe veprat të cilat i kanë shkruar ulematë shiitë përgjatë katëmbëdhjetë shekujve, do ta plotësojnë fotografinë mbi cilësitë dhe vlerat e Ali ibn Ebu Talibit a.s

- Besnikëria (lojaliteti) dhe dashuria ndaj Ehlul-Bejtit a.s është e nevojshme për dashurinë dhe besnikërinë ndaj Pejgamberit të nderuar a.s, e kjo njëherit nënshtrim ndaj All-llahut xh.sh, për të cilën dëshmon fjalimi i Pejgamberit a.s kur i'u drejtua ummetit duke i thënë:“ Duajeni All-llahun për dhuntitë (niëmetet) me të cilët u ka rrethuar, më duani mua për dashurinë nda All-llahut xh.sh duajeni familjen time për dashurinë ndaj mua.“

- „ Do të përpiqem-ndërhyj për ju në Ditën e Gjykimit, ndaj kush është armik imi, All-llahu do të jetë gjithashtu armik i tij, e kujt All-llahu i është armik, atë All-llahu do ta hudhë në Xhehennem.“

- Në fund, siç është e dijtur, garanca më e mirë që e pret njeriun në Ditën e Gjykimit është-Besimi në njëshmërinë e All-llahut xh.sh (tevhidi, vërejtje e përkthyesit) dhe në Ditën e Gjykimit; nënshtrimi ndaj All-llahut të Lartëmadhëruar; besimi në pejgamberinë e Muhammedit a.s të Dërguarit të All-llahut xh.sh; dashuria dhe lojaliteti ndaj Familjes së Pejgamberit a.s e cila është mbajtur fort për litarin e

Mustadrek në dy sahihët (Buahri dhe Muslimi) 3:150, ulema El-Vakem El-Nishapuri. Isa'f El-ragibin në komentim të veprës „Nur El-Absar“: 114, alim Ibn Shalabandi. All-llahut, shtegun e qartë dhe rrugën e drejtë. Dobia më e madhe për të cilën njeriu shpreson në Ditën e Gjykimit është shefa'ati (ndërmjetësimi) i tyre tek All-llahu xh.sh në ditën kur asgjë nuk do t'ju sjell dobi, madje as bijtë e juaj, vetëm ai që me zemrën e pastër do të vijë para All-llahut, do të jetë i shpëtuar“... Qoftë bekimi i All-llahut mbi mësuesin tonë Muhammedin a.s vulën e Pejgamberëve i cili shpie drejt rrugës më të mirë; mbi Familjen e tij të ndershme, ndriçuesit e udhëzimit dhe anijet e shpëtimit; mbi as-habët e tij të ndershëm, yjet e besimit të fortë!

- All-llahu xh.sh e pranofte këtë vepër tonën e cila do ta ndriçojë rrugën e Zotit dhe bukurinë e Islamit! Bekimi i All-llahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhammedin a.s dhe Familjen e tij të ndershme! All-llahu xh.sh e kthjellofte mendjen tonë dhe i gëzoftë zemrat tona! All-llahu xh.sh na shpërblefte për këtë vepër në këtë botë dhe në ahiret !

- Vërtet All-llahu xh.sh është dhurues i Cili dhuron dhe falës i cili falë!

- Ne dëshiroam atyre që në tokë ishin të shtypur, t'i mbulojmë me mëshirë dhe udhëheqës e trasgëgimtarë t'i bëjmë. ( nga Kur'ani).

- Gjithë falëndrimi i takon All-llahut, Zotit të botërave, i cili e Dërgoi të Dërguarin e Tij-Muhammedin a.s të birin e Abdull-llah El-Mustafe, mëshirë për botërat. Falëndrimi i qoftë All-llahut! Më Fisnikut, i Cili i dha njerëzimit udhëheqës që do të na udhëheqin drejt rrugës së vërtetë, ndërsa pas vdekjes së Pejgamberit a.s do të përpiqen për ne...

- Kjo ide e udhëheqjes është quajtur imamat ( udhëheqësi) dhe pas vdekjes së saj, askush nuk mund të shpresojë në kënaqësinë e All-llahut, përkundër lutjeve ndaj Tij apo veprave të mira në këtë botë, si dhe në botën e ardhshme.

- Aq është i rëndësishëm imamati, sa që nëse nuk besoni në udhëheqësit dhe nuk i ndiqni ata, ju nuk mund të shpresoni jetë të rehatshme pas vdekjes.

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s është përmendur shumë herë në Kur'anin e Madhnueshëm. Gjithë këto përmendje ja pozitive të shoqëruara me lavdërim dhe rrespekt. Si është e mundur që Fjala e Fundit e All-llahut xh.sh të ishte falëndërimi ndaj këtij Imami, ndërsa ai gjatë shekujve të jetë i mallkaur nga mimberi i xhamive përskaaj mbretërive muslimane? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje do të mund të gjendej vetëm nëpërmjet hulumtimeve të sinqerta dhe objektive, të cilës duhet qasur me zemër të hapur dhe dëshirë të sinqertë, të arrihet dhe të del në shesh e vërteta.

- Sa u përket muslimanëve, ata ishin të larguar nga pikëpamjet e drejta, ndaj vetëm me ndihmën e All-llahut, mund t'i hudhin dhe flakërrojnë tej aleancat dhe komplotet për thirje në të kaluarën, e cila nuk çon askundi pos në atë që më pas edhe pendimi nuk do të mundet t'u sjell dobi. Vetëm All-llahu xh.sh për hir të mëshirës ndaj Pejgamberëve të Tij, dhe imamëve, mund t'i nxjerr nga errësira ku kanë rënë, njësoj sikur edhe mosbesimi, injoranca, madje madhësia, zilia dhe kryeneçësia.

- Kjo vepër, që tani ju mbani ner duart e juaja lexues të nderuar, është një përpjekje modeste dhe e vogël për të shpjeguar personalitetin e Emirul-Muëmiminit-Ali ibn Ebu Talibit a.s dhe të prezentojë të vërtetën mbi të, ndërsa të gjitha pyetjet që e rrethojnë këtë



Njeri të madh bazohen vetëm në një fjalë: drejtësi.

- Është e rëndësishme, gjithashtu të shpjegohet dallimi mes rëndësisë së Imamit dhe Halifit. Emëritmi Imam i drejtohet dhe ekskluzivisht i atribohet Imam Aliut, birit të Ebu Talibit dhe bijëve të tij, Imam Hasanit dhe Husejnit a.s si dhe nënët bijve të cilët rrjedhin nga Imam Husejni a.s Ata ishin të zgjedhur nga All-llahu xh.sh e jo nga njerëzit. Ndërsa, nga ana tjetër Halifët zgjidheshin nga nëpunësit administrues, për funksione politike.

- Fatkeqësihtë, ashtu siç nuk ndahet politika dhe dini (feja) në Islam, kështuqë të zgjedhurit nuk janë përherë të kualifikuar të komentojnë qëndrimet dhe rregullat e fesë, ndaj ka ngjarë, madje fatkeqësisht edhe sot po ngjet tëhuajësimi në shoqëritë muslimane. Mirëpo, fatmirësisht besimtarët musliman me ndihmën e All-llahut xh.sh edhe përkundër ngjarjeve të sipërpërmendura, ishin në gjendje të shohin (njohin) të vërtetën. Duke ju falënderuar kësaj, pozita e Imam Aliut a.s sa vinte e bëhej më e çmuar, për të cilën do të kuptoni duke e lexuar këtë libër të vogël.

- Historia e Islamit është padyshim njëra nga më të tronditshmet dhe më të mjegulluarat-fatkeqësisht, përplot zënka, mistere, por gjithashtu për t'gjitha këto fatmirësisht ka argumente të qarta. Muslimanët, por edhe gjithë të tjerët që janë të interesuar për islam, për të pasur fotografinë e qartë të kuptimit të islamit që nga themelet, duhet ta njohin historinë e tij (islamit, vërejtje e përkthyesit). Pak fe të tjera ka, ku janë të përziera shumë ndodhi të fshehta dhe sjellje të njerëzve, të cilat kanë shkaktuar ripërtërim të rregullave konform caktimeve të Zotit, të cilat i ka përcjellur i Dërguari Muahmmedi a.s, dhe nuk ka asnjë fe tjetër që të ketë siguri kaq të shpejtë. ( në ruajtjen e mësimëve islame burimore- nga këndvështrimi i ndryshëm, vërejtje e përkthyesit).

- Duke e studjuar historinë e Islamit do të vërtetohemi se për asnjë person dhe emër nuk është diskutuar kaq shumë, sa për Emirul-Muëminin-Aliun a.s të birin e Ebu Talibit. Për të janë thënë plotë të vërteta të shumta, por, edhe të pavërteta, kështuqë si rrjedhojë e kësaj shpes vie gjer te paqartësitë rreth personalitetit dhe rolit të tij në ndodhitë e asaj periudhe kohore.

- Shkrimtarët islamë janë përpjekur të japin fotografinë e qartë për të dhe ngjarjet historike që e kanë shoqëruar nga lindja gjer në vdekje. Dialogje të shumta janë bërë mes sekteve të ndryshme për të. Akoma e kemi mundësinë, që kur të flasim për Imam Aliun a.s, vetëm të prekim“majën e bregut të akulltë.“

- Menjëherë pas vdekjes së Pejgamberit a.s të nderuar pozita e Imam Aliut filloi të anashkalohet dhe ai me vetëdëshirë nisi të izolohej. Ai është zgjedhur nga All-llahu xh.sh, në vendin e quajtur Gadir Hum, Pejgamberi Fisnik e emëroi që ta merr udhëheqjen pas tij. Më shumë se 100.000 muslimanë ishin dëshmitarë të asaj zgjedhjeje (nga Pejgamberi a.s vër.e përkth.) dhe emërtimi, ndaj ia shfaqën lojalitetin atij (Aliut) në atë kohë dhe vend. Kjo ndodhi 25 vjet përpara se ta merrte pozitën që i takonte sipas rregullës. Ai udhëhoqi më pak se pesë vjet përpara se të vritej tragjikisht nga dora e dorasit të paguar. Në moshën 63 vjeçare u shua drita e tij e kësaj bote, ndërsa iu hap drita (nuri) i Ahiretit. Rrethi i tij ishte i jashtëzakonshëm ngase njëkohësisht ishte edhe Imam edhe Halif I muslimanëve. Pasardhësit e tij ishin Imamë të udhëheqjes së muslimanëve në çështjet fetare, por nuk e kishin mundësinë që vërtetë ta merrnin pozitën e Halifit si udhëheqës politik. Kurdoherë dhe kurdoqoftë kur qartazi dukej se ata ( pasardhësit e Aliut a.s vër. e përkth.) mund të zgjidheshin për Halifë për shkak të

popullaritetit të tyre që gëzonin në popull, pamëshirshëm vriteshin kryesishtë nga prita ( prapa shpine), përveç të fundit prej tyre, Imam Mehdiut a.s të cilin ne jemi duke e pritur.

- Ne e përbetojmë Imam Aliun a.s që të na ndihmojë në prezentimin e historisë së jetës së tij, ayre që nuk dijnë asgjë për të si dhe për ata që e kontestojnë të drejtën e tij.

- Pjesa e parë e këtij libri do t'i vë në pah të dhënat më të rëndësishme për të kuptuarit e prejardhjes së tij, vendin e tij te I Dërguari a.s I All-llahut xh.sh si dhe në mesin e muslimanëve.

- Në pjesën e dytë të biografisë së Imam Aliut a.s në rrjedhën e biografisë së Ehlul-Bejtit a.s do ta shqyrtojmë Imamatin dhe Halifatin e prijësve të besimtarëve, Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s. Urtësia e tij e paaritshme por edhe e pavërejtur gjatë kohës së tre halifëve, gjë që është shpjeguar në pjesën e parë. Gjatë kohës së udhëheqjes si Halif i zbatoi qëndrimet e tij, më fisnike të dijës së tij, gjë që e vendosi në krye të vendit, ndërsa sundimi i tij ishte i karakterizuar me seriozitetin më të madh në kundërshtim ndaj armikut, butësinë ndaj të shtypurve, mëshirës ndaj të varfërve, dorëdhënien ndaj të mjerëve (miskinëve). Ishte i ndershëm ndaj obligimeve, dha dashurisë që kishte për fëmijët e tyre.

- Ne dëshmojmë se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut Një të Vetmit, dhe se Muhammedi a.s i biri i Abdull-llahut është Pejgamber i Tij, si dhe Imam Aliun a.s biri i Ebu Talibit është trashëgimtar i Pejgamberit a.s

- Lusim All-llahun xh.sh Mëshiruesin më të Madh t'i dërgojë selame të Dërguarit të Tij-Muhammedit a.s dhe Emirul-Muëmininit-Ali ibn Ebu Talibit a.s!

- E lusim All-llahun xh.sh Të Ghithëmëshirshmin, për ndihmë në këtë vepër!

- Me All-llahun xh.sh vijmë ndihma dhe sukcesi!

I Dërguari Muhammedi alejhisselam ka thënë:

„ O Ali, ti ishte i pari prej muslimanëve që më besuan, Ti ishte i pari prej muslimanëve që e pranove Islam. Ti je për mua sikur Haruni për Musain .(1)

## **Emirul-Muëminini- -Ali ibn Ebu Talibi**

*« Askush asnjëherë nuk ka vuajtur nga ummeti i tij, ashtu siç kam vuajtur unë ».(2)  
(Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s)*

- Asnjë personalitet i lartë historik nuk ka duruar aq padrejtësi dhe të këqija, siç duroi Ali ibn Ebu Talibi a.s gjatë jetës së tij si dhe pas shpërnguljes së tij nga kjo botë. Jeta e tij ishte e mbushur përplot trimëri dhe famë, por prapëseprapë padrejtësia iu vërsul atij dhe e ndoqi gjatë gjithë jetës si dhe pas vdekjes. Një kohë bukur të gjatë pas shahidllëkut ( martirizmit) të tij, ai ishte i privuar nga e drejta më e thjeshtë, të ketë biografinë e tij dhe vendin e tij të merituar në historinë e shkruar e të sinqertë. Shumë gjenerata të ummetit islam i ishin ekspozuar gënjeshtres së paparë dhe dredhive të pashembullta, pas vdekjes së Imamit, kështuqë ekzistonte rrezik të harrohej Imam Aliu a.s dhe roli i tij i dobishëm në hapat e para të lëvizjes islame që më vonë rezultoi drejt madhështisë dhe famës. Ato bëma të Aliut a.s që nuk kishin mundur të harrohen, ishin shtrembërruar dhe paraqitnin fotografinë e rrjshme për të.

- Gjithashtu duhet ditur edhe ajo se për dekada me rradhë folësit nëpër faltore rrejshëm informonin popujt muslimanë, duke fyer e folur keq për Imam Aliun a.s dhe rolin e tij të rëndësishëm në histori. Këtë, ato e konsideronin mënyrë më perfide për të ndikuar në popull. Ky dënim ishte i merituar nga armiqtë e islamit, në shenjë hakmarrjeje ndaj humbjeve që dikur pësuan idhujtarët në betejën e Bedrit.

- Gjatë kohës së sundimit të rregjimit të Emevitëve, namazxinjtë (ato që falnin namaz) për shembull, në fillim të xhumasë e mallkonin Aliun a.s me fjalë të cilat madje edhe historia ka refuzuar t'i shënojë në faqet e saja (3). Ky akt i shtrembërimit të fesë, fort e njolloste fotografinë dhe karakterin e Imam Aliut a.s e që ndihmohej fort dhe dhunshëm nga rregjimi, ndërsa këtë lojë të fëlliqtë e luanin folësit e paguar, tradicionalistët, historianët e oborreve të pallateve etj.

- Përkundër tendencave të këtilla të ndërpritet e vërteta, asnjëherë askush nuk mundi t'a ndal të vërtetën e cila nëpërmjet mjegullave të komplotit doli në dritë, kjo falë natyrës heroike të Islamit dhe drejtësisë së tij. Gënjeshttrat dhe intrigat ishin të shkurtëra ashtu siç ishte edhe komploti i gatuar më dyfytësi. Kështuqë grupi i komplotistëve bashkë me shkrimtarët e tyre të parapaguar tentuan ta shtrembërojnë biografinë e Imam Aliut a.s sipas tekeve të tyre të shëmtuara, interesave mesquine, qëllimeve të dëmshme e të këqija, ngase ato siç duket e kishin harruar faktin se e vërteta nuk mundet përgjithnjë të fshihet: „ Kjo gënjeshtër u hoq nga sipërfaqja.“

- Lënda e studimit është rregulluar në dy pjesë, nga të cilat, ashtu siç edhe e përmendëm më sipër, e para është biografia e shkurtër e Emirul-Muëmininit-Ali ibn Ebu Talibit a.s gjatë jetës së Pejgamberit-Muhammedit a.s dhe kohës së sundimit të tri Halifëve të parë. Pjesa e dytë e sundimit shkoqit vetë jetën e tij, përkatësisht periudhën kur Imam Aliu a.s u morr me udhëheqjen e bashkësisë islame.

- Jemi përpjekur ta rrëfejme heroizmin dhe fisnikërinë e tij në fushën e politikës, administratës dhe ekonomisë së shoqërisë, si dhe udhëheqjen gjatë kohës së paqes dhe luftës.

- Segmenti i tretë, i publikuar në pjesën e dytë, përcakton karakteristikat e spikatura ( të veçanta) të Emirul-Muëmininit-Aliut a.s si dhe prezentimi i afërsisë së tij me All-llahun xh.sh dhe popullin rreth tij.
- Lusim All-llahun xh.sh për udhëzim, mbrojtje, udhëheqje dhe ndihmë në përpjekje që t'i forcojë të gjitha energjitë tona, dhe mundësinë e sigurtë të besimit se konfliktet e sotshme ideologjike të ummetit Islam dhe të armiqëve të përbetuar të Islamit, do të tejkalohen dhe përfundimisht do të mposhten.  
Ai All-llahu vërtetë dëgjon lutjet tona dhe Ai është Mbrojtësi më i Mirë!

## Lindja

- E premtë, 13-ti i maujit të bekuar Rexhep, dymbëdhjetë vjet para caktimit të Muhammedit a.s për të Dërguar të All-llahut. Fatimeja e bija e Asedit ndje se do të lind fëmijë. Ajo erdhi në Qabe dhe duke e përshkruar, iu lut Zotit të Madhërishtëm:  
„ o All-llah! Unë besoj në Ty, në të Dërguarin Tënd, në librin e Shenjtë që e ke zbritur. Unë besojë në atë që ka thënë ghyshi im Ibrahim El-Halili a.s i cili e ndërtoi Shtëpinë e Shenjtë-Qabenë. Kështuqë për hirë të ndërtuesit të kësaj Shtëpie dhe për hirë të fëmijut që e kam në bark, të lutem ty që dhimbjet e lindjes të m'I lehtësosh“(4)
- Fatimeja bija e Asadit u mbështet në murin e Qabes për të pushuar. Çuditërisht muri u hap, dhe Fatime bint Asad hyri brenda , dhe muri prapë u mbyll pas saj.
- Axha I Muhammedit a.s, Abbas ibn Abdul-Mutalibi e vërtetoi këtë çudi. Ai dhe shokët e tij u vërsulën drejt dyerve të mbyllura të Shtëpisë së Shenjtë, duke u përpjekur më kot që t'i hapin.
- Duke kupruar se kjo është një ndodhi e jashtëzakonshme, ata ndalën tentimin e tyre për të hyrë në Qabe.
- Lajmi për këtë ngjarje të çuditshme sa era u përhap në qytetin e Mekes.
  
- Imam Aliu u lind në Qabe me sytë e mbyllur, ndërsa trupin e tij të njomë solemnisht e paralajmëroi All-llahi i Plotëfuqishëm.
- Fatimeja në Qabe kaloi tri ditë, ndërsa të katërtën ditë doli duke mbajtur në duart e saja fëmijën e vet dhe shkoi drejt te Muhammedi që të pasalindurin ta vëjë në duart e tij besnike. Atëherë Muhammedi a.s e lexoi ezanin dhe tekbirin në veshët e fëmijut.
- Lindja e Imam Aliut a.s në brenda Qabesë së Shenjtë është e vetmja lindje e tillë në botë. Asnjë Pejgamber nuk është bekuar dhe nderuar kësisoji. Fakti i pakontestueshëm se Qabeja është vendi i lindjes së Ali ibn Ebu Talibit a.s është i njohur në të gjitha historitë.(5)
- Lajmet e bekuara dhe të gëzuara ju përcollën Ebu Talibit (6) dhe banuesve të shtëpisë së tij, dhe ato fllitnin se si e kanë parë Muhammedin-Mustafanë a.s duke e mbajtur Aliun në duartë e tij, dhe se është nisur drejt shtëpisë së Ebu-Talibit, shtëpi në të cilën edhe ai vetë kishte jetuar dhe ishte edukuar.
- Me këtë rast u shtrua një gosti e madhe. U therën shumë dele në shenjë të të pasalindurit. U shprehën përgëzime nga të gjithë si dhe nderime të shumta për bajraktarin e tyre të Benu Hashimëve Ebu Talibin dhe fëmijun e tyre.
- Ditët iknin shpejtë, ndërsa fëmija i bekuar rritej e merrte shtat në duart e prindërve të tij dhe kushëritit të tij Muhammedit a.s i cili e vizitonte shtëpinë e axhës së tij, shtëpi në të cilën ai më parë përjetoi shqetësimet e ngrohat djaloshare dhe thithi nga burimi i sinqeritetit dhe përkushtimit qysh në vitet e fëmijërisë dhe rinisë. Muhammedi

a.s gjithnjë e vizitonte shtëpinë e axhës së tij edhe atëherë kur ishte i martuar me gruan e tij Hadixhenë, me të cilën jetonte në shtëpinë e vet. Ai e ushqente Aliun dhe e mbulonte me dashurinë dhe përkujdesej me devocion për të, duke e marrë në krahë dhe duke ia përkundur djepin.(7)

## **ALIU NËN MBROJTJEN (PËRKUJDESJEN) E TË DËRGUARIT-MUAHMEDIT A.S**

Kaluan gjashtë vjetë nga lidja e Aliut. Kurejshët, fisi nga i cili rrjedh Muahmmedi a.s përjetuan krizë të thellë ekonomike e cila fort ndikoi (e goditi) Ebu Talibin, i cili si kryefamiljar i popullit të varfër, i cili i drejtohej atij për ndihmë, ngaqë përfaqësonte personalitet eminent në shoqërinë e Mekës, i ndihmonte familjes së madhe me aq sa mundej.

- Vetëm Pejgamberi a.s dhe fisi i tij Benu Hashim e kuptojnë situatën e rëndë të udhëheqësit të vet. Ndaj, mu për këtë Pejgamberi a.s shkoi tek El-Abbas bin Abdul-Mutalibi, më pasaniku i fisit Benu Hashim, dhe i thotë : „ O xhaxha! Vëllai yt Ebu Talibi ushqen familje të madhe, ndërsa populli është tejet i pikëlluar me situatën. Vemi t’ia lehtësojmë brengën, ngase ai edhe neve na ka ushqyer.“(8)

- Propozimi i Pejgamberit a.s u prit me zemërgjërësi nga xhaxhai i tij El-Abbasi dhe së shpejti të dy u nisën për te Ebu-Talibi, dhe e lajmëruan për atë që kishin biseduar. Ebu Talibi në gjithë këtë u shpreh:“ Nëse Akilin dhe Talibin m’i punësoni e kështu ata më ndihmojnë, unë do t’ju lejoj juve të merni gjithçka nga unë që ju pëlqen.“(9)

- El-Abbasi e morri Xhaferrin, ndërsa Pejgamberi a.s morri Aliun, i cili atëbotë ishte vetëm gjashtëvjeçar.(10) Me zgjedhjen e Aliut a.s Pejgamberi a.s tha :“Unë e zgjodha atë që All-llahu ma caktoi nga ju, Aliun „,(11)

- Kështu Aliu a.s që nga fëmijëria e hershme jetoi nën mbrojtjen e të Dërguarit të All-llahut xh.sh, u rrit nën mbikëqyrjen e tij dhe nga vetë burimi thithi butësinë dhe kreativitetin sakrifikues për Islam. I dërguari i All-llahut xh.sh si mbrojtës dhe përkujdesës i tij e mësonte dhe ushqente vetë. Ai kurrë nuk u nda nga ai gher sa u shpërngul tek All-llahu i Lartëmadhëruar.

## **FRYTI I EDUKATËS SË PEJGAMBERIT A.S**

- Imam Aliu a.s ka pohuar, se pjesën më të madhe të diturisë e ka fituar-nxënë nga mësuesi i tij, Pejgamberi a.s.

- Në njërën nga fjalimet e tij, të njohur me emirin El-Kasiah (fjalimi i qorimit) ka thënë: „ E dini mirë vendin tim pranë Pejgamberit a.s-duke pasur parasysh afërsinë gjinore dhe pozitën e posaçmë. Kur isha fëmi, ai më merrte nën mbrojtjen e tij. E kishte zakon të më shtrëngonte në krahë dhe t’me vendoste pranë në shtratin e tij, ta afronte trupin e tij pranë trupit tim dhe me këtë t’me mundësonte ta shijojë aromën e këndshme të tij. E kishte të përtypete diçka dhe mandej t’ma jepte pak nga pak. Kurrë nuk ka gjetur gënjeshtër në fjalët e mia, e as dobësim në çfarëdo veprimi tim. Që nga koha kur ate-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij! e ndanë nga sisa, All-llahu pranë tij e caktoi melaqen më të madhe të Vetin për të udhëhequr edhe ditën edhe natën rrugës së mirësisë dhe mirësjelljes së njerëzve. Kurse unë e kam ndjekur pas si mëz i deves i cili ndjek gjurmët e nënës së tij. Për çdo ditë më tregonte, me shembuj,

disa nga vetitë e tij dhe më urdhëronte t'i ndjek. Ç' do vjet shkante në izolim në Hira, ku e kam parë, por ku askush tjetër nuk e ka parë. Atëbotë Islami nuk ka qenë i pranishëm në asnjë shtëpi pos në Shtëpinë e Pejgamberit të Zotit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi Familjen e tij! dhe Hadixhes. Kam qenë i treti pas atyre dyve. E kam shikuar dritën e Shpalljes dhe Porosisë dhe e kam shijuar aromën e pejgamberllëkut.”(12)

- Teksti i mësipërm me vetë fjalët e tij, rrëfen, se si Imam Aliu a.s qysh në fëmijëri kishte trajtim të veçantë nga ana e Pejgamberit a.s. Kujdesi, dhembshuria dhe përkujdesi vetëmohues i Pejgamberit a.s madje edhe për typja e ushqimit të cilën Aliut ia jepte në gojën e tij, duke e mbajtur gjithnjë në duart e tij, qartë na tregon se Pejgamberi a.s e ndjente sikur djalin e tij të dytë.

- Gjatë kohës së fëmijërisë dhe rinisë së Aliut a.s, Pejgamberi a.s investoi mund të madhë në formimin e personalitetit të tij, gjithnjë duke e mësuar të punojë sikur ai dhe ta ndjek shembullin e tij. Ç' do ditë i tregonte shembuj të ri të moralit të tij të lartë, gjë që Aliu a.s hap pas hapi e ndiqte. Ndaj nuk është gabim të thuhet apo të besohet se Aliu a.s qysh në fillim ishte zgjedhur gjithnjë për të komentuar Pejgamberin a.s, në dijen e tij, qëndrueshmërinë e tij, qëndrimet e tij të ndryshme në çështjen e udhëheqjes po bile edhe në të ecurit.(13)

- Imam Aliu a.s ishte shumë i pastër në shpirtë, i ndershëm dhe i moralshëm në ndjekjen e shembullit të Pejgamberit a.s. Shumë hije të fshehta që do të ndoshin në të ardhmen, ishin të ndriçuara përpara tij. Ai thotë:“ Kur Pejgamberi a.s e shpaloj Shpallje e parë, e kamë dëgjuar vajtimin e shejtanit, ndaj pyeta: „Ç’është ky vajtim (rënkim)? Ai (Pejgamberi a.s) u përgjegj :“ Ky është shejtani i cili e humbi shpresën se do t’i nënshtrohem. Në dëshprimin e tij vajton për shansin e humbur. O Ali, vërtetë ti dëgjon atë që dëgjojë unë dhe sheh atë që shoh unë, vetëm që ti nuk je Pejgamber. Ali ti je ndihmësi im dhe ti gjithnjë do të jeshë në anën e të së vërtetës dhe drejtësisë.“(14)

- Rrugë kjo, të cilën e arrijti duke e ndjekur rrugën e madhërisme të All-llahut xh.sh. Ky ishte rol që ishte i ndarë nga roli i Muhammedit a.s por atij (Aliut) i ishte dërguar sikur thirrje. Kështuqë ai plotësisht e meritoi të jetë ndihmës i Pejgamberit a.s. I tillë ishte Imam Aliu a.s.

## **NËN HIJEN E SHPALLJES**

-Edhe pse Imam Aliu a.s jetoi gjashtë vjet nën përkujdesjen e të jatit dhe vëllezërve të tij, rolin kyç në përkujdesjen e tij e pati Muhammedi a.s, dhe kjo paraqet një detyrë të veçantë dhe kthesë vendimtare në formimin e personalitetit të tij, gjë të cilën e kemi përmendur më herët në libër, përkatësisht ardhjen e tij në shtëpinë e Pejgamberit a.s për shkak të krizës që e kishte goditur të atin e Aliut.a.s Ebu Talibin. Që nga kjo kohë Imam Aliu a.s jetoi gjithnjë me Pejgamberin a.s duke duruar vështirësitë, që i përjetoi në rininë e tij të hershme si dëshmitarë i drejtëpërdrejtë i gjithë atyre ndodhive që ndodhnin në jetën e të Dërguarit të All-llahut xh.sh. Ndaj nisur kjo, edukimi dhe arsimimi i Imam Aliut a.s nuk ishte i rëndomtë dhe i natyrshëm, sikur që do të ishte po të edukohej nga i ati dhe vëllezërit e tij. Përvojën dhe mësimin e merrte duke u kënaqur nga ajo që si hije e ndiqte Pejgamberin a.s madje edhe gjatë kohës kur ai (Muhammedi a.s) izolohej në shpellën Hira, shpellë në të cilën iu rrëfyen dhe hapën fshehtësitë e mendjes dhe shpirtit, dhe me të cilat i Dërguari i All-llahut xh.sh e nisi rrugëtimin e tij pejgamberik.

- Imam Aliu a.s i kujton ato ditë vendimtare të periudhës së jetës së tij, duke i kujtuar:“Çdo vjet Pejgamberi a.s shkonte në izolim në shpellën Hira, ku e kam parë, dhe vetëm unë kam qenë me të e askush tjetër.(15)
- Po, ai ishte vetëm Aliu a.s i cili tregoi ndryshimet e mëdha shpirtërore të cilët ndodhën në shpirtin e Muhammedit a.s. Falë shpirtëgjërësisë dhe vetive të forta morale e shpirtërore, që shpirti i tij i arriti duke e ndjekur Shpalljen që i zbriste Pejgamberit a.s, Imam Aliu a.s thellë i ndjeu ndryshimet që do pasonin, e që ishin në botën e padukshme, në të cilën shejtani i mallkuar pasiqë pësoi humbje dhe shpresë se do të adhurohet, ishte përfundimisht i humbur. Ai-Imam Aliu a.s i vërejti parashenjat e pejgamberllëkut të cilat në një mënyrë tjetër e më të vogël se sa Mësuesit të tij-Muhammedit a.s iu dëftuan, para se drita hyjnore të shndërrit nëpërmjet ajeteve të Para të Shpalljes, udhërrëfyesin e tij Pejgamberin a.s që ia shpallën misionin e tij për mbarë njerëzit, pra ajetet e para:“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi(çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.“ (El-Alek, 1-5).

## **BESIMTARË E PARË**

- Duke e marë Shpalljen e parë të shpenjtë, dhe zbritjen e shpalljes, i Dërguari Muhammedi a.s e informoi Imam Aliun a.s për Shpalljen menjëherë pasi u kthye në shtëpi.(16). Imam Aliu a.s këtë e pranoi me besueshmërinë dhe vërtetësinë më të madhe, njësoj siç veptoi edhe gruaja fisnike e Muhammedit a.s hazreti Hadixheja, duke e mbështetur fort burrin e saj. Nga këto dhe këtu filloi qeliza e bashkësië së besimtarëve në sipërfaqen e tokës. Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se Pejgamberi a.s kurrë nuk e thiri në Islam Imam Aliun a.s ashtu siç veptoi më vonë me njerëzit e tjerë, ngase ai-Aliu a.s veçmë ishte musliman me lejen e All-llahut, nga ana e familjes së tij. Asnjëherë nuk e kaploi injoranca e xhajilijetit, dhe kurrë nuk u shoqërua me injorantët, e as që ndonjëherë ishte kyçur në ndonjë vepër të shëmtuar. Kështuqë, kur i Dërguari i All-llahut xh.sh e informoi Imam Aliun a.s për Vahjin që iu shpall dhe thirrjen islame, ai palëkunshëm menjëherë besoi në vërtetësinë e Shpalljes dhe u vu në disponim të urdhëresave të Muhammedit a.s.
- Kjo ishte leja që e dha All-llahu xh.sh. „Keramull-llahu Vexh-huhu“ (All-llahu xh.sh e bekoftë fytyrën e tij) dhe kështu Aliut a.s iu bë një nder i madh. Kjo ishte një surprizë ne ndriçimin e të së Vërtetës, ngase Imam Aliu a.s ishte akoma fëmijë dhjetëvjeçar.
- Imam Aliu a.s, astu siç thamë, ishte i parapërgaditur që ta ndjek Pejgamberin a.s dhe gjithnjë në këtë fytyrë e ndërtoi karakterin dhe personalitetin e tij si dhe i thelloi

bazat e vetive dhe moralit të lartë. Asnjë e re nuk është shtuar në kallëzimet që Imam Aliu nuk i morri me befasi duke dëgjuar për Shpalljen e bekuar. Ngase, ai siç dijme, jetoi nën mbrojtjen dhe përkujdesjen e Muhammedit a.s, i cili i lutej dhe e madhëronte vetëm All-llahun xh.sh, dhe ndryshoi botëkuptimin e gabuar të të kuptuarit të gjërave dhe udhëheqjes, si dhe sjelljen iracionale të periudhës paraislamike, periudhë para shpalljes ë Sures së parë të Kur'anit të Madhnueshëm.

- Imam ali u a.s dinte gjithçka për të Dërguarin e All-llahut xh.sh, për fenë dhe zbatimin e saj, shumë bukur , ashtu siç i dinte dhe njihte vetitë e tij të jashtëzakonshme mendore e shpirtërore. Lutej bashkë me të, e ndiqte dhe punonte siç punonte ai (Pejgamberi a.s vër. e përkth.), madje edhe në ditët e tij të rinisë së hershme. Kurdoherë kur Muhammedi a.s fliste për Shpalljen e Shenjtë, ai-Imam a.s çdoherë atë e pranonte me gjithë zemër, si deh me tërë trupin, pa asnjë lloj hezitimi dhe ngurrimi.

- All-llahu xh.sh kur ia besoi Shpalljen e Tij të Shenjtë, Muhammedi a.s e urdhëroi që thirrjen islame ta fillojë nga të afërmit e tij përkitazi me këtë Ibn Hisham, në veprën e tij „Es-siretu“ thotë:“Atëherë i Dërguari i All-llahut xh.sh filloi ftesën e tij për në rrugën e Zotit dhe Pejgamberllëkun e tij, fshehurazi duke i thirrë dhe kumtuar familjarëve të tij, që më tepër u besonte.(17)

- Kështu ai e nisi thirrjen duke filluar me Imam Aliun a.s dhe Hadixhenë, duke ua rrëfyer Shpalljen, ndërsa më vonë edhe Zejdin birin e Harithit. Askush përveç këtyre dhe disa familjarëve tjerë të tij nuk dinte asgjë për këtë.

- Imam Husejni biri i Aliut a.s në fjalimin e tij mbajtur në lidhje me Islamin e babait të tij-Ali ibn Ebu Talibit a.s ka thënë:“...edhe ai besonte në All-llahun e Lartëmadhëruar dhe në Pejgamberin e Tij. Ai tri vjet ua tejkalonte të tjerëve në imanin ndaj All-llahut xh.sh, Pejgamberit të Tij, si dhe në faljen e namazit.“(18)

- Për pranimin e tij të hershëm të Islamit, vetë Imam Aliu a.s për vetveten thotë:“... unë isha i treti prej ne të treve që e pranuan Islamin (Pejgamberi-Muhammedi a.s, Hadixheja dhe unë), kur askush tjetër në botë nuk e kishte pranuar Islamin. Unë madje e kam dritën e Shpalljes dhe Porosisë dhe kam shijuar aromën e Pejgamberllëkut.“

- Pejgamberi a.s duke e patur rrethin e familjarëve që e pranuan Shpalljen, atëherë filloi ta zhgjerojë hallkën e thirrjes në Islam, drejtuar personave tjerë potencial, të cilëve u besonte dhe të cilët ishin të përshtatshëm për thirrjen e tij. Kështuqë një pjesë e popullit e pranoi Islamin. Shumica prej tyre ishin djelmosha të rinj mekkas, që u ndalohej besimi dhe u ekspozoheshin torturimeve. Ata mblidheshin për ta mësuar Kur'anin e Madhnueshëm dhe të merrnin lajme mbi shpalljet e All-llahut xh.sh që ia zbritte fesë së Lartësuar. Këto në atë kohë ishin ndryshimet më të mëdha avangarde-revolucionare.

## I PARI NGA THIRRËSIT NË ISLAM

- All-llahu xh.sh i tha Pejgamberit të Vet a.s t'i thirrë në fe edhe anëtarët e tjerë të fisit të tij.“Benu Hashim“, me një porosi më të gjërë:

„ Dhe tërhiq vërejtjen farefisit tënd më të afërt. E të jeshë i butë ndaj besimtarëve që të preanuan ty. E nëse ato (jobesimtarët) të të kundërshtojnë, ti thuaj:“ Unë jamë i pastër nga ajo që punoni ju.“ (El-Shuara, 214-216)

- Kur Pejgamberi a.s e morri urdhërin nga All-llahu i Lartësuar t'ua tërheq vërejtjen farefisit të afërt, e caktoi Aliun a.s që ta ftojë fisin në gosti. Erdhën dyzet prej tyre në shtëpinë e Pejgamberit a.s. pas ngrënies I Dërguari-Muhammedi a.s iu drejtua



me fjalët: “O Bijtë e Abdul-Mutalibit! All-llahu xh.sh më dërgoi mua që të gjitha krijesave, e posaçërisht juve- më tha Ai (All-llahu) t’ua tërheq vërejtjen, fisit tuaj dhe farefisit më të afërt.

- Kështu që unë ju thërras t’i thoni dy fjali, fjali të lehta në gjuhë, ndërsa me peshë në peshore; me të cilat fjali do t’i pushtoni popujt arabë dhe të tjerë që juve do t’ju ndjekin dhe me të cilat fjali ju do të hyni në Xhennet dhe do të shpëtoni nga Xhehennemi: “Dëshminë se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, dhe se unë jam I Dërguari i All-llahut. Secili që këtë e pranon dhe më përkrah mua në kryerjen e misionit, do të jetë vëllai, zëvendësi, ndihmësi, kryembrojtësi dhe trashëgimtari im.” (19).

Përderisa Ebu Lehebi e kritikoi dhe ia tërhoqi vërejtjen Pejgamberit a.s kundër shpalljes së pejgamberrllëkut të tij, nga ana tjetër Ebu Talibi ia dha përkrahjen e tij duke i thënë Pejgamberit a.s: “Ec përpara me thirrjen (mesazhin) tënd! Për Zotin, unë asnjëherë nuk do të heq dorë për të të mbrojtur dhe do të jem mburoja jote.” (20)

Në këtë kohë, më i riu nga të gjithë të pranishmit, Ali ibn Ebu Talibi u çua dhe tha: “O I Dërguari i All-llahut! Unë do të të ndihmoj në rolin tënd.”

Pejgamberi a.s e urdhëroi që të ulet. Aliu duke parë se askush nuk përgjigjet, u çua sërish dhe përsëri ia ofroi ndihmën e tij, për ta përkrahur e mbrojtur, por Pejgamberi a.s përsëri e urdhëroi të ulet.

Pejgamberi a.s prapë i përsëriti fjalët e tij. Dhe sërish askush nuk u përgjigj përveç Imam Aliut a.s zëri i vetëm i cili dëgjohej si përgjigje pohuese ndaj thirrjes së të Dërguarit a.s, duke ia ofruar përkrahjen e plotë kësaj të mire ( Fesë Islame, vërej. e përkth.) Ky ishte vendimi i fortë i tij, dhe besimi i cilie ndërpreu heshtjen që mbretëronte. Kur edhe për herën e tretë nuk kishte asnjë përgjigje nga askush, përveç Imam Aliut a.s, nga i cili u kthye Pejgamberi a.s duke i thënë: “Ulu, ti je vëllai im, përfaqësuesi, ndihmësi, ndjekësi dhe trashëgimtari im. (21)

Vizitorët u çuan të shkojnë dhe në mënyrë ironike iu drejtuan Ebu Talibit: “Urime për pranimin e fesë së nipit tënd, i cili e përcaktoi djalin tënd në komandantin tënd.”

## **KUNDËRSHTIMI I JOBESIMTARËVE**

Pas refuzimit të thirrjes nga anëtarët e fisit të vet, Pejgamberi a.s i Lartësuar a.s ishte në gjendje kritike dhe tepër kundërshtuese. I pari kundërshtim ishte me Ebu Lehebin dhe gruan e tij, të cilët filluan ta sulmojnë Pejgamberin a.s dhe t’i shkaktojnë vështirësi në rrugën e tij, duke i bërë shantazhe që t’i ndryshojë mendimet dhe të heq dorë nga misioni i tij fisnik.

Thirrja e All-llahut shpejtoi në sqarimin e rrugës për shoqërinë në kohën e injorancës.

Thirrja për ta pranuar Islamin, nga mënyra e të thirrurit fshehurazi kaloi haptazi.

Pejgamberi i All-llahut xh.sh doli para Qabesë dhe haptazi zëshëm ia shpalli popullit të vet, atë që All-llahu xh.sh ia shpalli si Pejgamber.

Suksesi i përhapjes dhe pranimit të Islamit, sa vinte e shtohej nga numri i të rinjve, që shumica ishin nga shoqëria mekase. Sa vinte e shtohej numri i

besimtarëve, aq më tepër ashpërsuhej qëndrimi i jobesimtarëve, të cilët madje futën në përdorim taktikën e terrorit. Secili fis si dhe familje e filluan fushatën e përndjekjes së besimtarëve, edhe pse ishin anëtarë të tyre. I torturonin dhe me çdo kusht tentonin ta shtypnin besimin e tyre, mirëpo, ata-besimtarët ishin të vendosur dhe kishin besim të

patundshëm, si dhe udhëzimin e së Vërtetës përcjellur nga fjalët xhevahir të të Dërguarit të All-llahut xh.sh-Muhammedit a.s, fjalë këto të cilat thellë ishin ngulitur në zemrat e tyre, dhe ishin të etshëm për të bërë vepra të mira. Pejgamberi a.s me qëllim që t'i lirojë nga torturimet brutale fizike besimtarët, të cilët, sa vinin e ashpërsoheshin, i udhëzoi dhe i lejoi të shpërngulen në Abisini (Etiopinë e sotshme, vërej. e përkth.) nën udhëheqjen e Xhafer ibn Ebu Talibit, vëllait dhjetë vjetë më të vjetër të Imam Aliut a.s. Xhaferi me urtësinë e tij i ndaloi planet e Kurejshëve, të cilët tentonin të ndikojnë te mbreti i Abisinisë, me qëllim që ky i fundit të ndërrojë mendjen dhe qëndrimin e tij ndaj emigrantëve muslimanë dhe t'i dëbojë nga vendi i tij.

## **KUNDËRSHTIMI I EBU TALIBIT NDAJ ARMIQËVE TË ISLAMIT**

Edhe pse Kurejshitët i kundërshtonin pasuesit e Islamit me anë të dhunës dhe torturave, prapëseprapë nuk mundnin t'i bëjnë dëm të Dërguarit-Muhammedit a.s, i cili ishte udhëheqësi i ndryshimeve dhe zbritjes së Shpalljes. Ata e dinin se Ebu Talibi është kryetari i Benu Hashimëve dhe ai nuk jepte asnjëfarë leje për çfarërdoqoftë lloj terrori ndaj të Dërguarit të All-llahut xh.sh. Ebu Talibi udhëhiqej dhe gëzonte rrespekt të madh, jo vetëm mes anëtarëve të Benu Hashimëve por tek të gjitha fiset e Mekkës. Ai ishte mbrojtës i vendosur i pejgamberllëkut dhe qëndronte si mur i pakapërcyeshëm kundër armiqëve në mbrojtje të Muhammedit a.s, nga e keqja edhe tërbimi i tyre. Kurejshitët shumë mirë e dinin këtë gjë, ndaj edhe pranuan metodën e bisedimit, pazarllëqeve dhe provokimeve.

Kurejshitët e përdornin ndikimin e tyre te Ebu Talibi, me qëllim që ai të heq dorë nga përmbajtja që kishte për Pejgamberin a.s. Ata-Kurejshitët i ofronin pasuri dhe pushtet të Dërguarit –Muhammedit a.s vetëm e vetëm ta ndërpresë thirrjen e tij hyjnore, ndaj për gjithë këto oferta ta bisedonin me Ebu Talibin dhe ia tërhiqnin vërejtjen në konfrontim të ashpër fizik mes tij dhe Kurejshëve, nëse ai më tej vazhdon ta mbrojë të Dërguarin-Muhammedin a.s. Mirëpo, përkundër gjithë këtyre presioneve dhe shantazheve e kërcënimeve, Ebu Talibi qëndroi stoikisht i palëkundur në mbrojtjen e të Dërguarit-Muhammedit a.s dhe e mbrojti përkundër rreziqeve nga më të mëdhajtat që u ekspozojë e që mund t'i kushtoni shtrenjtë madje edhe me viktima të shumta.

## **EBU TALIBI ME TË DËRGUARIN E ALL-LLAHUT NË RRETHIM**

Kur Kurejshitët dështuan pëkatësisht nuk ia arijtën qëllimet që Pejgamberin a.s t'a ndalojnë nga misoini i tij-thirrja Islame, udhëheqësit kurejshitmbajtën mbledhje urgjente në « Daru-n-Nevada » (« Shtëpia e mbledhjeve ») në shtëpinë e Kasij ibn Kilabit, ku filluan të diskutojnë për ngjarjet dhe çështjet kyçe që ngjanin në shoqërinë e

tyre. Aty ata ranë në ujdi që t'i bojkotojnë Benu Hashimët dhe çdo kënd që do të kishte punë me to. Ranë në ujdi dhe sollën vendime që t'i izolojnë ekonomikisht dhe t'i leçitin në shoqëri, që do të thoshte se askush me to (muslimanët, vërej. e përkth.) nuk ka të drejtë as të bisedojë, tregtoj qoftë në blerje apo shitje, madje as që do të kishte të drejtë marrëje e dhënie martesore me anëtarët e Hashimitëve.

Këtë marrëveshje e vërtetuan dyzet Kurejshitë eminent. Për ta mbrojtur vetveten nga Kurjeshitët, anëtarët e Beni Hashimëve, nën urdhërin e udhëheqësit të tyre Ebu Talibit, u vendosën në kodrinën « Shoub Ebu Talib ».

Një kohë bukur të gjatë ata nuk guxonin të futen në Mekë, përveçse në dy raste : gjatë kohës së vizitës së Qabesë dhe Umres. Kjo mënyrë e jetesës, filloi edhe më tepër t'i acarojë marrëdhëniet mes Benu Hashimëve dhe Kurejshitëve. Ebu Talibi e përforconte rrethinën e Shoubit me qëllim që mos të befasohej nga sulmet e papritura të Kurejshëve. Kështu, Kurejshitët në këtë gjendje qëndruan bashkë me Pejgamberin a.s, Imam Aliun a.s plot tri vjetë, ndërsa sipas disave katër vjet, vjet këto të jetës së rëndë ku hoqën të zinjte ullirit, të rrethuar me varfëri, mjerim, duke përjetuar mynxyrë të hatashme dhe pikëllim në zemër.

- Me qëllim që gjendja të përkeqësohet edhe më tej, Kurejshitët e shtrënguan rrethimin skajmërisht duke e ndërprerë furnizimin apo dyfishuar çmimet, kështuqë edhe disa ishin miq të Benu Hashimëve, prapsepapë nuk, mundnin asgjë të shitnin. Ndaj, gjithë kjo leçitje-izolim, Benu Hashimët hiqnin vuanin nga skamja (varfëria), historia ka shënuar se fëmijët qanin me të madhe prej urisë sa që dëgjohej tepër larg vaji i tyre.

- Pas kalimit të atyre tri viteve të rënda e të dhimbshme, Pejgamberi a.s i tha xhaxhait të tij Ebu Talibit, se marrëveshja e Kurejshitëve me të gjitha padrejtësitë e saja, që ishte vënë në formë të shkruar në murin e Qabesë, është shkyer (ngrënë nga krymbi, vërej e përkth.) përveç fjalëve « ...në emrin Tënd, O Zot » (23).

- Ebu Talibi vrapoi drejt Kurejshitëve duke ju thënë : » Nipi im më ka thënë, se letrën e juaj të marrëveshjes e ka ngrënë krimbi, përveç pjesës ku përmendet emri i All-llahut. Kështuqë ai (Muhammedi) është në të drejtë, ndërsa ju keni gabuar dhe keni bërë të keqe të madhe me vendimin e juaj, mirëpo, nëse ai nuk e ka thënë të vërtetën, atëherë vet unë me duart e mia do t'ua dorëzoj juve. »

- « Ti plotësisht je i qartë «- thanë Kurejshitët dhe e morrën letrën. Kur filluan ta shikojnë panë se letrën e kishte grisur krimbi tamam siç u kishte thënë Ebu Talibi. Filloi një diskutim vendimtar, pjesa tjetër e letrës u copëtau në grim ca, dhe bojkotit e rrethimit i dhanë fund. Humbja e bojkotit ishte fitore e jashtëzakonshme për shumë e shumë simpatizues dhe ndihmës të Shpalljes që gjendeshin në Mekë.

- Të tilla ishin sakrificat e Familjes së Imam Aliut a.s për rrugën e All-llahut xh.sh.

- Gjersa Imam Aliu i pari iu përgjigj ftesës së të Vërtetës dhe qëndroi stoikisht si luftari më i shquar i frontit islamik gjatë gjithë jetës, i ati i tij Ebu Talibi, e sakrifikoi madje edhe pozitën e tij shoqërore që gëzonte tek Kurejshitët, duke përjetuar vështirësi të hidhura në mbështetje të Shpalljes së Madhe të All-llahut. Ai, në të vërtetë ishte mbrojtësi i Pejgamberit a.s në misionin e tij të thirrjes, përkundër pozitës që kishte në shoqëri si dhe rolin e tij prej kryepari të fisit, e cila i ndizte të gjithë të tjerët.

- Xhafer ibn Ebu Talibi e filloi jetën e tij e të jetuarit në Islam, me rastin e mbajtjes së fjalimit madhështor, që e mbajti kur ishte në krye të emigrantëve muslimanë në Abisini. Më pas, kulminacionin e tij e arrijti, me sakrificën e tij të pashoqe në Betejën e Mut'es, kur sakrificën e tij e kurërizoi me hubjen e dy duarve, ndaj ishte i

njohur me emrin « Xhaferi Fluturues », d.m.th ai i cili në Xhennet fluturon me melaqet, ashtu siç e emërtoi vetë i Dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s.

- Pejgamberi, Muhammedi a.s shumë e donte, dhe kur Xhaferi u kthye prej Abisinie në Medinë, e cila përputhet me çlirimin e Mekës, Muhammedi a.s e shtrëngoi fort dhe e puthi në ballë duke i thënë : »Unë nuk di për çfarë të jem më tepër i gëzuar : për kthimin e Xhaferit apo çlirimin e Hajberit. »(25)

## **KTHIMI NË TERITORIN E ISLAMIT (MEKË)**

- Vdekja e Ebu Talibit sihte humbje e madhe për Islamin. Konflikti i ashpër mes Thirrjes së Bekuar të All-llagut dhe injorancës dhe jobesimtarëve vazhdoi edhe gjatë kësaj periudhe, përkatësisht ngjarjes së dhimbshme-vdekjes së Ebu Talibit, gje që e pikëlloi Pejgambein a.s. I dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s fort mirë e dinte se Kurejshitet donin ta përshpejtonin dhe forconin fushatën e tyre kundër tij dhe peygamberrllëkut të tij. Kurejshitet të cilët i frikësoheshin Ebu Talibit i cili gëzonte reputacion të thellë, tani pas vdekjes së tij, nuk kishin pengesë për të vepruar, ngase e kishin të qartë se Muhammedi a.s kishte humbur mbështetësin që e kishte në personalitetin e Ebu Talibit. Të njëjtin vit I Dërguari i All-llahut xh.sh, Muhammedi a.s pësoi edhe një godiye tjetër të fortë, vdekjen e gruas së tij besnike hazreti Hatixhenë, ndaj këtë vit e quajti « Viti i Dëshprimit » (« Senetul-Huzni » vërej e përkth.)

- Vdekja e Ebu Talibit ndikoi në ngecjen e Thirrjes së Lartësuar, lidhur me këtë Pejgamberi a.s është shprehur « Kurejshitet qëndroni larg nga unë, gjer sa vdiq Ebu Talibi. »(26)

- Kurejshitet kohë pas kohe vërsuleshin ndaj të Dërguarit të All-llahut xh.sh dhe ithtarëve të tij të parë. Nisur nga kjo Pejgamberi a.s kërkonte një vend tjetër kudoqoftë jashtë Mekës, ku do të mundej të rriste Drurin e Udhëzimit. Ai nisi hulumtimin duke vënë kontakte me fiset, duke lajmëruar popullin që jetonte rreth Mekës për detyrën e tij. Ai e vizitonte Taifin dhe bisedoi me kryetarin e fiseve, por ata refuzuan, askush nuk iu përgjigj thirrjes së tij. Mirëpo ai, prapësepapënuak u dëshpruar, përkundrazi vazhdoi t'ua përcillte mesazhin e tij popujve jashtë Mekës.

- Gjatë haxhit (vizitës së Qabesë, që arabët i bënin në kohën e injorancës vërej e përkth) u takua me disa nga popujt (fiset) e Medinës. Ai u foli atyre për thirrjen-mesazhin e tij, ndërsa ata menjëherë pa ngurruar pranuan Thirrjen e All-llahut. Ata u kthyen në Medinë duke marrë me vete në shtëpitë e tyre Urdhëresat e All-llahut dhe ua shpërndanë popullit të vet. Dymbëdhjetë njerëz nga Medina erdhën për t'i dhënë besën Muhammedit a.s në besimin e tij, duke e marrë kështu mesazhin e të Dërguarit të All-llahut xh.sh. Ai bashkë me to e çoi Musejb ibn Umejrin që t'ua mësoj ligjet e fesë së All-llahut xh.sh, që t'i udhëzoj në thirrjen e Tij dhe t'ua mësoj Kur'anin. Mus'abi qëndroi me to një vit, ndaj një numër tejet i madh i medinasve e pranoi Thirrjen e Bekuar dhe pranoi Islamin.

- Gjatë kohës së Haxhit tjetër një grup më i madh prej tyre erdhën në Mekë, të prirë nga Mus'ab ibn Umejri, që t'i bashkangjiten Pejgamberit a.s dhe njëherit i premtuan ndihmë nëse ai shpërngulet në qytetin e tyre.

- Ndërkohë erdhi edhe Urdhëri nga ana e All-llahut xh.sh si sprovë për besimtarët që të shpërngulen prej Mekës, pas së cilës ata u nisën në drejtim të venbanimit të ri, të jetojnë pa pasurinë e tyre, pronën dhe familjet e tyre, të gatshtëm të sakrifikohen për rrugën e All-llahut. Gjersa Islami po hynte në fazën e re të përparimit, udhëheqësit

Kurejshiti u mblodhën në « Dar-El- Nadva » që të bëjnë një marrëveshje për Pejgamberin a.s, she unanimisht të gjithë ranë në ujdi dhe sollën vendim që ta vrasin. Ranë në ujdi që çdo fis të çojë nga një anëtarë të vetin, që likuidimin ta bëjnë natën, ndërsa synimi i një mënyre të tillë të organizimit të vrasjes, kishte për qëllim që të mos akuzohej asnjë fis i vetëm për aktin e kryer. Melaqja e Medhe, Xhibrili a.s e lajmëroi Muhammedin a.s për komplotin e Kurejshitëve, me këtë rast u shpall ajeti i mëposhtëm i kur'anor : »Përkujto (o i Dërguar) kur ata që nuk besuan thurrnin kundër teje ; të ngujojnë, të mbysin ose të dëbojnë. Ata bënin plane, e All-llahu asgjësonte, se All-llahu është më i miri për që asgjëson (dredhitë). » (El-Enfalë, 30)

## **KURTHI PËR PEJGAMBERIN S.A.V.S**

- Xhibrili a.s i tha të Dërguarit të All-llahut xh.sh se All-llahu është i kënaqur me idenë e tij të shpërnuljes për në Medinë. Kur u lëshua errësira, komplotistët shpejtuan ta rrethojnë shtëpinë e Pejgamberit a.s dhe ta ndalojnë ikjen e tij. Atëherë i Dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s e lajmëroi Imam Aliun a.s për gjithçka që kishte ngjarë. Ai e pyeti Imam Aliun a.s a do të pranonte të shtrihej në shtratin e Pejgamberit a.s dhe të mbështillet me mbulojën e tij ? Imam Aliu a.s u përgjigj se po do të dëshironte, nëse me një akt të tillë do të jetë i sigurtë Muhammedi a.s, gjë që Muhammedi a.s u përgjigj pozitivisht. Imam Aliu a.s pa asnjëfarrë komenti pranoi që të veproj siç e urdhëroi Muhammedi a.s, të shërbej si kurthë për jobesimtarët. Atëherë Muhammedi a.s e lëshoi shtëpinë e vet dhe kaloi fare pranë rrethimit duke lexuar zëshëm ajetin kur'anor : »Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë e edhe mbrapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin. »(Jasin, 9)

- Dhe vërtet askush prej jobesimtarëve nuk e pa.

- Në të gdhirë të ditës, në agim komplotistët u futën në shtëpinë e Pejgamberit a.s për të kryer aktin kriminel që e kishin ndërmend. Kur u futën brenda në dhomën e Pejgamberit a.s, Imam Aliu a.s kërceu nga shtrati duke ju bërtitur : »Ç'është ?, Çfarë kërkoni ? »

- « Ku është Muhammedi «-pyetën ata.

« A më keni caktuar ju mua për ta ruajtur ? Jo, nuk më keni caktuar ! Ju e keni përzënë nga qyteti juaj. Tani ai juve u ka lëshuar (ka ikur, vërej e përkth ) » (27)

- Komploti i tyre dështoi dhe ata e lëshuan shtëpinë pa korrur sukses. Meqë, e tërë kjo ngjau, ata filluan të hulumtojnë përkatësishtë të kërkojnë Pejgamberin a.s nëpër fusha e male. Për këtë qëllim ata e morrën me vete Abu Karzan, i cili ishte ekspert për gjurmët (ndjekjen e gjurmëve të shkretëtisë, vërej e përkth) që t'i zbuloj hapat e Pejgamberit a.s. Ai këtë e bëri deri sa mbërritën në kodrën Theur, dhe u tha se ai është aty brenda, në të kundërtën, nëse jo, d.m.th ose ka flturuar në qiell ose është zhytur në tokë.(28)

- All-llahu i Lartëmadhëruar e dërgoi një marrimangë, e cila sa po Muhammedi a.s dhe as-habi tij Hazreti Ebu Bekri hyrën në shpellë, lëshoi rrjetin e vetnë hyrje të shpellës. Komplotistëve nuk u shkonte ndërmend që dikush mund të futej në shpellë e të mos këputeshin fijet e holla të rrjetit apo vetë marrimanga, ndaj edhe ndaluan përndjekjen. Atëherë nën mbrojtjen e tërrit të natës Imam Aliu a.s me Hind ibn Ebu

Halou shpejtuan për kah shpella për ta parë të Dërguarin e All-llahut xh.sh. Muhammedin a.s. Pejgamberi a.s bisedoi me Imam Aliun a.s se çfarë do të duhej që ai të bëjë gjatë kohës së qëndrimit të tij (Muhammedit a.s vërej e përkth) në Medinë. I tha Imam Aliut a.s që të kthehet në Mekë, t'ua kthejë amanetet që i kishte në ruajtje popullit, dhe më pas të niset pas tij për në Medinë duke e marrë me vete edhe Hazreti Fatimenë dhe gratë e tjera të Ehlul-Bejtit a.s.

## **PRITJA NË KUBÂ**

- Pas disa ditësh rrugëtimi, karvani arrijti në Kubâ. Në këtë vend Pejgamberi a.s e ndërrtoi xhaminë « Kubâ ». Derisa po priste ardhjen e Imam Aliut a.s, Pejgamberi a.s i dërgoi një letër të diktuar (ngase Muhammedi a.s nuk dinte shkrim-lexim, vërej e përkth.) dhe e ftonte për t'iu bashkangjitur. Letrën e rregulloi dhe e dërgoi Ebu Vakid El-Laithi.

- Nga ana tjetër Imam Aliu a.s veçmë i kishte kryer ato që e kishte porositur Muhammedi a.s. Amanetet përkatësisht gjërat që populli ia kishte besuar Muhammedit a.s për t'iu ruajtur ua kishte kthyer. Pastaj i bëri ulëset mbi supet e elefantit, ku do të uleshin gratë : hazreti Fatimeja-bija e Muhammedit a.s, Fatimeja-bija e Asadit, Fatimeja-bija e Hamzës dhe Fatimesë, bija e Zubejrit. Ky karvan u quajt »Karvani i katër Fatimeve «

- Imam Aliu. Atëherë caktoi që disa besimtarë ta lëshojnë qytetin natën, ndërsa ai, gratë dhe Ebu Vakid El-Laithi udhëtuan ditën,(në pikë të drekës, vërej e përkth)(31). Për disa ditë udhëtimi karvani mbërriti në Kubâ. Kështu, aty u takuan me të Dërguarin e All-llahut xh.sh. Ai e përqafoi Imam Aliun a.s dhe filloi të qajë për shkak të vështirësive dhe mynxyrave që ata kishin përjetuar.

- Gjatë rrugëtimin nëpër rërën e nxehtë përcëlluese të shkretëtirës, shputat e Imam Aliut a.s ishin mbuluar me gjak, përkatësisht i kishin palsur, këshuqë Muhammedi a.s u lut për shëndetin e tij, gjë që i ndihmoi shumë dhe ia lehtësoi dhembjet.

- Të premten e 16.rebbiul-evelit, Pejgamberi, Muhammedi a.s e lëshoi Kubânë dhe u nis për në Medinë, e cila është larg rreth 3-4 kilometra larg në veri. Karvani i të Dërguarit të All-llahut xh.sh pritej ngrohtësisht dhe me një mirëseardhje të paparë, në shumicën e vendeve dhe rajoneve ku kalonte, ashtu siç u prit edhe në Medinë. Kur Muhammedi a.s kapërceu nëpër vendin ku luftoi, më vonë u ndërtua Xhamia e Pejgamberit a.s. Ky ishte vendi ku deveja, me të cilën udhëtonte Muhammedi a.s u ndal dhe pikërisht aty në atë vend u ul. Atëherë Pejgamberi a.s zbriti nga deveja dhe shkoi tek Ebu Ejub El-Ensariu (All-llahu qoftë i kënaqur me të) si mysafir i tij.

- Më vonë, vetë Muhammedi a.s caktoi që në atë vend të ndërtohet xhamia bashkë me objektin për banim ku do të vendosej ai me gjithë Familjen, ndërsa dhomën e tij e ndërtoi afër dhomës së hazreti Aliut a.s.

## **DETYRAT PAS SHPËRNULJES (HIXHRETIT)**

- Me ardhjen e të Dërguarit të All-llahut xh.sh në qytetin e Medinesë, Medineja hyri në një epokë të re historike. Këtu u vërtetua Kur'ani dhe fitoi përkrahës të denjë, ku si flakadan ndriç rrugën e të Vërtetës, duke e shkatërruar errësirën e mosbesimit të asaj

kohe. Pas Hixhretit peygamberllëku u kthye në administratë shtetërore, duke siguruar pasuri, mbrojtje dhe famë. Mirëpo, kjo nuk do të thoshte edhe fundi i rreziqeve që vinin nga armiqtë dhe koplotet e errëta, që për synim dhe aspiratë tyre kishin shuarjen e dritës së Islamit kudoqoftë dhe në çfarëdo mënyre. Kështuqë forcat e injorancës me pikëpamjet kundër Islamit dhe shtetit të tij. Shumë fise hyrën në luftë kundër Islamit dhe të Dërguarit të All-llahut xh.sh me qëllim të rrezikimit të ekzistencës së Islamit dhe mënyrës së jetesës që vendos Islami. Tani Islami ishte organizuar në Shtet, i cili kishte udhëheqës dhe ushtri për mbrojtje, nëpërmjet të cilëve ishte siguruar arritja e synimit të tij.

- Ishte e tmerrshme më shumë se kurrë që idhujtarët ta sundojnë Arabinë. Ndaj, periodha pas Hixhretit përpara muslimanëve vinte detyra të mëdha e të rëndësishme :përforcimin e Shtetit, mbrojtjen e tij, ndërtimin e shoqërisë dhe forcimin e saj zbrapsjen e armiqëve si dhe përhapjen-përcjelljen e thirrjes (mesazhit) Islam dhe rregullimin e mënyrës islame të të jetuarit. Natyra lufturake e individëve dhe fiseve rrënjësisht u ndryshua, ngase ata kur pranuan mesazhin islam, u shndërruan në paëqsore dhe i lanë veset e moçme ngatërestare, dhe nuk posedonin asgjë tjetër me aq kënaqësi sa besimin e tyre në All-llahun xh.sh në sajë të cilit besimin e tyre në All-llahun xh.sh në sajë të cilit besim fituan edhe vlera të tjera. Organizimi i fushatave ushtarake dha atyre mbrojtëse u shndërrua në interes të përgjithshëm, për t'i arrijtur disa aspirata nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër lulëzimin e madh të Islamit. Kështuqë rreziku që ekzistonte të shkaërrojë Islamin dhe konfliktet ushtarake që do të pësojnë më pas, u shndërruan në rrugë të pashembullt në historinë e tij.

- Sa për të ilustruar më mirë rrethanat në kohën e shpalljes së Kur'anit, njofton vetëm e dhëna se gjatë dhjetëvjetëve të qëndrimit të Muhammedit a.s në Medinë, kishte dymbëdhjetë luftëra qofshin këto mbrojtëse apo ofanzive, në të cilat muslimanët patën shumë viktime. Duke u ballafaquar me të gjitha mënyrat e vështirësive, ata mposhtën ekzistimin e fundit të injorancës arabe, me cka Shteti Islam përfshin tërë Gadishullin Arab.

- Duke ndjekur historin kritike të viteve të hershme të mesazhit të fundit të All-llahut xh.sh, shohim se roli i Imam Aliut a.s ishte i pashmangshëm. Në të gjitha luftat ai dilte fitimtar, ndërsa në guximin dhe sakrificën vetëmohuese ua tejkalonte gjithë të tjerëve. Shkathësia e tij luftarake, heroizmi dhe pamoshtëmëria veçmë ishin të njohur për arminjtë e tij, ndaj edhe i iknin ballafaqimit me të në fushat e betejës. Është me rëndësi të tregohen disa lufta të bëra mes forcave islame dhe atyre armike, të asaj peëriudhe kohore dhe rolin e rëndësishëm që Imam Aliu a.s luajti në secilën luftë nga to.

## **LUFTA E BEDRIT**

- Bedri shtrihet në largësi rreth 200 milje prej Mekës, dhe rreth 80 milje prej Medinës. Ki është vendi ku u zhvillua lufta e parë mes forcave islame dhe atyre të kufrit (mosbesimit).

- Muslimanët ishin të pakët në numër në raport me kundërshtarin, kështuqë proporcioni i forcave ishte 3:1 në dobi të mekasve pagan, të udhëhequr nga Ebu Xhehli. Në dimrin e dytë pas Hixhretit, ushtria e tij u nis në drejtim të Medinës, kështuqë Muhammedi a.s u detyruara të nxjerr grupin e vet prej 313 njerëzve që t'u kundërvihet

me qëllim të parandalimit të gjakderdhjes, brenda për brenda territorit të vetë qytetit. Përgaditja (armatimi) i muslimanëve ishte i pakët. Tri-katër njerëz posedonin një deve, duke kalëruar në ndryshe. Shembullë i jashtëzakonshëm në ato grupe të vogla ishte Imam Aliu a.s dhe rreth tij edhe një kalorës tjetër, Mikdad ibn Esved-Kindi. Disa muslimanë ishin të armatosur vetëm me shtiza druri të bëra nga palmat.

- Luftimi aso kohe ishte krejtësisht ndryshe nga i sotmi. Para se të fillonte lufta kryesore, kryej një dyluftim mes luftëtarëve të të dy palëve. Kur muslimanët mbërritën në fushën pjellore të Bedrit, vend i mrekulluar përplot me ujë, në të cilin vend shërbeheshin karvanet rrugës për në Mekë, që ishte në veri, Pejgambei a.s e caktoi ndalimin dhe marrjen e pozicioneve rreth ujit të rrjedhshëm freskues. Të nesërmen, përkatësisht ditën e premte të shtatëmbëdhjetën e Ramazanit, armiku me anë të zërit që dilte nga buria i afrohej muslimanëve. Tre luftëtarët mosbesimtarë : vjehri Sufjan Utbe, vëllai i tij Shejbe dhe El-Velidi, dolën nga rradhët e tyre dhe në mënyrë arrogante filluan t'i provokojnë muslimanët. Fill pas këtij provokimi, tre Ensarë nga Medina menjëherë dolën rradhët e tyre dhe pranuan t'i sfidojnë provokimet e tyre (Ebu Sufjanit, Shejbes dhe El-Velidit, vërej e përkth). Mirëpo, mekkasit u ndien të fyer dhe refuzuan të luftojnë kundër Ensarëve duke ju thënë: »Ne nuk kemi ardhur të luftojmë medinasit, ngase ne ata nuk i urrejmë. Ne i provokojmë banorët e Mekës, kush do të kishte guxim të na kundërvihet neve . »

- Duke e parë gjithë këtë, Imam Aliu a.s dhe Ubejdi, të dy kushërinj të Pejgamberit. Muhammedit a.s dhe Hamza, xhaxhai i tij, iu përgjigjën një provokimi të tillë.

- Zotëri Thomas Bodhi (1545-1613), diplomat anglez dhe themeluesi i bibliotekës së Bodhijit, thotë : »Kurejshtiëve plotësisht të përgatitur i pari iu turr Imam Aliu nga tabori muslimanë, i cili sihte veshur me një pancir ndriçues dhe helmetënë kokë. Atë menjëherë e pasoi Ubejd ibn El-Harithi, kushëri i Muhammedit, dhe Hamza i cili mbante një pendë në pjesën e sipërme të pancirit.

- Gjithë këta të tre ishin në lidhje farefisnie të afërtme Pejgamberin , Muhammedin dhe kështu u plotësua kërkesa për gjakun Hashimit. »

- Në rrëfimin e tij Thomas Bodhi vazhdon : » Gjithë këta tre luftëtarë ishin të shpejtë. Hamza e mbyti Shejben, ndërsa Imam Aliu e mbyti El-Validin, birin e Utbes.

- Ubejdi u plagosë rrëndë, gati për vdekje por para se të binte, Imam Aliu dhe Hamza patën mundësinë që ta shpëtojnë. Hamza u vërsul mbi Hudbashin dhe me një të rënë të shpatës ia preu kokën. Për një kohë tepër të shkurtër, tri luftëtarët më eminentë mekkas u dërguan që ta gjejnë të vërtetën e Xhehennemit, gjë t'q cilën Pejgamberi Muhammed ua kishte premtuar më parë. « (32).

- Pas kësaj, të nxituar dhe trimëruar nga ushtria e Ebu Xhehlit, e provokuan Imam Aliun a.s dhe Hamzanë. Edhe ata tre gjithashtu ranë përdhe të vdekur nga shpata e Islamit. Më pas edhe tre të tjerë përjeëtuan të njëjtin fat. Në ato momente hamendjeje që mbizotronte te armiqtë, Pejgamberi a.s e lëshoi ushtrinë e vet në sulm masiv. Muslimanët, me ndihmën e të Madhit Zot i cili ua ofroi ato ditë, dhe me pjesëmarrjen e melaqeve, të cilët iu përgjigjën lutjes (duanë), e mundën-shkatëruan armikun. Në Kur'anin e Madhënueshëm thuhet : »Pëkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e ai ju është përgjigjur : » Unë do t'ju ndihmojë me njëmijë melaqe që vijnë një pas një (grup pas grupi). « (El-Enfalë, 9).

- Rradhët e Kurejshtëve filluan të shkatërrohen ndërsa një numër i madh i ushtarëve të zgjedhur u vranë. Filluan turpshëm të ikin-zbrapsen. Në atë rrëmujë që u krijua ata lanë pajisjet luftarake bashkë me kafshët kalëruese, çadrat (tendat) e tyre si



dhe pajisjet e tjera. Lufta mbaroi me vdekjen e 70 jobesimtarëve, nga të cilët, gati gjysmën prej tyre i vrau vetë Imam Aliu a.s. (33)

## LUFTA E UHUDIT

- Trembëdhjetë muaj më vonë, i Dërguari i All-llahut xh.sh Muhammedi a.s ia dha flamurin e tij e të shpërnulërve përsëri Imam Aliut a.s. Kësaj here në Uhud. Kjo ngjau më 7 sheval, të vitit të tretë pas Hixhretit. Sërish ushtarët muslimanë u ndeshën me Kurejshitët nga Meka.

- Kurejshitët udhëhiqeshin nga Ebu Sufjani, në formën e një rrethi që i ngjante gjysmëhënës, me kalorësit në anën e djathtë, të cilët i udhëhiqte Halid ibn Velidi, luftarëtari me nam të keq. I pari i mekasve Ebu Amri duke hapëruar përpara me 50 shigjetarët i gjuajti muslimanët, të cilët menjëherë iu kundër përgjigjën. Kështu filloi lufta. Më pas shigjetarët mekkas u tëhoqën mbrapa, ndërsa bartësi i flamurit të tyre Talha ibn Abu Talha, me daljet e tij përpara vazhdonte t'i provokojë muslimanët. Atëherë Imam Aliu a.s doli nga rradhët e ushtrisë dhe ia preu këmbën. Ai u përmbys në tokë, ndërsa një luftëtar tjetër e morri flamurin. Këtë të dytin e mbyti hazreti Hamza, ndërsa kur i treti sa po e morri flamurin, edhe atë prap Imam Aliu a.s e mbyti.

- Imam Aliu a.s dhe Hamza, të parët e Luftës së Bedrit, duke mos kursyer të dy mbytjen e armiqëve, filluan të bëjnë kërdrinë në rradhët e ushtrisë. Por, Hamza gjersa ishte duke luftuar me Shejbe ibn Abd-El-Uzzon dhe me një luftëtar mekkas, u vra nga prapa shpine. Këtë sulm prej qyqari e kreu Vahshiu, rob Etiopian, i cili për ta arrijtur qëllimin e tij, ishte fshehur mbas një druri. Për një akt të tillë, atij i ishte premtuar lirianga Hindi, gruaja e Ebu Sufjanit, e cila merrte pjesë në këtë luftë dhe e shikonte me admirim hakmarrjen për vdekjen e babait dhe të vëllait të saj, të vranë në luftë me Imam Aliun a.s dhe hamzën në Bedër.

- Imam Aliu siç shihet, me heroizmin e tij të pashoq, vetëm me dy luftëtarë, e ndëshkoi armikun. Fuqia e ndëshkimit e ndërpreu kordonin e armiqëve dhe ai rrëshqiti (i shkanë këmbët). Atëherë Imam Aliu a.s ia doli ta pushtojë kampin e kundërshtarit, dhe si rrjedhojë mekkasit filluan të ikin nga fusha e betejës. Pas kësaj, muslimanët u kthyen ta përfundojnë luftën në favor të vetin, mirëpo, një grup prej luftëtarëve muslimanë, të cilët Muhammedi a.s i kishte urdhëruar që ta mbrojnë prapavijën e ushtrisë nga mali Uhud, duke e parë humbjen e jobesimtarëve të etshëm që edhe ata të marrin plaçkë lufte, e lëshuan pozicionin e tyre. Kjo gjendje i dha rast të mirë Halid ibn Velidit i cili e shfritëzoi për t'i sulmuar mu nga ajo pozitë që e lëshuan, prapa malit.

- Kësaj here situata filloi të kthehet kundër muslimanëve në favor të jobesimtarëve. Muslimanët atëherë humbën shumë nga luftëtaërt më të mirë. Madje edhe vetë Muhammedi a.s u plagos në fytyrë. Filluan të përhapen zërat se i Dërguari i All-llahut xh.sh është vranë. Muslimanët u tmerruan nga kjo. Ata, në konfuzion dhe pa roje, duke qenë të frikësuar për jetën e prijësit të tyre, u gjendën të rrethuar nga mekkasit. Disiplina muk mundej të vihej. Disa flisnin se Muhammedi si Pejgamber nuk mund të vritet ngase ai është i vërtetë. Të tjerët propozonin t'i kërkojnë falje Ebu Sufjanit dhe të vihen nën mbrojtjen e tij. Rreth kësaj ndodhie, muslimanëe u zbritën ajetet e mëposhtme të Kur'anit të Madhnueshëm :

« Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i Dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose nga lufta) ? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm All-llahut aspak, kurse All-llahu do t'i shpërblej mirënjohësit »(Ali-Imran, 144).

« O besimtarë, nëse u nënshtroheni jobesimtarëve, ata ju kthejnë prapa aty ku ishit (në kufër) dhe atëherë do të jeni të humbur » (Ali-Imran, 149).

« Dhe kur largoheshit e nuk përfillshit as njëri-tjetrin, ndërsa i Dërguari ju thërriste mbrapa. Atëherë u goditi me dëshprim për dëshprim (që i shkaktuat Pejgamberit), ashtu që të mos pikëlloheni për atë që u shpëtoi (prej luftës) e as për atë që u goditi. All-llahu është i njohur hollësisht me atë që veproni. (Ali-Imran, 153).

- Këto ajete flasin për sjelljet dhe veprimet e muslimanëve në luftën e Uhudit. Hulumentimet më të detajuara qartë treguan se kush është në Islam në lidhje me marrëdhëniet, informacionet, shoqërinë në luftë për Islamin dhe muslimanët, ndaj u dasht të tregohet valideti i domosdoshmërisë së të shoqëruarit me Pejgamberin a.s. Shumë të tjerë me lutjet e tyre vetjake tentuan të bëhen udhëheqës t' muslimanëve ndaj edhe i mashtruan ata në çështjet fetare.

- Edhe përkundër mendimit se Pejgamberi i tyre i dashur alejhisselam ishte vdekur, shumë besimtarë me besimin e tyre të sinqertë e të paluhatshëm, vendosën të luftojnë dhe nëpërmjet kësaj (luftimit) ta shuajnë etjen për mednimet që i kishin ndjerë në lëkurën e tyre. Kur i Dërguari (a.s) i All-llahut xh.sh, Ebu Dan'ahi dhe Sahl Bin Hunejfi e mbështjellën (rrethuan) Muhammedin a.s për ta mbrojtur nga sulmet e e luftëtarëve të Ebu Sufjanit.(34). Imam Aliu a.s me këmbëngulje luftonte për Pejgamberin a.s dhe Islamin. Heroizmi i tij ishte aq madhështor sa që melaqja kryesore Xhibrili a.s, zërin e të cilit e dëgjoi edhe vetë Aliu a.s, thoshte : » Këtu Aliut nuk i ndihmoi rinia fitimtare ! Këtu shpata nuk është arma e sukses-shme, këtu është « DHULFIKKARI » (shpata e Imam Aliut a.s).

- Në këtë luftë Imam Aliu a.s morri gjashtëmbëdhjetë plagë, nga të cilat katër ishin tejet serioze, sa që edhe u rrëzua kali. Në gjithë këtë, rinia e tij e vrullshme i jepte impuls për të ecur përpara, për t'u ngritur sërish në shalën e kalit, dhe qetësohej kur dëgjonte një zë : » Shko në luftë trim ! All-llahu dhe i Dërguari i Tij i vlerësojnë shërbimet e tua ».

- Ky nuk ishte akush tjetër pos melaqja Xhibrili i cili e falënderonte Pejgamberin a All-llahut, për besnikërinë dhe devotshmërinë kur shumëkush e lëshoi.

- Pejgamberi a.s i tha Xhibrilit a.s « Aliu më vjen mua, ndërsa nuk i shkoi atij ».

- Në këtë Xhibrili a.s hetoi se ai sërish u vjen të dyve. (Gjithçka është krijuar nga e njëjta Dritë).

- Pas marrjes vesh të lajmit se Pejgamberi a.s ishte vetëm i plaguar, e jo i vranë, muslimanët filluan të tubohen sërish rreth tij. Mekkasit më nuk patën guximin që sërish t'i shpartallojnë, kështu që mbetën të kënaqur nga fitorja e korrur e lëshuan fushëbetejën duke i deformuar kufomat e muslimanëve dhe ato të plagosurve. Duke u ndalë në Rauhi, tetë milje larg nga Uhudi, Ebu Sufjani u ndje i pakënaqur dhe i dëshpruar nga humbja e madhe e njerëzve të tij, dhe konstatoi se është i kotë luftimi i tij. Filloi të mendonte për të sulmuar Medinën.

- Muhammedi a.s duke dyshuar në tradhëtinë, vendosi që të merr diç dhe që të nesërmen në mëngjes vërtetoi se Hamra El-Asadi i kishte lajmërua mekkasit për afrimin e tyre dhe ishte kthyer në shtëpi.

## LUFTA E AHZABIT (ALEATËVE)

- Sërish në muajin sheval, pas dy vjetësh, në vitin e pestë të Hixhretit një luftë të madhe filluan çifutët në aleancë me jobesimtarët e Mekës, të udhëhequr nga Ebu Sufjani, fiset beduine Gatafan, Solaim, Benu Kuajs dhe Benu Asad, si dhe me çifutët e Hajberit, gjithë këto me një qëllim të vetëm : shkatërrimin e Islamit dhe Pejgamberit a.s.
- Kjo ishte një luftë e rëndësishme historike, për nga natyra dhe mënyra e shkëlqyeshme e mbrojtjes dhe demonstrimit të shkathtësive të të Dërguarit të All-llahut xh.sh. Kjo luftë njihet me emrin lufta e « Hendekut », për shkak të vendosjes së strategjisë së re luftarake përkatësisht hapjes së kanaleve (hendeqeve) prej pesëmbëdhjetë shputave të këmbës në gjërësi dhe po aq masë në thellësi, në pjesën e pambrojtur veriore të qytetit.
- Armiqtë duke iu afruar qytetit, kur e panë formacionin përkatësisht strategjinë e mbrojtjes, gati sa nuk u çmendën nga befasia. Kjo mënyrë e mbrojtjes gjer atëherë ishte e panjohur për arabët, ndaj edhe nuk e dinin se si ta mposhtin një pengesë të tillë.
- Medineja ishte e rrethuar me 10.000 ushtarë jobesimtarë të fiseve të ndryshme. Benu Kurejshi atëherë e ndërpreu marëveshjen e bërë me Pejgamberin a.s dhe iu bashkangjittolonës së jobesimtarëve. Muslimanët ishin tejet të frikësuar, Kur'ani i Madhnueshëm e përshkruan këtë gjendje, duke theksuar : » Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshti, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojllojshme për All-llahun » (ElAhzab, 10).
- Kaluan më tepër se katërmbëdhjetë ditë, gjersa një çetë kalorësish e zbuluan një pjesë më të ngushtë e të dobët të hendekut. Amr ibn Abd Vidi, Nafal ibn Abdullahu dhe Xherar ibn Al-Khattabi, të prirë nga Ikrimë ibn Ebu Xhehli, kërcyen me kuajt e tyre atë vend dhe u turrën drejt muslimanëve. Amr ibn Abdi duke kalëruar dhe lavdëruar heroizmin e tij, iu drejtua muslimanëve duke bërë titur ashpër : » A ka aty dikush nga ju që do të më dal në dyluftim ? »
- Imam Aliu a.s e pyeti Muhammedin a.s që t'i lejojë ta pranojë provokimin e kundërshtarit, por Pejgamberi nuk e lejoi duke i thënë : »Ulu, ai është Amri ».
- Abdu Vidi sërish vazhdoi me provokimin e tij, duke nënçnuar e bërë titur : » Ku e keni atë Xhennetin për të cilin flisni se do të shkoni nëse vriteni ? Nëse është kështu, atëherë pse nuk dilni në dyluftim me mua ? »
- Kur askush prej muslimanëve nuk shprehi dëshirë ta sfydojë thirrjen e tij, Aliu a.s e përsëriti kërkësen e vet : « Unë jam për te, o i Dërguari i All-llahut ! »
- Pejgamberi Muhammedi a.s sërish i tha : » Ulu, ai është Amri ! »
- Imam Aliu a.s nuk kishte rrespekt për Amrin dhe të ngajshmit me te, ndaj tha : » Çka se ai është Amri ?! »
- Në atë çast i Dërguari i All-llahut xh.sh u pajtua dhe e lejoi për të dalë. Ai ia dha Imam Aliut a.s shpatën e tij « Dhulfikkar », e veshi me pancirin e tij, ia vëndoi turbanin e vet në kokë, dhe tha : »O All-llah ! Ai është vëllai dhe kushëriri im, ndaj o Zoti im, mos lejo të mbetem vet. Ju jeni më i mirë se trashëgimtari ».
- Imam Aliu a.s doli në fushën e betejës, duke i bërë titur Amrit : » Ti u betove në Zot se asnjërit nga Kurejshitet nuk do t'i kishe lejuar dy provokime përveç nëse ti e zgjedh një prej tyre ».
- « Vërtet u përgjigj Amri, » Ç'është ajo ? »
- Unë të thëras ty në All-llahun, Pejgamberin e Tij dhe Islamin » u përgjigj Imam Aliu a.s.

- « Mua kjo nuk më duhet (nevojitet) » ia priti Amri.
- « Atëherë unë të ftoj në luftë »- i tha Imam Aliu a.s.
- « Kthehu », u përgjigj Amri. » Kishte miqësi të madhe mes meje dhe babait tënd, ndaj unë nuk dua të të vras ».
- « Por, me ndihmën e All-llahut, unë dëshiroj të të mbys ty ! »-sërish u përgjigj Imam Aliu a.s.
- Amri u hidhërua dhe u vërsul ndaj Imam Aliut a.s i cili me plot guxim u kthye kundër tij, dhe si zakonosht, e mbyti. » (35)
- Më pas u dëgjua zëri i Imam Aliut a.s : »All-llahu Ekber ! » (All-llahu është më i Madh), që me fjalë të tjera do të thoshte fitore...
- Kur Imam Aliu a.s u kthye nga fusha e betejës, Resulull-llahu s.a.v.s e pranoi dhe i tha : »Lufta e Ali ibn Ebu Talibit me Amr ibn Vidin, është më e madhe me përmasa, se sa i tërë aktiviteti i gjithë Ummetit tim gjer në Ditën e Kijametit.(36)
- Pas vrasjes së Amrit, Imam Aliu a.s u vendos në boshllëkun e hendekut ku Amri kaloi dhe u pozicionua në atë vend, me qëllim që t'i kundërvihet çdokujt që do të tentonte ta kalojë hendekun (37). Ndrësa aspiratat e ushtërisë së jobesimtarëve, e cila numëronte mijëra ushtarë ishte që t'i mundnin muslimanët dhe ta marrin qytetin e Medinësë. Heroizmi i pashoqë i Imam Aliut që tregoi në luftën e Ahzabi, ishte stimulsi më i fortë që rezultoi në fitoren e bindshme të muslimanëve dhe në paralizimin e ushtrisë së jobesimtarëve. Vdekja e Amrit ndjelli frikë në zemrat e armiqëve, ndaj edhe filluan të tërhiqen grupe-grupe nga fushëbeteja. Më pas edhe vetë Ebu Sufjani u tërhoq.
- Disfata e plotë në luftë dhe vrasja e Amrit nga dora e Imam Aliu a.s aq fort paralizoi forcat e tyre dhe krenarinë, sa që as u shkonte më ndërmend të futen në Medine. Kjo luftë njëherit u tregoi se me çfarë vetëmohimi e sakrifice janë të pajisur luftëtarët e pamposhtur siç ishte Imam Aliu a.s, të cilët e mbronin Pejgamberin a.s dhe thirrjen e tij në Islam, dhe se e pamundur është mposhtja e tyre, ngase Islami vjen të jetojë edhe pas luftës .
- Rasti i Luftës së Ahzabit dhe disa luftërave më të vogla, bënë që fama e Imam Aliut a.s të ndjell frikë në zemrat e siccilit që do të merrte guximin t'i kundërvihet në luftë. Shumë prej luftëtarëve të mëdhenjë refuzonin t'i dilnin Imamit në dyluftim. Ndonjëherë Imam Aliu a.s me dëshirën e flaktë që kishte për të përfunduar luftën, fshihej natën dhe ashtu i padukshëm i sulmonte kundërshtarët befas. Luftëtarët në Benu Kurejdha, Benu Mustalek dhe Fedek janë vetëm disa nga to.

## **LUFTA E HAJBERIT**

- Hajberi, i cili ndodhet rreth 100 milje në verilindje nga Medineja, është vend plotësisht i vërtetuar. Çifutët nga Hajberi, paraqitnin kërcënim serioz për muslimanët. Ata, duke i humbur luftërat që i bënin kundër Pejgamberit të All-llahut xh.sh, filluan ngadalë dhe fshehurazi të përgatitën dhe të nxitin një luftë të madhe kundër muslimanëve.
- Fusha dhe rripi i Hajberit konsideroheshin një ndër oazat më pjellore të shkretëtirës. Fiset çifute, teritor i të cilit ishte Hajberi, me xhelozin e ruanin trungjet e mëdha të pallmave të moçme. Fusha e Hajberit ishte e rrethuar me fortesa të forta, të vendosura në bregore, e që ishin afro dhjetë sosh. Shumica e tyre konsideroheshin të

pamposhtura. Çifutët e Hajberit njiheshin për luftëtarë trimadhe kishin dëshirë të madhe për ta mposhtur Islamin. Duke llogaritur në numrin e tyre të madh, guximin e tyre dhe pozitën e vendbanimit, vendosën që të luftojnë. Kur i Dërguari i All-llahut xh.sh u lajmërua për këtë, u nis me 1400 muslimanë në sulm. Çifutë kishte, shumë më tepër, afro 10.000, të armatosur mirë dhe të fortifikuar në fortesat e tyre. Mirëpo, kur ca prej fortesave u rrethuan, pas një apo dy sulmeve, nuk rezistuan fortë dhe u tërhoqën. Muslimanët i pushtuan fortesat një nga një, deri tek e fundit, e cila dukej e pamposhtme.

- Çifutët ishin të tubuar rreth mbretit të tyre të kombit Kinan ibn Ali Rab-ës, i cili gjendej na atë fortesën më të fortë të Hajberit, të ashtuquajturën Al-Kvamus, e ndërtuar me gurë në një vend tepër strategjik, kështuqë ushtria muslimane u ndal pas tri sulmeve të pasukseshme. Më në fund, i Dërguari i All-llahut xh.sh e dha kushtimin e njohur, i cili njëherit paraqiste mirënjohjen më të shkëlqyeshme për Imam Aliun a.s.

- Duke paraqitur pamundësinë, e udhëheqësve muslimanë për ta pushtuar këtë fortesë të fundit të çifutëve, e cila njëherit ishte edhe pozicionimi i tyre kyç, Pejgamberi a.s duke e ngritur bajrakun e ushtrisë muslimane tha »Nesër këtë bajrak do t'ia jap njeriut që sulmon pamëshirshëm dhe kurrë nuk zbrapset. Ai e don All-llahun e Lartësuar dhe Pejgamberin e Tij, por edhe All-llahu dhe Pejgamberi i Tij e duan atë, dhe ai nuk do të kthehet prapa gjersa All-llahu nuk ia dhuron fitoren.(38)

- Kjo deklaratë ndezi dëshirën në të gjitha zemrat e të pranishmëve prej muslimanëve, gjitha atyre që besonin në All-llahun xh.sh dhe të Dërguarin e Tij. Ata që më tepër e aspironin një nderë kaq të madh ishin Saad ibn Vekkasi dhe Omer ibn Hattabi. Askush nuk mendonte në Imam Aliun a.s kushëririn dhe zëvendësin e Pejgamberit a.s, heroin e të gjitha luftërave të mëparshme, i cili mu ato ditë vuante nga dhimbja e syvendaj edhe nuk shihte asgjë.

- Imam Aliu a.s i cili kishte mbetur në Medinë ngase për shkak të sëmundjes nuk mund të qëndronte në Hajber. Mirëpo, përkundër humbjes së të pamurit shkoi Hajber, mbërriti në mbrëmje tamam në atë ditën e madhe, priste të del mëngjesi, por Pejgamberin a.s askushi nuk e kishte lajmëruar për këtë. Kur Pejgamberi a.s pyeti për Imam Aliun a.s, të gjithë iu përgjigjën se ai është larg, lëngon nga sëmundja dhe nuk sheh fare. Por Muhammedi a.s prapë urdhëroi që t'ia sjellin Imam Aliun a.s. Në kërkesën e tillë, Imam Aliu a.s u paraqit vetë, i prirë nga Selma ibn Aku-u, ngase ai nuk e shihte as rrugën nga ecën. I Dërguari i All-llahut xh.sh e vëndoi kokën e Imam Aliut a.s në krahët e tij dhe me pështymën e tij ia lau sytë, duke e lutur All-llahun xh.sh që t'ia kthejë të pamurit. Në të njëjtin çast, sytë e tij u kthjelluan, kështuqë filloi të shohë, ndërsa më vonë ka thënë se prej atij çasti, kurrë më nuk ka patur probleme me sytë.

- I Dërguari i All-llahut xh.sh erdhi tek Imam Aliu a.s me bajrakun e ngritur, e caktoi atë, e armatosi me « dhulfikkarin », sikur njeriun që e don All-llahun xh.sh dhe Pejgamberin a.s. Ai- Pejgamberi a.s e udhëzoi ta udhëheq luftën dhe të sulmojë gjersa çifutët nuk mposhten. Imam Aliu a.s më pas u ngjiti me një grup luftëtarësh në një dru përpara fortesës me qëllim që ta vëjë bajrakun në majën e saj, njëherit duke u shpjeguar muslimanëve që asesi të mos e largojnë, gjersa nuk pushtohet fortesa. Çifutët fill pas kësaj, menjëherë u turrën në sulm që t'ia zbrapsin muslimanët poshtë. Rabini çifut e pyeti e pyeti Imam Aliun a.s se si e ka emrin, ndërsa Aliu a.s iu përgjigj se quhet : Ali ibn Ebu Talib i ashtuquajtur i Hajdar. Duke e dëgjuar emrin, rabini ua tërhoqi vërejtjen njerëzve të vet, se ki njeri (Imam Aliu a.s, vërej e përkth) nuk do të tërhiqet pa e pushtuar kështjellën. Mirëpo, prijësi çifutë Harithi, i cili fort u rezistonte sulmeve të

mëparshme të muslimanëve, doli përpara duke mbytur disa muslimanë. Kur e pa këtë, Imam Aliu a.s kërceu dhe e mbyti Harithin në një luftë të barabartë gjoks më gjoks.

- Vëllai i Harithit, gjithashtu ishte luftëtar i hatashëm dhe konsiderohej i pathyeshëm në mesin e çifutëve.

- Për t'u hakmarrë vdekjes së vëllait të vet, u paraqit i mbështjellur me pancir të dyfishtë. Mbante një helm të përmbrojtjes së goditjeve të shpatave, që përbëhej me lidhëse nga të dyja anët. Filloi të afrohet drejt muslimanëve me një shtizë prej tri majave. Duke ecur pranë aradhave çifute, provokonte luftëtarët në dyluftim duke bërtitur :

« Unë jam Marhabi, luftëtar i madh në botë ».

- Askush prej muslimanëve nuk merrte hapin për t'i dalë ballë. Imam Aliu a.s vetë u afrua duke mbajtur në vete tesha të leckosura dhe pancirin, duke folur :

« Unë jam ai që nëna më ka emëruar Hajdar, luani i shkretëtirës. Unë i matim armiqtë e mi me madhësinë e thjeshtësisë. »

- Fjalët e Imam Aliut a.s nuk ishin pa kuptim. Ai e dinte se ato kishin ndikim tek Marhaba në shqetësimin, të cilin filloi ta ndjejë, nga ëndërra e pardokohshme, kur iu shfaq se e shndreëon (copton) luanin në copa-copa. Kështuqë ata të dy u afruan fare pranë njëri-tjetrit. Marhaba kishte besim se Imam Aliu a.s do ta shpërthejë me shtizën e tij prej tri majave. Imam Aliu a.s i eskivoi goditjes së tij, dhe para se Marhabi ta rimarë vetveten, ai e cotoi me « dhulfikkarin » e tij, me çka ia shkyu pancirin, kaloi pranë helmës së tij, drejt gjoksit të tij, duke e ndarë (coptuar) në gjysma-gjysma. Marhabi ra në tokë i vdekur, ndërsa fitimtari-Imam Aliu a.s e shpalli fitoren e tij në mënyrën e tij të rëndomtë duke bërtitur : « All-llahu Ekber » !

- Atëherë muslimanët filluan të sulmojnë përpara, gjatë së cilit sulm gjashtë çifutë ranë nga shpata e Imam Aliut a.s. Çifutët duke qenë të ndjekur nga muslimanët, filluan të tërhiqen në fortesë. Gjatë luftimit, një çifutë i dha një goditje në dorë Imam Aliut a.s duke ia nxjerrë shtizën nga dora, të cilën një tjetër ia hudhi përtoke. Imam Aliu a.s tepër u revoltua në këto çaste, duke bërë një përpjekje mbinjerëzore dhe terguar heroizëm të pashoqë. Duke kërcyer hendekun, arriti deri te dyert e hekurta të fortesës , të cilat i lëvizti dhe në rrjedhën e mëturjeshe të luftës i përdori si mburojë.

- Ebu Rafe , njëri prej atyre i cili bashkë me Imam Aliun a.s e morrën fortesën, hulumtoi dyert pas luftimeve, dhe u përpoq bashkë me shtatë njerëz të tjerë t'i lëviz ato, por nuk ia arriti.

- Fortesa u morr, dhe me këtë u arrit fitorja.

- Çifutët në këto luftime humbën 93 njerëz, ndërsa pala muslimane humbi vetëm 19 veta.

- Sipas dijetarit, Sujutiut, në vepërën e tij »Tarihul-hulefa « (Historia e halifëve), Imam Aliu a.s ato dier i ka mbajtur me një dorë, kështu duke ju mundësuar luftëtarëve të vet kalim në anën tjetër të hendekut. Pas fitores, Pejgamberi-Muhammedi a.s e përqafoi Imam Aliun a.s dhe e puthi në ballë duke i thënë :

« Ali ! U frikësova se muslimanët ty do të rrespektojnë siç të krishtertët e rrespektojnë Jezusin. Dëshiroj të them për ty gjithçka që ke bërë për muslimanët, duke të rrespektuar dhe duke e parë pluhurin në këmbët e tua. Ky është një rrespekt i denjë dhe ka hije të të them se ti je pranë meje, e unë jam pranë teje. Ti je i rëndësishëm për mua ashtu siç jam edhe unë për ty, ashtu siç ishte Haruni për Musanë. Ti lufton për të mirën time dhe ti do të jesh i afërti im në Ditën e Gjykimit. Ti do të jesh me mua në burimin e Kevtherit.

Armiqësia ndaj teje, njëherit paraqet armiqtë edhe ndaj meje. Lufta kundër teje është luftë kundër mua. Miku yt është edhe mik imi. Siguria jote është edhe siguria ime. Trupi

yt njëherit është edhe trup imi, ashtu siç është gjaku yt edhe gjak imi. Kush të pendohet ty është njësoj sikur të më pendohet mua. E vërteta gjendet në mendimin tënd, zemrën tënde si dhe gjuhën tënde. Ti beson në All-llahun, ashtu siç besoj edhe unë. Unë do të lutem nëpërmjet udhëzimeve, me të cilat miqtë e tu do të jenë të shpërblyer në qiej, ndërsa armiqët e tu do të ghykohen në Xhehennem » (39).

## LUFTA E HUNEJNIT

- Siç duket muaji sheval, ishte muaj veçse i luftërave.
- Përsëri në këtë muaj, Fiset Benu Huajdha dhe Benu Thekif, të cilët jetonin jashtë Mekës, ishin jashta zhvillimit të Shtetit Islam. Ata filluan t'i mobilizojnë forcat e tyre kundër muslimanëve dhe kështu mblodhën 20.000 njerëz. Muslimanët iu kundërvunë me 12.000 ushtarë. Jobsimtarët u fshehën në rajonin bregor të Hunejnit, mes Taifit dhe Mekës.
- Kur muslimanët arritën herët në mëngjes, jobsimtarët befasisht i sulmuan nga kurtha. Muslimanët e papërgaditur u dekurajuan dhe në rradhët e tyre u paraqit konfuzioni. Filluan të ikin, ndërsa me Pejgamberin-Muhammedin a.s mbetën vetëm Imam Aliu, El-Abbasi dhe disa familjarë të afërt të Muhammedit a.s nga Ehli-Bejti a.s. (40). Ata qëndruan dhe me shembullin e tyre që nuk u lëkundën aspak, me vetë qëndrimin stoik të tyre, u treguan muslimanëve të tjerë që të kthehen në luftë, të cilën sukses-shëm e përfunduan.
- Këto ca shembuj të heroizmit dhe përpjekjeve mbinjerëzore të Imam Aliut a.s janë të shënuara gjatë ditëve të para të Islamit, kur Pejgamberi, Muhammedi a.s ishte në momentet kritike të jetës së tij.
- Imam Aliu a.s kështu pranë të Dërguarit të All-llahut xh.h morri pjesë në të gjitha luftërat që u zhvilluan atëherë, përveç asaj të Tebukut, kur me urdhërin e të Dërguarit të All-llahut xh.sh abstenoj. (41). Ai në të gjitha ato luftëra luajti rolin kryesor dhe jashtëzakonisht ishte i sukses-shëm. Secili hulumtues, duke e parë jetën e Imam Aliut a.s e veçanërisht luftërat që zhvilloi ai, e pamundur është të mos përmendet dhe të potencohet heroizmi i tij, dhe sakrifica e tij vetëmohuese. Vetëm heroizmi si cilësi nuk ishte karakteristikë dalluese e tij, por përdorimi i këtij heroizmi në rrugën e All-llahut xh.sh, në xhihad ishte përcaktimi i tij strategjik e i pashoq. Aspekti më i rëndësishëm i heroizmit të tij ishte përkushtimi i tij i plotë ndaj All-llahut xh.sh dhe sakrifica në rrugën e All-llahut xh.sh. Besimi i Aliut a.s në All-llahun xh.sh ishte motivi i vetëm i heroizmit të tij, dhe që historia e Islamit e ka shënuar në faqet e saja më të ndritura dhe ngjashëm si për të, nuk është shkruar për askënd tjetër. (42)
- Shumë nga udhëheqësit eminent arab nuk i flisnin popullit të thjeshtë për rrethanat e shumta të luftërave, për dobësitë apo humbjet, të cilat kishin të bëjnë me Imam Aliun a.s (përkatesisht i kishin pësuar nga Imam Aliu a.s, vërej e përkth.), ngase shënimet historike janë tejet të qarta dhe decide kur flasin për atë që qëndrueshmëria dhe vendos-shmëria e tij e pashembullt kanë dalë në spikamë në cilat do rrethana qofshin, qoftë kur muslimanët kanë ndejtur bashkë në luftime me të, apo e kanë lëshuar, përkatesisht e kanë lënë vet, në disa çaste betejash. Ky fakt mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet cilësive të Imam Aliut a.s, i cili ishte shpërblyer me besimin e vërtet, duke u mbështetur vetëm në ndihmën e të Madhit Zot. Ai i shërbente vetëm All-llahut xh.sh dhe asgjë tjetër nuk pranonte përveç Tij, All-llahut të Madhëruar. Përveç kësaj, Imam

Aliu a.s posedonte përkatësisht ishte i pajisur me guximin, vendos-shmërinë, paluhatshtërinë dhe fisnikërinë.

## VËSHTRIMI ISLAM NDAJ IMAM ALIUT A.S

- Askush tjetër asnjëherë, në historinë e Islamit nuk ka fituar vlerë dhe madhësi, përkatësisht nuk ka zënë vend të çmuar, ashtu siç ka zënë Imam Aliu a.s. Ndaj nisur nga kjo, del si imperativ porosia që kërkohet prej pasuesve, që atë (Imamin, vërej e përkth.) ta çmojmë, ta duam dhe ta ndjekim ç' do gjurmë të jetës së tij. Kur'ani i Madhnueshëm, tradita dhe tekstet autotentike historike si dhe librat e ndryshëm, me rrëfime të vërteta, të cilat duke e lavdëruar dhe ngritur lart pozitën e Imam Aliut a.s, shkëlqejnë si madalje në gjoksa, të cilat shërbejnë për të spikatur dhe vënë në pah rregullat dhe urdhërat, duke i obliguar muslimanët që ta ndjekin dhe pasojnë rrugën e tij. Nga shpërblimet që Imam Aliu a.s ka marrë nga All-llahu i Lartësuar dhe Pejgamberi i Tij a.s mund të përmendim mbase edhe atë të fundit : »... All-llahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndytësinë e mëkateve dhe t'ju pastroj deri në skaj » (El-Ahzabë, 33)

- Komentatorët e këtyre ajeteve thonë se ky ajet ka të bëjë përkatësisht i dedikohet të Dërguarit të All-llahut xh.sh Muhammedit a.s, Imam Aliut a.s, hazreti Fatimesë, Hasanit dhe Husejnit, të cilët, Pejgamberi a.s njëherë në një rast të gjithë së bashku i mbuloi me jorganin e tij. Kur u shpall ky ajet, Ummu Seleme, bashkëshortja e Pejgamberit a.s e pyeti Pejgamberin : » A bëj pjesë edhe unë në anëtarët e familjes » ? Jo », u përgjigj Pejgamberi a.s » por ti je në rrugën e drejt » (43)  
« E kush të kundërshton ty në çështjen e tij (Isait) pasi të është bërë e ditur e vërteta, ti thuaj : »Ejani i thërrasim bijtë tanë dhe bijat tua, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju, mandej sinqerisht të lutemi për mallkim, dhe mallkimin e All-llahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve ! » (Ali-Imran, 61)

-Të gjithë mufesirët dhe komentatorët e hadithit pohojnë se ky ajet është shpallur kur Pejgamberi a.s e dërgoi Imam Aliun a.s, Fatimenë, Hasanin dhe Husejnin, për ti takuar të krishterët e Naxhranit, për shkak të mospaguajtjes së obligimit (xhizjes, vërej e përkth.). Kur të krishterët e panë Pejgamberin a.s se vjenë bashkë me familjen e tij, ata filluan të frikësohen dhe filluan të arsyetohen për mospagesën e tyre, dhe prematuan se këtë oblogim do ta kryejnë për hir të rrespektit ndaj Pejgamberit a.s (44)

« Dhe ushqimin ua jepnin, edhe pse vet e dëshironin-të varfërit, bonjakut dhe robit. » Ne juve ju ushqejmë vetëm për hir të dashurisë ndaj All-llahut, nga ju nuk kërkojmë as falënderime as lavdërime, ne i frikësohemi Zotit tonë, atë ditë kur fytyrat do të jenë të errësuar dhe të mëzitura. »

Dhe atyre, atë ditë All-llahu frikën do t'ua largojë dhe mirëqenie e gëzim do t'ua jep. » (Ed-Dehr, 8-11).

- Njohësit e tefsirit dhe hadithit unanimisht pajtohen se këto ajete janë shpallur për nderë të Aliut, Fatimesë, Hasanit dhe Husejnit a.s, kur Hasani dhe Husejni ishin të sëmurë, ndërsa Aliu, Fatimeja dhe Fiddah (amvisja e tyre) u betuan ndaj All-llahut



xh.sh se do të agjërojnë tri ditë, nëse dy vogëlushat do të shërohen nga sëmundja e tyre. Vogëlushat u shëruan ndaj ata të tre agjëruan.

- Para perëndimit të diellit, një ditë një i varfër trokiti në derën e tyre, dhe ata ia dhanë një bukë prej elbit, të vetmen që e kishin. Të nesërmen, ditën e dytë sërish një fukara trokiti në derën e tyre, dhe ata përsëri e ushqyen. Ditën e tretë të agjërimit të tyre, një rob lufte gjithashtu kërkoi prej tyre ushqim, dhe ata ia dhan atë që e kishin. Kështuqë, Kjo Familje a.s agjëroi tri ditë duke mos ngrënë asgjë, pos asaj që pinë vetëm ujë. Për shkak të kësaj ngjarjeje, u shpallën ajetet fisnike, të cilët i lavdërojnë ata dhe vepërën e tyre, duke ju treguar si shembull ndjekësve të tyre...

« A mos e konsideruat dhënien e ujit haxhinjëve dhe kujdestarinë ndaj Xhamisë së Shenjtë, si besimin e atij që i besoi All-llahut dhe ditës së fundit dhe që luftoi në rrugën e All-llahut ? Jo, ata nuk janë të barabarta te All-llahu. Popullin mizor All-llahu nuk e vë në rrugë të drejtë. (Et-Tevbe, 19)

- Ndërsa, ky ajet i mësipërm u shpall kur Talha ibn Shejbe e lavdëroi Abbas ibn Abdul-Muttalibin duke i thënë : »Unë kamë kompetenca më të mëdha ndaj Qabesë, ngase unë jam përgjegjës për furnizimin e haxhinjve me ujë dhe çelësi i Qabesë është në duart e mia. »

- Pikërisht në këto çaste Imam Aliu a.s qëlloi të kaloi pranë tyre dhe i pyeti :

« Me cka lavdërohesh ti » ? Kur e morri përgjigjen, Ai-Aliu a.s tha : » Kur isha fëmijë, isha i zgjedhur, gjë që askush prej jush nuk është. »

« Çfarë është ajo » ?- e pyetën ata. Ai u përgjigj : » Unë i pari jam lutur në Islam, dhe jam i pari që kam zhvilluar në rrugën e All-llahut. »

- Që nga ai çast, zbritja e ajeteve ishte lavdërim i dinjitetit të Imam Aliut a.s (46)

- Veç nderimit të madh të Imam Aliut a.s që i bën Kur'ani i Madhnueshëm, duke rrespektuar traditën, Pejgamberi a.s fletë për të si vijon :

1. » Unë jam qyteti i diturisë, ndërsa Aliu porta e atij qyteti. » (47)

- Rresull-llahu a.s gjithashtu ka thënë, duke iu drejtuar Imam Aliut a.s :

2. ti je për mua ashtu siç ishte Haruni për Musanë a.s veçse pas meje nuk ka pejgamber. » (48)

3. « Vetëm besimtarët do të duan ty, ndërsa dyfytëreshit do të urrejnë » (49)

- Në ditën e vëllazërimit të muhaxhirëve me ensarët, Pejgamberi a.s i tha Imam Aliut a.s « Ti je vëllau im, ndërsa unë jam vëllau yt. Nëse dikush të pyet thuaji : » Unë jam rob i All-llahut dhe vëlla i të Dërguarit të Tij. Nëse dikush këtë cilësi do t'ia përshkruante vetes së tij, ai ka gënjyer. » (50)

- Këto ishin disa nga shembuj me të cilat është lavdëruar Imam Aliu a.s. Për tekste të tjera lidhur me këtë çështje, duhet shikuar : »Fada'il Kamsah Min », « Al Sihah Al Sittah », »Yanabi'u Al-Mevada », « Ahmed ibn Hanbel », « Musned, » dhe Dala'il Al-Sadik, »vepërën « Fadail Emirul Muëmininin » dhe argumentet e imamatit të tij.

## **VIRTYTET E IMAM ALIUT A.S**

- Si burim i cili potencon të qenit besnik ndaj Imam Aliut a.s si udhëheqës të muslimanëve, mund ta theksojm ajetin vijues:

« Mik (i afërt) juaji është vetëm All-llahu, është I Dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zeqtin duke bërë rukuë (duke qenë respektues) ». (El-Maide, 55)

- Komentatorët e Kur'anit thonë se ky ajet posaçërisht është shpallur për Imam Ali ibn Ebu Talibin a.s duke pohuar se ai detyrimisht mbetet si imam, autoritet ideologjik, dhe lider politik e shoqëror i komunitetit.(51)
- Kjo është shpallur atëherë kur Imam Aliu a.s e nxorri unazën e tij prej gishti duke u falur dhe ia dha një fukaraje si sadaka. Ajeti u shpall tamam në këtë rast të rëndësishëm dhe e vërtetoi imamatën e Imam Aliut a.s.

## **FJALIMI-HUTBEJA NË « GHADIR »**

- Ky është fjalimi, që i Dërguari i All-llahut xh.sh ua mbajti muslimanëve në vendin e quajtur « Ghadir Khum », në kthimin e tij nga haxhi i fundit prej Mekës, për të cilin Bera bin Azibi thotë : » Ne erdhëm me Pejgamberin a.s në vitin e tij të fundit të haxhit, në vendin, ku ai thirri gjithë popullin në një namaz të përbashkët, »dhe më pas iu drejtua popullit me këto fjalë :  
« A jam ndaj jush më tepër përhjegjës ndaj jush se sa ju vetë? »  
« Po »- iu përgjigjën të pranishmit.
- Atëherë Pejgamberi a.s e ngriti dorën e Aliut a.s dhe tha :  
« Ai është evlija, mbrojtësi i të cilit jam unë. All-llahu xh.sh e mbroftë secilin të cilit ai- (Imam Aliu a.s, vërejt e përkth) i është evlija. All-llahu qoftë armik i atij që është armik i Imam Aliut a.s. »(52)
- Apo, në përputhje me thënien e Ahmed ibn Hanbelit, kur Pejgamberi a.s ka thënë : Çfarëdo qoftë përgjegjësie që kam unë, ka gjithashtu edhe Aliu. O Zot ! Ndhimoi atij që e ndihmon atë, ndërsa bëhu armik i atij që është armik i tij ». (53)
- Pejgamberi-Muhammedi a.s ka thënë :  
« Aliu është me të Vërtetën ashtu siç është edhe e Vërteta me të. Ata (Ali dhe e Vërteta, vërejt e përkth) nuk do të ndahen gjersa Aliu nuk më bashkangjitet...(ndërron jetë, vërejt e përkth)...(54)
- Në një rrëfim tjetër, duke iu drejtuar Ammar ibn Jasinit, Muhammedi a.s i tha : » dhe sikur i gjithë populli të shkojë një lugine, ndërsa Aliu tjetrës, shko luginës që shkon Aliu, mos u bazo në popullin... »(55)
- Pejgamberi a.s gjithashtu ka thënë : » Secili pejgamber ka pasur zëvendësin dhe trashëgimtarin... » (56)
- Kjo që u theksua më sipër, është vetëm një pjesë nga veprat e vërtetuara islame, të dëshmuara nga të gjithë muslimanët. (57).

## **PERIUDHA E HILAFETIT**

- Pejgamberi a.s u shpërngul në Ahiret me kokën në krahët e Imam Aliut a.s. Shkoi tek All-llahu xh.sh mu në kohën kur akoma brengosej për Thirrjen dhe popullin.
- Kjo dëshmohej gjatë vizitës së tij që ua bëri varrezave « Baki », në kohën e sëmundjes së tij të pashërueshme, kur pranë varreve u shpreh : »Es selamu Alejkum, Ehlul-Kabur (banorë të varrezave). Gëzohem që jeni ndryshe prej popullit që do t'u vijnë trazira si netë të errëta prej pasuesve të tyre të parë dhe të fundit ». (59)

- Ai pandërprerë kërkonte nevojën e përmabajtjes pas dy gjërave më të rëndësishme, Librit të Madhnueshëm-Kur'anit dhe ndjekjes së familjes së Pejgamberit a.s (60)
- Në çastet e fundit të jetës së tij, ai kërkonte që t'i sjellin një letër dhe penë, që në të t'i shkruajë popullit çka duhet të ruhet nga haresa, dhe që të mos kthehet në rrugë të shtrembër pas ndrimit jetë të tij. (61)
- Këto dhe shinjat e tjera, qartë tregojnë se Pejgamberi-Muhammedi a.s brengosej për ardhmërinë dhe zhvillimin e Islamit dhe forcimin e komunitetit përpara sfidave dhe trazirave që do të pasonin më vonë. Para se shpirti i Muhammedit a.s ta lëshojë trupin e tij të pastër, Imam Aliu a.s dhe anëtarët e Familjes së tij filluan përgatitjet rreth xhenazes së tij.
- Në ndërkohë, ensarët dhe disa prej muhaxhirëve mbanin një mbledhje në « Thakifa benu Said El-Ensarij », për të caktuar trashëgimtarin i cili do ti udhëheq më tutje muslimanët. Pas një debati të gjatë dhe diskutimi të ashpër në një atmosferë të tendosur, nën zërat e ashpër dhe grindjeve, hazreti Omer ibn Hatabi, tentonte të fitojë të pranishmit për betimin e tij në dhënien e besimit për Ebu Bekrin si halif dhe trashëgimtar të Pejgamberit-Muhammedit a.s, dhe kërkonte që një gjë të tillë ta bëjnë edhe ata, ashtu siç e bëri vetë ai (62).
- Imam Aliu a.s asgjë nuk dinte për atë që po ndodhte, por lajmi i erdhi nga zhurma që ishte shkaktuar kur populli e kishte lëshuar « Thakifa benu Said-in » dhe ishte nisur drejt Xhamisë së Pejgamberit a.s. Imam Aliu a.s dhe Familja e tij akoma ishin të zënë rreth përgatitjes së trupit të Pejgamberit-Muhammedit a.s i cili u mbajt tri ditë pa u varrosur, me qëllim që ndjekësit e tij edhe më tej ta shohin.(63). Kështuqë Imam Aliu a.s besonte në të drejtën e tij legjitime për hilafetin, duke mos e dijtur se çfarë po ngjet jashtë. Gjersa Imam Aliu a.s ishte i zënë me përgatitjen e xhenazes së Pejgamberit a.s të pranishmit në « Thakifa benu Saيدا » pranuan propozimin e Omer ibn Hatabit për pranimin e Ebu Bekrit si halif të muslimanëve.
- Duke marrë parasysh faktin se Imam Aliu a.s dhe Familja e tij, nuk ishin të pranishëm në atë zgjedhje, nukme dhanë bej'atin (betimin) për halifin e posazgjedhur. Krahas Imam Aliut a.s dhe Benu Hashimëve, edhe një numër bukur i madh i disa muslimanëve eminentë dhe as-habëve besnikë nuk ia dhanë bej'atin (besimin) e tyre. Mes tyre ishin :
  1. Abbas ibn Abdul-Muttalibi
  2. Utbe ibn Ebi Lehebi
  3. Selman El-Farisiju
  4. Ebu Dherr El-Giffariju
  5. Ammar ibn Jasiri
  6. El-Mukdadi
  7. El-Ber'a ibn Azibi
  8. Ubej ibn Kabi
  9. Saad ibn Ebi Vekasi
  10. Talha ibn Abdullahu
  11. El-Zubejri
  12. Hudhejme ibn Thabiti
  13. Farva ibn Amr el-Ensariu
  14. Halid ibn El-As El-Amaviu
  15. Saad ibn Ubejde-ja
  16. El-Fadl ibn Abbasi. (64).

- Ai vetë atëherë u tërhoq nga shoqëria dhe iku larg nga njerëzit dhe zënkat e tyre, ndaj për gjastë muaj zëri i tij nuk u dëgjua në të ashtuquajturën « periudhë të ndarjes »(65).

- Incidentet e atëhershme që vërtetë po ngjanin, e rrezikonin dhe e vunë Islamin në rrezik, aq më tepër që mu në këtë periudhë, filluan të paraqiten pejgamber të rrejshëm e të vetëshpallur nëpër Gadishullin Arab, siç ishin » Musejleme El-Kedhabi, Talha ibn Huvejlid El-Affaku, Si'ah ibn El-Harth De'alah, e të tjerë, të cilët seriozisht i shkaktonuan dëm Islamit.

- Njëkohësisht, paralel me këtë, munafikët filluan të forcohen në Medine, si dhe pushteti i tyre, ndërsa nga ana tjetër romakët dhe persianët filluan të vënë jurtha për muslimanët. (66) Pas gjithë këtyre, filluan të paraqiten grupime dhe klane të ndryshme si rezultat i betimit të Tjekifes.

- Marrja e Aliut a.s me çështjen e hilafetit ishte në përputhje me interesin e Islamit, në interes të mbrojtjes së vetvetes dhe unitetit të muslimanëve, e në kundërvënien përkatësisht ndalimin e ndarjes-coptimit të shoqërisë në grupacione dhe në vënien me përkushtim të realizimit të synimeve madhore Islame, për të cilat ai luftoi. Në një nga letrat e asaj kohe, Imam Aliu a.s kështu i përshkruante rrethanat e atëhershme :

« Dhe tani ! All-llahu i Lartësuar e dërgoi të Dërguarin Muhammedin a.s si parlatmëruer për të gjitha botërat, dhe dëshmitarë për të gjithë pejgamberët. Kur Pejgamberi-Selamet e All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij !- u shpërngul në Ahiret, muslimanët filluan të ndahen pas vdekjes së tij. Pasha All-llahun ! Kurrë nuk më është dukur dhe as që kam menduar se arabët pas tij do të largohen nga përfaqësuesit e Shtëpisë së tij të Pastër, e as që do të më tëhuajsojnë mua pas tij. Por befas pashë njerëzit të cilët e rrethonin njeriun duke iu betuar. E mbaja shtrënguar dorën e betimit, gjersa fillova të shoh se si njerëzit me të madhe braktisnin Islamin, duke thirrur në shkatërrimin e fesë së Muhammedit-Selamet e All-llahut qofshin mbi te dhe mbi Familjen e tij !- Atëherë fillova të frikohem se, nëse nuk i ndihmojë Islamit dhe pasuesve të tij, dhe nëse në të paraqiten ndasi dhe përçarje, atëherë fatkeqësia do të jetë më e madhe se sa humbja e pushtetit tuaj, e cila, shikuar në cilindo aspekt është afatshkurtër, pas së cilës gjithçka kalon ashtu siç kalon famitja (vegimi) apo siç shkapërderdhen retë. Ndaj pranoj në këto rrethana të qëndroj, gjersa gënjeshtër nuk shpartallohet dhe shkatërohet, dhe gjersa feja nuk arrinë paqenë dhe sigurinë. » (67).

- Mirëpo, zëri i Imam Aliut a.s filloi të dëgjohet vetëm atëherë kur pyetej rreth ndonjë mendimi. Ai përpiquej në këtë relacion ta kahëzojë jetën islame në përputhshmëri me mësimet e të Dërguarit të All-llahut xh.sh dhe urdhërave më të larta të Kur'anit të Madhnueshëm. Në ndjekjen e përpiktë të mësimave të historisë së jetës së Imam Aliut a.s lehtë dhe menjëherë vërehen qindra situata dhe ndodhi gjatë qeverisjes së hilafetit të Ebu Bekrit, halifit Omer dhe halifit Osman, që ai-Alliu a.s i sqaronte dhe i zgjidhte plotësisht në përputhshmëri me mësimet islame.

- Të tre halifët kërkonin mendimin dhe këshilla prej Imam Aliut a.s në çdo rrethanë kur gjendja vërtetë ishte ngushtë dhe pa shtegdalje. Nga gjithë kjo shihet veprimtaria e tij si udhërrëfyes gjatë eliminimit të zbatimit të Islamit, njohës i fortë i të cilit ishte vetë ai, dhe dhënia e mendimeve të tij udhëheqëse, të cilat qartë na e prezentojnë personalitetin e tij idealeve të larta islame. Roli i tij konstruktiv ishte padyshim tepër domethënës, që argumentohet në shumë shembuj gjatë udhëheqjes së tri halifëve para tij.

## HILAFETI I EBU BEKRIT

- Ebu Bekri mendoi njëherë t'i sulmojë romakët. Gjatë konsultimit me ithtarët e tij, këto të fundit hamendeshin të jepnin mendimin e tyre.
- Kur u këshilluan me Imam Aliun a.s ai, qartë iu përgjigj :  
« Nëse e bën atë (luftën, vërej e përkth), do të jesh fitimtar ».
- Ebu Bekri ishte i kënaqur nga përgjigja e tij, dhe iu drejtua me fjalët :  
« Ti vërtet je në gjendje të japish këshillë të mirë, » dhe pas kësaj përgjegjësinë e udhëheqjes ia besoi Halid ibn Seidit. (68)
- Me një rast tjetër dëshironte ta dënoj një pijanec, mirëpo ky i fundit iu përgjigj :  
« Unë kam pirë, por ama nuk e ka dijtur se është e ndaluar ». Ebu Bekri dërgoi një njeri që të pyes se çfarë duhet të bëjë, përkatësisht si të veproj, Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s u përgjigj :  
« Lejoi njeriut që t'i gjejë dy muslimanë të besueshëm, një ensarij dhe një prej muhaxhirëve, që të pyeten, në qoftë se dikush prej tyre e ka lajmëruar për ajetin e ndalimit të alkoolit apo e ka njoftuar përkitazi me këtë çështje sipas urdhëresës së Pejgamberit-Muhammedit a.s. Nëse ato dy njerëz dëshmojnë se ky njeri nuk ka qenë i njoftuar, atëherë thuaji që më kurrë të mos e bëjë një gjë të tillë dhe lëshoje të shkojë ».
- Halifi veproi tamam kështu dhe e vërtetoi se njeriu e ka fol të vërtetën , ndaj edhe e liroi njeriun (69).
- Muhammedd el-Munkadiri rrëfen se Halid ibn Velidi i shkroi një letër Ebu Bekrit, se si e ka takuar një arab i cili ka kryer marrëdhënie intemedhunshëm me një njeri tjetër, ndaj Ebu Bekri shkurtimisht i informoi disa prej ithtarëve të Muhammedit a.s ndërmjet të cilëve edhe Imam Aliun a.s, i cili ia kumtoi fjalët më të rrepta : » Ky është krim i paparë ndonjëherë, përpos asaj që njëherë e ka kapluar popullin e Lutit. Ju e dini se si All-llahu xh.sh i dënoi ata. Mendoj se ky mëkatar do të duhej të privohet nga jeta. (70). Ebu Bekri i shkroi Ibn Velidit që të veprojë kësisoji, pra ta dënojë me vdekje.
- Udhëheqësi suprem i të krishterëve bashkë me një numër të njerëzve të tij, i parashtrroi disa pyetje Ebu Bekrit. Halifi dërgoi një njeri për ta thirrë Imam Aliun a.s me qëllim që ky i fundit të përgjigjet. Ky njeri e pyeti Imam Aliun a.s si duket fytyra e Zotit dhe ku gjendet Ai. Aliu a.s urdhëroi të bëjnë ca drurë para se ai të vijë. Atëherë filloi ta ndez zjarrin, dhe kur u ndez flaka , Imam e pyeti udhëheqësin krishter :  
« Më thuaj ku është ana e përparme e këtij zjarri « ?
- I krishteri u përgjigj se në të gjitha anët, është ana e përparme. Imam Aliu a.s i tha :  
« Kësaj flake që njeriu e bëri, askush nuk është në gjendje ta dijë se ku është ana e përparme, ndaj edhe për Krijuesin nuk mundemi të themi, përveç asaj se All-llahut i takojnë edhe Lindja edhe Perëndimi, dhe nga do që të kthehesh, ti je-gjendesh përpara All-llahut xh.sh dhe përpara Atij asgjë nuk është e fshehur. (71)
- Perenadori romak e dërgoi përfaqësuesin e vet tek Ebu Bekri, duke ia parashtruar pyetjen se cili është njeriu që asnjëherë nuk ka shpresa se do të hyjë në Xhennet. Nuk i është frikësuar All-llahut ndaj edhe nuk i është lutur. Asnjëherë nuk është përkulur. E han coftinën dhe pin gjakun. Dëshmon për ngjarje të cilat kurrë s'i ka parë, e don fitnen (përçarjen) dhe e urren të Vërtetën. Ebu Bekri u konsultua me Imam Aliun a.s dhe në përgjigjen e tij tha :

« Ky njeri është rob i mirë i All-llahut xh.sh. Ai nuk ka shpresuar në Xhennetin, ndërsa Xhehennemit nuk i është frikësuar, por All-llahut i është frikësuar. Ai kurrë nuk është frikësuar nga « padrejtësia » e Zotit, përkundrazi ai është frikësuar nga drejtësia e Tij. Ai nuk është falur e as që ka rrënë në gjunjë në xhenazet. Ai han prej kafshëve brinore, peshkun dhe mëlçinë e bardhë. Ai e don pasurinë dhe familjen. Fëmijët e juaj dhe familja janë fitneja e juaj... »

« Ai ka dëshmuar se ekziston Xhenneti dhe Xhehennemi, të cilët kurrë nuk i ka parë, ndërsa e ka urrejtur vdekjen e cila është realitet » (72) Këto ishin disa aspekte të rolit të tij në përparimin e Islamit, gjatë qeverisjes së Hazreti Ebu Bekrit, si dhe kjo na e pasqyron urtësinë e tij të jashtëzakonshme që posedonte dhe përdorte tamam në situatat kur duhej dhënë gjykim të drejtë rreth dukurive dhe gjërave të ndryshme.

## HILAFETI I OMER IBN EL-HATTABIT

- Sikundër hazreti Ebu Bekri, edhe halifët tjerë kërkonin mendimin dhe këshillën e Aliut a.s në situatat delikate. Kështu, kur Omer ibn El-Hattabi donte ta sulmojë Perendorinë Romake, ai u konsultua me Imam Aliun a.s i cili e këshilloi që ai vetë (d.m.th hazreti Omeri, vërej e përkth) të mos i prijë ushtrisë, por e këshilloi :

« ...Cakto udhëheqës me përvojë që t'i prijë ekspeditës dhe t'i vëjë nën komandën e tij gjithashtu ushtarët me përvojë, të cilët sukses-shëm mund t'i kundërvihen cilësdorë rrethanë qoftë dhe të cilët kanë përvojë në luftë. Nëse All-llahu xh.sh ua dhuron atyre fitoren, ti do ta arrijshë synimin tënd. Por, nëse në të kundërtën ata e humbasin luftën, ti do të mbetesh në vendin ku duhet t'i ndihmohet shtetit Islam. (73)

- Njëherë në arkën shtetërore erdhën një sasi shumë e madhe të hollash nga Bahrejni. Omeri ua shpërndau muslimanëve, duke mbajtur një sasi rezervash në arkën e shtetit. Ai i thirri Ensarët dhe Muhaxhirët dhe i pyeti se çfarë të bëjë me tepicën e të hollave, ata u përgjigjën :

« O Emirul Muëminin ! Ne e dijmë se tepër je i zënë me punët tona, ndaj kjo edhe nuk të le të qënrosh pran familjes, tregëtisë dhe punës tënde vetjake, ndaj merri ato rezerva për vete ».

- Omeri iu drejtua Imam Aliut a.s dhe e pyeti :

« Çfarë thua ti në këtë ? »

« Ata veçmë tu përgjigjën- i tha Imam Aliu a.s

« Ti më thuaj mua »- sërish iu drejtua Omeri.

- Atëherë Imam Aliu a.s. U përgjigj :

« Përse e morre mbi vete dyshimin dhe e lëshove qetësinë dhe sigurinë » ?

- Atëherë Imam Aliu a.s i rrëfeu një ngjarje të ngjajshme nga jeta e Pejgamberit-Muhammedit a.s dhe në fund i sugjeroi që këto rezerva t'u shpërndajë fukarave.

« Unë të këshilloj që nga ato asgjë të mos marrish, por gjithë ato shpërndajva fukarave. »- i tha Imam Aliu a.s.

- Halifi Omer tha : « Pasha All-llahun, ti ke të drejtë. » (74)

- Ibn Abbasi citon se si Omer ibn El-Hattabi ka thënë :

« Unë nuk do ta lë atë pasuri në Qabe. Unë do ta nxjerr atë prej aty dhe do ta shpenzojë në rrugën e All-llahut, pra në rrugën e hajrit. »

- Imam Aliu a.s e dëgjoi këtë. Ndaj, Omeri e pyeti « Pasha Zotin, çfarë thua ti në këtë ? Nëse ti më trimëron unë ashtu do të veprojë. »

- Imam Aliu a.s i tha : » Si do mundje që atë të na japish neve, kur pronari i saj është njeriu që do të vijë në fund të kohës « (kështu ai mendoi në Imam Mehdiun a.s) (75)
- Sikur të kishte vepruar ndryshe, Omeri do të shpallej fajtorë, ngase e ka prekur pasurië e Qabesë.
- Ebu Ubejde ibn Xherrahu dhe Berah ibn Raman El-Kalbi i shkruan Omerit : » Këtu në Sham popullin e pin verën. Ne kemi dënuar nja dyzet prej tyre, por mendojmë se kjo nuk do të na sjell dobi. »
- Omeri e pyeti popullin, kurse Imam Aliu a.s i tha : Unë jam i mendimit se duhet t'i dënojmë me gjobë siç përshkruhet ai që nuk i dëgjon urdhërat, d.m.th me shtatëdhjetë të rëna. Ngase nëse njeriu pin verë ai vetëm lllomotitet, e me këtë ai nuk bënë çrregullim. »(76)
- Kështuqë Omeri e morri në konsideretë këshillën dhe i shkroi Ebu Ubejdes, se si të njëjtën gjë ta zbatojë në Sham (Dmask).
- Tregohet se një natë Omer ibn Hattabi pa se si një burrë dhe grua (kurvëri). Të nesërmen në mëngjes ai i tha popullit : »Nëse Udhëheqësi sheh se si bëjnë zina një burrë dhe grua, dhe ai i dënon ata ashtu siç e ka përshkruajtur Sheriati, çfarë thoni ju në këtë ? »
- Të pranishmit u përgjigjën : »Ti je Imam (Udhëheqës) » ! Por, Imam Aliu a.s iu drejtua Omerit me këtë fjalë :  
« Ti nuk ke të drejtë një gjë të tillë ta bësh, ngase me një akt të tillë ti do ta kishe dënuar vetveten tënde. All-llahu nuk është i kënaqur me këtë punë, nëse për këtë nuk dëshmojnë katër dëshmitarë. »(77)
- Omeri një kohë bukur të gjatë e la mënjanë këtë ngjarje, ngase ishte i vetëdijshëm dhe e kuptonte se përcaktimet e Sheriatit edhe për të që është Emirul-Muëminin, vlejna njësoj sikur edhe për muslimanët e tjerë. Ndaj, sërish përkitazi me këtë çështje e pyeti popullin, i cili përsëri iu përgjigj si më parë, kurse edhe Imam Aliu a.s prap qëndronte në përgjigjen e mëparshme.
- Halifi Omer, më në fund pranoi mendimin e Imam Aliut a.s.
- Pas miratimit të Ibn Sirinit, Omer ibn El-Hattabi e pyeti popullin : »Sa gra mund të ketë robi » ? Më pas u kthye kah Imam Aliu a.s dhe i tha : »Unë e pyes njeriun që mban veshur xhybenë (d.m.th Imam Aliun a.s) ? »
- Imam Aliu u përgjigj : »Dy » !
- Pas marrjes së Shamit nga ana e muslimanëve, Ubejde ibn Xherrahu e mblodhi popullin dhe filloi t'i pyes a të shkohet në Bejtul-Makdis (Jerusalem) apo në Kisarij.
- Muadh ibn Xhebeli, propozoi që t'i shkruajnë Emirul-Muëminin Omerit për këtë çështje. Kur hazreti Omeri e lexoi letrën, u këshilluan me muslimanët në mesin e të cilëve ndodhej edhe Imam Aliu a.s i cili tha : »Thuaji njeriut tënd të bëjë sulm me ushtrinë e tij në drejtim të Jerusalemit. Pas marrjes, atëherë mund të shkohet në drejtim të Kirsasë, e cila do të pushtohet pas Bejtul-Makdisit Insha-All-llah ! Kjo është ashtu siç ka thënë vetë Pejgamberi a.s »
- Omeri tha : »Në rregull është gjithçka që ka caktuar Resulull-llahu, dhe ti ke të drejtë o Ebul-Hasan. »(79)
- Atëherë i shkroi Ebu Ubejdes të veprojë ashtu siç u tha Imam Aliu a.s.
- Pas fitores së muslimanëve ndaj Persianëve, gjatë qeverisjes së Omerit, Omeri bëri marrëveshje me pasardhësit e Muhammedit a.s rreth rajonit të Kufes.
- Disa prej tyre i thanë : » Ta ndajmë këtë hapësirë mes nesh . »

- Hazreti Omeri atëherë pyeti për mendimin e Aliut a.s, i cili u përgjigj : » Nëse ju e ndani këtë sot, nesër nuk do të mbetet asgjë për ata që do të vijnë pas nesh. Ndaj, lëshoi ata ta caktojnë tokën në dobi të tyre, dhe në këtë rast do të ketë edhe për ne edhe për ata që do të vijnë pas nesh. »
- Halifi Omeri i tha Aliut a.s :  
« Mund që All-llahu atë ta bëjë të mirë. Ke të drejtë. » (80)
- Historiani Taberijn në vepërën e tij »Tarih « (« Historia »), citon Seid ibn Musejbin se ka thënë : » Omer ibn El-Hattabi e tuboi popullin ta llogaritën kalendarin Islam » ?
- Në këtë pyetje, Imam Aliu a.s u përgjigj :  
« Prej ditës kur Pejgamberi i All-llahut u shpërngul prej idhujtarëve të Mekkes. » (d.m.th nga Hixhreti, vërejt e përkth)
- Omeri e pranoi një propozim të tillë që koha të fillojë të llogaritet nga ajo ngjarje, pra viti i Hixhrij. (81)
- Këto ishin disa cilësi që e karakterizonin personalitetin dhe veprat e Imam Aliut a.s gjatë periudhës së hilafetit të hazreti Omerit.

## HILAFETI I OTHMAN IBN AFFANIT

- Tradita Islame gjithashtu përmend një numër buku të madh të ngjarjeve, të cilat dëshmojnë për urtësinë dhe drejtësinë e Aliut, gjatë kohës së qeverisjes halifiti Othman. Shembujt e mëposhtëm, këtë e ilustronjë më së miri :
  1. Një burrë plak u martua me një virgjëreshë. Ajo mbeti me shtatëzënë, ndërsa plaku filloi ta akuzojë për tradhëti bashkëshortore, duke pohuar se ai nuk ka fjetur organikisht me të.
    - Othmani e pyeti gruan : » Ky plaku a ta ka marrë virgjinitetin ? » Jo » - u përgjigj ajo. Atëherë asaj Othmani i caktoi dënimin e paraparë me Sheriat.
    - Mirëpo, Imam Aliu a.s pati vërejtje në këtë, duke thënë : » Gruaja ka dy hapje ; një për pastrimin mujor (menstruacionet) dhe tjetër për urinim. Sipas gjitha gjasave plaku plaku ka nxjerrë mjaftë spermë kështuqë sperma e tij ka mbërijtur në hapjen e saj të menstruacioneve dhe kështu ajo ka ngelur shtatëzënë.
    - Plaku pohoi se, duke thënë : »Unë jam zbrazur mbi organin e saj, por jo gjer në atë masë sa t'ia virgjinitetin asaj. »
    - Imam Aliu a.s tha : » Shtatëzënia ka ngjarë nga kjo, ndaj edhe fëmiju është i tij, dhe mendoj se ai është dashur të dënohet. » (82)
  2. Një as-hab i rëndësishëm i Malikut, duke e cituar Bajah bin Badr Juhamiun, i tha halifit Othman ( Zoti qoftë i kënaqur me të) se një grua ka mbetur shtatëzënë para martesës, ngase ajo ka lindur fëmijë vetëm gjashtë muaj pas shtatëzënisë. Halifi Omer e dënoi me gurëzim (rexhm), por Imam Aliu a.s : » Nëse ajo ta thotë të kundërtën, në pëjtim me librin e All-llahut (Kur'anin), ajo do të fitojë ngase All-llahu i Lartësuar thotë : »... në mbajtjen e fëmijut dhe largimin e tij nga të ushqyerit (ghidhënies) ka tridhjetë muaj... dhe All-llahu poashtu thotë : » Nën atë duhet t'ia ushqejnë fëmijët e tyre dy vite të plota, e cila (kohë) mjafton për ata që plotësisht dëshirojnë të ushqejnë.
    - Kështuqë dy vjet janë periudhë e të ushqyerit, ndërsa gjashtë muaj mund të jenë të shtatzanisë. Othmani atëherë tha : » Lëshojeni të shkojë ! » (83)



## **PËRMBYLLJE E SHKURTËR**

- Këto që u përmendën ishin vetëm disa shembuj të përgjegjësisë së madhe, të cilat i kishte mbi vete personaliteti dhe figura e Imam Aliut a.s e që duhej t'i shpjegonte gjatë periudhës së tri halifëve, të colët shpesh-herë i drejtoheshin për konsultim rreth dhënies së përgjegjeve dhe gjykimit vendimtar për ndonjë çështje. Ai e ka theksuar se një gjë të tillë e ka bërë për hir të lidhjes së fortë që ka pasur me Muhammedin a.s dhe porosinë e tij që ta ruajë unitetin Islam dhe ta mbrojë Islamin nga shtrembërimet dhe devijimet e ndryshme.

- Halifi i dytë (Omer ibn El-Hattabi) tepër i çmonte veprat e Imam Aliut a.s dhe gjithnjë në këtë frymë synonte t'i jetësojë mendimet e tij.

- Disa herë e ka falënderuar dhe lavdëruar, si dhe me plotë dëshirë i pranonte këshillat e tij. Në situata të ndryshme, nuk ngurronte ta përmend këtë, ndaj edhe është shënuar se ai (Omeri, vërejt e përkth) ka thënë : » E lus All-llahun të më mbrojë nga shoqëria ku nuk je ti, o Ebul-Hasan »(84) dhe « Të mos ishte Aliu, Omeri do të ishte shkatërruar. » (85)

## SHËNIME

1. Ansab el-Ashraf 2:170 ; El-Balazri
2. Ansab el-Ashraf 2:177 ; El-Balazri
3. Sharh- komentimi i Nehxhul-Belaga (Shtegu i Elokuencës) 4:561 ; Ibn Ebi Hadid; Dar Ehja El-Kutub Arabi Kajro/Egjpt.
4. Manakib Ali ibn Ebi Talibi (a.s):7, Ibn Magazili;
5. Keshf El-Gima 1:60, El-Arbali, El-Kitab El-Islami;
6. El-Fusul El-Muhima :14; Ibn Sabag El-Meliki-El Sharh Nehxhul-Belaga 1:151, Ibn Ebi Hadid
7. Bihar El-Envar 35:18, Mexhlisi
8. El-Fusul-El-Muhima :14 ; Ibn Sabag El-Meliki-Sharh Nehxhul-Belaga 1:151, Ibn Ebi Hadid
9. Sira Ibn Hisham :263, Ulema ibn Hisham ; Dar ehja'el-turas el-arabi, Bejrut. Bihar El-Envar 35:44 ; Maxhlisi (Hadithi është përcjellur nga vepra « Kanz El-Umal » nga Mutaki El-Hudi) Sharh Nehxhul-Belaga 1:15 ; Ibn Ebi Hadid
10. Sharh Nehxhul-Belaga 1:15 ; Ibid
11. Shahr Nehxhul-Belaga 1:15, njësoj (Hadithi është përcjellur nga vepra e ulema El-Balazri dhe Isfahani)
12. Nehxhul-Belaga :300, komenti i Dr. Subhi Salijj, Bejrut 1967.
13. Ali ibn Ebi Talib (a.s) 1:39 ; Abdulfettah Maksud, dijetarë eminentë i El-Az-harit, Kajro Egjpt.
14. Nehxhul-Belaga 2:137, komenti i Muhammed Abduhusë, Kajro.
15. Nehxhul-Belaga 2:137, njësoj.
16. Tarihul-Hulefa: 185 ; Xhelaluddin Abdurrahman Es-Sujuti El-Shafij.
17. el-Mustadrik 3:136 ; El-hakim El-Nisaburi. Tarihul Kebir 2:81 ; Hatibi El-Bagdadi-Hiljetul-Evlja 1:66 ; Ebu Nuajm.  
El-Sira El-Halabija 1:268 ; Taberi.  
El-Sira El-Nebevijj 1:173 ; Zejni Dahlan.
18. El-Sira El-Nebevijje 1:259 ; Ibn Hisham.
19. El-Kafi 8:399, Kulejni
  - Mustadrik El-Hakim 3:111 ; El-Hakim el-Nisaburi
  - Zahair El-Ukba :60, Ulema Muhibulddin El-Taberi
  - El-Rijad El-Nadira 2:158, Muhibulddin El-Taberi
  - Kitab Sifin :100 ; Naser Ibn Huzahem
  - Vepra El-Gadir 3:221-240 ; Abdul-Husejn El-Amini En-Nexhafi.
20. Musned Ibn Hanbeli 1:111, 159, Ahmed ibn Hanbel
  - El-Sirah El-Halabija 1:381 ; Taberi
  - Kanz El-Umal 13:114 ; El-Mutaki El-Hindi
  - El-Irshad :11 ; Mufid
  - El-Murada't :124 ; Abdul Husejn Sherafuddin (Këtë hadithë e transmetojnë në veprat e tyre : Ibn Is-haku, Ibn Xheriri, Ibn Ebi Hatimi, Ibn Murdavajhi, Ebu Nuajmi, dijetari Bejhekiu në veprat Sunen dhe Delail ; El-Salabija dhe Taberiu në tefsirët e tyre.
21. El-Kalem Fi El-Tarih 2:24 ; Ibn Esir
  - Fikh El-Sirah:102 ; Muhammed El-Gazali
22. (Njësoj sikur në numrin 9)
23. Tarih El-Taberi 2:217 ; El-Taberi
  - El-Kamel fi El-Tarih 2:22, dijetar dhe i njohur
  - Ibn Esir El-Sira El-Halebija 1:381, dijetari Taberi
  - Musned Ibn Hanbeli 1:111, Imam Ahmed Ibn Hanbeli
  - Kanz El-Umal 13: hadhithi nr. 36371 (Këtë hadith e transmetojnë Bejhekiu në Sunen dhe Delail ; El- Sal'abi dhe Tabeiu në komentimet përkatësisht tefisët e sures së Kur'anit Ash-Shuara)
24. Bihar El-Envar 19:3, Mexhlisi ;
  - Tabakat Ibn Saad 1:173, 192
  - Sira Ibn Hisham 1:399-404-Ibn Hisham,
  - Ujun El-Ahbar 2:151, Ibn Kutejbe
  - Tarih Ibn Kethir 3:84, 96, 97, Ibn Kethiri
  - El-Sirah El-Halabija 1:343, dijetar Taberi,

- El-Kausel Fi El-Tarih 2:36, ulema Ibn Esir,
- El-Gadir 7:363-366, dijetar Abdul-Husejn El-Amini El Naxhafi.
- 25. Bihar El-Envar 21:62, Mexhlisi
- Tabakat Ibn Saad 4:23, Ibn Saad.
- Asad Ibn Gaba 1:287, Ibn Esir
- Sherh Nehxhul-Belaga 3:407, Ibn Ebi Hadid
- El-Bidaje ve En-Nihajai 4:256, Ibn Kethir-El-Istiab 1:81, Ibn Kethir El-Istiab 1:81, Ibn Abdel Bari
- Makatil El-taberiju:10, Ebu Feraxh El-Isfahani
- 26. Bihar El-Envar 21:63, ulema Mexhlisi
- 27. Tarih El-Taberi 2:222, ulema El-Taberi
- Tarih Ibn Assaker 1:284, Ibn Assaker
- El-Mustadrik El-Hakim 2:622, El-Hakim El-Nisaburi
- El-Gadir 7:367 ; Abdul-husejn El-Emini El-Naxhafi
- Kashf El-Gama 1:16, Arbili
- 28. El- Mizan (Komentimi i Kur'anit të Madhnueshëm) 9:80 filozofi Muhammed Husejn El-Tabatabai
- 29. El-Mizan 9:80, po ashtu
- 30. Ajn El-Shia't 1:237, Muhsin El-Amin El-Amili
- 31. El-Fusul El-Muhema , 52 Ibn Sabag El-Maliki
- 32. Ansab El-Eshraf 2:91,94 El-Balazri
- Mustedriku i dy sahihëve 3:111, El-Nisai
- Tabakat Ibn Saad 3:15, Ibn Saad
- 33. El-Magazi 1:152, El-Vakidi
- 34. Tarih El-Taberi 3:17, El-Taberi
- El-Sirah En-Nebevija , 3:134, Ibn Hisham
- Dael Es-sidk 2:357, Muhammed Hasan El-Muzafer
- Hajat (jeta) e Emirul Muëminin Ali ibn Ebi Talibi (a.s) :236, Sejjid El-Sadr
- El-Irshad : 52, Mufid
- 35. Es-Sira En-Nebevijeh 2:122, Zejni Dahlan
- Mustedriku në dy sahihët 3:32, El-Nisai
- 36. Mustedriku në dy sahihët 3:32, (ky sahih është transmetuar nga Sufjan El-Theurijju)
- Tarih (Historia) Bagdadi 3:19, Hatibi Bagdadi
- 37. El-Irshad : 58, Mufid
- El-Sirah En-Nebevijj 2:112 Zejni Dahlan
- 38. Ansab Al-Ashraf 2:93, 94, El-Balazri (ky hadith transmetohet nga Ebu Hurejrja dhe Ibn Abbasi)
- Hasais (cilësit) Imam Ali ibn Ebi Talib a.s :9
- 39. El-Sirah En-Nebevijj, Zejni Dahlan
- 40. Sirah Er-Resul 1:279, Muhsin El-Amini
- Tefsiri Al-Mizan :10, komentimi i sures At-Tevbe ajeti 25.
- El-Irshad :74, Mufid
- 41. Ansab Al-Ashraf 2:92, El-Balazri
- Mustedreku në dy sahihët 3:111, dijitari Ibn Saadi.
- Tahzib Al-Tahzib 3:475, Ibn Hudr El-Ashkalani
- El-Fusul El-Muhema 2:309, Ibn Sabag El-Meliki
- Kthehuni në literaturën e veprës (veçoritë e të pestëve- familja e Pejgamberit a.s në gjashtë Sahihët 2:309)
- 42. Tarih El-Hulefa :118, Sujuti
- 43. Mustedrik El-Hakim 3:147, El-Hakim El-Nisaburi
- Sunen El-Bejheki 2:149, El-Bejheki
- Sunen El-Tirmidhi 2:209, Tirmidhi
- Tahzib Al-Tahzib 2:297, Ibn Haxher El-Askalani
- Fada'il El-Hamsa fi sahih El-Sitte 1:270.
- 44. El-Fusul El-Muhemma :25, Ibn Sabag El-Meliki
- 45. Kashaf 2: kapitulli : » Shkaku i zbritjes së ajeteve kur'anore
- Madman El-Bejan, kapitulli tefsiri i Sures Ed-Dehr, Tabrusi
- El-Ukud El-Farid 3:42, Ibn Abdarbahu
- El-Rijad El-Nadira 2:207, taberiu

- El-Mizan 20:132, Muhammed Husejn Tabatabai
- Kashf El-Gamma 1:302, El-Arbali
- El-Gadir 3:107, Abdul-Husejn El-Amini En-Nexhafi
- 46. Tefsiri i Kur'anit të Madhnueshëm 10:59, Taberi
- Esbab En-Nuzuli (Shkaqet e Shpalljes) :182, El-Vahidi
- Komentimi i Kur'anit të Madhnueshëm 8:91, El-Kutubi
- Komentimi i Kur'anit të Madhnueshëm 4:422, Er-Razi
- Komentimi i Kur'anit të Madhnueshëm 2:211, El-Hazem
- El-Dur El-Mensur 3:218, Sujuti
- Xhenaibu El-Mevada :93, El-Kanduzi El-Hanefi
- 47. Mustedriku i dy Sahihëve 3:126, dijetari El-Nissai
- Kanz El-Umal 6:401, dijetari El-Mutaki El-Hindi
- Assad El-Gaba 4:22
- Tarih Bagdadi 4:348, ulema Hatibi Bagdadi
- Fadail El-Hamselfi el-Sihah el-Sitta 2:250
- 48. Musnedi i Ibn Hanbelit 1:174, Imam Ahmed Ibn Hanbel,
- Musned Ebi Davud 3:280, Ebi Davudi
- 49. Sahih Tirmidhi 5 ; Kapitulli « manakib Ali ibn Ebi Talib a.s »
- Musned Ahmed ibn Hanbel 6:292, Ahmed Ibn Hanbeli
- Mustedreku në dy Sahihët 3:128, Nissai
- Fadail El-Hamsa fi El-Sihah Es-Sitte 2:209
- 50. Sahih Tirmidhi 5 : kapitulli « Cilësit e Imam Ali ibn Ebi Talibit a.s »
- El-Hasais :3,18 Nissai
- Mustedriku në dy Sahihët 3:14, El-Hakim El-Nisaburi
- Musned ibn Hanbeli 1:159, Ahmed Ibn Hanbel
- 51. Tefsiri i Kur'anit të Madhnueshëm 6:165, Taberiu
- Asbab En-Nuzul :148, El-Vahidi
- Tefsir Ebu Barakut El-Nasafi 1:496, Ebu Barakut En-Nesafi
- Tefsiri i Kur'anit të Madhnueshëm 3:461, El-Nisaburi
- El-Svavaik El-Muhreka :25, Ibn Haxh El-Askalani
- A'jan El-Shiat 1:368 « Dar Et-Tearuf » Bejrut
- 52. Sahih Ibn Maxhe :12, Ibn Maxhe
- 53. Musned Ibn Hanbeli 4:281, Ahmbed Ibn Hanbel
- Kanz El-Umal 1:48, Mutaki El-Hindi
- Mustdriku në dy Sahihët 3:109, El-Hakim El-Nisaburi-Mexhmaul-Zavaid 9:103,109 ; El-Hajthemi
- El-Gadir 1:213, Abdul-Husejn El-Amini El-Naxhefi
- 54. tarih Bagdad 14:321, Hatibi Bagdadi
- Mexhmual-Zavaid 7:235, El-Hajthemi
- Kenz El-Umal 6:157, Mutaki El-Hindi
- Ali ve Vasija :13, Nexhmuddin Xhefer ibn Muhammed El-Askeri
- 55. Tarih-Bagdadi 13:186, Hatibi Bagdadi
- Mexhmual Zavaid 7:238, El-Hajthemi
- Kanz El-Umal 6:155, Mutaki El-Hindi
- Manakib Ali ibn Ebi Talib :57, El-Havarizmi
- 56. Xhanabiul-Mevada :79, kapitulli : »Porositë e të Deërguarit Muhammedit a.s, Imam Aliut a.s si mbrojtës ».
- Mexhmual-Zavaid 9:113, El-Hajthemi
- Kanz El-Umal 6:154, ulema Mutaki El-Hindi
- Zahair El-Ukba :71, ulema El-Taberi
- Ali ve Vasija (Aliu dhe porositë e Muhammedit a.s) :194 Nexhmuddin el-Askeri (ky hadith është përmendur në këto vepra :Mizan El-I'tiad, El-Zahabija, El-Sa'ali, Sujuti, Kunuz El-daka'k, Dajlavije, Manakib, Ahmed Ibn Hanbeli)
- 57. Kush dëshiron t'i thellojë njohuritë për këtë çështje le t'u referohet veprave në vijim :Xhanaibu El-Mevaida, El-Kanduzi El-Hanefi, El-Fusul El-Muhema, Ibn Sabag El-Maliki, Fadail El-Hamsa fi El-Sihah El-Sittah, Fejrui Abadi, Musned Ibn Hanbel-Imam Ahmed Ibn Hanbeli, El Murad'at, Abdul Husejn Serafudin, Ali ve Vasija Nexhmuddin El-Askeri...
- 58. Musned Ibn Hanbeli 2:300, Ahmed Ibn Hanbel

- Zahair El-Ukba :72, Muhibuddin El-Taberi
- Ali ve Vasija :206-211, Nexhmuddin el-Askeri
- 59. Sunen En-Nissai 4:93, Nissai
- 60. Kanz El-Umal 1:44, Mutaki El-Hindi
- Musned Ibn Hanbeli 5:182-189, Ahmed Ibn Hanbel
- Mustedrik në dy Sahihët 3:148, El-hakim El-Nisaburi
- 61. Sahih El-Buhari 1:39, El-Buhari
- Sahih Muslim 3:259, Muslim
- Musned Ibn Hanbeli 1 : kapitulli i porosive të Pejgamberit a.s
- 62. Tarih El-Taberi , El-Taberi
- Tarih ibn Ethir, Ibn Ethir
- 63. Sahihul-Buhari 5:8, Buhari
- El- Sakifa , ulema Muhammed Rida El-Muzafer
- Sherh El-Nahexh, Ibn Ebi Hadid
- 64. El-Ukd El-Farid 4:259-260, Ibn Abd Rabahu, botimi i dytë.
- Abdullah Ibn Sab'a 1:105, Murteda el-Askeri
- Sherh Nehxhul-Belaga 1:131-134, Ibn Ebi Hadid El-Mua'tezili, botimi i parë, Egjipt.
- El-Gadir 7:76-77 ;5:370-371 ; Abdul-Husejn El-Amini El-Naxhafi
- Muruxh El-Zahab 2:301, Mes'udi
- Assad El-Gabba 3:222, Ibn Ethir
- Tarih El-Taberi 3:208, Taberi
- El-Kamil fi Et-Tarih, 2:325-331 Ibn Ethir
- Tarih El-Jakubi 2:103-105 El-Jakubi
- Semt El-Nuzum El-Avali 2:244, Abdul-Melik El-Mekki
- El-Sirah El-halabija 3:356
- 65. El-Sakifa :160, Muzafer, Bejrut, 1973
- 66. El-Maraxhat :302, Abdul-Husejn Sherafuddin El-Amili
- 67. Nehxhul-Belaga : letra nr. 62 Imam Ali ibn Ebi Talibit a.s bashkësia Islame, Zagreb 1994
- 68. Tarih El-Jakubi 2:111, El-Jakubi
- 69. Manakib Familja e Ali ibn Ebi Talibit a.s 2:356 Ibn Sharh Esh-Shvab
- 70. Ali ve El-Hulefaa :63, Nexhmuddin El-Askeri
- Kanz El-Umal 3:99, Mutaki El-Hindi
- 71. Ali ve Hulefa'a : 60, Nexhmuddin El-Askeri
- Kada Emirul Muëminin Ali ibn Ebi Talib a.s :86, Tastari, botimi i dytë El-A'lami, Bejrut
- 72. Manakib i Familjes së Ali ibn Ebi Talibit a.s 2:358, Ibn Sherh El-Ashvab
- 73. Ali ve El-Hulefa :83 ulema Nexhmuddin El-Askeri
- Musned Ahmed Ibn Hanbeli 1:94, Ahmed ibn Hanbel
- Kanz El-Umal, 7:147, Mutaki El-Hindi
- 74. Shiko në Nehxhul-Belaga
- 75. Kanz El-Umal 7:147 Mutaki El-Hindi
- Sharh El-Meuta 4:25, El-Zarkani
- Ali ve El-Hulefa :98, Nexhmuddin El-Askeri (Ky fjalim gjendet në veprat : Suneni i Bejhekiut dhe Tarihu i Taberiu)
- 76. Kanz El-Umal 3:96, Mutaki El-Hindi
- El-Futunat El-Islamijja 2:482, Zejni Dehlan
- Ali ve El-Hulefa: 9, Nexhmuddin El-Askeri
- 77. Manakib i Familjes së Ali ibn Ebi Talibit a.s 2:370, ulema ibn Shehr Ashvab
- 78. Ali ve El-Hulefa :133, Nexhmuddin El-Askeri
- 79. Ali ve El-Hulefa :239 njësoj
- 80. Tarih El-Taberi, 2:253, Taberi
- Ali ve El-Hulefa :240, Nexhmuddin El-Askeri
- (Ky fjalim gjendet edhe në vepart vijuse :Kanz El-Umal, Mutak El-Hindi; Tarih El-jakubi; El-Jakubijje; Mustedriku në dy Sahihët; El-Hakim En-Nisaburi; El-Kamil fi Et-Tarih, Ibn Ethiri etj)
- 81. Manakib i Familjes së Ali ibn Ebi Talibit a.s 2:371; ulema Ibn Shahr Eshvab
- Axhaib Ahkam Emirul-Muëminin :43; Muhammed ibn Ali El-Komi
- 82. Mankib i Familjes së Ali ibn Ebi Talibit a.s 2:371, Ibn Shehr Ashvab
- Tefsir Ibn Kethir 4:57; Ibn Kethir
- Sunen El\_bejheki 7:442, El-Bejheki

83. Ed-Dur El-Mensur 3:144 Sujuti El-Shafi  
- Siretu ulema Omer Ibn Hattab; 106 Ibn Kijjim El-Xhevzijj  
- El-Futuhah El-Islamijjeh 2:486, ulema Zejni Dahlan  
- Mankib i Familjes së Ali ibn Ebi Talibit a.s 2:361, Ibn Shahr Eshvab  
- El-Gadir 6,7 El-Amini En-Nexhafi
84. Faraid Es-Samtajn 65, kapitulli; El-Hamavini Esh-Shafi  
- Manakib i Familjes së Ali ibn Ebi Talibit a.s 15, El-Hamavini  
- Kifajat Et-talib :96, El-Kani Esh-Shafi.

## **IMAM ALI IBN EBU TALIBI A.S**

(Pjesa e dytë)

### **IMAM ALI IBN EBU TALIBI A.S SI HALIF**

- Pas vrasjes së halifit të tretë hazreti Omerit, birit të Affanit, populli musliman e propozoi Imam Aliun a.s për halif të ri, ndaj edhe ia dhanë tij bej'atin (betimin) d.m.th e zgjodhën për halif. Meqë ndaj Imam Aliut a.s tepër u entuziazmuan dhe i shprehën dëshirat më të mira, Ai u përgjigj:

»Më leni dhe kërkoni një tjetër «

- Imam Aliu veproi kështu pasi që nuk dëshironetë ishte peng dhe instrument I emocioneve të disa njerëzve, të cilët e kundërshtonin halifin e mëparshëm Osman ibn Affanin, ndaj nisur nga kjo ato i shprehnin ndjenjat e tyre dhe qëllimet e mira në adresë të Imam Aliut a.s.

- Imam Aliu a.s nuk dëshironte që hidhërimi i tyre (ndaj Osmanit, vërejt e përkth) të lindte simpatinë ndaj tij. Ç'është e vërteta, Imam Aliu a.s nuk ishte prej atyre që e tërhiqnin pozita apo titulli i lartë, dhe si rrjedhojë e kësaj menjëherë ta pranoi hilafetin, përkundrazi, siç do të shihet edhe në fjalimin e tij të mëposhtëm të cilin e mbajti me rastin e bej'atit, të cilin muslimanët vendosën t'ia japin pas vdekjes së Osman ibn Affanit, me çrast Imami u shpreh :

« Më leni dhe kërkoni një tjetër. Po ballafaqohemi me çështjen e cila posedon fytyra dhe ngjyra, të cilën asnjë zemër nuk mund ta përballojë dhe asnjë nuk mund ta pranojë. Me të vërtetë horizontet janë mjegulluar, ndërsa Rruga e Vërtetë është e humbur... »

- Nisur nga kjo, Imam Aliu a.s në fillim nuk pranoi ftesën e popullit para se ta vërtetojë zgjedhjen e tyre të vërtetë dhe aftësinë e tyre për ta pranuar rrugën e tij dhe planet e tij të drejta. Mirëpo, përkundër gjithë kësaj, muslimanët e kryeqytetit të botës islame-Medinës u tubuan dhe me kënbëgulje i shprehnin dëshirat e tyre të thella për zgjedhjen e tij si halif.

- Ai me vëmendje të posaçme i vështroi insistimet e popullit musliman, dhe më pas atyre iu drejtua me fjalimin e mëposhtëm, fjalim ky në të cilin duke i shpjeguar cilësitë e halifit dhe udhëheqësit të ummetit islam, i parashtrroi edhe kushtet e veta për pranimitë hilafetit :

« O njerëz mendimesh të ndryshme dhe zemrash të ndara, trupar e të cilëve janë të pranishëm, por zemrat e të cilëve nuk janë të pranishme. Po u prij drejt së Vërtetës, mirëpo ju po ikni nga ajo, siç ikin dhinë dhe delet nga ulurima e luanit ! Sa vështirë më vjen t'ua zbuloj fshehtësitë e drejtësisë ose t'ua drejtoj shtrembërimet e së vërtetës ! O Zoti im ! Ti e din se atë që e bëmë nuk ka qenë për të kërkuar pushtet, as për të fituar diç nga kotësia e kësaj bote. Më me dëshirë deshëm, që sërish të rivendosim sombolet e besimit Tënd dhe të rivendosim përparim në qytetet Tua, ashtu që të shtypurit nga krijesat Tua të mund të jenë të sigurt dh të mund të vendosen në kufijtë Tu të braktisur. Zoti im ! Zoti im ! Jam i pari i cili jam orientuar dhe i cili ka dëgjuar dhe është përgjigjur. Asnjëri nuk më ka udhëhequr më tutje, pos Pejgamberit të Zotit- Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij ! Dhe nëse ma jepni bej'atin sipas kushteve të mia, unë do ta pranoj hilafetin. » dhe më pas shtoi : » Ta dini se, nëse i përgjigjem kërkesës suaj, do t'u prij siç di vetë dhe nuk do të dëgjoj çka thot dhe

kritikon dikush. Nëse më braktisni, atëherë unë jam i jëjtë si edhe ju. Mund të ngjajë që më të mirët nga ju t'i dëgjoj dhe t'i bindem atij të cilin ju e zgjidhni për të udhëhequr. Më mirë për ju të jem si këshilltar, se si sundimtar. » (2)

- Në këto momente ummeti pranoi kushtet e Imam Aliut a.s duke i shprehur dëgjueshmërinë e plotë dhe bej'atin, ndërsa ai-Imami i pranoi detyrat e tij si halif dhe imam (udhëheqës) për ta udhëhequr ummetin islam drejt shpëtimit. Detyra e parë të cilën e kishte për obligim që ta bëjë ishte drejtimi i situatës së shtrembër e cila mbretëronte në jetën islame dhe të bëjë reforma rrënjësore të bazuara në themelet e burimit të Zotit. (Kur'anit dhe Hadithit, vërejt e përkth). Ndaj, mu për këtë Imam Aliu a.s e hartoi planin për rrugën në të cilën i dërgoi mëkëbësit e vet anekënd botës islame. Synimin e tij e drejtoi kah dy faktorët apo planet kyçe: atë politiko-udhëheqës dhe ekonomiko-reformator.

## PLANI POLITIK DHE UDHËHEQËS

- Imami dhe udhëheqësi, Ali ibn Ebu Talibi a.s i caktoi cilësitë për mëkëmbës dhe nënpunësit e shtetit, të cilat i rekomandon islami që t'i kenë dhe posedojnë ata që udhëheqin me ummetin islam, patjetër. E si duhet të jenë ato cilësi, ai i definoi me fjalimin vijues : »Ju e dini se vërtet, ai cilit i janë besuar nderi, jeta, preja e luftës, dispozitat ligjore dhe udhëheqja e muslimanëve nuk guxon të jetë dorështrënguar, meqë makutëria e tij e orienton drejt pasurisë së tyre; nuk guxon të jetë as injorant, meqë në atë rast do ta mashtronte me paditurinë e vet; nuk guxon as të punojë padrejtë me pasurinë e vet duke i dhënë përparësi një grupi ndaj një grupi tjetër; nuk guxon as të pranojë mito gjersa sjell vendime, meqë do të shpërdorte të drejtat dhe do t'i mabnte pa përfunduar; dhe nuk guxon të lë pas dore rrugën e Pejgamberit, meqë do të prishte njerëzit. » (3)

- Politika e drejtë të cilën e drejtonte Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s në botën islame, qartë vërehet edhe nga këshilla që ia dha shokut të vet besnik Malik El-Ashtar El-Nahaijut, kur e dërgoi për mëkëmbës (vali) në Egjipt dhe rrethinën e tij. Malikut iu drejtua duke i rekomanduar takvallëk dhe dëgjueshmëri ndaj All-llahut xh.sh me këto fjalë :

« Në emër të All-llahut, Mëshiruesit Mëshirbërësit !...

- (Kjo është ajo që robi i All-llahut, Aliu-Emirul Muëminini, i urdhëroi Malik ibn Eshterit dhe këshillimi i tij, kur e zgjodhi atë për mëkëmbës të Egjiptit, me qëllim të mbledhjes së zekatit, xhihadit kundër armiqve të tij, kërkimin e mirëqenies për banorët e atyre viseve si dhe përparimin e rajonit! E urdhëroi të jetë i ndërgjegjshëm dhe i vetëdijshëm ndaj All-llahut xh.sh, t'i jep përparësi përuljes ndaj All-llahut, dhe ta ndjek atë që Ai e urdhëron në Librin e Tij (Kur'anin) dhe ndjekjen e domoshdoshme të principeve dhe urdhërave të Tij, pa ndjekjen e së cilave, askush nuk do të ishte i lumtur, ndërsa në të kundërtën, përkatësisht në mohimin dhe mosrespektimin e tyre, njeriu shkatërrohet dhe është jo i lumtur; gjithashtu e urdhëron që All-llahut të Madhëruar t'i ndihmojë (shërbej) me gjithë zemrën, dorën dhe gjuhën e tij, kjo për faktin se Ai-I Lartësuar është emri i Tij !- e merr për obligim t'i ndihmojë atij që që e ndihmon All-llahun dhe e forcon atë që e madhëron All-llahun ! Gjithashtu ia tërhoqi vërejtjen që t'a largojë shpirtin e tij prej epshit dhe ta frenojë kur ajo të del në spikamë. Dhe vërtetë shpirti të bie të këqia, përveç atij shpirti që All-llahu e fal dhe mëshiron...)- ; (pra)



... Pastaj, dije o Malik, se po të dërgoj në vendin në të cilin para teje ka pasur administratime edhe të drejtë edhe tiranzues. Njerëzit tani do të shikojnë me vëmendje veprimet e tua, siç ke shikuar edhe ti me vëmendje veprimet e administratorëve para teje. Dhe do të flasin për ty po atë çka ke folur ti për ata. Të ndershmit, natyrisht, janë të njohur për nga autoriteti i mirë i tyre, të cilin All-llahu e ka lëshuar të qarkullojnë për ta përmes gjuhës së robërve të Tij. Rezerva më e mirë le të jetë rezerva e veprave të mira. Prandaj kontrollo pasionet e tua dhe përmbaju ndaj asaj që nuk është e lejuar, ngase të përmabjturit e shpirtit nënkupton të mbajturit e tij në rrugën e mesme, ndërmjet asaj çka adhuron dhe asaj çka nuk adhuron...

... Shpërblej ata me faljen dhe amnistinë tënde bjësoj siç do të dëshiroje që All-llahu të të shpërblej ty me falje dhe mëshirë, ngase ti je mbi ta, kurse ai i cili të porositi për këtë është mbi ty, gjersa All-llahu është mbi atë i cili të emëron administrator. Ai kërkon nga ti të administrosh punët e tij dhe provon përmes tyre...

... Ruaju nga të krahasuarit me Zotin në madhësinë e Tij dhe imitimim e Tij në pushtetin e Tij, ngase All-llahu vërtet e poshtëron çdo tiran dhe turpëron çdo mburravec mendjelartë. Bëhu i drejtë ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve si ndaj vetes tënde, ndaj familjes tënde dhe atyre nga besimtarët e tu pr të cilët ke simpati, sepse nëse nuk vepron kështu do të jesh i padrejtë, ndërsa All-llahu, në emër të robërve të tij, është kundërshtar i atij i cili është i padrejtë ndaj robërve të Zotit...

... Adhuroje më së shumti atë që është më e ekuilibruar në të drejtë, më e përgjithësuarnë drejtësi dhe më gjithpërfshirëse duke marrë parasysh kënaqësinë e besimtarëve, ngase pakënaqësia e njerëzve të zakonshëm merr me vete kënaqësinë e njerëzve të shquar, kurse pakënaqësia e njerëzve të shquar mund të lihet pasdore nëse ekziston kënaqësia e njerëzve të zakonshëm...

... Ruaju nga vrasjet dhe gjakderdhja pa arsyetim, meqë asgjë nuk e shton dënimin e All-llahut dhe nuk është më i madh për nga pasojat dhe më i fuqishëm për zhdukjen e mirësive dhe shkurtimit të afatit, siç është gjakderdhja e pajustificueshme. All-llahu i Madhëruar në Ditën e Gjykimit marrjen në pyetje të njerëzve do ta filloj me rastet e gjakderdhjeve që i kanë bërë...

... Ruaju nga vetëkënaqësia dhe besimi në atë që të duket e mirë... Ruaju nga dëshira për lavdërim të tepruar, meqë kjo është rasti më i sigurt për shejtanin që të zhdukë veprat e mira, të njerëzve të devotshëm. Ruaju nga qortimi i shtetasve për mirësinë tënde, shtimin e veprave tua, ose t'u premtosh e pastaj ta prishësh premtimin, ngase qortimi e zhdukë mirësinë, vetëlavdimi shuanë dritën e së Vërtetës, kurse prishja e premtimit shkakton urrejtjen e Zotit dhe njerëzve. All-llahu i Lartëmadhëruar thotë : « Tek All-llahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni ! » (Kur'an; Es-Saff, 3)

... E ke për detyrë të kujtosh atë që të ka parapri, qoftë ajo administratorë e drejtë, rrëfim i bukur ose shembull i Pejgamberit tonë-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët !- ose dispozitë nga Libri i All-llahut. Prandaj, bazohu në atë që na ke parë neve duke bërë dhe përpiqu ta pasosh atë që të kam urdhëruar në këtë porosi, duke shterruar argumentin tim kundër ty, ashtu që ti nuk ke pretekst kur shpirti yt të sulet drejt pasionit tënd.

- I lutem All-llahut me rrahmetin dhe mëshirën e Tij dhe madhësinë e pushtetit të Tij për dhënjën e aftësisë së mirë, me të cilën Ai mund të më nxitë edhe mua edhe ty të paraqesim arsyetim të qartë para Tij dhe krijesave të Tij në mënyrën me të cilën mund të joshet kënaqësia e Tij bashkë me mirënjohjen e mirë ndër njerëz, rezultat të mirë në pasuri, shtimin e begatisë dhe ngritjen e famës, si dhe që Ai më në fund, t'na mundësojë

të vdesim me vdekje të virtytshme dhe dëshminë e së Vërtetës me jetrat tona; »...Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi ! » (El-Bekare, 156)

- Selam Pejgamberit të All-llahut !

- Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasrdhësit e pastër dhe të ndërsihëm të tij ! Edhe shumë selame !

- Selam ! » (4)

- Në bazë të këtyre parimeve, Imam Aliu a.s ka përshkruar shërbimet e administratës, përkatësisht qeverisjes ashtu siç e lyp Islami në të vërtetë. Meqë disa prej mëkëmbësve që udhëhiqnin në vise të ndryshme Islame, veçmë kishin gabuar, nuk iu kishin përmbajtur këtyre parimeve, Imami i shkarkoi ato prej posteve. Sipas mendimit të disa historianëve, Imam Aliu a.s këtë shkarkim nuk e bëri i shtyrë nga ndonjë motiv hakmarrës apo diç tjetër, përkundrazi ai këtë e bëri vetëm e vetëm për hir të gjeneratave të ardhshme, të reja të cilëve duhej t'ju sigurohej fotografia e drejtë dhe e pastër e Sheriatit Islam, të cilën All-llahu xh.sh e caktoi në Kur'anin e Tij të Madhënueshëm.

## **PLANI EKONOMIK DHE REFORMAT EKONOMIKE**

- Kur Imam Aliu a.s i bëri reformat politike, atëherë u kthye kah reformat ekonomike, kështuqë e ndryshoi sistemin e vjetër të ndarjes së pasurisë islame dhe të dhënave. Me këtë, njëherit bëri edhe një hap tejet të rëndësishëm në drejtësi. Vuri risi në mënyrën e ndarjes së të mirave materiale të shtetit ndërmjet njerëzve, duke i trajtuar të barabartë, ashtu siç i trajtonte edhe vetë Pejgamberi a.s. Hudhi poshtë çfarëdo lloji qoftë diskriminimi në ndarjen e drejtësisë mes njerëzve. Takvallëkun, zgjuarsin islame, xhihadin dhe afërsinë e tij me Pejgamberin a.s, nuk i konsideronte përparësi mbi të cilat dikush mund të ishte i privilegjuar në këtë botë, falë këtyre, por, jo, Imami këto cilësi dhe merita i konsideronte për bazë të shpërblimit të All-llahu xh.sh në Ahiret, ku All-llahu i Lartëmadhëruar çdo vepër do ta peshojë dhe për të do të jep shpërblim (sevap). Këtu, në këtë botë, mbi sipërfaqen e këtij dheut, njerëzit Aliu a.s i konsideronte të barabartë, si para drejtësisë ashtu edhe para gjyqit, detyrimeve si dhe obligimeve. Politikën e tij ekonomike, ashtu edhe si shumicën e çështjeve me të cilat merrej, gjithashtu e shfaqti përkatësisht elaboroi në paraqitjen e para ummetit islam dhe atyre që u interesonte kjo çështje :

« ... Por disa prej muhaxhirëve dhe ensarëve, as-habëve të Pejgamberit a.s, konsideronin se kishin përparësi ndaj të tjerëve për shkak të shoqërimit të tyre me Pejgamberin a.s. Kjo është një përparësi e shkëlqyer tek All-llahu xh.sh, dhe sevapi për veprat e tyre gjithashtu është i madh tek All-llahu xh.sh.

- por dikush i përgjigjet All-llahut xh.sh, Pejgamberit a.s dhe fesë sonë, dhe e pranon fenë tonë dhe falet në drejtim të Qabes sonë (Mekës), si dhe i kryen obligimet e tjera islamike, i meriton të gjitha të drejtat. Ju jeni robër të All-llahut, ndërsa pasuria është pronë e All-llahut, ndaj do ta kisha ndarë drejt mesh jush. Askush nuk ka përparësi ndaj të tjerëve, ndërsa i devotshmi (takvaja) tek All-llahu xh.sh do ta fitojë kompenzimin dhe shpërblimin më fisnik. Por, All-llahu xh.sh të devotshmëve (takvave) nuk u jep kompenzim dhe shpërblim përkatësisht dhuratë në këtë botë, përkundrazi, ajo që është në vetë All-llahun xh.sh-është më e mira. » (5)

- Duke u frikësuar nga pakënaqësitë, shokët e tij më të mirë e mëbesnik, veçanërisht Malik EL-Eshteri, e këshillonte që me rastin e ndarjes së pasurisë islame,

përparësi-prioritet t'ju jep kryetarëve të fiseve dhe as-habëve të Resulullahit a.s Imam Aliu e refuzoi një gjë kategorikisht duke u përgjigjur:

« Më rekomandoni që patjetër të kërkoj ndihmë, duke shkelur mbi ata të cilët jam zgjedhur për udhëheqës. Pasha All-llahun, nuk do të veproj kurrë kështu gjersa të zgjasë kjo botë dhe gjersa madje edhe një yll çon drejt qiellit tjetër. Po sikur edhe pasuria të ishte pronë e vetjake e imja, përsëri do ta kisha ndarë barabar mes tyre, e jo më për këtë pasuri që është në pronësi të All-llahut. Kini kujdes, vërtet dhënia pasuri dikujt që nuk e meriton është e prishur dhe harxhim i kotë. Ai që vepron kështu ngrihet lartë (merr fozitë, famë, vërejt e përkth) në kët botë, por do të jet prej të përbuzëve në botën tjetër-ahiret. Ajo e ngrit përpara njerëzve, por e turpëron në sytë e All-llahut. Nëse njeriu ia jep pasurinë e vet personit që nuk e ka të drejtë për të apo nuk e meriton, All-llahu atë njeri e len pa dashurinë e tyre dhe përveç kësaj dashuria e tyre do të jetë për të tjerët. Ndaj, atëherë kar ai të bie (gjendet) në vuajtje a vështirësi dhe tamam kur i nevojitet ndihmë e atyre që u ndihmoi, ata as që do ta ndihmojnë, por do të shndërrohen në armiqtë dhe mospërfillësit më të këqinjë. »

- Në këtë mënyrë Imam Aliu a.s e caktoi statusin e pasurisë islame në mesin e muslimanëve dhe e praktikoi këtë ndarje të drejtë pa asnjëfarë kushtëzimi. Drejtësia ishte parimi kryesor që udhëhoq edhe në segmentet e tjera të jetës. Posaçërisht ishte kundër çdo keqpërdorimi dhe anashkalimi:

« Pasha All-llahun ! Më me ëndje do ta kisha kaluar natën pa gjumë me një stuhi të llahtarshme apo do të zvarritesha nëpër zinxhirët si marinar i përmbysur, se sa ta takoj All-llahun dhe Pejgamberin e Tij-Selamet e All-llahut qofshin mbi te dhe familjen e tij!- si torturues ndaj ndonjë personi kushdoqoftë ai apo si privues i dikujt nga të nga të mirat e kësaj bote! E si mund t'i hyjë në hak dikujt për hir të atij që ecën rrëmbimthi drejt mosekzistimit dhe i cili gjatë do të presë në sipërfaqe të tokës ?!

- Pasha All-llahun! Sikur edhe të më jepet gjithçka që gjendet mes shtatë qiejve dhe sipër tyre, për tu larguar nga dëgjueshmëria ime ndaj All-llahut xh.sh madje kjo qoftë sa edhe një fletë e mizës, kurrë një gjë të tillë nuk do ta bëja. Për mua vërtetë kjo botë është e pavlerësikur një gjeth në gojën e karkalecit që e përtyp. Ç' i duhen Aliut pasuritë dhe kënaqësitë që nuk do të zgjasin përgjithmonë ?! Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej mendjemadhësisë dhe gabimeve. Vetëm nga Ai ndihmë kërkojmë ! »

- Ky fragment nxjerrë nga fjalimet e tij, qartë tregon qëndrimin e tij ndaj drejtësisë; në të kupruarit e udhëheqjes dhe sundimit; në mënyrën e udhëheqjes sipas udhëzimeve të Pejgamberit a.s; si dhe cilësitë e veçanta të Aliut a.s ndaj urdhërave të All-llahut xh.sh si dhe dhënien përparësi të mirave dhe shpërblimeve të botës tjetër-ahiretit kundrejt të mirave relative e të kalueshme të kësaj bote.

## **SHTEGU I REFORMAVE**

- Ashtu siç veçmë pamë, Imam Aliu a.s vendosi një plan të përgjithshëm të reformave dhe rilindjes së pushtetit islam, posaçërisht në segmentet e drejtësisë dhe ekonomisë.

- Rreth këtij plani d.m.th planit të reformave të cilat Emirul Mëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s e udhëhoqi, ummetin islam përfitoi dobi të madhe në revitalizimin e ligjeve islame, principeve si dhe rilindjes së veprave të tyre. Nisur nga kjo, Imam Aliu a.s për punonjës të administratës dhe mëkëmbës që do të udhëhiqnin botën islame, zgjodhi

njerëz që ishin shembull i jashtëzakonshëm në punën mendore dhe sjelljen e tyre shpirtërore, dhe që ishin plotësisht të dorëzuar ndaj All-llahut xh.sh, dhe njerëz të cilët gjatë gjithë veprave të veta i venin në zbatim rregullat e All-llahut xh.sh. Në mesin e tyre ishin Osmani biri i Hanifit, Muhammedi biri i Ebu Bekrit, Maliku biri i Eshter El-Nehajit si dhe shokët e tjerë besnik të Muhammedit a.s. Udhëheqësve dhe mëkëmbësve të vet u caktoi një detyrë tejet me rëndësi, e ajo ishte: të këshilluat e robërve të Zotit dhe ta përhapin drejtësinë në mesin e tyre, si dhe t'i largojnë dhe eliminonjë të gjitha forcat lokale që ndikojnë, përkatësisht paraqesin pengesë në zhvillimin e drejtë dhe të mbarë të rrugës dhe jetës së drejtë islame, gjë që shihet edhe në udhëzimin e tij që ia jep mëkëmbësit të vet dhe udhëheqësit Muhammedit birit të Ebu Bekrit, me rastin e emërimit për në Egjipt :

« Tregohu ndaj tyre i njerëzishëm, i butë dhe fytyrqeshur. Sillu ndaj tyre në mënyrë të drejtë, ashtu që fisnikët të mos presin padrejtësi në favor të tyre dhe që të dobëtit të mos e humbin shpresën në padrejtësinë tënde ndaj tyre. All-llahu i Madhëruar ! O bashkësi e robërve të Tij, me siguri do t'ju pyesin mbi veprat e tuaja, të vogla e të mëdha, të dukshme e të fshehta. Nëse Ai ju ndëshkon, kjo do të bëhet ngase keniqenë tiranë, e nëse Ai ju falë, kjo do të bëhet për atë se është më i Mëshirshmi... (6)

- Në mesin e këtyre njerëzve Imam Aliu a.s i zgjodhi më të mirët të jenë përkras tij, ata të cilët ishin të aftë dhe të devotshëm (takva), ndërsa nga ana e tij, ai-Imam Aliu a.s i furnizonte me këshillat dhe udhëzimet e tij, me qëllim që sa më mirë t'i udhëzojë drejt jetës dhe klasave të ndryshme të ummetit me të cilat do të udhëhiqnin. Ai u caktoi dhe i urdhëroi mëkëmbësit e tij që të jenë absolutisht të dhënë pas All-llahut xh.sh, duke ju këshilluar mëshirë dhe zbatim të përpiktët drejtësisë, disponim të këndshëm dhe qëndrim miqësor ndaj ummetit të tyre; që me pozitën e tyre që e gëzojnë, të mos shfaqin mendjemadhësi karshi të tjerëve; që të mos shprehin efektin e ashtuquajtur « të forcës së madhe » dhe padrejtësisë në shoqëri, ngase pikërisht veprat e këtilla e ngadalësojnë përkatësisht e pamundësojnë zbatimin e drejtësisë. Detyra e tyre ishte përhapja e drejtësisë shoqërore, dhe vendosja e drejtësisë së individit dhe secilit musliman, dhe e tërë kjo përparësi qartë shihet nëpërmes letrave të cilat Imam Aliu a.s u dërgonte mëkëmbësve të tij :

« Priti njerëzit fytyrqeshur, lejo që të vizitojnë lirisht dhe komuniko urdhëresat me zemërgjërësi. Dije se nga Zjarri të largon krejt ajo që të afron te All-llahu dhe se zjarri të afron krejt ajo që të largon nga All-llahu. »(7)

- Këto ishin vetëm ca pjesë fragmentesh prej udhëzimeve që Imam Aliu a.s ua dërgonte shokëve të tij besnikë e të devotshëm dhe udhëheqës të drejtë, ai iu përkushtua i tëri udhëzimeve dhe këshillave mbi sundimin dhe sjelljen e tyre ndaj ummetit. Kështu që ai i i ndiqte veprat e tyre dhe mënyrën e sundimit gjithnjë duke insistuar në zbatimin e drejtësisë islame, dhe kur ndodhte të paraqitejndonjë gabim; qoftë ia spontan apo i rastësishëm; ai menjëherë dinte si të ndërvejojë për ta përmirësuar rrugën e tyre, qoftë kjo nëpërmjet kësillimit a udhëzimit apo tërheqjes së vërejtjes ose largimit të tyre nga detyra. Kjo më së miri shihet nëpërmjet letrës së tij drejtuar mëkëmbësit të vet në Basër, Osmanit birit të Hunejf El-Ensariut, kur Imam Aliu a.s morri lajmin se banorët e Basrës e kanë ftuar atë në gosti dhe ai i është përgjigjur një ftese të tillë. Imam Aliu a.s duke supozuar veprat e këtilla mundët që Osmanin ta largojnë nga veprat e mira, duke u nisur nga ajo se Osmani në të ardhmen mund atyre njerëzve që e kanë ftuar në gosti t'u jep përparësi dhe favorizime të tjera, të cilat mund të prishin autoritetin e tij si dhe atë të halifit musliman, ai dërgoi letrën vijuese:

« Dhe tani ! O biri i Hunejfit, kam marrë vesht se një nga të rinjtë e Basrës të ka ftuar në gosti dhe se ti ke ngerendur me te. U shtruan gjellëra të ndryshme për ty dhe të u afruan pjata të mëdha. Kurrë nuk kam menduar se do të pranosh gostinë e njerëzve të cilët i dëbojnë lypësit dhe ftojnë të pasurit. Mendo për kafshatat të cilat i merr, lëri ato në të cilat dyshon dhe merr ato për të cilat je i sigurt se janë siguruar në mënyrë legjitime (hallall).

- Dije mirë se çdo besimtar e ka imanin të cilin e pason dhe kërkon të ndriçohet me dritën e diturisë së tij. Dije mirë se ju nuk jeni në gjendje të veproni në këtë mënyrë. Por më ndihmoni me virtytshmërinë, përpjekjet personale, nder dhe drejtësi...

... Prandaj , o biri i Hunejfit, ki frikë nga Zoti dhe kënaqu me kothere të bukës, në mënyrë që të spëtosh nga Zjarri ! » (8)

- Letër, gati me përmabjtje të njëjtë, Imami dhe Halifi i besimtarëve-Ali ibn Ebu Talibi a.s i dërgoi në Ardeshir mëkëmbësit të tij Hurra Maskali ibn Hubejre Esh-Shejbaniut, duke ia tërhequr vërejtjen për veprat që i ka bërë, dhe në bazë të cilave e meriton largimin nga posti-detyra:

« Jam informuar për ty për gjëra me ta cilat-nëse i ke bërë-e ke zemëruar All-llahun dhe ia ke mohua ndëgjuesën Imamit tënd. Ti në mesin e arabëve të fisit tënd, të cilët të përkrahin, e shpërndan prenë luftarake të muslimanëve që e kanë fituar me heshtat dhe kuajt e tyre dhe për të cilën është derdhur gjaku i tyre.

- Pasha Atë, i Cili bën që fara të mbijë dhe krijon qenie të gjalla, nëse kjo është e vërtetë, do të poshtëroheshe në sytë e mi dhe do të humbje vlerën për mua. Prandaj mos u sjell me mendjelehtësi ndaj të drejtës së Zotit tënd dhe mos e përmirëso këtë botë duke rrënuar besimin tënd, dhe të jesh nga ata që cilët me veprat e tyre janë në humbje... » (9)

- Letra të ngjajshme u drejtonte edhe mëkëmbësve të tij të tjerë:

« Dhe tani! Kam marrë vesht për ty gjëra me të cilat-nëse i ke bërë- e ke zemëruar Zotin tënd, nuk iu ke bindur Imamit tënd dhe ke tradhëtuar betimin tënd.

- Kam marrë vesht se ke shkatërruar vendin dhe ke grabitur çdo gjë që ka rënë nën këmbët e tua dhe ke gëlltitur çdo gjë që ka qenë në duart e tua. Më dërgo një raport dhe dije që të dhënurit e llogarisë para All-llahut do të jetë më e ashpër se para njerëzve. (10)

- Imam Aliu a.s ashtu siç dinte ti udhëzojë dhe këshillojë mëkëmbësit e tij të cilët i emëronte anakënd trojeve islame, ashtu dinte edhe të udhëheq dhe drejtojë ushtrinë duke ia shpjeguar rrugën e drejtë, si dhe atë se çfarë duhet të bëjnë e si të sillen kur të ballafaqohen me armikun.

- E ndaloi torturimin, nxitjen dhe fillimin e konfliktit, por rekomandoi për durim (sabër), kontroll ndaj vetvetes si dhe të jenë tejet të ndërgjegjshëm edhe kur janë mbrojtës përkatësisht luftëtar. Por, kur armiku filloi t'i provokojë dhe sulmojë, atëherë kanë të drejtë absolutë për t'u mbrojtur, dhe kur të korrin fitore, nuk duhet të bëhën mendjemëdhën. Për fitoren e arrijtur ndaj armikut dhe nuk kanë të drejtë t'i ndjekin ushtarët kundërshtar që janë në tërheqje e sipër nga fushbeteja, ashtu siç edhe nuk kanë të drejtë të varosin të plagosurit, e as që t'i fyejnë e demigrojnë civilët e pafajshëm siç janë gratë, fëmijët dhe pleqtë. Se si duken në të vërtetë disa prej rekomandimeve dhe udhëzimeve të Emirul-Muëmininit Ali ibn Ebu Talibit a.s drejtuar ushtrisë së vet dhe komandantëve që i caktonte, tregojnë fjalët e mëposhtme të Imam Aliut a.s :

« Mos luftoni gjersa ata të mos fillojnë! Ngase-Zotit i qofshim falë-ju vërtet keni të drejtë. Ndërsa fakti që i lejoni atyre të fillojnë luftën do të jetë argument plotësues kundër tyre.

Kur armiku, me vullnetin e Zotit, të mposhtet, mos i vrisni ata të cilët sprapsen, mos i goditni personat e pafuqishëm, mos i ekzekutoni të plagosurit dhe mos i bezdisni femrat nëse ato atakojnë nderin tuaj dhe fyejnë prijësat tuaj, ngase janë të dobëta për nga fuqia, karakteri dhe mendja... » (11)

« Nga robi i All-llahut Aliu, biri i Ebu Talibit, Prijësi i besimtarëve, për oficerët përgjegjës të garnizoneve në pozicionet mbrojtëse !...

... Dijeni mirë se ju vërtet keni të drejtë nga unë, të mos fshehë nga ju asnjë fshehtësi pos në luftë, as të vendos për ndonjë gjë e të mos këshillohem me ju, pos në dispozitat fetare, as të shtyjë çfarëdo të drejtë tuajën nga vendi i saj, as të ndalem gjersa nuk e përmbushi tërësisht, si dhe që për mua të gjithë jemi të barabartë në të drejta. Kur të gjitha këto t'i kryej, atëherë për ju është obligim ta falënderoni Zotin për këto begati, si dhe të më bindeni dhe të mos ngurroni kur të ftoheni, as të mos i leni pas dore veprat e mira, por të ballafaqoheni me vuajtje për hir të asaj çka është e drejtë... » (12)

- Sigurimi material, e drejta e individit në ekonomi dhe mbrojtja e jetës private është faktori tepër i rëndësishëm në ekonominë islame dhe njëherit paraqet themelin e politikës shtetërore islame.

- Sasia e tatimeve (të dhënave) të përcaktuara me Sheriat i siguronte burimet e të mbuluarit të detyrimeve shtetërore në lëmenjt e segmenteve politike, sociale dhe ushtarake, si dhe sektorëve të tjerë shtetërorë, për të cilat shteti bën përkujdesjen. Kështuqë mbledhësit e tatimeve (fjala është për zekatin, vërejt e përkth) kishin një rol të veçantë në shtet, ngase njëkohësisht ishin edhe rojëtar të thesarit. Duke u nisur nga ky rol si dhe specifika e mbledhjes së tatimeve, e cila mund të dilte jashtë kontrollit, Imam Aliu a.s i kushtoi vëmendje të jashtëzakonshme kësaj çështjeje. Vëmendja e tij nuk përqëndrohej në atë që të mblidhen sa më shumë të ardhura në kuptimin material pra, por ai vëmendjen plotësisht e përqëndronte drejt asaj që sistemi i mbledhjes plotësisht të jetë në pajtim dhe përputhshmëri me fisionin e drejtësisë islame për të cilën Imam Aliu a.s çdo herë insistonte dhe e zbatonte në shoqërinë islame. Kështuqë Imam Aliu a.s tepër ishte i vëmendshëm që nëpunësit e tij dhe mbledhësit e tatimeve të jenë të butë, të dashur dhe të drejtë si dhe të posedojnë moral të lartë dhe sens për një përgjegjësi të tillë specifike. Sipas tij, detyra e tyre nuk ishte vetëm mbledhja e pasurisë për pasurimin e shtetit, por sigurimi në kryerjen e obligimeve ndaj së Vërtetës, ndërsa nëpërmjet sjelljes së mirë me ummetin ta vë në pah përkatësisht të del në shesh fytyra e vërtet e fesë Islame. Gjatë misionit të tyre të mbledhjes, targambledhësit nuk kishin të drejtë të detyrojnë njerëzit me dhunë të japin të dhënat, e as të mos i paguanin borxhlinjtë, ta akuzonin dikë rreyh të hollave, të dëmtonin pasurinë e muslimanëve si dhe të atyre të tjerëve që jetonin në botën islme. Gjithashtu nuk kishin të drejtë askënd ta detyrojnë të shesin ndonjë gjë të mirë që atyre t'ua shlyejë borxhet; e as që dikush nga mbledhësit kishte të drejtë të kërkojë diç më tepër se ajo që ishte përshkruar e caktuar në Kur'anin e Madhnueshëm; e as më tepër që rreptësisht e kishin të ndaluar të sillen mendjmedhenj, apo dikjt t'ia ndalojnë përshëndetjen; por me butësi, buzëqeshje dhe dinjitet të silleshin ndaj të obliguarve; gjë që më së miri e pohon udhëzimi i Imamatit a.s:

« ... Prandaj, bëhuni të drejtë ndaj njerëzve dhe punoni me durim në pikëpamje të nevojave të tyre, ngase ju vërtetë jeni thesarët e besimtarëve, përfaqësues të Bashkësisë dhe mëkëmbës të Imamatit.

- Mos e ndani asnjërin nga nevoja e tij! Mos pengoni asnjërin në të kërkuarit e saj! Kurrsesi mos ua shitni njerëzve veshjen e verës ose dimrit, ose kafshët me të cilat punojnë, ose robërit, në mënyrë që të realizoni pagimin e tatimit. Mos e fshikulloni

kursesesi ndonjërin, madje as për një para të vetme. Mos veni dorë kursesesi në pasurinë e ndonjë personi, qoftë musliman ose jomusliman... » (13)

... « Nisu në rrugë me përkushtim ndaj Zotit Një, i Cili nuk ka shok. Kurrë mos ia kall tmerrin muslimanit. Mos iu afro kursesesi nëse ai këtë nuk e dëshiron. Mos merr nga ai kurrë më tepër seç është e drejta e Zotit nga pasuria e tij. Kur të shkosh te ndonjë kabile, qëndro afër puseve të tyre në vend që të futesh në shtëpitë e tyre. Pastaj nisu drejt tyre qetas dhe me dinjitet, gjersa të arrish në mesin e tyre. Mandej jepju selamdhe mos përto t'i përsëndetësh si duhet. Pas kësaj thuaju:

« O robët e Zotit, mëkëmbësi i Zotit dhe halifi i Tij më dërgoi te ju për të mbledhur hisen e Zotit nga pasuria e juaj. A ka diç nga hisja e Zotit në pasuritë tuaja ? Nëse ka, dorëzojani atë mëkëmbësit të tij! »

- Nëse thot : » Nuk ka! » Nëse ndonjëri të përgjigjet pozitivisht, shko me te. Në ndërkohë mos u kanos, as mos rëndo... » (14)

## ASPEKTI ISLAM I DREJTËSISË SHOQËRORE

- Caku I programit të reformave të Imam Aliut a.s kishte të bëjë me të gjitha fushat e shtetit islam konform rregullave të drejtësisë silame. Kjo ishte vazhdimësi e politikës të cilën e filloi dhe zbatoi Pejgamberi-Muhammedi a.s. Imam Aliu a.s duke studjuar dhe hulumtuar gjithë atë që ishte arrirë gjer atëherë si dhe nën dëgjueshëmrinë e plotë ndaj fjalëve të All-llahut xh.sh vëndosi parime të caktuara për të cilat ishte I bindur se përbëjnë kushtet e suksesit. Ai personalisht në jetë u përmbahej këtyre parimeve apo edhe i ndërtonte, gjë që i jepte të drejtë që me këmbëngulje t'i kërkojë edhe nga të tjerët, përkatësisht shokët dhe mëkëmbësit e tij.

- Kushtet që kërkonte mund të përmbliidhen në katër më kryesorët: drejtësia dhe qëndrimi miqësor në jetën e përditshme; kontrolli i punësimit dhe tregut; vetësakrifikimi në emër të Bashkësisë; si dhe barabarësia.

## DREJTËSIA DHE TË QENIT MIQËSOR

- Shoqëria islme në periudhën e Ali ibn Ebu Talibit a.s përjetoj gjendje tepër të lakmueshme, përjetonte lulëzim, drejtësi dhe përkujdesje ndaj njerëzve dhe ajo që ishte më e veçantja-drejtësia në ndarjen e të mirave materiale përkatësisht-pasurisë së Zotit. Vetë Imami personalisht përkujdesej tepër për këtë çështje dhe e kontrollonte gjendjen në shtetin islam:

« Pasha All-llahun ! Me siguri do t'i ndihmoj atij që i është bërë e padrejtë që ta fitojë të drejtën e tij karshi personit që e ka bërë padrejtësinë, dhe të jemi të sigurtë se shtypësin do ta ndjek të lidhur me hallkë gjersa nuk e çoj tek burimi i së vërtetës qoftë ai edhe marrëzisht rrebelohet. » (15)

- Ummeti islam të cilin e udhëhoqi Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s, në gjithë fushat e jetës e ndjeu drejtësin, vëmednjen, mëshirën e cila ummetit i siguroi një nderë të madh, krenari, lumturi dhe liri. Rasti në vijim dëshmon për këtë.

- Shoku i Aliut a.s El-Hakemi rrëfen : »Një ditë Imam Aliu a.s morri disa enë plotë me mjaltë të mbushura dhe i thirri jetimët (bonjakët) e u tha : »Hani dhe kënaquni ». Atëherë kur e pashë gjithë këtë, dëshirova që edhe unë të isha jetim e të

kisha mundësi të hajë me to. Pjesën tjetër që mbeti prej mjaltit e dërgoi në Xahminë e Pejgamberit që aty të ndahet. »

- Haruni, biri i Autarit nga Zazani përcjell ngjarjen vijuese : » Isha me Kamberin, shërbetorin e Imam Aliut a.s, kur ky shkoi tek Imam Aliu a.s e i tha : » O Emirul-Muëminin ! Eja me mua, unë kam ruajtur diç për ty ». Atëherë Imam Aliu a.s e pyeti : » E çka ke ruajtur ? » Kamberi e morri me vete gjer tek shtëpia e vet. Kur ç'të shohim, aty kishte një thes plot të mbushur me ar dhe argjend, dhe Kamberi iu drejtua : »O Emirul-Muëminin ! E di se vetes nuk i ke lënë asgjë prej asaj që më parë e ke ndarë, ndaj edhe lash diç nga kjo pasuri për ty. » Mjerr për ty »-tha Imam Aliu a.s « Ti dëshiron në shtëpinë time të futish një zjarr të madh. » De më pas Imam Aliu a.s e morri shpatën e tij dhe e coptoi në pjesë të vogla arin dhe argjendin, dhe i thirri njerëzit, duke urdhëruar që barabar të ndahet mes tyre. Pastaj shkoi drejt në arkën e shtetit dhe e ndau gjithë atë çka kishte aty. » (17)

- El-Hakemi transmeton : » Imam Aliu a.s e ndante shëgën ^ në mesin e njerëzve kurse Xhamia jonë mori shtatë copa. Imam Aliu a.s atëbotë tha : »O njerëz ! ne fitojmë sasi e cila na duket neve se është e mbushur, mirëpo kur atë e ndajmë atëherë na duket e vogël, ndërsa unë ndaj gjithçka që kam ». Kur për pagë merrtë copëzat të arit, e coptonte atë dhe e shpërndante. »

- Ali ibn Rabi'a rrëfen : » Ibn Et-Tajahu erdhi te Imam Aliu a. dhe i tha :  
« O Emirul-Muëminin ! Thesari (arka) e shtetit është e mbushur përplot me ar dhe argjend ». Ndërsa Imam Aliu a.s u përgjigj : »All-llahu Ekber ! » dhe u ngrit nga vendi duke u mbështetur në duart e Ibn Et-Tajahut. Më pas, hyrën në arkën e shtetit dhe i ftoi njerëzit dhe ua ndau gjithë atë që gjendej brenda, duke thënë :  
« O e verdhë dhe e bardhë (d.m.th ar dhe argjend, vërejt e përkth), mashtroni të tjerët, ndërsa mua jo ! » Dhe kur Imami a.s e shpërndau tërë atë që kishte, e pastroi dyshtemenë dhe i fali dy rekate namaz. »

- Përkujdesja dhe brengosja e Imam Aliut a.s për ummetin e tij ishte tejet e madhe, ai përpiquej t'i eliminojë të gjitha llojet e varfërisë dhe vuajtjet e ummetit të tij, gjë që qartë shihet qysh në fjalimin e tij të parë kur e mbajti me rastin e zgjedhjes për halif, duke thënë :  
« ... Po të dëshiroja, kam mundur të shkoj rrugës e cila shpie midis pastërtisë së gurit të begatshëm, dhe veshjes prej mëndafshit, por nuk ka ndodhur që pasionet e mia të më pushtojnë dhe që lakmia të më shpie në të zgjedhurit e gjellërave, gjersa në Hixhaz ose Jemen ndoshta ka ndonjë i cili nuk ka shpresë në sigurimin e një cope të bukës, ose ndonjë që kurrë nuk ka hëngër gjersa është ngopur. A të shtrihem me barkun plot gjersa përçark mund të ketë stomakë të urriur dhe banorë të etshëm ?! Ose a të bëhem ashtu siç thotëpoeti :

« Gjersa populli pranë teje për një kothere bukë lakmon, ti sëmundjen në brendinë e staomakut e shton ».

- A duhet të jem i kënaqur me atë që më thuhet : » Ky është Prijësi i Besimatrëve !-ndonëse me njerëzit nuk i ndaj vuajtjet e jetës ? Nuk jam i kënaqur për të qenë i brengosur me të ngrënurit e ushqimit të mirë, si shtaza e lidhur, brenga e vetme e së cilës është ushqimi i vet, ose si shtaza e pangopur e cila hallapië. Ajo mbushë stomakun e vet me ushqim, por nuk përfill qëllim pas saj. A do t'i qasem kullosës së shfrenuar të lirë ? Ose do ta heq zvarrë litarin e devijimit ? Ose do të bredh pa qëllim shtigjeve të hutimit ?... (19)



## KONTROLLI I RREPTË NDAJ TREGUT

- Imam Aliu a.s tepër me vëmendje i zbatoi ndryshimet ekonomike, e kuptoi se nuk mundet gjithçka t'i lehet vetëdijes dhe ndërgjegjes së individit. Konsideronte se edhe për drejtësinë në të gjitha fushta e jetës, duhet të vendoset një mekanizëm i cili do të siguronte atë...

Në këtë drejtim, bëri edhe planin e ndjekjes së tregut me qëllim që në formimin e çmimeve të nderohet kërkesa dhe oferta, si dhe kualiteti i mallit; kështuqë nëpërmjet kësaj të pengohet manipulimi gjatë peshimit, çmimeve apo parandalohet mashtrimet e natyrshme të ndryshme. Lidhur me këtë Imam El-Bakiri a.s transmeton :

« Emirul-Muëminin Ali ibn Ebu Talibi a.s për çdo mëngjes e kishte zakon të kalojë pranë tregut të Kufes duke e mbajtur shkopin e tij mbi supë duke folur : » O Tregëtarë ! preferojeni mirësinë, bekohuni me thjestësi, afrojuni mushterinjve, zbukurohuni me urtësi, largojuni nga gënjeshtria, ikni nga e keqja dhe jini të drejtë ndaj të lënëve pasdore (skamnorëve), assesi mos e merrni kamatën, peshoni drejtë edhe në kandar edhe në litra dhe mos ua pakësoni njerëzve gjërat e tyre e as mos bëni të keqe nëpër tokë duke krijuar rrëmujë (kaos) » (20)

- Ebu En-Nevari transmeton : » E kam parë Imam Aliun a.s kur e ka takuar një rrobaqepës, dhe iu ka drejtuar me fjalët : » O rrobaqepës, shtrëngoje perin, kopsat dhe qep fortë. Unë e kam dëgjua Resulullahun a.s kur ka tëhën : » Në Ditën e Gjykimit do del rrobaqepësi mashtrues duke mbajtur teshat të cilat i ka qepur keq, ndaj edhe do të jetë i turpëruar par të gjithëve, » dhe më pas Imami a.s shtoi : » O rrobaqepës, kujdesu edhe për mbeturinat e materialit të qepur, ngase pronari i materialit ka më tepër të drejtë se sa ti... » (21)

- Kështu Imam Aliu a.s e zbatonte drejtësinë në sjoqërinë islame në mënyrën më adekuate, duke treguar këtë personalisht dhe praktikisht me vetë sjelljen e tij. Njëkohësisht edhe ndaj ummetit sillej me shumë mirësi dhe ndjenja të sinqerta, i ngjallte tek njeëzit shpresat e tyre dhe ua largonte atyre vuajtjet gjersa ata nuk e fitonin frytin e drejtësisë në historinë e tyre barabar dhe ashtu siç e përjetonin edhe me Pejgamberin a.s.

## SAKRIFIKICA VETËMOHUESE NË DOBI TË UMMETIT TË VET

- Modestia dhe sinqiriteti ishin dy komponentat që Imam Aliun a.s ia këmbyen të gjitha shijimet të paskrupullt dhe shijimet të kënaqësive të kësaj bote. Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s jetonte në një shtëpi jashtëzakonisht të thjeshtë e cila aspak nuk dallonte nga shtëpitë e më të varfërve të ummetit të tij, hante bukë prej elbi të cilën e përgatiste ai apo gruaja e tij. Vishej me tësja tepër të thjeshta. Parimi i tij themelor shihet edhe nga fjalimi i tij vijues :

« ... Dije mirë se Imami juaj është i kënaqur me dy copa të vjetëruara të veshjes nga gjithë bota dhe me dy rrishta bukë për ushqim. Dije mirë se ju nuk jeni në gjendje të veproni në këtë mënyrë. Por më ndihmoni me virtytshmërinë, përpjekjet personale, nder dhe drejtësi. Ngase-për All-llahun ! unë nuk kam tubuar kurrfarë ari nga kjo botë e juaj, as kam grumbulluar pasurinë e bujshme të saj, as kam mbledhur veshje tjetër pos kësaj të vjetëruar, as kam grabitur ndonjë pëllëmbë të tokës së saj, as kam marrë prej saj më

shumë seç është racioni i gomarit lëkurërjepur. Ajo (kjo botë) në sytë e mi është më e dobët dhe më e ligësht dhe më e parëndësishme se lendeja e idhët... (22)

- Politikën e drejtë të Imam Aliut a.s mundemi ta ndjekim pikërisht në zbatimin e gjithë asaj që ka folur dhe kuvenduar duke jetësuar tek anëtarët e familjes së tij dhe vetja e tij. Vetën e tij dhe familjen nuk e liroi nga asnjë detyrim që ua ngarkonte anëtarëve të tjerë të ummetit islam, gjithnjë duke patur synim përfundimtar mirësinë e përgjithshme. Harun Ibn Antari lidhur me këtë transmeton : » Gjatë dimrit hyja në shtëpinë e Imam Aliut a.s kur jetonte në Harnak. Për shkak të veshjes së hollë që mbante mbi trupin e vet, qartë shihej se i tëri ishte i ftohur, d.m.th ishte i mbërthyer me të ftohtë, ndaj i thashë : » O Emirul-Muëminin! All-llahu xh.sh ty dhe familjes tënde u ka dhënë një pjesë (hise) nga pasuria, ndaj për çfarë shkak u bën kështu nga vetvetja ?! » Atëherë Imam Aliu a.s më shikoi dhe tha : » Pasha Zotin! Nuk do të dëgjoj fjalët e tua, këto janë teshat që i kam marrë me vete prej Medines ».

- Një ditë Asim ibn Zejdi iu drejtua Imam Aliut a.s duke i thënë :  
« O Emirul-Muëminin! Edhe ti ke veshur tesha të ashpra dhe han ushqim të thjeshtë », Imam Aliu a.s iu përgjigj : » Mjerr për ty! Vërtet, nuk jam sikur ti. All-llahu i Madhëruar vërtet i ka urdhëruar prijësit e drejtësisë ta mbajnë veten e tyre në nivelin e njërzve më të thjeshtë, kështuqë të varfërin mos ta mbisundojë varfëria e tij. » (24)

- Suajid ibn Xhafla transmeton për mënyrën e jetesës së Imam Aliut a.s si vijon : » Një ditë hyra në shtëpinë e Imam Aliut a.s ku nuk pashë asgjë tjetër pos Imamit a.s i cili qëndronte ulur në dysheme, ndaj edhe iu drejtova : » O Emirul-Muëminin! Ti je « mbret » i muslimanëve, sundimtar dhe mbrojtës i thesarit të shtetit, ndërsa pranon mysafirë dhe ambasadorë në këtë gjendje... » Atëherë Imam Aliu a.s m'u përgjigj : » O Suajid! Çfarë të duhet rregullimi i shtëpisë në këtë botë, kur së shpejti do ta braktisim, dhe kur ajo më nuk do të na nevojitet në botën tjetër-ahiret, ne-në botën tjetër-me vete do ti marrim vetëm veprat tona dhe atje së shpejti do të shpërngulemi. (25)

- Imam Aliu a.s vetë shkante në treg për ta shitur shpatën e vet me qëllim që të blejë diçka ushqim për familjen e tij, këtë e bënte edhe kur ishte halife dhe udhëheqës islam dhe pranonte pasuri të madhe dhe tatime nga të gjitha anët e botës islame. Ebu Raxha' transmeton : » Një ditë, Imam Aliu a.s e nxorri shpatën e tij në treg dhe tha : » Kush dëshiron ta blejë këtë shpatë nga unë ? Pasha All-llahun në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do ta kisha shitur kurrë këtë shpatë, sikur të kisha diç tjetër për të blerë xhuben. » Athëherë iu drejtova : » Unë do ta shes xhuben hua gjersa ta marrish rogën. » Kështuqë kur Emirul-Muëminini e morri rogën, menjëherë ma pagoi borxhin. » (26)

- Imam Aliu asnjëherë asgjë nuk ka marrë prej pasurisë së muslimanëve. Kur udhëtonte nga një vend në vendin tjetër, ai kishte me vete vetëm atë që e kishte marrë nga Medineja; siç është fjala vjen: deveja, ulësjae saj dhe shëbetori i tij.

- Bekr ibn Issa transmeton : » Imam Aliu a.s u thoshte banorëve të Kufes : » O banorë të Kufes, nëse ndonjëherë e lëshoj qytetin tuaj, dhe nëse me vete marrë diçka tjetër pos shërbetorit tim dhe deveve sime si dhe ulëses së saj-atëherë dijeni se ju kam tradhtuar-mashtruar ».

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s dinte që nafakën e vet ta fitojë nga pasuria e tij që kishte në Xhenbu'ë afër Medines. Kur ndodhte që të fitonte nga kjo pasuri, ai atëherë ma ato fitime i ushqente të varfërit me mish dhe bukë, ndërsa vetë ai e bashkë ma familjen ushqej me bukë të lyster me vaj. Gjithnjë kujdesej që me drejtësinë dhe modestinë e tij me përpikshmëri përherë ta ndjek rrugën e Muhammedit a.s. Në lidhje me këtë Akabe ibn Akva thotë : » Njëherë shkova tek Imam Aliu a.s dhe e pashë duke

ngrënë bukë të thatë me dhallë, gjë që më erdhi habi, ndaj edhe e pyeta : »O Emirul-Muëminin! Po ti a kështu han, në këtë mënyrë ? » Imam Aliu a.s mu përgjigj : » O Abul-Xhanube, Pejgamberi i All-llahut-Selami i All-llahut gjithnjë qoftë mbi te dhe mbi familjen e tij !hante edhe më keq se kjo që hajë unë, Ai-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi familjen e tij !-vishej me tësha më të vjetëruara se sa të miat, ndërsa nëse unë nuk sillem sikur që sillej ai, kam frikë se nuk do të meritojë të jem me të bashkë në ahiret. » (27)

- Për veprat e tij të mira të bëra nda ummetit, Abdullah ibn Husejni Ibn Hasani, transmeton si vijon : » Imam Aliu a.s gjatë kohës së Resulullahut a.s liroi mijëra robër (sklevër) me të hollat që vetë i fitoi me pasurinë dhe djersën e tij. Ndërsa kur u zgjodh halife, pasuria e botës islame gjendej në duart e tij. »

- Sufjan Eth-Thevriju transmeton nga Omer ibn Kajsi si vijon : » E kanë parë Imam Aliun a.s të veshur me xhuben e arrnuar, ndaj edhe për këtë ia tërhoqën vërejtjen, Ai-Imam Aliu a.s u përgjigj : » Në situata të këtilla zemra do të jetë e nënshtruar, ndërsa besimtari do ta pasojë atë. » (28)

- Në këtë thellësi të modestisë dhe të vetëmohimit për hir të kënaqësisë së All-llahut xh.sh, Imam Aliu a.s në shumë raste është shprehur :

« Pasha Zotin! Unë aq shumë herë e kam arrnuar xhuben time, sa që kam filluar të turpërohem prej atij që ma arrnonte. Disa më thonin që ta ndërrojë, mirëpo unë u përgjigjesha : » Keq do të jet për ju, mos insistoni më në këtë, ngase ai që heq vështrësi dhe vuajtje në këtë botë, me siguri do të jetë i kënaqur në botën e ardhshme. (29)

- Më lartë u theksuan vetëm disa nga veçoritë (cilësitë) e Imam Aliut a.s të cilat qartë na pasqyrojnë besimin e tij të patundshëm në drejtësinë Islame, të cilës plotësisht iu përkushtua me qëllim të ndjekjes së udhëzimeve dhe rrugës së Pejgamberit të All-llahut xh.sh, Muhammedit-Selami i All-llahut qoftë gjithnjë mbi te dhe mbi familjen e tij !

## **BARAZIA E TË GJITHË PJESTARËVE TË UMMETIT**

- Standardi i jetësës së gamiljes së Imam Aliut a.s përafërsisht ishte i njëjti si vetë standardi dhe mënyra që vetë Imami jetonte. Jetesa e tyre ndërtohej mbi parimin e drejtësisë në raport me të tjerët sa i përket të drejtave dhe obligimeve. Shtoj edhe atë që detyra e tyre në mbrojtjen e pejgamberllëkut të të Dërguarit a.s, zhvillimin e saj, ishte shumë më e madhe se të gjithë të drejtat tjera të cilin e fitonin apo pranonin.

- Imam Aliu a.s ishte i kujdheshëm dhe i rreptë ndaj familjes së tij dhe fisit, kur ishin në pyetje të drejtat e tyre. Ai-ato i trajtonte njësoj sikur muslimanët tjerë apo njerëzit e thjeshtë dhe nuk preferonte dhënien e çfarëdoqoftë beneficioni, e as në asnjëfarë mënyre në cilindo aspekt nuk u jepte privilegje. I mësonte ata dhe insistonte në atë që të mësojnë duke ndjekur gjurmët dhe rrugën e tij, ndërsa ndonjëherë ishte edhe i ashpër ndaj ndonjërit prej tyre duke ia rrëfyer rrugën e vet të drejtë e cila shpie drejtë drejtësisë. Lidhur me këtë Muslim Sahib El-Hana transmeton : » Pasiqë Imam Aliu a.s e përfundoi luftën në Basër, luftën rreth devesë, u kthye në Kufe, hyri në arkën e shtetërore të muslimanëve dhe tha :

« Oj pasuri, sprovovj të tjerët, ndërsa mua jo ! » dhe e ndau pasurinë në mesin tonë. Atëherë hyri një vogëlushe, e Hasanit apo e Hysejnit, nuk jam i sigurt dhe morri diçka. Imam Aliu vrapoi pas saj dhe ia morri atë senda nga dora. Ne i thamë : » O Emirul-Muëminin ! Ajo ka të drejtë të marrë diçka ». Ndërsa iu na u përgjigj : » I ati i saj e

morri të drejtën e tij (atë që i takonte, vërejt e përkth), le ti jep asaj sa të dojë ! (30)

Harun ibn Saidi gjithashtu transmeton një shembull identik :

« Abdullah ibn Xhafer ibn Ebu Talibi i tha Imam Aliut a.s : » Më jep ndonjë ndihmë apo sadaka, ngase nuk kam me çla të jetojë, përveçse ta shes gomarin tim » Imam Aliu a.s i tha : » Jo, pasha All-llahun, nuk mundem të të jap asgjë, veçse ta urdhërosh djalin e axhës tënd Aliun, të vjedh e të të jep diçka (31)

- Njëherë Akil ibn Ebu Talibi, i cili ishte i verbër, erdhi tek vëllai i vet Imam Aliu a.s dhe kërkoi pak më tepër miell se sa merrte prej thesarit të shtetit. Erdhi disa herë dhe e përsëriti kërkesën e tij. Duke dashur që vëllait të vet Akilit, Imam Aliu a.s e skuqi me zjarr një copë prej hekurit dhe e vendosi në trupin e Akilit. Kur Akili e ndjeu hekurinë e zjarrtë, u largua anash, atëherë Imam Aliu a.s i tha : » Le të vajtojnë ata që vajtojnë o Akil ! Ti po bërtet par këtij hekuri të skuqur nga njeriu vetëm sa për shaka, kurse mua më fut në zjarr të cilin i Plotëfuqishmi e ka ndezur nga zemërimi i Tij !? Ti të çirresh nga dhembja, e unë të heshti para asaj flake ?!... (32)

- Transmetohet se Shurejh ibn El-Harithi i cili ishte gjykatës i halifit dhe Imam Aliut a.s dhe gjersa duke e kryer detyrën e gjykatësit, bleu një shtëpi prej tetëdhjetë dinarësh. Kur Imam Aliu a.s morri vesht për këtë, e thirri Shurejhin dhe i tha : » Kam dëgjuar se ke blerë një shtëpi prej tetëdhjetë dinarësh dhe për këtë ke hartuar një shkresë në të cilën ke futur dëshmitarë !

- Shurejhu u përgjigj : » Po, o Prijësi i besimtarëve, ashtu është ». Imam Aliu e shikoi me zemërim dhe i tha !

« O Shurejh ! Së shpejti do të arrijë ai i cili nuk do të shikojë shkresën tënde, as do të kërkojë nga ti argument të qartë, por do të nxjerrë nga ajo, ndërë shikimi do të jetë i shtangur dhe do të dorëzojë në varrin tënd fare të vetmuar. Prandaj ki kujdes, o Shurejh, nëse shtëpinë e ke blerë nga paratë që nuk janë tuat ose ke paguar këtë çmim nga ndonjë burim ilegjitim, atëherë e ke humbur edhe këtë edhe botën tjetër. Po të më kishtë ardhur me rastin e blerjes së asaj që ke blerë, do ta shkruaja në shkresë në po këtë letër dhe atëherë ti nuk do ta kishte blerë atë shtëpi as edhe për një dëshmi edhe më pak se kjo.

- Ajo shkresë është si vijon :

« Kjo është ajo që ka blerë robi i përvuajtur nga një tjetër, i cili është i shqetësuar nga largimi i shpejtë !

- Ai prej tij ka blerë njërën nga shtëpitë e mashtrimit në viset e të vdekshmëve dhe vendin a tyre që i nënshtrohet shkatërimit. Kjo shtëpi ka katër kufij, si vijon : Kufiri i parë është i afërt me burimet e fatkeqësive : kufiri i dytë përpjeket me kufijt e mjerimit; kufiri i tretë paraqet me pasionin i cili shkatërron; kufiri i katërt arrinë gjer te shejtani, i cili çon në rrugë të prapë, dhe drejt saj hapen dyert e kësaj shtëpie.

- Këtë shtëpi e ka blerë ai që është i mashtruar me shpresa nga ai i cili është i shqetësuar prej vdekjes, duke dalur kështu prej nderit të kënaqësive dhe duke hyrë në poshtëri të kërkimit të lutjes. Nëse ky blerës has në ndonjë pasojë nga kjo kontartë afariste, atëherë kjo është nga Ai i Cili zbulon trupat e sundimtarëve, shtypë jetat e tiranëve, shkatërron pushtetin faraonit si Kisra dhe Cazari, Tuba dhe Himjara dhe gjithë atyre që grumbullojnë pasuri mbi pasuri dhe vazhdojnë me shtimin e saj, ndërtojnë, ngrisin dhe stolisin, grumbullojnë dhe krijojnë rezerva të bindur dhe me supozim se kjo është për pasardhësit, për ti dërguar në vendin e prezentimit dhe llogaritjes, dhe në vendin e shpërblimit dhe dënimit. E kur vendimi të shpallet me drejtësi të plotë do të jenë të humbur « ... kur të vijë koha e caktuar nga All-llahu, zbatohet gjykimi me drejtësi dhe aty atëherë dështojnë ata të katit. » (Gafir, 78)

- Këtë e dëshmon mendja e liruar nga prangat e pasionit dhe e shpëtuar nga pemgesat e kësaj bote. » (33)
- Në këtë mënyrë Imam Aliu a.s e trajtonte familjen e tij, shokët duke e treguar qëndrimin e tij, dhe kurrë nuk ua nënçmoi përkatësisht shkeli çfarëdo qoftë të drejte që kanë muslimanët dhe në llogari të ummetit të vet. Ai tentonte që ti mësojë ata se si ta ngritin moraline tyre mbi parimet e tyre të modëstisë, shquarjes së sakrifikimit në rrugën e All-llahut dhe dobisë së shoqërisë islame. Parimet e tij ishin të qarta, pa asnjëfarë fshehtësie, larg rënies nën ndimimin e çfarëdo lloj qoftë emocioni dhe kompromisi. Edhe kjo shihet nga fjalët e tij : » Pash All-llahun ! Më me ëndje do ta kisha kaluar natën pa gjumë me një stuhi ta llahtashme apo do të zvarritesha nëpër zinxhirët si marinari i përmytur, se sa ta takojë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij-Selamet e All-llahut qofshin mbi te dhe mbi Familjen e tij ! si torturues ndaj ndonjë personi kushdoqoftë ai apo si privues i dikujt nga të mirat e kësaj bote ! E si mund t'i hyjë në hak dikujt për hir të atij që ecën rrëmbimthi drejt mosekzistimit dhe i cili do të presë në sipërfaqe të tokës ?! (34)
- Këto ishin principet e Imam Aliut a.s të cilat i mbajti dhe zgjodhi për moto të jetës së tij kreative. Imam Aliu a.s me të vërtetë paraqet një shkallë të lartë të drejtësisë së shoqërisë islame, të cilën e udhëhoqi dhe realizoi në jetën e njerëzimit, si dhe shembull i moralit të lartë që mund të posedojë një musliman.

## REAGIMET POLITIKE

- Duke qenë se Kurejshitet gjatë kohës së halifes së mëparshme (hazreti Osmanit, vërejt e përkth) kishin përjetuar privilegje dhe përparësi të panumërta, e kishin të vështirë të pranonin rrugën që e caktoi Imam Aliu a.s, posaçërisht në ndjekjen e drejtësisë mes muslimanëve sipas parimeve të drejtësisë shoqërore ashtu siç kishte urdhëruar All-llahu xh.sh, parime këto që ai iu qas me përkushtim duke u përpjekur t'i sendërtojë në shoqërinë islame. Zubejr ibn Avami dhe Talha ibn Ubejdullahu protestonin kundër kësaj politike të re, duke konstatuar se kjo është larg nga tradita me të cilën ishin mësuar njerëzit. Imam Aliu a.s i pyeti : » Çfarë nuk ju pëlqen tek unë, ndaj edhe jeni kundër meje ? » ; Ndërsa ata iu përgjigjën : » Ti e barazove të drejtën tonë (pasurinë) me të tjerët dhe na barazove me ata që nuk janë të rangut tanë, ndërsa atë që e fitojmë nga thesari (pasuria) e shtetit është fryt i luftës tonë dhe punës të cilën e kemi investuar me qëllim të forcimit të thirrjes së All-llahut dhe atë që ne me forcë e kemi fituar është prej atyre që nuk i janë nënshtruar fesë islame. » (35)
- Imam Aliu a.s në lidhje me këtë iu përgjigj të dyve :  
« Të dytë varni buzët për vogëlimal, ndërsa leni anash atë që është e madhe. A mund të thoni për diç që keni të drejtë ndërsa unë ua kam ndaluar, ose për kontributin i cili është juaji ndërsa unë ua kam mohuar, ose për ndonjë musliman i cili ka paraqitur ndonjë të drejtë para meje dhe unë kam qenë i aftë të vendosi për këtë, ose ta kem lënë pas dore, ose të kem bërë gabim lidhur me këtë ?
- Për Zotin nuk kam pasur kurrëfarë dëshire për hilafet, as kurrëfarë nevojë për sundim. Por ju vetë më keni ftuar për këtë dhe më keni bindur për këtë. Ndërsa kur e morra hilafetin në dorë, jam kujdesur për Librin e All-llahut dhe për çdo gjë që Ai na ka urdhëruar përmes tij dhe ka përcaktuar në mënyrë që siaps tij-Kur'anit-të gjykojmë. Dhe kësaj i jam përmbajtur. Ndërsa po kështu kam vepruar me atë që Pejgamberi-Selamet e All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij !- na ka porositur me Pasardhësit të tij.

Dhe i jam përmbajtur. Në këtë nuk kam pasur nevojë për mendimin tuaj dhe mendimin e kujdoqoftë tjetër, as ka pasur ndonjë dispozitë për të cilën nuk kam pasur njohuri ose për të cilën është dashur të kërkoj këshillë nga ju ose vëllezërit e mi musliman. Po të ishta kështu nuk do t'ua ktheja shpinën juve ose të tjerëve.

- Sa i përket insistimit tuaj për çështjen e barazisë, kjo është diç për çka unë nuk kam vendosur sipas mendimit tim, as kam bërë sipas dëshirës sime, porse e kam kuptuar-madje edhe ju e keni kuptuar-se çdo gjë që e ka sjellur Pejgamberi-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij ! ka qenë tërësisht e zbatuar. Prandaj nuk kam ndjerë kurrfarë nevojë që t'u drejtohem lidhur me atë që All-llahu e ka përcaktuar dhe për të cilën ekziston dispozita e Tij. Prë këtë arsye, pasha All-llahun, ju dy. Ose kushdo qoftë tjetër, nuk mund të keni kurrfarë përparësie te unë. All-llahu i përqëndroftë zemrat tona dhe tuajat në të Vërtetën dhe na dhuroftë edhe juve edhe neve durim ! »

- Kurse pastaj Imami a.s tha : » All-llahu e mëshiroftë njeriun i cili, kur e vëren të vërtetën, e përkrah atë, ose kur e vëren të padrejtën, e refuzon atë, dhe kështu me të vërtetë e ndihmon atë i cili është me të Vërtetën ! » (38)

- Sundimi i Imam Aliut a.s sipas urdhëresave të Zotit dhe të Pejgamberit të Tij-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij !- ishte shkaku i konfortimit konceptual dhe parimor me ata që për premisa të tyre merrnin interesat vetjake. Mirëpo, synimi i ruajtjes dhe zhvillimit të principeve të pejgamberrllëkut, të cilat vetë Muhammedi a.s i urdhëroi dhe vuri në zbatim, e jo interesi material e përfitues që fare shkurtë do të qëndronin-ishin synimi parësor dhe caku përfundimtar i Imam Aliut a.s, dhe pikërisht këto e karakterizonin portretin madhështor të Imamit a.s.

## **KUNDËRSHTIMI I MUAVIJE IBN EBU SUFJANIT**

- Kur u përhap lajmi se Imam Aliu a.s u zgjodh halife dhe u bë udhëheqës i ummetit islam, Muaviu i biri i Ebu Sufjanit u frikësua nga hilafeti i Imam Aliut a.s dhe e shpalli kundërshtimin e tij për këtë. Muaviu fill pas kësaj, morri një letër nga Amr ibn Asi i cili ia paraqiti situatën e re të posa krijuar në qytetin e Pejgamberit a.s nëpërmjet një shkrese ku thuhej : » Prej Amr ibn Asit për Muavi ibn Ebu Sufjanin : Dhe tani, bëjë çfarë dëshiron të bësh, por Ali ibn Ebu Talibin të xhveshi nga gjithçka që posedon ashtu siç xhveshet (qërohet) shkopi nga lëkuar e tij » (37)

- Në atë kohë Imam Aliu a.s duke mos dëshiruar ndarjen përkatësisht përçarjen në mes muslimanëve, i shkroi një letër Muavi ibn Ebu Sufjanit, duke e ftuar që të vijë në Medine. Muaviu nuk iu përgjigj ftesë e as që shkroi përgjigje Imam Aliut a.s (38). Tre muaj pas vresjes së halifit të tretë Osmanit dhe ushtrimit të detyrës për halife të Imam Aliut a.s, Muaviu e ngriti zërin e tij dhe thirri për një kryengritje kundër halifit dhe imamit të zgjedhur. Prë pretekst e morri kërkesën e tij për gjakmarrje ndaj vdekjes së halifit Osman. Protesta dhe kryengritja e tij filloi me ekspozimin e këmishës së përgjakur të halifit të vrasur Osman dhe ca qimeve të mjekrrës së tij, në zhaminë kryesore të Damaskut. Muaviu filloi t'i nxitë bashkëpunëtorët e tij dhe banorët e Damaskut që të ngriten në kryengritje për shkak të gjakmarrjes së halifes dhe hakmarrjes ndaj vrasësve të tij. Pos kësaj, Muaviu nëpërmjet një të autorizuarit të vet i dërgoi një letër Imam Aliut a.s. I autorizuari kur arrijti në Medine, ua tregoi jerëzve letrën e Muaviut në mbulojën e saj shkruante : » Nga Muaviu për Aliun. » Kjo filloi të

bëhet objekt i habitës së madhe tek njerëzit, ngase një shkrim i tillë lente përshtypjen e mos respektit dhe paprëgjegjshmërisë ndaj halifit të muslimanëve. Kur Imam Aliu a.s e morri letrën e Muaviut, brenda gjeti letrën e pastër, pa asnjë shkrim (bosh) ? Personi që e sollti letrën, kërkoi nga Imam Aliu a.s mbrojtje për sigurimin e jetës së tij, nëse ia thotë të vërtetën. Imam Aliu a.s ia dha besën e fortë se do ta ketë mbrojtjen dhe sigurinë e plotë, atëherë lajmëtari i tha : » Kam lënë pas vete njerëz të cilët thonin : » Ne nuk do të jemi të kënaqur gjersa nuk hakmerremi. « Imam Aliu a.s e pyeti : » Kujt t'i hakmerren ? » Personi që e sollti letrën iu përgjigj : » Njerëzit thonë : Imam Ali ibn Ebu Talibit » ; Në Damask kam lënë 60.000 pleq të cilët qajnë mbi këmishën e Osmanit, e cila qëndron e varur në minberin e Xhamisë, ndërsa në këmishë rrin varur gishti i Nailes, gruas së Osmanit ». Imam Aliu a.s krejt i habitur u përgjigj :  
« Mua do të më hakmirren për vrasjen e Osmanit. All-llahu e di se unë jam i pafajshëm rreth derdhjes së gjakut të Osmanit » (39)

## PRAPASKENA E KËRKESËS SË HAKMARRJES PËR OSMANIN

- Të mos shkojmë më tutje, përkatësisht të mos largohemi nga çështja e hakmarrjes, më mirë do të ishte të japim një përgjigje strikte që vetë pyetja ngërthen në vete, bonorët d.m.th njerëzit nga Damasku dhe Basra a dëshironin sinqerisht dhe në të vërtetë hakmarrje për Osmanin apo jo? Përgjigjen më të mirë e rreth kësaj pyetje na e pasqyrojnë rrethanat për atë se çka dhe si ndodhi ngjarja dhe se çfarë ishte qëndrimi i asaj pale rreth kryengritjes e cila çoi gjer te vrasja e halifit të tretë. Muaviu i dinte të gjitha detajet dhe rrethanat që çuan në vrasjen dhe kundërshtimin ndaj halifit të tretë hazreti Osmanit. Gjatë kohës së bllokadës në medinë, halifi Osman i kërkoi ndihmë Muaviut, por Muaviu as që iu përgjigj një kërkesë të tillë. Ai-Muaviu në ndërkohë e nisi një ushtri në drejtim të Medines nën komandimin e Jezid Ibn Asad El-Kasrijut, duke e porositur : » Kur të mbërrishë te vendi i quajtur –Dhul-Hushub- vend që gjendet jashtë Medinës, qëndro aty me ushtrinë tënde dhe mos e lësho atë vend. Dhe mos mendo se të pranishmit do ta shohin atë çka e shohin të pranishmit, ngase unë jam i pranishëm ndërsa ti je i papranishëm. » (40)

- Komandanti El-Kasriju qëndroi me ushtrinë e vet në vendin ku e caktoi Muaviu. Kur Osmani u vra, Muaviu i bëri thirrje ushtrisë së tij të kthehet në Damask. Ky është edhe njëri nga shumë qëndrimet që Muaviu kishte ndaj halifit Osman të birit të Affanit gjatë periudhës së pushtetit dhe tragjedisë së tij. Mirëpo, ç'është e vërteta, kërkesën e tij për hakmarrje ndaj vrasësve të Osmanit ishte një kurthë nëpërmjet së cilës dëshironte të fitojë simpati dhe të tubojë njerëz rreth vetes. Shkaku i një qëndrimi dha akti të tillë qëndronte në mospranimin e planit të reformave të Imam Aliut a.s, reforma këto që shkatërron interesat e shoqërisë elite, privilegje dhe përparësive që disa i gëzonin në llogari të shoqërisë islame. Me fjalë të tjera, e rrethononte autoritetin, forcën dhe pasurinë që Muaviu e gëzonte gjatë kohës së sundimit të Osman ibn Affanit, dhe në fund, e çrrënjoste që në start prerendimin vetjak të Muaviut për halif.

- Nga ana tjetër, Imam Aliu a.s e tregoi pafajësinë e vet në lidhje me vrasjen e halifit Osman, duke u shprehur : » o Zot ! Unë jam i pafajshëm për vrasjen e Osmanit, pasha All-llahun ! Vrasësit e Osmanit nuk do të shpëtojnë, por kur All-llahu xh.sh vendos për diçka, Ai vetëm thotë : » Bëhu ! dhe ajo menjëherë bëhet. » (41) Ndërsa kur Imam Aliu a.s e morri lajmin se edhe Benu Umejjët (familja e Ebu Sufjanit) e akuzon atë për mbytjen e Osmanit tha : » E ditura e Umejjëve për mua nuk i ka ndalur Umejjët

për të më akuzuar e madje edhe përparësia ime nuk i ka zbrapsur ata të padijshëm të më akuzojnë?! Vërejtjet e All-llahut u janë më të qarta se fjalimet e mia. Unë jam luftëtar me argumente kundër atyre që largohen nga feja dhe jam ndjekës i atyre që i paraprijnë dyshimit. Paqartësitë duhet vënë prapa Librit të All-llahut. Ndërsa njerëzit do të shpërblehen sipas asaj që kanë brenda në zemrat e tyre ». (42)

- Qëndrimi i Imam Aliut a.s qartë shihet edhe nga letra që ia dërgoi Muavi ibn Ebu Sufjanit, ku mes tjerash i shkruan »... Ti i zë në gojë (përmend) shumë shpesh dorasit e Osmanit. Më parë përqafo atë që e kanë përqaftuar njerëzit. Dhe pastaj thirr njerëzit para meje, ashtu që edhe ty edhe ata t'i ballafaqoj me Librin e All-llahut të Madhëruar. Por ajo që ti po përgatit është vetëm mashtruese që i jipet fëmijut në ditë e para të ndarjes nga sisa.

- Selam atyre që e meritojnë !... » (43)

## **QËNDRIMI I IMAM ALIUT A.S GJATË KOHËS SË KRYENGRITJES KUNDËR HALIFIT OSMAN**

- Kur halifi Osman ibn Affani ishte i rrethuar, Abdull-llah ibn Abbasi i solli një letër Ali ibn Ebu Talibit a.s prej halifit Osman, në të cilën letër halifi Osman shprehte dëshirën që Imam Aliu a.s të shkojë në çiflikun e tij Janba, në mënyrë që të heshte propozimi që ai të zgjidhet halif. Imami a.s lidhur me këtë Ibn Abbasit i tha : » O biri i Abbasit! Osmani dëshiron të veprojë me mua si me deven e cila nxjerr kovën e madhe me ujë, ashtu që të shkojë para dhe prapa. Njëherë më dërgoi fjalë se duhet të shkoj. Pastaj më dërgoi fjalë se do të duhej të kthehem. Tani sërish më dërgon fjalë që të shkoj. Për All-llahun, do të vazhdoj ta mbaroj gjersa nuk kam frikë se do të bëhem mëkatar » (44)

- Kur njerëzit u rebeluan kundër halifit Osman, Imam Aliu a.s tentonte të bindë halifen për domosdoshmërinë e reformave të cilat njerëzit i lypin dhe iu drejtua Osmanit me këto fjalë : » Njerëzit qëndrojnë pas meje dhe më kanë caktuar përfaqësues për ndërmjetësim mes teje dhe atyre. Mirëpo, për All-llahun, nuk di ç'të them. Nuk di asgjë që nuk e din edhe ti, as mund të të udhëzoj diç për çka nuk je i vetëdijshëm. Ke shikuar siç kemi shikuar edhe ne, dhe ke dëgjuar siç kemi dëgjuar edhe ne. Ke qenë shok i Pejgamberit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijtë! siç kemi qenë edhe ne. Biri i Ebu Kuhafës (Ebu Bekri, vërejt e përkth) dhe i Hattabit (Omeri, vërejt e përkth) nuk kanë qenë më shumë se ti të detyruar të veprojnë në harmoni me të vërtetën, meqë sipas lidhjes familjare je më afër Pejgamberit të All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij! nga ata të dy dhe nga ana e gruas ke arritur afri me të (Pejgamberin, vërejt e përkth) të cilën ata nuk e kanë pasur.

- Pra, nga All-llahu, nga All-llahu ti ki frikë për vete !... Dije se robi më i nderuar i All-llahut para All-llahut është prijësi i drejtë i cili është udhëzuar dhe udhëzon, i cili përmbahet Kur'anit të Madhnueshëm dhe çrrënjësë risitë e panjohura. Drejtimet vërtet janë të qarta dhe kanë udhërrëfyes, ndërsa risitë vërtet janë të qarta dhe kanë shenja... Të përbej në All-llahun që të mos bëhesh aso udhëheqësi i kësaj bashkësie të cilën do ta mbysin, pasi që është thënë : » Një prijës i kësaj bashkësie do të vritet pas kësaj vrasjet dhe luftat ata do t'i shkatërojnë gjer në Ditën e Gjykimit, kështu që do të ngatërrohen lidhjet e tyre dhe do të përhapen vuajtje në mesin e tyre. Prandaj ata do të dallojnë të vërtetën nga e pavërteta. Do të lëkunden si valët dhe do të humbin rrugën



tërësisht ». Për këtë arsye mos u shndërro kursesi në shtazë bartëse për Mervanin, ashtu që të tërheqë nga të dëshirojë edhe përkundër pleqërisë tënde dhe moshës tënde shkuar. »

- Atëherë Osmani i tha : » All-llahu qoftë i kënaqur me te! Thuaju njerëzve të më japin kohë gjersa t'i eliminojë keqtrajtimet nga ankesat e tyre. » Pas kësaj Imam Aliu a.s u përgjigj : » Sa i përket Medinës, problemi i kohës nuk ekziston. Sa i përket viseve të largëta, afati është gjersa urdhëri yt të arrijë atje : » Halifi Osman ia ktheu : » Mirë, por sa i përket Medinës, më jep afat prej tri ditësh. »

- Imam Aliu a.s doli përpara njerëzve dhe ua përcolli premtimet e halifes. Gjithashtu shkroi edhe një marrëveshje mes halifes dhe popullit, ndërsa për këtë dëshmuar disa prej muslimanëve eminentë nga rradhët e muhaxhirëve dhe ensarëve.

- Mirëpo, kur halifi nuk mundi t'i përmbush premtimet e veta, situata sërish u keqësua. Kur kryengritësit egjiptas morrën vesh për letërn të cilën halifi Osman ia kishte dërguar mëkëmbasit të tij në Egjipt, nëpërmjet së cilës e urdhëronte që t'i dënojë me vdekje kryengritësit, ndërsa kundërshtarët tjerë me burgim, revolta u ashpërsua edhe më tej. (47) Kryengritësit dhe të gjithë ata që kishin interesa për hilafet përsëri e rrethuan halifen në shtëpinë e tij dhe ia ndaluan madje edhe ushqimin edhe ujin. Halifi Osamn disa herë ka kërkuar ndihmë prej Imam Aliut a.s, i cili përkundër rrethimit dhe bllokadës e furnizoi Osmanin me ushqim. (48) Pas dyzet ditëve aq sa zgjati bllokada ndaj Osmanit, muslimanët kërkuar nga Imam Aliu a.s që t'i udhëheq në namaz si imam kryesor, gjë të cilën ai kategorikisht e refuzoi. Atëherë Talha, si imam, i udhëhoqi njerëzit gjatë namazit në Xhaminë kryesore, Xhaminë e Pejgamberit a.s

- Një qëndrim dhe sjellje e këtyllë e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s ndaj halifit Osman, qartë tregon qëndrimet e pastra dhe fisnike të tij, përkatësisht lojalitetin e tij ndaj Osmanit, po marrë parasysh se kjo a priori nuk do të thotë se Imam Aliu a.s ishte i kënaqur me politikën e halifit, udhëheqjen dhe qeverisjen e tij që ndiqte në botën islame (49) Sidoqoftë në asnjë mënyrë Imami a.s nuk kishte dorë në ekzekutimet me vdekje që zbatonte halifi. Dhe ajo çka është më tragjike Imam Aliu a.s tërhoqi vërejtejn se mbytyja e halifit do të ishte një rrezik i madh dhe sfidë që do të rezultonte me pasoja të rënda dhe ta paparashikura, të cilat pasoja do ta shkatërronin unitetin islam, gjë që edhe për fat të keq ndodhi pas vresjes së halifit Osman.

## LUFTE NË BASRA

- Talha dhe Zubejri ishin në krye të kryengritjes që u çuan kundër të halifit Osman dhe politikës së tij. në fakt, në krye të rrebelimit qëndroni persona të cilët ia dhanë bej' atin (besatimin) Imam Aliut a.s pas vresjes së halifit Osman, mirëpo ata prapëseprapë u ngritën edhe kundër Imam Aliut a.s ngase lëvizja dhe dhe programi që i ndiqte halifi i ri pra Imam Aliu a.s buk i kënaqte interesat e tyre personale. Ata u rreshtuan kundër Imam Aliut a.s pasi që ai duke mos pasur besim të plotë në to, e refuzoi kërkesën e Talhasë që Imami a.s ta emërojë për mëkëmbës dhe administrator në qytetin e Basrës; si dhe kërkesën që Zubejrin ta emërojë po në të njëjtat poste në Kufe dhe viset për rreth. Menjëherë pas kësaj, ata të dy u vunë në krye të rrebelimit kundër Imam Aliut a.s duke marrë me vete edhe një grup muslimanësh. Rezultati i këtij konflikti ishte dëmi dhe pasojat e mëdha që pësuan muslimanët e që vërtetë ishin tepër të mëdhaja, fatkeqësisht... Ata madje arrijtën ta bindin edhe hazreti Aishenë, të venë e Muhammedit

a.s përkatësisht vajzën e Ebu Bekrit, që ehde ajo me ta të shkoj në Basër dhe të filloj kundërshtimin ndaj Imam Aliut a.s.

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s dha një punë dhe mund të pakrahasueshëm që t'i ik këtij konflikti nëpërmjet të cilave ua tërhiqte vërejtjen për pasojat dhe rezultatet në rast se fillon lufta-mjerisht nuk ia doli të arrijë. Në përpjekjen e tij që ta evitojë më të keqen, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s iu drejtua me këto fjalë : » Dhe tani! O Talha, O Zubejr, ju të dytë e dini se vërtetë nuk iu kam drejtuar njerëzve gjersa, ata nuk më janë drejtuar mua dhe se nuk kam kërkuar të më betoheni gjersa ata nuk u betuan. Kurse ju të dytë ishit midis atyre që më kërkuat dhe që më dhatë besimin për besnikëri. Ju këtë nuk e bëni nga presioni. O Zubejr, ti je hero i Kurejshëve ndërsa ti Talha udhëheqës i muhaxhirëve. Nëse ju duket se është vështirë ta tërhiqni bej'atin (besatimin) dijeni se nuk është aspak. Më e lehtë është të hiqni dorë se sa kur mu betuat. Familja e Osmani ka prioritet më të madh në kërkimin e hakmarrjes ndaj vrasjes së halifit Osman. Ju jeni vetëm dy njerëz, përfaqësues të muhaxhirëve, dhe përveç kësaj ia dhatë të drejtën vetvetes që nënën tuaj dhe nënën e të gjithë besimtarëve (ummul-Muëmini), gruan e Pejgamberit-Muhammedit a.s ta nxirrni jashtë shtëpisë së vet, ndërsa ate All-llahu i Madhëruar e kishte urdhëruar që të mos lëshojë shtëpinë » (50)

- Në Basër, Imam Aliu a.s i këshillonte muslimanët përgjegjës t'i largohen përkatësisht ta evitojnë gjakderdhjen mes muslimanëve. Lidhur me këtë Imam Aliu a.s e mbajti hutben vijuese :

« Falënderimi i përket vetëm All-llahut, nga shikimi i Cilit një qyell nuk mund të fsheh tjetrin, as një tokë nuk mund ta fshehë tjetrën.

- Dikush më tha : » Ti, biri i Ebu Talibit e dëshiron këtë ». Pas kësaj unë u përgjigja : » Në realitet, pasha All-llahun ju jeni më lakmitarë, ndonëse jeni më të largët, kurse unë jam edhe më i denjë deh më i afërt. E kërkojë këtë si të drejtën time, gjersa ju ndërhyni mes mua dhe asaj, si dhe më privoni nga ajo. « Kur trokita me argument në veshin e tij, në mesin e atyre që ishin të pranishëm, ai kërceu sikur të ishte i dehur dhe nuk dinte çfarë përgjigje do t' më ipte për këtë...

- ... Ata dy dolën (Talha dhe Zubejri) duke tërhequr gruan e Pejgamberit të All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!—mu ashtu siç e tërheqin rrebëreshën për ta shitur, duke e nisur drejt Basrës. Ata dytë i kishin mbyllur gratë e tyre, ndërsa gruan e Pejgamberit të All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij !-ia ekspozuan vetes dhe të tjerëve në ushtri, në të cilën ushtri nuk kishte asnjë njeri i cili nuk ma kishte shprehur besimin e tij dhe nuk më ishte betuar në besnikëri, vullnetarisht dhe pa kurrfarë detyrimi. » (51)

- Pëkundër tentimeve dhe përpjekjeve të mëdha të Imam Aliut a.s që ta shmang konfortimin pra luftën, pala tjetër filloi të terrorizonte banorët e Basrës, duke krijuar turbullira dhe incidente serioze. Lufta në Basër filloi, ndërsa Imam Aliu a.s reagoi me këto fjalë : » Arritëm të mëkëmbësi im në Basra dhe rrojet e thesarëve (pasurisë) të muslimanëve dhe banorët tjerë të saj, duke i asgjësuar ashtu që disa i futën në burgje, në të cilët vdiqën, gjersa të tjerët i mbytën në pabesi. Pasha All-llahun! Nëse e kanë mbytur qëllimisht qoftë edhe një njeri të vetëm nga muslimanët pa kurrfarë faji, për mua do të ishte legale asgjësimi i tërë kësaj ushtrie, meqë kam qenë pjesmarrës në këtë, (vrasje, vërejt e përkth) mirëpo nuk kanë shprehur pakënaqësi për këtë, as e kanë ndaluar këtë me gjuhë ose me dorë, e të mos flasë për ata që njëmend kanë mbytur nga muslimanët aq njerëz sa kanë qenë kur u vërsulën mbi ta » (52). Imam Aliu a.s gjithashtu u dërgoi një dorëzan të tij, me qëllim që të pajtohen (të ndaletluftimi, vërejt e përkth) por qëllimi i tij nuk pati sukses...

- Pasiqë filloi lufta në rrethinën e Basrës, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e kërkonte Zubejrin në rradhët e ushtrisë, me qëllim që t'i a përkujojë disa nga ndodhitë që kishin ngjarë gjatë kohës së Pejgamberit Fisnik s.a.v.s Kur u takuan, Imam Aliu a.s e pyeti Zubejrin: » Ç'të shtyri ta bësh këtë që e bërë ? »

- « Hakmarrja për mbytejen e Osmanit, » Po të jesh i drejtë (sinqertë) ndaj vetvetes, do të pranojë se ti dhe shokët e tu e keni vrarë halifin Osman. Të përbej në All-llahun o Zubejr kujtohu kur Pejgamberi s.a.v.s të pyeti: « O Zubejr, a e don Aliun ? », ndërsa ti u përgjigje: » E pse mos ta dua » ? Ai është djali i xhaxhait tim » ; dhe atëherë Pejgamberi s.a.v.s të tha: » Së shpejti do t'i bëhesh armik dhe ai që do ta mundosh. »; O Zot kjo është e vërtetë, kështu ka qenë - u përgjigj Zubejri. Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s sërish i tha: » Të përbej në All-llahun e Madhëruar ! A të kujtohet dita kur Pejgamberi Selamet e All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij !- erdhi nga Aufi. Ishte në shoqëri me Pejgamberin-Selami i All-llahut qoft gjithnjë mbi te dhe mbi familjen e tij !- dhe ai të kapi për dore. Unë ju të dyve u prita, Pejgamberin e përshëndeta, ndërsa ai më buzëqeshi pastaj i buzëqesha edhe unë. Atëbotë ti Zubejr the: » Aliu, nuk mundet që të mos jetë mendjemadh ! » Resulull-llahu s.a.v.s atëherë t'u drejtua me fjalët: » Ngadalë Zubejr, Aliu nuk është mendjemadh. Një ditë me siguri do ta braktisësh dhe atëherë do ta shtypësh » O Zot ! » tha Zubejri dhe shtoi: « Unë e kam haruar këtë, por pasiqë ma kujtove, gjithë këtë unë do ta lëshoj (do të largohem nga kjo që jam duke bërë, vërejt e përkth) (53) Në atë çast Zubejri vendosi që ti tërheq njerëzit e tij, por djali i tij Abdull-llahu i tha se nëse e bën një gjest të tillë, atëherë ai është qyqar. Pasiqë Zubejri u tërhoq nga beteja, shokët e tij e vazhduan luftën gjersa nuk vdiqën 1700 luftëtarë prej palës të ushtrisë së Imam Aliut a.s dhe 16.790 luftëtarë të palës tjetër.

## **QËNDRIMET HUMANE TË ALI IBN EBU TALIBIT A.S**

- Imam Aliu a.s qëndroi pranë durimit (sabit) të tij, tolerancës dhe moralit të lartë human. Në fillim të betejës, pasiqë e investoi gjer në maksimum përpjekjen dhe punën e tij për ta ndaluar gjakderdhjen në mes të muslimanëve, iu drejtua shokëve të vet duke u thënë që të shërbehen me moralin dhe karakterin e tyre më të mirë, të cilat All-llahu xh.sh i ka përcaktuar në vështirësitë përkatësisht telashe e luftës e luftës duke u thënë: » ... O njerëz! Ju përbej në All-llahun, mos i vrisni ato të cilët zbrapsen (ikin), mos i goditni personat e pafuqishëm, mos i ekzekutoni të plagosurit e as robërit, mos ua grabitni armët dhe as pasurinë që e posedojnë... » (54) Kështu, në këtë mënyrë Imam Aliu a.s e tregoi Sheriatin e All-llahut ndaj besimtarëve. Më pas iu drejtua All-llahut të Madhëruar që ta mbrojë nga fitneja e disa muakisunëve (të bërë pishman). Në fund iu drejtua Zotit të Madhëruar duke iu lutur: » O All-llah ! Talha dhe Zubejri ma kanë dhënë bej'atin me vetëdëshirë, dhe më pas i ngritën njerëzit kundër meje. O All-llah ! Vërtetë për to je i mjaftueshëm, vepro me to kur dhe si të duash. » (55)

- Aq sa betejës i afrohej fundi, fitorja bindshëm i takoi Imamit a.s dhe ushtrisë së tij, ndërsa Imam Aliu a.s shpalli falje-amnesti për të gjithë muslimanët dhe i liroi të gjithë robërit e luftës.

- Disa nga ushtarët e tij, e pyetën Imam Aliun a.s » Si na lejon të luftojmë kundër tyre, ndërsa nuk na i lejon (për robëresha, vërejt e përkth) gratë e tyre? Imam Aliu a.s u përgjigj: » Kështu janë rregullat, përkatësisht këto rregulla vlejné kur lufta është kundër muslimanëve. » Mirëpo, disa prej ushtaërve të tij dëshironin të merrnin më shumë plaçkë lufte se sa që u lejoi Imam Aliu a.s. Kurse sipas urdhërit të tij, ata nuk kishin të

drejtë të merrnin asgjë tjetër më tepër, pos kuajve dhe ca armëve. Atëherë një njeri iu drejtua Imam Aliut a.s duke i thënë: » Pasha Zotin, nuk e ke ndarë plaçkën e luftës, e as që ke qenë i drejtë ndaj nesh. » Imam Aliu a.s e pyeti njeriun: » Sipas teje ç' duhej të bëja ? » Njeriu u pëgjigj: « diçka në të vërtetë ndave, por i le pasuritë, gratë dhe fëmijët e tyre. »

- Imam Aliu a.s atëherë filloi t'ia shpjegojë filozofinë e asaj pyetje, dhe qëndrimin e tij human, duke iu drejtuar sërish njeriut më këto fjalë: « O vëlla i fisit Bekër, ti je njeri shkurtëpamës. A e din ti se nuk i fajësojmë fëmijët për shkak të gabimeve të prindërve të tyre, e as të dobëtit për shkak të më të fortëve ?! Para luftës pasuritë e tyre u takonin atyre, ata u martuan sipas rregullave të Sheriatit, fëmijët janë nisur (formësuar në barqet e nënave të veta, vërejt e përkth) në islam dhe si rrjedhojë ata janë muslimanë. Juve u takon ajo që gjendet në sipërfaqe ku zhvillohet beteja, ndërsa ajo që ata e posedojnë në shtëpitë e tyre, ajo u përket pasardhësve të tyre. Atë i cili neve na sulmoi në mënyrë jo legjitime, ne do ta ndëshkojmë për gabimet e tij, mirëpo, nëse ai e ndërpret sulmin atëherë ne nuk do ta ndëshkojmë për mes jush, ashtu siç ka ghykuar Resulull-llahu-Selami i All-llahut qoftë gjithnjë mbi te dhe familjen e tij !- në ditën e çlirimit të Mekes, ndërsa ai atëbotë ndau vetëm atë që ndodhej mbi sipërfaqe, ndërsa në këtë rast, unë nuk kam vepruar ndryshe, pos që vetëm atë (Pejgamberin s.a.v.s) e kam ndjekur.

- Këto ishin vetëm disa prej qëndrimeve të jashtëzakonshme të përmendura më sipër të cilat Imam Aliu a.s i zbatoi ndaj armiqëve të tij gjithnjë duke ndjekur urdhërat e All-llahut në përputhshmëri me Sheriatin Fisnik. Qëndrimi i tij ishte larg ndjesive për të qenë hakmarrës dhe urrejtës. Me këto qëndrime Imam Aliu a.s e zbatonte më përpikshmëri drejtësinë Absolute të All-llahut xh.sh. Askush nuk mundte ta zbatojë aq bukur dhe aq përpiktë drejtësinë e të Madhit Zot, pas ndërrimit jetë të Muhammedit s.a.v.s, se sa që e vinte në praktikë dhe jetësonte Imam Aliu a.s. Përveç Imam Aliut a.s nuk kishte tjetër që mund ta bënte këtë. Imam Aliu a.s aktet e tij i vazhdoi edhe më tej, sidomos ndaj »muakisunëve « duke ju treguar aktin më të shenjtë dhe moralin më të lartë kur me plotë dinjitet, ashtu siç i ka hije dhe e meriton, nënën e të gjithë besimatërve-hazreti Aishenë e ktheu në qytetin e Medinesë, duke ia dhënë asaj-nënës së besimatërve-për përcjellës gjatë rrugës vëllain e saj Muhammed ibn Ebu Bekrin, heroin dhe udhëheqësin e pashoqë të ushtrisë së vete.

- Kështu lufta në Basra përfundoi në dobi të Imam Aliut a.s i cili dëshironte ta rruajë hilafetin dhe sërish ta tubojë ummetin (popullin), duke ia ngritur atij famën e shenjtë të integritetit.

## LUFTA E SIFFINIT

- Pas fitores në Basra, Imam Aliu a.s u kthye në qytetin e Kufes, me qëllim që ta forcojë ushtrinë e tij dhe vazhdoi rrugëtimin drejt Damaskut (Sirisë), kësaj here për ta ndalë rrebelimin që kishte nxjerrë kokë me në krye Muavije ibn Ebu Sufjanin. Ai-Imam Aliu a.s bashkë me ushtrinë e tij u nis në drejtim të Sirisë. Së shpejti lajmi i nisjes së tij, mbërrijti tek Muaviu, kështuqë ky i fundit e dërgoi ushtrinë e vet në Siffin, që atje ta presë ushtrinë muslimane dhe t'i kundërvihet. Imam Aliu a.s akome vazhdonte t'i vë në përdorim të gjitha metodat e tjera, vetëm e vetëm që nëpërmjet këshillave dhe mirëkuptimit ta evitojë luftën.

- Imam Aliu a.s dërgoi një delegacion prej tre anëtarësh, me qëllim që Muavijen ta ftojë për në « takva » (devotshmëri) dhe në ruajtjen e unitetit të ummetit islam, si

dhe në pranimin e hilafetit të atij që vetë muslimanët e kanë zgjedhur. Duke e dërguar delegacionin e tij, Imam Aliu a.s iu drejtua me fjalët: » Shkoni tek ki njeri-Muaviu dhe thirrnie në detyrimin dhe dëgjueshmërinë që duhet ta ketë ndaj All-llahut xh.sh.

Ndoshta All-llahu xh.sh do ta udhëzojë, dhe ummeti ynë do të bashkohet! » (57).

Delegacioni u takua me Muavijen, ia transmetoi qëllimin dhe dëshirat e Imam Aliut a.s dhe e përbetuan në emër të All-llahut duke ia tërhequr vërejtjen në aktin e tij që është duke bërë, mirëpo Muaviu insistonte në qëndrimin e vet, dhe më pas u tha: » Dilni jashtë! Unë nuk kam përgjigje tjetër, përveç shpatës. » (58).

- Pa marrë parasysh qëndrimin e Muvijes, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s përsëri tentonte të mbetet i përmbajtur dhe tolerant. Nuk ngutej me fillimin e luftimeve, dëshironte si e si ta shmang gjakderdhjen dhe tu ik vrasjeve të në të dyja palët.

- Qëndrimi i tij human dhe durimi (sabri) i tij tejet i fortë, i shtuan aspratet e tabarrit kundërshat, kështuqë forcat e tyre tentuan ta bllokojnë rrugën e cila çon tek lumi Eufrat, me qëllim që ushtria muslimane të mos mund t'i afrohet ujit përkatësisht lumit. Imami a.s me këtë rast, Muavijes ia dërgoi një dorëzan i cili ia dërgoi një shkresë me këto fjalë: » Nuk kemi ardhur këtu për shkak të ujit, ndërsa edhe po të mbërrimim të paërt në atë vend, përpara jush, prapëseprapë ujin nuk do t'ua ndalnim. » Muavije ibn Ebu Suffjani u përgjigj: » Jo, pasha All-llahun! Asnjë pikë uji nuk do të merrni. Vdisni nga etja! » (59) Imam Aliu a.s pas këtyre fjalëve e kuptoi se në çfarëdoqoftë mënyre duhet të arrijë tek uji. Kur një çetë e Imam Aliut a.s u nis në drejtim të ushtrisë së Muavijes, kjo e fundit (ushtria e Muavijes, vërejt e përkth) iku menjëherë nga vendi. Ndërsa kur bregu i lumit ra në duart e ushtrisë së halifit, Imam Aliu a.s armikut ia lejoi shfrytëzimin e ujit. Me një akt të tillë Imam Aliu a.s tregoi një zemërgjërësi të pashoq, të cilin akt vet islami ia rekomandonte. Imam Aliu a.s është më i lartësuar se sa luftëtarë i ndershëm, ai gjithashtu është më i zgjedhur se sa udhëheqës me një zemërgjërësi të pashoq...

- Ashtu siç ishte i përmbajtur dhe i vëmendshëm në evitim e gjakderdhjes dhe ruajtjen e unitetit të muslimanëve, kërkoi nga Muaviu që të luftojnë vetëm ata të dy, pra i kërkoi dyluftim, pa konfrontimin e ushtrive dhe me kusht që hilafeti do t'i përkas atij që do të fitojë dyluftimin; Imami a.s iu drejtua me fjalët: » O Muavije, pse njerëzit të vriten mes vete ? Eja dhe lufto! Mbroji jetërat e njerëzve, ndërsa fitimtari nga ne të dytë, le ta merr pushtetin » (60)

- Kuptohet që Muaviju e refuzoi këtë propozim të Imamit a.s ngase kishte frikë të madhe nga humbja, për shkak se ai e njihte fort mirë Imam Aliun a.s dhe xhihadin e tij përkushtues në islam. Ai e dinte gjithashtu se Aliu a.s kurrë nuk e kishte humbur asnjë dyluftim. Taktika e Imam Aliut a.s ishte ajo që të mos e humbte kontrollën ndaj vetvetes, kështuqë edhe jepte propozime që lufta të mbetet individuale edhe ndërmjet ushtarëve, njëri kundër njërit (61)

- Para fillimit të luftimeve, Imam Aliu a.s u mbante fjalim udhëheqësve dhe ushtarëve, ku u thoshte: » Mos luftoni gjersa ata të mos fillojnë! Ngase- All-llahut i qofshim falë!- Ju vërtetë keni të drejtë. Ndërsa fakti që i lejoni atyre të fillojnë luftën do të jetë argument plotësues kundër tyre.

- Kur armiku, me vullnetin e Zotit, të mposhtet, mos vritni ata të cilët zbrapsen (ikin), mos i goditni personat e pafuqishëm, mos ekzekutoni të plagosurit dhe mos i bezdisni femrat nëse ato atakojnë nderin tuaj dhe fyejnë prijësat tuaj, ngase ata janë të dobëta për nga fuqia, karakteri dhe mendja... (62)

- Pos përpjekjeve të shumta dhe këmbëngulëse të Imam Aliut a.s dhe komandantëve të tij që të mbizotrojnë paqja, Muaviju nuk pranoi asgjë, kështuqë filloi

lufta e cila zgjati afro 15 ditë, dhe në të cilën luftë u mbytën një numër tejet i madh i muslimanëve nga të dyja palët, që njëherit do të thoshte edhe fillimi i tragjedisë për islamin në përgjithësi. Kur filloi lufta, dhe kur rrjedha e saj filloi të anojë në fitoren e taborrit të Imam Aliut a.s dhe humbja e ushtrisë së Muaviut ishte çështje kohe, atëherë, duke e nuhatur këtë Muaviu, sipas këshillës së Amër ibn Asit u tha ushtarëve të tij: » Ngritni nga një kopje të Kur'anit në kokat e shigjetave dhe shpatave (Si mashtrim) që ta detyrojmë Imam Aliun dhe muslimanët e tjerë që të gjykojnë sipas Librit të All-llahut » (Kur'anit, vërejt e përkth)

- Një akt i tillë, vërtetë ndërroi rrjedhën e betejës. Filloi diskutimi mes ushtarëve të ushtrisë së Imam Aliut a.s. Gjë që në ato çaste u kushtoi shumë shtrenjtë. Mijëra ushtarë vendosën ta lëshojnë fushbetejën duke mos dashur të atakojnë, përkatësisht sulmojnë Librin e All-llahut. Imam Aliu a.s menjëherë kuptoi se fjala është për mashtrim dhe tentonte që ushtarëve të tij t'ua shpjegojë qëllimet e Muaviut duke u shpjeguar se fitorja është afër fare në prag, por më kot... Njerëzit të cilët ishin të dhënë pas asaj që gjykohet me Kur'an, nuk dëshironin më që t'i dëgjojnë këshillate tij. Pas gjithë këtyre përpjekjeve dhe tentimeve Imam Aliu a.s të pranishmëve u tha: » Ne vërtetë nuk i kemi caktuar njerëzit për gjykatës, por e kemi marrë Kur'anin për gjykatës. Kur'ani është libër i shkruar mes dy kopertinave dhe i cili nuk flet me gjuhë. Prandaj ai patjetër duhet të ketë komentues. Vetëm njerëzit mund të jenë komentues të tillë. Pasi njerëzit na ftuan ta caktojmë Kur'anin si gjykatës mes nesh, ne nuk kemi mundur të jemi grup që ia kthen shpinën Librit të All-llahut Famëmadh thotë: »... Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje atëherë parashtronjeni atë të All-llahu ( te Libri i Tij dhe te Pejgamberi... » ( En-Nisa, 59)

- T'i drejtohesh All-llahut do të thotë të vendosësh në bazë të Librit të Tij; (Kur'anit, vërejt e përkth) gjersa t'i drejtohesh Pejgamberit do të thotë të ndjekësh rrugën e tij. (Pejgamberit s.a.v.s vërejt e përkth) Dhe për këtë arsye, nëse gjykimi në mosmarrëveshje vërtet zgjidhet në bazë të Librit të All-llahut, prej të gjithë njerëzve ne do të ishim më të drejtë; dhe nëse do të vendosej në bazë të rrugës së Pejgamberit të All-llahut (Sunnetit)-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi familjen e tij!- ne do të ishim më të afërt dhe më të drejtë për këtë...

- ... Prandaj, ku jeni humbur dhe nga jeni sjellur ?

- Bëhuni gati të shkoni në drejtim të njerëzve të cilët janë larguar nga e Vërteta dhe nuk shikojnë, të cilët janë ngatrruar në keqëbërje dhe nuk përmirësohen. Ata janë larg nga Libri dhe kanë lëshuar Rrugën. Ju nuk meritoni të mbështetem në ju, as jeni mbajtës të fjalës së nderit për t'u ndjakur pas. Ju jeni shumë të dobët në ndezjen e zjarrit të luftës. Të mjerët tu! Më duhet të duroj shumë hidhërime nga ju atëherë kur u ftoj dhe atëherë kur u flas në besim. As nuk jeni njerëz të lirë në kohën e thirrjes, as nuk jeni vëllezër besnikë në kohën e bisedimit në besim. » (63) Pas kësaj Imam Aliu a.s u detyrua që Ashas ibn Kajsin ta dërgojë tek Muaviju që ta pyesë se çfarë nënkupton me gjykimin dhe si mendon atë ta zbatojë ?! Dorëzani u kthye tek Imam Aliu a.s me lajmin se Muaviju dëshiron të gjykojë sipas Kur'anit...

- Pjesa e dytë e tragjedisë doli në skenë, kur rrëmuja që u shkaktua në taborin e ushtrisë së halifit-Imamit a.s, kundër dëshirës së Imam Aliut a.s e zgjodhi Ebu Musa El-Esh'ariun si përfaqësues të halifit. Imam Aliu a.s nuk ia ofroi besimin, ngase ky i fundit ( Ebu Musa El-Esh'ariu, vërejt e përkth) kishte shfaqur kundërshtimin e tij për zgjedhjen e Imam Aliut a.s për halif, pas vrasjes së halifit Osman, ndaj edhe nuk mund të pritej nga ky person lojaliteti i plotë ndaj halifit të ri d.m.th Imam Aliut a.s. Përveç kësaj, argument i mosbesimit ndaj tij i Imamit a.s ishte edhe ajo që Ebu Musa El-

Esh'ariu, për shkak të mosbesimit vetjak, e kishte shkarkuar menjëherë mëkëmbësin e Kufes. (64)

- Përveç gjithë këtyre që i përmendëm më sipër, Imam Aliu a.s Ebu Musanë e konsideronte si bashkëbisedues të pazotë në krahasim me bashkëbiseduesin e palës tjetër Amr ibn Asit, të cilin Muaviju e kishte caktuar për përfaqësues të vetin.

- Imam Aliu a.s ishte i mendimit tjetër, ai dëshironte që për përfaqësues të vetin ta zgjedh Abdull-llah ibn Abbasin, mirëpo grupi i madh që shkaktoi rrëmujën brendapërbrenda toborrit të ushtrisë së halifit, këmbëngulte kategorikisht për zgjedhjen e Ebu Musa El-Esh'ariut, pa marrë aspak në konsiderim vërejtjet e Imam Aliut a.s për dobësitë e Ebu Musasë dhe subjektivitetin e tij ndaj vetë Imam Aliut a.s. Ndaj, nisur nga kjo, Imam Aliu a.s iu drejtua ushtarëve të vet, duke ua tërhequr vërejtjen: » Nuk më keni dëgjuar (kur kam folur, kur kam përmendur mbi gjykimin dhe mbi ndërprerjen e luftës), ndaj tani mos e refuzoni propozimin tim. Unë e di se Ebu Musa El-Esh'ariu është i dobët karshi Amr ibn Asit dhe dinakërisë së tij. » (65)

- Mirëpo më kot, taborri rebelues insistonte që Ebu Musa El-Esh'ariu të jetë përfaqësues i tyre.

- Ngjarjet e mëvonshme do të tregojnë se e gjithë kjo nuk ishte e rastit, përkundrazi Sigurisht ekzistonte ndonjë marrëveshje rreth trikit që përdori ushtria e Muaviut kur e vëndoi Kur'anin mbi shigjeta dhe shpata dhe lëvizjes rebeluese në vetë rradhët e taborrit të Imam Aliut a.s, marrëveshje kjo ndoshta tepër e fshehtë...

- Pas afro 15 ditë luftimesh lufta mbaroi. Rezultati përfundimtar ishte mbyjtja e 36.000 ushtarëve, nga të dyja palët.

- Më e tmershme ishte në natën e ashtuquajtur « harira », kur Muaviu humbi 523 luftëtar nga më të famshmit, ndërsa luftimet u ndërpre në atëherë kur ranë në ujdi të gjykojnë sipas Librit të All-llahut. Kjo ngjau të mërkurën e 13 Safirit, të vitit 37 sipas hixhretit. Dy gjyqtarët-përfaqësuesit pas dy muajve u takuan në vendin e quajtur Demmat El-Xhandal. Imam Aliu a.s me ushtrinë e tij u bë gati të nisej për në Kufe, por rebelët nga rradhët e tij nuk dëshironin t'i bashkangjiten Imamit a.s gjersa nuk mbahet gjykimi. (66). Një grup i vogël i muslimanëve të cilët nuk dëshironin të presin gjykimin, u larguan nga rradhët e ushtrisë së Imam Aliut a.s ndaj edhe u quajtën « harixhi ». udhëheqësi i tyre ishte Shabes ibn Rubi'j El-Tamiu, ndërsa kërkesa e tyre ishte zgjedhja e një halifi të dytë, një halifi kryesisht tjetër... Imam Aliu a.s atyre »harixhinjëve » ua dërgoi Ibn Abbasin që t'i bind për t'u kthyer në rradhët e ushtrisë së halifit, por pa sukses. Në ditën e caktuar për gjykim, Imam Aliu a.s e dërgoi Ebu Musa El-Esh'ariun, Ibn Abbasin dhe Shurejh Ibn Hanin, bashkë me katërqind ushtarë, dhe njëkohësisht, në ndërkohë edhe Muaviu nga Damasku e dërgoi nga ana e tij, Amr ibn Asin, Abdullah ibn Omerin, Ibn Hattabin, Abdurrahman ibn El-Harithin, Mugire ibn Sheuben bashkë gjithashtu me katërqind ushtarë. Kur u takuan në vendin e caktuar, Amr ibn Asi me shkathtësinë (dinakërinë) e tij, filloi t'i japë komplimente dhe me mirësjellje të lartë, iu drejtua Ebu Musa El-Esh'ariut me fjalët: » Unë asnjëherë nuk mund të jem para teje, as para fjalëve të tua as para hapave të tua. Ti je njeri më përvojë, posedon plot dituri, dhe përkundër gjithë këtyre, ti je madje njëri prej as-habëve të Pejgamberit s.a.v.s. »

- Ebu Musa u besoi fjalëve të këtilla duke u nisur nga hijeshia dhe thënia (shprehja) e tyre në mënyrë bindëse, ndaj edhe e kishte shpirtin dhe zemrën e qetë ndaj Amrit, duke mos dijtur asgjë për qëllimet dhe dinakërinë e tij. Ebu Musa El-Esh'ariu e pranoi një argument të dobët të sjellë nga Amr ibn Asi, ndërsa lidhur më këtë Ibn Abbasi ia tërhoqi vërejtjen Ebu Musasë në jovaliditetin e atyre argumenteve, mirëpo ai vazhdoi bashkëbisedimin. Pas një kohe të shkurtër Amr ibn Asi arrijti ta bind Ebu Musa

El-Esh'ariun që secili prej tyre të heq dorë nga ai që e përfasëon, si dhe që gjithashtu edhe Muaviju do të largohet nga posti i tij, me qëllim që zgjedhja e re për halif të bëhet sërish me një shura (votim) që do të përsëritet. Para fillimit të marrëveshjes publike dhe gjykimit të ri, Amr ibn Asi ia doli mbanë që ta bind Ebu Musanë që i pari të shfaq vendimin e tij. Ibn Abbasi duke ia tërhequr vërejtjen sërish Ebu Musasë iu drejtua përfaqësuesi të delegacionit që edhe ai ta shpreh të vetin, kam frikë se ka përgaditur ndonjë kurthë dhe nuk jam i sigurtë se të ka dhënë përgjigje të sinqertë, (fjalën e kishte për Amr ibn Asin, vërejt e përkth) ngase kur ti i pari e flasish tënden, ai atëherë mund të flas të kundërtën » Ebu Musa i vetëbindur u përgjigj:» Ne bëmë marrëveshje, jemi të kënaqur me marrëveshjen dhe këtu nuk ka asnjëfarë gënjeshtre (dredhie) Ebu Musa ishte njeri i nderdshëm por ama edhe naiv.

- Fjalimin e tij e filloi me lavdërimin ndaj All-llahut xh.sh dhe më pas shtoi:» O njerëz! Ne e kemi parë të arsyeshme se ummetit tonë i duhet një marrëveshje e paqes dhe e unitetit. Amr Ibn Asi dhë unë bëmë marrëveshje që t'i largojmë të dy njerëzit ( Imam Aliun a.s dhe Muavijen) me dëshirën më të mirë që ummeti musliman sërish të zgjedh një person tjetër më të mirë dhe aftë. Unë largohem nga Aliu dhe Muaviu, ndaj ju zgjidhnie atë që është më meritori. »

- Më pas Amr ibn Asi e gjithashtu morri fjalën, shprehi lavdërimin ndaj All-llahut xh.sh dhe më pas shtoi:» O njerëz! Ashtu siç dëgjuat, Ebu Musa u tërhoq nga halifi i tij Aliu. Gjithashtu edhe unë jam larguar (nuk e pranoj, vërejt e përkth) halifin e tij, por qëndroj dhe e përmbaj halifin tim Muavijen, ngase ai është përgjegjës për hakmarrjen ndaj vrasësve të Osmanit dhe më meritor për pozitën e tij. »

- Kur Ebu Musa e pa dredhinë e Amrit, i tha:» Më premtove dhe e shkele fjalën tënde! », dhe atëherë Ibn Abbasi iu drejtua Ebu Musasë :» Nuk ke ti faj, por faji është i atyre që të kanë zgjedhur në një pozitë të tillë »

- Pas një diskutimi të shkurtër dhe akuzave, Ebu Musa e morri deven e tij dhe u nis në drejtim të Medines, duke shqiptuar fjalët :» Ibn Abbasi ma tërhoqi vërejtjen për dredhitë e Amrit, mirëpo mua fjalët e tij-Amrit më dukeshin të sigurta, ndaj edhe mendova se ky intrigant (dhelpërak) ia dëshiron të mirën dhe dobinë muslimanëve.

- Delegacioni i Muavijut në krye me dinakërinë e Amr ibn Asit, mbërritën në Damask, ndërsa delegacioni i halifit mbërritë në Kufe dhe e lajmëroi Imam Aliun a.s për rezultatin dhe atë se çfarë kishte nngjarë. Imam Aliu a.s rreth dy gjykatësve tha si vijon :

« Pala juaj morri vendimin që të caktojë dy gjyqtarë, andaj ne i obliguam që të veprojnë në harmoni me Kur'anin dhe të mos i largohen atij, dhe gjuhët e tyre të jenë me te, dhe që zemrat e tyre ta ndjekin atë. Mirëpo, ata u larguan nga ai, e braktisën të vërtetën edhe pse e kishin parë. Të vepruarit e padrejtë ishte dëshira e tyre, ndërsa të lëshuarit e Rrugës ishte sjellja e tyre e vërtetë, ndonëse jemi marrë vesht me ta që të veprpjnë në bazë të drejtësive, të punojnë në pajtim me të vërtetën dhe të mos ngatërrojnë të menduarit e gabuarit dhe gjykimin e padrejtë të tyre. Tani kur ata e lëshuan rrugën e të së Vërtetës dhe u paraqitën me atë që është tërësisht në kundërshtim me atë që jemi marrur vesht, kemi argumente të forta për vete. » (68)

- Imam Aliu a.s edhe në raste të tjera pas kësaj ngjarjeje (gjykimit, vërejt e përkth) shprehej me këto fjalë:

« Tërë falënderimi i përket vetëm All-llahut, edhe nëse koha sjell ndonjë mjerim shfarosës dhe ngjrye të madhe! Dëshmoj se nuk ka Zot pos All-llahut Një, se nuk ka bashkëpunor për te, as ekziston me Te ndonjë zot tjetër pos Tij, dhe se Muhammedi është rob i Tij dhe Pejamberi i Tij!



- Dhe pastaj! Mosbindja ndaj këshilltarit të mëshirshëm, i cili posedon dituri dhe përvojë, njëmend sjell dëshprim dhe si pasojë ka ndëshkimin. Ju kam dhënë urdhëra lidhur me këtë gjykim dhe kam prezentuar para juve pikëpamjet e mia intime- ah sikur të ishin përmbushur urdhërat e Kasirit !?- mirëpo i keni refuzuar si armiq të vrazhdë dhe rebelues të padëgjueshëm, gjersa vetë këshilltari nuk ka rënë në dyshim për këtë botë, andaj urari pushoi së prodhuari xixa. Pozita ime dhe juaja është bërë sikur në vargjet e Havazinit :

Ju dhashë urdhër në mes të Mun'arixhu-l-Livit,  
Mirëpo nuk më kuptuat gjer në drekën e nesërme ! » (69)

## LUFTA E NEHREVANIT

- Pas ndodhisë së gjykimit, Imam Aliun a.s e befasoi dalja e një grupi të ushtarëve të pakënaqur prej taborrit të tij. rreth 4000 ushtarë dhe luftëtarë shpallën kryengritje ndaj Aliut a.s në shenjë revolte ndaj gjykimit. Vajtën në vendin e quajtur Harura dhe i zunë pozitat e tyre. Plotësisht ishte e qartë se në grupin kryengritës bënin pjesë pikërisht ata njerëz të cilët Imam Aliu a.s e detyruan në ndërprerjen e luftimeve dhe gjykimin në Sifin. (70)

- Tani, kjo grupë e kundërshtonte Imam Aliun a.s duke e detyruar ta pranojë gjykimin, duke bërë titur me fjalët:» Gjykimi i takon vetëm All-llahut. Nuk duam që njerëzit të na sundojnë në fenë e All-llahut. All-llahu e kë dërguar Muavijun dhe pasardhësit e tij drejt vdekjes, gjersa nuk e pranojnë gjykimin tonë kundër tyre. Ç'është e vërteta, faji ynë qëndron në atë se i kemi pranuar të dy gjykatësit, mirëpo tani i jemi penduar All-llahut, jeni kthyer, ndaj kthehu edhe ti Ali, sikur që jemi kthyer ne, ose në të kundërtën do të likuidojmë » (71). Atëherë Imam Aliu a.s iu përgjigj njërit prej Harixhinjëve, që quhej Burxh ibn Mushir El-Tai e që tha:» Gjykimi i takon vetëm All-llahut » ; më këto fjalë:» Hesht, All-llahu të gjymtoftë, o dhëmbëprishur! Ngase pasha All-llahun, kur e vërteta doli në shesh, madje edhe atëherë personaliteti yt ka qenë i dobët, ndërsa zëri yt i ngjiruar. Mirëpo, kur e pavërteta nisi të bërtasë me të madhe, ti atëherë dole sikur brirët e sqapit. » (72)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s atëherë u shpjegoi se bazamenti përkatësisht shtylla mbi të cilën ngritet Islami është të përmbushurit e premtimit:» Ne ua dhamë fjalën e nderit (besën, vërejt e përkth) për armëpushim në kohëzgjatje prej një viti si marrëveshje për të dyja palët; dhe më pas shtoi:» Mjerë për ju! Ju dëshironi që unë ta thyej (shkel) fjalën time pasi që u kam dhënë besë dhe premtim solemn. A e dini se All-llahu xh.sh ka thënë:» Dhe përmbajuni premtimeve të cilave me emrin e All-llahut ua kemi dhënë dhe mos e prishni besimin kur e keni dhënë fort dhe All-llahu për dëshmitar tuajin e keni marrë, ngase vërtetë All-llahu e din atë çka punoni... » ( nga Kur'ani i Madhënueshëm, vërejt e përkth).

- Fitneja atëbotë injoronte këshillat dhe udhëzimet e Imam Aliut a.s, fitneja dhe trazirat e tyre-harixhinjëve-nga dita në ditë forcoheshin dhe vetëm vinin duke u shtuar, e sidomos kur një numër bukur i madh i njerëzve ju bashkangjit. Atëherë, me të madhe filluan t'i kundërshtojnë ushtrinë dhe shokët e halifit, Imam Aliu a.s, dhe pa asnjëfarë hezitimi, fare lirshëm filluan ta derdhin gjakun e tyre...

- Imam Aliu a.s duke e parë sjelljen e tyre të këtill dhe rrëmuajt e fitnet që shkaktonin, u dërgoi një letër me përmbajtjen vijuese:

« Shtërngata ju shkatërroftë dhe mos lashtë asnjë nga ju për mbarësim! Vallë më duhet të tregoj mosbesim pas besimit në All-llahin dhe pas luftës në rrugën e All-llahut dhe Pejgamberit të All-llahut ?!

« Unë nuk ndjeki dëshirat tuaja, pse atëherë do ta isha i humbur

e jo prej të udhëzuarve (në rrugë të drejtë). » El-En'am (56)

- Dhe për këtë arsye zini vendin më të keq të kthimit dhe kthehuni prapa. Kini kujdes; Me siguri, pas meje do të përjetoni shumë poshtërime, me shpata të mrehta dhe egoizëm, të cilin tiranët do ta zbatojnë si mënyrë e sjelljes ndaj jush. » (73)

- Mendimi dhe iniciativa e Imam Aliut a.s ishte që të mos i provokojë ata, por që t'u jepet mundësia që seriozisht dhe me mendje kthjelltësi të mendojnë, përkatësisht rezonojnë rreth asaj se çfarë kanë ndër mend të bëjnë dhe veprojnë. Imami a.s shpresonte se mund të vetëdijesohen dhe të kthehen në rrugën e vërtetë, dhe se ashtu siç janë komplet mund t'i ktheheshin luftës së drejtë kundër Damaskut. (luftës kundër Muavijut, vërejt e përkth) Veçanërisht shpresonte në këtë pas mos-suksesit të gjykatësit në takimin nga kjo si dhe mungesa e gjykimit sipas Librit të All-llahut për të cilin ishin marrë vesht që më parë, Imami a.s akoma vazhdonte të shpresojë...

- Mirëpo, për fat të keq, rreziku i parë i brendshëm për hilafetin veçmë filloi dhe dhuna ishte rëndë për t'u shmangur... Kundërshtarët-harixhinjët filluan të vrasin njerëz të pafajshëm, kudo që venin ndjellnin frikë dhe tmerr, kështuqë e prishën paqen. Dhuna e tyre arriti gjer aty sa që e vranë edhe as-habin e Resulull-llahut s.a.v.s Abdull-llah ibn Hababin dhe ia çanë barkun gruas së tij shtatzënë... Gjithashtu vraën edhe tre gra po të të njëjtit fis, si dhe gruan Um Sanan El-Sidavijen. Meqë situata sa vinte e keqësohej, Imam Aliu a.s e dërgoi shokun e tij Harith ibn Mura El-Abdiun në mision që t'ua tërheq vërejtjen dhe t'ua ndal hovin valës së vrasjeve, por ata (harixhinjtë) e vraën edhe Harithin. (74) Kur Imam Aliu a.s mori vesht për këtë, u kthye menjëherë nga grunaja, vendi ku e kishte tubuar ushtrinë e tij për të marrshuar drejt Damaskut. Kur parakaloi pranë foracave të fitexhive dhe rrebelëve (harixhinjëve, vërejt e përkth) sërish u pëpoq ta qetësojë situatën pa dëshiruar që të derdhet gjaku i muslimanëve. Kërkoj prej tyre që t'ia dorëzojnë vrasësitë e Abdull-llah ibn Hababit, Harith ibn Mura El-Abdiut dhe të tjerëve, duke ju premtuar se nëse ata ia dorëzojnë vrasësit, atëherë ai-Imami a.s do t'i lëjë të qetë. Mirëpo, ata me kryelartësi njëzëri u përgjigjën:» Ne të gjithë, ata i kemi vararë. » Imam Aliu a.s atëherë ua dërgoi as-habin e njohur (eminent) të Pejgamberit s.a.v.s Kajs ibn Saadin, që t'i këshillojë dhe sërish tua rëheq vërejtjen për qëndrimin e tyre të gabueshëm, duke i lutur që t'i lëshojnë kuptimet e shtrembëruara ndaj fesë Islame dhe derdhjen e kotë gjakut musliman pa apsur ndonjë shkas a justifikim.(75) Imam Aliu a.s vazhdonte edhe më tej me qëndrimet e tija humane dhe me argumentimin racional për atë se çfarë janë duke bërë e vepruar. Më pas, kushedi për të satën herë, ua dërgoi edhe as-habin tjetër eminent të Pejgamberit s.a.v.s Ebu Ejjub El-Ensariun, i cili pas këshilës që ua drejtoi atyre (harixhinjëve) e ngriti flamurin e paqes dhe bërëtit me zë të lartë: « Ai i cili vjen në këtë anë, dhe nuk ka marrë pjesë në mbytjen e njerëzve të pafajshëm, do të jetë i shpëtuar. Ne nuk kërkojmë asnjërin prej jush, përveç se vrasësve të vëllezërve tanë » (76)

- Ftesa për paqe, deri diku pati sukses dhe njerëzit filluan të dalin nga taborri i harixhinjëve, gjersa numri i tyre prej 12000 nuk u zvogëlua në 4.000.

- Mirëpo, ata 4.000 që mbetën filluan ta sulmojnë ushtrinë e halifit. Në këtë rast, si zakonisht, Imam Aliu a.s e urdhëroi ushtrinë e vet që të mos fillojë e para të sulmojë, por të pres që këtë gjë e para ta bëjë pala tjetër. Dhe kur ata filluan sulmin, ushtria e halifit, Imam Aliut a.s i rrethoi në të katë anët dhe me plotë meritë i mundi duke i

shkatërruar për një. Kjo ishte Lufta e Nahrevanit kundër «havarixhëve» të cilën luftë Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s e kishte paralajmëruar duke e quajtur « El-marikin » të cilën ia përmend në një hadith, as-habit të tij Ebu Seid El-Hudriu i cili thotë:» E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s kur ka thënë:» Do të ketë nga ky ummet një grup njerëzish që do të dalin nga feja ashtu siç dek shigjeta nag harku » (77) (Në këtë hsdith, Muhammedi s.a.v.s qartë aludon për harixhinjtë, vërejt e përkth).

## **MBI AMANETIN E ALL-LLAHUT**

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e përfundoi luftën në Nahrevan kundër harixhinjëve dhe u kthye për në Kufe, me qëllim që ta organizojë ushtrinë e vet për luftën që do të bëhej në Damask, pasi që edhe për herë të dytë dështuan bisednimet përkatësisht çështja e gjykimit që pati një rezultat të disfavorshëm.

- Imam Aliu a.s shpalli një mobilizim të përgjithshëm tek populli dhe njëherit i shpalli luftë opozitës kryengritëse me në krye Muavi ibn Ebu Suffjanin. Me rastin e mbajtjes së fjalimit në Kufe, që atëherë ishte shndërruar në kryeqitet të botës islame, e ftoi ummetin musliman në xihad (luftë në rrugë të All-llahut xh.sh.) duke ju thënë të pranishmëve

« Falënderimi i qoftë All-llahut, te Cili kthehet çdo gjë dhe përfundon çdo gjë ! I falënderojmë Atij për madhështinë e mirësisë së Tij, mëshirën e argumenteve të Tij, shtimin e bagatisë dhe të mirave të Tij-me falënderin i cili do ta kënaqë të drejtën e Tij, do t'i përshtate meritave të Tij, do ta afrojë shpërblimin e Tij dhe do të jetë efikas në shtimin e mirësisë së Tij. dhe kërkojmë ndihmën e Tij, si ai që është plotë shpresë në mirësinë e Tij, i etshëm për të mirat e Tij, i sigurt nën mbrojtjen e Tij, i cili pranon shpërblimet e Tij dhe i bindet Atij edhe me gjalë edhe me vepër. I besojmë Atij me besimin e atij i cili shpreson në Te me besim të fortë, i drejtohet si besimtarë, i dorëzohet me përlulësi, beson sinqerisht në Njësinë e Tij (Tevhidin), e lartëson Ate duke e lavdëruar dhe duke punuar me përkushtim, me admirim kërkon shtrehim te Ai.

- I Madhëruari nuk është i lindur ashtu që ndonjëri të ketë hise në tëlartësuarit e Tij, as e ka lindur ndonjëri për të qenë i trashëguar dhe kalimtar. Koha dhe lashtësia nuk kanë ekzistuar para Tij. Nuk e dëmton as zmadhimi as zvogëlimi. Ai i zbulohet mendjeve përmes asaj që ua zbulon nga shenjate udhëheqjes së përsosur dhe qëllimit përfundimtar. Ndër argumentet e krijimit të Tij është krijimi i qiejve të cilët janë vendosur për shtylla dhe qëndrojnë pa mbështetje. Ai e ftoi dhe ata iu përgjigjën thirjes me përlulësi e bindje dhe nuk shprehën plogështi ose keqardhje. Sikur të mos e kishin pranuar Hyjninë e Tij dhe të mos iu kishin bindur. Ai nuk do t'i kishte bërë vend të Fronit të Tij, vendbanim të melekëve të Tij dhe shkallë e skajshme të ngritjes së fjalës së bukur dhe veprës së mirë të robërve të Tij...

... Po ju lë amanet, o robët e All-llahut, të jeni të vetëdijshëm për All-llahun, i Cili u ka dhënë veshje të mirë dhe u ka shpërblyer me paisje të begatshme. Po të ekzistonte ndonjë tjetër që do të mund t'i sigurontë shkallët drejt jetës së amshueshme, ose të gjejë mënyrën për ta larguar vdekjen, ai do të ishte Sulejmani biri i Davudit-Alejhis-salam! të cilit pos misionit dhe pozitës së lartë, i është dhënë pushtet mbi xhinët dhe njerëzit. Mirëpo, kur ky e shpenzoi nozullimin që i është dhënë dhe kur përmbushi afatin e vet, harku i kalueshmërisë e goditi me shigjetën e vdekjes. Shtëpitë e tij mbetën të shkreta, ndërsa vendbanimet të zbrazëta. Ato i trashëguan të tjerët. Me të vërtetë, në brezat e kaluar keni mësim!

... O njerëz, vërtetë po ju paraqes këshilla me ta cilat të dërguarit i kanë këshilluar popujt e tyre dhe po u transmetoj atë që të dërguarit ua kanë transmetuar atyre që kanë ardhur pas tyre...

... Dijeni mirë, ajo nga kjo botë që ka ardhur-tani më ka shkuar, ndërsa ka ardhur ajo prej saj që ka devijuar. Robët e ndërshëm të Zotit tanimë kanë vendosur të udhëtojnë. E kanë shitur një pjesë të vogël të kësaj bote e cila nuk zgjatë përgjithmonë, për një pjesë të madhe të botësjetër e cila nuk ka mbarim.

- Çfarë durimi (sabri) përjetuan vëllezërit tanë, gjaku i të cilëve është derdhur në Siffin, me atë që sot nuk janë gjallë? Vetëm për atë që nuk pësojnë fyerje, të cilët ta zëjnë frymën dhe që nuk pijnë ujë të ndotur! Pasha All-llahun! Ata me siguri e kanë takur All-llahun dhe Ai i ka shpërblyer me dhuratën e Tij dhe i ka vendosur në shtëpi të sigurta pas frikës së tyre... »

- Pastaj Prijësi i besimatërve-Imam Aliu-Alejhissem!- e kapi me dorë mjekrrën e tij të respektuar dhe elegante dhe qajti e qajti një kohë të gjatë... Pastaj foli:» Ah, Vëllezërit e mi të cilët kanë mësuar nga Kur'ani dhe kanë sjellur vendime në bazë të tij, që kujtonin obligimet e tyre dhe i zbatonin ato, që rringjallnin Sunnetin-Rrugën e Pejgamberit dhe eliminonin risitë-bid'atet! Kur u ftuan në xhihad, u përgjigjën: Patën besim në prijësin e tyre dhe pasuan ate. »

- Atëherë Prijësi i besimatërve-Imam Aliu a.s bërtiti me aq zë sa kishte:  
« Xhihad! Xhihad! O robët e Zotit! Diejni mirë se po e tuboj dhe përgatiti ushtrinë. Ai i cili dëshiron të përparojë drejt All-llahut le të dalë një hap para! » (78)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s filloi ta organizojë ushtrinë, t'i caktojë udhëheqësit e bataljoneve, ndaj edhe caktoi të birin e vet Hasanin për udhëheqës të bataljonit të parë, Ebu Ejjub El-Ensariun për të dytin, ndërsa Kajs ibn Saadin për udhëheqës të bataljonit të tretë. Gjersa Imam Aliu a.s ishte i preokupuar dhe zënë me mobilizimin e popullit i cili duhej t'i printe luftës kundër Muaviut dhe komplotistëve të tij në Damask, Muaviju fshehurazi planifikonte t'i bëjë atentat halifit të athëreshëm-Ali ibn Ebu Talibit a.s.

- Një grup armiqësh, veçanërisht harixhinjtë, u takuan në qytetin e Shenjtë të Mekës, me qëllim të fillimit të së keqes më të madhe të kësaj bote, duke mos llogaritur aspak pasojat. Marrëveshja e bërë ishte që t'i bëhet atentat Imam Aliut a.s, ndërsa për ekzekutues të atentatit e caktuan Abdurrahmanin birin e Mulxhem El-Muradit. Gjithë kjo po ndodhte në kohën më të keqe që po përjetonte islami dshe rruga e tij e vërtetë, pikërisht në kohën kur ummeti islam priste luftën përfundimtare dhe fitoren bindëse kundër rrebelëve dhe komplotistëve të cilët kontribuan për përçaren dhe ndasitë në mesin e muslimanëve.

- Dora mëkatore e Mulxhemit e goditi Imam Aliun a.s me shpatë, ditën e dymbëdhjetë të muajit të ramazanit, në vitin e 40 sipas hixhretit. Kjo ndodhi gjatë kohës së bërjes sexhde në namazin e sabahut në xhaminë e Kuffes.

- Atentati ngjau në kohën më të admiruar dhe rrethanat më madhështore, d.m.th gjatë kohës kur Imam Aliu a.s ishte agjërueshëm, kur ndodhej në namaz si dhe kur kokën e tij e kishte lëshuar në tokë, kur i bënte sexhde All-llahut të Madhëruar, duke e kryer veprimin e tij më fisnik; si dhe gjithashtu në kohën e përgatitjeve të mëdha për xhihad dhe si kulminacion i gjithë kësaj atentati ndodhi në xhaminë e Kuffes (d.m.th në shtëpinë e All-llahut xh.sh vërejt e përkth). Qoftë gjithnjë i lavdëruar dhe shijoftë shpërblimin e Zotit të Madhëruar e Fisnik!

- Eliminimi përkatësisht likuidimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s gjithnjë do të mbetet si vepër më e keqe, kriminale dhe stër-shëmtuar, ngase vrasja e tij, nuk ishte e drejtuar vetëm kundër një njeriu të rëndomtë, por vrasja ishte kundër halifit musliman

më racional për ndërrimit jetë të Pejgamberit s.a.v.s. Me atentatin ndaj Imam Aliut a.s gjithashtu doli në skenë, u shfaq haptazi ndaj pejgamberllëkut, historisë, qytetërimit, si dhe kundërshtimit ndaj gjithë ummetit të cilin Imam Aliu a.s e përfaqësonte. Me një akt të këtillë, ummeti islam humbi një udhëheqës përparimtar të rrugës së Pejgamberit s.a.v.s dhe qytetërimit dhe rastin më të mirë për t'u udhëhequr mbas bërimit jetë të Pejgamberit s.a.v.s.

- Imam Aliu a.s vuajti nga plagët tri ditë. Gjersa rrinte i shtrirë në shtartë, e caktoi birin e vet Hasanin për halif dhe udhëheqës të ummetit islam, duke ia besuar kështu një funksion udhëheqës në jetën ideologjike dhe shoqërore. Gjatë këtyre tri ditëve, ashtu sikur edhe gjatë gjithë jetës së vet, Imami a.s nuk u ndal së përmenduri All-llahun xh.sh dhe Madhërimin ndaj Tij, kështu në këtë mënyrë duke e shprehur kënaqësinë ndaj urdhërit dhe caktimit të Tij. Gjithashtu, gjatë këtyre ditëve, nuk u ndal së dhënuri këshilla dhe udhëzime të urta të cilat shpiejnë rrugës së drejtë, rrugës së mirësisë dhe shpëtimit. Ftonte me të madhe në mbrojtjen dhe kryerjen e obligimeve të Zotit, duke ua tërhequr vërejtjen për pasojat e mosndjekjes së këtyre obligimeve.

- Ja në vijim, një pjesë prej këshillës së Imam Aliut a.s drejtuar djemëve të tij, - nipërve të Pejgamberit s.a.v.s; families së tij, farefisit dhe ummetit, shprehur më këto fjalë:

« Ju lë amanet të jeni të vetëdijshëm ndaj All-llahut dhe të mos e gjakoni këtë botë edhe nëse ajo këtë e dëshiron nga ju. Mos t'ju vijë keq për asgjë që u është refuzuar nga ajo. Folni të vërtetën dhe punoni për shpërblim. Bëhuni kundërshtarë të tiranit dhe ndihmës për të shtypurin.

- Ju lë amanet juve dhe krejt fëmijëve të mi dhe anëtrave të familjes time dhe çdonjërit të cili arrinë kjo porosi e shkruar që të jeni të përkushtuar ndaj Zotit, që t'i kryeni si duhet punët tuaja dhe t'i eliminoni mosmarrëveshjet midis veti, ngase e kam dëgjuar gjyshin tuaj ( Pejgamberin, vërejt e përkth)-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi dhe mbi të tijët!- duke thënë:» Përmirësimi i marrëdhënieve të ndërsjella është më i mirë se namazi i joobligueshëm dhe agjërimi i paobligueshëm. »

- Keni frikë Zotin, dhe sërish, keni frikë Zotin lidhur me jëtimët! Mos lejoni të jenë të uritur dhe që në praninë tuaj të keqtrajtohen. »

- Keni frikë Zotin, dhe sërish keni frikë Zotin lidhur me fqinjët tuaj, ngase ata janë amanet i Pejgamberit! Aq ka porositur për sjellje të mirë ndaj tyre sa që menduam se do ta bëjë që ta trashëgojnë njëri-tjetrin.

- Keni frikë Zotin, dhe sërish keni frikë Zotin sa i përket Kur'anit! Askush të mos ua kalojë në të vepruarit sipas tij!

- Keni frikë Zotin, dhe sërish keni frikë Zotin në lidhje me shtëpinë e Zotit tuaj! Mos e braktisni gjersa të jeni gjallë, ngase nëse ajo braktiset, as ju nuk do të jeni ata të cilët duhet marrë si shembull!

- Keni frikë Zotin, dhe sërish keni frikë Zotinnë pikëpamje të xhihadit me pasuritë tuaja, jetët dhe fjalët në rrugën e All-llahut!

- Jeni të vendosur në miqësinë e ndërsjellë dhe flijimin e disave për të tjerët. Dhe ruajuni nga grindja dhe ndarja e ndërsjelle. Mos hiqni dorë nga thirrja për vepra të mira dhe largimin nga ato të këqijat, ashtu që të ligët nga ju të administrojnë mbi ju, kur do të luteni, por nuk do të miartohet. »

- Prandaj, Imam Aliu sërish u tha:

« O bijtë e Abdul-Mutalibit! Vërtet nuk dëshiroj t'u shoh se si shkëlmi vrazhdë mbi gjakun e muslimanëve duke bërëtitur:» Është vrarë Prijësi i besimatërve! » Keni kujdes! Mos e vritni kurrsesi asnjërin për mua, pos vrasësit tim!

- Pritni! Nëse unë vdes nga kjo goditje e tij, atëherë goditnie edhe atë.goditje për goditje. Dhe mos e shëmtoni njëriun, ngase e kam dëgjuar Pejgamberin e All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët! duke thënë:» Ruajuni nga të shëmtuarit ( Pra, mos shëmtoni askënd, vërejt e përkth) edhe nëse është fjala për qenin e tërbuar. »

- Kështu në këtë mënyrë e përfundoi jetën e tij heroike ky kalos i njerëzimit. Pejgamberllëku dhe ummeti pësuan humbje tëpër të madhe pas humbjes që pësuan me vdekjen e Resulull-llahut s.a.v.s.

- Me vdekjen e Imam Aliut a.s ummeti musliman humbi: heroizmin i cili u shndërrua si këngë e kohës, guximin përkatësisht trimërinë për të cilën historia madje as që kishte ëndërruar; Urtësinë dhe mençurinë që askush nuk e posedonte, kuptohet përveç All-llahut të Madhëruar; pastërtinë të cilën askush nuk e posedonte përveç Mhammmedit s.a.v.s; modëstinë të cilën askush në këtë botë nuk e kishte përpos evlijave të Zotit; elokuencën e të folurit e cila buronte përkatësisht inspirohej nga Libri i All-llahut xh.sh; njohësinë e fikhut ( Sheriatit të All-llahut xh.sh) të cilën e quajtën » porat e qytetit të diturisë së Pejgamberit s.a.v.s; diturinë dhe autoritetin të cilat Imami a.s e shndërruan në simbol të mbrojtës së udhëzimeve të ummetit islam në të gjitha aspektet dhe rrethanat që gjendej dhe kalonte jeta e tij vetëmohuese e sakrifikimit për fenë e All-llahut xh.sh; simboli i njeriut që me tërë qenien e vet gjithë jetën gjersa vdiq e vuri në shërbim të fesë së All-llahut xh.sh.

## SHËNIME:

1. Nehxhul-Belaga: 136; komentues: Dr. Subhi Es-Salih
2. Nehxhul-Belaga: 136, njësoj;
3. Nehxhul-Belaga: 136, njësoj;
4. Nehxhul-Belaga: 136, njësoj;
5. Nehxhul-Belaga: 1:269; komentues nga Muhammed Abduha, Kajro
6. Nehxhul-Belaga: 383; komentues nfa Dr. Subhi Es-Salih
7. Nehxhul-Belaga, njësoj; botuar në Bejrut
8. Nehxhul-Belaga, 416, njësoj;
9. Nehxhul-Belaga: 415, njësoj;
10. Nehxhul-Belaga: 512, njësoj;
11. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.4 fq.343 komentuar nga Dr.Subhi Salih
12. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.50 fq.424
13. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.51 fq. 424
14. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.21
15. Madhështia e Nehxhul-Belagës: Xhorxh Gabdek (krishter nga Libani)
16. Ansab El-Ashraf 2:136, El-Balazri
17. Komentim i Nehxhul-Belagë 2:198, 199; dijetari Ibn Hadid komentuar nga Ebu El-Fadil Ibrahim, botuar më 1378 hixhrijj
18. Tadhkeret El-Havas:117; Sebet ibn Kajjim El-Xhevziij
19. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.45 fq 418 komentuar nga Dr. Subhi Salih
20. Bihar El-Envar 41:104; Mexhlisi
  - Tadhkeret El-Havas:134; Ibn Kajjim El-Xhevziij
  - Ansab Al-Ashraf 2:129; Balazri ;
21. Tadhreket El-Havas; Sebet Ibn Kajjim El-Xhevziij;
22. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.45 komentuar nga Dr. Subhi Es-Salih
23. Abkarijjet Imam Ali a.s « Gjenialiteti » : 16; nga Abbas Mahmud El-Akadi botuar në Bejrut më 1976
24. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.209, fq. 324 komentuar nga Dr.Subhi Es-Salih
25. Tadhreket El-Havas:68; Sebet Ibn Kajjim El-Xhevziij
26. Nehxhul-Belaga 2:200; komentuar nga Ibn Ebi Hadid El-Muëtezili
27. Nehxhul-Belaga 2:201, 202; komentuar nga Ibn Ebi Dadid El-Muëtezili
28. Tadhreket El-Havas:121; Sebet Ibn kajjim El-Xhevziij
29. Tadhreket El-Havas:125; Sebet Ibn Kajjim El-Xhevziij
30. Ansab El-Ashraf 2:132; El-Balazri
31. Nehxhul-Belaga2:200; komentuar nga Ibn Ebi Hadid El-Muëtezili
32. Manakib Ali ibn Ebu Talibi a.s 1: kapitulli : » Modestia e Imam Aliut a.s; Ibn Magazili
33. Nehxhul-Belaga; komentuar nga Muhamed Abduhu
34. Nehxhuk-Belaga 2:216, njësoj
35. Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s- Shikim i Ri:32; Dr. Muhammed Ahmed Halefullah dhe të tjerë
36. Nehxhul-Belaga, fjalimi nr.205; komentuar nga Dr. Subhi Es-Salih
37. Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s ve Fadalihi, botuar nga Dar El-Hajat;Bejrut
38. El-Fusul-El-Muhimme; 50; Ibn Sabig El-Maliki
39. El-Fusul-El-Muhimme; 51, njësoj
40. Nehxhul-Belaga 16:154; komentimi i letrave të Imam Aliut a.s drejtuar Muaviut, nr.37
41. El-Fusul-El-Muhimme: 51; Ibn Sabig El-Maliki
42. Nehxhul-Belaga, 1:125; komentuar nga Muahmmmed Abduhu
43. Nehxhul-Belaga 3:75; komentuar nga Muahmmmed Ebu Fadil Ibrahim
44. Nehxhul-Belaga 2:232; komentuar nga Muhammed Abduhu
45. Nehxhul-Belaga 2:68; njësoj
46. Nehxhul-Belaga 2:68; njësoj
47. Hadith Ummul-Muëminin (Nëna e besimatërve-Hazreti Aisha): 98; këto hadithe janë transemtuar nga Tarihu i Taberiut, Ibn Kethiri, dijetari Murteda El-Askeri

48. Hadith Ummul-Muëminin; transmetuar nga Taberiu, Ansab El-Ashraf, El-Balazri- në vepërn »El-Maërif », dijetari Ibn Kutejbe
  49. Komentimi i Nehxhul-Belagës 9:5-6; Ibn Ebi Hadid El-Muëtezili
  50. El-Fusul-El-Muhimme; 55; dijetari Ibn Sabig El-Maliki
  51. Nehxhul-Belaga; 2:84; Imam Ali ibn Ebu Talib a.s kometuar nga Muhammed Abduhu
  52. Nehxhul-Belaga; 2:84; Imam Ali ibn Ebu Talib, komentim i Abduhusë
  53. Tadhreket El-Havas; 77; Sebet Ibn Kajjim El-Xhevziij- komentimi i Nehxhul-Belagës 2:167; Ibn Ebi Hadidi
  54. El-Fusul-El-Muhimme ; 62, Ibn Sabig El-Maliki
  55. El-Fusul-El-Muhimme; 62 njësoj
  56. Hadith Ummul-Muëminin Aishe, 1:181; transmetuar nga Tarihu i El-Jakubit dhe Kanz El-Ummal, dhe El-Mutaki El-Hindi
  57. El-Fusul-El-Muhimme; 70,71- Ibn Sabig El-Meliki
  58. El-Fusul-El-Muhimme; 70,71, njësoj
  59. Komentim i Nehxhul-Belagës 1:23; Ibn Ebi Hadid; komentuar nga Muhammed Ebu Fadil Ibrahim; botuar më 1959 në Sh.b »Dar El-Ihja El-Kutubu-Arabijjetu »
  60. El-Fusul-El-Muhimme: 90, Ibn Sebig El-Maliki
  61. El-Fusul-El-Muhimme: 90, njësoj
  62. Nehxhul-Belaga 3:14; komentur nga Muhammed Abduhu
  63. Nehxhul-Belaga 2:5; Imam Ali ibn Ebu Talib a.s komentuar nga Abduhu
  64. Tadhreket El-Havas:103; Ibn Kajjim El-Xhevziij
  65. Tadhreket El-Havas:79; komentuar nga El-Xhevziij
  66. El-Fusul-El-Muhimme: 98; Ibn Sabig El-Maliki
  67. El-Fusul-El-Muhimme: 103,104,105,106; komentuar nga El-Maliki
  68. Nehxhul-Belaga 2:96; Imam Ali ibn Ebu Talib, komentuar nga Muhammed Abduhu
  69. Nehxhul-Belaga; 1:94 ; Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s, komentuar nga Abduhu
  70. El-Havarixh « (harixhinjtë) ve Esh-shiatu:32, Xhulimms Filhausen; përkthyer nga Abdurrahman Bedevi, botimi i II, Kuvajt 1972
  71. « Vaka (Lufta) e Siffinit »:517 ;-Naser ibnMuhazim,botimi i dytë, viti 1382 hixhrij.
  72. Nehxhul-Belaga, 2:144; Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s., komentuar nga Muhammed Abduhu;
  73. Nehxhul-Belaga 1:106, fjalimi nr.57; komentuar nga Abduhu
  74. El-Fusul-El-Muhimme: 92; komentuar nga Maliki
  75. El-Fusul-El-Muhimme: 108; Ibn Sabig El-Maliki
  76. El-Fusul-El-Muhimme :93; Ibn Sabig El-Maliki, A'jan Esh-Shuatu 3:20; dijetari Muhsin El-Amin ; botuar në Bejrut
  77. Sahihul-Buhari
    - Ansab El-Ashraf 2:376
    - Hasaisu En-Nisaijj, dijetari Nisaijju
  78. Nehxhul-Belaga II, 103, fjalimi nr.182; Imam Ali ib Ebu Talibi a.s; komentim i Muhammed Abduhusë
  79. Nehxhul-Belaga 3:421, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s; komentuar nga Muhammed Abduhu
- P.S Gjatë përkthimit në gjuhën shqipe jamë shërbyer me:
- 1-« Kur'ani- Përkthim me komentim në gjuhën shqipe », përktheu dhe komento: H.Sherif AHMETI, Medinë, 1992 ; dhe
  - 2- « Nehxhul-Belaga (Shtegu i Elokuencës) »- fjalimet, letrat, fjalët e urta të Hz.Imam Ali ibn Ebu Talibit-; Përktheu dhe botoi Redaksia e Bashkësisë Islame »Eh-li Bejt », Prizrenë 1998.



## IMAM ALI IBN EBU TALIBI A.S (PJESA E TRETË)

Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s ka thënë:

« *Aliu është me drejtësinë dhe drejtësia është me Aliun,  
dhe nuk do të ndahen gjersa nuk më takojnë mua  
te burimi i kthjellët në Ditën e Gjykimit.* » (1)

### ME EMRIN E ALL-LLAHUT MËSHIRUESIT, MËSHIRBËRËSIT !

- Ndjekësi i jetës së Emirul-Muëmininit Ali ibn Ebu Talibit a.s fare lehtë mund të vërejë ndikimin dhe rolin e të Dërguarit të All-llahut xh.sh-Muhammedit s.a.v.s në përgatitjen dhe brumosjen e personalitetit të Imam Aliut a.s që nga fëmijëria e tij e hershme e gjersa u shndërrua në « fotografi » të Pejgmanberit s.a.v.s nëpërmjet urtësisë, mençurisë, drejtësisë dhe besimit e veprës. Vetë Imam Aliu a.s këtë natyrë të ngjashme me atë të Resulull-llahut s.a.v.s e ka përshkruar me fjalët vijuese:

« ... E dini mirë vendin tim pranë Pejgamberit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!- sa i afërt ka qenë, duke pasur parasysh afërsinë gjinore dhe pozitën e posaçme. Kur isha fëmijë, ai më merrte nën mbrojtjen e tij. e kishte zakon të më shtrëngonte në kraharor dhe t'më vendoste pranë në shtratin e tij, ta afronte trupin e tij pran trupit tim dhe me këtë t'më mundësonte të shijojë aromën e e tij të këndshme. E kishte zakon të përtypte diç dhe mandej t'ma jepte pak nga pak. Kurrë nuk ka gjetur gënjeshtër në fjalët e mia, as dobësim në çfarëdo veprim timin. Që nga koha kur atë-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe familjen e tij !- e ndanë nga sisa, All-llahu pranë tij e caktoi Melekun më të madh të Vetin për ta udhëhequr edhe ditën edhe natën rrugës së mirësisë dhe mirrësjelljes ndaj njerëzve. Kurse unë e kam ndjekur pas si mëz i deveve i cili ndjek gjurmët e nënës së tij. për çdo ditë më tregonte, me shembuj, disa nga vetitë e tij dhe më urdhëronte t'i ndjek. Çdo vjet shkante e veçohej në shpëllën Hira, ku e kam parë vetëm unë e askush tjetër pos meje. Atëbotë Islami nuk ka qenë i pranishëm në asnjë ahtëpi pos në shtëpinë e Pejgamberit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!- dhe Hatixhesë. Kam qenë i treti pas atyre të dyve. E kam shikuar dritën e Shpalljes dhe Porosisë dhe e kam shijuar aromën e pejgamberllëkut.

- Kur atij-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!-i zbriti Shpallja, e kamë dëgjuar përloshjen e shejtanit. Atëherë i thashë:» O Pejgamber i All-llahut ç'është kjo përloshje ? » Kurse ai m'u përgjigj:

« Ky është shejtani i cili ka humbur çdo shpresë se do t'na bëjë robër të tij! Ti vërtet dëgjon çka dëgjoj edhe unë, dhe shikon çka shikoj edhe unë, pos që ti vërtet nuk je i dërguar (Pejgamber), por ti je ndihmës, dhe ti, me siguri je në rrugë të mbarë !... » (2)

- Ky është një argument i mirë që historia na e sjell dhe na e rrëfen përgatitjen e bekuar që Imam Aliu a.s e pati qysh në fëmijëri nga ana e Pejgamberit s.a.v.s, me qëllim të ndjekjes së rrugës së tij, vazhdimit të saj, duke e shndërruar në mësues për muslimanët dhe muxhtehid i tyre pa ndërrimit jetë të Resulull-llahut s.a.v.s.

- Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s filloi ta edukojë Aliun a.s qysh nga fëmijëria e tij e hershme. Ishte kujdestar dhe mësues i cili i kushtoi një vëmendje të posaçme,

vëmendje që askush tjetër nuk e pati pas tij. kështu që Imam Aliu a.s ishte krah Pejgamberit s.a.v.s qysh si fëmijë, ishte me te edhe pas zbritjes së Shpalljes së Zotit, ashtu siç ishte me te vazhdimisht, gjersa Resulull-llahu ndërroi jetë.

- Imam Aliu a.s ishte tepër i vëmedshëm ndaj Pejgamberit s.a.v.s. E merrte Pejgamberin si shembull dhe mësues, duke i kushtuar vëmendje dhe koncentrim të madh. Pejgamberi s.a.v.s rrinte me Aliun a.s me orë të tëra, ditë e natë, me qëllim që ta mësojë dhe forcojë trurin dhe të kuptuarit e gjëravëe, si dhe e mësonte që në frymën e peygamberrllëkut të gjitha mësimet t'i shndërrojë dhe jetësojë nëpërmjet veprave në jetën e përditshme. Shumë transmetues të haditheve kanë folur për këtë dhe i kanë pohuar këto qëndrime të Pejgamberit s.a.v.s ndaj Aliut a.s.

- Dijetari En-Nisaiu transmeton nga Abdullahu i biri i Amrit, ky i biri i Hudra-El-Xhamaliut, nga Imam Aliu a.s se ka thënë:» Kurdoherë që e kam pyetur Pejgamberin s.a.v.s ai më është përgjigjur, ndërsa kur kam heshtur Pejgamberi s.a.v.s ka filluar të flasë. » (3)

- Ibn Abbasi transemtion nga Aliu a.s se ka thënë:» Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s kisha dy termine për takim, njërin gjatë ditës e tjetrin gjatë natës. »

- Ebu Seid El-Hudriu transmeton:» Aliu e kishte një trajtim të posaçëm tek Muhammedi s.a.v.s, që askush tjetër nuk e kishte përpos tij. »

- Abdull-llah ibn Jahja transmeton nga Aliu a.s se ka thënë:» Çdoherë kur kam ardhur tek Pejgamberi s.a.v.s gjatë natës kur falej, e fillonte me tesbih, ndërsa kur nuk falej atëherë më lejonte të hyjë. » (4)

- Ummu Selemi (Gruaja e Pejgamberit s.a.v.s) thotë: « Beto hem në All-llahun xh.sh se Aliu ishte më i afërt për nga pozita me Muhammedin s.a.v.s. »

- Pune e Pejgamberit Fisnik s.a.v.s rreth përgatitjes së personalitetit të Aliut a.s nxorri fryte. Imami a.s e meritoi që pas Muhammedit s.a.v.s ta marrë udhëheqjen e plotë të ummetit islam si politikisht ashtu edhe shpirtërisht. Tradita islame në forma të ndryshme dhe të drejtëpërdrejta e ka pohuar aftësinë e tij për udhëheqjen e ummetit Islam, nëpërmjet lavdërimeve dhe falënderime të cilat Imam Aliu a.s vërtetë i meritoi me anë të punës dhe veprave të tij te Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s.

## **VEÇORITË DHE POZITA E IMAM ALIUT A.S TEK PEJGAMBERI MUHAMMEDI S.A.V.S**

- Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s në shumë thënie të tij e dha qëndrimin e tij mbi Aliun a.s

1. « Aliu është sikur Qabeja ... » (6), kjo do të thotë se Imam Aliu a.s është sikur Qabeja. Ashtu sikur të gjithë njerëzit gjatë kohës së faljes së namazit i kthejnë fytyrat e tyre në drejtim të Qabesë, ashtu edhe ne jemi të obliguar të veprojmë ndaj udhëzimeve dhe porosive të tij.

2. « Aliu është porta e diturisë sime dhe udhëheqës i ummetit tim pas meje. Dashuria ndaj tij është imani (besimi) i plotë, kurse urrejtja ndaj tij është dyfityrësi. » (7)

3. unë jam qyteti i diturisë, ndërsa Aliu është porta e atin qyteti. » (8)

- Imam Aliu është rruga e drejtë të cilën ummeti islam duhet ta ndjekë dhe ta njohë Zotin dhe tefsirin, si dhe vënien në praktikë të rregullave islame, d.m.th praktikimin e tyre

4. « O Ebu Bekër, hiseja ime dhe hiseja e Aliut janë të njëjta në drejtësi. » (9)

5. « Aliu është gjykatësi (ndarësi i drejtësisë, vërejt e përkth) më i mirë ndër pjesëtarët e ummetit tim. » (10)

- « Ky është një tregues dhe argument i besueshëm, që Imam Aliu a.s si gjykatës është më i afti, si dhe ai që më së miri i njeh ligjet islme dhe që ato lirisht mund t'i zbatojë përkatësisht parimet islame në çdo sferë të jetës.

6. « Aliu është me drejtësinë dhe drejtësia me është me Aliun, dhe këto të dy nuk do të ndahen gjer në Dytën e Gjykimit. » (11)

- Pasiqë Imam Aliu a.s është simbol i drejtësisë dhe të drejtës, All-llahu e dërgoi atë për të gjithë robërit që ta ndjekin, ngase ai dhe e drejta nuk do të ndahen, pra do të jenë bashk gjer në Ditën e Gjykimit.

7. « Pas meje do të ndodhin ngatërresa (turbullira), dhe kur ato turbullira të vijnë, mbahuni për Ali ibn Ebu Talibin, ngase ai është i pari që mua do të më shohë në Ditën e Gjykimit dhe i pari që mua do të më përshëndet në qyejt e lartë, ai është prej meje dhe ai është faruk (ndarës) i të drejtës nga e padrejta (e keqja) » (12)

- Sa i pëket besimit (imanit) të Aliut a.s dhe lidhjes së tij me All-llahun e Madhëruar, Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s ka thënë:

« Sikur ta vëndoni imenin e të gjithëve që janë në tokë e qiej, në peshojë nga njëra anë dhe në anën tjetër të peshojës imanin e Aliut, ana e peshoresh ku gjendet imani i Aliut do ta rëndonte anën tjetër. » (13)

« Shpallja e Zotit dhe udhëzimet e Muhammedit s.a.v.s tregojnë dhe dëshmojnë për immamatin e Ali ibn Ebu Talibit a.s dhe aftësitë e tij për udhëhqjen e ummetit islam.

- Historianët dhe transmetuesit e hadithit, përcjellin se ajeti kur'anor i Suretu El-maide, 55-56:» Mik ( i afërt) juaji është vetëm All-llahu, është i Dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namaz dhe japin zekatin duke bërë rukuë (duke qenë respektues). E kush ka për mik All-llahun, të Dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s'ka dyshim se ana (pala-krahu) e All-llahut është nganjyese; ka zbritur për shkak të lojalitetit të Imam Aliut a.s. Ky ajet tregon se si ummeti islam është i obliguar ta përmbajë (ndjek) Imam Aliun a.s si udhëheqës, muxhtehid në fe dhe në politikë pas Pejgamberit s.a.v.s. Shkaku i ardhjes së këtij ajeti është: kur një i varfër hyri në xhami, Pejgamberi s.a.v.s i ftoi njerëzit për t'i ndihmaur (varfanjakut, vërejt e përkth), kurse ata të gjithë u drejtua kah Imam Aliu a.s gjersa ky i fundit ishte duke u falur. Më pas, Imam Aliu a.s tregoi (bëri me shenjë) në unazën që e mbante në gisht, dhe i varfëri e morri unazën e Aliut a.s si sadaka. (14)

- Veçmë është e njohur hutbeja El-Ghadir të cilën Pejgamberi, Muhammedi s.a.v.s e mbajti gjatë kthimit të tij prej Mekkes për në Medinë. I Dërguari Muhammedi s.a.v.s bashkë me haxhinjtë e arrijti në vendin e quajtur Ghadir Khum, vend ku ndahen rrugët të cilat çojnë në viset tjera arabe. Në këtë vend, Muhammedi s.a.v.s i ndali haxhinjtë në atë ditë që ishte tepër e nxehtë, përcëllonte nga dielli me qëllim që të pranishmëve t'ua kumtojë një Shpallje të rëndësishme të Zotit, nëpërmjet hutbes, e cila kishte të bëjë me Imam Aliun a.s. Pejgamberi s.a.v.s tha:» O njerëz! All-llahu është Mbështetësi im, kurse unë jam mbështetësi juaj, ndërsa atij të cilit unë i jam mbështetës, mbështetës i është edhe Aliu. Zot! Duaje atë që e don Aliun dhe urreje atë që e urren Aliun. » (15)

- Ahmed ibn Hanbeli transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s se ka thënë: » Mbështetës i kujat jam junë, mbështetës i tij është edhe Aliu. Zot! Duaje atë që e don Aliun dhe bëhu armik i atij që është armik i Aliut. » (16)

- Umme Seleme ( Gruaja e Pejgamberit s.a.v.s) transmeton se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë :» All-llahu xh.sh për secilin pejgamber e ka zgjedhur trashëgimtarin e tij, ndërsa trashëgimtarin im është Aliu, trashëgimtar i familjes së tij, fisit dhe ummetit. » (17)
- Këto që u përmendën më sipër, janë vetëm disa prej dëshmive, argumenteve dhe porosive të All-llahut xh.sh dhe Pejgamberit të Tij s.a.v.s për pozitën dhe rolin e Ali ibn Ebu Talibit a.s si udhëheqës në botën fetare, politike dhe shoërore. » (18)

## **IBADETI (ADHURIMI) I IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S**

- Vërtetë ishte dëshira e All-llahut që Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s t'i kushtojë vëmendje Imam Aliut a.s që ta mësojë dhe edukojë në frymën e Kur'anit, dhe kështu në te-Imamin a.s të mbjellë cilësitë e veçanta, karakterin dhe moralin e lartë të cilët do t'i praktikonte denjësisht në këtë botë. Synimi i kësaj pune ishte që Imam Aliu a.s të shndërrohet në hije besnike përkatësisht « fotografi » e Pejgamberit s.a.v.s në çfarëdo kuptimi, qoftë në atë mendor, të urtësisë etj, si dhe në udhëzimin, me qëllim që ta merr qëndrimin e njëjtë që e kishte edhe Muhammedi s.a.v.s.
- Hadithi i Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s që ka të bëjë me Imam Aliun a.s, qartë tregon se Imam Aliu a.s ishte i pastruar prej mëkateve, dhe se ishte Haruni i ummetit të vet. Kur Pejgamberi s.a.v.s e ndanë drejtësinë, ai (Aliu a.s) është ndjekës i drejtësisë dhe drejtësia dhe ai-Aliu, kurrë nuk do të ndahen njëri prej tjetrit, si dhe ai gjithashtu është edhe porta e qytetit të Zotit. (19). Këto janë cilësitë dhe veçoritë që e karakterizojnë dhe zbukurojnë jetën e Imam Aliut a.s, dhe njëherit janë edhe argument i qartë për pozitën dhe rolin e tij që e kishte në botën reale. Këto cilësi dhe veçori të jashtëzakonshme që e karakterizonin portretin e Imam Aliut a.s s' do mend se ishin rezultat dhe fryt i punës dhe vëmendjes së Muhammedit s.a.v.s që kishte ndaj tij, gjer në ditën e fundit të jetës së tij s.a.v.s.

## **LIDHJA E IMAM ALIUT A.S ME ALL-LLAHUN XH.SH**

- Lidhja e Imam Aliut a.s me All-llahun xh.sh ishte njësoj sikurse lidhja e çdo muslimani-besimtar që ka me All-llahun xh.sh, e pa kufizuar dhe e përhershme.
- All-llahu xh.sh i përshkruajti dhe i ërcaktoi ato lidhje për të gjithë robërit, nëpërmjet udhëzimeve dhe rregullave, e që janë:
  - PËRKUSHTIMI I PLOTË ndaj All-llahut xh.sh në çdo lëvizje të çdo pjese të trupit tonë dhe në çdo frymë të frymëmarrjes së shpirtit tonë, si fjala vjen gjatë namazit, agjërimit, haxhit, ibadetit, largimit prej kënaqësive të kësaj bote, mbajtjes së lidhjeve farefisnore dhe raporteve në shoqërinë, besimit në kaderin (caktimin) e Zotit si dhe në Ditën e Gjykimit dhe gjithë atë që pason pas saj.
  - Kur'ani i Madhënueshëm i përcaktoi lidhjet nëpërmjet njeriut dhe Zotëriut të tij të Madhëruar-All-llahut xh.sh sipas ajetit të shpallur në vijim: » Thuaj: « Namazi im, sakrifikica ime, jeta ime, dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve »! (El-En'am, 162). Ky ajet në tegon qartë neve se obligimet madhore në islam siç janë:namazi, agjërimi, haxhi dhe të tjera, janë thjesht të përkushtuara ndaj All-llahut xh.sh dhe të cilat e përfshijnë gjithë njerëzimin. Mirëpo, kryerja e këtyre obligimve me

devocion çon deri tek kënaqësia e All-llahut xh.sh gjatë kryerjes së tyre në kohë dhe hapësirë të caktuar pa asnjëfarrë mangësie apo shtese.

- Një obligim i tillë, siç është fjala vjen martesë apo aktiviteti ekonomik të cilën All-llahu e ka përcaktuar në suaza të përkushtimit ndaj Tij, gjithashtu bën pjesë në suaza të jetës sonë, sjelljes, pa marrë parasysh se nuk është ekuivalent i ndonjë ibadeti tjetër të njeriut. Martesa, fjala vjen, të cilën Islami e ka përcaktuar është mburojë prej zinasë (kurvërisë). Feja Islame, konsideron se martesë është plotësimi i gjysmës së fesë, kurse legjitimiteti i martesës është një lidhje e bukur dhe e mirë mes burrit dhe gruas si dhe njëherit edhe obligim i secilit musliman. Ndaj, nisurr nga kjo martesë dhe puna janë obligime të secilit musliman që vetvetes t'i sigurojë ekzistencë të mirë dhe të sigurtë.

- Shembullin e besimtarit të vërtetë dhe raportin e tij me All-llahun xh.sh e shohim dhe ndjekim tek Imam Aliu a.s; ngase ai është fryt i punës dhe përpjekjes së Muhammedit s.a.v.s, i cili qysh në fëmijërinë e tij të hershme të jetë sikur ai s.a.v.s dhe kjo qartë vërehet dhe shihet edhe prej ibadetit (adhurimit) të Imam Aliut a.s.

## NAMAZI DHE LUTJA E IMAM ALIUT A.S

- Imam Aliu a.s ishte nxënës i Pejgamberit të All-llahut xh.sh Muhammedit s.a.v.s ndaj edhe çdo herë gjendej në ibadet (adhurim), falej gjatë dhe lexonte lutje të shumta (dova), kështuqë në këtë mënyrë t'i afrohej Zotit të tij xh.sh. Irva ibn Zubejri transmeton nga Ebu Derda, këtë në vijim:

« Isha me Imam Aliun a.s, kur ai u larguaprej nesh dhe filloi të falej nën një drunjë të ngushtë dhe me një zë të mallëngjyeshëm duke qarë e lexoi lutjen vijuese:

« O All-llah! Sa cilësi të mira më ke dhuruar nga Falja jote dhe sa gjunahe m'i ke mbuluar me Mirësinë Tënde.! O Zot! Sa gjatë zgjat mosdëgjueshmëria ime ndaj Teje dhe gjunahet e mia janë të mëdha në Librin dhe mëshirën Tënde, ndërsa unë shpresoj vetëm në faljen Tënde dhe mëshirën Tënde dhe nuk kërkoj asgjë tjetër përveç kënaqësisë Tënde! »

- Ebu Derda thotë :» Isha në dilemë, zëri i kujt është ky, ndaj edhe fillova të shkoj në drejtim të zërit, kur ç'të shoh ai sihte Aliu. Qëndrova gjatë pa lëvizur. Imam Aliu a.s vazhdoi gjatë e gjatë të falet në atë natë të errët, dhe kur e përfundoi namazin, sërish ra në sexhde duke qajtur mallëngjyeshëm dhe duk e lexuar lutjen vijuese: » O All-llah! Kur mendoj në faljen Tënde, atëherë më lehtësohet shpriti, ndërsa kur kujtoj ndëshkimin Tënd, atëherë më duket se gjynahet e mia janë të mëdhaja. O Zot! Kur në Librin Tënd të shohësh ndonjë gjynah që pavetëdije e kam bërë, Ti atëherë do t'u thuash melaqeve :» Mernie, keq do ta ketë ai që askush nuk do të mundet ta shpëtojë e as që për te dikush do të përpiqet atëherë kur të vijë Dita e Gjykimit, nga Zjarri i cili do t'i shkatërrojë zemrat dhe ndjenjat, mjerr për atë i cili do të bjerrë në te (zjarrin) »

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s vazhdoi të lutej, lexoj me tërë përkushtim vet lutje, dhe të qajë mallëngjyeshëm, dhe pas kësaj, sërish ra në sexhde, ndërsa Ebu Derda lidhur me këtë thotë :» U afrova tek Aliu, ndërsa ai ishte bërë si dru i ngujuar... Atëherë i thirra as-habët tonë, të cilët e didhin gjendjen e tij të këtitillë. Ata morrën ujë dhe e lëshuan mbi kokën e Imam Aliut a.s. Atëherë Imami a.s u zgjua, erdhi në vete, kurse unë e pyeta :» Çfarë je duke bërë kështu me vetveten » ?- ndërsa Aliu m'u përgjigj :» O Ebu Derda si mendon, çfarë do të bëhet kur do të thirrem para gjykimit të Zotit, kur do t'më pranojnë melaqet e rënda dhe të forta, kurse unë do të qëndrojë përpara All-llahut,

Krijuesit të Madhëruar, pasiqë të më kenë përcjellur nga kjo botë për në ahiret. Atëherë, vështirë është t'a fitosh mëshirën e Atij i Cili i din të gjitha fshehtësitë. » Ebu Derda, vazhdon të rrëfejë edhe më tej dhe thotë:» Beto hem në emrin e All-llahut xh.sh se asnjëherë nuk kam parë asnjë nga as-habët e tjerë të Pejgamberit s.a.v.s në një gjendje të tillë, siç ishte Aliu. » (20)

- Hazreti Fatimeja gjendjen e Imam Aliut a.s e ka përshkruar me këto fjalë:» Kjo ishte frika që ai e kishte prej All-llahut xh.sh. »

- Nauf El-Bikali transmeton:» Një natë fjeta tek Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s dhe e pashë se si u çua nga shtrati, e drejtoi shikimin nga yjet dhe më tha:» O Neuf, a flen apo je i zgjuar ? » I zgjuar jam »- iu përgjigja. Atëherë më tha:» O Neuf, lum për ata që largohen nga kjo botë dhe gjakojnë për botën tjetër-ahiretin. Këto janë njerëzit që botën e mbajnë të ekuilibruar, pluhurin e saj e kanë shtroje dhe ujin pasurin ëmë të çmuar të saj. Kur'anin e lexojnë me zë të ulët, ndërsa lutjet me zë të lartë. Përveç kësaj, ata kalojnë (jetojnë) në këtë botë sikur Isa a.s. » Neufi thotë:» Imam Aliu a.s ishte në lidhje të thellë me All-llahun xh.sh, duke ndjekur gjurmët e Pejgamberëve të Zotit, ai në ibadetin (adhurimin) e tij sihre njësoj siku Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s ndërsa sa i përket thjeshtësisë, përkatësisht modëstisë ishte sikur Isa a.s i biri i Merjemes. » (21)

- Imam Aliu a.s e ka falur namazin e natës gjatë gjitha jetës së tij ndërsa Ebu Ja'la në « Musnedin » e tij transmeton se Imam Aliu a.s ka thënë:» Kurrë në jetën time nuk e kam lënë pa e falur namzin e natës, që atëherë kur Pejgamberi-Selami i All-llahut qoftë gjithnjë mbi te dhe pasardhësit e tij! më pat thënë se namzi i natës është dritë. » Ibn El-Kava e pyeti:» Edhe gjatë kohës së luftës nuk e ke lënë namazin e natës ? »- Imam Aliu a.s u përgjigj :» Po, as gjatë kohës së luftës nuk e kam lënë pa e e falur. » (22)

## **TAKVALLËKU (DEVOTSHMËRIA) DHE IBADETI I I FALËNDERUESIT**

- Mbi të dhënurit e Imam Aliut a.s ndaj Zotit dhe devotshmërinë e tij, shkruan në « Tefsirin » e tij dijetari El-Kajsheri:» Kur afrohej koha e namazit, Imam Aliu a.s e ndryshonte ngjyrën e fytyrës dhe fillonte të dridhej, ndërsa kur e pyetnin në lidhje me këtë, Imam Aliu a.s përgjigjej:

« Tani ka ardhur koha e amanetit, ngase All-llahu i Madhëruar ua kishte afuar (amanetin) qiejve dhe tokës që ta pranojnë kurse ata e kishin refuzuar, ndërsa njeriu përkundër dobësive të veta e pranoi-amanetin, ndaj nuk e di nëse e kam mbajtur mirë apo keq amanetin.» (23)

- Sulejman ibn Mugireja transmeton nga nëna e tij, e cila transmeton nga Ummu Saidi, mbi namazin e Imam Aliut a.s gjatë muajit të ramazanit:» Imam Aliu a.s në muajin e ramazanit si dhe në atë të shev-valit, falej gjatë gjithë natës. » (24)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e çmonte All-llahun e tij të Madhëruar, kështuqë ibadeti i tij u shndërrua në ndjenjë të dashurisë dhe respektimit ndaj All-llahut të Madhërishëm, e ja ndaj dikuj tjetër.

- Kështuqë Imam Aliu a.s nuk e luste All-llahun xh.sh për shkak të frikës ndaj Tij dhe dënimit të tij, as që falej duke e aspiruar xhennetin, e as për diç tjetër që All-llahu i Madhëruar ua kishte premtuar besimtarëve të Tij, por këtë thjesht e bënte për shkak të përkushtimit ndaj Tij. Lidhja e Imam Aliut a.s ndaj All-llahut xh.sh ishte e lartësuar dhe qëndronte në një shkallë të lartë gati sikur ajo e mësuesit të tij jetësor-Pejgamberit

Muhammedit s.a.v.s. Vetë Imam Aliu a.s e zbuloi cakun e lidhjes së tij me All-llahun duke thënë :» O All-llah! Nuk të kam shërbyer për shkak të frikës dhe dënimit Tënd, e as duke e aspiruar shpërblimin Tënd, por të kam shërbyer për shkak të Madhërisë Tënde dhe Madhështisë Absolute që ke. » (25) Pikërisht besimi më i denjë dhe i papërsëritshëm është ky që u pohua nga vetë goja e Imamit Fisnik a.s.

- Imam Aliu a.s sipas sjelljes së njerëzve i përcaktoi llojet e ibadetit në këtë mënyrë:» Vërtetë disa njerëz i shërbejnë All-llahut duke aspiruar shpërblimin e Tij. Ky është shërbimi i tregtarit! Disa njerëz i shërbejnë All-llahut shkak të frikës. Ky është shërbimi i robërve. Ndërsa disa njerëz i shërbejnë All-llahut xh.sh për hir të falënderimit. Ky është shërbimi i të lirëve.

- Ibadeti i tij a.s ishte rezultat i ndjenjave se i shërben All-llahut xh.sh ngase vërtetë vetëm Ai- All-llahu i Madhëruar e meriton një adhurim të këtillë. Ndërsa sikur ibadeti të bëhej për t'u fituar sevapi (shpërblimi); atëherë kjo do të ishte punë tregëtie; dhe këtu për ibadetin kërkohet çmim dhe shpërblim... Ndërsa dallimi është i madh në mes të synimit të falënderimit dhe lavdërimit të All-llahut xh.sh dhe tregtarit kur vëhen në peshoren e Zotit.

- Namazi të cilin e kryente Imam Aliu a.s ishte pjesë e ibadetit të tij të madh dhe në mënyrën se si atë e kryente Pejgamberi s.a.v.s dhe e përmendte vetë All-llahun xh.sh.

- Mutrafi biri i Abdull-llahut rrëfen:» Isha duke u falur me Umran ibn Husejnin mbas Ali ibn Ebu Talibit a.s. Dhe kur e përfundua namazin, Umrani më kapi për dore dhe më tha:» Aliu e fali namazin ashtu siç e falte Pejgamberi s.a.v.s »- dhe atëherë vërtet edhe unë u kujtova se si Pejgamberi s.a.v.s e kryente namazin e tij. »

- Imam Aliu a.s insistonte në kryerjen e obligimeve, e kjo ishte namazi i përditshëm, duke ua rekomanduar shokëve të vet dhe ithtarëve të tij faljen e namazit në kohë, duke ju thënë:»

« Obligojeni veten me namaz dhe qëndroni të vendosur në të (namaz) duke e ruajtur atë. Praktikojeni atë sa më shumë që të jetë e mundur dhe kërkoni afri përmes tij, meqë « besimtarët janë porositur që ta praktikojnë atë « namazin » në kohë të caktuar. » (En-Nisaë, 103)

- A nuk keni dëgjuar për përgjigjen e banorëve të Xhehennemit kur u pyetnë:  
« Cka ju solli juve në Sekar (zjarrin e tmershëm) » ?!

Ata thanë:» Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz) » (El-Muddeththir, 42,43)

- Të faurit (namazi) vërtet bën që mëkatet të bijnë sikur rënia e gjetheve dhe i heq siç hiqet litari nga qafët e bagëtisë. Pejgamberi i All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- e krahasonte atë me banjo të nxehtë pranë derës së një personi i cili në të pastrohet pesë herë në gjatë ditës dhe natës. Vallë do të mbetet në te pas kësaj ndonjë ndytësirë ?!

- Obligimet e namazit e pranojnë ata besimtarë të cilët as stolitë e pasurisë, as përvuajtësia e syve për shkak të fëmijëve dhe begative nuk mund t'i largojnë nga ai. All-llahu i Madhëruar thotë:

« Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur All-llahun, për ta falur namazin dh për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet. » (En-Nurë, 37)

- Madje edhe pai e kishte marrë lajmin e gëzuar se i ishte siguruar Xhenneti, Pejgamberi i Zotit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!-këputej duke u falur në harmoni me urdhërin e Zotit të Madhëruar:» Urdhëro familjen tënde të

falë namazë, dhe ti vetë zbatoje atë, ngase Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet. » (Ta-Ha, 132)

- Prandaj, ai (Pejgamberi, vërejt e përkth) e urdhëronte familjen e tij ta kryejë namazin dhe vetë ishte i vendosur në këtë... » (26)
- Imam Muhammed El-Bekiri a.s në lidhje me ibadetin e Imam Aliut a.s thotë:» Sikur Imam Aliu a.s të ballafaqohej me dy mundësi në Rrugën e All-llahut, ai-a.s çdo herë do të zgjidhte mundësinë fizike më të rëndë për te. » (27)
- Imam Aliu a.s thotë:» Çdo herë jam përpjekur që shpirtin tim ta mësoj në atë shkallë të ndërjegjes ndaj All-llahut xh.sh, kështuqë në Ditën e frikësimit (Gjykimit) më të madh, shpirti im të ishte plotësisht i qetë. »
- Denar ibn Damra e përshkroi personalitetin e Imam Aliut a.s tek Muaviju, me këto fjalë:» Betohe në All-llahun se agjëronte tërë ditën, dhe falej gjatë gjithë natës.»
- Imam Aliu a.s kështu e ka përshkruar takvallëkun-devotshëmrinë:» Dijeni, o robër të All-llahut se takvallëku është vetëdija për ekzistimin e All-llahut xh.sh, shtëpi e mbrojtjes, ndërsa harresa është shtëpia e dobët, e cila nuk mund t'i mbrojë fëmijët e saj dhe nuk i jep siguri atij që në te kërkon mbrojtje. Dijeni se therra e gjynahut ta nxjerr vetëdijen mbi Zotin dhe se caku përfundimtar arrihet nëpërmjet dëshmisë së besimit. »

## **MODESTIA E IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S**

- Modestia e Imam Aliut a.s është njëra ndër karakteristikat më kryesore të personalitetit të tij. ky është një zbukurim që All-llahu ia dhuroi Imam Aliut a.s. Amar ibn Jasiri, njëri ndër as-habët më të ngushtë të Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s, transmetonse Pejgamberi s.a.v.s i ka thënë Imam Aliut a.s:» All-llahu xh.sh ty o Ali të ka zbukuruar me një zbukurim që asnjëherë askënd nga robërit e tij nuk e ka zbukuruar, ndërsa zbukurim më të mirë se ky nuk ka, e kjo është mirësia dhe modestia në këtë botë pët të cilat nuk turpërohesh, e as që kjo botë ty të turpërohet. All-llahu xh.sh të dhuroi dashuri ndaj të varfërve dhe të dobtëve, që me ato të jeshë i kënaqur si pasardhës kurse ato me ty si Imam. » (28)
- Imam Aliu a.s ishte tejet modest në këtë botë, qoftë ajo në paratë, pushtetin, harxhimin, veshmbathjen etj. Jetonte në një shtëpi të thjeshtë, ngjashëm me ato shtëpi të cilët i posedonin njerëzit e varfër, hante sa më thjeshtë që mundej dhe gjithnjë të njëjtin ushqim edhe pse ishte halif dhe me vetë këtë post e posedonte gjithë pasurinë e muslimanëve në duart e tij. Shkaku që jetonte thjeshtë qëndronte në atë, se ai-a.s vetë konsideronte se Imami duhet të jetë shembull si për të varfërit ashtu edhe për të pasurit. Gjithë jetën e tij e jetoi në mënyrën më modeste bashkë me familjen e tij, kështuqë edhe kur u zgjodh për halif dhe kishte mundësitë të jetojë në pallatin të cilin të gjithë ia ofruan në qytetin e Kufes. (29), ai këtë e refuzoi.
- Lidhur me modestinë e Aliut a.s, Imam Xhafer Es-Sadiku a.s transmeton:» Emirul-Muëminini, Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte i afërt për nga karakteri me Pejgamberin-Muhammedin s.a.v.s, dinte të hajë bukë të thatë, uthëll dhe vaj, si dhe bukë të thjeshtë me mish dhe mjaltë. » (30)
- Ndërsa Imam Muhammed El-Bakiri a.s në lidhje me këtë thotë:» Imam Aliu a.s e udhëhoqi pesë vjet, e nuk vuri asnjë tullë përmbi tullë (d.m.th, nuk ndërtoi asgjë), nuk u dha të vetëve (të afërmëve) asnjëfarë dhurate, e as që la mbas vete diç të bardhë apo të verdhë, d.m.th as ar as argjend. » (31)



- Halifi Omer ibn Abdulazizi transmeton:» Kurrë nuk kemi dëgjuar për ndonjë njeri në mesin e këtij ummeti të jetë aq modest sikur që ishte Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s, përveç Imam Aliut a.s, i cili kur nuk vuri tullë përmbi tullë (d.m.th nuk ndërroi asgjë) e as që vuri ndonjë kashtë përmbi kashtë. » (32)

- Ahnaf ibn Kajsi për ata të cilët silleshin ndryshe nga Aliu a.s transmeton:» Kur isha tek Muaviju, më ofroi për të ngrënë diç të ëmbël dhe të tharrët si dhe disa lloje të ushqimeve të ndryshme të cilat për mua ishin të panjohura , dhe kur e pyeta se çfarë janë këto, Muaviju m'u drejtua:» Këto janë rosa të mbushura me trurë , shqindë\* dhe sherbet »

- Atëherë fillova të qajë, kurse Muaviju më pyeti se për çfarë qajë, andaj i thashë:» All-llahu e bekoftë birin e Ebu Talibit, ai për veten e tij e punon atë që askush nuk e ka dëgjuar. » Muaviju më pyeti:» Çfarë ? »- kurse unë i thashë:» Njëherë isha tek Imam Aliu a.s gjatë kohës së iftarit, ndaj edhe më ftoi që të hamë bashkë iftar me Hasanin dhe Husejnin, ndërsa ai shkoi për t'u falur. Kur e përfundoi namazin, morri prej thesit pak thekër\* e përziu me ujë dhe kështu hëngrën iftar, dhe më pas e mbylli fort thesin, ndaj edhe i thashë:» Nuk të njohim për dorështrënguar, por shumë fort e mbylle thesin. » Imam Aliu a.s m'u përgjigj:» Nuk është ashtu siç mendon, por kam frikë që fëmijët e mi Hasani dhe Husejni mos ta përziejnë atë me vaj apo gjalpë. » Kjo a është e ndalur » e pyeta, Imam Aliu a.s m'u përgjigj:

« Jo, por udhëheqësit e të drejtës (Imamët) duhet që vetveten e tyre ta bëjnë sa më modest në të ushqyerit dhe që ndërmjet tyre të mos ketë asnjëfarrë dallimi, kështuqë kur t'i shohin të varfërit, atëherë do të jenë të kënaqur ndaj All-llahut me atë që e posedojnë, ndërsa kur do t'i shohin të pasurit, ata para All-llahut do të jenë modest dhe falënderues. » (33)

- Suajd ibn Gafla, vazhdon për modestinë e Imam Aliut a.s dhe thotë:» Kur njëherë isha tek Imam Aliu a.s në Kufe, e pashë tek hante për darkë një copë bukë thekri të zezë e të fortë dhe një gotë me dhalltë. Më erdhi keq kur e pashë në këtë gjendje, ndaj edhe e luta shërbetoren e tij që të jetë e dëgjueshme dhe ta shkoj miellin nëpër sitë, d.m.th ta sitë, kurse ajo mu përgjigj:» Kurrë nuk jemi mësuar që ta sitim miellin. » Imam Aliu a.s atëherë shtoi:» Dije o Suajd! Familja e Pejgamberit-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe familjen e tij gjithnjë!- ka qenë e urrijtur për tri ditë rresht dhe prapë kurrë nuk kemi shkajtur miell nëpër sitë. »

- Sufjan Eth-Thevriju transmeton nga Amri, biri i Kajsit, si vijon:» E kanë parë Ali ibn Ebu Talibin të veshur me rroba të arnuara, ndaj edhe e kanë përgojuar. Athëreë Imam Aliu a.s është përgjigjur:

« Zemra e njeriut atëbotë do të jetë e pikëlluar, por besimtarët do të jenë të kënaqur, kurse unë do të jem shembull për ta. »

- Ebu Hamid El-Gazali, filizofi i njohur musliman, në veprën e tij »El-Ihja... » thotë:» Imam Aliu a.s kurrë nuk ka huazuar asgjë nga « Bejtul-Mali » (pasuria shtetërore), dhe kur me të vërtetë i nevojitej ndonjë gjë, ai atëherë e shiste shpatën e tij. Kur Imam Aliu a.s e arronte xhubenë e vet, duhej ta priste arnimin e saj ngase nuk kishte tjetër për të veshur. » (34)

- I tillë ishte Imam Aliu në jetën e tij, përplotë me modesti, larg nga zbukurimet e kësaj bote dhe kurthat e kësaj bote të kalushme. Ishte i njëjtë në qëndrimin e tij sikur që ishte Pejgamberi s.a.v.s dhe gjithashtu ishte i njëjtë sikur Pejgamberi s.a.v.s në raport me të varfërit dhe të dobët të ummetit të tij.

- A njeh apo a përmend historia edhe ndonjë njeri tjetër (përveç Imam Aliut, vërejt e përkth) i cili i fitonte të hollat si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi, që

jetonte në qytetin e Kufes, në pjesën më të pasur të botës islame, ndërsa vetë ishte simbol i asaj që quhej-MODESTI ?

- Përgjigjen në këtë pyetje si dhe shpjegimin për qëndrimin e tij ndaj pasurisë, vetë Imam Aliu a.s e jep nëpërmjet këtyre fjalëve:» Beto hem në All-llahun se nuk kam grumbulluar asnjëfarë ari nga kjo botë, e as që kam tubuar ndonjë pasuri të saj, e as që grumbulluar tesha të tjera përveç këtyre që i kam shtrënguar në kollanin, e as që kam marrë ndonjë copë toke të saj, e as që kam marrë nga kjo botë diçka tjetër më tepër se ajo që e përtyp gomari me këmbë të shtrembërta. Kjo botë në sytë e mi është më e pavlerë se sa teshja e dhisë ».

- rosë-Anas-lat, vërejt e përkth
- shqindë-Pistacia lentiscus, vërejt e përkth
- thekër- Secale cereale-lat, vërejt e përkth

## MËSHIRA E IMAM ALIUT A.S

- Mëshira e Imam Aliut a.s është treguar peaktikisht nëpërmjet sadakasë e cila është lavdëruar edhe në ajetet e Kur'anit të Madhnueshëm me lavdërimin më të bukur. E gjithë kjo më së miri na e pasqyron vlerën e tij që e kishte tek shpërblimi i All-llahut xh.sh të cilën vlerë vetëm All-llahu mund ta çmojë. Ky shpërblim (sevap) të cilin All-llahu xh.sh ia ka premtuar robit të tij Emirul-muëmininit, shihet edhe nëpërmjet këtyre ajeteve:

« Ato janë që për hir të Tij (All-llahut) u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit të) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po All-llahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me xhennet dhe me tesha mëndafshi. » (El-Insan, 8-12)

- Shumë historianë përcjellin se sipas terfsirëve të një numri të madh të dijetarëve islam, këto ajete kanë zbritur për Imam Aliun a.s dhe familjen e tij, ngase ata i ushqenin të varfërit, jetimët, skamnorët, dhe të përvuajturit. Gjatë kohës së agjëritit ndodhte që nga tri ditë të mbeteshin pa ushqim. (35) Nuk ishte me rëndësi se sa u jipej atyre njerëzve, e rëndësishme ishte që ajo pjesë e ndarë, d.m.th sadakaja shkonte drejt synimit, përkatësisht qëllimit përfundimtar, arritjes së vëmendjessë Zotit, e jo për shkak të ndonjë shkakut a shpërblimi të kësaj bote. E këtillë ishte edhe sadakaja e tij a.s gjatë kryerjes së namazit të tij, kur e nxorri unazën prej gishtit dhe e dha për sadaka, lidhur me këtë ngjarje, zbritën edhe këto ajete kur'anore të Sures El-Maide, 55-56, ku thuhet: « Mik (i afërt) juaji është vetëm All-llahu, është i Dërguari i Tij dhe ata që besuan e që (e) falin namazin dhe japin zeqatin duke bërë rukuë (duke qenë respektues). E kush ka për mik All-llahun, të Dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s'ka dyshim ana (pala-krahu) e All-llahut është ngadhënjyese. »

- Nga këto ajete të mësipërme, mund të shohim qartë se mirësia është e rëndësishme tek All-llahu xh.sh, pa marrë parasysh sasinë. Nuk është me rëndësi se sa do të japish, por e rëndësishme është që ajo vepër e mirë të jetë në emër të arritjes së kënaqësisë së All-llahut dhe kënaqësisë së Rrugës së Tij.

- Imam Xhaffer Es-Sadiku a.s përmend:» Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s punonte palodhshëm, e rrëmihte tokën me qëllim të fitim të parave, kurse ai nga vetë puna e tij liroi më tepër se njëmijë robër. » (36)
- Ejjub ibn Atije El-Hiza, përcjell nga Xhaffer Es-Sadiku a.s se ka thënë:» I Lartësuar, Pejgamberi i All-llahut xh.sh Muhammedi s.a.v.s ua ndante tokën muslimanëve, kështuqë edhe Imam Aliu a.s e fitonte hisen e tij. kur e morri tokën, Imami e hapi një pus nga ku dilte ujë, ndaj Imam Aliu a.s atëherë tha:» Ky pus do të jetë sadaka për kalimtarët dhe haxhinjtë, dhe nuk është as për shitje e as për trashëgimi. Ndërsa ai që e shet apo e dhuron këtë pus, le ta mbërrijë mallkimi i All-llahut, mallkimi i melaqeve të Zotit dhe i të gjithë njerëzve. » (34)
- Imam Ahmed ibn Hanbeli në veprën e tij « El-Fadail » transmeton:» Kur Imam Aliu a.s kishte në posedim njëmijë denarë ai atëherë jepte sadaka. » (38)
- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte dorëdhënës për ummetin e tij më shumë se sa që shiu lëshon pika uji, gjithashtu i pakufizuar ashtu siç ishte i pakufizuar edhe përkushtimi i tij ndaj All-llahut xh.sh për hir të ruajtjes së pejgamberllëkut dhe rrëgëtimit historik të Islamit, duke ua shtuar gjithë këyre edhe heroizmin dhe trimërinë e tij të pashoqe të treguar në të gjitha betejat që i zhvilloi për Rrugën e Islamit. Mëshirën, përkatësisht dorëdhënien e tij a.s e pranonin edhe kundërshtarët e tij më të rrept, siç ishte fjala vjen Muaviju biri i Ebu Sufjanit, i cili një kohë tepër të gjatë thurri komplete dhe shkaktoi trazira (fitne) kundër Imam Aliut a.s, i cili megjithatë i pranoi cilësitë e Imamit a.s dhe dorëdhënien e tij a.s, kur i erdhi Muhfi El-Dabiju, duke iu drejtuar me ironi:» Po vij nga njeriu më i lumtur Aliu biri i Ebu Talibit » Muaviju atëherë iu drejtua : » Çfarë po flet kështu ?! Sikur Aliu të kishte shtëpi prej arit dhe shtëpi prej kashte, jam i bindur se më parë ai do ta ndante arin se sa kashtën. » (39)
- Dijetari Esh-Shabiu duke e përshkruajtur karakterin e Imam Aliut a.s thotë:» Ishte më dorëdhënësi (më i mëshirshmi) në mesin e njerëzve. Ai ishte një karakter që All-llahu xh.she e dëshironte, dorëdhënës dhe mirëbërës, ngase kurrë nuk ka bërë vaki që dikush prej tij të kërkojë ndihmë, e ai të mos i ketë ndihmuar. » (40)

## **XHIHADI NË RRUGËN E ALL-LLAHUT XH.SH**

- Jeta e Imam Aliut a.s është e karakterizuar me veçimin e tij në xhihad në rrugën të All-llahut xh.sh që nga fillimi i misionit të pejgamberllëkut të Muhammedit s.a.v.s e gjer në formimin e shtetit islam. Në fillim u sakrifikua duke u shtrirë në shtratin e Pejgamberit s.a.v.s në natën e bekuar të Hixhretit me qëllim të vënies në kurthë të gjakpirësve të xhahilijetit. Pas Hixhretit, në Medine Imam Aliu a.s u bë simbol i xhihadit dhe heroizmit kurdo qoftë dhe kudo qoftë në luftë kundër mushrikëve. Roli i tij në luftë ishte sigurimi i fitores, duke e mbrojtur kështu pejgamberllëkun prej rrezikut i cili i kanosej fesë së re Islame. Në luftën e Uhudit dhe atë të Ahzabit, Imam Aliu a. s i ktheu shpresat në fitore, kur e mbyti luftëtarin më të madh kundërshtar të asaj kohe, Amr ibn Abid Ved El-Amiriun. Në luftën e Hajberit vetë i ngriti dhe i hapi portat e kështjellës më të madhe. Kështuqë për Imam Aliun a.s dhe xhihadin e tij është shënuar se ai është « fotografia » e kthjellët e cila pasqyron dhe ndriçon nderin, dinjitetin, madhështinë dhe besimin-imanin e thellë. Për shkak të gjithë kësaj Kur'ani i Madhërueshëm e lavdëron shpirtin e tillë të Emirul-Muëminininit Ali ibn Ebu talibit a.s

i cili luftoi dhe u pëtrpoq që fjala e All-llahu të jetë më e lartësuar në sipërfaqe të dheut.

- Kur'anin i Madhërueshëm e lavdëroi Imam Ali ibn Ebu Talibin a.s në ditën kur Imam Aliu a.s e propozoi veten e tij (e dorëzoi, flijoj, sakrifikoi, vërejt e përkth) për sakrificë në vend të Pëjgamberit, Muhammedit s.a.v.s. Në Kur'anin e Madhërueshëm thuhet:

« Ka nga njerëzit, i cili për hirë të All-llahut flijon vetveten, e edhe All-llahu është shumë i mëshirshëm për robët e vet. » (El-Bekaretu, 207)

- Këhtu All-llahu xh.sh në Kur'anin e Tij të Madhërueshëm e vërtetoi se sakrifica e Imam Aliut a.s si dhe heroizmi i tij-xihadi për lartësimin e fjalës së All-llahut në faqen e dheut, si aktin më të madh, dhe nuk pranoi që cilado qoftë tjetër vepër e mirë është më e çmuar se sa xihadi, ngase çmimi i sakrificës së Tij-Imamit a.s në rrugën e All-llahut është tepër madhore, përkatësisht madhështore.

- Nga ajeti që pason në vijim, shohim pozitën e Imam Aliut a.s:

« A mos e konsideruat dhënien e ujit haxhinjëve dhe kujdëstarinë ndaj xhamisë së shenjtë, (njësoj) si besimin e atij që i besoi All-llahut dhe Ditës së Fundit dhe që luftoi në rrugën e All-llahut ? Jo, ato nuk janë të barabarta te All-llahu (ndërsa) Popullin mizor All-llahu nuk e vë në rrugë te drejtë. » ( Et-Tevbe, 19)

- Ky ajet zbriti pas një diskutimi në mes Talha ibn Shibasë dhe Abbasit birit të Abdul-Mutalibit, kur Talha tha:» Unë jam përgjegjës për xhaminë e lartësuar, ngase çelësat e saj janë në duart e mia, ndërsa Abbasi iu përgjigj:» Unë jam më përgjegjësi, ngase unë haxhinjtë i furnizojë me ujë.» Me këtë rast kaloi Imam Aliu a.s dhe me krenari u tha të dyve:» Unë All-llahut xh.sh i jam falur para të gjithë njerëzve, dhe unë jam i pari i cili ka bërë xihad në rrugë e All-llahut xh.sh » (42)

## **DREJTËSIA E IMAM ALIUT A.S**

- Ndjekësi besnik i jetës së Imam Aliut a.s mundet që logjikisht ta analizojë përshkrimin e Imam Aliut a.s që i bëri nga ana e tij Derar ibn Damra, kur ky i fundit, pra Derari ishte i pranishëm tek Muavijju-i cili e pranoi postin e halifit pas dorëheqjes së Imam Hasanit a.s.

- Muavijju insisonte që Derari ta përshkruaj karaktertin e Imam Aliut a.s por Derari refuzonte. Muavijju pandërprer e luste dhe insistonte me të madhe. Derari lëshoi pe, dhe pasi e lavdëdoi dhe falënderoi All-llahun xh.sh tha:

« Ishte njeri që kishte vizion për të ardhmen, me ndenja vitale, me fjalime të jashtëzakonshme (elokuente) dhe gjykonte drejt pa i hyrë në hak askujt. Dituria buronte prej tij nga të gjitha anët, ndërsa urtësia e fjalëve të tij gjendej në dhënien e këshillave të Zotit, ndjehej i vetmaur në këtë botë, i braktisi të gjitha stolitë e kësaj bote ndjehej në gjithë tepër i gëzuar jur binte terri d.m.th nata sepse drejtohej ai atëherë i drejtohej All-llahut xh.sh. Beto hem në All-llahun xh.sh, se kur e përmendte All-llahun All-llahun ai qante e qante qetë, shumë mendonte, tepër lexonte lutje (dua), gjithnjë mbante veshur tesha të lira ndërs edhe në ushqim gjatë ngrënies ishte modest.

- Ishte sikur dikush nga ne, kur e pyesnin për diçka ai atëherë na përgjigjej, ndërsa kur shkonim tek ai, i pari e fillonte bisedën, ndërsa tek ne vinte vetëm kur e thërrisnim.

- Betohe në All-llahun se ai ishte një person i thjeshtë (modest), sa herë që ai ishte afër nesh, aq edhe ne ishim afër tij, kurse kur qeshte, qeshte qetë, ndërsa dhëmbët e tij të përparmë i kishte sikur margaritarë.
- I lavdëronte dijetarët, i çmonte mësuesit, i donte të varfërit, dhe gjithë këtë e bënte për hir të dashurisë që kishte ndaj All-llahut xh.sh ngase edhe vetë ishte besimtar i devotshëm.
- Dëshmoj në emët të All-llahut xh.sh se e kam parë disa netë, kur lëshohej terri dhe paraqiteshin yjet në horizontin qiellor, se si rrinte në mihrab (vendin ku falet namazi, vërejt e përkth) duke e mbajtur me dorë mjekrrën e tij, duke u dridhur (përpëlitur) sikur njeriu që e kafshon gjarpëri dhe duke qarë zëshëm ashtu me një të qarë tejet mallëngjyese, dhe më pas thoshte:  
« Oj botë! Oj Botë! Largohu, ik nga unë! Më vjen mua apo ke aspirata ndaj meje ? Nuk do të keshë shansë, mashtroje dikënd tjetër! Nuk më interesojshtë aspak! Jam ndarë (shkukorrëzuar) me ty tri herë, pas së cilës më nuk ka kthim në gjendjen e më parshme. Jeta jote është e shkurtër, vlera jote është e vogël ndërsa shpresa jote është e pavlerë. Ah! Sa i vogël është furnizimi, rruga e gjatë, udhëtimi i largët, vendcaktimi i rëndë që të mund të arrihej... »
- Një përshkrim i tillë në këtë botë tregon personalitetin e fortë të Imam Aliut a.s qoftë kjo në aspektin shpirtëror, shoqëror si dhe në atë në raport me Krijuesin e Madhëruar; me vetveten si dhe në raport përkatësisht në lidhje me njerëzit që rreth tij. Një lidhje e tillë e Imam Aliut a.s me ummetin e tij gjatë kohës së pushtetit të tij, na e tregon neve qartë mendjen e shëndoshë në personalitetin madhështor, ngase nëpërmjet këtyre ai arriti gjër tek maja e veçorive të jashtëzakonshme dhe përsosshmërisë, pa marrë parasysh se sundonte dhe e udhëhiqte botën islme dhe dinte në mënyrën më briljante t'i zgjidhë problematikat e tyre politike dhe shoqërore. E shohim se si silltet, sikur të jetë njëri prej tyre dhe sikur të mos jetë në rolin e udhëheqës.
- Silltet sikur baba i mëshirshëm, me shpirt të thjeshtë; i sinqertë/çiltër dhe përplot me dashuri. Këso shpirti ummeti islam nuk ka parë përveç tek figura markante e të Dërguarit të All-llahut xh.sh-Muhammedi s.a.v.s dhe pasardhësi-trashëgimtari i tij Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s.
- Po ta kërkojmë karakterin dhe personalitetin e të Dërguarit të All-llahut xh.sh-Muhammedit s.a.v.s si shembull në mbarë botën e ummetit islam, do të vërejmë se rruga e tyre është identike gati e njëjtë, madje edhe përvojat, pa marrë parasysh ndryshimin e pozitës ndërmjet nocioinit Pejgamber dhe atij Imamit.
- Sa'sa'a bin Suhani transmeton për Imam Aliun a.s si vijon:» Ishte në mesin tonë sikur secili prej nesh, i këndshëm përplot me modesti, udhëheqës i rëndomtë, e respektonim dhe i frikësoheshim. » (43)
- Përsosshmëria e karakterit të Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s shihet nëpërmjet disa qëndrimeve dhe parimeve parësore të tij, e që kryesisht mund të përmbledhen me fjalinë:

## PËRHAPJA E DREJTËSISË SHOQËRORE NË MESIN E NJERËZVE.

- Imam Aliu a.s hilafetin islam e pranoi në situatën dhe kohën më të keqe e më të komplikuar, ngase njerëzit nuk ishin të mësuar me situatën e re të posakrijuar, në të cilën Imam Aliu a.s gjithnjë me të madhe insistonte. Pushtetin lakmitar që atëherë sundonte ishte e vështirë ta pajtosh me realitetin, pasi që hilafetin ata e kishin shndërruar në pasurim e jo përgjegjësi për mbrojtjen dhe ruajtjen e Sheriatit dhe ummetit. Imam

Aliu a.s ishte tejet i vetëdijshtëm rreth këtij qëndrimi si dhe pasojave që rezultojnë nga një konceptim i tillë i gjërave. Nisur pikërisht nga kjo, Imami a.s refuzoi marrëjen e postit udhëheqës të hilafetit islam pas vrasjes së halifit Osman, duke u shprehur:» Më leni mua dhe kërkoni një tjetër. Po ballafaqohemi me çështjen e cila posedon fytyra dhe ngjyra, të cilën asnjë zemër nuk mund ta përballojë dhe asnjë mendje nuk mund ta pranojë. Me të vërtetë, horizontet janë mjegulluar, ndërsa Rruga e Vërtetë është humbur... »

- Mirëpo, muslimanët e Medines, Irakut dhe Egjiptit insistonin me të madhe dhe këmbëngulnin që Imam Aliu a.s ta pranojë caktimin e tyre dhe shu^ranë (legjislacionin më të lartë, vërejt e përkth) që e kishte zgjedhur për halif. Atëherë Imam Aliu a.s e pranoi postin e halifit por ama me një kusht të cilin vetë e caktoi:»... Ta dini se, nëse i përgjigjem kërkesës suaj, do t'ju prijë siç di vetë dhe nuk do të dëgjoj çka thotë dhe kritikon dikush... »

- Synimi i Imam Aliut a.s ishte forcimi i drejtësisë shoqërore në mesin e njerzve dhe udhëzimi i muslimanëve në rrugën e drejtë me qëllim të ndërtimit të shoqërisë së drejtë. Për këtë shkak Imam Aliu a.s vendosi një politikë të re financiare të administrimit shoqëror, me të vetmin synim që ta ndërrojë politikën e cila sundonte përpara ardhjes së tij si halif. Politika e re e prirë nga Imam Aliu a.s ishte e njëjtë me politikën të cilën e udhëhoqi Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s. Imam Aliu a.s insistonte në politikën e tij të drejtë në punën e tij ngase ai e dinte se ajo ishte çelësi kryesor për drejtësinë dhe suksesin e mëtutjeshëm: Për këtë qëllim edhe urdhëroi:

- Shkarkimin e të gjithë mëkëmbësve dhe administratorëve të cilët e kishin keqpërdorur pozitën, përkatësisht postin e tij, dhe ishin larguar nga rregullat e Zotit dhe kishin kapërcyer shtegun (kufirin) që All-llahu xh.sh ua kishte përcaktuar robërve të Tij;

- Kthimin e gjithë pasurisë të fituar në mënyrën jolegale (jolegjitime) të cilën Ummejtë e kishin fituar nga Bejtul-Mali (pasuria e muslimanëve, thesari/arka shtetërore);

- Vendosi drejtësinë dhe barazinë në të drejtat dhe ndihmën në të holla të njerzve, pa marrë parasysh ngjyrën e lëkurës, racën, nacionalitetin dhe klasat shoqërore; dhe lirisht kjo mund të konsiderohet përpjekja/forma e parë e barazisë shoqërore. Vetë Imam Aliu a.s në lidhje me këtë është shprehur:»... Madje edhe po të ishte kjo pasuri e imja, do ta ndaja mes tyre, e le më kur kjo është pasuri e All-llahut. Kini mendjen, vërtetë dhënia e pasurisë atij i cili nuk ka të drejtë në këtë është shpenzim i tepërt dhe plangprishje. Kjo ate i cili vepron në këtë mënyrë e ngritë në këtë botë, mirëpo e poshtëron në botën tjetër-ahiret. Kjo e nderon para njerzve, por e ç'nderon para All-llahut... » (44)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte principiell në dhënien/ndarjen e drejtësisë ndaj të gjithë njerzve në të gjitha segmentet dhe ndarjen e detyrave ndaj atyre që e meritonin dhe ishin të zotë për ato obligime që u caktoheshin. Në të njëjtën mënyrë, tamam kësajsoji ndahej drejtësia dhe jepej detyra gjatë kohës së Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s . Që Imam Aliu a.s vërtet i përmbahej kësaj dhe e ndiqte këtë politikë, tregon edhe fjalimi i tij vijues:

« Pasha All-llahun! Më me dëshirë do ta kaloja natën pa gjumë në murrizin e egër me gjemba ose të lidhem me zinxhir si i burgosur, se sa ta takoj Zotin ose Pejgamberin e Tij-Ditën e Gjykimit si tiranizues i cilitdo person ose shpërdorues i ndonjë gjësendi nga Rrahmeti tokësor... »

- ... Për Zotin! Edhe po të mi ofronin të shtatë hapësirat me atë që është në qyejt e tyre për ta braktisur përkushtimin ndaj Zotit me shpërdorimin e vetëm të një kokrre të elbit nga thnegla, këtë nuk do ta bëjë! Për mua kjo botë është më e pavlerë se gjethi që përtypet në gojë të karkalecit. Ç’i nevojitet Aliut pasuria e cila është kalimtare dhe kënaqësia e cila nuk do të zgjasë përjetë?! Të kërkojmë mbrojtjen e Zotit nga plogështia e mendjes dhe prapësia e gabimeve. Nga Ai të presim ndihmë! » (45)
- Njeriu i nënçmuar tek unë është i lartësuar, gjersa atij t’i kthehet e drejta që i është mohuar. »
- Si teorikisht, ashtu edhe praktikisht, Imam Aliu a.s e udhëhiqte procesin e drejtësisë në të gjitha fushat e shtetit islam. Vërtetë Emirul-Muëminini-Aliu a.s mbante veshur tesha të arnuara, kurse madje edhe disa herë pohoi se i vjen turp (turpërohet) ta çojë te qepësi t’ia arnojë. Disa herë e ka shitur shpatën e tij për të blerë ushqim për fëmijët e tij, kurse me pozitën e tij të lartësuar ishte në krye të shtetit të pasur islam... Hante bukë e cila nuk ishte prej miellit të mirë, ndërsa shumica e ngrënies së tij përbëhej prej bukës së thekrrës, dhalltit dhe ujit. Kishte vetëm një këmishë, ndërsa kur e lante, nuk kishte se çka të veshë... (46) Modestia e tij ishte aq e thjeshtë, sa që arin dhe argjendin ua ndante njerëzve. U jepte atyre mish, mjaltë dhe bukë, me qëllim që të varfërit t’i shpëtojë nga uria.
- Kurdoherë dhe kudoqoftë kur arrinte Bejtul-Mali, Imam Aliu a.s nuk hezitonte që menjëherë të fillojë ta ndajë dhe secili e fitonte hisen e tij. Kjo ishte rruga e tij dhe shtegu që ndiqte gjatë ndarjes së pasurisë së muslimanëve.
- Njëherë Imam Aliu a.s iu drejtua Talhasë dhe Zubejrit, kur këta dy lypën më tepër pasuri, me këto fjalë:» Për Zotin, dini se edhe unë edhe shërbetori im jemi në të njëjtën pozitë. » (47)
- Asim ibn Majsami ishte një njeri plak ndaj edhe iu drejtua Imam Aliut a.s për një shumë më të madhe të pasurisë/parave, kurse Imam Aliu a.s iu përgjigj:» Për Zotin, këtë pasuri as që e kam fituar me punën time, e as që e kam trashëguar nga prindërit, por kjo është amanet i All-llahut në duart e mia. » (48)
- Abdull-llah ibn Zam’a-i i cili ishte njëri prej ndjekësve të Imam Aliut a.s, gjatë hilafetit të tij, erdhi për ta pyetur për disa të holla, në të cilën pyetje Imam Aliu a.s iu përgjigj:  
« Kjo pasuri, në të vërtetë nuk është as e imja por as e jotja, por ajo është plaçë luftee fituar nga muslimanët dhe e fituar me anë të shpatave të tyre. Ndaj, nëse merr pjesë në luftë bashk me ta, atëherë të takon hise njësoj sikur qëu takon atyre. Në të kundërtën, fitimi që është bërë me duart e tyre, nuk mund të jetë për të tjerët, d.m.th t’i takojë tjetër kujt pos gojëve të tyre. » (49)
- Amr ibn Asi një natë jozyrtarisht ktheu tek Imam Aliu a.s kur ky gjendej në Bejtul-Mal, dhe Imam Aliu e shuajti flakadanin që e kishte ndezur në dorë. Të dy qëndruan nën rrezet e dritës së hënës dhe vazhduan të bashkëbisedojnë. Ky ishte një rast i rrallë ku qartë shihej edhe në natën më të errët se si Imami a.s tepër kujdesej për muslimanët gjë që e vuri përpara çdo detyrimi tjetër dhe i tëri me gjithë qenien e tij ishte vënë në shërbim të ummetit islam, pa dhanë asnjë shenjë lodhjeje dhe josingëriteti... Nga ky rast shihet se Imami a.s nuk dëshironte që gjatë bisedës private me Amrin, ta harxhojë kandilin që i përkiste shoqërisë islame ngase një gjë të tillë e konsideronte (pra përdorimin e kandilit për bisedë private, vërejt e përkth) thyerje të pasurisë së Zotit dhe hyrje në hak ndaj muslimanëve...

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte kurdoherë i gatshëm t'u ndihmojë të dobtëve dhe t'i mbrojë ata, si dhe të udhëheqë luftë kundër shkeljes së dinjitetit të njeriut dhe vjedhjes së pasurisë, lidhur me këtë është shprehur:» Mos u bëj rob i huaj/tjetërkujt, ngase All-llahu të ka krijuar të lirë. »

« ... Ju e dini se vërtet, ai të cilit i janë besuar nderi, jeta, preja e luftës, dispozitat ligjore dhe udhëheqja e muslimanëve nuk guxon të jetë dorështrënguar, meqë makutëria e tij e orienton drejtë pasurisë së tyre; nuk guxon të jetë as injorant, meqë në atë rast do ta mashtronte me paditurinë e vet; nuk guxon as të punojë padrejtë me pasurinë e vet duke i dhënë përparësi një grupi ndaj një grupi tjetër; nuk guxon as të pranojë mito gjersa sjell vendime, meqë do të shpërdorte të drejtat dhe do t'i mbante pa përfunduar; dhe nuk guxon ta lë pas dore rrugën e Pejgamberit (Sunnetin), meqë do t'i prishte njerëzit. » (50)

- Imam Aliu a.s e mbante detyrën e tij nëpërmjet zbatimit të drejtësisë në botën islame, pa marrë parasysh pozitën e individit, racën dhe ngjyrën. Kjo bile më së miri shihet kur ai-a.s dhe një i krishter ishin në gjyq që gjykatësi të gjykojë, përkatësisht të sjell vendim për një mburojë. Imam Aliu a.s i tha gjykatësit:» Kjo mburojë është e imja, as e kam shitur po as që e kam dhuruar! » Gjykatësi e pyeti të krishterin:» Çfarë thua ti ? » ndërsa i krishteri u përgjigj:

« Kjo mburojë është e imja kurse Imam Aliu a.s gënjen. » Atëherë gjykatësi kërkoi prej Imam Aliut a.s të sjell dëshmitarë; kurse Imam Aliu a.s buzëqeshi qetë, dhe u përgjigj se nuk ka asnjë dëshmitarë; gjë që ndikoi që gjykatësi të jep gjykimin në favor të krishterit, i cili e fitoi mburojën dhe shkoi. Nuk vonoi shumë, pas një kohe fare të shkurtër i krishteri u kthye duke thënë:» Dëshmoj se këto rregulla janë rregulla të Pejgamberit Muhammed, ngase Emirul-Muëminin Ali ibn Ebu Talibi mua më paditi në gjyq që ta kthejë mburojën e vet, dhe më pas i krishteri shtoi:» Për Zotin, kjo mburojë është e jotja, kurse unë kam gënjyer në aktakuzën time. » (51)

- Kjo ngjarje të theksojmë se ndodhi atëherë kur Imam Aliu a.s ishte halif-Emirul-Muëminin (prijës i besimdrejtëve).

## **REKOMANDIMET DHE POROSITË (UDHËZIMET) E IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S DREJTUAR SHOKËVE TË VET**

- Imam Aliu a.s shokëve të tij, udhëheqësve, administratorëve dhe mëkëmbësve u drejtonte rekomandime, udhëzime, dhe shkresa në raste dhe rrethana të ndryshme. Ja, në vijim disa prej fjalimeve dhe udhëzimeve të tij:

« Kush fillon t'i mësojë njerëzit në lidhje me besimin (imanin), së pari le të fillojë ta mësojë vetveten e pastaj të tjerët. Mësimi i vetvetes duhet të filloj nëpërmejt veprave konkrete e më pas nëpërmjet gjuhës. Atij që e udhëzon dhe edukon-mëson vetveten, i takon e drejta më e madhe e të nderuarit se sa atij që i udhëzon dhe mëson të tjerët, kuptohet po e bënë njëherë këtë me vetveten. »

- Porosia e shkruar Malik El-Eshterit, kur e caktoi për mëkëmbës në Egjipt:

« Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbrësit!

- Pastaj, dije o Malik, se po të dërgoj në vendin në të cilin para teje ka pasur administratime edhe të drejta edhe tiranizuese...

- ... Bëhu i drejtë ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve si ndaj vetvetes tënde, ndja familjes tënde dhe atyre nga besimtarëve të tu për të cilët ke simpati, sepse nëse nuk vepron



kështu do të jeshë i padrejtë, ndërsa All-llahu në emër të robërve të Tij, është kundërshtar i atij i cili është i padrejtë ndaj robërve të Zotit...

- ... Le të jetë për ty më e dashur ajo që është më e ekuilibruar në drejtësi, më përfshirëse në drejtësi dhe më e drejtë, ngase kënaqësia e të dhënurit është moskënaqësi e botës dhe njëherit bie kënaqësi për atë që nuk është i dhënë pas kësaj bote. Kurse moskënaqësia e atij që e gjakon këtë botë mund të tejkalohet nëse ekziston kënaqësia e robërve tjerë të thjeshtë. Kështuqë fitimi yt më i këndëshëm-le të jetë vepra e mirë.

- ... Ruaju nga barazimi i Zotit në madhësinë e Tij dhe në qëndrimin e Tij ndaj Fuqisë së Tij, ngase vërtetë All-llahu e nënçmon tiranin dhe e turpëron çdo mendjemadh...

- ... Para teje nuk duhet të jenë të njëjtë ai i cili kryen vepra të mira dhe ai i cili kryen vepra të këqia me të vërtetë, në këtë qëndron largimi i mirëbërësit nga mirëbërësia dhe inkurajimi i kryerësit të veprave të liga për prapësi. Mbaje çdonjërin prej tyre në vendin të cilin e meriton...

- ... Krahas kësaj, lidhur me njerëzit që vijnë nga prejardhja e mirë, shtëpi të ndershme dhe me të kaluar të mirë.

- ... Pastaj lidhur me njerëzit guximtar, bujarë, zemërgjërë dhe bamirës, ngase ata janë pasuria e shenjtë dhe burimi i çdo të mire...

- ... Përkujdesu për jetimët dhe pleqët që nuk kanë asnjë të ardhur, dhe të cilët nuk janë të dhënë pads lypjes. Kjo është një brengë e madhe për sundimtarin; në të vërtetë, e drejta e çdo kujt është e rëndë. All-llahu ua lehtëson njerëzve të cilët e dëshirojnë botën tjetër-ahiretin, ndaj ata janë durimtar dhe besojnë në të vërtetën e premtimeve që All-llahu ua ka premtuar...

- ... Ruaju nga vrasjet dhe gjakderdhjet pa arsyetim, meqë asgjë nuk e shton dënimin e Zotit dhe nuk është më i madh për nga pasojat dhe më i fuqishëm për zhdukjen e mirësive dhe shkurtimit të afatit, siç është gjakderdhja e pajustificueshme. All-llahu i Madhëruar në Ditën e Gjykimit marrjen në pyetje të njerëzve do ta fillojë me rastet e gjakderdhjes që i kan bërë... »

- Këto pjesë të shkëputura nga njëra prej porosive të Imam Aliut a.s janë tejet të bukura dhe madhështore, sa që lirisht mbi parimet e këtyre fjalëve mund të ngritet kushtetuata e shtetit islam...

- Në vazhdim po sjellim porosi që Imam Aliu a.s e kishte zakon t'i shkruajë secilit që e caktonte për ta mbledhur (tubuar) zekatin:

« Nisu në rrugë me përkushtim ndaj All-llahut Një, i Cili nuk ka shok. Kurrë mos ia kall tmerrin muslimanit. Mos iu afro kurrsesi nëse ai këtë nuk e dëshiron. Mos merr nga ai kurrë më tepër seç është e drejta e Zotit nga pasuria e tij. kur të shkosh te ndonjë kabile, qëndro afër puseve të tyre në vend që të futesh në shtëpitë e tyre. Prandaj nisu drejt tyre qetas dhe me dinjitet, gjersa të arrishë në mesin e tyre. Mandej jepju selam dhe mos përto t'i përsëndësish si duhet. Pas kësaj thuaju:» O robët e Zotit, mëkëmbësi i Zotit dhe halifi i Tij më dërgoi te ju për të mbledhur hisen e Zotit nga pasuria juaj. A ka diç nga hisja e Zotit në pasuritë tuaja ? Nëse ka, dorëzojani atë mëkëmbësit të tij! » Nëse ndonjëri të përgjigjet pozitivisht, shko me te. Në ndërkohë mos u kanos, as mos rëndo. Dhe merr nga ari e argjendi atë që të jep. Nëse ka kafshë dhe deve mos iu afro atyre pa lejen e tij, ngase pjesa më e madhe është e tij. Nëse u afrosh, atëherë mos iu afro si dikush që ka pushtet ndaj tyre ose me dhunë. Kurrë mos e frikëso asnjë shtazë, mos e shqetëso dhe mos i bënë ndonjë të keqe pronarit të tyre lidhur me to... » (52)

- Porosia e Imam Aliut a.s dhënë luftëtarëve të tij para ballafaqimit me armikun në luftën e Siffinit: » Mos luftoni gjersa ata të mos fillojnë! Ngase- All-llahut i qofshim falë!- ju vërtet keni të drejtë. Ndërsa fakti që i lejoni atyre të fillojnë luftën do të jetë argument plotësues kundër tyre.

- Kur armiku me vullnetin e Zotit, të mposhtet, mos i vrani ata të cilët sprapsen (ikin), mos i goditni personat e pafuqishëm, mos i ekzekutoni të plagosurit dhe mos i bezdisni femrat nëse ato atakojnë nderin tuaj dhe fyejnë prijësat tuaj, ngase ato janë të dobëta për nga fuqia, karakteri dhe mendja. Ne jemi të obliguar të përmbahemi edhe atëherë kur ato (femrat, vërejt e përkth) janë shërbetore të idhujve. Madje edhe në kohën e xhahilijetit, mashkulli i cili e ka goditur femërn me gurë ose shkop ka qenë i përbuzur bashkë me pasardhësit e tij. » (53)

- Këto janë udhëzimet, porositë e Imamit të drejtësisë, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s të dhëna dhe të përmbledhura gjatë historisë. Ky është Imam Aliu a.s i cili kishte një zemër të madhe e cila i përfshinte të gjithë njerëzit të cilëve u afronte drejtësi, dhe të cilëve ua mbjellte ndjenjën e krenarisë, njerëzisë, duke ju dhënë paqe dhe siguri në shoqëritë e barabarta,

DREJTËSI dhe JETË DINJITOZE.

## **ZEMËRGJËRËSIA E IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S**

- All-llahu xh.sh e bëri që modestia të jetë një llojë ibadeti të cilin Islami e rekomandon si lidhje të mirë të sjelljes mes krijesave të Tij. modestia është faktor i cili eliminon dhe çrrënjosë çdo dallim mes klasave të ndryshme në shoqëri në qëndrimin e përbashkët, i cili qëndrim rezulton me përhapjen e dashurisë dhe moralit e karakterit të lartë. Imam Aliu a.s ishte pasardhës i Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s në aspektin e modestisë dhe zemërgjërësisë si dhe aspektet e tjera.

- Imam Xhaffer Es-Sadiku a.s për veçoritë e personalitetit të Imam Aliut a.s thotë:» Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi dinte të mbajë (bukur) hutbe, të mbajë ujë, pastrojë shtëpinë, kurse hazreti Fatimeja a.s dinte të bluaj miell, të përgatis gjellë dhe të pjekë bukë. » (54)

- Imam Aliu a.s dinte të blejë gjithçka që i duhej dhe i nevojitej familjes së tij dhe personalisht ato t'i sjell nga tregu, (vëmendje: ai ishte halif-udhëheqës i shtetit islam!) pa ndihmën e askujt. Vetë ecte rrugëve të qytetit pa roje dhe shërbetore, duke ju dhënë tregëtarëve këshilla dhe duke kërkuar prej tyre zbatimin e sjelljes së mirë, matjes (peshojës) së drejtë, si dhe me zë të lartë e lexonte ajetin Kur'anor:» Atë vend të përjetshëm (Xhennetin) ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresa në tokë, (ndërsa) përfundim i këndshëm u takon atyre që i frikësohen All-llahut (El-Kasas, 83)

- Njëherë Imam Aliu a.s u nis në drejtim të Sirisë, dhe gjatë rrugës e takuan banorët e Anbarit; kur e panë, filluan të vrapojnë, dhe më pas u nisën në drejtim para tij. Ai i pyeti:» Përse veproni kështu ? » Ata u përgjigjën:» Kjo është mënyra jonë e respektit të cilën ua shprehim të parëve tanë. » Në lidhje me këtë Imam Aliu a.s u përgjigj:» Për Zotin! Kjo nuk u shërben të parëve tu. Vërtetë ju mundoheni në këtë botë dhe kështu fitoni varfëri për botën tjerë-ahiretin. Ah, sa i rrezikëshëm është mundi pas të cilit vjen ndëshkimi dhe sa e bukur është qetësia e mirë në të cilën ekziston mbrojtja prej zjarri. » (55)

- Modestia e Imam Aliut a.s vërehej në qëndrimin/sjelljen e tij, veshjen, ushqimin, thjeshtësinë në jetë (p.sh, kur qëndronte në gjyq si njeri i rëndomtë). Amr ibn Asi, duke u përpjekur që ta nënçmojë dhe t'i pakësojë cilësitë e tij të veçanta, foli njëherë në Damask se Imam Aliu a.s e kishte dëshirë shakanë. Kur dëgjoji për këtë Imam Aliu tha:» Habitem, që Ibn En-Nebiga përcjell në Damask se e dua shakanë dhe se jam njeri shakaxhi!». » (56). Nuk është për t'u habitur që Muaviju biri i Ebu Sufjanit e lansoi të njëjtën propagandë bashkë me Amr ibn Asin kundër Imam Aliut a.s. Mirëpo, kjo propagandë nuk e dëmtoi Imamin.

- Saherë që ishte në rrugë d.m.th udhëtonte, Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s e ndiqte sjelljen e tij. Imam Aliu a.s dëshironte t'i njohënjerëzit, problemet me të cilat ata ballafaqohen, e ndiqte gjithashtu punën e mëkëmbësve të tij, komandantëve të ushtrisë si dhe pushtetarëve të tjerë.

- Modestia e tij bëri që ai të kuptojë gjithçka dhe ndaj njerëzve të sillet me mirësinë dhe zemërgjërësinë më të madhe. Ai e arriti majen e mirësisë në jetën e tij. Gjatë historisë, rrallë ka pasur njerëz të tillë, kuptohet përveç Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s. Ai-Imami a.s ua fali atyre që i kishin bërë të këqija dhe i kishin shkaktuar dhimbje personale, kurrë nuk u hidhërua përveç atëherë ku dëmtohej dhe shkilej drejtësia dhe tejkalohehin kufijtë dhe ndalesat e urdhërave të Zotit. I tillë ishte edhe para ardhjes në krye të halifatit, i tillë mbeti edhe pas marrjes së halifatit. Veçoritë e Imam Aliut a.s në durimin (sabin) e tij i tejkalohej të gjitha kufijtë, duke e ilustruar këtë me plotë madhësi pa marrë parasysh fuqinë dhe famën që kishte, kur gjithë këtë e jetësonte në përditshëmrinë e tij, e sidomos kur e falte ndonjërinë prej armiqëve të tij më të mëdhenj. Gjatë kohës së halifatit të tij mund t'i dënonte armiqët e tij edhe kur ishte në krye të shtetit, por nuk duhet harruar kurrë se ai ishte nxënës i Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s. Jeta e tij është përplotë me mirësi dhe zemërgjërësi të pashoqe. Do t'i përmendim më poshtë vetëm disa prej tyre.

- Malik El-Eshteri gjatë kohës së luftës e kapi rob Mervan ibn Hakimin dhe kur e çuan të del përpara Imam Aliut a.s, Imami a.s vetëm e kritikoi dhe e fajësoi për vepërën e tij komplotiste kundër tij; dhe më pas e liroi Mervanin edhe pse fort mirë e dinte rolin e tij kundër islamit dhe rolin që e kishte lozur në trazirat e tjera kundër halifit të zgjedhur (d.m.th kundër vetë Imam Aliut a.s, vërejt e përkth) Mervani ishte njëri prej atyre të cilët e refuzuan që Imam Aliu a.s t'i japin bej'atin (besatimin) dhe që iku prej qytetit të Medines. Ai ishte në mesin e atyre që e nxitën luftën në Basra duke i përmbajtur tradhëtarët të cilët i dhanë njëherë bej'atin Imam Aliut a.s dhe më pas e tradhëtuan atë.

- Imam Aliu a.s gjithashtu e fali edhe Abdull-llah ibn Zubejrin, kur ishte i zënë rob në betejën e « Deves »; kurse Abdull-llah ibn Zubejri e kishte udhëhequr luftën kundër Imam Ali ibn En\bu Talibit a.s !!!... (57)

- Musa, i biri i Talha Ibn Abdull-llahut gjatë luftës rreth « Deves » u zu rob. Imam Aliu a.s kërkoi nga ai që të falë namaz istgfar (të pendimit) ndaj All-llahut xh.sh dhe ju drejtua me këto fjalë:» Shko në kampin (taborin) tonë, nëse gjen ndonjë nga armët që t'i të takojnë merri. Frikësohu nga All-llahu xh.sh dhe largoju luftës. » (58)

- Imam Muhammed El-Bekiri a.s transmeton në lidhje me shpirtëgjërësinë dhe faljen (amnestinë) e Imam Aliut a.s duke thënë:» Imam Aliu a.s i pranonte robërit e Shamit (Damaskut), ua merrte armatimin, ndërsa për kusht të lirimimit u vënte: Betimin se më ata-robërit nuk do të luftojnë kundër tij. » (59) Imam Aliu a.s e dinte se banorët e Shamit bashkë me Muavijun kishin luftuar kundër tij, ngase Muaviju i kishte korruptuar me të holla, me pozita dhe benificione të ndryshme, kështu që nëpërmjet këtyre ua

kishte megjulluar atyre të vërtetën, të cilën e kishin keqpërdorur edhe dijetarët e tij të këqinjë të cilët e kishin shitur ndërgjegjen e tyre për një jetë më të mirë në këtë botë.

- Sabri (durimi), falja dhe mëshira e halifit Ali ibn Ebu Talibit a.s ishin të pranishme në të gjitha fushat e jetës, posaçërisht kur ushtria e Muavijut e okupoi rrugën që çonte tek lumi Euftrat, me qëllim që ushtria muslimane të mbetej pa furnizim me ujë.

- Më pas halifi Aliu a.s ishte i detyruar që me forcë ta lirojë shtegun që çonte drejt Euftratit, dhe i urdhëroi ushtarët e tij që t'u lejojnë fritëzimin e ujit ushtrisë kundërshtarë, duke u thënë:» Merrni ujë për nevojat e juaja dhe kthehuni në kampin tuaj, lëshoni ata (ushtarët kundërshtarë, vërejt e përkth) tek uji, ngase All-llahu i Madhëruar juve ua ka dhënë fitoren për shkak të dhunës dhe tiranizimit (terrorit) të tyre. » (60)

- Imam Aliu a.s mundej lirisht atyre t'ua ndalojë ujin për shkak të padrejtësisë që ata ia bënë, por karakteri i tij i lartë që e posedonte në shpirt dhe e çonte drejt rrugës së Vërtetë, rrugës së hidajetit, të karakterit të shëndosë dhe punës në rrugë të përkushtimit të paluhatshtëm ndaj All-llahut xh.sh dhe pikërisht kjo e tregon dallimin që kishte karakteri i tij prej karakterit të Muavi ibn Ebu Sufjanit.

- Imam Aliu a.s një ditë e thirri shërbetorin e tij i cili nuk i kushtoi vëmendje thirrjes së tij. Atëherë Imam Aliu a.s e ftoi për rregulloren duke i thënë:» Pse nuk paraqitesh » ? Shërbetori iu përgjigj:» M'u mërzi të të përgjigjem, dhe isha i sigurt se nuk do të më ndëskosh. »

- Imam Aliu atëherë tha:» falënderimi i qoftë All-llahut, i Cili ka bërë që nga unë të jenë të sigurtë dhe qetë krijesat e Tij; Dil dhe je i lirë për hir të All-llahut xh.sh » (61)

- Në jetën e Imam Aliut a.s shihen shumë shembuj të tillë të panumërt të cilat qartë na e pasqyrojnë humanitetin e tij, i cili ishte definicioni më sublim që e ndoqi Imami a.s gjatë gjithë jetës-prej lindjes e deri në vdekje.

- Humaniteti, shpirtgjërësia dhe bujaria e tij fare qartë mund të vërehen edhe në qëndrimin e tij që pati ndaj Abdurrahman ibn Mulxhemit-harixhiut, i cili e goditi Imam Aliun a.s me shpatë në kokë, një qëndrim të këtillë human mund të shprehin vetëm Pejgamberët e All-llahut xh.sh. Vallë a e njeh historia njerëzore dhe a ka shënuar ndonjëherë ndonjë njeri të sillet kësisoji ndaj vrasësit të tij, ashtu siç u soll Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s ?

- Imam Muhammed El-Bakiri transmeton:» Në mesin e porosive të fundit që Imam Aliu a.s ua drejtoi bijëve të tij Hasanit dhe Husejnit, ishin edhe këto fjalë:» Mbyllnie këtë të burgosur- (Ibn Mulxhemin), ushqejeni me ushqimin tim, i jepni të pijë prej pijes sime (ujë), silluni mirë ndaj tij. Nëse mbetem gjallë, unë jam përgjegjës se çfarë do të ndodhë me atë për shkak të asaj që ka bërë, par unë do vendosi se a do ta dënojë apo do t'ia fali; ndërsa nëse vdes, atëherë vendimi është në duart tuaja. Dhe nëse vendosni që ta vritni, atëherë mos e masakroni trupin e tij të vdekur. » (62)

## **DEVOTSHMËRIA NDAJ SUPERIORITET**

- Devotshëmria (takvallëku) ndaj superioritetit në karakterin dhe mendimin e Imam Aliut a.s dhe morali i lartë i karakterit të tij janë fenomeni i shkallës më të lartë të devotshëmisë së tij. Ai i ikte përdorimit të forcës edhe ndaj armikut më të ashpër. Për këtë shkak. Imam Aliu a.s ishte thirrësi më i madh i paqes përkundër kohës dhe rrethanave si komplotistëve të cilët u çuan kundër tij; ndërsa animi i tij i drejt paqes, shihet edhe nëpërmjet politikës që e udhëhiqte:

- Imami a.s i largohej gjakderdhjes dhe vrasjeve, atëherë kur i luti Talhën dhe Zubejrin që t'i ndërrojnë qëndrimet e tyre dhe t'i kthehen paqes. (63). Mirëpo, kur të dy ushtritë u takuan në Basra, Imam Aliu a.s përsëri e luti Zubejrin që të del pa armë, ndaj edhe u përshëndetën dhe u përçafuan fortë, kurse Imam Aliu a.s e pyeti Zubejrin se për çfarë shkak u shpalli luftë atij, duke ia përkujtuar marrdhëniet e mira që kishin pasur si dhe dashurinë e tyre të ndërsjellë, posaçërisht kur Imam Aliu a.s e përmendi bisedën e zhvilluar në mes Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s dhe Zubejrit, duke i thënë:

« Në emër të All-llahut Zubejr, a të kujtohet kur Pejgamberi s.a..v.s të pyeti:» Zubejr a e don Aliun ? »- kurse ti iu përgjigje:» Çfarë më shtyn të mos e dua, ai është djali i axhës tim. » Atëherë Pejgamberi s.a.v.s të tha:» Ti do të jeshë kundër tij dhe atij do t'i shkaktosh dhunë. »

- « O Zot! Kjo është e vërtetë, unë e kisha harruar këtë »-u përgjigj Zubejri. (64). Më pas Zubejri e lëshoi fushbetejën dhe u kthye i vetëm, ndërsa u vra gjatë rrugës për në Medine. Kur bisedimet nuk dhanë rezultate, atëherë tradhëtarët-rrebelues ia filluan luftës, mirëpo edhe përkundër kësaj, Imam Aliu a.s ishte i përmbajtur gjer në momentet e fundit. Në fillim të luftimeve e mbajti një fjalim ku ia rikujtoi ushtrisë së vet parimet e moralit islam, duke ju thënë:» O njerëz! Në emër të All-llahut mos e vrisni atë që sprapset (ikën), të plagosurit, mos u merrni asgjë nga pasuria, qoftë armatim apo gjësende. » (65)

- Pas betejës, Imam Aliu a.s me komandatët dhe ushtarët u përshëndet. E njëjta gjë ndodhi edhe në Narevan, kur Imami a.s përpiquej si e si të gjejë shtegdalje nga kriza ku kishin hyrë, por nuk ia doli mbanë, nuk pati sukses ngase pala tjetër kundërshtarë insistonte për luftë, edhe filluan të shkatojnë rrëmujë dhe turbullira duke vrarë civilë të pafajshëm, duke shkaktuar kështu revoltë anekënd trojeve islame. Mu për këtë shkak, më në fund Imam Aliu a.s u detyrua të luftojë kundër tyre.

## **POROSITË E IMAM AILI IBN EBU TALIBIT A.S DREJTUAR KOMANDANTËVE DHE MËKËMBËSVE TË TIJ**

- Vërtetë duhet të ketë qenë njeri i madh ai i cili i shkruan një porosi të tillë məkëmbësit të tij Malik El-Ashtarit, porosi të gjatë, e cila përmban një filozofi të thellë të udhëzimeve. Disa pjesë nga kjo porosi e Imam Aliut a.s janë:

« ... Mësoje zemrën tënde të jetë e mishirshme ndaj vartësve, e diponuar dhe e mirë ndaj tyre. Mos u bëj për ta si egërsirat mizore, të cilat e konsiderojnë të mjaftueshme vetëm t'i kapërdijnë, pasi që janë të ngurtë, ose vëllezërit tu për nga feja ose ndonjë i ngjashëm me ty për nga krijimi... »

... - Shpërblej ata me faljen dhe amnistinë tënde njësoj siç do të dëshiroje që All-llahu të të shpërblejë ty me falje dhe mëshirë, ngase tyje mbi ta, kurse ai i cili të porosinë për këtë është mbi ty, gjersa All-llahu është mbi ate i cili të emëron administrator... »

...- Bëhu i drejt ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve si ndaj vetes tënde; ndaj familjes tënde dhe atyre nga besimtarët e tu të cilët ke simpati, sepse nëse nuk vepron kështu do të jeshë i padrejtë ndaj robërve të Tij. Kurse atij të cilit All-llahu i është kundërshtar, do t'i dobësohet preteksti i tij dhe ai do të mbetet në gjendjen e të qenurit në luftë me Zotin, gjersa nuk bindet dhe nuk pendohet... » (66)

- Këto janë pjesë nga porosinë që Imam Aliu a.s ua drejtonte administratorëve dhe məkëmbësve të tij në tokat islame, duke kërkuar gjithnjë prej tyre që të sundojnë sipas drejtësisë së All-llahut xh.sh, disponimit të këndshëm dhe mirësisë së pakufijshme.

- Në porosinë drejtuar Muhammed ibn Ebu Bekrit kur Emirul-Muëminini e caktoi për mëkëmbës të tij në Egjipt, mes tjerash i thotë:

« Tregohu ndaj tyre i njerëzishëm, i butë dhe fytyrqeshur. Sillu ndaj tyre në mënyrë të drejtë, ashtu që fisnikët të mos presin padrejtësi në favor të tyre dhe të dobëtit të mos e humbin shpresën në padrejtësinë tënde ndaj tyre. All-llahu i Madhëruar, o bashkësi e robërve të Tij, me siguri do t'ju pyes mbi veprat tuaja, qofshin ato të vogëla apo të mëdha, të dukshem apo të fshehta. Nëse Ai ju ndëshkon, kjo do të bëhet ngase këni qenë tiranë, e nëse Ai ju falë, kjo do të bëhet për atë se Ai është më i Mëshirshmi...  
...- Kryeje namazin në kohën e caktuar. Mos e shpejto kohën e tij nga ngeja e as mos e shtyjë kohën e tij ngase je i zënur. Dije se çdo punë e jotja e ndjek namazin tënd.

- Me të vërtetë nuk janë të njëjtë prijësi i rrugës së mbarë dhe prijësi i shkatërrimit, miku i Pejgamberit dhe armiku i Pejgamberit. Pejgamberi i All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!- më ka thënë:

« Lidhur me ithtarët e mi, nuk kam frikë as nga besimtari as nga shërbyesi i idhujve. Sa i përket besimtarit-All-llahu do ta pranojë me besimin e tij, ndërsa sa i përket shërbyesit të idhujve- All-llahu do ta mposhtë për arsye se u shërben idhujve. Por frikësohem për ju nga çdonjëri që është hipokritë në zemër, mjeshtër i gjuhës i cili e deklaron atë që e konsideroni të mirë, kurse e bën atë që nuk ju pëlqen. » (67)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s kishte dëshirë të madhe, elan të pashoqë, shpirtgjërësi, durim të thellë, cilësi këto të cilat e karakterizonin personalitetin e tij, dhe e tërë kjo shihet gjatë gjithë jetës së tij, lidhja e fortë që kishte me All-llahun xh.sh, ibadeti, takvallëku, modetia në këtë botë dhe falja (amnestia) e tij ndaj atyre që bënë dhe udhëhoqën luftëra të ashpra kundër tij në ditët e fundit të jetës, gjë që edhe më tepër na e pasqyrojnë karakterin e tij të shëndoshë. Imam Aliu a.s qëndronte i fortë dhe stoik ndaj vështirësive që i dilnin përpara dhe e pengonin, ai u shndërrua në kandil, kandil ky i cili i ndriçon shpirtërat tonë, ndërgjegjen dhe vetë fenë e lartësuar Islame. Këtu, në vijim do të shohim, se si Imam Aliu a.s ndahej nga njerëzit më të dashur të jetës së tij, siç ishte fjala vjen ndarja me dy më të dashurit e jetës së tij-Pejgmaberin Muhammedin s.a.v.s dhe hazreti Fatimenë a.s

- Kur Pejgamberi Fisnik s.a.v.s u shpërngul në botën tjetër-ahiret, koak e tij gjendej në krahët e Imam Aliut a.s dhe ai-Imami a.s e lajti-pastroi trupin e Pejgamberit s.a.v.s dhe e përgatiti xhenazen e tij, dhe me këtë rast tha:

« Edhe babain edhe nënën do ta flijoja për ty, o Pejgamber i All-llahut!

- Me vdekjen tënde u mbyll rendi i pëjgamberllëekut, shpalljes (vahjit) dhe porosive qiellore që nuk ka përfunduar me vdekjen e Pejgamberëve të tjerë.

- Pozita jote në krahasim me neve është aq e veçantë saqë dhimbja për ty u shndërrua në burim të ngushëllimit-kundruall pikëllimit të gjithë të tjerëve. Pikëllimi për ty është edhe i përbashkët, ashtu që të gjithë të përkushtuarit (ndaj All-llahut) e ndajnë njësoj.

- Po të mos na kishte urdhëruar të përmbahemi dhe po të mos e kishte ndaluar vajtimin, do të kishin derdhur shumë lot, madje edhe atëherë dhimbja për ty nuk do të na zvogëlohej dhe ky pikëllim nuk do të përfundonte. Dhe kjo do të ishte fare pak nga pikëllimi për ty.

- Mirëpo, kjo është diç që nuk mund të kthehet, e as mund të refuzohet!

- Edhe babain edhe nënën do ta flijoja për ty!

- Na përmend te Zoti yt dhe mos na harro! » (68)

- Nga kjo qartë shohim se çfarë pozite kishte Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s tek Imam Aliu a.s si dhe dashurinë madhështore që e ndjente ndaj tij s.a.v.s. Kështu qartë e

shohim vëmendjen e posaçme, dashurinë dhe edukatën që Pejgamberi s.a.v.s i ofroi Imam Aliut a.s që nga fëmijëria e hershme e gjer në vdekje; e shohim dhe e vërejmë dashurinë e tyre vëllazërore, përkushtimin, sinqeritetin dhe respektimin që ka ekzistuar mes atyre të dyve. Gjithë kjo na e tregon edhe humbjen e madhe që Imam Aliu a.s e ndjeu me rastin e ndërrimit jetë të Pejgamberit s.a.v.s.

- Në kohën më të keqe, në rrethanat më të vështira, tetëdhjetë ditë pas ndërrimit jetë të Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s; Imam Aliu a.s e humbi edhe personin tjetër më të dashur, hazreti Fatimetu Ez-Zehranë a.s pas një sëmundjeje të shkurtër dhe vuajtjeve që i pësoi pas vdekjes së babait të saj-Pejgamberit s.a.v.s. Hazreti Fatimeja ishte amanet në mesin e muslimanëve, të cilët ia morrën asaj, përkatësisht privuan nga pozita që duhej ta gëzonte në shoqërinë islame, ndaj edhe vdiq herët e pikëlluar dhe durimtare. Imam Aliu a.s e përgatiti xhenazen e hazreti Fatimesë a.s. Gjatë përgatitjes së xhenazes atij i ndihmoi familja e tij e ngushtë dhe e varrosën gjatë natës. Pas varrimit të saj Imam Aliu a.s u nda më këto fjalë lamtumirëse, drejtuar nga varri i Pejgamberit s.a.v.s.

« O Pejgamber i All-llahut! Selami i All-llahut qoftë mbi ty nga unë dhe nga bija jote, e cila erdhi afër teje dhe e cila nxitoi të takohet me ty! O Pejgamber i All-llahut, durimi im rreth të zgjedhurës tënde u sos dhe fuqia ime e qëndresës u dobësua; mbeti vetëm ngushëllimi, nga pikëllimi i madh i pësuar, dhe ngjarjen e hidhur të ndarjes tënde; me atë se të kam lëshuar në varrin tënd dhe me atë që shpirti yt ka kaluar nëpër qafën dhe gjoksin tim.

« ... Ne jemi të All-llahut dhe vetëm tek Ai do të kthehemi. » (El-Bekaretu, 156)

- Kurse tani huaja u kthye dhe ajo që është dhënë u morr prapa. Pikëllimi im është i përhershëm. Kurse sa i përket netëve të mia, ato do të mbesin pa gjumë gjersa All-llahu nuk do të caktojë për mua shtëpinë në të cilën banoni ju tani.

- Natyisht, bija jotë do të lajmërojë se ithtarët tu janë bashkur për shkak të tiranizimit të saj. Pyete për çdo gjë dhë mëso të gjitha lajmet mbi gjendjen. Kjo ndodhi ku nuk kishte kaluar as kohë e gjatë, e as kujtimi për ty. Selam keni të dytë nga ai i cili përcjell, e jo nga personi i cili urren dhe ndjen mërzi, ngase nëse shkoj, kjo nuk do të jetë nga mërzia, kurse nëse mbetem kjo nuk do të jetë për shkak se dyshoj në atë që All-llahu u ka premtuar durimtarëve (sabërshinjeve). » (69)

- Në këtë mënyrë Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e përcolli gruan e tij të dashur, duke u pajtuar më caktimin e All-llahut xh.sh, i pikëlluar por ama edhe duke duruar denjësisht ashtu siç i ka hije individit i cili me tërë qenein e tij i është përkushtuar All-llahut xh.sh.

- Kështu Imam Aliu a.s filloi t'i humbë njerëzit e tij më të dashur, duke filluar që nga Pejgamberi s.a.v.s, hazreti Fatimeja a.s dhe shokët e tjerë të përkushtuar. Disa ditë para vdekjes Imam Aliu a.s e mbajti një hutbe në Kufe, në të cilën i përmendi shokët e tij dhe gjithë ata vëllazër që bashkë me të luftuan krahas Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s. Në mes tjerash tha:

« ... Ku janë vëllazërit e mi të cilët kanë shkuar Rrugës së drejtë dhe të cilët kanë ndjekur të Vërtetën ?

Ku është Ammari ? Ku është Ibn Et-Tejhani ? Ku është Dhu-sh-Shehadetejni ? Dhe ku janë të tjerët si këta nga vëllazërit e tyre të cilët e zgjodhën vdekjen për vete dhe kokat e të cilëve u janë dërguar armiqëve të shfrenuar ? »

- Pastaj Prijësi i besimtarëve-Alejhissem!-e kapi me dorë mjekrrën e tij të respektuar dhe elegante dhe qajti e qajti një kohë të gjatë; pastaj foli:

« Ah, vëllazërit e mi, të cilët kanë mësuar nga Kur'ani dhe kanë sjellur vendime në bazë të tij, që kujtonin obligimet e tyre dhe i zbatonin ato, që rringjallnin Rrugën

(Sunnetin) e Pejgamberit dhe eliminonin risitë! Kur u ftua në xhihad, u pëgjigjën; patën besim në prijësine tyre dhe e pasuan ate. (70)

- Kështu Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s i përballoi të gjitha ato sfida dhe prova që i përjetoi pas ndërrimit jetë të Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s duke iu shmangur kësaj bote dhe zbukurimeve e bagative të saja, me qëllim të arritjes së jetës së lumtur e të amshueshme të cilën All-llahu xh.sh ua ka premtuar robërve të tij të mirë.

## **DITURIA E IMAM ALI IBN TALIBIT A.S DHE QËNDRIMI I TIJ NDAJ SHKENCËS**

- Imam Aliu a.s është pasardhës i Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s dhe udhëheqës i ummetit, autoritet i lartë në të gjitha pyetjet, dhe s' do mend se e gjithë kjo është rezultat dhe fryt i punës së Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s i cili e përgatiti për udhëheqës të ummetit islam. Misioni i Imam Aliut a.s ishte i përqëndruar prej udhëzimit të All-llahut xh.sh. Ngase ai-Imami a.s ishte burim i drejtësisë të cilën ia afroi njerëzimit, rrugës së përparimit në të gjitha lëmitë e dijeve, nëpërmjet të cilave ummeti do të udhëhiqej sipas udhëzimeve të Zotit dhe rrugës së drejtësisë. Pa marrë parasysh vështirësitë që Imam Aliu a.s i përjetoi dhe të cilat e pengonin në kryerjen e detyrave të veta, ai prapëseprapë pati një rol të madh e tejet të rëndësishëm në edukimin e njerëzimit dhe shoqërisë si dhe udhëzimin e tij drejt rrugës së drejtë e progresive.

- Secila përpjekje e vërtetë e njohjes së diturisë së Imam Aliut a.s dhe mendimeve të tij briljante si dhe urtësisë së pakrahasueshme në sytë e njerëzimit, rezultoi dhe pati ndikim në shkollat dhe drejtimit e ndryshme islame, të cilat filluan të bazohen në personalitetin e Imam Aliut a.s, mësimet e tij si dhe udhëzimet dhe porositë e tij të pakrahasueshme me qëllim të përhapjes së dijes në përgjithësi dhe legalizimit të rrugës së drejtësisë. Esh-ariu dhe shkolla/drejtimi i tij i pranoi mësimet dhe dijen e pakontestueshme të Imam Aliut a.s ashtu siç vepruan edhe Muëtezilitit dhe Sufinjët (mistikët islam, vërejt e përkth) (71). Mirëpo, ithtarët e Ehli-Bejtiti a.s i ndoqën me përpikshëmri parimet e Imam Aliut a.s, si shprehje të vepërs së dytë të rëndësishme, menjëherë pas Kur'anit të Madhnueshëm, që Sheriati Islam e kërkoi prej neve muslimanëve që t'i ndjekim, ashtu siç është rekomanduar në Shpalljen e All-llahut të cilën Pejgamberi i Islamit-Muhammedi s.a.v.s e përcolli. Imam Tirmidhi El-Hakimi transmeton nga Zejd ibn Arkami se Muhammedi s.a.v.s ka thënë:» Ua lë amanet diçka prej së cilës nuk do të humbni e as që do të devijoni prej rrugës së drejtë gjersa t'u përmbaheni: Librin e All-llahut (Kur'anin) dhe Familjen time (Ehlul-Bejtin), ndaj kujdes se si nëpërmjet tyre mua do të më ndiqni, ngase ata (Kur'ani dhe Ehlul-Bejti, vërejt e përkth) nuk do të ndahen njëra nga tjetra gjer në Ditën e Gjykimit. » (72)

- Shkollat e ndryshme islame të fikhut gjathashtu me krenari i kanë takuar Imam Aliut a.s. Kjo është shenjë dhe argument i respektimit të figurës së tij, aftësive të tija të diturisë gjithpërfshirëse, ndërsa një pozitë të tillë askush nuk e ka pasur përveç Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s. Kështuqë dituria e Imam Aliut a.s i përfshin të gjitha fushat e jetës dhe shkencës, ngase Imam Aliu a.s ishte themelues i një numri bukur të madh të degëve të dijes siç janë: fikhu (jurisprudenca islame), filozofia, tefsiri, historia, oratoria dhe gramatika e gjuhës arabe, duke i vendosur kështu themelet e hulumtimeve dhe zhvillimeve të mëtejshme të gjeneratave të ardhshme islame.

- Gjithë ky bagazh i diturisë së madhe që Imam Aliu a.s ia afroi njerëzimit në përgjithësi, është fryt dhe rezultat i përpjekjes dhe punës së Pejgamberit-Muhammedit



s.a.v.s ndaj Imam Aliut a.s që e bëri deri në momentet e fundit të jetës së vet. Imam Aliu me krenari e pranon përkujdesjen e Pejgamberit s.a.v.s që ia ofroi atij, kur shprehet:» E dini mirë vendin tim pranë Pejgamberit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e Tij!- sa i afërt ka qenë, duke pasur parasysh afërsinë gjinore dhe pozitën e posaçme. Kur isha fëmijë, ai më merrte nën mbrojtjen e tij. E kishte zakon të më shtrëngonte në kraharor dhe t' më vendoste pranë në shtratinë e tij... »

- Kujdesi i Muhammedit s.a.v.s përqëndrohej në edukimin dhe përgatitjen e Imam Aliut a.s që të mund të bëhej udhëheqës dhe Imam i muslimanëve pas vdekjes së tij. Pejgamberi s.a.v.s ishte i sigurt në aftësitë e Imam Aliut a.s kur e falënderoi me fjalët:» Unë jam qyteti i diturisë, kurse Aliu është porta e tij, kush dëshiron të mësojë le të hyjë nëpërmjet portës. » (73)

« Aliu është dera e diturisë sime dhe udhërrëfyes i këtij ummeti, çfarë unë kam shpallur. » (74)

- Ibn Mes'udi transmeton:» Isha tek Pejgamberi s.a.v.s kur dikush e pyeti mbi diturinë e Ali ibn Ebu Talibit, kurse Pejgamberi s.a.v.s u përgjigj:» Urtësia (mençuria) është ndarë në dhjetë pjesë, Aliu është i shpërblyer me nëntë pjesët e mençurisë, kurse njerëzit tjerë e dijnë vetëm pjesën e dhjetë, ndërsa Aliu është më i miri në mesin e tyre. » (75)

- Tërë këto hadithe tregojnë pozitën e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s dhe aftësinë e tij të jashtëzakonshme për dituri. Kjo është një ftesë e sinqetë se duhet ta ndjekim dijen e tij dhe shkencat/dituritë e Zotit xh.sh ngase Aliu a.s pas Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s është ai që nëpërmjet porosive dhe udhëzimeve të tija e ndriçon rrugën e drejtë, rrugën e Cila të çon tek All-llahu xh.sh.

- Ita' Ibn Ebu Ribah transmeton se e kanë pyetur:

« A e din dikush mirë diturinë pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s ? », kurse Ebu Ribahi është përgjigjur:

« Për Zotin nuk e di! »

- Abdull-llah ibn Abbasi ka thënë:» Aliu posedon nëntë hise (pjesë) të diturisë, dhe ai është më i miri në mesin e njerëzve që e dijnë pjesën e dhjetë të diturisë. » (76)

- Halifi Omer ibn Hattabi ka thënë:» Dituria është e ndarë në gjashtë pjesë, Aliu i din pesë prej atyre ta gjashtave dhe ai është më i miri në mesin tonë që e din edhe atë pjesë (pra pjesën e gjashtë, vërejt e përkth) » (77)

- Tre halifët që sunduan para Imam Aliut a.s i drejtoheshin atij në lidhje me pyetjet që kishin të bëjnë me: gjyqësinë/gjykimin, të udhëhequrit dhe administrimin. Halifi i dytë Omer ibn Hattabi shpesh-herë ka thënë:

« Unë asnjëherë nuk do të mundesha t'i tejkaloj vështirësitë pa Aliun, sikur të mos ishte Aliu Omeri do të shkatërrohej. » (78)

- Edhe hazreti Aisheja-nënë e besimtarëve thotë:» Aliu është më i miri që e njuh Sunnetin. » (79)

- Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s shpesh-herë deklaronte se ai posedon dituri të madhe dhe të gjërë, ndaj edhe u thoshte shokëve të vet:» Në kraharorin tim kam dituri të madhe të cilën Pejgamberi s.a.v.s ma mësoi, dhe sikur të gjeja nxënës të cilët mirë do Ta nxënin diturinë që e posedoj dhe ta transmetojnë atë që e flas, atëherë unë do t'i mësoja ata me një pjesë bukur të mirë të diturisë. » (80)

- Ibn Nabata transmeton:» Kur Imam Aliu a.s e morri bej'atin (besatimin), vajti te xhamia e Pejgamberit s.a.v.s duke pasur veshur teshat e Pejgamberit s.a.v.s dhe e mbajti hutben vijuese:

« ... O njerëz! Më pyetni para se të më humbni, më pyetni sepse unë posedoj diturinë e përcjellur prej pasardhësve të mençur. Për Zotin, sikur të më lejonin kushtet, unë do t'ua komentoja ndjekësve të Teuratit-Teuratin, ndjekësve të Inxhilit-Inxhilin, ndjekësve të Zeburit-Zeburin kurse ndjekësve të Furkanit (Kur'anit) atë që gjendet në Kur'an, gjersa ta përfundoja secilën prej atyre librave, dhe deri sa dikush të më thoshte:» O Zot! Dëshmoj se Aliu gjykoj sipas caktimit Tënd! Për Zotin unë e di që Kur'anin dhe komentimin e tij më mirë se çdo kush tjetër... »

- Më pyetni para se të më humbni. Kujdes, pasha Atë i Cili e shkapërderdh kokrrën dhe krijon gjallesat ( u jep shpirt), sikur të më pyetni për çdo ajet që është shpallur, kur dhe kujt i ka ardhur (pse ka zbritur, vërejt e përkth) përmabjtjen dhe komentimin e tij, cilësinë dhe karakterin, si dhe cili ajet është mekas e cili medinas, do të dija të përgjigjem. Për Zotin, do ta dija secilin grup që thirr në udhëzimet e Zotit apo kundër tyre, do ta dija edhe udhëheqësin e tyre, mëkëmbësin dhe thirrësinë... » (81)

« Më pyetni, për Zotin do t'u përgjigjesha të gjitha pyetjeve tua. Më pyetni për Librin e All-llahut (Kur'anin). Për Zotin, nuk ka ajet e që nuk e di se a ka zbritur natën apo ditën si dhe a ka zbritur në fushë apo në male » (82)

- Këhtu, në këtë mënyrë Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s nuk e kishte mundësinë ta tregojë tërë potencialin e tij të diturisë dhe bagazhin e tij të madh të njohurive për çdo fushë të dijes dhe shkencës. Për këtë shkak, shpesh-herë përsëriste:» Më pyetni! »- duke e treguar kështu aftësinë e tij me dinjitet dhe krenari që i kishte hije.

- Seid ibn Musidi transmeton:» Askush asnjëherë nuk i pyeste njerëzit se çfarë nuk kanë të qartë, përveç Imam Aliut. Ngase thirrja e tij që ia bënte ummetit të tij ishte argument i diturisë së madhe e cila përfshinte pasurinë mendore, mirësinë, udhëzimin dhe faljen. »

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s jetoi në një kohë kur nuk e pranuan dhe kur nuk i kuptonin mendimet e tija të mëdha demokratike e qytetëruese e as që dinin ta çmojnë rolin e tij madhështor në përhapjen dhe zgjerimin e parimeve dhe principeve të shëndosha islame. Mu për këtë, duke qenë krejt i vetëdijshëm Imam Aliu a.s i luste njerëzit që ta pyesin për ato gjersa që nuk i dinjë, duke u thënë:» Më pyetni para se të më humbni! » Disa herë nxënësi besnik i Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s përjetoi telashe (shqetësime) prej atyre që e keqkuptonin dhe e konsideronin për njeri mendjemadh e plot krenari. Mirëpo, pëkundër kësaj, në të njëjtën kohë koshte një numër bukur të madh të dijetarëve që u edukuan nga medreseja (shkolla) e tij, duke e kërkuar diturinë e tij, kurse ai si zakonisht i porosiste dhe i udhëzonte sipas porosive dhe udhëzimeve të Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s.

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s pas vetes la një pasuri të jashtëzakonshe/ kolosale në shkencë, në këshillat e tij, parimet dhe mendimin e tij madhështor në historinë mbarënjerezore që është një argument i fortë dhe i pakonteshtueshëm i aftësive të tij në të gjitha fushat e jetës. Kishte një rol tepër të rëndësishëm në të gjitha sferat e besimit islam dhe kjo qartë shihet nëpërmjet fjalimeve të tij, letrave dhe kësillave të cilat plotësisht e kompletojnë pasurinë e tij të pashtershme shpirtërore.

- Kështuqë Emirul-Muëmini Ali ibn Ebu Talibi a. i dha besimit islam një përparim të amdh duke i forcuar themelet e besimit islam, dhe e mënjanoi, përkatësisht largoi nga besimi islam çdo dyshim dhe shtrembërim prej parmit bazë të saj.

- Emirul-Muëminini Ali ibn Ebu Talibi a.s e përshkruajti All-llahun xh.sh (kuptohet nëpërmjet cilësive-sifateve, vërejt e përkth) dhe Emrat e Tij të Bukur-Esmaul-Husna; veprat, cilësitë e pejgamberllëkut, Vahjin (Shpalljen), melaqet, imamatin, fatin dhe caktimin/kaderin e Zotit; rringjalljen, filozofinë, këtë botë të përkohshme,

xhennetin, Ditën e Gjykimit dhe çështje të tjera të besimit (imanit) islam, të cilat Imam Aliu a.s të gjitha këto i shpjegoi dhe komentoi me plot fakte, argumente, sqarime dhe qartësime...

## **SIKUR UMMETI ISLAM T'A KISHTE MARRË MENDIMIN ISLAM QË IMAM ALI IBN EBU TALIBI A.S E NXORRI NGA BURIMI I PASTËR, BOTA ISLAME DO TË ISHTE E BASHKUAR NË TË GJITAH PIKËPAMJET E JETËS, DHE NUK DO TË VINTE GJER TEK SHTERMBËRIMI NGA RRUGA E DREJT !!!**

- Imam Aliu a.s Njëshmërinë (Teuhidin) e All-llahut xh.sh e përshkruajti më këto fjalë:

« E falënderojmë All-llahun, i Cili me krijimin e Tij dëshmon mbi qenësinë e Tij, mbi amshueshmërinë e Tij pa fillim-me risi të Krijimit të Tij dhe mbi atë që asgjë nuk është e ngjashme-përmes ngjashmërisë së krijësive të Tij. Shqisat Ate nuk mund ta arrijnë, as mbulesat nuk mund ta fshehin, duke pasur parasysh dallimin midis Krijuesit dhe krijësës, Kufizuesit dhe të kufizuarit dhe Ushqyesit dhe të ushqyerës. Ai ka krijuar gjithçka. Ai i krijon botërat me Madhësinë e Tij, i shpërndan errërat me Mëshirën e Tij si dhe ai është që krijoi botën pa shtyllë mbajtjeje...

-... Në fe gjëja e parë është pranimi i Njësisë së Zotit. D.m.th dëshmia se Ai është Një. Përsoshmëria e Tij është dëshmi e Njëshmërisë së Tij dhe të qenët më i Pastri.

-... Ai është Një, por jo në kuptimin e të parit në numërim. Ai është Krijues, por jo përmes punës dhe veprimit. Ai dëgjon çdo gjë, por jo përmes shqisave të trupit. Ai sheh çdo gjë, por jo me të hapurit e kapakëve të syrit. Ai është i pranishëm, por jo në të prekur. Ai është i ndarë, por jo me masë të distancës. Është i dukshëm, por jo me të shikuar. Është i fshehur por jo me vogëlsi. Është i veçuar nga gjërat, pasi që i nënshton dhe ka pushtet mbi ta, gjersa gjërat janë të ndara nga Ai, si pasojë e mvertësisë së tyre nga Ai dhe orientimit të tyre drejt Tij...

- ... Ai i cili e përshkruan- e kufizon Ate. Ai i cili e kufizon e shënon me emër. Ai i cili e shënon me emër e refuzon amshueshmërinë e Tij. Ai i cili thotë » Si ? »-kërkon ta përshkruaj. Ai i cili pyet »Ku ? »- i përshkruan vend. Ai është njohës, dhe nëse nuk do të kishte asgjë për t'u njohur. Ai është Ruajtës, edhe nëse nuk do të ekzistonte asgjë për t'u ruajtur. Ai është i Gjithëfuqishëm, edhe nëse nuk do të ekzistonte asgjë që do të duhej mposhtur...

- I Madhëruari nuk është i lindur ashtu që ndonjëri të ketë hise në të lartësuarit e Tij, as e ka lindur ndonjërin për të qenë i trashëguar dhe kalimtar. Koha dhe lashtësia nuk kanë ekzistuar para Tij. Nuk e dëmton as zmadhimi as zvogëlimi...

- ... Falënderuar qoftë All-llahu i Cili ekziston para se të jenë krijuar Selia, Froni, qielli, toka, xhinët dhe njerëzit! Ai nuk mund të arrihet me të paramenduar, as të matet me arsye. Ai i cili kërkon nga Ai nuk e brengos Ate, as shkaputja nuk i shkakton pakësim. Ai nuk shikon me anë të syrit, as mund të përfshyhet me një vend. Për Te nuk mund të thuhet se ka shok. Ai nuk krijon me veprim. Ai nuk mund të vërehet me shqisa. Njerëzit nuk mund ta përkufizojnë Ate... » (83)

- në këtë mënyrë Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e përshkruan Njëshmërinë e All-llahut xh.sh Zotëruesit të botërave, duke e përshkruar me përshkrime që vetë All-llahu i Madhëruar i ka bërë, larg çdo dyshimi, mangësie dhe të mete.

## PEJGAMBERËT DHE SHPALLJET E TYRE

- Kur Emirul-Muëminini-Ali ibn Ebu Talibi a.s e defynoi Njëshmërinë e All-llahut xh.sh (Teuhidin); ai gjithashtu caltoi dhe dha shpjegime edhe mbi nocionin « Pejgamber », filozofinë e këtij nocioni dhe synimim, kështuqë nëpërmjet kësaj (Imami a.s, vërejt e përkth) ua shpjegoi begatinë e All-llahut xh.sh kur dërgoi Pejgamberë për t'i udhëzuar njerëzit drejt udhëzimit, drejt rrugës së drejtë dhe të vërtetë, ngase ata kur largoheshin nga ligjet e All-llahut xh.sh-Ai si mëshirë ua dërgonte pejgamberët që sërish të kthehen rrugës së mbarë:

- Imam Aliu a.s thotë:

« Lavdiploti pastaj e vendosi Ademin në vendbanim ku kishte jetë të lumtur dhe qëndrim të sigurt dhe e paralajmëroi për Iblisin dhe armiqësinë e tij. Ky armik më vonë e mashtroi nga zilia e qëndrimit të tij në Xhennet dhe shoqërimin e tij me të gjitha të mirat. Kështu bindjen e vet e shkriu në dyshim, ndërsa vendosmërinë në dobësim. Gëzimin e vet e shndërroi në frikë, kurse devijimet morale në pendim. Atëherë All-llahu Lavdiplot ia ofroi rastin Ademit që të pendohet, ia mësoi fjalët e mëshirës së Tij, i premtoi kthim në Xhennet dhe e lëshoi në vendim e tundimeve dhe lindjes së pasardhësve.

- Nga pasardhësit e tij (Ademit, vërejt e përkth) Lavdiploti i ka zgjedhur Pejgamberët dhe ka marrë zotimin e tyre për shpalljen e Tij dhe për transmetimin e porosisë së All-llahut si obligim të tyre. Me kohë shumë njerëz tradhëtuan besimin e All-llahut, e lanë anash të drejtën e Tij dhe i ngatërruan fantazmat bashkë me Te. Shejtani i prapsoi nga të njohurit e Tij dhe i mabjti larg nga të shërbyerit Atij. Pasatj All-llahu ua dërgoi Pejgamberët dhe një sërë të dërgurish të Tij që ta përmbushin betimin e Krijimit Origjinar, që t'ua përkutojë shpërblimin e Tij, që t'i cytë me anë të mësimëve, që t'ua zbulojë dritën e fshehur të njohjes, që t'ua tregojë shenjat e plotëfuqishmërisë së Tij, qiejt e ngritur mbi ta, tokën e shtruar nën ta, mjetet për jetë me të cilat janë pajisur, vdekjen e cila i ndalon, vështirësit të cilat shpenzojnë dhe fatkeqësit të cilat bijnë mbi ta njëra pas tjetrës.

- All-llahu nuk ka lejuar kurrë që krijesat e Tij të mbeten pa të dërguar nga Ai, ose pa porosi të zbritur nga Ai, ose pa argument i cili obligon ose pa rrugë të qartë. Këta pejgamberë/të dërguar ishin të tillë që nuk e ndienin veten të dobët ngase ishin pak për nga numri, kurse mohuesit e tyre shumë. Në mesin e tyre gjithnjë ka pasur ose pararendës i cili e ka emëruar atë që vjen, ose ai që vjen të cilin e kishte prezentuar pararendësi. » (84)

- « All-llahu i dërgori pejgamberët dhe i ndriçoi ata me Shpalljen e Tij. ai i bëri dëshmi të Vetën për krijesat e Tij, ashtuqë ata të mos kenë argument as kurrfarë preteksti. Dhe Ai i ftoi me fjalim të siqertë ne rrugë të së Vërtetës... » (85)

- « All-llahu e dërgoi Muhammedin-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!- me të Vërtetën, në mënyrë që popullin e tij ta shpëtojë nga të qenët rob i lugetëv në të qenët rob i Tij; dhe e dërgoi me Kur'anin të cilin ia shpjegoi dhe mësoi mirë; në mënyrë që njerëzit ta njohin Zotin e vet, pasiqë nuk e njihnin, ta pohojnë Ate, pasiqë e kishin mohuar dhe ta pranojnë Ate, pasiqë e kishin refuzuar. Kështu Famëmadhi ua zbuloi Vetën përmes Librit të Tij, (Kur'anit, vërejt e përkth) por pa e parë Ate, përmes asaj që u ka zbuluar nga pushteti i Tij. Në ç'mënyrë Ai i shkatërroi ata

të cilët i shkatërroi me ndëshkime dhe në ç' mënyrë i kositi ata të cilët i kositi me dënime. » (86)

- Krahas kësaj, Imam Aliu a.s e definoi fenë islame në një mënyrë, që kurrë më parë nuk e kishte përshkruajtur, ai u shpreh:

« Ua caktoi Islamin ashtu siç nuk ua ka caktuar askush para meje. Islami është dorëzim, kurse dorëzimi është besimi i plotë, besimi i plotë është pranimi, kurse pranimi është vërtetimi, e ndërsa vërtetimi është zbatim, ndërsa zbatimi është vepër. » (87)

## IMAMATI NË BOTËN ISLAME

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s shpjegoi nevojën e domosdoshmërisë së imamatit (të udhëhequrit) si vazhdimësi të peygambërllekut, ngase bartësit e saj janë ata të cilët vazhdojnë me udhëzimet e All-llahut edhe pas ndërrimit jetë të Muhammedit s.a.v.s, si mbrojtës të Sheriatit dhe fesë së All-llahut të Madhëruar.

- Njëpërmjet tyre rruhet (mbrohet) fjala e All-llahut xh.sh që nëpërmes saj (pra fjalës së All-llahut xh.sh, vërejt e përkth) njerëzit të udhëhiqen/udhëzohen drejt mirësisë dhe hidajetit; kurse pa prezencën e tyre do të mbizotronte anarkia, çrregullimi dhe daldësija. Për këtë shkak, Imam Aliu a.s e përkufizoi definicionin e imamatit, duke thënë: « ... Asnjëri nga bashkësia e muslimanëve (ummeti) nuk mund të barazohet me pasardhësit e Pejgamberit. Kurrë nuk mund të barazohet me ta ai mbi të cilin shtrihet bekimi i tyre. Ata janë edhe themeli i fesë dhe shtyllë e besimit. Vrapuesi që është larguar duhet t'u kthehet, kurse përcjellësi që u shkon pas duhet t'i arrijë. Ata posedojnë të gjitha cilësit për të qenë udhëheqës. Porosia dhe trashëgimi janë në favor të tyre. Tani e drejta i është kthyer pronarit të saj dhe është orientuar nga esenca e kthymit. » (88)

... » Me të vërtetë Imamët janë nga Kurejshitet, ata janë rrënjësor në këtë degë të Hashimëve. Të tjerët, pas tyre, nuk janë të përshtatshëm, as për të tjerët, por atyre, nuk u ka hije të udhëheqin punët... » (89)

- Ashtu siç përcaktoi qartë imamin dhe imamatit, njëkohësisht Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s tërhoqi vërejtjen në marrjen (arritjen) e të drejtave të tyre dhe rolin të tyre në shoqëri, duke thënë:

« ... Me të vërtetë Imamët janë mëkëmbësit e All-llahut mbi krijesat e Tij, dhe dituria e Tij për robët e Tij. Nuk mund të hyjë në Xhennet asnjëri, pas atij i cili i njeh dhe të cilin njohin ata. Dhe nuk do të hyjë në Xhehennem asnjëri, pas tij i cili nuk i njeh dhe të cilin ata nuk e njohin... » (90)

- Gjithashtu Imam Aliu a.s e tërhoqi vërejtjen edhe drejt atyre që refuzonin rolin e tyre në jetën islame. Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s shpjegoi se drejtësia dhe e drejta janë gjithnjë në anën e tyre dhe se nuk ka udhëzim të drejtë pa ta (Imamët, vërejt e përkth) dhe pa pasimin e rrugës së tyre, duke thënë:

« ... Pra, ku jeni, kah shkoni ?! (El-Tekvir, 26) » Megjithatë sa të çoroditura janë mendimet e tuaja ?! (cituar nga Kur'anit i Madhnueshëm) »; dhe më pas shtoi: » Udhërrëfyesit janë vendosur, shënimet janë të qarta, kurse fanari është ngritur, pra përse mënjaroni dhe bredhni, gjersa në mesin tuaj gjenden pasardhësit e Pejgamberit tuaj ? Ata janë frerët e së Drejtës, shenjat e Besimit dhe gjuhët e së Vërtetës. Pranojeni pra pozitën meritore, siç ia pranoni Kur'anit dhe afrojeni si devet e etshme që i afrohen vendit ku do të pinë ujë... » (91)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s tregon se rruga e imamatit është e shoqëruar me rrugën e peygambërllekut, dhe se All-llahu xh.sh u ka premtuar robërve të Tij se bota asnjëherë nuk do të mbetet pa argumenet e Tij, ngase Familja e Pejgamberit s.a.v.s do të

jetë ajo që do t'ua përhap dhe shpërndajë porositë e All-llahut xh.sh muslimanëve; duke ua shprehur: » Kini kujdes! Pasardhësit e Muhammedit janë sikur yjet në qiell. Kur një yll shuhet, tjetri menjëherë paraqitet dhe shndërrit. Ndaj ju keni mundësi që plotësisht bekimi i All-llahut t'ju përfshijë, ndaj dhe Ai-All-llahu u ka treguar atë cilësi se cilës duhet t'i shpresoni. » (Fjala këtu është për Familjen dhe pasardhësit e Pejgamberit s.a.v.s, vërejt e ëprkth)

- Ky është vetëm njëri nga mendimet e Imam Aliut a.s që ka të bëjë me pyetjet kryesore të besimit islam.

## **VEPRAT E IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S**

- Sipas historianëve, Emirul-Muëminini-Ali ibn Ebu Talibi a.s ishte i pari në botën islame që zgjidhi veprat e rëndësishme dhe u dha venden e merituar në raport me Kur'anin e Madhnueshëm, e posaçërisht:

- E tuboi (mblodhi) Kur'anin e Madhnueshëm sipas rradhës së Shpalljes, duke e shpjeguar njëherit edhe shkakun e zbritjes së ajeteve dhe komentimin e tyre.

- Historiani i njohur Ibni Sirini ka thënë:» Sikur ta kisha në dorë atë Libër atëherë do ta kisha në zotërim gjithë shkencën. » (92)

- Imam Aliu a.s e rradhiti Kur'anin në mënyrë që t'ua shpjegojë dhe komentojë dituritë që i nevojiteshin dhe i duheshin ummetit islam.

- Pas zgjedhjes së Ebu Bekrit në Thekife për halif, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s u tërhoq dhe iu përkushtua veprimtarisë shkencore në komentimin e Kur'anit, në Xhaminë e Pejgamberit s.a.v.s-duke dhënë këshilla dhe fetva të ndryshme për çështje të nduarduarta, duke vazhduar jetën sikur udhëheqës fetar, për të cilën edhe vetë ka thënë:» Kur Muhammedi s.a.v.s u shpërngul në ahiret, u betova se nuk do t'i veshi teshat, gjersa nuk e mbledh/tubojë Kur'anin. » (93)

- Mus'hafin e Fatimesë; Pasiqë Imam Aliu a.s e përfundoi me tubimin e Kur'anit të Madhnueshëm; filloi të shkruaj përmbledhje porosishë, këshilla, hadithe që më vonë u njohtën me emrin si « Mus'hafi i Fatimes » a.s.

- « Sahifen-« Librin mbi shpërblësat (përkatësisht paratë që u jepeshin të dëmturëve të pafajshëm dhe atyre që pësonin.) Imam Buhariu dhe Imam Muslimi e kanë përmendur këtë »Sahife » të Imam Aliut a.s, ashtu siç e kanë përmendur edhe Ibn Sa'di në « Xha'miun... » e tij, si dhe dijetari Ahmed ibn Hanbeli.

- « El-Xhamiu'-n » përbledhjen e haditheve që Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s ia diktoi Imam Aliut a.s, e cila i tregon fetvatë (urdhërat fetare) të cilat u nevojiten njerëzve për t'i rregulluar çështjet që janë të lejuara (hallall) dhe të ndaluara (haram)-ashtu siç i ka caktuar Kur'ani i Madhnueshëm. Imamët e Ehlil-Bejtit a.s e trashëguan këtë libër i cili tepër u vyejt në jetë. Imam Xhaffer Es-Sadiku a.s flet mbi rëndësinë e këtij libri që Imamët e Ehlil-Bejtiti a.s e konsideronin vepër kapitale dhe bazë e cila ishte nxjerr nga Sheriati i All-llahut xh.sh, dhe gjersa e kanë, përkatësisht posedojnë këtë libër, njerëzit nuk u nevojiten, duke u shprehur: » Ne posedojmë diçka për shkak të së cilës nuk na nevojiten njerëzit, kurse ne atyre (njerëzve) u nevojitemi. Ne posedojmë librin që Pejgamberi s.a.v.s e diktonte, kurse Imam Aliu a.s e shkruante. Në këtë libër gjendet gjithçka që është lejuar (hallall) dhe gjithçka që është e ndaluar (haram). » (94)

- « Sahifetu El-Faraid »-in, librin i cili flet mbi trashëgimin dhe gjyqësinë. (95) Historianët transmetojnë se Imam Aliu a.s ka shkruar edhe disa vepra mbi zekatin, begatitë, fikhun dhe shkencën e Kur'anit të Madhnueshëm dhe të ngjajshme. (96)

- Librin «El-Xhaffer »; Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s ia diktonte Imam Aliut a.s fjalët e këtij libri, ndërsa ky libër flet për ardhmërinë, dhe librat e shenjtë të pejgambërëve të mëhershëm, si dhe për pejgamberët e ardhur para Shpalljes së Kur'anit. Ai personalisht vepër të tij më të çmuar e konsideronte ruajtjen e Sheriatit Islam, rregullat dhe parimet e komentimit të Kur'anit si dhe shpjegimin e synimeve të tij, veçanërisht nëpërmjet fikhut (jurisprudencës islame). Prandaj mendimi i tij gjithnjë ishte në përputhshëmi me përmbajtjet Kur'anore, kurse fjalimet e tij ishin këshilla dhe porosi që dilnin nga Kur'ani i Madhnueshëm ashtu siç vihen re edhe në « Nehxhul-Belaga » Shtegun e Elokuencës.
- « Shtegun e Elokuencës » (Nehxhul-Belagën) e cila është përmbledhje e fjalimeve, letrave, këshillave dhe porosive të tij, të cilat i ka mbledhur/tubuar Sherif Er-Radi i cili vdiq në vitin 406 të hixhretit; autor i kësaj vepre voliminoze është vetë Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s « Nehxhul-Belaga »-« Shtegu i Elokuencës » është vepër tejet voluminoze, ndaj nisur nga kjo këtë vepër e kanë komentuar dhe shpjeguar një numër bukur i madh dijetarëve dhe studjuesve të ndryshëm, siç janë p.sh Ebu Hasan El-Bejhekiu, Imam Fahrudin Er-Raziu, El-Ravendi, Muhammed Mejrem El-Bahrani, Izuddin ibn Ebi Hadid El-Madaini dhe Imam Muhammed Abduhu-ja e shumë të tjerë.
- « Musnedin » e Imam Aliut a.s të cilën e përmbledhi Ebu Abdurrahman Ahmed ibn Shajb El-Nisaiu i cili vdiq në vitin 309 hixhrijj. « Musnedi » I Imam Aliut a.s përmban thënie dhe hadithe të transmetuara nga Pejgamberi s.a.v.s.
- « Girar El-Hikam » dhe « Durar El-Kelam », të cilët i tuboi/përmbledhi Abdul-Vehid ibn Muhammed El-Amadi, dhe përmban një përmbledhje të shkurtër të udhëzimeve dhe parimeve të Imam Aliut a.s.
- « Matlub Kul-lu Talib min Kelam Ali ibn Ebi Talib, » të cilën e përmbledhi Ebu Is-hak El-Vetvatel Ansariu.
- « Mietu Kelime » (100 fjalë), të cilën e përmbledhi Ebu Amr El-Xhahizi.
- « Nasir El-La'ali' u; » të cilën e tuboi Abu Ali El-Fadili biri i Hasan El-Tubrusijjut, njëherit edhe autor i vepres « Mexhmaul-Bejan » e cila flet mbi tefsirin e Kur'anit të Madhnueshëm.
- « Kitabus-Siffin » të cilën e përgatiti Nasir ibn Muhazimi, edhe i cili përmban fjalime të shumta të Imam Aliut a.s.
- « Xhennetul-Esma » (« Xhenneti i emrave »); të cilën e komentoj Ebu Hamid Muhammed ibn Muhammed El-Gazali, i cili vdiq në vitin 505 hixhrijj.
- « Es-Sahifetu El-Alevijjetu »; të cilën e përmbledhi Abdull-llah ibn salih El-Samahixhijj, dhe përmban një numër të madh të lutjeve (duave) të Imam Aliut a.s.
- « Kalaid El-Hikam » dhe « Faraid El-Kelam »; të cilat i përmbledhi Ebu Jusuf El-Asfarajini. (97)
- Imam Aliu a.s paralajmëroi edhe për të ardhmen dhe ngjarjet që do të ndodhin. Mbi ardhmërinë dhe atë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen din vetëm All-llahu xh.sh e askush tjetër; mirëpo Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s nëpërmjet Shpalljes (Vahjit) merrte informacione për atë se çka do të ndodh në të ardhmen; ndërsa Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s i rrëfente për këto Imam Aliut a.s, kurse Imam Aliu a.s falë diturisë me të cilën e kishte dhuruar All-llahu xh.sh arinte të jep vetë disa konkluzë lidhur me atë se çka do të ndodh në të ardhmen, gjithnjë duke u inspiruar nga All-llahu xh.sh. Siç e kemi parë edhe më herët në këtë libër, Imam Aliu a.s shpesh-herë u drejtoheshte të pranishmëve:» Më pyetni para se të më humbni! Nëse më pyetni për një grup njerëzish se cilët njëqind prej atij grupi do të shkojnë rrugës së drejtë dhe cilët njëqind të tjerë rrugës së humbjes/ shkatërrimit, mund lirisht t'ua tregojë, gjithashtu t'ju lajmërojë se

kush është prijësi i tyre, si dhe kur dhe ku do të ndalen, madje edhe atë se kush nga ato do të vritet dhe kush do të ketë vdekje normale. » (98)

- Ndjekësit besnikë të cilët siqerisht kanë transmetuar gjithçka nga jeta e Imam Aliut a.s gjithashtu na përcjellin neve edhe për personalitetin e tij të madh që kishte si dhe pozitën e tij të lartë shpirtërore e cila e inspironte rreth dijeve mbi të ardhmën që do të ndodhin në sipërfaqe të tokës, si dhe mbi individët dhe grupet e njerëzve. Historianët kanë përcjellur nga Imam Aliu a.s vetëm një pjesë të thënieve të tij mbi ardhmërinë.

- Suedj ibn Gafle transmeton se Imam Aliu a.s një ditë mbajti një fjalim nga minberi, kur një njeri nga të pranishmit iu drejtua:» O Prijës i besimtarëve! Isha në fushën e fshatit ku e gjeta Halidin birin e Arfatit të vdekur, ndaj jepja faljen/hallallëkun, » Imam Aliu a.s u përgjigj: » Pasha All-llahun! Ai nuk ka vdekur e as që do të vdes para se të t'ju bashkangjitet një grupi të humburish me në krye Habibin birin e Hemarit. » Atëherë njeriu u çua në këmbë dhe tha:» Unë jam Habibi biri i Hemarit. Për All-llahun unë jam nga ithtarët e tu dhe admirues i joti. Imam Aliu a.s i tha:» ti je Habibi biri i Hemarit ?, njeriu u përgjigj:» Po. » Atëherë Imam Aliu a.s i tha:» Për Zotin, ti do ta mbash flamurin e tyre, dhe të hyni nga kjo hyrje; »- duke bërë me dorë në drejtim të ashtuqjtarës rruga e « elafantit » e Kufes.

- Sebet Esh-Shimali transemeton:» Për Zotin! Kam jetuar gjatë kohës kur Ibn Zijadi të cilin e kishte dërguar Omeri biri i Saadit, kundër Imam Husejnit a.s, kurse udhëheqës i atij grupi ishte Habibi biri i Hemarit, dhe hyrën pikërisht nga hyrja e ashtuquajtur « elefanti. ».

- Shamir ibn Sadir El-Ezidi transmeton:» Me një rast Imam Aliu a.s i rrëfente Amrit birit të Humk El-Huzajut si vijon:» Amër, pas meje do të vritesh, kurse koka jotë do të bartet nga një vend në vendin tjetër-mjerr për vrasësin tënd.

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s që më herët paralajmëroi për ardhjen në pushtet të bijëve të Mervanit, të cilët vërtetë sunduan pas Umejëve.

- Thënia e Imam Aliut a.s për Mervan ibn Hakimin dhe katër djemtë e tij, ishte tepër domethënëse, të kujtojmë se Imam Aliu a.s kishte thënë:» Ai është babai i katër përçarësve/shkatërruesve. Njerëzit do të përjetojnë nga ai dhe bijtë e tij ditë të zeza. » (99)

- Azadi, më pas shton:» Për Zotin, nuk kaloi shumë kohë nga vdekja e Imam Aliut a.s dhe gjatë sundimit të Muavijut, Amri u vra në Irak, kurse koka e tij u bartë prej Irakut në Damask tek Muaviju. » (100)

- Imam Aliu ibn Ebu Talibi a.s kishte aftësi të parashikojë ngjarjet. Kështu është i njohur:

- Paralajmërimi (profecia) që bëri për veten e tij se si do të goditet me shpatë në kokë nga Ibn Mulxhem, paralajmërimi se si Muaviju do të rrëmbejë pushtetin musliman;

- Paralajmërimi për vrasjen e Imam Huseinit në Qerbela;

- Paralajmërimi mbi vrasësin e Haxhaxh Jusuf Eth-Thekafiut, si dhe çfarë do të ndodhë me të;

- Paralajmërimi për kryengritjen/rrebelimin e Abdull-llah bin Zubejrit dhe mos-suksesin e tij;

- Paralajmërimi për shkatërrimin e qytetit të Basrës gjatë përmytjes;

- Paralajmërimi për vrasjen e Muhammedit, të ashtuquajturit « shpirti i pastër »; dhe vëllait të tij Ibrahimit pas kryengritjes së tyre kundër Abbasitëve;

- Lajmërimi që ia bëri Abdull-llah ibn Abbasit se fëmijët e tij do ta pranojnë pushtetin islam;



- Paralajmërimi për ardhjen e Imam Mehdiut a.s dhe formimin e shtetit të bekuar islam. (101)

**TESTAMENT I IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S  
SHKRUAR BIRIT TË TIJ HASANIT, KUR  
PRIJËSI I BESIMTARËVE- PO  
PUSHONTE NË HADIRIN, DUKE  
U KTHYER NGA SIFFINI:**

- Prej prindit i cili është i vdekshëm, i cili i pranon vështirsitë e kohës, i cili ia ka kthyer shpinën jetës, i cili i është dorëzuar fatit të kohës, i cili e qorton këtë botë, i cili banon vendbanimet e të vdekurve dhe i cili nesër do t'i braktisë-djalit i cili lakmon atë që nuk mund të arrihet, i cili ecë rrugës së atyre që janë zhdukur, i cili është shënjestër e sëmurjeve, i cili është syrgjyn i ditës i cili është viktimë e vuajtjeve, rob i kësaj bote, tregtar i mashtrimit të saj, obligues i dhëshirave, i vdekjes, aleat i brengave, shokë i mjerimit, viktimë e vuajtjeve, i cili është i pushtuar nga pasionet dhe i cili është pasardhës i të vdekurve!

Kurse tani, vërtet, atë që e kam kuptuar nga rrotullimi i kësaj bote rreth meje, nga sulmet e furishme të kohës ndaj meje dhe të afruarit e asaj bote, mjafton të më mbrojnë nga të kujtuarit e kujdo qoftë, pos të vetes dhe nga të persiaturit jashtë vetes. Mirëpo, kur të kufizohen në brengat e mija duke i lënë brengat e të tjerëve, mendja ime më shpëton dhe mbron nga dëshirat e mija. Kjo spastron çështjet e mija dhe më udhëheq drejt seriozitetit, ku nuk ka lojë, dhe drejt së vërtetës e cila nuk është turbulluar me gënjështre. Të konsideroj pjesë të vetëvetes; më saktësisht- të konsideroj tërësi timen. Kështu, nëse të ndodhë diç, ajo është sikur të më ndodhë mua. Dhe nëse vdekja të vjen, është njësoj si të më vinte mua. Ajo që është e jotja më intereson njësoj si edhe ajo që është e imja. Prandaj, po ta shkruaj këtë këshillë si rrugë të kërkimit të ndihmës përmes saj, qoftë se mbeten gjallë, qoftë se nuk do të egzistoj më.

Të këshilloj të jesh i vetëdijshëm ndaj Zotit, biri im, të jesh i patundur në dispozitat e Tij, ta përmbush zemrën tënde me përkushtim ndaj Tij dhe të mbahesh për litarin e Tij. Cila lidhje është më e sigurt se lidhja midis teje dhe Zotit, nëse mbahesh për litarin e Tij?!

Fresko zemrën tënde me këshillë të mirë, qetësoje atë me durim, forcoje atë me besim të qëndrueshëm, ndriçoje me urtësi, bëre të përvujtur duke kujtuar vdekjen, nxite të besojë në kalueshmëri, mundësoj të shikojë vuajtjet e kësaj bote, paralajmëroje për fuqitë e kohës dhe shpejtësinë e ndrrimit të natës dhe ditës, njohtoje me ngjarje e popujve të lashtë, përkujtoja atë që u ka ndodhur atyre të cilët kanë qenë para teje, si dhe kalo midis vendbanimeve dhe gjurmëve të tyre, shiko ate që kanë bërë, prej ç' vendi janë larguar nga miqët dhe janë vendosur në shtëpitë e vetmisë. Së shpejti do të jeshë i ngjajshëm me ndonjërin prej tyre. Prandaj përgaditë vendin e qëndrimit tëndë dhe mos e shit botën e ardhshme tënden për këtë për këtë botë.

Hiqu diskutimit rrethë asaj për çka nuk ke njohuri dhe mos fol lidhur me atë që nuk ka të bëjë me ty. Largohu nga shtegu nga i cili frigolesh që të mos humbesh, ngase të përbajturit, kur ekziston friga nga të shtemëngurit, është më i mirë se të përzierit në punë të rrezikshme. Urdhëro për punë të mira, do të jeshë nga të mirët. Pengo kryerjen e

veprave të këqia me dorë e fjalë dhe përpiqu të jesh sa më largë atij që bënë keq. Lufto në emër të All-llahut, me luftë të sinqertë dhe mos të largojë kurrë një qortim nga Zoti. Hedhu në rrezik për të Vërteten, kudo qoftë ajo, dhe orientohu në të kuptuarit e fesë. Mëso shpirtin tënd të pësojë vuajtje, meqë vetia më e mirë e karakterit është durimi në çeshtjet e së Vërtetës në të gjitha punët tua mbështetu te Zoti yt, ngase ashtu do të mbështetesh në ndihmtar të sigurt dhe mrojtës të fortë. Kërko vetëm nga Zoti yt, ngase Ai në dorë ka gjithçka, dhënjen dhe refuzin. Kërko të mira sa më shumë që mundesh. Kuptoje këtë porosi timen dhe mos e harro kurrë, ngase me të vërtetë fjala më e mirë është ajo e cila sjell dobi. Dhe dije se nuk ka kurrë një të mirë nga dituria e cila nuk sjell dobi. Nëse dituria nuk është e dobishme, atëherë as mësimi i saj nuk është i arsyeshëm.

Biri im, kur kuptova se jamë plakur mirë dhe kur hetova se po ligështohem, nxitova ta lë këtë amanet ty dhe i paraqita këshillat kryesore të saj, ashtu që vdekja të mos më arrijë para se ta zbuloj atë që më flenë në zemër, para se urtia ime të goditet siç është goditur trupi im dhe para se të mposhtin fuqitë e pasionit dhe tundimet të kësaj bote, duke të bërë si deve kokëfortë. Zemra e të riut vërtet është si ara e papunuar, e cila pranon çdo gjë që hedhet në te. Nxitova pra të këshilloj para se zemra të ngurtësohet dhe përmes mendjes tënde frytet e përvojave të tjerëve. Kështu do të ishte kursyer që vetë të kalosh nëpër këto përvoja. Në këtë mënyrë do ta shmangish barrën e kërkimit të tyre dhe do të ruheshë nga vështirsitë e përpjekjeve. Me këtë arrin njohuri mbi atë që na e kemi përjetuar, e kupton madje edhe atë që na ndoshta e kemi lëshuar.

Biri im, edhe nëse nuk arrita moshën që e arritën ata para meje, megjithatë i kam shqyrtuar veprat e tyre dhe kam menduar mbi ngjarjet nga jeta nga jeta e tyre. Kam ndjekur gjurmët e tyre, ashtu që jamë bërë si ata; në realitet, përmes asaj që kam mësuar nga ata sikur kam jetuar me ta prej fillimit gjerë në fund. Prandaj kam qenë në gjendje të dalloj atë që është e pastër nga ajo që është e flliqur dhe atë që është e dobishme nga ajo që është e dëmshme.

- Kam zgjedhur për ty më të shkëlqyeshmen dhe kam mbledhur për ty gjërat më të dobishme, kurse kam largua nga ti gjërat e padobishme. Meqenëse të kuptoj siç duhet të kuptojë prindi i zgjuar dhe meqë dëshiroj të mësoj, mendova se kjo duhet të jetë në kohën kur ti rritesh dhe gjersa je i freskët në skenën e botës, duke pasur qëllim të sinqert dhe zemër të çiltër dhe se do të duhet filluar me mësimin e Librit të Zotit (Kur'anin) të Madhnueshëm dhe Fuqiplot, dhe me komentimin e tij, dispozitave të Islamit dhe rregullave të tij, mbi atë që ai ndalon dhe largon, si dhe që nuk duhet dalur jashtë tyre për të mirën tënde. mandej u frikova të mos ngatërrohesh në paqartësi siç janë ngatërruar të tjetër për shkak të pasionit dhe mendimit të tyre. Madje edhe krahas ndjenjës time të prirjes ndaj kësaj mënyre të paralajmërimit, u binda se më mirë është të forcoj këtë gjendje se të të lë në pozitë në të cilën nuk konsideroj se je i sigurt nga të rënit në humnerë. Kam shpresuar se All-llahu do të ndihmoj në të gjykuarit tënd dhe do të udhëheqë në qëllimin tënd. Prandaj po ta lë si obligim këtë porosi timen.

- Dije, biri im, ajo çka dëshiroj më së shumti që ta përvetësosh nga porosia ime është që të kesh përkushtim ndaj All-llahut, të përkufizohesh në atë që All-llahu të ka bërë obligim dhe të ndjekësh veprat e të parëve tu dhe njerëzve të devotshëm nga Familja jote. Ata nuk kanë harruar të kujdesen për vete, siç kujdesesh edhe ti dhe të gjykojnë siç gjykon edhe ti. Dhe kjo mandej i solli që të pranojnë atë që e kanë mësuar, por zemra jote nuk e pranon këtë pa fituar njohuri siç e kanë fituar ata, atëherë kërkesa

jote le të jetë me mirëkuptim dhe mësim, e jo me zhytje në dyshim ose ngatërrim në polemika.

- Para se të pranosh këtë, kërko ndihmë nga All-llahu yt dhe lutu të mundësojë të kesh sukses dhe të braktisësh tërë atë që do të flakë zemrën në dyshim ose do të shpie në hutë. Kur të bindesh se ke zemër të pastër dhe të përvuajtur dhe se të menduarit tënd është plotësuar dhe përmbledhur, si dhe që kjo të është bërë brengë e vetme, ahëre do të kuptosh atë që ta kam sqaruar. Mirëpo, nëse nuk je i aftë të arijshtë urtinë e të vëzhguarit dhe të përsiaturit të cilin dëshiron ta posedosh, atëherë dije se vetëm e shkelë tokën si deve e verbër dhe se zhytesh në errësisë, gjersa ai i cili bredh nëpër terr dhe krijon ngatërrim nuk është gjurmues i vërtetë i besimit (imanit). Më mirë është të heqësh dorë nga kjo.

- Përpiqu drejtë ta kuptosh këshillën time, biri im, dhe dije se All-llahu i vdekjes gjithashtu është edhe Zot i jetës, që Ai i Cili krijon gjithashtu edhe zhdukë, se Ai i Cili shkatërron gjithashtu është edhe Përtëritës i jetës dhe se Ai i Cili jep sëmundje gjithashtu është edhe Shërues. Kjo botë zhvillohet në mënyrën të cilën e ka përcaktuar All-llahu për të në raport me kënaqësitë e saj, sprovat, shpërblimet në Ditën e Gjykimit dhe tërë atë që Ai dëshironë por ti nuk din. Nëse diç nga kjo nuk ke kuptuar, atëherë këtë hedhja paditurisë tënde mbi këtë, ngase kur je lindur, je lindur si i padijtur. Pastaj ke fituar njohuri. Ka shumëçka për çka nuk ke dijtur dhe për çka luhatet mendja jote dhe bredh shykimi yt, por më vonë e njeh. Prandaj, mbështetu te Ai i Cili të ka krijuar, të ka pajisur dhe të ka bërë komplet. Shërbimi yt le të jetë për Te, përkushtimi yt ndaj Tij, kurse frika jote nga Ai.

- Diej, biri im, se asnjëri nuk ka rrëfyer mbi Zotin Lavdiplot siç ka rrëfyer Pejgamberi-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!- Prandaj bëhu i kënaqur me të si udhëheqës. Dhe njëmend, madje edhe nëse përpiqesh fort, nuk do të mund të arrijshë mirëqenien të cilën unë e dëshiroj për ty.

- Dije, biri im, sikur Zoti të kishte shok, gjithashtu do të arrijnin edhe pejgamberët e Tij, dhe ti do të shikoje shenjat e pushtetit dhe fuqisë së Tij, si dhe do të kuptoje veprat dhe cilësitë e Tij.

- Por, Ai është All-llahu, Një dhe i Vetëm, siç e kë përshkruar Ai Vetën e Tij. askush nuk mund t'i kundërvihet pushtetit të Tij. Ai është ngaherë dhe përherë. Ai është para çdo gjëje, pa kurrëfarë fillimi dhe Ai është i fundit, pa kurrëfarë mbarimi. Ai është aq i Madh sa zotërimi i Tij nuk mund të përfshihet me zemër ose sy. Kur ta kuptosh këtë, atëherë duhet të bësh atë që do të bënte i ngjashmi me ty krahas gjendjes së ulët të tëndes, mungesës së fuqisë tënde, paaftësinë e shtuar dhe nevojën e madhe tënden për Zotin tënd në të kërkuarit e përkushtimit ndaj Tij, duke u frikësuar nga dënimi i Tij dhe duke u temrruar nga mllef i Tij, ngase Ai vërtet nuk të ka urdhëruar asgjë pos asaj që është e mirë dhe nuk të ka ndaluar asgjë pos atë që është e pahijshme.

- Birim im! Të kam lajmëruar për këtë botë, gjendjen e saj, tatëpjetën dhe kalueshmërinë e saj. Të kam lajmëruar edhe mbi botën tjetër dhe mbi atë çka është përgatitur në të për banorët e saj. Të kam paraqitur shëmbuj mbi këto, ashtu që të nxjerrësh mësim prej tyre dhe të veprosh në përshtatje me ta. Shembulli i atyre që e kanë kuptuar këtë botë është sikur ai i udhëtarëve të cilët, duke ndërë urrejtje ndaj viseve të goditura nga thatësia, nisen në drejtim të viseve të gjelbëruara dhe pjellore, madje përjetojnë vështitësi në rrugë, ndarje nga miqtë, vuajtje gjatë udhëtimit dhe ushqim bajat për të arrijtur hapësirat e vendosjes së tyre dhe vendin e qëndrimit të tyre. Prandaj ata, në këtë nuk ndiejnë kurrëfarë dhimbjeje dhe asnjë shpenzim nuk e konsiderojnë pësim. Asgjë nuk e adhurojnë më shumë se ajo që i afron të caku i tyre

dhe që shpie më afër vendit të qëndrimit. Kurse shembulli i atyre që mashtrohen nga kjo botë është si ai i njerëzve të cilët kanë qenë në vise të gjelbëruara, por u është bërë i urrejtur dhe shkojnë në viset e goditura ngë thatësia. Prandaj për ta nuk ka asgjë më të urrejtur ose më të shëmtuar se të lëshuarit e vendit nga i cili duhet të largohen në vendet në të cilat befasi do të arrijnë dhe drejt të cilave janë nisur.

- Biri im! Bëre veten tënde masë në atë që ekziston midis teje dhe të tjerëve. Kështu, dëshiroja tejtrit atë që ia dëshiron vetes, kurse urreje tek ai atë që e urren në ty. Mos tiranizo, siç nuk dëshiron të të tiranojnë edhe ty. Bën mirë! Siç dëshiron që edhe ti të të bëjnë mirë. Konsidero të ligë për vete çdo gjë që e konsideron të ligë për të tjerët. Kënaqu me njerëzit me atë që nuk ke njohuri, madje as për atë çka din relativisht pak. Mos u thuaj të tjerëve atë që nuk ke dëshirë të të thuhet ty.

- Dije se të mahniturit me vetveten është në kundërshtim me drejtësinë dhe mjerim për medjen. Prandaj, shto përpjektjet tua dhe mos u bën thesar për tjetrin. Kur je i prirë në Rrugë të drejtë, bëhu pëndestar para Zotit tënd sa më shumë që mundesh.

- Dije e para teje qëndron një rrugë shumë e gjatë dhe plot halle të ashpra dhe që nuk mund të shmangesh nga të kërkurit e saj. Kurrësesi mos e rëndo shpinën më shumë seç ka fuqi, ashtu që kjo barrë të bëhet vuajtje. Sa herë që takon një person i cili ka nevojë për ndihmë dhe i cili mund ta bartë pajisjen tënde deri kur të rikthehet në Ditën e Gjykimit, kur të nevojitet, atëherë pranoje si rast të mirë dhe afroji që ta bartë atë pajisje. Ngarko në të sa më shumë që mundesh, ngase ndoshta do ta kërkojë, por nuk do të mund ta gjejsh. Nëse një person dëshiron të huazojë nga ti në kohën tënde kur ke shumë, për ta kthyer në kohën e nevojës tënde, ahëre shfrytëzoje këtë rast.

- Dije se përpara teje ekziston përpjetë e mundimshme dhe rrepinët, në të cilën personi me barrë të lehtë do të jetë në pozitë më të mirë se ai me barrë të rëndë, kurse ai i ngadalshmi në të do të jetë në pozitë më të keqe se ai i shpejti. rezultati yt i fundit i kalimit të saj pa dyshim do të jetë ose Xhenneti ose Xhehennemi. Prandaj hapu sytë!, në dobi tënden, para të zbriturit dhe përgatit vendin para të arrijturit, ngase pas vdekjes nuk ka kurrëfarë afrimi, e as kthim në këtë botë.

- Dije se Ai në pushtetin e të Cilit janë thesarët e qijve dhe të tokës, të ka lejuar t'i lutesh Atij dhe të ka premtuar pranimin e lutjes. Ai të ka urdhëruar të kërkojë nga Ai, në mënyrë që të të ofrojë, dhe të kërkojë mëshirën (rahmetin) e Tij, në mënyrën që të të mëshirojë. Ai nuk ka vendosur asgjë midis teje dhe Atij çka do të mbulonte nga Ai. Ai nuk të detyron që për vete të sigurosh ndërmjetës te Ai. Kurse, nëse gabon, Ai nuk do të pengojë të pendohesh. Ai nuk nxiton në ndëshkim. Ai nuk qorton nëse pendohesh, as të turpëron kur turpërimi yt është me vend. Ai nuk është i ashpër ndaj teje në të pranuarit e pendimit. Ai nuk të provon me ashpërsi për ghyahet e tua. Ai nuk të dëshpron me mëshirën e Tij. aq më tepër, largimin tënd nga gjynahet Ai e numëron në vepra të mira. Ai një gjynah tëndin e llogarit si një, kurse një vepër të mirë tënden e llogarit si dhjetë.

- Ai ta ka hapur portën e pendimit (teubes) dhe portën e kënaqësisë. Prandaj, sa herë që e fton Ai e dëgjon thirrjen tënde, ndërsa kur i drejtohesh fshehurazi, Ai din për thirrjen tënde të fshehtë. Çfaqja para Tij kërkesat tua, ankoju Atij për hallet tua, lute të të lirojë nga vuajtjet, mbështetu në Ndihmën e Tij në punët e tua dhe kërko nga thesarët e mëshirave të Tij atë që askush tjetër nuk mund të ofrojë, e kjo është gjatësia e jetës, shëndetin e trupit dhe begatinë e pajisjes. Pas kësaj, Ai t'i ka lënë çelësat e thesarëve të Tij në duart tua, me atë që të ka lejuar të kërkojë nga Ai.

- Prandaj me lutje (dua) hapu portat e të mirave të Tij, kudo që dëshiron, ashtu që reshjet e bujshme të mëshirës së Tij të derdhen mbi ty. Vonimi i pranimit të Tij nuk guxon të të dëshprojë, meqë vërtet shpërblimi është në përmasë të qëllimit. Pranimi

ndoshta është shtyrë në mënyrë që për kërkuesin vrulli i shpërblimit të jetë më i madh dhe shpërblimi më i begatë për atë që e kërkon. Ndoshta ke kërkuar diç që atëherë të është dhënë, por së shpejti ose më vonë të është dhënë (dhuruar) diç më mirë se kjo, ose të është refuzuar ngase është më mirë për ty. Ndoshta ti ke kërkuar shumë gjëra të cilat, po të jepeshin, do të paraqesin dëm për besimin tënd. Prandaj, kërkimi yt duhet të jetë për hir të asaj bukuria e së cilës është e përhershme dhe barra e së cilës do të mbetet larg nga ti. Sa i pëket pasurisë, ajo nuk do të jetë përjetë jotja, e as që ti do të jeshë përherë i saj.

- Dije, biri im, si ti je krijuar për botën tjetër-ahiretin e jo për këtë, përzhdukje e jo për jetë të amshueshme, për vdekje e jo për jetë. Ti ndodhesh në vendin i cili nuk të përket, në shtëpinë e përgatitjes dhe në rrugë drejt botës tjetër. Je i ndjekur nga vdekja, nga e cila ikanaku nuk mund assesi të ikë, pasi që ajo, me siguri, do të mposhtë. Prandaj bëhu i kujdes-shëm ndaj saj (vdekjes) për të mos të të mposhtë befaz, kur je në gjendje të gjynahut dhe mendon mbi të penduarit (teuben), por ajo sajton pengesa midis teje dhe teubes. Në këso raste, do ta humbësh veten.

- Biri im! Kujtoje shpesh vdekjen dhe vendin ku do të shkosh befaz dhe do të arrijshë pas vdekjes, kështu që kur arrijë, të jeshë i kujdes-shëm ndaj saj dhe ta kesh përgatitur veten për të, kështu që ajo (vdekje) të të mos të vijë krejt papritur dhe mos të zëjë të papërgatitur. Kij kujdes të mos të mashtronjë prirjet e njerëzve ndaj kënaqësive të kësaj bote dhe mësymja e tyre në to. All-llahu të ka paralajmëruar lidhur me këtë, kurse kjo botë të ka lajmëruar mbi kalueshmërinë e saj dhe t'i ka zbuluar ligësitë e saj.

- Me të vërtetë, ata të cilët janë për të, janë të ngjashëm me qentë që lehin, ose bishat gjakatare të cilat i ngërmohen njëra-tjetrës. E forta e han të dobtën dhe e madhja e shkel të voglën. Disa janë si bagëti e lidhur kurse disa si ajo e zgjidhur, që janë çoroditur dhe vrapon në drejtime të panjohur. Ata janë kope vuajtjesh që bredhin fushave të përhimta. Nuk ka bari që do t'i mbante, e as që ndonjëri dëshiron t'i marrë në kullosë. Kjo botë i shpie rrugës së verbësisë dhe ua kthen shikimin nga fanari i udhëzimit.

- Prandaj, ata janë të ngatërruar në konfuzionin e saj dhe zhyten në kënaqësitë e tij. E marrin si Zot, andaj ajo luan me ta, kurse ata luajnë me të dhe harrojnë atë që vjen pas saj.

- Errësira ngadalë zhduket. Tani është sikur udhëtarët zbresin nga kuajt, kurse ata të cilët nxitojnë do të arrijnë së shpejti. Dije biri im, se ai në shalën e natës dhe ditës bartet te ata, edhe nëse rrin i qetë, dhe kalon distanca të mëdha, edhe nëse qëndron edhe nëse pushon.

- Dije me siguri se nuk mund të realizosh dhëshirën tënde dhe të tejkalosh afatin e caktuar dhe se je në rrugë të atyre para teje. Prandaj bëhu i përvuilur në të kërkuar dhe fito në mënyrën më të mirë, ngase ka shumë kërkesa të cilat shpiejnë më humbje. Nuk është shpërblyer çdo kërkues me pajisje, as është privuar çdonjeri i cili kërkon në mënyrë të duhur. Ngrite shpirtin tënd mbi çdo prapësi, edhe nëse të çon drejt qëllimeve të preferuara, ngase kurrë nuk do të mund ta kompenzosh atë-që e ke flijuar prej vetes tënde. Mos u bënë rob i tjetërkujt, ngase All-llahu të ka krijuar të lirë. Nuk ka të mirë nga e mira e cila arrihet përmes të keqes dhe nuk ka kurrëfarë të mire në kënaqësinë e cila arrihet përmes vuajtjeve.

- Kujdesu të të mos të bartin kujat e lakmisë dhe të mos të të përplasnin në zjarrin e shkatërrimit. Nëse mund të ndikosh që të mos ketë ndonjë person të pasur midis teje dhe Zotit, bëre këtë, meqë gjithësesi do të gjesh atë që të mjafton dhe do të marrësh hisen

tënde. E pakta e fituar drejt nga Zoti Lavdiplot, është më e madhe dhe më fisnike nga e fituara përmes krijesave të Tij, ndonëse çdo gjë rrjedh nga Ai.

- Është më e lehtë të përmirësosh atë që e ke lëshuar me heshtjen tënde, se ta arrijshë atë që e ke humbur me të folur. Ajo që ndodhet në enë rruhet me vendosjen e kapakut. Më qejd kam dëshirë ta ruash atë që e kë në dorë, se të kërkosh atë që ndodhet në duart e tjetrit. Më e mirë është idhëtina e disfatës, se të kërkuarit nga njerëzit. Puna e ndershme me dorë është më e mirë se pasuria në imoralitet. Njeriu është rojtari më i mirë i fshehtësive të tij. ka shumë që punojnë në atë që i dëmton. Ai i cili flet shumë-flet-përçart. Kush mendon-kupton. Shoqërohu me njerëz të ndershëm-do të jesh një prej tyre. Qëndro larg nga njerëzit e korruptuar-do t'i braktisë ata. Ushqimi më i keq është ai që është i ndaluar. Shtypja e të dobët është tirranizimi më mizor. Atje ku mirësia nuk përshtatet, ashpërsia është mirësi. Shpesh ndodhë që ilaci është sëmundje, kurse sëmundja ilac. Shpesh dashakeqi të këshillon drejt, gjersa dashamiri të mashtron. Ruaju nga të mbështeturit në dëshira, ngase ato janë veshje të vdekurish. Është urti ta mbash mend përvojën e dikujt. Përvoja më e mirë e jotja është ajo e cila të mëson. Nxito dhe shfrytëzo rastin para se të shndërrohet në pikëllim të rëndë. Çdo kërkues nuk gjen, as çdo i shkuar kthehet. Prishja e pajisjes dhe fitimi i ghyhahut për Ditën e Gjykimit-do të thotë shkatërrim. Çdo gjë ka pasojë. Ajo që e ke kismet do të arrijë. Tregtar është ai i cili i ekspozohet humbjes. E pakta shpesh është më e dobishme se e shumta. Nuk ka asnjë të mirë nga ndihmësi i keq dhe miku i pasigurt. Bëhu i epur ndaj kohës gjersa të përshtatet. Mos rreziko asgjë duke pritur diç më shumë nga kjo. Kujdesu të të mos të pushtojë ndenja e armiqësisë.

- Sillu ndaj vëllait tënd ashtu që ta ruash lidhjen familjare edhe ai nëse nuk e përfillë. Kur ai të largohet, bëhu i sjellshëm ndaj tij dhe afroju. Kur të shtrëngojë dorën gjatë dhënies së lëmoshës, shpenzo për te. Kur ai të largohet ti afroju. Kur ai është i egër, ti bëhu i butë. Kur ia të bëjë gjynah, mendo mbi pretekstin e tij ashtu sikur ti të jesh rob kurse ai zot-dashamirës yti. Dhe ruaju që këtë të mos e bësh atje ku nuk është vendi, ose të mos ia bësh atyre që nuk e meritojnë. Mos e merr kurrë armikun e mikut tënd për mik, ngase kështu do të bëhesh armik i mikut tënd. Jepi këshillë të drejtë vëllait tënd, qoftë e mirë ose e hidhur. Gëlltite zemërimin, ngase nuk kam gjetur asgjë më të ëmbël se kjo në fund, dhe asgjë më të favorshme në përfundim. Bëhu i butë ndaj atij i cili është i vrazhdë nda teje, ngase është për t'u besuar se së shpejti ai do të bëhet i butë ndaj teje. Sillu më mirë ndaj armiqëve të tu, ngase kjo është më e mirë se dy suksese. Nëse ke ndërmend të prishesh me vëllain tënd, lëri pak hapësirë nga ana jote me të cilën ai sërish mund të fillojë miqësinë, nëse një ditë do të dëshironte. Nëse ndonjëri ka mendim të mirë mbi ty, besoj mendimit të tij. Mos lër anash të drejtën e vëllait tënd, duke u bazuar në marëdhëniet midis atij dhe ty, ngase nuk është vëlla ai të drejtën e të cilit e ka cenuar. Mos të jenë anëtarët e familjes tënde njerëzit më të varfër për shkak tëndin. Mos pretendo nga ai i cili është i rezervuar ndaj teje. Mos të jetë vëllai yt më i vendosur në këputjen e lidhjes me ty, seç je ti në të kultivuarit e kësaj lidhjeeje. Dhe kurrë mos lejo që ligësia të jetë më e fortë se veprat tua të mira. Aspak mos të bie vështirë tiranizimi i atij që të tiranizon, ngase ai vërtetë nxiton që ta dëmtojë veten dhe të sjell dobi ty. Nuk është kompenzim gjegjës që t'i shkaktosh dëm atij i cili ta bën qejfin.

- Dije, biri im, se ekzistojnë dy lloje të pajisjes: pajisja të cilën e kërkon, dhe pajisja e cila të kërkon ty, ashtu që nëse ti nuk i afrosh asaj, ajo do të vijë te ti. Sa e shëmtuar është përlulësia kur ke nevojë dhe vrazhdësia kur je i pavarur! Nga kjo botë duhet të posedojsh vetëm atë me çka mund të përmirësosh venndbanimin tënd të

përjetshëm. Nëse pikëllohesh për atë që të ka dalur nga dora, atëherë pikëllohu edhe për gjithë atë që nuk ka arrijtur fare te ti. Konkludo mbi atë që akoma nuk ka ndodhur, prej asaj që tanimë ka ndodhur, ngase këshilla publike nuk sjell dobi përderisa nuk u shkakton dhimbje, ngase i mençuri e pranon porosinë nga këshillat, gjersa shtazët i mëson kamxhiku.

- Dëbo prej veti sulmet e fuqishme të brengave me forcën e durimit (sabit) dhe pastërtinë e besimit. Ai që nuk e përfill të përmbajturit-e humb rrugën. Shoku është si farefisi. Miku është ai-mungesa e cilit gjithashtu dëshmon miqësinë. Pasioni është shok i verbërisë. Ka shumë të largët të cilët janë më të afërt-se të afërmit, dhe ka shumë të afërt të cilët janë më të largët-se i largëti. I huaji është ai i cili nuk ka miq. Ai i cili e thyen të drejtën e ngushton rrugën e vet. Kush kufizohet me masën e vet, është i qëndrueshëm në këtë. Lidhja më e sigurt në të cilën mbështetesh është lidhja midis teje dhe All-llahut të Madhëruar. Ai i cili nuk kujdeset për ty, është armiku yt. Kur makutëria të çon në shkatërrim, heqja dorë është arritje. Nuk është çdo mangësi e dukshme, as çdo rast të shfrytëzohet.

- Shpesh ai i cili shikon e huq shtegun , gjersa i verbëri gjen rrugën e drejtë. Vono të bërit keq, ngase mund të shpejtosh kur të duash. Braktisja e të padijturit është baras me të vizituarit e të dijturit. Ai i cili këtë vazhdimësi e konsideron të sigurtë-ajo do ta tradhtojë; atë i cili e mban për të madhe-ajo do ta poshtërojë. Nuk qëllon çdonjëri që gjuan.

- Kur ndërron pushteti, ndryshon edhe koha. Për bashkëudhëtarin pyet para nisjes në rrugë dhe për fqinj para blerjes së shtëpisë. Ke kujdes që në diskutimin tënd të mos përmendësh diç që bën të qeshesh, madje edhe nëse këtë e transmeton nga dikush tjetër.

- Ruaju këshillimeve me gra, ngase mendja e tyre është e dobët, kurse vendosmëria e tyre e pasigurt. Mbulo shikimet e tyre duke i mbajtur nën vel, ngase rigoroziteti i mbulimit është mbrojtje e tërësishme. Të dalurit e tyre ndër njerëz nuk është më keq se aprovimi yt që një njeri i pasigurt t'i vizitojë. Nëse mund ta rregullosh ashtu që ato të mos njohin asnjë tjetër pas teje-bëre këtë. Mos i lejo gruas asgjë tjetër, pas asaj që është për vetë atë, ngase vertetë gruaja është si bimë aromatike dhe jo prijes.

- Mos trego respekt ndaj saj jashtë së vërtetës për te. Mos e nxit që të ndërmjetësojë për të tjerët. Ruaju nga xhelozia e pavend në formë të dyshimit, ngase kjo frmrës së shëdoshë i sjell sëmurje, ndërsa atë të virtytshmen e hedh në dyshim.

- Për çdo njërin nga shërbetorët tu përcakto një punë për të cilën mund ta konsiderosh përgjegjës. Në këtë mënyrë ata nuk do të mund ta hedhin punën prej njërit tek tjetri duke të shërbyer ty. Respekto farefisin tënd të afërm ngase ata janë krahët me të cilët flutoron, pikënisje ku do të kthehesh dhe suar me të cilat sulmon.

- Mbështete besimin tënd në mbrojtje të Zotit dhe kërko nga Ai që të caktojë për ty çdo gjë më të mirë kundruall afërsisë dhe largësisë, në këtë dhe botën tjetër/ahiret. Selam!

## **HUTBET DHE FJALIMET E IMAM ALI IBN EBU TALIBIT A.S**

- Duke pasur parasysh gjitha atë që u theksua dhe përmend më sipër, mbi diturinë dhe kompetecat e Imam Aliut a.s, mbi fushat e gjëra të tij të dijes me të cilat u marr apo vetëm i përmendi, si dhe ndikimin e madh të tij që kishte mbi arsimimin dhe edukimin e ummetit; qartë kuptohet mesazhi i fortë që mbanin fjalimet dhe hutbet e tij dhe të cilat



qarqet e ndryshme historike-kulurore nuk ngurruan pa asnjë farë hezitimi t'i notojnë me notat më të larta të mundshme.

- Fjalimet e Imam Aliut a.s duke pasur prioritet udhëzimet fetare dhe kodeksin e lartë të moralit, kanë ndikim të fortë të jashtëzakonshëm në secilin i cili ndeshet me to. (fjalimet e Imam Aliut a.s, vërejt e përkth)

- Këtu nuk duhet ta theksojmë edhe rëndësinë e tyre të madhe dhe kualitetet që posedonin, ngase kur të merret parasysh koha kur jetoi Imam Ali Ibn Ebu Talibi a.s dhe iu drejtua ummetit, shokëve të tij, mëkëmbësve apo Familjes së tij Fisnike, s' do mend se komentet do të ishin të tepërta. Ishte kjo një periudhë kohore kur nëpërmjet një shkrese (porosie) me anë të letrës ishte baras sikur të mbaje një hutbe. meqë të gjithë fjalimet e tij kryesisht ishin të thëna lidhur me ndonjë rast a ndodhi, ato lirisht mund të rradhiten sipas tematikave përkatëse.

- Në vend të parë, gjithësesi vijnë fjalimet e tij mbi lavdërimin e madhështisë së All-llahut xh.sh, të cilta në mënyrë më briljante na e vërtetojnë gjithë atë që e kemi thënë lidhur me personalitetin e Imam Aliut a.s dhe përkushtimin e tij vetëmohues ndaj All-llahut xh.sh dhe devotshëmrisë së tij madhështore.

- Zgjidhja e fjalimeve të mëposhtme që do të vijoje, më së miri na e ilustron dhe pohon të gjitha thëniet dhe fjalët e shprehura mbi Emirul-Muëmininin-Ali ibn Ebu Talibin a.s.

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s mbi cilësitë e All-llahut xh.sh thotë:» Qoftë i lavdëruar All-llahu, për të Cilin asnjë kusht nuk i paraprinë tjetrit, kështu që Ai mund të jetë i pari para se të ketë qenë i fundit dhe i dikshëm para se të ketë qenë i padukshëm. Çdo gjë që përkufizohet me një pos Tij-është e parëndësishme. Çdo i famshëm pos Tij-është i mjerë, Ç' do i fortë pos Tij-është i dobët. Ç' do sundimta pos Tij-është skllav. Ç' do i dijtur pos Tij-është kërkimtar. Ç' do udhëheqës pos Tij-nganjeherë është i pushtuar nga të udhëhequrit, kurse nganjeherë nga paaftësia. Ç' do dëgjues pos Tij-është i shurdhër për zërat e qetë; zërat e fortë e shurdhojnë; kurse të largët nuk i dëgjon fare. Ç' do shikues pos Tij-është i verbër për ngjyrat e fshehura dhe substancat tepër skofiare. Çdo gjë e dukshme krahas Tij-është e fshehur, kurse çdo e fshehur krahas Tij-nuk mund të bëhet e dukshme.

- Ai nuk e ka krijuar atë që e ka krijuar për të forcuar pushtetin e Tij, as për shkak të frikës nga pasojat e kohës, por as për të kërkuar ndihmë kundër sulmeve të rivalit të njejtë ose mburravec, ose të armikut të urryer. Nga ana tjetër, Ai i ka krijuar të gjitha krijesat dhe ato janë robët pendestarë (tevbexhinjtë) të Tij. Ai nuk hyn në gjëra që të thuhet. Ai ndodhet në to. Dhe nuk veçohet nga ato që të thuhet. Ai është i veçuar nga ato. Ate nuk e lodhë krijimi i asaj që e ka filluar Vetë, as të udhëhequrit me atë që e ka shpërndarë Vetë. Ate nuk e pushton kurrëferë dobësie ndaj asaj që Vetë e ka krijuar. Kurrë nuk lind dyshimi për atë që Vetë ka urdhëruar dhe vendosur. Vetëm dispoziatat e Tij janë të qëndrueshme, dituria e Tij e përsosur, vendimi i Tij përfundimtar. Në fatkeqësi shpresën e mbështesim të Ai. Kurse në mirëqenie frikohemi prej Tij. »(106)  
« I qofshim falë All-llahut, Krijuesit të njerëzve, Shtrirësit të tokës... Zanafilla e Tij nuk ka kurrëfarë fillimi, as përjetësia e Tij nuk ka kurrëfarë fundi. Ai është i pari dhe ngaherë. Ai është i përhershëm dje pa afat. Kokat bëjnë sexhde para Tij dhe buzët shqiptojnë Njësinë e Tij. Ai përcaktoi kufijt e gjërave në kohën kur i krijoi, ashtu që ata të mos jenë të ngjajshme me Te.

- Parafytyrimet nuk mund ta parandjejnë brenda suazave të lëvizjes së gjymtyrëve dhe shqisave. Për Te nuk mund të thuhet « Kur », as nuk i caktohet përfundimi kohor me « Gjer ». Ai është i dukshëm, por nuk mund të thuhet « Prej çkahit ». Ai është i

fshehur, por nuk mund të thuhet « Në çka ». Ai nuk është trup që të zhduket, as nuk është i mbuluar për të qenë i përmbajtur përbrenda. Ai nuk është afër gjërave ashtu që t'i prekë ato, as larg tyre ashtu që të jetë i ndarë nga ato.

- Për Te nuk është i fshehur drejtimi i shikimit të robëve të Tij, as përsëritja e fjalëve, as vështrimi përciptas në bregore, as të shpejtuarit e hapave në natën e zezë (plot terr) ose në errësirën e thellë, mbi çka hën andriçon ose derdhë dritën e saj dhe Dielli i shkëlqyer arrinë në vigjilencën e tij, duke perënduar dhe lindur me rrotullimin e kohëve dhe periodave, si ditës e cila po përfundon.

- Ai i paraprinë çdo skajshmërie dhe kufiri, çdo llogarie dhe numrimi. Ai është larg mbi atë çka i përshkruajnë ata të cilët e kufizojnë me vlerë të masave, skajet e vendeve, vendosejen në shtëpia dhe jetën në vende të caktuara, ngase kufizimi ka të bëjë me krijesat e Tij dhe mund t'i përshkruhet vetëm dikujt tjetër pos Tij.

- Ai gjërat nuk i krijoi nga fillimet e amshuemshme, as në bazë të modeleve gjithnjë ekzistuese, përse Ai krijoi atë që e krijoi, pastaj ia përcaktoi kufijtë. Ai formësoi atë që e formësoi dhe ia dha formën më të bukur. Asgjë nuk mund të mos i nënshtrohet Atij, mirëpo të nënshtuarit e çdo gjëje nuk i sjell kurrëfarë dobie. Dituria e Tij mbi të vdekurit, të cilët kanë shkuar është e njëjtë si dhe dituria e Tij mbi të gjallët, të cilët akoma jetojnë. Dituria e Tij mbi atë që ndodhet në qiejt më të lartë është si dituri e Tij mbi atë që ndodhet në thellësitë e nëntokës.

« Për All-llahun, Ne krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkë-baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (farë) në një vend të sigurt. »; Mandej je transferuar prej vendbanimit tënd në vendbanimin të cilin nuk e ke parë, as nuk i dijtur mënyrat e shfrytëzimit të tij. Kush është ai i cili të ka udhëzuar të thithësh nga sisat e nënës tënde dhe të ka mësuar për to, kur të jetë nevoja, vendet e kërkesave dhe dëshirave tuaja? Madje edhe shumë më shumë! Ai i cili nuk është në gjendje të kuptojë cilësitë e atij më formë e gjymtyrë, është edhe më pak i aftë të kuptojë cilësitë e krijesit ose edhe më shumë se kjo, ta kuptojë me ndihmën e suazave të asaj që është krijuar. » (107).

- Mbi lavdërimin e All-llahut thoshte: » Kjo dhe bota tjetër-ahireti ia kanë përshtatur Atij frerët e tyre, ndërsa qijet dhe tokët ia kanë dorëzuar çelësat e tyre. Drurët që lulojnë i bëjnë sexhde Atij në mëngjes dhe në mbrëmje dhe prodhojnë për hir të Tij zjarr flakëruës nga degët e tyre dhe me urdhërin e Tij e shndërrojnë ushqimin e vet në fryte të pjekura. »

- Për Kur'anin e Madhnueshëm thoshte:» Librin e All-llahut e keni në mesin tuaj. Ai tregon dhe gjuha e tij nuk ngatërrohet. Ai është shtëpi-shtyllat e së cilës nuk rrënohen. Ai Kur'anin është fuqi, përkrahësit e të cilit kurrë nuk do të pësojnë disfatë. »

- Për Muhammedin s.a.v.s ka thënë:» Ai e dërgoi Pejgamberin-Selami i All-llahut qofshin gjithnjë mbi te dhe mbi familjen e tij! pasi një kohë ishte ndërprerë dërgimi i pejgamberëve, jur kishte shumë thashethëme. Me të-Pejgamberin All-llahu shterroi zinxhirin e pejgamberëve dhe e përmbushi Shpalljen. Ai pas kësaj zhvilloi luftëra në emër të All-llahut kundër atyre të cilët ia kishin kthyer shpinën Atij (All-llahut) dhe kishin krahasuar të tjetër me Te. « (Fjala është për shirkun, vërejt e përkth).

- Mbi këtë botë:» Me të vërtetë kjo botë është kufiri i fundit i të pamurit, dhe i verbëri nuk shikon asgjë nga ana tjetër e saj, gjersa shikimi i atij që shikon depërton nëpër te dhe ai e din se shtëpia ndodhet nga ana tjetër e saj. Ai që shikon, për këtë arsye e braktisë, gjersa i verbëri orientohet drejt saj. Ai që shikon frymëzohet nga ajo, gjersa i verbëri grumbullon rezerva për të. »

- Këshillë paralajmëruese:» ta dini se njeriu ngopet dhe mërzitet me çdo gjë, pos me jetë, ngase në vdekje nuk gjen kurrëfarë kënaqësie për vete. Kjo është ngjashëm me urtinë e cila është jetë për zemrën e molisur, shikimin për syrin e verbër, dëgjimin për veshin e shurdhër dhe shuarjen e etjes për ate që ka etje. Në këtë përkufizohet tërë begatia dhe shpëtimi.

- Libri i All-llahut është ai me të cilin ku shikoni, flitini dhe dëgjoni. Çdo pjesë e tij komunikon në pjesën tjetër dhe çdo pjesë e tij dëshmon mbi pjesën e tjetër. Ai nuk ka divergjenca lidhur me All-llahun, as largon ithtarin e vet nga All-llahu. Jeni bashkuar që të urreni njërin-tjetrin dhe të kultivoni barin me fëlliqësirën tuaj. Jini të sinqertë ndaj njëri-tjetrit në arritjen e pasurisë. Shpirtëkeqi u ka hutuar dhe gënjeshtari u ka mashtruar. All-llahu është ndihmës edhe për mua edhe për ju. » (108)

- Sërish mbi madhësinë dhe cilësitë e All-llahut:

« E falënderojë All-llahun, i Cili me krijimin e Tij dëshmon mbi qenësinë e Tij, mbi amshueshmërinë e Tij pa fillim-me risi të krijimit të Tij dhe mbi atë që asgjë nuk është e ngjashme- përmes ngjashmërisë së krijesave të Tij. Shqisat Ate nuk mund ta arrijnë, as mbulesat nuk mund ta fshehin, duke pasur parasysh dallimet midis Krijuesit dhe të krijuarës, Kufizuesit dhe të kufizuarit dhe Ushqyesit dhe të ushqyerit.

- Ai është Një, por jo në kuptimin e të parit në numërim. Ai është Krijues, por jo përmes punës dhe veprimit. Ai dëgjon çdo gjë, por jo përmes shqisave të trupit. Ai sheh çdo gjë, por jo me të hapurit e kapakëve të syrit. Ai është i pranishëm, por jo me të prekur. Ai është i ndarë, por jo me masë të distancës. Është i dukshëm, por jo me të shikuar. Është i fshehur por jo me vogëlsi. Është i veçuar nga gjërat, pasi që i nënshton dhe ka pushtet mbi to, gjersa gjërat janë ta ndara nga Ai, si pasojë e mvartësisë së tyre nga Ai dhe orientimit të tyre drejt Tij.

- Ai i cili e përshkruan-e kufizon Ate. Ai i cili e kufizon-e shënon me emër. Ai i cili e shënon me emër-e refuzon amshueshmërinë e Tij. ai i cili thotë:» Si » ?-kërkon ta përshkruajë. Ai i cili pyet:» Ku » ?-i përshkruan vend. Ai është njohës, edhe nëse nuk do të kishte asgjë për t'u njohur. Ai është Raujtës, edhe nëse nuk do të ekzistonte asgjë për t'u ruajtur. Ai është i Gjithëfuqishëm, edhe nëse nuk do të ekzistonte asgjë që do të duhej mposhtur.

- Ai i cili ngritet-është ngritur. Ai i cili ndriçon-ka shndërritur. Ai i cili paraqitet-është paraqitur. Ndërsa, ai i cili është shtrëmbërruar-është drejtuar. All-llahu një popull e ka zëvendësuar me një popull tjetër dhe një ditë me një ditë tjetër. Ne i kemi pritur këto ndryshime siç e presin shiun të goditurit nga thatësia. Me të vërtetë, imamët janë mëkëmbësit e All-llahut mbi krijesat e Tij dhe dituria e Tij për robët e Tij. Nuk mund të hyjë në Xhennet asnjëri, pos atij i cili i njeh dhe të cilin e njohin ata. Dhe nuk do të hyjë në Xhehennem asnjëri, pos atij i cili nuk i njeh dhe të cilin ata nuk e njohin.

- All-llahu Famëmadh vërtetë ju ka shërbyer me Islam, dhe ju ka zgjedhur për te. Kjo ka ndodhur pasi që ai është emër për shpëtim dhe siguri të respektit. All-llahu Famëmadh e ka përcaktuar rrugën e tij dhe i ka shpallur argumentet e Tij përmes njohjes publike dhe deklaratave të fshehta. Mrekullitë e tij janë të pashtershme dhe ngazëllimet e tij nuk kanë të sosur. Në te janë përqëndruar begatitë e lulëzimit dhe kandilet për errësi. Mirësitë çelen vetëm me çelësat e tij, kurse errësitat dëbohen vetëm me kandilet e tij. All-llahu i ka ruajtur vendet e paarritshme të tij dhe i ka lejuar atij të kullotë në vendkullosat e Tij. Në te ndodhet ilaçi për shërimin e atij i cili kërkon ilaç dhe mbështetje për ate i cili kërkon mbështetje. » (109)

- Falënderimi i All-llahut xh.sh:

« Dispozita e Tij është vendim edhe dispozitë edhe urti. Kënaqësia e Tij është siguri dhe mëshirë. Ai gjykon me dituri dhe falë me bujari.

- O Zoti im! Të falënderoj Ti për ate që na dhuron dhe për atë me çka na shoqëron dhe me çka sprovon-me falënderimin me të cilin Ti je i kënaquri, të cilin Ty e adhuron më së shumti dhe i cili është më i miri në Ty. Falënderim i cili përmbushë gjithëçka që ke krijuar dhe arrinë atje ku dëshiron, falënderim i cili nuk është i fshehur nga Ti dhe i cili nuk pushon kurrë, falënderim zgjatja e të cilit nuk ndërprehet dhe fuqia e të cilit nuk zhduket.

- Ne nuk e njohim realitetin e Madhësisë Tënde, pos që e dijmë se Tije vërtetë Jetues i Amshueshëm dhe Gjithmbajtës. Ty nuk të mundon as të koturit, as gjumi, edhe mendja nuk depërton gjer te Ti, edhe shikimi Ty nuk të arrin. Ti përfshinë pikëpamjet, numëron veprat dhe mbërthen për perçe dhe këmbë. Shikojmë krijimin Tënd dhe ngazëllehemi me aftësinë Tënde dhe e përshkruajmë këtë krijim si madhësi të pushtetit Tënd. Kurse ajo që është fshehur prej nesh, gjer ku shikimet nuk arrijnë dot, kurse mendjet tona nuk depërtojnë dhe midis cilës dhe neve janë vendosur perde të mosnjohjes-është edhe më e madhe.

- Atij që e liron zemrën e vet dhe mundon mendimin e vet për të kuptuar si e ke bërë Fronin Tënd, si i ke krijuar krijesat Tua, si e ke vendosur ajrin në qiejt Tu dhe si ke shtrirë tokën Tënde mbi valët e ujit-shikimi i tij do të kthehet i lodhur, mendja e tij e mahnitur, veshët e tij dhe mendja e tij e turbulluar.

- Ai pohon, në harmoni me të menduarit e tij, se mbështetet në All-llahun. Për All-llahun e Madhëruar, gënjen. Si u bë që kjo mbështetje e tij nuk është e dukshme në veprat e tij, ngase mbështetja e çdonjërit që mbështetet duket në veprën e tij. Çdo mbështetje, pos mbështetjes tek All-llahu Lavdiplot-është mashtrim. Çdo frikë është e dukshme, kurse vetëm frika nga Zoti vjen gjithnjë rishtas.

- Ai të madhen e prët nga All-llahu, kurse të voglën nga njerëzit. Mirëpo ai njerëzve u ofron atë çka nuk i ofron Zotit. Përse për All-llahun-e lartë është mirënjohja e tij!-bëhet më pak se ajo çka bëhet për robët e tij? A ke frikë se me mbështetjen tënde te Ai do të jesh gënjeshtar? Ose e konsideron epiqendër të mbështetjes tënde?! Gjithashtu, nëse njeriu i frikohet dikujt nga robët e Tij, nga frika i ofron çka nuk i ofron Zotit të vet. Kështu frikën e vet prej njerëzve e ka bërë realitet, kurse frikën nga Krijuesi i tyre e ka bërë shtyrje të zakonshme dhe premtim. Kështu është edhe me ate në sytë e të cilit kjo botë është e madhe dhe në zemrën e të cilit pozita e saj është e lartë. Ai e ngritë mbi All-llahun e Madhëruar, andaj mbështetet vetëm në te dhe bëhet rob i saj. »

- Shembulli i Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s:» Vërtetë, Pejgamberi i Zotit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij gjithnjë!-është shembull i mjaftueshëm dhe argument për urrejtjen e kësaj bote dhe të metave të saj kundruall shumë turpërimeve dhe ligësive të saj. Ngase, anët e saj qenë të mbyllura për te, ndërsa të hapura për të tjerët. Ka qenë i privuar nga gjiri i saj dhe i janë mohuar stolitë e saj. »

- Mënyra se si Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s i përmend shembujt e pejgamberëve të tjerë, na e ilustronjë plotësisht qartë qëndrimin e Islamit dhe Kur'anit të Madhnueshëm ndaj pejgamberëve të mëparshëm dhe obligimin e respektimit të tyre nga çdo musliman.

- Imam Aliu a.s për Musain a.s thotë:

« Nëse dëshiron, do të përmendi, edhe shembullin e Musait-alejhisselam-me të cilin All-llahu ka folur, kur tha:

« ... O Zot im, unë kam nevojë për çkado që të më japësh! » (El-Kasas, 24)

- Për All-llahun! Ai e luste vetëm për bukë të përditshme, ngase zakonisht ushqehet me bimët tokësore. Gjelbërimi i bimëve pasqyrohet në lëkurën e tëholluar të tij, në dobësinë e trupit dhe vogëlsinë e muskujve. »

- Shembulli i Davudit a.s:

« Nëse dëshiron, mund të përmendi edhe shembullin e Davudit-alejhisselam!-si shembull të tretë. Ai është transmetues dhe recitues i këngëve mbi famën e All-llahut për banorët e Xhennetit. Ai me duart e veta thurte shporta nga gjethet e palmës së hurmës, ndërsa pastaj i luste shokët e tij:

« Kush do t'më ndihmojë që t'i shesë ? » Ushqehet me bukë elbi të blerë nga paratë e fituara për shporta. »

- Shembulli i Isait a.s:

« Nëse dëshironi, do të tregojë mbi Isain, birin e Mejremes-Selami i All-llahut qoftë mbi ta!- Ai përdorte rrasa guri si jastëk të vetin, vishej me rroba të punuara shkel e shko dhe hante bukë të thatë. Erurina e gjellës së tij ishte uria. Kandila e tij e natës ishte hëna. Vendstrehim i tij gjatë dimrit ishin vetëm hapësirat tokësore nga lindja dhe perëndimi. Frytet e saj dhe bimët aromatike ishin vetëm diç që mbinë prej tokës për shtazët. Nuk kishte grua për ta sprovuar, as fëmijë për ta pikëlluar, as pasuri për ta joshur, as lakmi për ta poshtëruar. Dy këmbët e tij ishin bartëse të tij, kurse dy duart e tij ishin shërbetore të tij. »

- Shembulli i Pejgamberit Muhammedit s.a.v.s:

« Pra, ndiqe rrugën e Pejgamberit tënd, të pastër dhe të devotshëm-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij! Në te ka shembull për ata të cilët e marrin si shembull dhe ngushëlim për ata të cilët kërkojnë ngushëlim. Kurse më i dashuri prej njerëzve për All-llahun është ai i cili e merr si shembull Pejgamberin e Tij dhe cili shkon gjurmëve të tij. Ai këtë botë e ka kafshuar vetëm me majë të dhëmbëve të tij dhe nuk ia ka hedhur kurrë një shikim të plotë. Prej të gjithë njerëzve të botës, ai ishte më së paku i ngopur dhe me stomak më të zbrazët. Kjo botë i ishte premtuar, por ai refuzojë ta pranojë. Kur e dinte se All-llahu diçka urrente edhe ai këtë e urrente, se All-llahu diçka e konsideronte të ulët dhe ai këtë e konsideronte të ulët, se All-llahu diçka e konsideronte të vogël dhe ai këtë e konsideronte të vogël. Nëse e adhurojmë atë që All-llahu dhe Pejgamberi i Tij e urrejnë dhe nëse e konsiderojmë të madhe atë që All-llahu dhe Pejgamberi i Tij e konsiderojnë të vogël, kjo është largim i mjaftueshëm nga All-llahu dhe thyerja e urdhërave të Tij.

- Pejgamberi-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- zakonisht hante bukë në tokë dhe rrinte si rob. Me dorë të vet i rregullonte sandalet, arronte robat, i hipte gomarit pa shalë dhe zakonisht e vendoste ndonjërin pas vete. Njëherë kishte vërejtur një perde me vizatime në derë të dhomës dhe i kishte thënë njëerës prej grave të tij: (hazreti Aishesë, nënës së besimtarëve, vërejt e përkth) » Largoma sysh, ngase me të vërtetë, kur e shikoj më shkon mendja te kjo botë dhe bukuritë koshëse të saj. » Kështu ai largonte zemrën e tij nga kjo botë dhe fshinte kujtimin e saj në mendjen e vet. Dëshironte që bukuritë e kësaj bote të mos i rrijnë para sysh, ashtu që të mos merrte prej tyre veshje luksoze, që të mos e konsideronte këtë botë vend të jetës së përhershme dhe të mos ushqente shpresë se në të do të mbetej përgjithnjë. Prandaj e largonte nga mendja, e dëbonte nga zemra dhe e fshehte nga shikimi i vet. Kështu pra, kur ndonjëri urren diç, urren shikimin dhe të kujtuarit e vet.

- Me të vërtetë, te Pejgamberi i All-llahut-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- ka gjithëçka që u paralajmëron mbi anët e këqia të kësaj bote dhe të metat e saj, se ka vuajtur nga urria bashkë me as-habët më të ngushtë, gjersa bukuritë e

kësaj bote-edhe përkundër afrisë së tij me to-kanë mbetur larg nga ai. Ndërsa tani le të analizojë çdonjëri me intelektin e tij, a e ka nderuar All-llahu me këtë Muhammedin-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!- ose e ka poshtëruar. Nëse thotë se All-llahu e ka poshtëruar, ai-për All-llahun e Madh!-gënjen. Por nëse thotë se All-llahu e ka nderuar, atëherë le ta dijë se All-llahu të tjerët i ka poshtëruar duke u afruar këtë botë dhe duke i larguar nga ai i cili për Ate ka qenë më i afërmi prej të gjithë njerëzve.

- Prandaj, ai i cili e merr si shembull Pejgamberin, le të shkojë gjurmëve të tij dhe le të hyjë në hyrjen e tij. Përndryshe nuk do të shpëtojë nga shkatërrimi. Me të vërtetë All-llahu xh.sh Muhammedin-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- e ka bërë simbol të çastit të Fundit, transmetues të lajmeve të gëzuara mbi Xhennetin dhe paralajmërues mbi ndëshkimin. Ai u largua nga kjo botë i uritur, por në botën tjetër (ahiret) shkoi i sigurt. Ai nuk ka vendosur as edhe një gur mbi tjetrin gjersa nuk ka ecur rrugës së tij dhe gjersa nuk i është përgjigjur thirrjes së ftuesit të Zotit të tij. Sa i madh është Rrahmeti i All-llahut, i Cili na dërgoi ate-Pejgamberin s.a.v.s si prijës të cilin e pasojmë dhe udhëheqës të cilin e ndjekim këmba-këmbës. »

- Shembulli i tij personal mbi modestinë: (pra, shembulli i Imam Aliut a.s) » Për All-llahun! Kam ngjitur aq shumë arna në veshjen time prej leshi sa që tani kam turp për arnuesin e tyre. Dikush madje më tha:» Përse nuk po e ndërron ? » Kurse unë ia ktheva:» Largohu prej meje. » Kur të agojë, njerëzit e lavdërojnë rrugën e udhëtimit të natës. » (110)

- Të falënderuarit e All-llahut për begatitë e Tij:» Falëderojmë All-llahun i Cili është pranuar pa qenë i dukshëm dhe i Cili krijon pa vështirësi. Ai me pushtetin e Tij krijoi krijesat. Ai me madhësinë e Tij nënshtron sundimtarët, ndërsa fisnikët i orienton me fisikërinë e Tij. Ai është i Cili këtë botë e banoi me krijesat e Tij. Xhinëve dhe njerëzve ua dërgoi Pejgamberët e Tij që t'ua zbulojnë zbulesën e saj, t'i paralajmërojnë për dëmet e saj dhe t'ua paraqesin shembujt e saj , t'ua prezentojnë të metat e saj dhe para tyre ta prezentojnë tërësinë e plotë të gjërave të cilat përmbajnë këshilla mbi ndryshimin e shëndetit dhe sëmurjeve në të, si dhe gjërat e lejuara (hallall) dhe të ndaluara (haram) të saj, dhe atë që All-llahu e ka përgatitur për ata prej tyre të cilët janë të përkorë dhe ata të cilët janë të padëgjueshëm, do të thotë-Xhennetin dhe Xhehennemin, respektet dhe poshtërimet. E falënderoj me aso falënderimi të cilin Ai e kërkon nga krijesat e Tij. Ai çdo gjëje i ka caktuar masë, çdo mase-kufirin kohor, kurse çdo kufiri kohor-shënimin.

- Kur'ani urdhëron dhe frenon, heshtë dhe fletë. Ai është argument i All-llahut para krijesave të Tij. Ai prej tyre ka marrur premtim se do të veprohet sipas tij. Ai e ka plotësuar dritën e Vet dhe me këtë e përsosur besimin e Vet. Ai e ka marrur shpirtin e Pejgamberit të Vet-Selami i All-llahu qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!-pasiqë përmes tij njerëzve ua transmetoi dispozitat e Shaplljes (Vahjit). Prandaj, madhërojeni All-llahun e Madhëruar, ashtu siç e ka madhëruar Ai Vetën. Ngase, vërtetë Ai nuk ka fshehur asgjë nga besimi i Tij, as ka lënë anash diç me çka është i kënaqur ose i pakënaqur dhe kjo të mos ketë shenjë të qartë dhe të caktuar e cila largon nga kjo, ose fton në këtë. Kënaqësia e Tij është e njëjtë për atë që do të vijë, kurse zemërimi i Tij është i njëjtë me çdo gjë që pason.

- Dhe dijëni se Ai vërtet nuk do të jetë i kënaqur me ju për asgjë për çka ka qenë i pakënaqur me ata para jush, dhe nuk do të jetë i pakënaqur me ju për asgjë me çka ka qenë i kënaqur me ata para jush. Ju shkoni rrugës së qartë dhe flisni njësoj siç kanë folur njerëzit para jush. Ai u mjafton si ndihmë në këtë botë. Ai u nxit në falënderim dhe u fton ta përmendi Ate me gjuhët tuaja. (Të bëni dhikër, vërejt e përkth).

- Ai u këshillon që të jeni të vetë dijshëm për Te, ndërsa këtë e ka bërë kulminacionin e kënaqësisë së Vet dhe çdo gjë që kërkon nga krijesat e Tij. Prandaj, ju jini të vetëdijshëm për All-llahun i Cili është i tillë sa që ju ndodheni mu para Tij. Perçet tuaja janë në shtrëngim të fortë të Tij, kurse ndryshimi juaj është në pushtetin e Tij. Nëse fshihni diç-Ai e din këtë. Nëse diç deklaroni-Ai e shënon këtë. Për këtë ka caktuar rojtarë të ndershëm, të cilët nuk lëshojnë asgjë të vertetë dhe nuk regjistrojnë asgjë të pavërtetë. Dijeni se Ai çdo njerit që është i vetëdijshëm për Te do t' i afrojë shpëtim nga tundimet dhe dritë për dalje nga errësira. Ai do ta mbajë përgjithmonë në atë që Ai dëshiron shpirti i tij dhe do ta vendosë në vendbanimin të ndershëm pranë Tij, në Shtëpinë të cilën e ka ngitur për Vete. Hieja e kësaj Shtëpie është Froni i Tij, drita e saj është shkëlqimi i Tij, vizitorët e saj janë melaqet e Tij, ndërsa pejgamberët e Tij janë shoqërues të saj.

- Prandaj nxitoni drejt vendit të kthimit dhe prejauni rrugën e afateve! Së shpejti shpresa e njerëzve do të jetë e kuptuar, vdekja do t' i kaplojë dhe dera e pendimit do të mbyllet para tyre. Akoma gjendeni në vendet në të cilin ata që kanë qenë para jush do të dëshironi të ktheheshin. Në këtë botë, e cila nuk është shtëpia e juaj, jeni vetëm udhëtarë në kalim. Jeni të ftuar ta braktisni dhe u është urdhëruar që për këtë arsye të pajiseni në këtë. Dijeni se kjo lëkurë është e hollë nuk mund ta durojë zjarrin. Prandaj, keni mëshirë për vetveten, ngase këtë tani më e keni provuar në vuajtjet e kësaj bote.

- A e keni parë ndonjëherë ndonjë person i cili bërtet nga të therrurit me gjemb, ose i cili derdh gjak për shkak të zënies në thua gjatë të ecurit, ose i cili është djegur në rërën përvëluese ? Si do të ndjehet njeriu i tillë midis dy shtresave të zjarrit me gurë gjithëkund përqark dhe me shejtanin si mik të vetin ?! A e dini se kur Maliku (melaqja, verëjt e përkth) do të zemërohet me zjarrin, pjesët e tij do të vërsulen njëra mbi tjetrën për shkak të zemërimit të tij, e kur ai qorton, ai do të kërcejë me portave të tij i shqetësuar nga qortimi i tij.

- O ju të moshuar e të respektuar, të cilëve pleqëria u ka thinjur, si do të ndjeheni ju kur rrethet e zjarrit do t' u arrijën gjer në qafët tuaja, ndërsa prangat të shtrëngohen aq fort sa do të hanë mishin e parallërave? Bëhuni të vetëdijshëm ndaj All-llahut, o turm njerëzish, gjersa jeni me shëndet të mirë, para se të arrijë sëmundja dhe deri sa të keni mundësi, para se të paraqitet ankthi! Nxitoni e lironi qafët tuaja para se të shpallen para se të shpallen të pavlershme garaxat e tyre. Mbani sytë vigjilentë, zvogëlioni stomakun, shfrytëzoni këmbët, shpenzoni paratë tuaja, merrni nga trupi juaj dhe shpenzoni për shirtin tuaj dhe mos u bëni dorështrënguar në këtë, ngase All-llahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Madhnueshëm »

« Nëse ju i ndihmoni All-llahut edhe Ai do t' u ndihmojë juve do t' ua forcojë hapat tuaja. »

- I Madëruari gjithashtu thotë:

« Kush i jep All-llahu vullnetarisht hua që Ai t' ia kthejë ate shumëfish, kurse krahas kësaj të fitojë edhe shpërblim të mirë. »

- Ai nuk kërkon ndihmën tuaj për shkak të ndonjë dobësie, as nuk kërkon hua nga ju për shkak të ndonjë skamje. Ai kërkon ndihmën tuaj edhe pse disponon me të gjitha ushtritë e qiejve dhe të tokës, dhe Ai është i Gjithëfuqishmi dhe i Urti. Ai kërkon hua nga ju, ndonëse Atij i përkasin thesaret e qiejve dhe të tokës dhe Ai është i Pasuri dhe Lavdiploti. Ai dëshiron t' u provojë në atë se cili prej jush do të punojë më së miri. Prandaj, nxitoni me veprat tuaja për të qenë më afër me All-llahun në Shtëpinë e Tij. Ai i bëri shokët e Pejgamberit prej këtyre të afërmëve, si dhe rregulloi që t' i vizitojnë melaqet e Tij. Ai i nderoi veshët e tyre ashtu që ushtrimi e zjarrit të Xhehennemit kurrë

të mos arrijë gjer te ata dhe Ai u ofroi mbrojtje trupave të tyre nga plogështia dhe raskapitja- I Madhëruari në Kur'an thotë:

« Kjo është begatia e All-llahut të cilën Ai ia dhuron atij që dëshiron. Ndërsa begatia e All-llahut është e madhe. »

- Po ua them atë që jeni duke dëgjuar. All-llahu është Ai i Cili na ndihmon edhe mua edhe juve. Ai më mjafton dhe Ai është ndarësi më i mirë. » (111)

- Thënia e Imam Aliut a.s mbi njësinë e All-llahut: (ky fjalim përmban bazat e njohurive të cilat nuk gjenden në asnjë fjalim tjetër).

- « Ai i cili i përcakton gjendje nuk beson në Njësinë e Tij (Tevhidin), as ai i cili e krahason nuk e kupton vërtetësinë e Tij. Ai i cili e përshkruan nuk e njeh Ate. Ai i cili tregon për Te dhe e parafytyron Ate nuk e sqaron dot. Çdo gjë që është e njohur përmes vet asaj-është e krijuar, kurse çdo gjë që ekziston për arsye të diçkahit tjetër-është pasojë. Ai vepron, por jo me mjete, Ai përcakton masa, por jo me veprimin e të menduarit, Ai është i pasur por jo me të raditurit.

- Kohët nuk janë me Te, kurse mjetet nuk i ndihmojnë. Ekzistimi i Tij i paraprinë kohëve. Qenësia e Tij i paraprinë paqenësisë, ndërsa amshueshmëria e Tij i paraprin zënafillës. Me krijimin e shqisave nga Ai është dëshmuar se Ai nuk posedon kurrëfarë shqisash. Me tërësinë e kontradiktave është dëshmuar se Ai nuk posedon kurrëfarë kontradikte, kurse me ngjashmëritë mes gjërave është dëshmuar se asgjë nuk është e ngjashme me Te. Ai e krijoi dritën si kontrast errësirës, ndriçimin-errësirës së dendur, thatësinë-lagështisë dhe nxehtësinë-të ftohtit. Ai krijon prirje mes fenomeneve kontradiktore.

- Ai sajton forma të ndryshme, afron të larguarit dhe ndanë të bashkuarit. Ai nuk është i kufizuar me kufij, as i numëruar me numër. Veçoritë materiale mund të rrethojnë gjësendet e llojeve te tyre, kurse pjesët e trupit mund të tregojnë për atë që është e ngjashme me to. Shprehja « pasi që » e mohon amshueshmërinë e tyre, shprehja « pas » e mohon ekzistimin e tyre prej kohësh, ndërsa shprehja « si të mos ishte » i mban larg nga të përsosurit.

- Përmes tyre Krijuesi u praqitet mendjeve dhe përmes tyre Ai është i mbrojtur nga shikimi i syve. Të qëndruarit në një vend dhe të lëvizurit nuk kanë të bëjnë me Te, ngase si do të mund të bënte me Te diç që Ai vetë e ka krijuar ?! Dhe si do të mundet diç që Ai e krijuar të paraqitet sërish në mënyrë orogjinare ne Te !? Nëse nok do të ishte kështu, Vetë Ai do të ishte i shumëllojshëm, qenësia e Tij do të ishte e ndashme dhe vërtetësia e Tij do të pushtonte të quhej e amshueshme. Sikur për Te të ekzistonte ndonjë përparësi, për Te gjithashtu do të ekzistonte ndonjë përmbapësi. Ai do të kërkonte plotësim vetëm nëse i ngjanë ndonjë e metë. Në këtë rast do të paraqiteshin shenjat e krijimit dhe Ai do të bëhej shenjë në vend të shenjave të cilat shpiejnë te Ai. Përmes fuqisë së tij të refuzimit në Te nuk ndikojnë ajo çka ndikon në diç tjetër krahas Tij.

- Ai është Ai i Cili nuk ndryshon dhe zhdukaj nuk ka të bëjë me Te. Akti i të vendosurit Atij nuk i vejn për shtati. Ai asnjërin nuk e ka lindur, në mënyrën që të konsiderohet i lindur. Ai nuk është i lindur përndryshe do të ishte përfshirë në kufij. Ai është shumë lartë për të pasur fëmijë. Ai është shumë i pastër për t'iu qasur femrës. Të menduarit nuk mund të arrijë, ashtu që t'i caktohet masë. Të kuptuarit nuk mund të mendojë për Te ashtu që t'i caktojë formë. Shqisat nuk e hetojnë. Duart nuk mund ta prekin ashtu që ta përkëdhelin. Ai nuk ndryshon në kurrëfarë kondite. Ai nuk kalon nga një gjendje në tjetrën. Netët dhe ditët Ate nuk e plakin. Drita dhe errësiar Ate nuk e ndryshojnë.



- Nuk mund të thuhet se Ai ka kufij dhe skajshmëri, fund ose përfundim. As gjërat e drejtojnë Ate ashtu që ta lartësojnë ose ta ulinë, as mbajnë diçka ashtu që ta forcojnë ose ta mbajnë në këmbë. Ai nuk ndodhet as brenda formave as jashtë tyre. Ai dërgon lajme, por jo me gjuhë dhe zë. Ai dëgjon, por jo me vrimat e veshëve dhe shqisën e të dëgjuarit. Ai flet, por nuk shqipton fjalë. Ai ruan, por ruajtja nuk e lodhë. Ai përcakton, por jo me të ushtruarit e mendjes së Tij. Ai dashuron dhe pranon pa kurrëfarë brengosje. Ai urren dhe ndjen zemërim pa kurrëfarë brengosje. Kur dëshiron të krijojë diç, vetëm i thotë:» Bëhu! » dhe ajo bëhet, por jo me zë që tingëllon, as me thirrje që dëgjohet. Fjala e Tij-Madhëruar qoftë Ai!-është akti i krijimit të Tij. Prirja e Tij nuk ka ekzistuar kurrë para kësaj. Po të ishte ajo e amshuar, do të ekzistonte edhe një zot tjetër.

- Nuk mund të thuhet se ka lindur pas paqenësisë së Tij, meqë në këtë rast Atij do t'i përshkruheshin veti të së krijuarës dhe nuk do të mbetej kurrëfarë dallimi në mes asaj dhe Atij dhe Ai nuk do të kishte asnjë veti mbi të. Në këtë mënyrë Krijuese dhe e krijuara do të barazoheshin, kurse Nismëtari dhe e nisura do të ishin në nivel të njejtë. Ai krijoi çdo gjë që ka krijuar, pa kurrëfarë modeli që ka çpikur dikush tjetër, dhe Ai nuk ka siguruar ndihmë nga asnjë gjësend i krijimit të Vet.

- Ai e ka krijuar Tokën dhe e mban pa kurrëfarë mudi, e ka forcuar pa mbështetje, e ka bërë të qëndrojë pa këmbë, e ka ngritur pa shtylla, e ka siguruar nga përdredhimet dhe të lakuarit, e ka mbrojtur nga thërrmimi dhe shpërbërja. Ai i forcoi malet e saj si trungun dhe i ngurtësoi shkëmbinjtë e saj, bëri që të gufojnë me begati burimet e saj dhe ka çarë gjërë e gjatë luginat e saj. Çdo gjë që ka sajuar Ai nuk pëson kurrëfarë rrjedhimi dhe çdo gjë që ka forcuar Ai nuk pëson kurrëfarë plogështie.

- Ai paraqitet mbi të me pushtetin dhe madhësinë e Tij. Ai e njeh brendinë e saj përmes diturisë dhe njohurisë së Tij. Ai është lart mbi çdo gjë të saj me epërsinë dhe fisnikërinë e Tij. Asgjë e saj që e kërkon Ai nuk e kundërshton, as nuk i kundërvihet Atij ashtu që ta mposhtë. Asnjë nxitues nuk mund të ikë nga Ai, ashtu që t'i shpëtojë. Ai nuk është i mvarur nga asnjë i pasur ashtu që ai ta furnizojë. Gjithëçka i bindet dhe është e përulur para madhësisë së Tij. Asgjë nuk mund t'i ikë pushtetit të Tij te ndonjë tjetër për të shpëtuar nga begatia e Tij ose ndëshkimi i Tij. nuk ekziston asgjë krahas Tij që të mund të matet me Te dhe askush nuk është si Ai për të qenë i barabart me Te.

- Ai atë do ta shkatërrojë para ekzistimit të saj, gjersa çdo gjë që ekziston në të nuk do të ekzistojë. Asgjësimi i botës pas krijimit të saj nuk është më i mrekullueshëm se krijimi i parë dhe formësimi i saj. Si do të mund të bëhet kjo ?! Nëse edhe të gjitha shtazët e tokës, qoftë shpenzë, qoftë egërsira, bagëti stallash ose kulllosash, prejardhesh të ndryshme dhe llojesh të ndryshme, njerëz mendjehollë dhe të pagëdhendur, nëse të gjithë së bashku do të provonin ta krijonin madje një mizë, ata nuk janë në gjendje ta krijojnë dhe nuk e kuptojnë rrugën e krijimit të saj. Me siguri mendjet e tyre do të ishin të ngatërruara dhe do të hutoheshin duke synuar ta kuptojnë këtë. Aftësitë e tyre do të jenë të pafuqishme dhe nuk do t'ia dalin kësaj. Do të heqin dorë të dëshpruare të lodhur, duke kuptuar se janë mposhturedhe se janë aq të dobët që të guxojnë ta zhdukin.

- Me të vërtetë, pas zhdukjes së kësaj bote All-llahu i Madhëruar do të mbetet vetëm pa asgjë tjetër pranë Tij. Ai do të jetë, pas shuarjes së botës, siç ka qenë edhe para krijimit të saj, pa kohë, ose vend, ose çast, ose periodë kohore. Atëherë nuk do të ekzistojnë afatet, perodat dhe kohët, ndërsa vitet dhe çastet do të zhduken. Nuk do të ekzistojë asgjë pos të Vetmit, Fuqiplotit, te i Cili kthehet çdo gjë. Fillimi i krijimit të saj nuk ka qenë në pushtetin e saj dhe zhdukjen e vet ajo nuk mund ta ndalojë. Sikur të mund ta pengonte këtë, do të ekzistonte përgjithmonë. Kur Ai krijoi gjërat e kësaj bote, ky krijim nuk i shkaktoi kurrëfarë vështirësie, ndërsa krijimi i çdo gjëje që e ka krijuar

dhe formësuar, Ate nuk e ka lodhur. Ai këtë botë nuk e ka krijuar për të shtuar pushtetin e Vet, as nga frika prej humbjes ose dëmit, as për të kërkuar ndihmën e saj kundër ndonjë kundërshtari superior, as për të mbrojtur Vetën nga ndonjë armik hakmarrës për përkrahjen e saj, as për shkak të zgjerimit të pushteti të Tij me ndihmën e saj, as për shkak të mburrjes kundruall dikujt tjetër, as për arsye se ndjehet i vetmuar dhe ka vendosur të kërkojë afërsinë e saj.

- Madje, pas krijimit të saj, Ai do ta asgjësojë por jo nga mërzia e cila e ka kapluar për shkak të mbejtjes dhe udhëheqjes së saj, as për shkak të ndonjë kënaqësie që vie, as për shkak të barrës së saj mbi Te. Gjatësia e ekzistentencës së saj Ate nuk e lodhë ashtu që ta nxitë shkatërrimin e shpejtë të saj, mirëpo, Lavdiloti e udhëheq atë me mirësinë e Tij, e mban me urdhërimin e Tij, dhe e përsos me pushtetin e Tij. Mandej, pas shkatërrimit të saj, Ai sërish do ta rikthejë në jetë, por jo për shkak të ndonjë nevojë të Tij për të, as për të kërkuar ndihmë nga ndonjë krijes e saj kundër saj, as për ta kaluar ngja gjendja e vetmisë në gjendje të shoqërimin, as për shkak të paditurisë dhe verbërisë në kushtet e diturisë dhe hulumtimit, as nga skamja dhe nevoja për të panevojshmet dhe bagëtitë, as nga pamëshira e poshtërimin ndaj nderit dhe famës. » (112)

- Të madhëruarit e All-llahut, këshilla mbi përkushtimin ndaj Zotit, dhe gjëra mbi Ditën e Gjykimit:

« Falënderuar qoftë All-llahu i Cili i ka paraqitur gjurmët e pushtetit të Tij dhe famën e amdhësisë së Tij me anë të mrrekullive të pushtetit të Tij i cili vërbon bebëzat e syve dhe pengon mendjet në vlerësimin e vërtetësisë së cilësive të Tij. Dëshmoj se nuk ka Zot pos All-llahut me dëshmim të besimit-imanit dhe bindjes se Muhammedi është rob i Tij dhe Pejgamber i Tij, të cilin Ai e ka dërguar kur dëshmitë e Udhëzimit ishin ngatërruar dhe orientimet e besimit islam ishin tretur. Dhe ai prezantoi të vërtetën e plotë, këshilloi njerëzit, i udhëzoi në punë të mbarë dhe u urdhëroi të jenë të pëkohë-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!-

- Djeni, o robër të Zotit, se Ai nuk u ka krijuar së koti, as u ka lënë në kotësi. Ai e njeh përmasën e bekimeve të Veta dhe sasinë e mirësisë së Tij ndaj jush. Prandaj, lutuni për fitore nga Ai dhe kërkoni sukses nga Ai. Lypni nga Ai dhe kërkoni shpërblimet e Tij. Kurrëfarë pende nuk fshehë prej Tij, as është e mbyllur për Te ndonjë dreë para jush. Ai me të vërtetë gjendet në çdo vend, në çdo çast dhe në çdo kohë. Ai gjendet në çdo njeri dhe xhin. Dhënja nuk e cungon Ate. Të dhëruarit Atij nuk i shkakton pakësim. Ai i cili e kërkon nuk e shpenzon, ndërsa bujaria Ate nuk e lodhë.

- Asnjë person nuk mund ta largojë vëmendjen e Tij nga diç tjetër, asnjë tingull Ate nuk e largon nga një tingull tjetër dhe asnjë shpërblim Ate nuk mund ta pengojë të refuzojë një shpërblim tjetër. Zemërimi Ate nuk e ndalon në mëshirë, ndërsa mëshira-rahmeti Ate nuk e pengon në ndëshkim. Fshehtësia e Tij nuk e fshehë dukshmërinë e Tij, ndërsa dukshmëria e Tij nuk e pengon Ate në fshehtësi. Ai është afër, por njëkohësisht edhe larg. Ai është lart, por njëkohësisht edhe poshtë. Ai është i dukshëm, por njëkohësisht edhe i fshehur. Ai është i fshehur, por njëkohësisht i qartë (evident). Ai shpërblen, kurse Vetë nuk është i shpërblyer. Ai nuk i ka krijuar krijesat pas sajimit të projekteve, as ka kërkuar ndihmën e tyre për shkak të lodhjes.

- O robët e Zotit! Po ju lë amanet të jeni të vetëdijshëm për Zotin, ngase kjo është freri dhe mbështetja kryesore. Prandaj, përmbajuni fort këtij neni dhe përqafoni të vërtetën e tij, dhe kjo do t'ju shpjerë në vendbanimet e kënaqësisë, vendet e komoditetit, kështjellat e sigurisë dhe shtëpitë e nderit, ... » në ditën kur sytë do të shtangen nga trishtimi. » (El-Ibrahim, 42), kur errësira do të jetë gjithëkund përqark, kur kopeja e deveve të cilat bartin të vegjëlit prej dhjetë muajsh të mbetet pa bariun. Atëherë

do t'i fryhet surit (bririt), me ç' rast çdo qenie e gjallë do të vdesë, çdo tingull do të shuhet, me mendjemëdhenjtë dhe mburravecët do të poshtërohen, malet e larta dhe shkëmbinj të fortë do të thërrmohen ashtu që gurët e tyre do të shndërrohen në rërë, ndërsa themelet e saj do të rrafshohen. Atëherë nuk do të ketë ndërmjetës për të ndërmjetësuar, as mik për të mbrojtur, as pretekst i cili do të mund të ndihmonte... » (113)

- Karakteri i gjithdijshmërisë së All-llahut: » Ai-All-llahu din për britmat e shtazëve në shkretëtirë, gjynahet e njerëzve në vetmi, lëvizjen e peshqëve në detërat e thellë dhe vallëzimin e ujit nga erërat e vrullshme. Dëshmoj se Muhammedi është i zgjedhuri i All-llahut, transmetuesi i Shpalljes (Vahjit) dhe Pejgamber i mëshirës-rahmetit të Tij!

- Kurse tani, ju lë amanet të jeni të vetëdijshëm mbi All-llahun, i Cili ju krijoi në mënyrë autentike, dhe te Ai ju do të ktheheni. Me Te është sukcesi i drejtimeve tuaja, në Te përfundojnë dëshirat tuaja, drejt Tij shpie Rruga juaj e drejtë dhe Ai është caku drejt cilit jeni orientuar. Me të vërtetë përkushtimi ndaj All-llahut është ilaç për sëmundjet e zemrave tuaja, shikim për verbërinë e shpirtërave tuaj, shërim për dobësinë e trupave tuaj, përmirësues i ligësive të gjoksave tuaj, pastrues i ndotjes së mendjeve tuaja, eliminues i territ të syve tuaj, siguri nga frika e zemrave tuaja dhe dritë në errësirën e paditursë.

- Prandaj, bëjeni përkushtimin ndaj All-llahut mënyrë të jetës tuaj, dhe jo vetëm mbulesë tuajën të jashtmen, shprehi të brendshme në vend të shprehisë së jashtme, aq të dukshëm sa mund të depërtojë nëpër hijet tuaja, udhëheqës për të gjitha punët tuaja, vend të frymëzimit për frymëzimet tuaja, ndërmjetës për arritjen e qëllimëve tuaja, shoqëri për vetminë e gjatë tuajën, si dhe lirim nga vuajtjet e vendbanimeve tuaja. Me të vërtetë, përkushtim ndaj All-llahut është mbrojtje nga vështirësitë që ju rrethojnë, rreziket e pritura dhe flaka e zjarreve të tërbuar.

- Prandaj, çdo njeri që e kultivon përkushtimin ndaj All-llahut, telashet qëndrojnë larg prej tyre pasi të kenë qenë afër, punët u bëhen të këndëshme pasi të kenë qenë të vrazhda, valët tërhiqen nga ai pasi të jenë vërsulur mbi te, vështirësitë i bëhen të lehta pasi të jenë paraqitur, bujaria do të derdhet mbi ta pasi të ketë qenë mungesë, mëshira e mbulon ate pasi nuk ka qenë në anën e tij, të mirat do të rrjedhin drejt tij pasi që ishin shterrur, dhe bekimi bujshëm lëshohet mbi te pasi që të ketë qenë i pakët. Prandaj, jeni të përkushtuar ndaj All-llahut i Cili u siguron dobi me këshillën e Tij, ju mëson me porosinë e Tij dhe ju shprëblen me begatitë e Tij. I bëni shpirtërtat tuaj të devotshëm në shërbim të Tij dhe kryeni me besnikëri obligimin e përkushtimit ndaj Tij.

- Islami vërtetë është feja të cilën All-llahu e ka sjellur për Vete, e ka zhvilluar para Vetes, e ka zgjedhur si më të mirën për krijesat e Tij, i ka vendosur shtyllat e saj mbi dashurinë e Tij. Ai i ka poshtëruar përkushtimet tjera me atë që e ka lartësuar atë. Ai i ka pështëruar të gjitha bashkësitë me atë që e ka ngritur atë. Ai me mirësinë e Tij i ka poshtëruar armiqët e saj dhe i ka turpëruar kundërshtarët e saj duke i ofruar asj ndihmën e Vet. Ai me *thukun* e saj i ka thyer mbajtësit e mashtrimit. Ai ua ka shuajtur etjen të etshmëve nga saranxha e saj dhe ka mbushur saranxhat përmes atyre të cilët nxjerrin ujë. »

- Mbi Islamin Famëlartë: » Ai e bëri Islamin të tillë sa që lidhja e tij nuk mund të këputet, nyja e tij të zgjidhet, ndërtesa e tij të rrënohet, shtyllat e tij të shkatërrohen, trangu i tij të çrënjohet, koha e tij të soset, dispozitat e tij të harrohen, degët e tij të priten, shtigjet e tij të ngushtohen, lehtësia e tij të shndërrohet në vështirësi, qartësia e tij

të errësohet, drejtësia e tij të shtrembërohet, druri i tij të lakohet, rrugët e tij të gjëra të ngushtohen, kandilat e tij të shuhen dhe ëmbëlsira e tij të idhëtohet.

- Ai-Islami përbëhet nga shkallët-bazamentin e të cilave All-llahu e ka përforcuar në të Vërtetën, kurse themelin e cilave e ka forcuar Ai, dhe nga burimi rrjedha e të cilit është e begatshme me ujë, edhe nga kandilat flaka e të cilëve është plot dritë, edhe nga fanari me ndihmën e të cilit udhëtarët orientohen, edhe nga shenjat me anë të cilëve gjendet shtegu drejt rrugëve kryesore, edhe nga burimet të cilat i ofrojnë ujë atyre të cilët u vijnë pranë. All-llahun në te e ka vendosur kulmin e kënaqësisë së Tij, majën e shtyllave të Tij dhe superioritetin e përkushtimit ndaj Tij. Prandaj, te All-llahu shtyllat e Tij janë të forta, ndërtesat e tij të larta, argumentet e tij të shkëlqyeshme, zjarret e tij janë flakë, pushteti i tij i fuqishëm, fanarët e tij të lartë dhe do të jetë shumë vështirë të shkatërrohet. Prandaj, konsiderojeni të ndershëm dhe pasojeni! Jepni atë që i takon dhe caktojini vendin të cilin e meriton... »

- Mbi Pejgamberin-Muhammedin s.a.v.s thotë: » All-llahu i Madhëruar e dërgoi Muhammedin-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!- me të Vërtetën në kohën kur fundi i botës është afruar, ndërsa bota e ardhshme (ahireti) është afër, kur shndërritja e saj është shndërruar në errësirë pas shkëlqimit, andaj është ngritur në këmbë me banorët e vet. Syprina iu bë e vrazhdë, ndërsa shkatërrimi afërt. Kjo ndodhi në kohën e sosjes së afatit të saj, krahas afrimit të shenjave të saj, vuajtjes së banorëve të saj, këputjes së lidhjeve të saj, shpërbërjes së motiveve të saj, shfarosjes së shenjave të shenjave të saj, zbulimit të fshehtësive të saj dhe shkurtërimit të gjatësisë së saj. All-llahu e bëri transmetues të Porosisë së Tij (Vahjit), nderë për popullin e tij, pranverë për njerëzit e kohës së tij, lartësim për përkrahësit dhe respekt për ndihmëtarët e tij. »

- Mbi Kur'anin e Madhnueshëm thotë:

« Pastaj Ai ai shpalli Porosinë si dritë flaka e së cilës është e pashuar, kandile ndriçimi i cilës nuk mund të zhduket, det-fundi i cilit nuk mund të arrihet, rrugë drejtimi i cilës nuk shpie në prapësi, rreze-drita e cilës nuk zbehet, degëzues-argumenti i cilit nuk dobësohet, sqarim themelet e cilit nuk mund të rrënohen, shërimi i cili nuk len kurrëfarë frike nga sëmundja, autoritet-ithtarët e cilit nuk mund të mposhten, e Vërtetë-përkrahësit e cilës nuk mund të mposhten. Prandaj, ajo është minierë e besimit dhe esenca e tij, burim i diturisë dhe oqeanet e saj, kopsht i drejtësisë dhe pusët e tij, gurëthemel i Islamit dhe ndërtesa e tij, luginat e së vërtetës dhe fushat e saj, si dhe oqean të cilin nxjerrësit e ujit nuk mund ta zbrazin dot, burime të cilët ujëderdhësit nuk mund t'i thajnë, ujë për pije të cilin ata që mbushin ujë nuk mund ta sosin, vendprijë prej të cilëve udhëtarët nuk mund të largohen, shenja të cilët udhëtarët e rastit nuk i kalojnë pa i vërejtur dhe lartësi të cilat ata që u afrohen nuk mund t'i tejkalojnë.

- All-llahu ate-Kur'anin e ka bërë shuarje të etjes për të dijturit, pranverë zemrash për juristët, shteg kryesor për rrugët e të drejtëve, shërim pos të cilit eliminohet sëmundja, dritë me të cilën nuk ka errësirë, litar fijet e cilit janë të forta, kështjellë-maja e cilës nuk mund të rrënohet, nder për ate i cili e ndjek (pason), paqë për ate i cili hyn në të, udhëzim për ate i cili i shkon pas, arsytim për ate i cili e pranon, argument për ate i cili me të argumenton, dëshmitar për ate i cili me të dëshmon, fitore për ate i cili me te bindë, bartës për ate i cili bartë, vig për ate i cili shërbehet me të, shenjë për ate i cili kërkon udhëzim, mburojë për ate i cili mbrohet, dituri për ate i cili kupton, rrëfim për te i cili transmeton dhe vendim (aktgjykim) për ate i cilin gjykon (vendosë). » (114)

- Mbi madhësinë e Zotit dh krijimin e gjithësisë:

« Me Madhësinë e jashtëzakonshme të Tij dhe Pushtetin e Lartësuar të krijimit të së resë. Ai krijoi tokën e ngurtë dhe të terur nag uji i oqeanëve të pafund, të fuqishëm dhe

të turbulluar. Pastaj e shtresoi dhe e shpërndau në shtatë qiej, pas çkahit janë bashkuar mes vete. Kështu u qetësuan me urdhërin e Tij dhe u ndalën në kufirin të cilin Ai e caktoi. Dhe Ai e përforcoi tokën të cilën e bartin errësira e thellë dhe oqeani me ujë të përmbajtur, të përulur ndaj urdhërit të Tij dhe ta varur nga madhështia e Tij, gjersa të qarkulluarit e tij ndalet nga frika prej Tij.

- Ai formësoi malet e larta të saj, shkrepashtat shkëmbore dhe vargmalet e buta ashtu që i rrënjosi fort në shtratet e tyre dhe i obligoi të qëndrojnë të palëvizshëm. Majat e tyre lartëson në ajër, gjersa rrënjët e tyre janë të përforcuara në ujë. Në këtë mënyrë Ai lartësoi malet mbi fushore dhe pëcaktoi themelet e tyre në përmasa të gjëra kudo qofshin ato. Majat ua bëri të larta, ndërsa trupat e tyre madhështorë. I drejtoi si shtylla bartëse për tokën dhe i fortifikoi në të si pyka. Toka kështu u bë e fortë; në të kundërtën do të lëkundej me banorët e saj, ose do të rrënohej përbrenda me barrën e saj, ose do të lëvizte nga pozita e saj.

- Prandaj është i lavdëruar Ai i Cili e ndaloi pas të rrjedhurit të lëngut të saj dhe e ngurtësoi pas gjendjes fluide të skajeve të saj. Kështu Ai atë e bëri djep për krijesat e Tij dhe e shtroi për ta si shtrat mbi oqeanin e thellë i cili është qetësuar dhe i cili nuk lëvizë. Errërat e lëkundin andej këtej, ndërsa retë e thithin ujin nga ai:

« Në këtë, kini mendjen, ka mësim për të gjithë të cilët kanë respekt të thellë. » (En-Naziat, 26) (115)

- Fjalimet e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi krijimin e botës në përgjithësi e prezantojnë qëndrimin islam si dhe përfshijnë një pjesë të madhe të segmentit, i cili në domethënie e sotme nënkupton tërësinë e botës në gjithëpërfshirjen e saj:

« Falënderimi i takon All-llahut, famën e të Cilit nuk mund ta bëjnë tram ata që përpiqen, Cilin as guximi më i lartë mendor nuk mund ta vlerësojë, as të kuptuarit e thellë nuk mund ta arrijë. Atij-për cilësitë e të Cilit nuk ka kurrëfarë kufiri, as kurrëfarë përshkrimi-nuk i është caktuar kurrëfarë kohe dhe nuk i është caktuar kurrëfarë afati. Ai-All-llahu krijoi botërat me plotëfuqishmërinë e Tij, kurse tokën e cila dridhej e përforcoi me shkëmbinj të mëdhenj.

- Në besim (iman) në vendin parësor është të pranurit e Tij. Përsosmëria e pranimit të Tij është të dëshmuarit mbi Te. Përsosmëria e të dëshmuarit mbi Te është besimi në Njësinë e Tij (Tevhidi). Përsosmëria e besimit në Njësinë e Tij (Tevhidin) është ta konsiderosh të pastër. Kurse përsosmëria e pastërtisë së Tij është mohimi i cilësive të Tij, ngase çdo cilësi është dëshmi se është tjetërfare prej asaj cilësi i përshkruhen, ndërsa krejt ajo cilësi i përshkruhen për diç është e ndryshme nga cilësitë. Kështu çdo njeri që All-llahut i përshkruan cilësi pranon të ngjashme me të Tij, ndërsa ai që pranon (diç) të ngjashme me të Tij, Ate e konsideron si dyjësi, ndërsa kush e pranon si dyjësi i pranon pjesë për Te, kurse kush pranon pjesë për Te e kupton gabimisht, e kush pranon gabimisht e emëron, kurse kush e emëron Ate-e përkufizon , ndërsa kush e përkufizon Ate-e përkufizon në numër.

- Çdonjëri që thotë në çka ndodhet Ai, supozon se Ai është subjekt, ndërsa çdonjëri që thotë mbi çka është Ai, supozon se nuk është edhe mbi diçka tjetër. Ai është Ai Cili është, porse jo përmes fenomenit të arritjes në qenësi. Ai është, porse jo nga paqenësia. Ai është me të gjithë, por jo në afërsi fizike. Ai është i ndryshëm nga të gjithë, por jo në ndarjen materiale. Ai vepron, por jo në kuptimin e lëvizjes së objekteve. Ai shikon edhe atëherë kur nuk ka gjë për të shikuar midis krijesave të Tija. Ai është vetëm Një, ashtu që nuk ekziston askush me të cilin do të mund të shoqërohej, ose të cilin Ai do të mund ta vërente në mungesën e tij. »

- Krijimi i gjithësisë:

« Ai-All-llahu krijimin e ka aktivizuar tërësisht nga fillimi dhe e ka filluar krejtësisht në mënyrë origjinale, pa shfrytëzuar ndonjë eksperiment, pa inkuandrimin e kurrëfarë lëvizje, pa tundimin e ndonjë projekti që do Ta pengonte. Ai të gjithë gjërave ua ka caktuar afatet e tyre, i ka bashkuar shumëllojshmëritë e tyre, u ka dhënë veçoritë e tyre, ka përcaktuar, duke njohur, tiparet karakteristike të tyre, para se i ka krijuar, duke përfshirë tërësisht kufijtë dhe turpshmëritë e tyre, duke i dijtur i dijtur fshehtësitë dhe aftësitë e tyre.

- Kur Fuqiploti krijoi zgavrën e qiejve, nxiti zgjerimin e kupës qiellore dhe shtresat e erërave, me këtë vuri në lëvizje ujin, ndërsa valëvitjet e tij qenë shqetësuar dhe valët e tij kërcenin njëra mbi tjetrën. Këtë ujë ai ia ka vënë barrë erës së furishme dhe stuhive rrënuese; u dha urdhër që ta rikthejnë, u dha pushtet mbi fuqinë e tij dhe e njoftoi mbi kufizimet e tij. Era fryente nën të, kurse uji rrjedhte furishëm sipër saj.

- Pastaj Fuqiploti e ngriti erën; ia bëri lëvizjen shterpe, ia caktoi pozitën, ia forcoi vrullin dhe e përhapi anë e mbanë. Pastaj erën e urdhëroi të ngritë përpjetë ujë të bollshëm dhe të forcojë valët e detrave ta pafund. Kështu era shkumoi ujin sikur shkumohet hirra, dhe e ngriti vrulshëm në qiell, duke hedhur skajin e parë të tij mbi të fundit dhe duke qëndruar në të ardhshmin-gjersa niveli i tij nuk u ngrit dhe sipërfaqja nuk u mbulua me shkumë. Pastaj Fuqiploti ngriti shkumën në erën e lirë dhe qiellin e hapur, dhe prej kësaj sajoi shtatë qiejt, duke i bërë të poshtmit si valë e mbërthyer, ndërsa të epërmit si kupë mbrojtëse dhe ndërtesë pa kurrëfarë shtylle që do ta mbante ose kapëse që do ta mbante lidhur. Pastaj All-llahu i stolisi me yje dhe dritë të shkrepëtimave, dhe vuri Diellin ndriçues dhe Hënën shkëlqyese nën qiejt nën rrotullim, kupës në lëvizje dhe qiellin i cili lëviz. »

- Krijimi i melaqeve:

« Pastaj All-llahu krijoi hapësirat në mes qiejve të lartë dhe mbushi me lloje të ndryshëm melaqesh. Disa prej tyre janë të lëshuar përmbys dhe nuk kthehen në pozitë të gjuhëzimit. Të tjerat janë në gjuhë dhe nuk ngriten në këmbë. Disa prej tyre qëndrojnë në radhë dhe nuk ndërrojnë pozitën e vet. Të tjerat vazhdimisht madhërojnë All-llahun dhe nuk lodhen. Ata nuk i këput as gjumi i syrit, as gabimi i mendjes, as molisja e trupit, as efekti i harresës.

- Në mesin e tyre ndodhen rojtarët besnikë të shpalljeve të Tij dhe transmetuesit e porosive të pejgamberëve të Tij dhe ata të cilat i bartin andej e këndeje urdhërat dhe vendimet e Tij. Në mesin e tyre ndodhen mbrojtësit e krijësive të Tij dhe rojtarët e dyerve të kopshteve të Xhennetit. Në mesin e tyre ndodhen edhe ata këmbët e të cilëve janë të ngulitura në tokë, kurse qafët u zgjate gjer në qiej; gjymtyrët e tyre dalin në të gjitha anët, shpinat e tyre puthiten me shtyllat e Fronit Hyjnor (Arshin), para cilit shikimi i tyre është i lëshuar dhe nën cilin krahët e tyre janë të paluar, dhe mes vete dhe gjithë të tjerëve kanë shtrirë velin e famës dhe perden e fuqisë. Ata nuk mendojnë mbi Krijuesin e vet përmes shembëlltyrës, nuk i përshkruajnë cilësi të krijuarës, nuk e kufizojnë Ate në ndonjë vendbanim dhe nuk rrëfejnë për Te përmes interpretimeve. »

- Përshkrimi i krijimit të Ademit alejhisselam:

« Famëlarti prej dheut të vrazhdë dhe të butë, të ëmbël dhe të njelmët, zgjodhi argjilin, të cilën e uli në ujë gjersa nuk u bë e pastër, pasatj e ngjeshi duke e lagur gjersa nuk u bë si ngitës. Nga kjo krijoi një figurë me trajta, lidhje, gjymtyrë dhe nyej. E forcoi atë gjersa nuk u ngurtësua dhe e ngjeshi gjersa nuk u bë e terur dhe kumbuese në kohë të caktuar dhe kohëzgjatje të duhur. Pastaj Ai e frymëzoi nga Fryma e Vet, me ç' rast ky morri formën e qenies njerëzore me mendje e cila e orienton ate, intelekt të cilin e shfrytëzon, gjymtyrë të cilat i përdorë, pjesë të trupit të cila ndërrojnë pozitën e tij,

arsyeshmëri e cila dallon mes të vërtetës dhe të pavërtetës, shijes dhe aromës, ngjyrërave dhe llojeve. Ai është brumosje e argjilës-ngjyrash të ndryshme, materieve lidhëse, kontrasteve dalluese dhe veçorive të llojllojshme, siç janë të nxehtit dhe të ftohtit, butësia dhe fortësia.

- Pasatj All-llahu Famëlart kërkoi nga melaqet që ta plotësojnë shpresën e Tij dhe ta përmbushin garancën e urdhërave të Tij, ta pranojnë ate duke rënë në sexhde para tij dhe t'i nënshtrohen pozitës së tij të respektuar. Prandaj All-llahu u tha:»... përluni (bini në sexhde) Ademit!; ata menjëherë u përlunë (ranë në sexhde), me përjashtim të Iblisit... » (El-Bekaretu, 34)

- Iblisin (shejtanin, vërejt e përkth) e ndaloi mendjemadhësia dhe e mposhti zilia. Ai u krekos tepër me përbërjen e tij të zjarrtë dhe u soll në mënyrë përbuzëse ndaj krijesës nga argjila (Ademit, vërejt e përkth). All-llahu për këtë arsye ia caktoi një kohë që t'i lejojë ta meritojë plotësisht zemërimin e Tij, ta përmbush sprovën dhe të plotësojë premtimin. Prandaj Ai thotë :» Vërtetë, të jepet afati gjer në Ditën tani më të caktuar. » (El-Hixhr, 37-38)

- Lavdiploti pastaj e vendosi Ademin ku kishte jetë të lumtur kurse qëndrimin e sigurt dhe e paralajmëroi për Iblisin dhe armiqtë e tij. Ky armik-Iblisi më vonë e mashtroi nga zilia e qëndrimit të tij në Xhennet dhe shoqërimin e tij me të gjitha të mirat. Kështu bindjen e vet e shkriu në dyshim, ndërsa vendosmërinë në dobësim. Gëzimin e vet e shndërroi në frikë, kurse devijimet morale në pendim. Atëherë All-llahu Lavdiplot ia ofroi rastin Ademit që të pendohet, ia mësoi fjalët e mëshirës së Tij, i premtoi kthim në Xhennet dhe e lëshoi në vendin e tundimeve dhe lindjes së pasardhësve.

- Nga pasardhësit e Tij-Ademit, Lavdiploti i ka zgjedhur pejgamberët dhe ka marrë zotimin e tyre për Shpalljen e Tij dhe për transmetimin e porosisë së All-llahut si obligim të tyre. Me kohë shumë njerëz tradhëtuan besimin e All-llahut, e lanë anash të drejtën e tij dhe i ngatërruan fantazmat bashkë me Te. Shejtani i prapësoi nga të njohurit e Tij dhe i mbajti larg nga të shërbyerit Atij. Pastaj All-llahu ua dërgoi pejgamberët dhe një sërë të dërguarish të Tij, që ta përmbushin betimin e Krijuesit Origjinar, që t'ua përkuqtojnë shpërblimin e Tij, që t'i cytë me anë të mësimëve, që t'ua zbulojë dritën e fshehur të njohjes, që t'ua tregojë shenjat e Plotfuqishmërisë së tij; qiejt e ngritur mbi ta, tokën e shtruar nën ta, mjetet për jetë me të cilat janë pajisur, vdekjen e cila i ndalon, vështirësitë të cilat shpenzojnë dhe fatkeqësitë të cilat bijnë mbi ta njëra pas tjetrës.

- All-llahu nuk ka lejuar kurrë që krijesat e Tij të mbeten pa të dërguar nga Ai, ose pa porosi të zbritur nga Ai, ose pa argument i cili obligon ose pa rrugë të qartë. Këta të dërguar ishin të tillë që nuk ndienin veten të dobët ngase ishin pak nga numri, gjersa mohuesit e tyre shumë. Në mesin e tyre gjithnjë ka pasur ose pararendës i cili e ka emëruar atë që vjen, ose ai që vjen të cilin e kishte prezentuar pararendësi. »

- Mbi Pejgamberllëkun e Muhammedit s.a.v.s:

« Dhe kështu rridhnin kohët dhe kalonin periudhat e tyre; baballarët shkonin, ndërsa bijtë zinin vendin e tyre, gjersa All-llahu nuk e dërgoi Muhammedin-bekimi i All-llahut qoftë me te dhe me familjen e tij!-si Pejgamber të Vetin për të mbushur premtimin e dhënë dhe për të plotësuar misionin e pejgamberllëkut. Dëshmia për te është marrur nga të gjithë pejgamberët. Fytyra e tij ka qenë e njohur mirë, kurse lindja e tij ka qenë dinjitoze. Njerëzit në tokë në atë kohë ishin të ndarë në grupacione të ndryshme, qëllimet i kishin të ndryshme dhe rrugët e shumëfishta. Ata ose e krahasoni All-llahun me krijesat e Tij, ose shtrembëronin emrat e Tij, ose i luteshin tjerëve krahas Tij.

Përmes Tij-Muhammedit s.a.v.s Ai i shpëtoi nga mashtrimi dhe i nxorri nga padituria (xhahilijeti, vërejt e përkth).

- Mandej Famëlarti Muhammedit-All-llahu e bekoftë ate dhe pasardhësit e tij!-ia caktoi takimin me Te dhe bëri që ai ta përvetësojë atë që ndodhet tek Ai, e shpërbleu me largimi nga kjo botë dhe me largim nga ky vend i tundimeve. Prandaj, Ai e ofroi pranë Tij me respekt, All-llahu e bekoftë ate dhe pasardhësit e tij! »

- Mbi Kur'anin e Madhnueshëm:

« Mirëpo ai-(Pejgamberi s.a.v.s, vërejt e përkth) u ka lënë juve po atë që u kanë lënë popujve të tyre të dërguarit tjerë, ngase të dërguarit ata nuk i kanë lënë pa bamirësi, pa rrugë të qartë, pa shenja të qëndrueshme. Ua ka lënë Librin nga Krijuesi juaj, (Kur'anin, vërejt e përkth) ju ka sqaruar të lejuarat (hallallin) dhe të ndaluarat (haramin), obligimet e prera dhe vendimet e lira, urdhërat revokues dhe të revokueshëm, atë që është e mundshme dhe detyrimet e prera, të veçantën dhe të përgjithshmen, këshillat dhe shembujt e tij, tërësitë dhe pjesët, qartësitë dhe paqartësitë e tij, duke i sqaruar hollësisht shkurtesat dhe duke ndriçuar të gjitha gjërat e paqarta.

- Në të-Kur'anin janë disa ajete, njohja e të cilëve është obligim dhe disa të tjerë mosnjohja e të cilëve njerëzve u lejohet. Përmban edhe atë që sipas tij është e obligueshme, mirëpo ai e lejon mospërmbushjen e kësaj. Ose ekziston ajo që është obligim për një kohë të caktuar, por jo edhe pas kësaj kohe. Ndalesat e tij gjithashtu dallojnë. Disa janë të mëdha dhe për to ekziston ndëshkimi me Zjarr (Xhehennem). Të tjerat janë të vogla dhe ka gjasa të falen. Disa të tjera Ai do t'i falë me një shpagim të vogël ose të madh. »

- Mbi haxhillëkun:

« All-llahu jua ka bërë obligim vizitën e Shtëpisë së Shenjtë (Qabenë) të Tij, e cila është pikë orientimi për njerëzit që shkojnë drejtë saj, ashtu si shtazët tokësore dhe pëllumbat që nxitojnë drejt burimit të ujit. All-llahu Famëlart e ka bërë simbol të përlësisë dhe pendimit ndaj Famës së Vet dhe simbol të përlësisë dhe pendimit para Fuqisë së Tij. Ai prej krijesave të Tij-iu përgjigjën dhe dëshmuan fjalët e Tij. Ata zurën pozitë si të dërguar të Tij dhe janë të ngjashëm me melaqet e Tij të cilat vijnë rrotull rreth Fronit të Tij (Arshit), të cilët për vete sigurojnë çdo dobi nga të shërbyerit Atij dhe nxitojnë drejt faljes së premtuar të gjynaheve nga ana e Tij. All-llahu Lavdiplot atë-haxhillëkun e bëri simbol të Islamit dhe shenjtëri për ata të cilët në Islam kërkojnë strehim. Ai e ka bërë obligim të vizituarit e saj-Qabesë dhe ka përcaktuar të drejtën e saj, me të cilën ju obligon në realizim e kësaj. Kështu Famëlarti në Kur'anin e Madhnueshëm thotë:

« ... për hirë të All-llahut, vizita e Shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit. » (Ali-Imran, 97). » (116)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s gjithashtu, siç e kishte zakon me mençurinë e tij dhe shprehjet elokuate përshkruajti edhe mbi asgjësimin dhe shkatërrimin e kësaj bote, duke thënë:

« O robët e All-llahut! Bëhuni të vetëdijshëm për All-llahun, dhe prenia hovin vdekjes me vepra të mira. Bleni mirëqenien e përhershme duke paguar me gjëra kalimtare. Përgatituni për udhëtim, ngase jeni të ndjekur. Dhe përgatituni për vdekje, ngase ajo i ka shtrirë krahët mbi ju. Bëhuni njerëz të cilët zgjohen kur i ftojnë dhe të cilët e dinë se kjo botë nuk është vendbanimi i tyre, andaj e ndërrojnë.

- Vërtet, All-llahu nuk ju ka krijuar pa qëllim, as ju ka lënë në harresë. Vetëm ardhja e vdekjes është ajo që çdonjërin prej jush e ndanë nga Xhenneti ose nga



Xhehennemi. Qëndrimin, i cili arfon çdo moment dhe zbulon çdo çast, vërtetë duhet konsidruar të afërt. E panjohura, të cilën e ndjekin dy fenomene gjithnjë të rinj-nata dhe dita, me siguri po afrohet me nxitim. Udhëtari i cili vjen me humbje ose fitim meriton pajisje më të mirë. Për këtë arsye, gjersa ndodhemi këtu, siguroni pajisje të tillë nga kjo botë me të cilën do të mund të mbroheni nesër.

- Çdonjëri duhet të jetë i vetëdijshëm për All-llahun, t'ia tërheqë vëmendjen vetes, ta dërgojë përpara pendimit (teuben) e vet dhe ta mposhtë pasionin e tij, ngase fundi është fshehur nga ai, shpresat e tij e mashtrojnë, kurse shejtani i është qepur pas dhe ia zbukuron mëkatën për ta kryer, e joshë që ta lë për më vonë pendimin (teuben), gjersa vdekja ta godasë në çastin kur ai (njeriu) të jetë më i shkujesur ndaj saj. Eh sa pikëllim është për të shkujesurin! Jeta e tij do të jetë argument kundër tij, dhe ditët e tij do ta shpiejnë në shkatërrim.

- Nga All-llahu Lavdiplotë kërkoj që neve dhe juve t'na bëjë të njëjtë me ate të cilin pasuria nuk e bënë të shkujesur, të cilin kurrëfarë qëllimi tjetër nuk mund ta detyrojë të zvogëlojë besimin ndaj All-llahut të vet dhe të cilin pendimi (teubja) dhe vujtja e rëndë nuk do ta godasin pas vdekjes. » (117)

- Një numër bukur i madh i thënieve të Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s janë të shprehur për pejgamberët e All-llahut xh.sh.

- Lavdia e All-llahut dhe lavdi i pejgamberëve:

« I madhëruar qoftë All-llahu, Cilit kulminacionet e guximit nuk mund t'i afrohen, as mprehtësia e mendjes nuk mund ta gjejë. Ai është në atë masë i pari, sa nuk ekziston kurrëfarë skajshmërie për te që në te të përmbahet, as nuk ka kurrëfarë fundi për Te ku do të përfundojë. »

- Mbi Pejgamberin-Muhammedin s.a.v.s dhe pasardhësit e tij:

« Ai e lëshoi në vendin më të mirë të lëshimit dhe e vendosi në vendin më të mirë të banimit. Ata i kanë dhuruar njëri-tejtë, kurrizat më të fismë në mitrat më të pastra. Çdo herë kur vdiste i pari i tyre, parardhësi i ardhshëm ngritej për hir të fesë së All-llahut, gjersa ky nderë i All-llahut të Madhëruar nuk arrijti te Muhammedi-Selami i All-llahut qofshin mbi te, dhe pasardhësit e tij!-All-llahu e zgjodhi nga raca më e zgjedhur dhe nga vendi më i respektuar i tubimit, nga loza e njëjtë nga e cila Ai i zgjodhi pejgamberët e Tij dhe i ngriti emisarët e Tij. Familja e tij (Muhammedit s.a.v.s, vërejt e përkth) është familja më e mirë, gjinia e tij-është gjinia më e mirë, kurse baza e tij është baza më e mirë. Ai është rritur në vend të shenjtë dhe u ngritë në fisnikëri. Degët e tij janë të gjata, kurse frytet nuk mund të arrihen dot.

- Ai-Pejgamberi është prijës i të gjithëve që janë të vetëdijshëm për All-llahun dhe dritë për ata që janë udhëzuar. Ai është kandile-flaka e të cilit ndriçon, shkrepëse-drita e cilës është e shkëlqyeshme dhe strall-xixa e cilit është e zjarrtë. Rruga jetësore e tij është e drejtë, drejtimi i tij është i mbarë, fjalimi i tij është bindës, kurse gjykimi i tij është i drejtë. All-llahu e dërgoi pasi një kohë kishte ndërprerë dërgimin e pejgamberëve-alejhimusselam, kur njerëzit ishin zhytur në gabimet e veprimit dhe padijturi-xhahilijet.

- All-llahu u mëshiroftë!

- All-llahu e lëshoftë mëshirën e Tij mbi ju!

- Veproni në harmoni me shenjat e qarta, ngase rruga është e hapur dhe shpie në shtëpinë e sigurisë, gjersa ju gjendeni në vendin e kërkimit të begatisë së All-llahut dhe keni kohë dhe mundësi. Fjalët janë hapur, pendat shkruajnë, trupat janë të shëndoshë, gjuhët të papenguara, pendimet (teubet) miratohen, kurse veprat pranohen. » (118)

- Lavdërimi i Pejgamberit Famëlartë:

« Falënderuar qoftë All-llahu, Cili është aq i pari sa nuk ka asgjë para Tij, dhe aq i fundi sa nuk ka asgjë pas Tij. Ai është aq i Dukshëm sa asgjë nuk ekziston mbi Te dhe aq i Fshehtë sa nuk ka asgjë më afër se Ai.

- Vendi i tij (Pejgamberit, vërejt e përkth) i banimit është më i miri prej të gjitha vendeve, kurse prejardhja e tij është më e fisme se të gjitha prejardhjet në minierat e fisnikërisë dhe djepat e sigurisë. Zemrat e personave të ndershëm kanë simpati për te, kurse fnerët e shikimit janë orinetuar drejt tij. Me te (Pejgamberin) All-llahu ka varrosur pabesinë e ndërsjellë dhe ka shuar flakën e mospajtimit. Me te Ai i ka bashkuar si vëllëzër dhe i ka ndarë ata të cilët kanë qenë të bashkuar. Përmes tij-Ai i ka ngritur lart ata nga shtresa e ulët, ndërsa i ka hedhur poshtë ata nga shtresat e larta. Fjalimi i tij është i qartë, kurse heshtja e tij është fjalim. » (119)

- Mbi Pejgamberin Famëlartë dhe pasardhësit e tij:

« Falënderuar qoftë All-llahu, i Cili e përhap mirësinë e Tij në mesin e krijesave, dhe shtrin Dorën e bujarisë së Vet ndër ta. I falënderohemi Atij për të gjitha dhe kërkojmë ndihmën e Tij në jetësimin e të drejtave të Tij. Dëshmojmë se nuk ka zot pos All-llahut dhe se Muhammedi-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!-është rob i Tij dhe Pejgamber i Tij. Ai e dërgoi që të publikojë urdhërat e Tij dhe të dëshmojë mbi paralajmërimin e Tij. Ndërsa ky e zbatoi këtë dhe eci në Rrugë të drejtë.

- Midis nesh ai ka flamurin e të së Vërtetës. Kushdo që ecë përpara tij-bie nga sistemi moral i Islamit. Kushdo që mbetet prapa tij-është i humbur. Kushdo që mbetet vazhdimisht në te-i është bashkuar.

- Bartësi i saj është i vendosur në fjalë, i ngadalshëm në ngritje nga shtrati, kurse i shpejtë kur është ngritur. Kur përkulni qafën para tij dhe kur drejtoni gishtat drejt tij, do t'i arrijë vdekja dhe do ta marrë. Pas tij-Pejgamberit s.a.v.s do të jetoni aq gjatë sa të dëshirojë All-llahu. Gjersa All-llahu ua tregon ate i cili do t'u tubojë së bashku dhe do t'u bashkojë pas shpërndarjes. Prandaj, mos shkoni pas atij që nuk shkon përpara, as mos e humbni shpresën te ai që largohet, ngase vërtetë mund të ndodhë që atij që largohet t'i rrëshqet njëra këmbë, ndërsa tjetra të mbetet stabile gjersa të dyjat nuk kthehen dhe stabilizohen së bashku.

- Kini mendjen! Pasardhësit e Muhammedit-Selami i All-llahut qofshin gjithnjë mbi te dhe mbi familjen e tij!-janë si yjet në qiell. Kur një yll perëndon-tjetri lind. Prandaj, keni mundësi të realizohet Rahmeti i All-llahut mbi ju, kurse Ai u ka dëftuar për ate çka duhet të shpresoni. » (120)

- Misioni i Pejgamberëve alehjimusselam:

« All-llahu i dërgoi dhe i ndriçoi ata me Shpalljen e Tij. Ai i bëri dëshmi të Vetën për Krijesat e Tij, ashtu që ata të mos kenë argument as kurrëfarë preteksti. Dhe ai i ftoi me fjalim të singertë në rrugë të së Vërtetës-Dijeni mirë, All-llahu vërtetë e njeh pozitën e njerëzve në tërësi. Jo pse Ai nuk ka qenë i vetëdijshëm për atë që ata e mbajnë të fshehtë nga fshëhtesitë e ruajtura të tyre dhe ndjenjave të brenddëshme, por për të provuar cili prej tyre vepron më së mir, kështu që ekziston shpërblimi, lidhur me veprat e mira të ndëshkimi, lidhur me veprat e këqia. »

- Pozita e shtëpisë së Pastër-Famëlartë:

« Ku janë ata të cilët pohonin se janë udhëzuar thellësisht në dituri, krahas nesh, duke gënjyer dhe duke na bërë padrejtësi neve, edhe pse All-llahu na ka ngritur lart, kurse ata i ka poshtëruar, neve na ka pajisur, ndërsa ata i ka privuar, si dhe neve na ka afruar, kurse ata i ka dëbuar. Me neve kërkohet udhëzimi, kurse verbësia mënjanohet. Me të vërtetë, imamët janë nga Kurejshët, ata janë rrënjësor në këtë degë të Hashimëve. Të

tjetër, pos tyre, nuk janë të përshtatshëm, as të tjerëve-pos atyre, nuk u ka hije të udhëheqin punët. »

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s lidhur me ata të cilët ishin kundër Shtëpisë së Pastër-Famëlartë:

« Ata përqaftuan atë që është e përkohshme, ndërsa e kanë shtyrë atë që vie më vonë; e kanë lënë anash të pastrën dhe pijnë të ndoturën. Më duket se e shoh njeriun e prishur të tyre se si ka bërë vepër të palejueshme, është bashkuar me te, e ka ndihmuar dhe është pajtuar me te gjersa flokët e tij nuk janë thinjur, ndërsa natyra e tij e ka arritur cilësinë e vet. Ka vazhduar më tej, ka shkumbuar si rrëke e tërbuar, pa u mërzhitur fare për ate të cilin e përmbytë, ose si zjarri në kashtë i cili nuk e kupton fare çka djeg.

- Ku jane mendjet të cilat kërkojnë shoqërinë e kandilit të udhëzimit dhe sytë të cilët shikojnë në fanarët e virtytit? Ku janë zemrat e orientuara plotësisht nga All-llahu dhe besnike në përkushtimin ndaj All-llahut? Ata vërsulen drejt gjërave të kalueshme dhe grinden rreth të palejuarës. Shenjat e Xhennetit dhe Xhehennemit janë ngritur sipër tyre, mirëpo ata ia kanë kthyer shpinën Xhennetit dhe veprat e tyre janë drejtuar në Xhehennem. Zoti i tyre i ftoi, mirëpo ata refuzuan dhe nuk e përfillën. Kurse kur shejtani i thirri ata iu përgjigjën dhe iu bashkuan. » (121)

- Mbi msisionin e Pejgamberit s.a.v.s:

« Ai-All-llahu e dërgoi me dritën shëlqyese, argument të gjatë, rrugë të hapur dhe Libër i cili udhëzon. Familja e tij (Pejgamberit s.a.v.s, vërejt e përkth) është familja më e mirë, ndërsa druri i tij gjenealogjik është më i fisni; degët e këtij druru janë harmonike, ndërsa frytet e tij janë në largësi të dorës. Vendi i lindjes së tij është Meka, ndërsa Taibi është vendi i transferimit, prej cilit fama e tij u ngrit në lartësi, kurse emri i tij u përhap anë e kënd e botë.

- Ai e dërgoi me argument të mjaftueshëm, me të folur dhe ftesë bindëse e cila vendosë rregull. Përmes tij Ai paraqiti ligjet të cvilët ishin të panjohur, asgjësoi risitë të cilat ishin futur, dhe gjer në imtësi sqaroi rregullat.

- Prandaj çdonjëri që ndjek ndonjë besim tjetër pos Islamit, mjerimi i tij është i sigurt, lidhja e tij do të këputet, vuajtja e tij do të jetë pikëllim i gjatë dhe dënim i ashpër. »

- Mbi nxjerrjen e mësimin nga kjo botë:

« I besoj All-llahut, me besim të orientimit te Ai dhe i lutem Atij të më orientojë në rrugë e cila shpie në Xhennetin e Tij dhe të sjell në vendin e kënaqësisë së Tij. Po u lë amanet, o robët e Zotit, që të jeni të vetëdijshëm për All-llahun dhe t'i bindeni Atij, ngase ky është shpëtimi i së nesërme dhe çlirimi i amshueshëm. Ai u ka vetëdijesuar dhe këtë e ka bërë rrënjësisht. Ai u ka nxitur dhe këtë e ka bërë tërësisht. Ai ua ka përshkruar këtë botë, ndarjen nga ajo, pastaj perëndimin dhe kalueshmërinë e saj. Prandaj, qëndroni larg asaj që u joshë në të, pasi që do të vijë me ju vetëm pak nga ajo që e posedoni në të. Shtëpia e tillë është më e afër pakënaqësisë së Zotit dhe më e largët nga kënaqësia e Zotit.

- Andaj, ktheni shikimet o robët e Zotit, nga brengat dhe punët e saj, pasi që jeni bindur se do të ndaheni nga ajo dhe në ndryshimin e gjendjeve të saj.

- Jeni vigjilent ndaj saj si ai i cili frikohet vërtet dhe si përpjekësi i cili përpiqet shumë. Nxjerrni mësim nga ajo që keni parë nëpër vendet e vuajtjeve të vendeve para jush. Vendet e nyjeve të tyre gradualisht janë tretur, sytë dhe veshët e tyre janë zhdukur, nderi i tyre dhe respekti kanë kaluar, ndërsa gëzimet dhe kënaqësitë e tyre janë sosur. Afërsia e fëmijëve të tyre është zëvendësuar me largësinë e tyre, ndërsa bashkëjetesa e bashkëshortëve është zëvendësuar me ndarjen e tyre. Ata nuk lëvdohen mes vete, as

lindin, as vizitojnë, as jetojnë si fqinjë. Pra, kini kujdes, o robët e All-llahut, me kujdesin e atij i cili ka në dorë vetëveten, i cili frenon pasionet e veta dhe i cili gjykon me arsyeshmërinë e tij. kjo është vërtet e sigurt, shenja është vendosur, shtegu është i dystë, kurse rruga e drejtë. » (122)

- Mbi lojalitetin e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s-pra lojalitetin e tij ndaj

Pejgamberit-Muhammedit s.a.v.s:

« Shokët më të besueshëm të Muhammedit-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe pasardhësit e tij!-e dijnë se kurrë, për asnjë moment, nuk kam refuzuar përkushtimin ndaj All-llahut dhe Pejgamberit të Tij- Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e Tij!- dhe e dijnë se me trimërinë me të cilën më nderoi All-llahu, e kam përkrahur me jetën time në rastet kur madje edhe sypatremburit sprapsen dhe këmbët nuk ecin.

- Kur Pejgamberi-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- nërroi jetë, koka vërtet i gjendej në kraharorin tim dhe frymëmarrja e fundit e tij kaloi mbi shuplakën time, dhe me të përshkova fyryrën time. Unë e bëra pastrimin e tij-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!-gjersa melaqet më ndihmonin. Shtëpia dhe oborri ishin përplot me njerëz, me çrast një grup binin duke u lutur, ndërsa të tjerët ngriteshin. Veshët e mi vazhdimisht kapnin zërat e tyre fërgëllues duke thirrur bekimet e All-llahut mbi te, tërë kohën gjersa nuk e varrosëm në varrin e tij. Prandaj kush është më i merituari për këtë se unë, të gjallë ose të vdekur?! Prandaj, dëgjoni arsyen tuaj, ngase, pesha Ate i Cili është i tillë që nuk ka Zot pas Tij, me të vërtetë unë jamë në rrugë të së Vërtetës, kurse ata vërtet janë në vendrrëshqitje të mashtrimit. Po u them këtë që dëgjoni dhe kërkoj ndjes nga Zoti për mua dhe përju. » (123)

- Në vijim po sjellim fjalët që Imam Aliu a.s me rastin e varrimit të gruas së tij-Fatime Zehrasë, i shprehi duke qenë i drejtuar kah varri i Pejgamberit Muhammedit s.a.v.s:

« O Pejgamber i All-llahut, Selami i All-llahut qoftë mbi ty nga unë dhe nga bija jote, e cila erdhi afër teje dhe e cila nxitoi të takohet me ty! O Pejgamber i All-llahut, durimi im rreth të zgjedhurës tënde u sos dhe fuqia ime e qëndresës u dobësua ;mbeti vetëm ngushëllimi, nga pikëllimi i madh i përsosur dhe ngjarjen e hidhur të ndarjes tënde, me atë se të kam lëshuar në varrin tënd dhe me atë që shpirti yt ka kaluar nëpër qafën time dhe gjoksin tim.

« ... Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi! »(El-Bekaretu, 156)

- Kurse tani huaja u kthye dhe ajo që është dhënë u morr prapa. Pikëllimi im është i përhershëm. Kurse sa i përket netëv të mia, ato do të mbesin të pagjumë gjersa All-llahu nuk do të caktojë për mua shtëpinë me të cilën banoni ju tani.

- Natyrisht, bija jote-Fatimeja do të lajmërojë se ithtarët tu janë bashkuar për shkak të tiranzimit të saj. Pyete për çdo gjë dhe mëso të gjitha lajmet mbi gjendjen. Kjo ngjan kur nuk kishte kaluar as kohë e gjatë, as kujtimi për ty. Selam keni të dytë nga ai i cili përcjell, e jo nga personi i cili urren dhe ndjen mërzi, ngase nëse shkoj, kjo nuk do të jetë nga mërzia, kurse nëse mbetem kjo nuk do të jetë për arsye se dyshoj në atë që All-llahu u ka premtuar durimtarëve. » (124)

- Fjalët e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi fisnikërinë e pasardhësve të Pejgamberit-Sal-lall-llahu alejhi ve alihi:

« Dëshmoj se All-llahu është i drejtë dhe rrespekton drejtësinë; Ai është gjykatës i cili sjell vendime. Gjithashtu, dëshmoj se Muhammedi është rob i Tij, Pejgamber i Tij dhe prijësi i robërve të Tij. Sa herë që All-llahu rishtas ka ekzekutuar krijesa në dy grupe, ata

e ka radhitur në atë më të mirin, në të cilin nuk ka kontribuar asnjë njeri imoral, as ka mbetur në të kurrëfarë njeriu i lig.

- Kini mendjen! All-llahu i Lartëmadhëruar vërtet i ka sajuar për të mirë ata të cilët janë të drejtë për te, për të Vërtetën shtylla dhe për bindjen mbrojtje. Ju vërtetë në çdo përvujtni do të keni ndihmën e All-llahut, e cila do të shprehet me gjuhë dhe zemrave do t'i japë qëndrueshmëri. Ajo është e mjaftueshme për ate i cili kërkon shërim.

- Dijeni se këto krijesa të All-llahut të cilët e ruajnë diturinë e Tij, vërtetë i ofrojnë mbrojtje atij që Ai dëshiron ta mbrojë dhe ata bëjnë që burimet e Tij të jenë të rrjedhshëm. Ata mes vete sillen si miq dhe takohen me dashuri. Njëri-tjetrit i japin ujë nga kupa e cila shuan etjen dhe kthen nga vendburimet tërësisht të kënaqur.

- Ata dyshimi nuk i kaplon, as thashethemet nuk gjejnë mbështetje te ata. Ai kështu e ka sajuar krijimin e tyre dhe sjelljen e mirë të tyre. Prandaj, ata respektohen në emër të All-llahut dhe vizitohen mes vete, ashtu që janë bërë superior si fara e cila është zgjedhur me marrjen e disave dhe me flakjen e të tjerave. Kjo zgjedhje i ka dalluar dhe veprimi i zgjedhjes i ka pastruar. »

- Vazhdon edhe më tej Imam Aliu a.s të flasë mbi cilësitë e të virtytshëmve-udhëzimin e të cilëve duhet ndjekur, duke shtuar:

« Prandaj njeriu le të marrë mësim të mirë për të cilën nuk kërkohet kurrëfarë shpërblimi tjetër pos pranimit të tij. Le të frikohet dhe të ketë kujdes për Kijametin para se ai të arrijë dhe le të shikojë numrin e vogël të ditëve të tij dhe kohën e shkurtër të qëndrimit të tij në shtëpinë e cila do të zëvendësohet me një shtëpi tjetër. Prandaj, le të bëjë diç për transferimin e vet dhe vendin e njohur të shkuarjes së vet. Ngase, është i lumtir ai i cili ka zemët të pastër, që i bindet atij që udhëzon të largohet nga ai që e shpie në shkatërrim, mban rrugën e sigurtë me ndihmën e atij i cili ia siguron dritën dhe dëgjon udhëzuesin i cili urdhëron, nxiton drejt Udhëzimit para se dyert e tij të mbyllen dhe shkaqet të sosën, si dhe hap portat e pendimit dhe eliminon mëkatet. Ai është i orientuar në rrugë të drejtë dhe është udhëzuar në rrugë të drejtë. » (125)

- Fjalimi që Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e mbajti gjatë pastrimit dhe përgatitjes së xhenazes (kufomës) së Pejgamberit-Muhammedit-Selami i All-llahut qofshin gjithnjë mbi te dhe mbi familjen e tij:

« Edhe babain edhe nënën do ta flijoja për ty, o pejgamber i All-llahut!

- Me vdekjen tënde u mbyll rendi i pejgamberllëkut, shpalljes dhe porosive qiellore që nuk ka përfunduar me vdekjen e të dërguarëve tjerë.

- Pozita jote në krahasim me neve është aq e veçantë saqë dhembja për ty u shndërrua në burim të ngushëllimit kundruall pikëllimit të gjithë të tjerëve. Pikëllimi për ty është edhe i përbashkët, ashtu që të gjithë të përkushtuarit (ndaj All-llahut) e ndajnë njësoj.

- Po të mos na kishte urdhëruar të përmbahemi dhe po të mos kishe ndaluar vajtimin, do të kishim derdhur shumë lot, madje edhe atëherë dhimbja nuk do të zvogëlohej dhe ky pikëllim nuk do të përfundonte. Dhe kjo do të ishte fare pak nga pikëllimi për ty.

- Mirëpo, kjo është diç që nuk mund të kthehet, as mund të refuzohet!

- Edhe babain edhe nënën do ta flijoja për ty!

- Na përmend te All-llahu yt dhe mos na harro. » (126)

## MBI EHLI-BEJTIN A.S

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s mbi Familjen e Pejgamberit s.a.v.s në mes tjerash thotë:  
« ... Asnjëri nga bashkësia e muslimanëve nuk mund të barazohet me pasardhësit e Pejgamberit. Kurrë nuk mund të barazohen me ta ai mbi të cilin shtrihet bekimi i tyre. Ata janë edhe themel i fesë dhe shtyllë e besimit (imanit). Vrapuesi që është larguar duhet t'u kthehet, kurse përcjellësi që u shkon pas duhet t'i arrijë. Ata posedojnë të gjitha cilësitë për të qenë udhëheqës. Porosia dhe trashëgimi janë në favor të tyre. Tani e drejta i është kthyer pronarit të saj dhe është orientuar nga esenca e kthimit. » (127)
- Mbi Shtëpinë Famëlartë dhe kundërshtarët e tij:  
« Ai i cili posedon mendje të arsyeshme, shkon në drejtim të caktuar të vet. Ai e njeh rrugën e vet të poshtërit dhe famës. Ftuesi u ka ftuar. Bariu u ka ruajtur. Prandaj, përgjigjuni ftuesit dhe shkoni pas bariut.
- Janë zhytur në oqeanet e ngatërrimit dhe janë qasur risive në vend të Kur'anit, gjersa besimtarët përmytyshin, ndërsa të mashtuarit dhe gënjeshtarët flisin.
- Ne jemi veshje dhe shokë, ruajtës të thesarit dhe porta. Në shtëpi hyhet vetëm nëpër portat e tyre. Ai i cili hyn në to ndryshe dhe jo nëpër portë- quhet hajn.
- Gjërat të çmueshme në Kur'an janë deklaruar mbi famën e tyre dhe ata thesaret e Mëshirbërësit. Kur flasin ata e thonë të vërtetën. Ndërkaq kur heshtin askush nuk flet. Le të jetë prijësi i sinqertë ndaj ithtarëve të tij, le ta ruajnë arsyeshmërinë e të gjykuarit, le të jetë prej atyre që i përkasin asaj bote, ngase prej saj ka ardhur dhe në të do të kthehet.
- Nisma e veprimit të atij që shikon me zemër dhe vepron me sy, duhet filluar me vlerësimin a do të jetë ky veprim në dëm ose në dobi të tij. Nëse është në favor të tij, ai e vazhdon. Nëse është në dëm të tij, ai largohet nga ai. Ngase ai i cili vepron pa dije është i ngjashëm me ate që ecë pa rrugë. Dhe sa më tepër që shtëmëngjet nga rruga, aq më tepër largohet nga caku i vet. Ndërsa ai i cili vepron me dije është i ngjashëm me udhëtarin në rrugë të ndriçuar. Prandaj, ai i cili shikon le të mendojë a do të vazhdojë ose do të kthehet prapa.
- Dije, se me të vërtetë çdo gjë e jashtme ka të brendshmen e ngjashme. Prandaj, për çka është e mirë e jashtëmja-e mirë është edhe e brendshmjja. Kurse për çka është e keqe e jashtëmja-e keqe është edhe e brendshmjja. Pejgamberi i Vertetë-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!- ka thënë:» All-llahu mund ta çmojë njeriun, por ta urrejë veprën e tij, edhe mund ta çmojë veprën, por ta urrejë personalitetin e tij. » Dije se çdo vepër është si bima, ndërsa çdo bimë ka nevojë për ujë. Gjersa ujrato dallojnë njëri prej tjetrit. Andaj, nëse uji është më i mirë, i mirë është edhe rasati, dhe jep fryte të shijshme, kurse nëse uji është i keq, edhe rasati është i keq dhe frytet e tij do t'i ketë të idhëta. » (128)
- Përshkrimi i anëtarëve të familjes së Muhammedit s.a.v.s:  
« Ata janë jeta e diturisë dhe vdekja e paditurisë. Mirësia e tij u tregon mbi diturinë e tyre, fizionomia e tyre mbi brendinë e tyre, ndërsa heshtja e tyre mbi urtinë e fjalëve të tyre. Ata nuk shkojnë kundër së Vërtetës, as kanë divergjencë lidhur me te; Janë mbështetje e Islamit dhe strehë e sigurisë. Me ta-së Vërtetës iu ktheje pozita e saj, kurse gënjeshtria u dëbua nga vendqëndrimi i saj dhe gjuha e saj u këput në rrënjë. Ata fenë e kanë kuptuar me vëmendje dhe përkujdesje, e jo përmes ruajtjes dhe transmetimit, ngase vërtet ka shumë transmetues të diturisë, kurse pak ruajtës të saj. » (129)
- Letër e Emirul-Muëmimit-Ali ibn Ebu Talibit a.s drejtuar Muavijut:

« Disa njerëz nga mjedisi jonë tentuan ta mbysin Pejgamberin tonë dhe të zhdukin rrënjën tonë. Ata na krijuan telashe, u sollën ndaj neve ashpër, na refuzuan lehtësimet e jetës, na ekspozuan trishtimit, na detyruan të gjejmë strehim në një kodër shumë të lartë dhe ndezën zjarrin e luftës kundër neve.

- Atëherë All-llahu na dhuroi vendosmëri ta mbrojmë Sheriatin e Tij dhe të ruajmë huret e Tij. Besimtarët tanë, presin shpërblim për këtë, gjersa pabesimtarët nga mjedisi jonë e mbronin lidhjen e gjakut. Ata nga Kurejshët të cilët pranuan Islamit ishin larg nga vuajtjet në të cilat ishin na, duke marrë parasysh garancën se do të jenë të mbrojtur lidhjet familjare të cilat u siguronin ndihmë. Kështu ata ishin të mbrojtur nga vrasja. Sjellja e Pejgamberit të All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!- ishte e tillë, sa që, kur beteja ashpërsohej, kurse njerëzit filluan të humbin kurajë, dërgonte në ballë anëtarët e familjes së vet, dhe përmes tyre mbronte shokët e vet nga sulmet e shpatave dhe heshtave. Kështu ishte vrasja e Ubejdes ibn El-Harithit në betejën e Bedrit, Hamzai në Uhud, kurse Xhaferi në betejën e Mu'tasë. Edhe një person, të cilin do të mund ta përmendja po të doja, e dëshironte vdekjen martire si ata. Mirëpo vdekja e tyre u shpejtua, gjersa vdekja e tij u shty për më vonë.

- Është shumë çudi që për mua lidhet ai synimi i cilit kurrë nuk ka qenë si i imi dhe i cili nuk ka merita si unë, meritë të ngjashme me këtë nuk ka theksua asnjëri, pas nëse ndonjëri pohon diç për çka nuk kam njohuri dhe për çka mendoj se nuk ka dijeni as Zoti. Mirënjohja gjithësesi i përket vetëm All-llahut!

- Lidhur më kërkesën tënde që t'i dorëzohet vrasësit e Osmanit, kam menduar mbi këtë, dhe mendoj se nuk mund të t'i dorëzohet ty, ose dikujt tjetër. Pasha jetën! Po të mos shkoje rrugëve tua të shtrembërta dhe të mos bie nën ndikim të magjive heretike, me siguri do t'i njihje. Ata së shpejti do të kërkonin dhe nuk do të mundonin t'i kërkosh nëpër tokë, det, male ose fusha. Por, ky kërkim do të ishte i mundimshëm për ty, kurse vizita e tyre nuk do të sjellte lumturi.

- Selam atyre që e meritojnë! » (130)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi madhësinë e Shtëpisë së pastër dhe rëndësinë e ligjeve të Islamit:

« Për All-llahun! E posedoj diturinë e transmetimit të porosive, zbatimit të premtimeve dhe dëshmimeve të tërësishme. Ne-familja e Pejgamberit, ruajmë portat e urtisë dhe dritës së saj. Kini kujdes, me të vërtetë ligji i fesë është një, ndërsa rrugët e tij janë të drejta. Ai i cili i përmbahet ia del dhe ka sukses. Kurse ai i cili largohet prej tyre është i humbur dhe pendohet. Punoni për Ditën për të cilën sigurohen rezervat dhe kur ndërgjegjet japin llogari. Atij të cilit në këtë çast urtia e tij nuk i bënë punë, urtia e huaj në këtë është akoma më e padobishme.

Ruajuni nga zjarri, vapa e cilit është e fortë, fundi i cilit është i thellë, rrobat e cilit janë të hekurta dhe pija e cilit është qelb i përgjakur. Kini mendjen! Ëvrtet kujtimi i bukur për njeriun të cilin All-llahu Famëmadh e mban ndër njerëz për te ëhstë më i mirë se pasuria të cilën ia len trashëgim atij që nuk e falënderon Ate. » (131)

- Nxitja e njerëzve për xhihad:

« Dhe tani! Xhihadi vërtet është një nga portat e Xhennetit, të cilat All-llahu i ka hapur për miqët më mirë të Tij. Ai është veshje e virtytshmërisë, kafulle mbrojtëse e All-llahut dhe mburojë e sigurtë e Tij. Kushdo që e braktisë, nga urrejtja, All-llahu e veshë me veshje të turpërta dhe gunë të mjerimit. Është braktisur me përbuzje e tallje, ndërsa zemrën e ka të mbuluar. Vërtetësia i është marrur atij, sepse e lë anash xhihadin. Ai duhet të durojë turpin dhe drejtësia i është refuzuar.

- Keni kujdes! Ju ftoj që të luftoni kundër njerëzve të tillë edhe natën edhe ditën, edhe haptas edhe fshehurazi. Dhe ju ftoj që t'iu sulmoni para se ata t'iu sulmojnë juve. Për All-llahun, asnjë popull nuk ka qenë i sulmuar në shtëpitë e tyre dhe të mos ketë pësuar turpërimë. Ndërsa ju këtë ua leni të tjerëve dhe largoheni nga kjo gjersa nuk sulmoheni dhe qytetet tuaja nuk pushtohen. Kalorësit e Benu Gamidit kanë depërtuar gjer në Ambar dhe e kanë vrarë Hasan ibn Hasan El-Bekrin. Ata i kanë dëbuar kalorësit tuaj nga kazermat. Kam dëgjuar se njerëzit e tyre i kanë çnderuar femrat muslimane dhe femrat tjera të cilat kanë qenë nën mbrojtjen e Islamit, dhe se ua kanë grabitur stolitë e tyre nga këmbët, duart, qafët dhe veshët. Dhe asnjë femër nuk ka mundur t'iu bëjë ballë kësaj, pos duke shqiptuar ajetin:

« Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi! » (El-Bekaretu, 156)

- Mandej u kthyen prapa të ngarkuar me thesare dhe pa asnjë plagë a jetë të humbur. Nëse ndonjë musliman vdes i pikëlluar nga kjo, ai atëherë nuk meriton akuzë, por në sytë e mi është justifikuar që më parë.

- Sa çudi! Sa çudi! Për All-llahun, zemra vyshket dhe shqetësimi shtohet duke shikuar bashkimin e këtyre njerëzve në padrejtësi dhe ndasitë tuaja në drejtësi. Të keni trup dhe ankth për këtë! Jeni bërë cak në të cilën janë drejtuar shigjetat. Ju jeni të sulmuar, e vetë nuk sulmoni. Ju janë vërsulur, kurse ju nuk vërsuleni. Ndaj All-llahut bëhet gjynah kurse ju po pajtoheni me këtë. Kur verës kërkova nga ju të nisemi kundër tyre, deklaruat se vapa ishte shumë e fortë, t'ju kursej gjersa vapa të mos lëshojë pe. Ndërsa kur ju urdhërova dimrit të ndërmerni sulm, ju deklaruat se është acar i madh, t'ju lë kohë gjersa acari të mos kalojë. Këto kanë qenë pretekste për t'iu ikur vetëm vapës dhe acarit. Por nëse ikni në këtë mënyrë nga vapa dhe acari, për All-llahun, aq më keq do të ikni nga shpata.

- O ju, që jeni vetëm figura të njerëzve, o ju jo njerëzor! Aftësia e të kuptuarit tuaj është si të kuptuarit e fëmijut, ndërsa mendja juaj është mendje e popujve që jetojnë në hapësirat e pafund. Dëshiroj të mos ju kisha parë as njohur. Për All-llahun! Kjo njohje më nxitë pendim dhe më sjellë vetëm pikëllim. All-llahu ju vraftë! Zemrën ma keni mbushur vrer dhe gjakun ma keni mbushur mllef. Më keni detyruar t'iu pi një nga një gëllënkat e helmit të zi. Keni thyer këshillën time me mosbindje dhe largim nga unë në atë masë sa Kurejshët filluan të flasin:» Biri i Ebu Talibit vërtetë është njeri i guximshëm, mirëpo nuk e njeh strategjinë e luftës. » All-llahu i mëshiroftë! A është ndonjëri prej tyre më i zjarrtë në luftë dhe më përvojë në të se unë?! Jam futur në luftë që nga të njëzetat. Edhe këtu jam! Kam shkelur të gjashtëdhjetat. Mirëpo ai të cilit nuk i bindet nuk mund të udhëheqë luftën me sukses. » (132)

- Largpamësia e Emirul-Muëmininit-Ali ibn Ebu Talibit a.s dhe argumenti komtant i tij në fe:

« Përmes nesh keni shpëtuar nga nata e errët. Le të shurdhohen veshët që nuk i dëgjojnë thirrjet! Si mundet dikush që është i shurdhër ndaj thirrjeve të zëshme ta dëgjojëzërin e dobët? Le të qetësohet zemra e cila ka rrahur vazhdimisht.

- Gjithnjë i kam pritur pasojat e tradhëtisë tuaj. Ju kam vështruar me vëmendje nëpër veshjen e mashtrimit. Perdja e fesë më ka fshehur nga ju, mirëpo sinqeriteti i qëllimeve të mia bëri që ju t'iu zbuloni.

- Qëndrova për ju në rrugën e së vërtetës mes gjurmëve të cilat shpiejnë prapa dhe në të cilat takoni njëri-tjetrin. Mirëpo nuk kishte prijës. Mihët, por nuk gjetët ujë.

- Sot po jua mundësoj të flasin shenjat e qarta. Ai që më tradhëton nuk e posedon mendjen e vet. Kurrë nuk kam dyshuar në të Vërtetën (Islamin, vërejt e përkth) pasi më është dëftuar. Musai-paqja qoftë mbi te!-nuk ka psur frikë për vete, por është frikësuar



të mos e mposhtin të padijturit (xhahilët) dhe të mos i ngjajë të devijojë. Sot gjendemi në udhëkryq të së Vërtetës dhe pavërtetës. Ai që është i sigurtë se do të gjejë ujë do ta ndien etjen. » (133)

- Të lavdëruarit e All-llahut të Madhëruar:

« Qoftë i lavdëruar All-llahu! Lëvdata e të Cilit është e shtrirë mbi krijesa, ushtria e të Cilit është ajo që ngjadhnen dhe fama e të Cilit është e madhe:

- E falënderoj Ate për begatitë (ni'metet) e vazhdueshme dhe dhuratat e shumta të Tij. Mëshira (Rahmeti) e Tij është e lartësuar. Ai falë gjynahet dhe është i drejtë në gjithëçka që vendosë. Ai din për atë që po kalon dhe që tanimë ka kaluar. Ai të gjitha krijesat i sajton me diturinë e Tij dhe i jetëson me urtinë e Tij, pa imitim, pa mësim nga dikush, pa pasur kurrëfarë modeli të ndonjë mjeshtri të urtë, pa bërë gabime dhe pa praninë e ndonjë turme. Dëshmojë se Muhammedi-Selami i All-llahut qoftë gjithnjë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- është rob i Tij dhe Pejgamber i Tij, të cilin Ai e dërgoi kur njerëzit ishin në humbje dhe endeshin të hutuar. Ata i orientonin frerët e shkatërrimit, ndërsa dryrët e ligësisë kishin kyçur zemrat e tyre.

- Po ju lë amanet, o robët e All-llahut, që njëmend të jeni të vetëdijshëm për All-llahun, ngase kjo është e drejtë e Zotit mbi ju. Me këtë e fitoni të drejtën tuaj te All-llahu në mënyrë që me te të dilni para Tij. me të vërtetë, devocioni ndaj All-llahut sot është mbrojtje dhe mburojë, ndërsa nesër-rrugë e Xhenetit. Drejtimi i saj është i qartë. Ai i cili e pason është fitimtar. Ai te i cili ajo ruhet është rojtar. Ajo vazhdimisht u shfaqet popujve të cilët janë zhdukur dhe atyre që do të vijnë. Për këtë arsye kjo do t'u nevojitet nesër, kur All-llahu sërish ta rikthejë atë që e ka krijuar njëher, ta marrë atë që e ka dhënë dhe ta llogaritë atë që e ka caktuar. Sa të pakët do të jenë ata të cilët e kanë pranuar dhe zbatuar ashtu siç është dashur ta zbatojnë ?! Do të jenë të pakët në numër dhe këta janë ata njerëz të cilët All-llahu i Madhëruar i përshkruan kur thotë:

« ... e nga robërit e Mi, paka janë mirënjohës. » (Es-Sebe'ë, 13)

- Prandaj nxitoni me bindjen tuaj drejt saj dhe shtoni përpjekjet tuaja për shkak të saj. Bëjeni zëvendësim për tërë të kaluarën tuaj që ta zeni vendin tuaj si trashëgimtar, si dhe bëjeni ndihmëtar tuajin kundër çdo armiku. Shndërrojeni me të ëndërrën tuaj në realitet dhe kaloni ditën tuaj me te, bëni ashtu që zemrat tuaja ta ndiejnë atë. Me këtë pastroni mëkatet tuaja, me të shëroni sëmundjet dhe ua preni rrugën vdekjes. Merrni mësim nga ai i cili nuk e përfillë dhe mos lejoni kurrësesi që nga ju të marrë mësim ai i cili i bindet. Dijeni mirë, duhet ta ruani dhe mbronin veten me të.

- Qëndroni larg nga kjo botë dhe me mallëngjim orientohuni drejt botës tjetër-ahiretit. Mos e konsideroni të ulët atë të cilin e ka lartësuar devotshmëria (takvallëku) ndaj All-llahut dhe mos e konsideroni të lartë atë të cilin e ka lartësuar kjo botë. Mos e lakmoni petkun shkëlqyes të kësaj bote. Mos e ndëgjoni atë i cili flet mbi te. Mos iu përgjigjuni atij i cili u fton drejt saj. Mos kërkoni dritë nga shkëlqimi i saj dhe mos gjakoni çmueshmëritë e saj, ngase shkëlqimi i saj është mashtrues, të folurit e saj rrenë, pasuria do të plaçkitet, ndërsa çmueshmëritë e saj do të grabiten.

- Kini kujdes, kjo botë ju joshë, por pastaj ju dëbon. Është tekanjoze dhe refuzon të shkojë tutje. Gënjën dhe tradhton. Mohon dhe nuk falënderon. Është e rëmbyer dhe të prapëson. Joshë dhe shkakton vuajtje. Qëndrueshmëria e saj është ndryshim, të ecurit e saj-zërje në thua, fama e saj poshtërim, serioziteti i saj-qesëndi, kurse lartësia e saj-ultësi. Ajo është vendi i hajnisë dhe grabitjes, shkatërrimit dhe zhdukjes. Banorët e saj janë në këmbë, në ndjekje, arritje dhe tërheqje. Drejtimit e saj hutojnë, daljet e saj janë të ngatërruara, ndërsa caqet e saj përfundojnë me dëshprim. Në pajtim me këtë, kështjellat i dorëzojnë, shtëpitë i flakin jashtë, ndërsa qeret i lodhin.

- Disa prej tyre janë si deveja e lishur për këmbë, disa si mishi i kafshës së therur, disa si gjymtyrët e shkurtuara, disa si gjaku i derdhur, disa kafshojnë duart e tyre, disa godasin me shuplakat e tyre, disa janë mbështetur në bërryla, kurse disa mallkojnë të menduarit e vet, ndërsa disa heqin dorë nga qëndrimet e tyre. Mirëpo, dinakëria e ka kthyer shpinën, kurse mashtrimi fytyrën. I Madhëruari thotë në Kur'an:

« Mirëpo koha është sosur! »;

- Fatkeqësisht! Fatkeqësisht! Ajo që është e humbur-është e humbur! Kurse ajo që ka kaluar-ka kaluar!

- Kjo botë shkon rrugës së saj; I Madhëruari në Kur'an thotë: » As qielli as toka nuk i kanë vajtuar, dhe nuk janë kursyer. » (134)

- Në pjesën e dytë të fjalimit të mësipërm, ku Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s jep këshilla për tëq qenë i vetëdijshëm për All-llahun xh.sh dhe informacione për këtë botë dhe njerzit e saj, qartë vërehet elokuenca e tij e të shprehurit, mençuria e tij e jashtëzakonshme dhe mbi të gjitha plotësisht na pasqyrohet portreti i tij madhështor, portreti i Imam Aliut a.s i cili tërë jetën punoi dhe palodhshëm u përpoq për fenë e All-llahut dhe përhapjen e saj në çdo skaj të botës, kështu duke u shndërruar në simbol të drejtësisë, urtësisë, mençurisë, devotshmërisë dhe xhihadit përkushtues ndaj All-llahut xh.sh. All-llahu e bekoftë Imam Aliun a.s me bekimet e Tij më të mëdhaja!

**ËSHTE TRANSMETUAR SE NJË SHOK I EMIRUL-MUËMININIT-ALEJHISSELAM! I QUAJTUR HAMMAM-I CILI ISHTE I DEVOTSHËM NDAJ ALL-LLAHUT XH.SH, KISHTE THËNË: » O EMIRUL-MUËMININ! M'I PËRSHKRUAJ NJERËZIT TË CILËT VËRTET JANË TË DEVOTSHËM NDAJ ALL-LLAHUT, ASHTU QË TË KEM PËRSHTYPJEN SE I SHIKOJ ? »**  
**EMIRUL-MUËMININI-ALI IBN EBU TALIBI A.S PAKËZ E ZVARRITI PËRGJIGJEN, POR PASTAJ FOLI:**

« O Hammam! Bëhu i vetëdijshëm ndaj All-llahut dhe bën vepra të mira ngase:» S'ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës. » (En-Nahl, 128);

- Hammami nuk ishte i kënaqur me këtë, andaj e cyti të fliste akoma. Pas kësaj, Emirul-Muëminini-Ali ibn Ebu Talibi a.s e madhëroi All-llahun dhe lëvdoi Ate, si dhe u lut për Rrahmetin (Mëshirën) e Tij mbi Pejgamberin e Nderuar-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!-dhe pastaj deklaroi:

« Dhe dije, All-llahu i Madhëruar dhe Lavdiplot i krijoi krijesat atëherë kur i krijoi, tërësisht i pavarur nga përkushtimi i tyre dhe i siguruar nga mosbindja e tyre, pasi që Ate nuk e dëmton mosbindja e atij që nuk bindet, as ka dobi nga bindja e atij që i bindet. Ai ndër ta ka shpërndarë begatitë (niëmetet) për jetën e tyre dhe u ka caktuar vendet e tyre në këtë botë.

- Kështu ata të cilët janë të vetëdijshëm për All-llahun në këtë botë janë bartës të denjë të vlerave. Tafalurit e tyre është i drejtë, veshja e tyre modeste, ndërsa të ecurit e tyre i qetë. Ata i ulin shikimet para asaj që All-llahu u ka ndaluar. Veshët e tyre i përqëndrojnë në atë dituri e cila është e dobishme për ta. Në tundime qëndrojnë të njëjtë çfarë kanë qenë në kënaqësitë jetësore. Po të mos ishte afati që u është caktuar, shpirtërat në trupat e tyre nuk do të mbeteshin as për një çast të vetëm në gjykimin e tyre të shpërblimit dhe frikën e tyre nga ndëshkimi. Krijuesi në zemrat e tyre është i madh, ashtu që çdo gjë tjetër pos Tij është i parëndësishëm në sytë e tyre. Kështu Xhenneti për ta është sikur ta shikonin, ashtu që kënaqen me begatitë e tij. Për ata edhe Xhehennemi është sikur ta shikonin dhe përjetojnë vuajtjet në të.

- Zemrat e tyre janë të pikëlluara, ata nuk kryejnë vepra të këqija, trupi i tyre është thatim, kërkesat e tyre janë të vogla, ndërsa shpirti i tyre është i pastër. Janë të durueshëm në kohën e cila është e shkurtër, kurse në fund fitojnë kenaqësi e cila zgjatë shumë. Kjo është tregti levdërishme të cilën e ka bërë të mundshme Zoti i tyre. Kjo botë është e orientuar drejt tyre, por jo ata drejt saj. Ajo i kishte nërë pengj, por ata i riblejten shpirtrat e tyre nga ajo.

- Netëve ata qëndrojnë në këmbë duke lexuar pjesë nga Kur'ani dhe duke recituar me maturi në mënyrë harmonike; me këtë i mallëngjejnë shpirtrat e tyre dhe kërkojnë ilaç për ligështimin e vet. Kur hasin në ndonjë ajet i cili nxitë dëshirën e madhe (për Xhennet), përkulen mbi te me pasion dhe shpirtrat e tyre orientohen drejt tij me ngazëllim, kështu që e ndiejnë se ai ndodhet para syve të tyre. Ndërsa kur hasin në ndonjë ajet i cili u shtie drithmat, i tendosin veshët e zemrat e tyre drejt tij dhe u bëhet se oshëtima e Xhehennemit dhe britmat e tij arrijnë gjer te veshët e tyre. Kërrusin shpinat e tyre, bijnë përtokë me ballin e tyre, shuplakat e tyre, gjunjët e tyre dhe gishtat e këmbëve të tyre; dhe vazhdimisht i luten All-llahut të Madhëruar për lirimim e qafëve të tyre. Gjatë ditës janë të sjellshëm, të udhëzuar, të devotshëm (takva) dhe të vetëdijshëm ndaj All-llahut. Frika ata i bën të hollë si shigjeta. Ai që i shikon mendon se janë të sëmurë, mirëpo nuk janë të sëmurë, dhe ai thotë se janë bërë njerëz. Në realitet, ata i ka përfshirë ajo që është madhështore. Ata nuk janë të kënaqur me numrin e vogël të veprave të mira të tyre, as e konsiderojnë diç të madhe shumësinë e veprave të tyre të mira. Gjithnjë e kritikojnë veten dhe kanë frikë për veprat e veta. Kur për ndonjërin prej tyre flitet me respekt, ai frikohet nga ajo që thuhet për te dhe deklaron:» E njoh veten time më mirë se të tjerët, kurse All-llahu im më njeh më mirë se unë. All-llahu im, mos vepra ndaj mua në bazë të asaj çka flasin ata dhe më bën më të mirë se që mendojnë për mua dhe më fal për atë që nuk kanë dijeni. »

- Veçoria e çdonjërit prej tyre në këtë është që të shohës te ai forcën në të besuar, vendoshmërinë në shpirtmirësi, besimin me bindje, pasionin për dituri, diturinë me durim, maturinë në begati, përlësinë në devocion, mirësjelljen në varfëri, durimin (sabrën) në vuajtje, kërkimin e asaj që është e lejueshme (hallall), zellin në udhëzim dhe heqjen dorë nga makutëria. Ai ndërmer vepra të mira dhe shqetësohet. Mbërmjeve është i pushtuar nga mirënjohjet, mëngjeseve nga të medituarit. Bie në gjumë plot vigjilencë dhe zgjohet në mëngjes plot hare. Është vigjilent që natën të mos e kalojë në harresë, ndërsa është i gëzuar për mirësinë dhe mëshirën që i ka siguruar. Nëse pasioni i tij refuzon ta pranojë atë që nuk e adhuron, ai nuk e pranon kërkesën e tij për të plotësuar atë që don ai. Kënaqësia e tij qëndron në atë që nuk është e amshueshme. Ai mirësjelljen e përshkon me dituri, ndërsa fjalën me vepër.

- Ti e shikon se shpresat e tij janë afër, të zërit në thua i rrallë, zemra e përvuajtur, shpirti i kënaqur, ushqimi i thjeshtë, besimi i sigurt, pasioni i ngulfatur dhe zemërimi i mposhtur. Nga ai priten vetëm vepra të mira dhe nga ai nuk duhet patur frikë për diç të keqe. Madje edhe nëse do të ndodhej në mesin e atyre që janë harrestarë, do të llogaritej ndër ata që mbajnë mend. Nëse gjendet në mesin e atyre që mbajnë mend, nuk llogaritet ndër ata që janë harrestarë. E falë atë që ka qenë i padrejtë ndaj tij. I jep atij i cili nuk i ka dhënë. E viziton atë i cili nuk e ka vizituar.

- Fjala e shëmtuar për te është e largët, fjalimi i tij është i ëmbël, ligësia e tij nuk ekziston, virtytshmëria e tij është e evidente, e mira e tij arrin, ligësia e tij largohet. Është dinjitoz në fatkeqësi, i durueshëm në vuajtje, mirënjohës për begatitë e jetës. Nuk bën padrejtësi ndaj gjërave të cilat nuk i pëlqen dhe nuk bën gjynah për shkak të asaj që

adhuron. E pranon të vërtetën para se t'i paraqitet argumenti. Nëse e dëmton atë që i është dhënë në ruajtje dhe nuk harron atë për çka paralajmërohet.

- Të tjerët nuk i quan me emra përbuzës. Nuk i shkakton dëm fqinjit. Nuk e kënaqë fatkeqëia e tjetrit. Nuk merr pjesë në padrejtësi dhe nuk e braktisë të drejtën.

- Nëse është i heshtur, heshtja ate nuk e pikëllon. Nëse qeshet, nuk e ngrit zërin. Nëse i bëhet e padrejtë, përmbahet-gjersa All-llahu nuk u hakmirret për te. Njerëzit janë të qetë nga ai. Ai e hedh veten në vështirësi të jetës së ardhshme dhe bën ashtu që njerëzit të ndjehen të sigurt nga ai. Largimi i tij nga ajo që largohet paraqet ngurrim dhe pastërti, gjersa të afruarit e tij asaj që i afrohet paraqet shpirtmirësi dhe mëshirë. Largimi i tij nuk bëhet nga mendjemadhësia dhe krenaria, as të afruarit e tij nuk bëhet me qëllim të mashtrimit dhe gënjeshtërisë. » (135)

- « I falënderohemi Atij për suksesin të cilin na ka dhënë në zbatimin e përkushtimit ndaj Tij dhe mbrotjen tonë nga mosbindja. I lutemi All-llahut të përmbushë Rrahmetin (Mëshirën) e Tij dhe të bëjë të mbahemi fort për litarin e Tij. Dëshmojmë se Muhammedi është rob i Tij dhe Pejgamber i Tij. Ai për të kënaqur All-llahun është futur në çdo vështirësi dhe për hir të Tij ka pirë çdo idhëtinë. Të afërmit e tij kanë qenë të luhatsëm ndaj tij, ndërsa ate të cilët ishin larg tij u bashkuan kundër tij. Arabët i lëshuan frerët kundër tij dhe goditnin barkun e deveve të tyre për të luftuar kundër tij në atë masë sa armiqtë arrijtën gjer te pargu i tij nga vendet dhe viset më të largëta.

- Po ju lë amanet, o robët e All-llahut, që të jeni të vetëdijshëm për All-llahun dhe po ju paralajmërojë për hipokritët (munafikët), ngase ata me të vërtetë kanë humbur rrugën dhe mashtrojnë të tjerët, bëjnë gjynah dhe nxitin të tjerët të bëjnë gjynahe. Ata ndryshohen në shumë ngjyra dhe marrin rrugë të ndryshme. Ju përkrahin me të gjitha mënyrat e përkrahjes dhe u rrijnë pranë, duke ju pritur në çdo vend të vëzhgimit. Zemrat e tyre janë të sëmura, gjersa fytyrat i kanë të pastra. Ecin fshehurazi dhe paraqiten si të afruarit e sëmundjes. Të folurit e tyre është ilaç, fjalët e tyre janë shërim, gjersa veprat e tyre janë si sëmundja e pashërueshme. Janë xhelozë për mirëqenie, shtojnë vuajtjet dhe rrënojnë shpresat. Viktimat e tyre janë të shtrira në çdo rrugë, gjersa synojnë t'i afrohen çdo zemre dhe kan lot për çdo pikëllim.

- Njëri-tjetrin e lëvdojnë dhe presin shpërblim njëri prej tjetrit. Kur kërkojnë diç janë të vendosur në këtë. Kur qortojnë-turpërojnë. Kur gijkojnë-e turpërojnë. Për çdo të vërtetë ata kanë përgatitur gënjeshtëri, për çdo gjë të mëkëmbur-atë që është e përkulur, për çdo qenie të gjallë-vrasës, për çdo derë-çelës dhe për çdo natë-kandile.

- Lakmojnë, por pa shpresë se këtë do ta forcojnë tregjet e veta dhe se njerëzve do t'ua bëjnë të këndëshme ofertat tregtarve të tyre. Flasin, dhe shkaktojnë dyshime. Përshkruajnë dhe mashtrojnë. Së pari ofrojnë rrugë të lehtë, pastaj ngushtojnë. Prandaj, ata janë grup i shejtanit dhe thimtha të zjarrit. I Madhëruari thotë:» Ata i ka nënshtuar shejtani dhe ua ka qitur në harresë porositë e All-llahut. Ata janë shoqëri e shejtanit, me të vërtetë ithtarët e shejtanit janë më të dëshpruarit. » (El-Muxhadele, 19) »- në këtë fjalim Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s në mënyrë tepër të detajizuar i përshkruan cilësitë e hipokritit (munafikit), dhe sërish vërehet elokuenca e tij e pashoqe. (136)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s lidhur me të përmbajturit nga kjo botë dhe paqëndrueshmërinë e kohës:

« E falënderojmë për ate që ka qenë dhe kërkojmë ndihmën e Tij në punët tona për atë që akoma do të ndodhë, dhe i lutemi Atij për siguri në besim, ashtu siç i lutemi për shëndetin në trupin tonë!

- O robët e All-llahut! U këshilloj të qëndroni larg nga kjo botë, e cila do t'ju braktisë pa marrë parasysh se nuk e dëshironi ndarjen me te dhe e cila trupat tuaj do t'i plakë, edhe pse ju dëshironi përtëritjen e tyre. Shembulli juaj dhe shembulli i saj janë të ngjashëm me shembullin e udhëtarëve të cilët marrin ndonjë rrugët të gjatë, dhe pastaj, sikur e kalojnë shpejt ose orientohen sipas ndonjë shenje, sakaq arrijnë. Sa e shkurtër është distanca gjer në cak nëse ndonjëri ecë drejt tij dhe e arrin!? Dhe sa e shkurtër është pjesa e asaj rruge e cila ka zgjatur një ditë, që nuk mund të zgjatet, gjersa ndjekësi e ndjek në këtë botë përderisa ai të mos e braktisë atë ?!

- Prandaj, mos e gjakoni respektin dhe krenarinë e kësaj botë dhe mos u ngazëllehuni me bukuritë dhe kënaqësitë e kësaj bote, as mos u ankoni nga dëmtimet e fatkeqësitë e saj, ngase respekti dhe kënaqësitë e saj do të ndërprehen, kurse fatkeqësitë dhe dëmtimet e saj do të kalojnë. Çdo periudhë në të përfundon dhe çdo qenie e gjallë në të do të vdesë. A nuk ka për ju paralajmërim në mbetjet e atyre para jush dhe hapës të syve, e mësim nga të parët tuaj të hershëm, nëse kini mendjen? A nuk keni kuptuar se të parët tuaj nuk po kthehen dhe se ithtarët e mbetur gjallë nuk po mbesin? Vallë nuk keni vërejtur se banorët e kësaj bote agojnë dhe ngrysen në gjendje të ndryshme?

- Dikush është i vdekur që të vajtohet, dikujt i shprehet ngushëllim, dikush rrëzohet me dhimbje, dikush interesohet për sëmundje, dikush e lëshon frymën e fundit, dikush e gjykon këtë botë gjersa ta fitojë vdekja, dikush është i shkujdesurpor nuk është i lënë pas dore, kurse tjerët ecin gjurmëve të të parëve të tyre.

- Kini mendjen! Kur kryeni vepra të këqija, kujtoni shkatërruesin e kënaqësive dhe eliminuesin e dëshirave. Kërkoni ndihmën e All-llahut në kryerjen e detyrave të cilat janë e drejtë e Tij edhe në begatitë e mirëbërësitë e Tij të cilat janë të panumërta. » (137)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s lidhur me nxitjen e njerëzve për të qenë të vetëdijshëm për All-llahun:

« E falënderojmë All-llahun, i Cili falënderim e ka bërë çelës për kujtimin e Tij, shkak të mirësisë së Tij dhe dëshmi të bollëkut të Tij dhe madhësisë. O robët e All-llahut, koha me të vërtetë me ata që kanë mbetur vepron njësoj si dhe me ata që kanë shkuar. Ajo që prej asaj ka kaluar nuk do të kthehet. Kurse ajo që është në të nuk do të zgjasë përgjithnjë. Veprimet e fundit të saj janë si edhe të parët. Vuajtjet e saj synojnë të tejkalojnë njëra-tjetrën. Shenjat e saj përcjellin njëri-tjetrin. Kjo është si të jeni lidhur me Ditën e Gjykimit, e cila u grahë shpejt siç i grahë grahësi deve e cila ka qenë shterre shtatë muaj. Ai i cili merret me diç tjetër, pos me shpirtin e vet, endet i hutuar në errësirë dhe ngatërrohet në rrjetat e shkatërrimit. Shejtanët e tij e tërheqin në krim dhe ia zbukurojnë veprat e këqija të tij. Xhenneti është caku i fundit për ata të cilët janë të parët në vepra të mira, kurse Xhehennemi është cak për ata të cilët i kanë braktisur tërësisht.

- Ta dini, o robët e All-llahut, se vetëdija mbi All-llahun është shtëpi e fortë e sigurisë, gjersa të harruarit e All-llahut ëshë shtëpi e dobët e cila nuk i mbron bijtë e saj, dhe nuk i afron siguri atij i cili aty kërkon strehim. Dijeni se therra e mëkatit nxirret me vetëdijen mbi All-llahun dhe se caku i fundit arrihet me të argumentuarit e besimit- imanit.

- O robët e Zotit! All-llahu në punët vetanake tuajat të cilat i keni më të dashura dhe më të preferuara! Ngase All-llahu u ka sqaruar rrugët e sëë vërtetës dhe u ka ndriçuar shtigjet e saj. Prandaj zgjedhni, ose fatkeqësinë gjithnjë të pranishme, ose lumturinë e amshueshme! Pajisuni pra në ditët e asaj që është kalimtare-për ditët e asaj që është e amshueshme. Tanimë jeni udhëzuar rreth kësaj pajisjeje, jeni urdhëruar të

ecni dhe jeni nxitur të nxitoni. Ju jeni si kalorësit të cilët janë të gatshëm por nuk dijnë kur do ta marrin urdhërin për t'u nisur. Shikoni ç' do të bëjë me këtë botë ai i cili është krijuar për botën tjetër! Si do të vepron me pasurinë ai i cili së shpejti do të ndahet prej saj, gjersa atij do t'i mbeten vetëm veprat e tija të liga dhe dhënia e llogarisë!

- O robët e All-llahut! Rrahmeti (Mëshira) të cilën All-llahu ua ka premtuar nuk duhet të lihen anash, kurse e keqja të cilën ua ka ndaluar nuk guxon të adhurohet. O robët e All-llahut, keni frikë nga Dita kur veprat do të hedhen në peshojë. Shumë dridhje të fuqishme do ta pasojnë atë Ditë, dhe fëmijët atë Ditë do të plaken.

- Ta dini, o robët e All-llahut, se qenësia juaj është mbrojtës mbi ju; gjymtyrët tuaja kujdesen për juve dhe vigjilentët e së vërtetës mbajnë mend veprat tuaja dhe numrin e frymëmarrjeve tuaja. Errësira e natës së zezë nuk mund t'u fsheh prej tyre, as dyert e forta të kyçura mirë nuk mund t'u mbajnë fshehur. Me siguri e nesërmja është afër të sotmes.

- E sotmja do të shkojë me çdo gjë që ekziston në të, ndërsa e nesërmja do të arrijë e lidhur për të. Kjo është sikur çdonjëri prej jush të ketë arritur gjer në atë vend në tokë ku do të jetë i vetëm gjer në varrin e tij. Ndërsa, e vështirë është shtëpia e vetmisë, i zbrazët është vendi i qëndrimit dhe i vetmuar transferimi! Kjo është sikur t'u kishte ardhur zëri i tmerrshëm, sikur t'u kishte mbërthyer Dita e Gjykimit dhe ju jeni paraqitur për shkak të shpalljes së gjykimit. Ndërsa të pavërteta janë larguar larg nga ju, pretekstet tuaja janë bërë të dobëta, të vërtetat për ju janë zbuluar dhe të gjitha punët tuaja kanë arritur te pasojat e tyre.

- Prandaj, merrni mësim nga shembujt, mësoni duke shikuar të tjerët dhe shfrytëzoni paralajmërimet. » (138)

- Fjalimi i Emirul-Muëmininit-Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi gjendjen e botës në kohën e shpalljes së Pejgamberllëkut, kalueshmërinë e kësaj bote dhe pozitën e banorëve të saj:

« Ai-All-llahu dërgoi kur nuk kishte kurrëfarë shenje të udhëzimit, as ndriçonte kurrëfarë fanari, as nuk kishte drejtim të qartë.

- Po ju këshillojë, o robët e All-llahut, të jeni të vetëdijshëm për All-llahun dhe po ju paralajmëroj të keni kujdes ndaj kësaj bote, ngase ajo vërtet është shtëpi nga e cila shkuarja është e paevitueshme dhe vend i bezdisë. Ai i cili jeton në të duhet të shkojë, ndërsa kush banon në të duhet ta braktisë. Ajo lëvizë me banorët e saj si barkë të cilën e vringëllojnë furtunat në detin e tërbuar. Disa prej tyre shkrihen dhe vdesin, gjersa disa prej tyre dalin mbi sipërfaqen e valëve, ku i shtynjë erërat me rrymat e tyre dhe i bartin drejt rreziqeve të tyre. Kështu, kush fundoset nuk mund të kthehet, ndërsa kush shpëton është në rrugë të shkatërrimit.

- O robët e Zotit, tani kryeni vepra të mira dhe dijeni se gjuhët janë të lira, trupat e shëndoshë, gjymtyrët e lëvishme, vendi i kthymit i madh, ndërsa e gjërë hapësira para humbjes së rastit dhe afrimit të vdekjes. Pranojeni afrimin e saj si argument të përmbushur dhe mos mendoni-ajo do të arrijë. » (139)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi kalueshmërinë e kësaj bote dhe rëndësinë e sigurimit të pajisjes për botën tjetër:

« O njerëz! Vërtetë kjo botë është vend kalimtar, gjersa bota tjetër është bota e qëndrimit të përhershëm. Prandaj, nga vendi kalimtar merrini për vendin e qëndrimit të përhershëm. Mos i hiqni perdet tuaja para Atij i Cili i din fshehtësitë tuaja. Largoni zemrat tuaja ng kjo botë para se t'i braktisin trupat tuaj, ngase në të jeni vënë në sprovë, meqenëse jeni krijuar për një tjetër e jo për të. Kur njeriu vdes, njerëzit pyesin: » Çka

dërguar para vete? » All-llahu ju mëshiroftë! Prandaj, dërgoni para jush hisen që do të jetë hua dhe mos i leni të gjitha pas veti që kjo të jetë barrë mbi ju.» (140)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s, përkatësisht paralajmërimi mbi rrezikun e Ditës së Gjykimit:

« Përgatituni për rrugë, All-llahu ju mëshiroftë, ngase tanimë jeni ftuar të shkoni. Konsiderojeni qëndrimin tuaj në këtë botë farë të shkurtër dhe kthehuni me pajisjen më të mirë të cilën e keni me vete, ngase vërtetë para jush ndodhen pengesa të cilat vështirë tejkalohehen dhe vendbanimet plot frikë e rreziqe. Gjer te ato duhet arrijtur dhe te ato duhet ndalur.

- Dijeni se shikimi i vdekjes drejt juve është tejet afër. Kjo është sikur të ndodhni në kthetrat e saj dhe sikur ajo të jetë qepur për ju. Punët e vështira dhe rreziqet tronditëse ju shtyjnë në të. Këputni pra të gjitha lidhjet me këtë botë dhe ndihmoni në pajisje të përkushtimit ndaj All-llahut. » (141)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi rëndësinë e vetëdijesmbi All-llahun, mbi boshllëkun e varrit dhe mbi vdekjen e adhuruesve të Shtëpisë së Pastër, e cila është si vdekja e atyre të cilët me vdekjen e tyre dëshmojnë të Vërtetën:

- « E falënderoj Ate me falënderim për bekimet e Tij dhe kërkoj ndihmën në të përmbushurit e të drejtave të Tij. Ai-All-llahu ka ushtri të fuqishme. E madhe është fama e Tij. Dhe dëshmoj se Muhammedi-Selami i All-llahut qofshin gjithnjë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!-është rob i Tij dhe Pejgamber i Tij. Ai-Pejgamberi ka ftuar në besim ndaj Tij dhe ka mposhtur armiqtë e Tij duke luftuar për besimin e Tij. Në këtë rrugë nuk e pengoi të bashkuarit për ta shpallur gënjeshtar, as përpjektjet për ta shuar dritën e tij.

- Prandaj, qëndroni të patundur në vetëdijen mbi All-llahun, ngase ajo është litar me fije të forta, ndërsa maja e tij është e lartë dhe e paprekshme. Nxitoni drejt vdekjes në vuajtjet e saj, dhe hapjani rrugën para arritjes së saj, dhe përgatituni për të para ardhjes së saj, ngase caku është Dita e Gjykimit. Kjo është këshillë e majftueshme për ate që kupton dhe mësim për ate që nuk din. Çka dini para arritjes së fundit të saj, mbi ngushtinë e varrezave, vuajtjet e vështira, frikën nga shtegu drejt botës tjetër, vështirësitë e ankthit, dhe zhvendosjen e brinjëve andej-këtej, shurdhësinë e veshëve, terrin e varrit, shqetësimin nga ndëshkimi i premtuar, të mbuluarit e gropës së varrit dhe vendosjes së gurrëve?

- Prandaj, jini të vetëdijshëm për All-llahun dhe, sërish-jini të vetëdijshëm për All-llahun, o robët e All-llahut, ngase kjo botë po vepron me ju në mënyrë të zakonshme, kurse ju dhe Dita e Gjykimit gjendeni në litar të nejtë. Sikur kanë arritur shenjat e saj, është afruar koha e saj dhe ju ndërprehen në rrugën tuaj, dhe sikur të jetë çfaqur me shungullimat e saj dhe është lëshuar në tokë me kraharorin e saj, gjersa kjo botë është shkëputur nga banorët e saj dhe i ka larguar nga përfaqimi i vet. Kjo ka ngjarë si dita që ka shkuar ose muaji që ka kaluar. Risia e saj u vjetërua, ndërsa e trasha e saj u bë e hollë.

- Ata ndodhen në vend të ngushtë, në veprime tejet të ngatërruara dhe në zjarrin dhimbja e të cilit është e madhe; klithmat janë të larta, flakat ngriten lart, zhurma është shurdhuese, flakërimi është i tmerrshëm, të epurit është mënjeluar; zjarri i tij djeg, kanosjet e tij janë tmerruese, zbrastitë e tij janë të fshehura, anët e tij janë të errëta, kazanët e tij janë vënë në zjarr dhe çdo gjë e tmerrshme është e tij.

« Kurse ata të cilët janë të vetëdijshëm për All-llahun e tyre do të inkurajohen në kolonat drejt Xhennetit. » (Es-Zumer, 73).

- Janë të mbrojtur nga ndëshkimi, të larguar nga durimi dhe të mbajtur larg zjarrit. Vendbanimi i tyre do të jetë i qetë dhe ata do të jenë të kënaqur në banesat e tyre dhe në vendqëndrimet e tyre. Këta janë prej atyre veprat e të cilëve në këtë botë janë të ndershme, sytë e tyre përlotur, netët e tyre si dita nga frika e të kërkuarit e ndjesës, ndërsa ditët e tyre si netët nga vetmia dhe ndarja. Prandaj All-llahu Xhennetin e ka bërë vend të kthymit të tyre, ndërsa shpërblimin kompenzim. »... Ata janë më të përshtatshmit dhe më të denjë për atë. » (El-Fet'h, 26). Dhe do të jenë banorët e tij në botën e amshueshme dhe kënaqësinë e përhershme.

- Prandaj, o robët e All-llahut, keni shumë kujdes për atë që nëse do të përkujdeseni për këtë, do të ndikojë të ketë sukses ai prej jush i cili ka suksese, ndërsa nëse nuk keni kujdes për këtë, do të ndikojë që të pësojë ai prej jush i cili nuk është i kujdes-shëm ndaj kësaj. Prejani hovin vdekjes me vepra të mira, ngase jeni përgjegjës për atë që e keni bërë më herët dhe u përket vetëm ajo që e keni dërguar përpara jush. Sikur t'u ketë ardhur ngjarja e tmershme, ashtu që nuk ka mundësi të kthimit as të lirimimit nga veprat e këqia! All-llahu na inkurajoftë edhe neve edhe juve në devocion ndaj Tij dhe devocion (devotshmëri) ndaj Pejgamberit të Tij. Dhe na mëshiroftë edhe neve edhe juve me bagatinë e Mëshirës së Tij.

- Qëndroni në tokë, keni durim në tundime, mos i vëni lëvizje duart tuaja dhe shpatat tuaja si gjuhën tuaj, dhe mos nxitoni në atë për çka All-llahu nuk ka kërkuar nxitim, ngase, me të vërtetë, ai nga ju që vdes në shtratin e vet, kurse e ka njohur të drejtën e All-llahut të vet dhe të drejtën e Pejgamberit të Tij dhe pjesëtarëve të familjes së tij, vdes si ai i cili me jetën e vet e dëshmon të Vërtetën, dhe shpërblimi i All-llahut për të është garantuar. Ai meriton shpërblim dhe për veprat e mira të cilat i ka pasur ndërmend t'i kryejë, ngase qëllimi i tij zëvendësoi nxjerrjen e shpatës së tij. Me të vërtetë, për çdo fenomen ekziston koha dhe kufiri. » (142)

- Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s e lexoi ajetin kur'anor:» Juve u preukopoi përpjekja për shumimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)! Derisa të mos i vizitoni varrezat (të bëheni banues të tyre-të vdisni). (Et-Tekathur, 1-2); pastaj tha: » E sa i largët është caku, sa të pakujdes-shëm janë vizitorët, dhe sa i tmerrshëm është rreziku?! Nuk morrën mësim nga ajo që është përplot këshilla, por morrën nga largësitë. Mos po krenohen me vdekjen e të parëve të tyre? Ose maten me numrin e atyre të cilët kanë rënë viktimë? Vallë dëshirojnë të ringjallin trupat e tyre të cilët kanë mbetur të pa shpirt dhe lëvizjet që janë zhdukur. Më e justifikuar është të jenë jenë burim i mësimi se burim i mburrjes. Më të përshtatshëm janë të jenë burim i përvujtësisë se i nderit.

- I shikojnë ata me sy shkurtpamës dhe zhyten në humnerën e paditurisë. Sikur mund t'i pyesin për ta oborret e lëna shkret të shtëpive të rënuara dhe vendbanimeve të pa njerëz, me siguri do të përgjigjeshin: Shkuan në tokë, ndërsa ju do të shkoni pas tyre si xhahil. Shkelni nëpër kafkat e tyre, mbyllni mbi trupat e vdekur të tyre, ushqeheni me atë që ata e kanë lënë dhe banoni në shtëpitë të cilat ata i kanë braktisur. Ditët mes tyre dhe juve vetëm u vajtojnë dhe mbi ju recitojnë këngë të përmotshme.

- Ata janë të parët tuaj në arritjen e qëllimeve dhe para jush arritën te burimi. Posedonin pozita të lakmishme dhe plot dinjitet si udhëheqës dhe si nënshtetas. Hyrën në brendinë e varrit, ku mbi ta u hodh dheu i cili e hëngri mishin e tyre dhe thithi gjakun e tyre. Në thellësinë e varrezave të tyre u shndërruan në dhe, edhe muk rriten më, edhe humbën si të mos kishin qenë fare. Të afuarit e rrezikut më nuk i frikon, kurse mjerimi i menjemadhësisë nuk i shqetëson. Nuk brengosen për shungullimat as ia vëjnë veshin bubullimës. Nuk janë të pranishëm dhe nuk pritën më vonë. Janë dëshmitarë, por nuk janë të pranishëm. Ishin së bashku, por u shpërndanë. Ishin miq, por u ndanë. Lajmet e



tyre janë të pakuptueshme dhe shtëpitë e tyre janë të shurdhëta, por jo për shkak të gjatësisë së moshës së tyre, as të distancës së vendit të tyre, por për shkak se e kanë pirë gotën e cila të folurit e tyre e kanë shndërruar në të qenët memec, të dëgjuarit e tyre në të qenët i shurdhër dhe lëvizjet e tyre në të qenët i palëvizshëm. Sikur të kishin rënë në gjumë të rëndë! Janë fqinj të cilët nuk ndiejnë prirje, ose miq që nuk vizitohen mes veti. Lidhjet e sjelljes reciproke të tyre janë sosur, ndërsa lidhjet e miqësisë së tyre janë këputur. Prandaj çdonjëri prej tyre është i vetëm, pa marrë parasysh se janë grup. Janë të huaj, ndonëse janë miq. Nuk janë të vetëdijshëm për agimin pas natës, as për mbrëmjen pas ditës. Kur u sosën, edhe nata edhe dita për ta u bënë të paqenë. U bindën se rreziku për vendbanimet e tyre është më i ashpër ngase janë frikuar dhe e kanë parë se shenjat e tyre janë më të mëdha seç kanë supozuar. Andaj u janë ofruar dy caqe gjer në vendin i cili është më larg se të arriturit e frikës ose shpresës. Po të ishin në gjendje të flisnin mbi këtë, me siguri do të ishin të pafuqishëm ta përshkruajnë atë për çka janë bindur (dëshmuar) dhe atë që e kanë parë.

- Edhe nëse gjurmët e tyre zhduken dhe lajmet e tyre ndërprehen, shikimet kanë mundësi të marrin (nxjerrin) mësim nëse orientohen në këto (këtë). Veshët e mendjes i ndëgjojnë dhe ata bisedojnë pa shqiptuar asnjë fjalë. Kështu ata deklarojnë: Fytyrat e bukura janë prishur, ndërsa trupat e njomë janë shkatërruar. Kemi veshur veshjen e vjetërruar të kalbësirës. Na ka mposhtur ngushtësia e varrit, ndërsa vetminë e trashëgojmë njëri nga tjetri. Vendqëndrimet tona të qeta janë rrënuar. Bukuria e trupave tonë është tretur. Tiparet e njohura të fytyrës nuk mund të njihen dot. Qëndrimi ynë në vendet e vetmisë u zgjat. Nuk fituam lehtësime të vuajtjeve, as largim të ankthit. Po t'i parafytyroje në mendjen tënde, ose po të ngritej perdja e cila i mbulon-tani kur veshët e tyre kanë humbur aftësinë e tyre dhe janë shurdhuar, sytë e tyre janë mbushur me pluhur dhe të thelluar në gropa, gjuhët e tyre, të cilat ishin tejet të gjalla, janë copëtuar, zemrat e tyre gjithnjë të zgjuara, janë të palëvizshme në kraharorin e tyre, kur në çdo gjymtyrë të tyre është paraqitur shkatërrimi i ri, i cili i gjymtoi dhe ia lehtësoi rrugën vuajtjes drejt tyre, dhe të gjithë ata janë të pafuqishëm, pa kurrëfarë dore që do t'u ndihmonte dhe pa kurrënjë zemër që do të mishërohej ndaj tyre-do të shikoje me siguri pikëllimin e zemrës dhe baltën në sy.

- Çdo fatkeqësi e tyre është e tillë që pozita e saj nuk ndryshon, kurse vuajtja zhduket. Sa furishëm e gërryen toka trupin e pashëm dhe bukurinë mahnitëse, ndonëse në këtë botë është ushqyer begatë dhe është rrethuar me respekt, nuk i ka lënë dëfrimet edhe në çastet e pikëllimit? Nëse është goditur nga ndonjë mjerim, ka kërkuar ngushëllim në kënaqësitë e jetës në lojra dhe dëfrime. Dhe gjersa ka qeshur me këtë botë, ka qeshur me të në kuadër të jetës së shfrenua, koha e shkeli si ferrat, ditët e rrënuan fuqinë e tij dhe vdekja e vështroi nga afërsia. Pastaj e kaploi një pikëllim i rëndë të cilin nuk e kishte njohur dhe sëmundja ia përfshiu atë që më parë ishte e shëndoshë. Pastaj iu kthye asaj çka thonë mjekët, duke luftuar të ngrohtit me të ftohët dhe duke nxitur të ftohtit me të ngrohët, gjersa të ngrohtit vetëm e shtoi të ftohtin. Dhe ai nuk u ekuilibrua në përzierjen e këtyre karaktereve, por sëmundjet shtoheshin në atë masë sa mjekët ishin dekurajuar, kujdestarët e tij kishin hequr dorë, kurse familja e tij ishte e pafuqishme të përshkruante sëmundjen e tij, andaj i bishtëronte përgjigjeve rreth saj dhe grindeshin mes vete rreth lajmit të hidhur të cilin e fshehin nga ai. Disa flitnin se gjendja e tij është e tillë çfarë është dhe i ngushëllonin me shpresë për shërimin e tij, gjersa të tjerët preferonin durim pasi do ta humbnin, duke u përkujtuar atyre shembujt e atyre të cilët kanë shkuar para tij.

- Dhe kështu, gjersa ishte në rrugë të largimit nga kjo botë dhe ndarjen nga miqët, e pushtoi një shtrëngesë e tillë sa mendja e tij e kthjellur u ngatërrua, kurse lagësira e gjuhës së tij u tha. Tani kishte shumë çështje të rëndësishme përgjigjet e cilave i dinte, por nuk mund t'i shprehte. Dëgjon thirrje të shumta, të cilat i shkaktojnë dhimbje në zemër, por qëndron i shurdhër ndaj zërit të më të moshuarit, të cilin i ka respektuar, ose të riut, të cilin e ka ledhatuar. Vdekja vërtet ka mundime; ato janë aq trishtuese sa që nuk mund as të përshkruhen, as të kuptohen nga mendja e njeriut në këtë botë. » (143)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi kalueshmërinë e kësaj bote dhe pafuqinë e atyre në varre:

- « Ajo është shtëpi e rrethuar me tundim dhe e njohur për nga mashtrimi. Gjendjet e saj nuk janë të përvetshme dhe ata të cilët e banojnë nuk do të mbeten të padëmtuar. Konditat e saj janë gjithëfarëshe dhe kohët e saj ndryshojnë. Jeta në të meriton qortim. Siguria në të nuk ka vend. Banorët e saj janë caqe të cilët ajo i gjuan me shigjetat e saj dhe i shkatërron me vdekje.

- Dijeni, i robët e All-llahut, se ju dhe tërë ajo që ekziston në këtë botë jeni vërtetë në rrugë të atyre që kanë jetuar para jush, edhe kanë jetuar më gjatë se ju, edhe kanë pasur shtëpi më me shumë fëmijë, edhe kanë lënë gjurmë më të thella. Zërat u janë heshtur, lëvizjet u janë ndalur, trupat u janë kalbur, shtëpitë u janë mbetur shkretë, ndërsa gjurmët u janë tretur. Pallatet e larta dhe qilimat e shtrirë i zëvendësuan me gurë të radhitur dhe varre të thella, themelet e cilëve janë vendosur në gërmadha dhe godinat e cilëve janë ngritur nga balta. Pozitat e tyre janë të afërt, por banorët e tyre janë të huaj. Janë midis njerëzve të vendit të vet, por ndjehen të vetmuar dhe janë të liruar nga puna. Janë të preokopuar. Nuk ndiejnë kurrëfarë lidhje me atdheun, as mbajnë lidhje reciproke me fqinjët edhe përkundër afrisë së fqinjëve dhe afrisë së vendbanimit. Si mund të vizitohen mes vete kur i ka shtypur të kalburrit me barrën e vet, kurse gurët dhe dheu i kanë gërryer ngadalë?

- Është njësoj sikur edhe ju të keni shkuar ku kanë shkuar ata; Njësoj do t'u rrëmbente vendi i pushimit dhe vendqëndrimi i njejtë do të mbante. Çfarë do të jetë pozita e juaj ku gjërat do të arrijnë fundin e vet dhe kur varrezat të përmbysen ?!

« Aty, në atë vend, secili njeri provohet me atë që e ka bërë më parë dhe do të kthehen te All-llahu, Sundimtari i tyre i vërtetë, dhe humb (shkon huq) prej tyre ajo që trillonin (se do t'u bëjnë shefatë) ». (Junus, 30) » (144)

- Fjalimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s mbi të qenët i vetëdijshëm ndaj All-llahut, dhe njohja lidhur me ata të cilët janë të shqetësuar me vdekjen, si dhe mbi pranimin e durimit:

- « Përkushtimi ndaj All-llahut njëmend është çelës i udhëzimit, pajisjes për botën e ardhshme, lirim nga robëria për çdonjërin dhe shpëtim nga çdo shkatërrim. Me të ka sukses ai që kërkon, shpëton ai që ik dhe arrihen qëllimet.

- Prandaj, punoni, sepse vepra lartësohet, pendimi shfrytëzohet, lutja dëgjohet, konditat janë të qeta dhe pendat lëvizin. Prejani hovin me vepra moshës së jetës e cila ndërron, sëmundjes e cila pengon dhe vdekjes e cila grabit befas. Vdekja, gjithësesi, do t'ju japë fund kënaqësive tuaja, do të turbullojë pasionet tuaja dhe do t'i largojë caqet tuaja. Ajo është vizitor i padëshiruar, kundërshtar i pamposhtur dhe vrasës i pandëshkuar. Litarët e saj tanimë ju kanë ngatërruar, prapësitë e saj ju kanë rrethuar, maja e shigjetës së saj është orientuar drejt jush, pushteti i saj mbi ju është i fortë, të shtypurit e saj mbi ju është i pandërprerë, ndërsa gjasa që nuk do t'ju qëllojë është tejet e vogël.

- Shumë shpejtë do të mposhteni nga errësira e hijeve të saj, ashpërsia e sëmundjeve të saj, terri i halleve të saj, shprehje e pakuptim të vuajtjeve të saj, dhimbja e shkatërrimit të saj, terri i përfshirjes së saj dhe papëlqyeshmëria e shijes së saj. Do t'ju duket se u ka ardhur krejt befasi, duke ia mbyllur gojën atyre të cilët ju përshpëritnin, duke ndarë grupin tuaj, duke fshirë gjurmët tuaja, duke lënë shkret shtëpitë tuaja dhe duke dërguar pasardhësit tuaj që ta ndajnë pasurinë tuaj midis anëtarëve kryesorë të familjes, të cilët nuk mund t'ju shërbejnë asgjë ose ndër të pikëlluarit e afërm, të cilët nuk ia dolën t'ju mbrojtjen, atyre të cilët gëzohen dhe atyre të cilët vajtojnë.

- Prandaj, ju duhet të përpiqeni, të bëni çmos, të pajisni veten, të përgatiteni dhe furnizoheni në shtëpinë e furnizimit. Dhe mos t'ju mashtrojë kurrësesi jeta e kësaj bote siç i ka mashtruar ata para jush nga brezat e kaluar dhe kohët e shkuara-ata të cilët mjelën tërësisht qumështin e saj, gëzuan begatitë e saj, jetuan jetë të gjatë dhe ndërruan rininë e saj në vjetërsi. Ata nuk e njohin atë që u afrohet, nuk ia vënë veshin atij që ua qanë hallin dhe nuk i përgjigjen atij që i fton. Jini pra shumë të kujdesshëm ndaj lësaj bote, meqë është e pabesë, dinake dhe mashtruese, jep edhe refuzon, mbulon me veshje dhe zhveshë. Mirëqenia e saj nuk zgjatë përjetë, hallet e saj nuk kanë të ndalur, ndërsa tundimet e saj nuk përfundojnë. »

- Pjesë e fjalimit të njëjtë të Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s lidhur me eremitët:

- « Ata janë njerëz nga banorët e kësaj bote, por nuk janë banorë të ardhshëm të saj, meqë janë në të si të mos i përkasin. Në të veprojnë sipas asaj që e vërejnë dhe ia prejnë hovin asaj që i frikohen. Trupat e tyre qarkullojnë ndër banorët e botës tjetër. Ata e shohin se banorët e kësaj bote i kushtojnë vëmendje vdekjes së trupit të tyre, mirëpo vetë ata më shumë kujdes i kushtojnë vdekjes së zemrave të gjalla. » (145)

## **KËSHILLAT E IMAM ALIUT A.S DREJTUAR SHOKËVE TË TIJ BESNIKË:**

- Këshilla e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s drejtuar Muhammedit, birit të Ebu Bekrit-All-llahu qoftë i kënaqur me të!- kur Emirul-Muëminini a.s e caktoi për mëkëmbës në Egjipt:

- « Tregohu ndaj tyre i njerëzishëm, i butë dhe fytyrëshur. Sillu ndaj tyre në mënyrë të drejtë, ashtu që fisnikët të mos të mos presin padrejtësi në favor të tyre dhe që të dobëtit të mos e humbin shpresën në padrejtësinë tënde ndaj tyre. All-llahu i Madhëruar, o bashkësi e robëve të Tij, me siguri do t'ju pyesin mbi veprat tuaja, të vogla e të mëdha, të dukshme e të fshehta. Nëse ai ndëshkon, kjo do të bëhet ngase keni qenë tiranë, e nëse Ai ju falë, kjo do të bëhet për atë se është më i mëshirshmi.

- Ta dini, o robët e All-llahut, se ata të cilët janë të përkushtuar ndaj All-llahut e kanë fituar edhe këtë botë kalimtare si edhe atë të amshueshmen, ngase bëshkëveprojnë me banorët e kësaj në punët e përhershme të tyre, gjersa banorët e kësaj bote nuk bashkëveprojnë me ta në të mirat e botës së ardhshme të tyre. Këtë botë e banojnë në mënyrën më të mirë që mund të banohet dhe ushqehen me të mirat e saj në mënyrën më të mirë që mund të bëhet, dhe kështu e gëzojnë këtë botë siç e gëzojnë edhe ata që janë në bollëk dhe marrin prej saj atë që e marrin edhe tiranët kryelartë. Dhe atëherë largohen nga ajo pasi të keni marrë pajisje të mjaftueshme që t'ju shpiejnë gjer në cakun e udhëtimit të tyre dhe pas tregtisë e cila siguron dobi. Kënaqësinë e të përmbajturit nga kjo botë dhe janë shumë të bindur se nesër do të jeni në afërsi të

All-llahut në botën tjetër, ku kërkesat nuk do t'u refuzohen, as do t'u zvogëlohet hisja në kënaqësi.

- Prandaj, o robët e All-llahut, keni kujdes vdekjen dhe afërinë e saj dhe përgatitni çdo gjë që është e nevojshme për të. Ajo do të arrijë si ngjarje e madhe dhe punë madhështore, qoftë si mirësi në të cilën nuk ka ligësi, ose si ligësi në të cilën nuk ka ligësi, ose si ligësi në të cilën nuk do të ketë mirësi. Kush është më afër Xhenetit se ai i cili punon për të? Vdekja ju ndjek pas. Nëse ndaleni-do t'u rrëmbejë, e nëse ikni-do t'u arrijë. Është e lidhur për ju më fort se hija juaj. Vdekja është e lidhur për flokët tuaja të ballit gjersa bota bëhet lëmsh prapa jush. Keni frikë nga Zjarri i fundit i cili është i thellë, vapa e cilit është e tmerrshme dhe dënimi i cilit vazhdimisht përsëritet. Ai është vendqëndrim në të cilin nuk ka mëshirë, ku nuk ka përmëshirë të këresave për asnjë send, as largim nga çfarëdo .

- Nëse mundeni, shtoni frikën tuaj nga All-llahu dhe ushqeni shpresë të mirë të Ai. Pastaj bashkoni këto dy gjëra, ngase vërtetë shpresa e njeriut të All-llahu i vet është në përpjestim me frikën e tij nga All-llahu. Dhe vërtetë, uzdajë më të madhe në All-llahun kanë ata ta cilët frikohen më së shumti.

- O Muhammed, bir i Ebu Bekrit, dije se të kam vënë obligim Egjiptin, i cili është fuqia më e madhe imja. Prandaj e ke detyrë të pashmangshme t'i përballosh pasionet tua dhe të shërbesh si mburojë për fenë tënde, edhe mëse në këtë botë e kalon vetëm një orë dhe të mos e zemërosh Zotin për të kënaqur ndonjërin prej krijesave të Tij. Ngase vërtetë te All-llahu ka zëvendësim për te, gjersa askush tjetër nuk ka zëvendësim për All-llahun. Kryeje namazin në kohën e caktuar. Mos e shpejto kohën e tij nga ngeja as mos e shtyj kohën e tij ngase je i zënur. Dije se çdo punë e jotja e ndjek namazin tënd.

- Me të vërtetë nuk janë të njëjtë prijësi i rrugës së mbarë dhe prijësi i shkatërrimit, miku i Pejgamberit dhe armiku i Pejgamberit. Pejgamberi i All-llahut Selami i All-llahut qofshin gjiithnjë mbi te dhe mbi të tijët!-më ka thënë:» Lidhur me ithtarët e mi, nuk kam frikë as nga besimtari, as nga shërbyesi i idhujve. Sa i përket besimtarit-All-llahu do ta pengojë me besimin e tij, ndërsa sa i përket shërbyesit të idhujve- All-llahu do ta mposhtë për arsye se u shërben idhujve. Por frikohem për ju nga çdonjëri që është hipokrit (munafik) në zemër, mjeshtër i gjuhës i cili e deklaroi atë që e konsideroni të mirë, kurse e bën atë që nuk ju pëlqen. » (146)

- Këshillimi i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s të cilën zakonisht ia shkruante çdonjërit që e caktonte për të mbledhur zeqatin:

- « Nisu në rrugë me përkushtim ndaj All-llahut Një, i Cili nuk ka shok. Kurrë mos ia kall tmerrin muslimanit. Mos iu afro kurrsesi nëse ai këtë nuk e dëshiron. Mos merr kurrë nga ai më tepër seç është e drejta e Zotit nga pasuria e tij. kur të shkosh te ndonjë kabile, qëndro afër puseve të tyre në vend që të futesh në shtëpitë të tyre. Pastaj nisu drejt tyre qetas dhe me dinjitet, gjersa të arrish në mesin e tyre. Mandej jepju selam dhe mos përto t'i përshëndesesh si duhet. Pas kësaj thuaju:» O robët e All-llahut, mëkëmbësi i Zotit dhe halifi i Tij më dërgoi te ju për të mbledhur hisen e Zotit nga pasuria juaj. A ka diç nga hisja e Zotit në pasuritë tuaja? Nëse ka, dorëzoheni atë mëkëmbësit të tij! »

- Nëse thotë:» Nuk ka! »- atëherë përsërite kërkesën. Nëse ndonjëri të përgjigjet pozitivisht, shko me te. Në ndërkohëmos u kanos, as mos rëndo. Dhe merr nga ari e argjendi atë që të jep. Nëse ka kafshë dhe deve, mos iu afro atyre pa lejen e tij, ngase pjesa më e madhe është e tij. Nëse u afroshesh, atëherë mos iu afro si dikush që ka

pushtet ndaj tyre ose me dhunë. Kurrë mos e friko asnjë shtazë, mos e shqetëso dhe mos i bën ndonjë të keqe pronarit të tyre lidhur me to.

- Ndaje pasurinë në dy pjesë dhe lejo që pronari ta zgjedhë njëren. Kurrë mos e kontesto atë që e ka zgjedhur. Mandej ndaje pjesën e mbetur në dy pjesë dhe i lejo ta zgjedhë njëren, e kur ta bëjë këtë mos i bën vërejtje atë që ka zgjedhur. Vazhdo kështu gjersa të mbetet vetëm ajo që mjafton për përmbushjen e asaj që është e Zotit nga pasuria e tij. Pastaj prej tij merre hisen e Zotit. Nëse ai e kundërshton veprimin tënd, merre parasysh mendimin e tij, pastaj përziej dy pjesët dhe përsërit atë që e ke bërë pak më parë, para se e ke marrur hisen e Zotit nga pasuria e tij. kurrë mos merr kafshë të moçme, të gjymtë, të dobët dhe të sëmurë. Kafshët mos ia beso asnjërit, pos atij në të cilin ke besim se do ta ruajë pasurinë e muslimanëve gjersa nuk ia dorëzon prijësit të vet i cili do ta ndajë. Mos ia beso asnjërit, pos atij i cili është mirëdashës, i ndërgjegjshën, që meriton besim dhe është i kujdeshëm, si dhe nuk është i egër, as nuk i mundon tepër, as i lodhë, as i ligështon. Pastaj na dërgo tërë atë që e ke tubuar, kurse ne me të do të veprojmë sipas urdhërit të All-llahut.

- Kur t'i marrë i besurari yt, urdhëroje që të mos e ndajë deven nga mëzi i saj dhe të mos e mjel tërë qumështin e saj, për të mos e dëmtuar të voglin e saj, si dhe të mos e rëndojë duke i hipur. Për këtë le të ketë kujde edhe me kafshët e tjera. Deveve duhejt lejuar të pushojnë dhe të mos nguten ato të cilave u janë tëholluar lëpushat. T'i ndalojë kur të kalojnë pranë ujit që ta shuajnë etjen; dhe të mos i largojë nga terreni me barë në rrugë të fortë. Kohë pas kohe le t'i pushojë dhe le t'u lejojë të qëndrojnë afër ujit dhe kullosës. Kështu, kur ato me vullnetin e All-llahut të arrijnë te ne, do të jenë të majme dhe të fuqishme, e jo të lodhura e të dobëta. Pastaj ne do t'i shpërndajmë në pajtim me Librin e All-llahut dhe rrugën e Pejgamberit të Tij-Selami i All-llahut qofshin gjithnjë mbi te dhe mbi pasardhësit e tij!- Kjo sigurisht do të jetë burim i shpërblimit tënd dhe mjet për udhëzimin tënd, nëse All-llahu e lejon këtë. » (147)

- Pjesë nga këshillat që Imam Aliu a.s ia porositi birit të tij Hasanit a.s në testamentin e njohur që e kemi përmendur më sipër në libër:

- Prej prindit i cili është i vdekshëm, i cili i pranon vështirësitë e kohës, i cili ia ka kthyer shpinën jetës, i cili i është dorëzuar fatit të kohës, i cili e qorton këtë botë, i cili banon vendbanimet e të vdekurve dhe i cili nesër do t'i braktisë-djalit i cili lakmon atë që nuk mund të arrihet, i cili ecë rrugës së atyre që janë zhdukur, i cili është shënjestër e sëmurjeve, i cili është syrgjyn i ditës i cili është viktimë e vuajtjeve, rob i kësaj bote, tregtar i mashtrimit të saj, obligues i dhëshirave, i vdekjes, aleat i brengave, shokë i mjerimit, viktimë e vuajtjeve, i cili është i pushtuar nga pasionet dhe i cili është pasardhës i të vdekurve!...

- Të këshilloj të jesh i vetëdijshëm ndaj Zotit, biri im, të jesh i patundur në dispozitat e Tij, ta përmbush zemrën tënde me përkushtim ndaj Tij dhe të mbahesh për litarin e Tij. Cila lidhje është më e sigurt se lidhja midis teje dhe Zotit, nëse mbahesh për litarin e Tij?!

... - Biri im, kur kuptova se jamë plakur mirë dhe kur hetova se po ligështohem, nxitova ta lë këtë amanet ty dhe i paraqita këshillat kryesore të saj, ashtu që vdekja të mos më arrijë para se ta zbuloj atë që më flenë në zemër, para se urtia ime të goditet siç është goditur trupi im dhe para se të mposhtin fuqitë e pasionit dhe tundimet të kësaj bote, duke të bërë si deve kokëfortë. Zemra e të riut vërtet është si ara e papunuar, e cila pranon çdo gjë që hedhet në te. Nxitova pra të këshilloj para se zemra të ngurtësohet dhe përmes mendjes tënde frytet e përvojave të tjerëve...

...- Biri im kam zgjedhur për ty më të shkëlqyeshmen kam mbledhur për ty gjërat më të dobishme, kurse kam larguar nga ti gjërat e padobishme. Meqenëse të kuptoj siç duhet të kuptojë prindi i zgjuar dhe meqë dëshirojë të të mësoj, mendova se kjo duhet të jetë në kohën kur ti të rritesh dhe gjersa je i freskët në skenën e botës, duke pasur qëllim të sinqertë dhe zemër të çiltërt dhe se do të duhet filluar me mësimin e librit të All-llahut, të Madhëruar dhe Fuqiplot, dhe me komentimin e tij, dispozitave të Islamit dhe rregullave të tij, mbi atë që ai ndalon dhe largon, si dhe që nuk duhet dalur jashtë tyre për të mirën tënde...

...- Përpiqu ta kuptosh drejt këshillën time, biri im, dhe dije se All-llahu i vdekjes gjithashtu është Zot i jetës që Ai i Cili krojon gjithashtu edhe zhdukë, se Ai i Cili shkatërron gjithashtu është Përtëritës i jetës dhe se Ai i Cili jep sëmundje është edhe shërues. Kjo botë zhvillohet në mënyrën të cilën e ka përcaktuar All-llahu për të në raport me kënaqësitë e saj, sprovat, shpërblyemet në Ditën e Gjykimit dhe tërë atë që Ai dëshiron por ti nuk e din...

...- Dije, biri im, sikur Zoti yt të kishte shok, gjithashtu do të arrinin edhe pejgamberët e tij dhe ti do të shikoje shenjat e pushtetit dhe fuqisë së tij, si dhe do kuptoje veprat dhe cilësitë e tij. Por, Ai është All-llahu, Një dhe i Vetëm, siç e ka përshkruar Ai Vetën e Tij. Askush nuk mund t'i kundërvihet pushtetit të Tij. Ai është ngaherë dhe përherë. Ai është para çdo gjëje, pa kurrëfarë fillimi dhe Ai është i fundit, pa kurrëfarë mbarimi. Ai është aq i madh sa zotërimi i Tij nuk mund të përfshihet me zemër ose sy...

...- Dije se përpara teje ekziston përpjetë e mundimshme dhe rrepinët, në të cilën personi me barrë të lehtë do të jetë në pozitë më të mirë se ai me barrë të rëndë, gjersa ai i ngadalshmi në te do të jetë në pozitë më të keqe si ai i shpejti. Rezultati yt i fundit i kalimit të saj pa dyshim do të jetë ose Xhenneti ose Xhehennemi. Prandaj hapi sytë, në dobi tënden, para të zbriturit dhe përgatit vendin para të arriturit, ngase pas vdekjes nuk ka kurrëfarë afrimi, as kthim në këtë botë...

...- Dije biri im, se je krijuar për botën tjetër e jo për këtë, për zhdukje e jo për jetë të amshueshme, për vdekje e jo për jetë...

...- Biri im, shpesh kujtoje vdekjen dhe vendin ku do të shkosh befas dhe do ta arrish pas vdekjes kështu që kur të arrijë, të jeshë i kujdeshëm ndaj saj dhe të keshë përgatitur veten për të, ashtu që ajo nuk të vjen krejt papritur dhe nuk të zë të papërgatitur...

...- Errësira ngadalë zhduket. Tani është sikur udhëtarët zbresin nga kuajt, kurse ata të cilët nxitojnë do të arrijnë së shpejti. Dije biri im, se ai në shalën e natës dhe ditës bartet te ata, edhe nëse rrin i qetë, dhe kalon distanca të mëdha, edhe nëse qëndron dhe pushon...

...- Rrespektoje farefisnin tënd të afërm ngase ata janë krahët me të cilat fluturojshë, fillim tek i cili kthehesh, dhe duar me ta cilat sulmojshë. Dorëzoja plotësisht besimin tënd dhe ndërgjegjen All-llahut që të t'i ruajë dhe kërko nga Ai që të ta përvcaktojë çdo të mirë qoftë të largët apo të afërt, si dhe nga kjo dhe bota tjetër. » (148)

- Testamenti i Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s drejtuar bijve të tij Imam Hasanit dhe Husejnit a.s kur Ibn Mulxhemi-mallkimi i Zotit qoftë mbi te!- e kishte plagosur:

« Ju lë amanet të jeni të vetëdijshtëm ndaj All-llahut dhe të mos e gjakoni këtë botë edhe nëse ajo këtë e dëshiron nga ju. Mos t'ju vijë keq për asgjë që u është refuzuar nga ajo. Folni të vërtetën dhe punoni për shpërblym. Bëhuni kundërshtarë të tiranit dhe ndihmës për të shtypurin.

- Ju lë amanet juve dhe krejt fëmijëve të mi dhe anëtarëve të familjes time dhe çdonjërit të cili arrinë kjo porosi e shkruar që të jeni të përkushtuar ndaj All-llahut, që t'i kryeni si duhet punët tuaja dhe t'i eliminoni mosmarrëveshjet midis veti, ngase e kam

dëgjuar gjyshin tuaj-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!-duke thënë:» Përmirësimi i marrëdhënieve të ndërsjella është më i mirë se namazi i paobligueshëm dhe agjërimi i paobligueshëm... »

- Keni frikë Zotin dhe, sërish, keni frikë Zotin lidhur me jetimët! Mos lejoni të jenë të uritur dhe që në praninë tuaj të keqtrajtohen.
- Keni frikë Zotindhe, sërish, keni frikë Zotin lidhur me fqinjët tuaj, ngase ata janë amanet i Pejgamberit! Aq ka porositur për sjellje të mirë ndaj tyre sa që menduam se do të bëjë që ta trashëgojnë njëri-tjetrin.
- Keni frikë Zotin dhe, sërish, keni frikë Zotin sa i pëket Kur'anit! Askush të mos ua kalojë në të vepruarit sipas tij.
- Keni frikë Zotin dhe, sërish, keni frikë Zotin lidhur me namazin, ngase ai është shtyllë e besimit tuaj!...
- ... Jeni të vendosur në miqësinë e ndërsjellë dhe flijimin e disave për të tjerët. Dhe ruajuni nga grindja dhe ndarja e ndërsjellë. Mos heqni dorë nga thirrja për vepra të mira dhe largimin nga ato të këqia, ashtu që të ligët nga ju të administrojnë mbi ju, kur do të luteni, por nuk do t'u miratohet. »
- Pastaj ai-Imami a.s tha:
- O bijtë e Abdul-Mutalibit, vërtetë nuk dëshiroj t'u shoh se si keni shkelur vrazhdë në gjakun e muslimanëve duke bërë:» Është vrarë Emirul-Muëminini! » Keni kujdes! Mos e vrani kurrësesi për mua asnjërin pos vrasësit tim!
- Pritni! Nëse vdes nga kjo goditje e tij, atëherë goditeni. Goditje për goditje. Dhe mos e shëmtoni njeriun, ngase e kam dëgjuar Pejgamberin e All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!-duke thënë:» Ruajuni nga të shëmtuarit edhe nëse është fjala për qenin e tërbuar. » (149)
- Letra e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s drejtuar Muhammedit birit të Ebu Bekrit pas lajmit se kishte marrur postin e Eshterit si administrator i Egjiptit pas vdekjes së tij gjatë rrugës për në Egjipt:
- « Dhe tani! Kam marrur vesht për zemërimin tënd lidhur me emërimin e Eshterit në vendin tënd. Mirëpo këtë me të vërtetë nuk e bëra ngase të ka munguar diç, ose për atë që të shtoj përpjekjet tua. Përkundrazi-kur ta morra atë që ishte nën pushtetin tënd do të vendosi në post i cili ishte më pak i vështirë, kurse më shumë joshës për ty.
- Njeriun të cilin e emërova si administrator në Egjipt ka qenë qëllim-mirë ndaj neve, ndërsa tejet i ashpër dhe rezistues ndaj armiqëve tonë. All-llahu e mëshiroftë! Ai përmbushi ditët e veta dhe takoi vdekjen e vet. Ne jemi tërësisht të kënaqur me te. All-llahu i dhuroftë kënaqësinë e Tij dhe ia shumëfishoftë shpërblimin!
- Ndërsa tani! Përgatitu për armikun tënd dhe puno në përshtatje me gjykimin tënd. Përgatitu për luftë kundër atij që lufton kundër teje dhe fto në rrugën e Zotit tënd. Vazhdimisht kërkoni ndihmën e All-llahut, që të të mbrojë nga ajo që të brengosë dhe të ndihmojë në atë që të godet, nëse Ai dëshiron kështu. » (150)
- Letra e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s dërguar Abdull-llah ibn Abbaait, pas vresjes së Muhammedit, birit të Ebu Bekrit:
- « Dhe tani! Egjipti vërtet u pushtua dhe dhe Muhammedi biri i Ebu Bekrit-All-llahu e mëshiroftë!-u bë shëhid. Shpresojmë në shpërblimin e tij te All-llahu. Ishte njeri qëllim-mirë, mëkëmbës i cili ishte përpjekur shumë, shpatë e mprehtë dhe beden i mbrojtjes. I kam nxitur njerëzit t'i bashkohen dhe u kam urdhëruar ta arrijën, për t'i ndihmuar para kësaj ngjarje. I kam ftuar shpesh, fshehurazi dhe botërisht. Disa prej tyre

erdhën kundra vullnetit, disa paraqitën arsytetime të rrejshme, kurse disa mbetën në shtëpi duka u ndarë. Nga All-llahu i Madhëruar kërkoj që të më shpëtojë sa më parë prej tyre, ngase-për All-llahun!-po të mos gjakoj të ndeshem me armikun për shkak të shehidllëkut dhe po të mos jem i gatshëm për vdekje, nuk do të dëshiroja të jem me këta njerëz as edhe një ditë të vetme, as të takohem me ta kurrë. » (151)

- Letra e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s dërguar Osman ibn Hunejf El-Ensariut, I cili ishte mëkëmbës i Emirul-Muëmininit-alejhisselam!-në Basra, kur e kuptoi se banorët e këtij vendi e kishin ftuar Osmanin në gosti dhe ai kishte pranuar:

« Dhe tani! O bir i Hunejfit, kam marrë vesht se një nga të rinjtë e Basrës të ka ftuar në gosti dhe se ti ke ngarendur me te. U shtruan gjellëra të ndryshme për ty dhe u afruan pjata të mëdha. Kurrë nuk kam menduar se do të pranosh gostinë e njerëzve të cilët i dëbojnë lypësit dhe ftojnë të pasurit. Mendo për kafshatat të cilat i merr, lëri ato në të cilat dyshon dhe merr ato për të cilat je i sigurt se janë siguruar në mënyrë legjitime.

- Dije mirë se çdo besimtar e ka imamin të cilin e pason dhe kërkon të ndriçohet me dritën e diturisë së tij. Dije mirë se Imami juaj është i kënaqur me dy copa të vjetëruara të veshjes nga gjithë kjo botë dhe me dy rrisa bukë për ushqim. Dije mirë se ju nuk jeni në gjendje të veproni në këtë mënyrë. Por më ndihmoni me virtutshmërinë, përpjekjet personale, nder dhe drejtësi. Ngase-për All-llahun!-unë nuk kam tubuar kurrëfarë ari nga kjo botë e juaj, as kam grumbulluar pasurinë e bujshmetë saj, as kam mbledhur veshje tjetër pos kësaj të vjetëruar, as kam grabitur ndonjë pëllëmbë të tokës së saj, as kam marrë prej saj më shumë seç është racioni i gomarit lëkurëjpur. Aji në sytë e mi është më e dobët dhe më e ligësht dhe më e parëndësishme se lendeja e idhët.

- Me siguri gjithëçka që është pronë e jona nën këtë qiell, pa dyshim, është Fedeku, mirëpo një pjesë njerëzish ndiejnë lakmi ndaj saj, ndërsa pjesa tjetër përmbahet nga ajo. All-llahu, pos të gjithash, është edhe gjykatës më i mirë. Çdo të bëje me Fedekun, dhe me ate që nuk është Fedek, kur nesër trupi yt do të shkojë në varr, në errësirën e cilit gjurmët e tij do të zhduken dhe lajmet për te do të treten?! Kjo është humnerë të cilin, edhe nëse i zgjerohet hapsira, ose duart e mihësve e bëjnë të gjërë dhe të hapur, gurët dhe plisat e argjilit do ta ngushtojnë kurse dheu i shembur do t'i mbyllë vrimat e tij. Gjithënjë kam synuar që zemrën time ta mësoj për përkushtim ndaj All-llahut, ashtu që në Ditën e Gjykimit frikës së madhe të jetë e sigurt dhe stabile në vendet rrëshqitëse.

- Po të dëshiroja, kam mundur të shkoj rrugës e cila shpie, midis pastërtisë së grurit të begatshëm, dhe veshjes prej mëndafshit, por nuk ka ndodhur që pasionet e mia të më pushtojnë dhe që lakmia të më shpie në të zgjedhurit e gjellërave, gjersa në Hixhaz ose Jemen ndoshta ka ndonjë i cili nuk ka shpresë në sigurimin e një cope të bukës ose ndonjë që kurrë nuk ka hëngër gjersa është ngopur. A të shtrihem me barkun plot gjersa përquark mund të ketë stomakë të uritur dhe banorë tq etshëm?! Ose, a të pi siç thotë poeti:

« Gjersa populli pranë teje për një kothere bukë lakmon,  
ti sëmurjen në brendinë e stomakut tënd shton ».

- A duhet të jem i kënaqur me atë që më thuhet:» Ky është Emirul-Muëminini!-ndonëse me njerëzit nuk i ndaj vuajtjet e jetës? Nuk jam i kënaqur për të qenë i brengosur me të ngrënit e ushqimit të mirë, si shtaza e lidhur, brenga e vetme e së cilës është ushqimi i vet, ose si shtaza e papenguar e cila hallapitë. Ajo mbushë stomakun e vet me ushqim, por nuk përfillë qëllimin pas saj. A do t'i qasem kullosës së shfrenuar të lirë? Ose do ta heq zvarrë litarin e devijimit? Ose do të bredh pa qëllim shtigjeve të hutimit?



- Më bëhet se e shoh se si ndonjë prej jush thotë:» Nëse ky është ushqim i birit të Ebu Talibit a.s, atëherë ligështimi do ta pengojë në luftë kundër kundërshtarëve të tij dhe në përleshjet me trima! » Dije mirë se vërtet druri i malit ka lëndë më të fortë, gjersa degët e gjelbërta e kanë koren më të butë dhe se kaçubet e egra ndezen shpejtë dhe shuhen ngadalë. Lidhja ime me Pejgamberin e Zotit është si lidhja e dritës me dritë dhe llërës me parallërën. Për All-llahun, nëse arabët bashkohen për të luftuar kundër meje, nuk do të iki para tyre; dhe nëse me jipet rasti, do të nxitoj t'i kapi për zverrkun e tyre. Do të përpiqem, me siguri, që ta pastroj tokën nga këta persona të prishur dhe trupa të vrazhdë, gjersa copat e dheut të tharë të mos eliminohen nga kokrrat e grurit.

- Largohu nga unë oj botë! Litari yt është në supet tua, meqë kam liruar nga kthetrat tua, kam shpëtuar nga rrjetat tua rrëshqitëse. Ku janë brezat që i ke larguar me dredhitë tua? Ku janë popujt të cilët i ke larguar nga rruga e drejtë me stolitë tua? Të gjithë ata janë syrgjyn të varreve dhe brendi e vendve të grupuara. Për All-llahun, po të ishe person i dukshëm dhe organizëm i aftë për ndijim, do të të gjykoja me dënim që e ka caktuar All-llahu për arsye se ke mashtruar njerëzit, dhe njerëzit i ke hudhur në shkatërrim, edhe sundimtarët i ke lënë në dorë të asgjësimit, dhe i ke dëbuar në vende të mjerimit pas të cilit nuka ka as shkuarje as kthim. Vërtet, kushdo që ka ecur terreneve tua rrëshqitëse, ka rrëshqitur. Kushdo që ka kaluar mbi valët tua-është fundosur. Ndërsa kush u ikë kurthave tua-do të ketë sukses. Ai i cili arrin të mbrohet nga ti nuk brengoset, edhe nëse punët i ka shumë keq, dhe kjo botë i duket si dita e cila po soset.

- Ik nga unë! Ngase, për All-llahun, nuk përkulem para teje ashtu që të më poshtërosh, as t'i lë frerët në duart tua që të më udhëheqësh. Të betohem në All-llahun, me betimin nga i cili e nxjerri vullnetin e All-llahut, se do ta ushtroj ashtu shpirtin tim sa do të gëzohet nëse për ushqim ka kothere buke dhe do të jetë i kënaqur nëse ka vetëm kripë për ta kripur. Do t'u lejoj syve të mi të mbeten të zbrazët pa lot-si lumi uji i të cilit ka shterrur. A duhet Aliu të hajë çdo gjë që ka dhe të bëjë gjumë si kafsha e cila e ka mbushur stomakun në kullosë dhe është shtrirë të pushojë, ose si dhinë të cilat brejnë gjethet dhe shkojnë në torishtën e tyre? Sytë iu vërbofshin nëse ai, pas shumë vitesh, do të bëjë si begati e shpenguara dhe shtazë që kullosin.

- Është i mëshiruar personi i cili i përmbush obligimet e tij ndaj All-llahut të vet dhe që i duron fatkeqësitë e tij, që nuk i lejon vetes gjumë natën-kur gjumi e pushton-shtrihet në tokë duke përdorur dorën e vet si jastëk, bashkë me ata të cilët i mbajnë hapur sytë e tyre nga frika prej Ditës së Gjykimit, trupat e të cilëve janë gjithënjë larg shtetërve, buzët e të cilëve pëshpërisin duke kujtuar All-llahun dhe gjynahet e të cilëve janë eliminuar me lutjen e tyre të vazhdueshme për falje.

« Ata janë pjesëtarë të palës së All-llahut! Eh, vërtet këta janë ata pjesëtarë të palës së All-llahut të cilët do të arrijnë gjendje të lumtur! » (El-Hashr, 22)

- Prandaj, o biri i Hunejfit, ki frikë nga All-llahu dhe kënaqu me kothere të bukës në mënyrë që të shpëtosh nga Zjarri... » (152)

- Porosia, përkatësisht këshilla që Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s-Emirul-Muëminini, ia urdhëroi Malik ibn Harith El-Eshterit, kur e emëroi si administartor të Egjiptit, me qëllim të mbledhjes së zeqatit, luftës kundër armiqëve të tij, kërkimit të mirëqenies për banorët e Egjiptit dhe përparimit të atyre viseve.

- Emirul-Muëminini a.s e urdhëroi që të jetë i vetëdijshëm ndaj All-llahut, t'i jep përparësi përkushtimit ndaj All-llahut dhe të ndjekë atë që Ai e ka urdhëruar në Librin e Vet (Kur'anin, vërejt e përkth) me përpikshmëri dhe devocion, pa ndjekjen e të cilave askush nuk mundet të jetë i kënaqur ndërsa me moszbatimin dhe anashkalimin e këtyre

obligimeve të All-llahut, njeriu bëhet i palumtur-pikëlluar; gjithashtu Imami a.s e urdhëroi që t'i ndihmojë (shërbejë, vërej e përkth) All-llahut të Madhëruar me zemër, duar dhe gjuhë (fjalë), meqë Ai-Madhëruar qoftë emri i Tij!- e merr për obligim t'i ndihmojë atij që e ndihmon Atë, dhe e forcon atë që e madhëron Atë.

- Gjithashtu e urdhëroi Malik El-Eshterin që ta largojë shpirtin prej epsheve, dhe ta frenojë atë-epshin kur të del në pah.
- Ngase me të vërtetë shpirti sjell të këqija, përveç atij të cilin e kaplon mëshira e All-llahut.
- Në vijim ja këshilla e Imamit a.s drejtuar Malik ibn El-Eshterit:

Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

- Pastaj, dije o Malik, se po të dërgoj në vendin në të cilin para teje ka pasur administrime edhe të drejtë edhe tiranizues. Njerëzit tani do të shikojnë me vëmendje veprimet tua, siç ke shikuar ti me vëmendje veprimet e administratorëve para teje. Dhe do të flasin për ty po atë çka ke folur ti për ata. Të ndershmit, natyrisht, janë të njohur për nga autoriteti i miri i tyre, të cilin All-llahu e ka lëshuar të qarkullojnë për ta përmes gjuhës së robërve të Tij. Rezerva më e mirë le të jetë rezerva e veprave të mira. Prandaj kontrollo pasionet tua dhe përmbaju ndaj asaj që nuk është e lejuar, nga se të përmbajturit e shpirtit nënkupton të mbajturit e tij në rrugën e mesme, ndërmjet asaj çka adhuron dhe asaj çka nuk adhuron.

- Mësoje zemrën tënde të jetë e mëshirshme ndaj vartësve, e disponuar dhe e mirë nda tyre. Mos u bë për ta si egërsirat mizore, të cilat e konsiderojnë të mjaftueshme vetëm t'i kapërdijnë, pasi që janë të ngurtë, ose vëllezërit tu për nga feja ose ndonjë i ngjashëm me ty për nga krijimi. Do të gabojnë pa qëllim dhe do të ballafaqohen me lëshime. Ata mund të veprojnë me padrejtësi, qëllimisht ose nga pakujdesia. Shpërblej ata me faljen dhe amnistinë tënde njësoj siç do të dëshiroje që All-llahu të shpërblejë ty me falje dhe mëshirë, nga se ti je mbi ta, kurse ai i cili të porositë për këtë është mbi ty, gjersa All-llahu është mbi ate i cili të emëron administrator. Ai kërkon nga ti të administrosh punët e tij dhe të provon përmes tyre

- Mos shpreh prirje për luftë kundër Zotit, ngase nuk ke fuqi kundruall fuqisë së Tij dhe nuk mund të veprosh pa bekimin e Tij dhe mëshirën e Tij. Kurrë mos u pendo që ke falur dhe mos u gëzo kurrë që ke dënuar. Kurrë mos nxito me veprim të rrëmbyeshëm nëse mund t'i ikësh. Kurrë mos thuaj: « Mjaft më kanë urdhëruar andej do të urdhëroj, pra të gjithë duhet të më binden!» Meqë kjo fut huti në zemër, ligështon besimin dhe e shpie njeriun në shkatërrim. Nëse pozita në të cilën je emëruar të nxitë mburrje ose kotësi, atëherë shiko madhështinë e pushtetit mbi ty dhe fuqinë e Tij të cilën ti nuk e posedon madje as mbi veten tënde.

- Kjo do të eliminojë mburrjen, do të shërojë nga karakteri yt i egër dhe do ta kthejë urtinë e cila të është larguar. Ruaju nga të krahasuarit me Zotin në madhështinë e Tij dhe imitim të Tij në pushtetin e Tij, nga se All-llahu vërtet e poshtron çdo tiran dhe turpëron çdo mburravec mendjelartë.

- Bëhu i drejtë ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve si ndaj vetes tënde, ndaj familjes tënde dhe atyre nga besimtarët tu për të cilët ke simpati, sepse nëse vepron kështu do të jesh i padrejtë, ndërsa All-llahu, në emër të robërve të Tij, është kundërshtar i atij i cili është i padrejtë ndaj robërve të Zotit. Kurse atij të cilit All-llahu i është kundërshtar, do t'i dobësohet preteksti i tij dhe ai do të mbetet në gjendjen e të qenët në luftë me Zotin, gjersa nuk bindet dhe pendohet. Asgjë nuk është më me ndikim në ndryshimin e

rrahmetit të Zotit dhe në shpejtimin e kompenzimit të Tij se që është këmbëngulja në tirani, nga se All-llahu vërtet dëgjon lutjet e të shtypurve dhe Ai ua zë pritën tiranëve.

- Adhuroje më së shumti atë që është më e ekuilibruar në të drejtë, më e përgjithësuar në drejtësi dhe më gjithpërfshirëse duke marrë kënaqësinë e besimtarëve, ngase pakënaqësia e njerëzve të zakonshëm merr me vete kënaqësinë e njerëzve të shquar, kurse pakënaqësia e njerëzve të shquar mund të lihet pas dore nëse ekziston kënaqësia e njerëzve të zakonshëm. Asnjëri nga besimtarët e prijësit nuk është më i rëndë se njeriu i shquar në kënaqësitë e jetës, më i padobishëm në vuajtje, më i mbushur urrejtje ndaj veprimeve të drejta, më i neveritshëm në të kërkuarit e përkrahjes, më pak mirënjohës në kohën e dhënjës, më pak i ndieshëm për shkaqe në kohën e refuzimit dhe më i dobët në durim në kohën e problemeve të jetës. Njerëzit e zakonshëm të Bashkësisë janë shtylla e besimit, fuqia e muslimanëve dhe mbrojtja nga armiku. Prandaj, simpatia dhe synimi yt le të drejtohen në drejtim të tyre.

- Më i largëti prej teje ndër besimtarët dhe më i ligu prej tyre në sytë tu le të jetë ai i cili më së paku i hulumton mangësitë e njerëzve, me që njerëzit mund të kenë të meta, ndërsa sundimtari është më i thiruri për t'i fshehur. Prandaj, kurrësesi mos zbulo çkado prej kësaj që është fshehur nga ti, nga se ke obligim të përmirësosh atë që të është rrëfyer, ndërsa All-llahu do të gjykojë për çdo gjë që është e fshehur nga ti. Mbulo të metat sa të mundesh dhe All-llahu do të mbulojë të metat tua për të cilat ti do të dëshiroje të mbeten të fshehura nga ithtarët tu. Zgjidh çdo nyje të urrejtjes në popull dhe këput nga vetja shkakun e çdo armiqësie. Largo çdo gjë që nuk e ke të qartë. Kurrë mos nxito që të marrësh në mbrojtje gojëkëqinjët, nga se gojëkëqinjët është gënjeshtar, edhe nëse paraqitet si ai që dëshiron mirë.

- Kurrë mos e inkuadro koprracin ndër ata me të cilët këshillohesh, ngase do të largojë nga mirëbërësia dhe do të frikojë me varfëri, as frikamanin, i cili do të bëjë aq të dobët për për kryerjen e punëve tua, as lakmitarin, i cili do të joshë me grumbullimin e pasurisë në mënyra të pahëshme. Kopracia, frika dhe lakmia vërtetë janë instikte të ndryshëm, por të gjithë i bashkon të persiaturit e gabuar mbi Zotin.

- Ndhimësi më i keq yti është ai i cili ka qenë ndihmësi i njerëzve të këqinj para teje dhe i cili u është bashkuar në mëkate. Prandaj mos lejo që të bëhet personi i afërt, nga se të tillët janë aleatë të mëkatarëve dhe vëllezër të tiranëve. Për ta mund të gjesh zëvendës të mirë, të cilët do të jenë si ata në meditime dhe veprime, por nuk do të jenë të ngjashëm në mëkate dhe vese. Ata kurrë nuk kanë ndihmuar tiranin në tiranizimin e tij, ose mëkatarin në mëkatin e tij. Më së paku do të shetësojnë dhe më së shumti do të ndihmojnë. Do të jenë më të matur ndaj teje dhe më së pahu do të anojnë nga të tjerët. Prandaj merri si njerëz të zgjedhur fshehurazi si edhe botërisht.

- Pasatj më të çmuarit prej tyre për ty le të jenë ata të cilët e thonë hapur të vërtetën para teje dhe të cilët të ndihmojnë më së paku në atë veprim tëndin për të cilin All-llahu nuk dëshiron nga miqët e Vet, edhe nëse kjo është në pajtim me dëshirën tënde. Lidhur fort për ata të cilët janë të ndershëm dhe të singertë dhe pastaj i këshillo që të mos lëvdojnë as të mos ta bëjnë qejfin për vepra të cilat nuk i ke kryer, nga se tepëria e lëvdimit krijon krenari dhe të afron kah arroganca.

- Para teje nuk duhet të janë të njejtë ai i cili kryen vepra të mira dhe ai i cili kryen vepra të liga, meqë, me të vërtetë, në këtë qëndron largimi i mirëbërësit nga mirëbërësia dhe inkurajimi i kryesit të veprave të liga për prapësi. Mbaje çdonjërin prej tyre në vendin të cilin e meriton. Dije se më i përshtatshëm për përshtypjen e sundimtarit në nënshtatashit e tij është që të forcojë mirësinë e vet ndaj tyre, të lehtësojë vuajtjet e tyre dhe të largojë nga ajo për të cilën nuk kanë aftësi. Prandaj ndjeke drejtimin me të cilin

len përshtypje të mirë te besimtarët tu, sepse përshtypja e tillë e mirë do të lirojë nga shumë brenga të mëdha. Më i përshtatshmi në përshtypje të mirë mbi ty është ai për të cilin sjellja jote nuk është e mirë, ndërsa më i përshtatshmi për përshtypje negative mbi ty është ai për të cilin sjellja jote nuk është negative.

- Mos e ndërpre rrugën e drejtë nëpër të cilën kanë ecur brezat e parë të kësaj bashkësie, në themelet e cilës është krijuar uniteti i përgjithëshëm dhe në të cilën është arritur drejtësia e nënshtetasve. Mos formo kurrësesi ndonjë drejtim i cili i dëmton rrugët e mëhershme, ngase kompenzimi i bie atij cili e ka krijuar, kurse mëkati ty, sepse ti e ke lejuar. Bëhu i vendosur në zhvillimin e bisedave me dijetarët dhe diskutimeve me njerëz të urtë me qëllim të forcimit të asaj çka është e mirë për vendin tënd dhe rivendosjen e asaj për çka njerëzit para teje kanë vepruar drejt.

## **MBI GRUPACIONET E NDRYSHME TË NJERËZVE:**

- Dije se vartësit sajojnë grupacione të cilët mbahen vetëm njëri krahas tjetrit dhe se nuk mund të jenë të pavarur njëri nga tjetri. Nga këto grupacione janë: ushtria e All-llahut, personeli sekret nga njerëzit e zakonshëm dhe të zgjedhur, ndarësit e drejtësisë, të ngarkuarit për ligj dhe rregull, obliguesit e tatimit personal, dhe për tokë nga ata që janë nën mbikëqyrje dhe muslimanët, tregtarët dhe pronarët, pastaj shtresa më e ulët e nevojtarëve dhe të varfërve. All-llahu ka përcaktuar hisen e çdonjërit dhe ka paraqitur dispozitën e Tij, e cila ruhet te na për çdonjërin veç e veç, në Librin e Tij në sunnetin e Pejgamberit të Tij-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!

- Prandaj ushtria, me vullnetin e All-llahut, është foresë për të nënshtuarit, stoli për sundimtarët, forcë e besimit dhe rrugë e sigurisë. Vartësit nuk mund të ekzistojnë pa te, gjersa ushtria mund të mbahet vetëm me ato mjete të cilat i ka caktuar All-llahu për të, me të ardhurat me të cilat ajo vjel fuqinë për luftë me armikun, në të cilat ajo bazohet në të përparuarit e saj dhe me të cilat ajo i plotëson nevojat e saj. Këto dy grupacione nuk mund të ekzistojnë pa të tretin, të cilin e përbëjnë gjyqëtarët, ekzekutuesit dhe sekretarët; ata gjykojnë mbi kontratat, mbledhin të ardhurat dhe janë të nevojshëm për çështje të veçanta dhe të përgjithëshme.

- Kurse të gjitha këto grupacione nuk mund të ekzistojnë pa tregtarët dhe pronarët, të cilët për të siguruar nevojat, rivendosin tregun dhe u mundësojnë të tjerëve që tërë këtë të mos e bëjnë me duart e tyre. Pastaj vjen grupacioni më i ulët-i nevojtarëve dhe të varfërve, të cilët kanë të drejtë për ndihmë dhe mbështetje, kurse i përket çdonjërit, në emër të Zotit, pajisje për jetë dhe çdonjëri ka të drejtë te sundimtari në harmoni me atë çka është e nevojshme për mirëvajtjen e vet.

- Prijësi nuk mund të lirohet nga obligimet të cilat ia ka caktuar All-llahu, pos me përpjektjet dhe kërkim të ndihmës nga Zoti, si dhe me përshtaturit në pasimin e vazhdueshëm të së Vërtetës dhe në durimin e çdo gjëje që është e lehtë ose e rëndë.

## **USHTRIA:**

- Cakto për komandant të ushtrisë tënde atë njeri i cili, sipas mendimit tënd, ka qëllim të mirë ndaj Zotit, Pejgamberit të Tij dhe Imamit tënd, më të ndershmin në zerër dhe më të dalluarin prej tyre në shpirtëmirësi, më të ngadalshmin në zemërim, që pranon pendesën, që është i mëshirshëm ndaj të dobësit dhe i vendosur ndaj të fortit, atë që nuk e nxitë dhuna, as dobësia e mban ulur!

- Krahas kësaj, lidhu për për njerëz me prejardhje fisnike nga shtëpi të ndershme dhe me të kaluar të pastër, pastaj për njerëz trima, guximtarë, zemërgjërë dhe s të i dobishëm, gjersa ato të rëndësishmet janë të tilla sa që nuk mund të lihen pas dore.
- Le të ketë ky komandant i ushtrisë tënde aso pozite para teje që t'i ndohmojë. Shpenzo nga parat tuaja për ta dhe për familjet e tyre të cilat mbesin pas tyre, ashtu që brennga e vetme e tyre të jetë lufta kundër armikut. Disponimi yt ndaj tyre do të kthejnë zemrat e tyre drejt teje. Me të vërtetë, gjëja më e preferueshme për sundimtarin është të vendosurit e drejtësisë në Tokë dhe çfaqja e disponimit nga ana e vatësve të tyre, mirëpo disponim nuk e ka pastërtinë e zemrës së tyre. Dhe nuk ka mendim të drejtë të tyre pa praninë e administratorëve të tyre, mosngarkesën e krahinave të tyre dhe braktisjen e pritjes së padurueshme të përfundimit të kohës së tyre të administrimit. Prandaj bëhu zemërgjërë në raport ndaj kërkesave të tyre, vazhdo me lavdrimin e tyre duke rrëfyer për veprat e mira të atyre që i kryejnë, nga se të përmendurit e veprave të mira tund të guximshmit dhe nxitë të dobët, nëse All-llahu e dëhiron këtë.
- Vlerëso të arriturat e çdonjërit prej tyre. Kurr rezultatet e njerit mos ia përshkruaj tjetrit dhe kurrësi mos ia zvogëlo shpërblimin nën vlerën e rezultatit. Pozita e lartë e njeriut nuk duhet të nxitë që të smadhosh rezultatit e tij i cili është i vogël, as që pozita e ulët e ndonjërit të mashtrorë që rezultatit e tij të madh të konsiderosh të vogël. Besoja Zotit dhe Pejgamberit të Tij punët të cilat të brengosin dhe atë që e ke të paqartë. Meqë, duke iu drejtuar njerëzve të cilët dëshirojnë t'i udhëzojë, All-llahu i Lartëmadhëruar thotë:  
« O ju që e arritët besimin, përmendeni All-llahu dhe përmendeni Pejgamberin dhe ata prej jush të cilëve u është besuar pushteti, ndërsa nëse nuk mund të pajtoheni për ndonjë çështje drejtoni Zotit dhe Pejgamberit, nëse e besoni Zotin dhe Ditën e Fundit. (Kur'an 4:59)
- Të referuarit Zotit do të thotë të vepruarit sipas asaj që është e qartë në Librin e Tij, ndërsa të referuarit e Pejgamberit nënkupton të ndjekurit e pasardhësit të tij lidhur me të cilin nuk ka mospajtime.

## **GJYQTARI SUPREM**

- Për zgjidhjen e mosmarveshjeve midis njerëzve zgjidhe atë nga vartësit tu i cili, sipas mendimit tënd, është më i miri. Që punët nuk e mërzhitin, polemikat nuk e zemërojnë, mos të nguli këmbë në asnjë gabim, të mos llomotitë duke pranuar të vërtetën kur ta mësojë, të mos e synojë lakminë dhe të mos kënaqet me të kuptuarit sipërfaqësor, pa thellim të themelt në te. Mbi të gjitha duhet të jetë i gatshëm të përqëndrohet në çështjet e paqarta, duke përfillur tërësisht argumentet, në masë të vogël rezistues ndaj diskutimit të paditësve, tërësisht tolerues në hulumtimin e rasteve dhe prore i paluhatshëm në sjelljen e vendimeve. Lëvdata nuk guxon ta bëjë mendjemadh dhe pasioni nuk guxon ta anojë. Njerëz të tillë ka pak!
- Prandaj shumë shpesh verifiko vendimet e tij dhe i cakto aq para, në mënyrë që të mos ngurrojë gjatë hetuesisë dhe të mos mbetet për te asnjë arsye që t'i drejtohet tjetrit për nevojat e tij. Caktoji aso posti pranë teje për të cilin nuk do të gjykojë asnjë nga të afërmit tu, ashtu që ai të mbetet i sigurt nga ligësia e njerëzve rreth teje. Në këtë duhet pasur sy të mprehtë, me që vërtetë ky besim ka qenë syrgjyn në duart e degjenerikëve, kur në të veprohej përmes nxitjes së pasioneve dhe përmes saj është kërkuar kjo botë.

## **SHËRBIMI EKZEKUTIV**

- Prandaj, kontrollo punët e nënpunësve ekzekutivë. Emëroi pasi t'i provosh dhe mos i emëro në bazë të anësisë ose simpatisë, nga se të dyjat janë burim i të gjitha llojeve të padrejtësive dhe tradhëtisë. Zgjedhi midis tyre ata me përvojë dhe të turpshëm të cilët rrjedhin nga familje të ndershme dhe kanë të kaluar të gjatë në islam, nga se të tillët vërtet kanë sjellje më të mirë dhe nder të panjëllosur, më së paku janë të prirur pas lakmisë dhe më së miri e kuptojnë rezultatin e dukurive. Furnizoi ata me begati të bujshme, nga se në duart e tyre është i sigurt, si dhe argument kundër tyre nëse e prishin urdhërin tënd apo e tradhëtojnë besimin tënd. Gjithashtu, verifiko punët e tyre dhe cakto njerëz të cilët do të larmërojnë për ta, të cilët do të jenë të sinqertë dhe besnikë, nga se mbikëqyrja e fshehtë e punëve të tyre do t'i nxitë ta zbatojnë amanetin dhe të jenë të kujdesëshëm ndaj vartësve.

- Ki kujdes ndaj ndihmësve nëse ndonjëri prej tyre e shtrinë dorën drejt shpërdorimit, kurse informacionet e raportuesve tu e vërtetojnë këtë, atëherë kënaqu me këtë si argument. Në atë rast kundër tij duhet përdorur ndëshkimin fizik, të dënohet për atë që e ka bërë, ta caktosh në një vend të degraduar, ta turprosh me vulën e turpit dhe t'ia hedhësh qaforen e turpit për kundërvajtjen e tij.

- Mbikëqyr punët e të ardhurave ashtu që ata të cilët merren me këtë të prosperojë, ngase në prosperitetin e tyre qëndron prosperiteti i të gjithëve. Të tjerët nuk mund të prosperojnë pa ata, nga se të gjithë njerëzit varen nga të ardhurat dhe ata të cilët kujdesen për këtë. Kujdesi për përpunimin e tokës le të jetë më i madh se kujdesi për të mbledhur e të hyrave, sepse kjo është e mundur vetëm kur toka është e punuar, kurse çdonjëri që kërkon të ardhura pa përpunim të tokës, shkretëron tokën dhe shkretëron njerëzit. Administrata e tij është jetëshkurtër.

## **SHËRBIMI I TË HYRAVE:**

- Nëse njerëzit, ankohen për sëmurje ose ngarkesë të madhe, tatimin duhet shtyrë për aq sa besimi yt të përparojë pozitën e tyre. Mos të shqetësojë shtyrja që u ke falur për shkak të eliminimit të pasojave prej tyre, nga se ata këtë shtyrje do ta rikthejnë në formë të begatisë së tokës tënde dhe të prosperitetit të shtetit tënd, krahas fitimit të mirënjohjes së tyre dhe kënaqësisë tënde që atyre u ke ofruar begatinë e drejtësisë. Mund të mbështetesh në forcën e tyre nga se ke depozituar për shkak të lehtësimeve të tyre dhe mund ta bazosh besimin në ta sepse, u kë ndarë drejtësi me atë çka ke qenë bujar. Ndërkaq mund të ngjajë që do të kesh nevojë për ndihmën e tyre, dhe atëherë do ta ofrojnë me gjithë zemër, pasi që mirësia mund të durojë çdo gjë që ia ngarkon. Shkatërrimi i tokës është kushtëzuar me varfërinë e atij që e punon, gjersa administratorët merren me grumbullimin me pak shpresë se do të zgjasë dhe duke mos nxjerrur kurrëfarë dobie nga këshillat.

## **SHËRBIMET PUBLIKE:**

- Dhe pastaj shqyrto konditat e njerëzve të besuar në punët e tyre. Cakto për punët tua më të mirët prej tyre dhe ia beso letrat tua, të cilat përbëjnë politikën tënde dhe fshehtësitë tua, atij prej tyre: i cili ka cilësi më të mira, i cili nuk mburret me famën, në

mënyrë që të mos merr guxim të ngritet kundër teje në tubimet publike. Ai gjithashtu nuk guxon të jetë indiferent në transmetimin e informacioneve për ty nga mëkëmbësit tu dhe dërgimin e përgjigjeve të sakta atyre në emrin tënd në aspektin e rregullave dhe pagesave tua. Ai nuk guxon në të lidhë kurrëfarë marrëveshje të dëmshme në emrin tënd dhe nuk guxon të refuzojë prishjen e çfarëdo marrëveshje kundër teje. Nuk guxon të jetë i painformuar në shtrirjen e pozitës së tij në punë, sepse ai që nuk e din pozitën e vet edhe më pak e kupton pozitën e të tjerëve.

- Pastaj zgjedhja jote mos të bëhet në bazë të të kuptuarit tënd, besimit dhe përshtypjes së mirë, pasi që njerëzit i kapin mendimet e udhëheqësit me hipokrizinë e tyre ose me shërbim të mirë, kurse në këtë, nuk ka asgjë të ngjashme me qëllimirsinin dhe besnikërinë. Më mirë i verifiko në bazë të asaj ç'kanë bërë nën administrimin e njerëzve të ndërshëm para teje. Vendos në favor të atij i cili është në zë të mirë ndër njerëz të zakonshëm dhe i cili është më i sigurti në besnikërinë, meqë ky do të jetë argument i konsideratës tënde ndaj Zotit dhe ndaj atij në emër të cilit je caktuar në këtë pozitë.

- Cakto epror midis tyre për çdo seksion të punëve tua. Ai nuk guxon të hutojë. Sa herë që të çfaqet ndonjë e metë te nëpunësit tu, të cilën nuk e ke vënë re, ti do të jesh përgjegjës për këtë.

## **TREGTARËT DHE AFARISTËT:**

- Kurse tani! Prano këshillën mbi tregëtarët dhe afaristët. Jepu këshillë të mirë qofshin vendës, tregtarë, ose argatë, nga se ata janë burim i fitimit dhe mënyrë e sigurimit të prodhimeve të dobishme. Ata i sjellin nga vise të largëta dhe ta hapura anë e kënd vendit dhe detrave, ultësirave dhe maleve, prej nga njerëzit nuk mund të arrijnë dhe ku nuk vendosin të shkojnë, ngase ata janë të qetë dhe nuk ka frikë nga rebelimi i tyre, dhe nuk ka kurrëfarë frike nga tradhëtia e tyre.

- Kontrolllo punët e tyre para teje dhe kudo në vendin tënd. Pos kësaj, dije se shumë prej tyre janë tejet zemërgushtë dhe tepër dorështrënguar, se grumbullojnë pasuri në mënyrë të pandershme, si dhe se caktojnë çmime të larta të mallit në shitje. Ky është burim i ligësisë për njerëz të zakonshëm, por turp për nëpunësit e administratës. Prandaj, pengo fshehjen e mallit nga tregu gjersa nuk shtrejttohet, sepse Pejgamberi i All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!-e ka ndaluar këtë. Shitja le të jetë pa penguar, me çmime dhe matje të sakta, ashtu që të mos dëmtojë asnjë palë, shitësit ose blerësit. Çdonjëri që fshehë mallin gjersa nuk shtrejttohet, pasi të kesh ndaluar këtë, ndëshkoje si shembull, por mos e tepro.

## **POPULLI:**

- Bëhu i vetëdijshëm për All-llahun dhe sërish-bëhu i vetëdijshëm ndaj Zotit në planin e shtresës më të ulët të cilën e përbëjnë skamnorët, nevojtaret, të varëferit dhe të pafuqishmit, ngase në këtë shtresë bëjnë pjesë edhe lypësit dhe të pakënaqurit. Mbroje ne emër të Zotit të drejtën të cilën Ai ua ka caktuar atyre ndërsa ty ta ka bërë obligim që ta mbrosh. Cakto për ta një pjesë nga rezervat publike dhe një pjesë nga të mbjellat në toka i marrur në çdo krahinë si dobi për islamin, sepse në këtë më të largët kanë hise të njejtë si edhe më të afërmit. Të gjithë ata janë për të drejtat e të cilëve je obliguar. Prandaj jeta luksoze kurrësesi mos të largojë prej tyre. Nuk mund të arsyetohet

mospërfillja e gjërave të vogla ndaj tyre dhe mos ua kthe shpinën atyre nga mendjelartësia.

- Kujdesu për gjendjen e tyre nga ata të cilët nuk të bashkëngjiten ngase kanë pamje shëndetligë, ose atyre të cilët nga njerëzit konsiderohen të neveritshëm. Cakto për ta njerëz të besueshëm të cilët janë të ndruajtur dhe të bindur. Le të informojnë mbi konditat e tyre. Dhe pastaj vepra me ta pa ndjenjë të përgjegjësive para Zotit në Ditën kur do ta takosh, nga se nga të gjithë besimtarët këta njerëz më së shumti meritojnë trajtim të drejtë, gjersa edhe për të tjerët duhet t'i përmbushësh të drejtat e tyre, pasi që do të japësh llogari para Zotit. Kujdesu për jetimet dhe të moshuarit të cilët nuk kanë mjete për jetë, kurse nuk janë të gatshëm të kërkojnë lëmoshë. Kjo është detyrë e rëndësishme e nëpunësit të administratës. Në realitet çdo e drejtë është obligim i rëndë. All-llahu ua lehtëson njerëzve të cilët kërkojnë botë tjetër, prandaj kanë durim dhe besojnë në vërtetësinë e premtimit të cilin ua ka dhënë All-llahu.

- Dhe cakto një kohë për ata që kanë ankesa, kur do të jesh i lirë për ta, dhe rri me ta në tubim publik dhe ndieje veten të përlulur gjatë kësaj për hirë të Zotit i Cili të ka krijuar. Duhet t'i largosh prej tyre ushtarët dhe ndihmësit tu, siç janë rojet dhe kujdestarët, ashtu që çdonjëri që dëshiron të bisedojë mund ta bëjë këtë pa frikë, sepse e kam dëgjuar Pejgamberin e All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!-duke deklaruar shumë herë: » Bashkësia, në të cilën nuk është e mbrojtur pa frikë e drejta e të dobët nga i forti, kurrë nuk do ta arrijë pastërtinë ». Duro ngathtësinë e tyre dhe paafësinë e të shprehurit, largo prej vetes ngushtësinë dhe krenarinë. All-llahu për këtë do të mbulojë me bekimin e Tij dhe do të shpërblejë për bindjen tënde ndaj Tij. Çdo gjë që ep-ep me kënaqësi. Ndërkaq, kur të refuzosh, këtë bëre me njerëzi dhe duke kërkuar falje.

- Nga punët tua, madje ka edhe të tillë që nuk mund të mos i kryesh vetë, siç është të përgjigjurit nëpunësve tu kur këtë nuk janë në gjendje ta bëjnë sekretarët tu, ose zgjidhjet e ankesave të njerëzve kur u bëjnë bisht ndihmësit tu.

- Kryeje çdo ditë punën e planifikuar për atë ditë, sepse çdo ditë ka punën e vet. Ruaje pjesën më të madhe dhe më të mirë të kësaj kohe për vete, për t'iu lutur Zotit, edhe pse tërë kjo është në emër të All-llahut, nëse qëllimi është i mirë dhe nëse shtetasit nga kjo prosperojnë.

- Kryerja e atyre obligimeve të Zotit, të cilat i përkasin vetëm Atij, le të jetë ajo veçanti me të cilën besimin tënd te Zoti e bën të pastër. Prandaj dhuroja Zotit një pjesë të trupit tënd gjatë natës dhe ditës. Dhe çkado që kryen nga kjo duke kërkuar afrim te Zoti, duhet të jetë e tërsishme, pa të meta ose gabim, pa marrë parasysh çfarë mudi fizik do të kërkojë. Kur njerëzve u prinë në namaz, mos u bën si ai i cili refuzon, as si ai i cili shkatërron, sepse midis njerëzve ka të dobët dhe nevojtarë. Kur Pejgamberi i All-llahut-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijët!-më dërgoi në Jemen, e pyeta lidhur me atë se si duhet t'ua fali namazin atyre, kurse ai u përgjigj: » Falu me ta ashtu siç do të falej më i dobëti prej tyre dhe kthehu i mëshirshëm ndaj besimtarëve!

- Dhe tani! Kurrësesi mos u largo për një kohë të gjatë nga shtetasit tu, sepse largimi i bartësit të pushtetit nga shtetasit është një lloj i ngushtësisë dhe sjell panjohuri lidhur me hallet e tyre. Largimi prej tyre i privon nga të njohurit e asaj për çka nuk janë të informuar. Prandaj fillojnë ta konsiderojnë të madhen të vogël dhe të voglën të madhe, të bukurën të shëmtuar dhe të shëmtuarën të bukur, kështu që ngatërrohet e vërteta dhe gënjeshtër. Tekefundit, sundimtari është megjithatë vetëm njeri, andaj mund të dijë çka fshehin njerëzit prej tij.



## **MBI SJELLJET DHE VEPRIMET E SUNDIMTARIT:**

- Nuk ka shenjë të madhe në pamjen e së vërtetës që të mund të dallohen deklaratat e ndryshme të saj nga gënjeshttrat. Madje, mund të jesh nga dy llojet e njerëzve. Ose mund të jesh zemërgjërë në dhënjen e të drejtave-e përse kjo fshehje edhe përkundër kryerjes së obligimeve dhe veprave të mira që i kryen!-ose je në sprovë me refuzim, dhe njerëzit shpejt do të pushojnë të kërkojnë nga ti, sepse do të humbin shpresën në veprimin bujar tëndin! Krahas gjithë kësaj, ekzistojnë shumë nevoja njerëzish ndaj teje të cilat nuk paraqesin kurrëfarë vështirësie në raportin e tyre ndaj ty, siç janë ankesat kundër shtypjes ose kërkesa për drejtësi lidhur me ndonjë çështje.

- Më tutje, administruesi ka të zgjedhurit e tij dhe njerëzit besnikë. Ndër ta ka të tillë të cilët këtë e keqpërdorin, që janë arogantë dhe të padrejtë në veprime. Zhduk rrënjën e këtij të keqi me eliminimin e shkaqeve të këtyre veseve. Mos i cakti kurrësesi pronë si shpërblim asnjërit prej ithtarëve ose adhuruesëve tu. Ata nuk guxojnë nga ti të presin pronësi mbi tokën e cila mund t' u bëjë dëm njerëzve që kufizohen me këto toka në ujitje ose punët e përbashkëta bërren e të cilave të shpërblyerit ia hedhin të tjerëve. Në këtë mënyrë dobia do të jetë e tyre më parë se e jotja, ndërsa përgjegjësia e jotja edhe në këtë edhe në botën tjetër.

- Respekto të drejtat e çdonjërit që i përkasin, qoftë i afërt ose i largët. Në këtë trego durim dhe bëhu i kujdesëshëm edhe nëse kjo e përfshinë farefisën dhe të afërmit tu, dhe kërko shpërblim për atë që e ke vështirë, meqë shpërblimi për këtë është i madh.

- Nëse vartësit të akuzojnë, për arogancë, sqarju qëndrimin tënd haptas dhe elimino çdo dyshim të tyre me sqarimin tënd, sepse kjo nënkupton ushtrim për shpirtin tënd dhe mirësi për shtetasit tu, gjersa sqarimi i tillë do të mbrojë qëllimin tënd që t' i mbash fort në të Vërtetën.

- Kurrësesi mos e braktisë ujdinë të cilin ia ofron armikut, në të cilën ekziston kënaqësia e Zotit, meqë armëpushimi është vërtetë pushim për ushtrinë tënde, lehtësim i problemeve për ty dhe siguri për vendin tënd. Por qëndro gjer në fund i matur ndaj armikut tënd, pas armpushimit me te, meqë armiku shpesh ofron armëpushim për ta shfrytëzuar neglijencën tuaj. Prandaj bëhu i vendosur dhe mos vepro në këtë çështje sipas dëshirës. Nëse lidhë marrëveshje midis teje dhe armikut apo ia jep fjalën, atëherë zbatoje marrëveshjen dhe mbaje me sinqeritet fjalën tënde. Bëhu si mburojë ndaj çdonjërit të cilit ia ke dhënë fjalën, meqë ndër obligimet e Zotit nuk ekziston asgjë në çka njerëzit janë më ta bashkuar, edhe përkundër mospajtimit në idetë e tyre dhe dallimit në të menduarit e vet, siç është respektimi i përmbushjes së betimit. Pas muslimanëve madje edhe shërbyesit e idhujve mbajnë marrëveshjen reciproke, sepse i kuptojnë pasojat e prishjes së saj. Prandaj kurrësesi mos e tradhëto ate të cilit ia ke dhënë fjalën dhe mos e prish marrëveshjen me te, dhe mos e mashtro as armikun tënd, sepse askush nuk e kundërshton Zotin pos xhahilëve të ndyrë. All-llahu është marrëveshje dhe garancën e Tij e ka bërë simbol të sigurisë, të cilën Ai e ka lëshuar mbi robët e Tij për ata që kërkojnë dobi nga afria e Tij. Prandaj, në këtë gjë nuk guxon të ketë mashtrim, dinakëri ose hipokrizi.

- Mos harto marrëveshje në të cilën do të lejosh dobësi dhe mos e ndrysho kuptimin e fjalëve të shumëkuptimëshme pas lidhjes dhe verifikimit të saj. Barra e asaj për çka je i obliguar ta respektosh marrëveshjen e Zotit nuk duhet kurrësesi të nxitë ta kërkojë mohimin e paarsyeshëm të marrëveshjes, meqë të duruarit e vuajtjes, përmes të cilës prej çlirimit dhe rezultatit të mirë, është më i mirë se prishja nga pasoja e së cilës i

frikohesh dhe shqetësohesh se All-llahu do të ftojë të japësh llogari për të cilën nuk ka arsyetim as në këtë, as në botën tjetër.

- Ruaju nga vrasjet dhe gjakderdhjet pa arsyetim, meqë asgjë nuk e shton dënimin e Zotit dhe nuk është më i madh për nga pasojat dhe më i fuqishëm për zhdukjen e mirësive dhe shkurtimit të afatit, siç është gjakderdhja e pajustificueshme. All-llahu i Madhëruar në Ditën e Gjykimit marrjen në pyetje të njerëzve do të fillojë me rastet e gjakderdhjes q

- mos lejo kurrë që arroganca e pushtetit të nd të pengojë në të dhënit e të drejtave familjes së të vrarit.

- Ruaju nga vetëkënaqësia dh besimi në atë që të duket e mirë. Ruaju nga dëshira për lëvdim të tepruar, meqë kjo është rasti më i sigurt për shejtanin që të zhdukë veprat e mira, të njerëzve të devotshëm. Ruaju nga qortimi i shtetasëve për mirësinë tënde, shtimin e veprave tua, ose t'u premtosh e pastaj ta prishësh premtimin, ngase qortimi e zhdukë mirësinë, vetëlavdimi shuan dritën e së vërtetës, kurse prishja e premtimit shkakton urrejtjen e Zotit dhe njerëzve. All-llahu i Lartmadhëruar thotë:

« Sa mëni e ka All-llahu kur deklaroni atë që nuk e përmbushni?! (Kur'an 61:3) »

- Ruaju nga nxitimi në çështjet para kohës së tyre, ngathësisë në kohën e përshtatshme të tyre, vendosmërisë në to kur përshtatshmëria e veprimit nuk është e qartë dhe dobësisë kur ajo bëhet evidente. Vendos çdo gjë në vednin e vet dhe çdo punë kryeje në kohën e vet. Ruaju nga përvetësimi i asaj në çka njerëzit kanë hise të barabartë dhe ruaju nga indiferenca në çështjet të cilat do ta dalin sheshit me pretekst se ti je përgjegjës për të tjerët. Së shpejti do të hiqen mbulesat e gjërave dhe nag ti do të kërkohet t'i paguash kompenzim atij të cilit i është bërë dëm. Përmbaje zemërimin tënd, hidhërimin, forcën e muskujve tu dhe mprehtësinë e gjuhës tënde.

- E ke për detyrë të kujtosh atë që të ka parapri, qoftë ajo administratë e drejtë, rrëfim i bukur ose shembull i Pejgamberit tonë-Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi të tijt!-ose dispozitë nga Libri i Zotit. Prandaj, bazohu në atë që na ke parë neve duke bërë dhe përpiqu ta pasosh atë që të kam urdhëruar në këtë porosi, duke shterruar argumentin tim kundër ty, ashtu që i nuk ke pretekst kur shpirti yt të sulet drejt pasionit tënd.

- I lutem All-llahut me rrahmetin dhe mëshirën e Tij me madhështinë e pushtetit të Tij për dhënjen e aftësisë së mirë, me të cilën Ai mund të më nxitë edhe mua edhe ty të paraqesim arsyetim të qartë para Tij dhe krijesave të Tij në mënyrën me të cilën të joshet kënaqësia e Tij bashkë me mirënjohjen e mirë ndër njerëz, rezultat të mirë në pasuri, shtimin e begatisë dhe ngritjen e famës, si dhe që Ai, më në fund, t'na mundësojë të vdesim me vdekje të virtytshme dhe dëshminë e së Vërtetës me jetrat tona.

« Te ai vërtetë do të kthehem! » (El-Bekaretu, 156)

- Selam Pejgamberit të All-llahut!

- Selami i All-llahut qofshin mbi te dhe mbi pasardhësit e apstër dhe të ndershëm të tij! Edhe shumë selame!

- Selam ' (153)

- Letra e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s dërguar Harith El-Hamdaniut:

- « Mbahu për litarin e Kur'anit dhe kërkoni nga ai udhëzim. Konsidero të ligjshmen e tij të ligjshme dhe paligjshmen e tij të paligjshme. Dëshmo të vërtetën e cila ka qenë në të kaluarën. Merr mësim nga e kaluara për hir të asaj që akoma ka mbetur në

këtë botë. Meqë vërtet një ndërrim i saj i gjason tjetrit dhe fundi i saj do ta arrijë fillimin e saj, tërësia e saj duhet të ndryshojë dhe të zhduket. Madhëro emrin e All-llahut duke e përmendur vetmë për të vërteta. Kujto shpesh vdekjen dhe atë çka është pas vdekjes.

Kurrë mos e dëshiro vdekjen, pos në kondita dinjitoze.

- Ki kujdes ndaj çdo veprë të cilën autori i saj e don vetëm për vete, dhe nuk e don për muslimanët në tërësi. Ruaju nga çdo vepër e kryer fshehurazi, e nga cila turpërohesh publikisht.

- Gjithashtu, ruaju nga çdo vepër të cilët kryësi i saj, kur të pyetet për këtë e gjykon ose kërkon ndjesë për të. Mos u bën nderin tënd shënjestër për fjalët e njerëzve. Mos ua transmeto njerëzve të gjitha ato që i dëgjon, sepse kjo arrinë gjer në gënjeshtëri. Mos moho çdo gjë që rrëfejnë njerëzit sepse kjo do të thotë padituri. Përmbaje zemërimin dhe fal njerëzit kur je në pozitë të dënosh. Trego durim në çastin e zemërimit dhe fal kur je në pushtet. Rezultati i fundit do të jetë në dobinë tënde. Kërko mirësi në çdo begati që të ka dhënë All-llahu dhe mos zhduk asnjë nga bekimet e All-llahut ndaj teje. Të shikohet gjurma e asaj që All-llahu të ka dhënë si begati.

- Dije se besimtari më i mirë është ai i cili ka shkuar më së largu në të shpenzuarit nga ajo, familja e tij dhe pasuria e tij. Ngase, çdo gjë të mirë që dërgon para veti-ajo do të mbetet për ty në rezervë, kurse fitimin e tërë asaj që e len pas veti-do ta shfrytëzojnë të tjerët. Largoju shoqërimin me ate të menduarit e të cilit është i pasigurt, kurse vepra e tij e papëlqyer, pasi që njeriu e gjykojnë në bazë të shokëve të tij. Jeto në qytete të mëdha, sepse ato janë vende të tubimit të madh të muslimanëve. Largohu nga vendet e neglizhencës dhe smirës dhe vendet ku ke pak ndihmëtarë në të përkushtuarit ndaj All-llahut. Përkufizo të përsiaturit tënd në atë që të intereson. Ruaju nga qëndrimi në treg, ngase ata janë vendqëndrim i shejtanit dhe qarqe të ngatërimit. Shumë shpesh merr parasysh ate mbi të cilin ke pushtet, meqë kjo është një nga portat e mirënjohjes.

- Mos u nis në rrugë të premtëve, gjersa nuk e kryen faljen e përbashkët, (namazin e xhumasë, vërejt e përkth) pos kur shkon në rrugë të All-llahut ose me punë për çka ka arsytim. Përkujto All-llahun në të gjitha punët tua, sepse të përkushtuarit ndaj All-llahut ka përparësi mbi çdo gjë tjetër. Me shkathtësi binde zemrën tënde për t'i shërbyer All-llahut; bëhu mëshirplot dhe mos detyro me dhunë. Aktivizoje kuririn së koti dhe kur është në dëfrim, pos kur janë në pyetje detyrat që janë urdhër, pasi që ato nuk guxojnë të lihen anash dhe duhet të kryhen në kohën e caktuar. Ruaju që vdekja mos të të gjejë gjersa je larguar nga All-llahu yt duke kërkuar këtë botë. Ruaju nga shoqërimi me veskënjtë, sepse vesi lidh me ves. Kërko Zotin të madh dhe respekto miqët e Tij. Ruaju nga mllefë ngase është një ushtri e fortë e Iblisit.

- Selam. » (154)

- Emirul-Muëminini Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s para vdekjes tha:

- O njerëz, të gjithë duhet ta takojnë atë (vdekjen, vërejt e përkth) nga e cila dëshirojnë të shpëtojnë. Vdekja është vend drejt të cilit shkon jeta. Të ikësh nga vdekja do të thotë ta arrish atë! Sa shumë ditë i kam kaluar duke zgjidhur enigmën e kësaj fshehtësie?! Mirëpo, All-llahu nuk ma lejoi zbulimin e saj. Madje larg nga kjo! Ajo është dituri e fshehur. Sa i përket amanetit tim?! Ja ku po ua them: All-llahu-mos i përshkrini shok Atij; dhe Muhammedi-Selami i All-llahut qoftë mbi te dhe mbi familjen e tij!-mos e leni pas dore Ehli Bejtin e tij! Kultivoni këto dy shtylla dhe ndezni këto dy kandila gjersa nuk jeni shkëputur nga ata, nuk do t'u gjejë kurrëfarë e keqe. Çdonjëri prej jush le të barti barrën e vet dhe të mos e pikëllojnë injorantët. Kujdestari është më i mëshirshëm! Besimi është i tërësishëm! Imami është i gjithdijshëm! Dje kam

qenë me ju, sot për ju jam mësim, kurse nesër do të ndahemi. All-llahu na faltë edhe mua edhe juve!

- Nëse këmba mbetet stabile në këtë vend të rrëshqitshëm, është mirë. Mirëpo, nëse ajo rrëshqet kjo bëhet për arsye se jemi në hije të degëve përball erës nën kupën e reve, shtresat e të cilave shpërndahen në qiell dhe gjurmët e të cilave treten në tokë. Kam qenë fqinj i juaji. Trupi im ka qenë me ju në kohë të caktuar, kurse së shpejti do ta gjeni të zbrazët; ai do të qetësohet pas lëvizjeve dhe do të pushojë së foluri pasi ka folur. Le tu shërbej ë si mësim qetësia ime, edhe mbyllja e syve të mi, edhe palëvizshmëria ime. Kjo për ata të cilët mësimin e marrin seriozisht u ofron mësim më të mirë seç u ofron biseda kuptimplote dhe fjala e zëshme. Po ju braktisi si ai i cili gjakon për t'u takuar. Nesër do të shikoni në të kaluarën time dhe do të zbuloni brendinë time. Dhe do të më njihni, pasi që vendi im të jetë i zbrazët dhe pasi të vijë një tjetër në vendin tim.» (155)

- Kumejl ibn Zijadi transmeton:» Emirul-Muëminini-Ali ibn Ebu Talibi a.s më morri për dore dhe më çoi tek varrezat. Kur kaluam praën varreve dhe e lam qytetin pas nesh, ai (Imam Aliu a.s, vërejt e përkth) psherëtiu thellë dhe më tha:» O Kumejl, zemrat vërtetë janë të gdhendura. Më e mira prej tyre është ajo që më së miri ruhet. Prandaj, ruaje këtë që po ta them.

- Ka tri lloje njerëzish: dijetari që e njeh Zotin, kërkuesi i diturisë që është në rrugë të shpëtimit dhe njeriu i thjeshtë i cili rrieshtohet ndaj çdo thirësi, i cili kthehet kah fryn era e çdokjt dhe nuk dëshiron që të ndriçohet me dritën e diturisë, e as që kërkon mbështetje në atë që është i udhëzuar.

- O Kumejl, dituria është më e mirë se pasuria. Dituria të mbron ty, kurse pasurinë duhet ta mbrosh ti. Pasuria duke u harxhuar zvoglohet. Kurse dituria shumëzohet duke u shpërndarë . Dhe efekti i pasurisë humbet atëherë kur pasuria shterohet.

- O Kumejl, esenca e diturisë është besimi me anë të së cilit punohet. Nëpërmjet kësaj njeriu fiton modesti gjatë jetës së vet dhe zë të mirë pas vdekjes. Dituria është udhëheqëse kurse pasuria është ajo me të cilën udhëhiqet.

- O Kumejl, ata të cilët grumbullojnë pasuri kanë vdekur, madje edhe qofshin gjallë, kurse ata që janë të shpërblyer me diturinë do të jenë të gjallë sa të ekzistojë koha. Trupat e tyre vërtet janë zhdukur, mirëpo fotografitë e tyre jetojnë në zemrat e njerëzve. Shiko! Këtu gjendet bollkëu (thesari) i diturisë; Dhe Emirul-Muëminini tregoi gjoksin e tij. Dëshiroj ta gjejë dikë që ta merr. A të kërkojë dikë që kupton shpejt, por në të cilin nuk mund të mbështetesh, i cili e përdor fenë si mjet për këtë botë dhe me anë të begatitë të Zotit dëshiron ta vëjë pushtetin e tij ndaj robërve të All-llahut dhe me anë të argumenteve të All-llahut të sundojë mbi miqët e All-llahut?! Apo atë që është i dëgjueshëm ndaj bartësve të së Vërtetës, por ama nuk e ka aftësinë e të kuptuarit në gjoksin e tij, dhe pas argumenteve të para dyshuese pranon paragjykimet e këqija në zemrën e vet?! As njërin, as tjetrin, dije mirë! Apo atë që jipet pas kënaqësive dhe lehtë zhytet në epshe?! Apo atë që është mendjemadh në grumbullimin dhe ruajtjen e pasurisë?! Këto të dy në asnjëfarë mënyre nuk bëjnë pjesë në mbrojtës të fesë! Shembull i përafërt i këtyre të dyve është begatia e shfrenuar.

- Ja! Kështu vdes dituria me vdekjen e bartësit të saj!

- Po, All-llahu im! Por bota kurrë nuk mbetet pa atë që qëndron ndaj All-llahut me argumente, qoftë haptazi-me shfaqjen publike të tij, apo qoftë me frikë, fshehurazi, me qëllim që argumentet dhe shenjat e All-llahut të mos atakohen a shtrembërohen. Sa ka të tillë dhe ku gjenden?! Për All-llahu ata janë të paktë në numër, por ata-para All-llahut jashtëzakonisht janë të çmuar. Nëpërmjet tyre All-llahu i ruan

argumentet e Tij dhe shenjat e qarta-gjersa ata nuk ua besojnë këtë të tjerëve sikur vetvetja dhe nuk e mbjellin farën e tyre në zemrat e ngjashme me të tyret. Dituria i shpie në të kuptuarit e afërt, kështuqë lidhen me të Madhëruarin nëpërmjet shuntisë së besnikërisë. Ata e konsiderojnë për të lehtë atë që në të vërtetë është e rëndë. Atyre u është e dashur ajo që injorantët e konsiderojnë të çuditshme. Ata shoqërohen me këtë botë vetëm me trupat e tyre, kurse shpirtërat i kanë të lidhur në vendet e lartësuar. Ata janë mëkëmbës të All-llahut në tokën e Tij dhe ftuesit në fenë e Tij.

- Ah! Ah! Sa dëshiroj e përmallohem që t'i shoh!
- Largohu o Kumejl, nëse dëshiron. »
- Selami dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi mësuesin tonë Muhammedin-vulën e pejgamberëve, i cili na udhëheq drejt rrugës më të mirë; dhe mbi Familjen e tij-kandilat e udhëzimit dhe anijet e shpëtimit, si dhe mbi as-habët e tij të ndershëm-yeje të besimit të fortë!

## SHËNIME :

1. El-Tahir El-Kebir 14:321, Hatibi Bagdadi
  - Faraid El-Samtajn 1:kapitulli 3, El-Hamvini Esh-Shafi
2. Nehxhul-Belaga; fjalimi 192, komentuar nga Dr. Subhi Es-Salih;
3. Hasais (veçoritë) e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s, botim i Ensai Ansab El-Ashraf 2:98, Balazri;
4. Ansab El-Ashraf 2:48, Balazri;
5. Ansab El-Ashraf 2:65, ky hadith është transmetuar nga Ahmed ibn Hanbeli në « Musnedin » e tij si dhe nga Muhibuddin Taberiu;
6. Ebu Nuajmi në veprën e tij « Hiljetul-Evlja »,
  - Dejlemi në « Firdeusin » e tij;
  - Hamavini në « Feraidin » e tij;
7. Tarih El-Hulefa 1:96, Xhelaluddin Es-Sujuti; (këtë hadith e transmeton ibn Asake në veprën e tij « Tarihu Dimeshk » nga hazreti Ebu Bekri, hazreti Osmani, dhe hazreti Ajshja;
  - Kerbela 6,7; El-A'lami;
8. Këtë hadith e transmetojnë Ahmed ibn Hanbeli dhe Tirmidhiu në veprën « Xhamiu Es-Sahih »
  9. Xhelaluddin Es-Sujuti në « Tarihun » e Tij;
    - Ibn Asakiri në veprën « Tarihul-Kebir »;
    - Harith El-Hanejfi në « manakibin » e tij: 12;
  10. Er-Rijad En-Nadira 2:198;
    - El-Kanxhi Es-Safijji në « Kifajetin » e tij;
    - El-Fusul El-muhimme, ibn Sabig El-Maleki,
    - Ansab El-Ashraf, Balazri;
    - Mekam (vendi) i Imam Aliut a.s: 32, El-A'lami;
  11. Tarihul-Kebir 4:321, Hatibi Bagdadi
    - Ibn Kutejbe në « Sijasetin » e tij;
  - El-Zemahsheriu në veprën e tij »Rab'i El-Ebrar »,
    - El-Hamavini në veprën e tij »Faraid Es-Sumtajn »,
  12. El-Kanxhi Esh-Shafi në « Kifajetin » e tij,
    - El-Hafizi, në veprën e tij « Amali El-Hafidh »,
    - Aliu a.s dhe këshilla:167, Nemxhuddin El-Askeri;
  13. Kanz El-Umal 6:156,
    - Rijad El-Nadira 2:226; (këtë hadith e transmeton Abdullahu biri i biri i Omer ibn Hattabit, gjendet në veprën « Mekam » (pozita) e Imam Ali ibn Ebu Talibit a.s:15; El-A'lamiu;
  14. Bejdeviu në « Tefsirin » e tij,

- Tubrusi në « Mexhbul-Bej'anin » e tij,
- Ebu Is'haku El-Salebi në « Tefsirin » e tij,
- Taberiu në « Tefsirin » e tij,
- El-Vahidi në veprën e tij « Asbabun-Nuzuli »,
- Ebu Barakati El-Nisafiu në « Tefsirin » e tij,
- Nisaburi në « Tefsirin » e tij,
- 15. Musned Ahmed ibn Hanbel 4:281,
- « Sahih » ibn Maxhe :12, Ibn Maxhe
- 16. Mustadrek në dy Sahihët 3:116,
  - « Hiljetul-Evlja » 5:26, Ebu Nuajmi,
  - Tarih Bagdadi 7:377, Hatibi Bagdadi transmeton nga Ebu Hurejra,
  - Kenz El-Umal 1:48, dijetari Mutaki El-Hindi,
  - Khadir-dijetari Abdul-Husejn Sherafuddin,
- 17. Muvafaku biri i Ahmed El-Hanefit në « Manakibin » e tij,
  - El-Hamavini Esh-Shafi në « Faraidin » e tij,
  - Ahmed ibn Hanbeli në « Musnedin » e tij,
  - El-Salabiu në veprën e tij « El-kashif ve Bejan »,
- Aliu dhe Vasi (këshilla): 235;
- 18. Kitab El-Ghadir, Abdul-Husejn El-Emini,
  - Dalail El-Sedek, Muhammed hasan El-Muzafer,
  - Ihkak El-Hak, kreu El-Tastari,
  - Akabat El-Envar, Mir Hamid Husejn,
  - El-Muraxhat, Abdul-Husejn Sherafuddin;
- 19. El-Muraxhat :170; Abdul-Husejni transmeton nga Tereriju dhe Bejhekiu se Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s ka thënë se Imam Aliu është faruk i këtij ummetit.
  - Kanz El-Umal, Mutaki El-Hindi;
- 20. Bihar El-Envar 41:11,12, Mexhlisi,
  - Anvar Alavije :115, botimi i dytë,
  - Manakib (veçoritë) e familjes së Ebu Talibit, Ibn Shahir Eshvab El-Mezindrani,
- 21. Nehxhul-Belaga 4; thënia nr. 104; Ali ibn Ebu Talibit a.s,
- 22. Bihar El-Envar 41:17; Mexhlisijj,
- 23. Ibidem
- 24. Ibidem
- 25. Ibidem
  - Tazketit El-Havas: 144; Sebet ibn El-Xhevzijj
- 26. Nehxhul-Belaga, fjalimi 192, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s
- 27. Manakib i familjes Ebu Talib, Ibn Shahir Eshvab;
- 28. Manakib i familjes Ebu Talib 2:94, njësoj;
- 29. « Ali ve Hukul Insan »-« Aliu dhe të drejtat e njeriut » :75, George Gerdak, Bejrut 1970;
- 30. Bihar El-Envar 40:330; El-Mexhlisi;
- 31. E panjohur « e verdhë dhe e bardhë » neologjizëm i argjendit dhe dhe arit;
- 32. Tedhkirat El-Havas: 117, Sebet ibn El-Xhevzijj
- 33. Tedhkirat El-Havas : 118, njësoj;
- 34. Manakib i familjes së Ebu Talibit 1:366, transmetuar nga « Ihja'u Ulumuddin » të Imam Gazaliut;
- 35. Ibidem
- 36. Bihar El-Envar 41:37; Mexhlisijj;
  - El-Kafi :5, dijetari Kulejni ;
- 37. Bihar El-Envar 41:40, Mexhlisijj;
- 38. Manakib i familjes së Ebu Talibit 2:346, Ibn Shahir Eshvab,
  - Bihar El-Envar 41:43; Mexhlisijj;
- 39. Sherah El-Nahexh (Tefsiri i shtegut) 1:22; Ibn Ebi Hadid;
- 40. Sherah El-Nahexh 1:22; dijetari Ibn Ebi Hadid
- 41. El-Zamehsheriu në tefsirin e tij « El-Keshaf »;
  - El-Vahidi në tefsirin e tij « Esbabun-Nuzul »;

- Ibn Asiri në veprën e tij « Asad El-Gaba »;
  - 42. Tefsiri i Taberiu 10:59; Enes ibn Maliku;
  - Asbabun-Nuzul :182, El-Vahidi;
  - Tefsiri i Raziut, El-Nasifi i Sujutiut;
  - Tefsiri i Kur
- Nehxhul-Belaga, fjalimi 230, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s
- 50. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 130;
  - 51. « Ali ve Hukukul-Insan » (Aliu dhe të drejtat e njeriut) :87; Xherdaki;
  - 52. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 25; Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
  - 53. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 14;
  - 54. Manakib i familjes së Ebu Talibit 1:372, Ibn Shahir Eshvab;
  - 55. Manakib i familjes së Ebu Talibit 1:372; dhe Bihar El-Envar 41:55, Mexhliisij;
  - 56. Sherah « Nehxhul-Belaga » 1:25, Ibn Ebi Hadid;
  - 57. Sherah « Nehxhul-Belaga » 1:22;
  - 58. Bihar El-Envar 41:50, Mexhliisij;
  - 59. Manakib i familjes së Ebu Talibit 1:381, Ibn Shahir Eshvab,
  - 60. Imam Aliu biri i Ebu Talibit :173, Muhammed Rida;
  - 61. Manakib i familjes së Ebu Talibit 1:379, Ibn Shahir Eshvab;
  - 62. Bihar El-Envar 41:206, kapitulli 127, Mexhliisij
  - 63. Tedhkirat El-havas :76;
  - 64. El-Fusul El-Muhimme :61; Ibn Sabig El-Maliki;
  - Sherah « Nehxhul-Belaga » 2:176; Ibn Ebi Hadid;
  - 65. El-Fusul El-Muhimme :62; Ibn Sabig El-Maliki;
  - 66. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 53, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
  - 67. « Nehxhul-Belaga », këshilla 3:27, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
  - 68. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 233, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
  - 69. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 201, Imam Aliu a.s;
  - 70. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 181, Imam Aliu a.s;
  - 71. Sherah « Nehxhul-Belaga », 1:17, Ibn Ebi Hadid, botimi i parë;
  - 72. El-Xhamiu Es-Sahih, Tirmidhiu 5:663;
  - Xhamiu El-Usul 1:278, Ibn Kethir;
  - Assad El-Gaba 2:12, Ibn Kethir;
  - Zahair El-Ugba :16, Imam Taberiu;
  - Tefsirul-Kur'anil-Kerim- El-adhim 4:122;
  - Mustedriku i El-Hakimit 3:109;
  - Nesaiu në Hasaisin e tij mbi Emirul-Muëmininin a.s :69;
  - Ansab El-Eshraf 1:110; Belazriu;
  - Havarizmi në Manakibin e tij :93;
  - Tarihu-Dimeshk 2:36; Ibn Asakiri;
  - Kanz El-Umal 1:187, Mutteki El-Hindi nga Taberani El-Hakimi;
  - 73. Tirmidhiu në Sahihun e tij;
  - Imam Ahmed ibn Hanbeli në Mustadrikun e tij;
  - Hafidh Ebu Muhammed Samarkandi në veprën e tij »Bihar El-Asanid;
  - Ibn Xhurejr në veprën e tij « Tehzib El-Asar »,
  - Arbali në veprën e tij « Kashif El-Gima »,
  - Hafiz Ahmed ibn Muhammed El-Mamari, botimi i vitit 1969;
  - 74. Ebu Nuajmi në veprën e tij »Hiljetul-Evlija »;
  - Dejlemiu në « Firdeusin » e tij;
  - A'lamiu në veprën e tij « Pozita e Emirul-Muëmininit » :7;
  - 75. Është transmetuar nga Havarizëm ibn Magazili ibn Sharih Eshvabi në veprën « Manakib i familjes së Ebu Talibit » 2:30;
  - 76. Bihar El-Envar :40, kapitulli 93, Mexhliisij;
  - manakib i familjes së Ebu Talibit, Sharih Eshvab;
  - 77. Ibid.
  - 78. Ibid.

79. Bihar El-Envar :40; kapitulli 95, Mexhlsisijj
80. Bihar El-Envar : 40; kapitulli 93, Mexhlsisijj
81. Bihar El-Envar : 40; kapitulli 93, Mexhlsisijj
- El-Ershad: 191, dijetari Mufidi;
- 82. A'jan El-Shiat 3:63;
- Sahihu i Muslimit: 6;
- Hiljetul-Evlja; Ebu Nuajmi;
83. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 181, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
- « Nehxhul-Belaga », fjalimi 84;
84. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 1;
85. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 143;
86. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 146;
87. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 125;
88. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 2;
89. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 143;
90. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 151;
91. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 86;
92. Muraxhat, kapitulli 110:326; Sejjid Abdul-Husejn Sherafuddini, Bejrut;
93. Manakib i familjes së Ebu Talibit 2:41;
94. Usul-El-Kafi I, Kulejni Er-Razi;
95. Akidetush-Shi'a :65, Husejn Jusuf Meki El-Amilij;
96. A'jan Esh-Shiatu :3, kapitulli 2 (veprat e Imam Aliut a.s)
97. A'jan Esh-Shiatu 3:274, Sejjid Muhsin El-Amini, botimi i tretë, Bejrut;
99. « Nehxhul-Belaga » fjalimi 76, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
98. Sharih « Nehxhul-Belaga », fjalimi 2:286, Ibn Ebi Hadid;
- Bihar El-Envar 40:130, Mexhlsisijj;
100. Sharih « Nehxhul-Belaga » 2:289-290; Ibn Ebi Hadid;
101. Dirasat fi « Nehxhul-Belaga » :186, Muhammed Mehdi Shemsudin, botuar më 1972;
- Sharih « Nehxhul-Belaga » 2:286, Ibn Ebi Hadidi;
102. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 200, Imam Ali ibn Ebu Talibi a.s;
103. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 202;
104. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 203;
105. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 49;
106. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 64;
107. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 162;
108. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 132;
109. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 151;
110. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 159;
111. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 182;
112. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 185;
113. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 194;
114. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 197;
115. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 210;
116. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 1;
117. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 63;
118. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 93;
119. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 95;
120. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 99;
121. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 143;
122. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 160;
123. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 196;
124. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 201;
125. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 213;
126. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 233;
127. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 2;



128. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 153;
129. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 237;
130. « Nehxhul-Belaga », letra 9;
131. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 119;
132. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 27;
133. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 4;
134. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 190;
135. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 192;
136. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 193;
137. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 98;
138. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 156;
139. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 195;
140. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 202;
141. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 203;
142. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 189;
143. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 219;
144. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 224;
145. « Nehxhul-Belaga », fjalimi 228;
146. « Nehxhul-Belaga », letra 27;
147. « Nehxhul-Belaga », letra 25;
148. « Nehxhul-Belaga », letra 31;
149. « Nehxhul-Belaga », letra 47;
150. « Nehxhul-Belaga », letra 34;
151. « Nehxhul-Belaga », letra 35;
152. « Nehxhul-Belaga », letra 45;
153. « Nehxhul-Belaga », letra 53;
154. « Nehxhul-Belaga », letra 96;
155. « Nehxhul-Belaga », letra 148;
156. « Nehxhul-Belaga », letra 147;

## PASTHËNIE:

- Të vendosësh të shkruash një vepër të këtillë e të gjërë, duhet patur patur përnjëherë edhe guximin dhe diturinë, gjë që siç shihet autorit nuk i ka munguar. Autori Dr. Med. Saade Kanso në mënyrë të qartë përkatësisht konçize ka përmbledhur një detë të tërë botimesh që sjellojnë këtë temë, duke u përpjekur që nëpërmjet shpirtit të tij hulumtues dhe përgjedhës të tubojë-përmbledh për trevën boshnjake-folëse atë më interesanten, më të veçantën-njohjen më për së afërmi me të mëdhenjtë tanë, d.m.th. Pejgamberin tonë të fundit Muhammedin s.a.v.s dhe më pas Ali ibn Ebu Talibin a.s. Meqë Pejgamberi s.a.v.s është veçmë bukur mirë i njohur për besimtarët tanë, ngase për te, lindjen e tij, jetën dhe jetën luftarake të tij si dhe përhapjen e Islamit, mësojmë përkatësisht na rrëfëhet qysh në fëmijërinë e hershme, që në mejtep e më vonë edhe nëpërmjet veprave të shumta mbi Muhammedin s.a.v.s si Pejgamber të fundit të Allahut xh.sh. Nëpër familjet tona emri i Pejgamberit s.a.v.s, vendosmëria e tij, karakteri i tij i fortë, sukseset dhe brengat e tij gjithnjë-prore përmenden nëpërmjet ritregimit të ngjarjeve dhe ndodhive të ndryshme nga jeta e tij-duke potencuar rolin e tij kyç në transmetimin e Shpalljes (Vahjit), përhapjes së Islamit si dhe për luftërat dhe rezistencën që pati dhe u ballafaqua me mushrikët. Këto janë vitet vendimtare për mbarë njerëzimin që iu afruan si dhe rasti i fundit që njerëzimi përmes kuptimit dhe të çmuarit ta pranojë fenë e re Islamit e lartësuar. Gjithë kjo nuk vajti lehtë ndaj edhe vetë jeta e Muhammedit s.a.v.s ishte e tendosur dhe e rëndë gjë që mund ta vërejmë duke shfletuar dhe lexuar edhe në historitë më të shkurtëra të Islamit.

- Pikërisht nisur nga kjo që për Muhammedin s.a.v.s janë botuar në nënqiellin tonë mjaft vepra, kurse nëpërmjet Mevludit edhe fëmijët dhe të rrinjtë e kanë njohur personalitetin e ndritur të Pejgamberit Muhammedit s.a.v.s; Dr.med. Saade Kanso ia kushtoi vetëm pjesën e parë të librit të tij Pejgamberit Muhammedit s.a.v.s ndërsa dy pjesët tjera të librit ia kushtoi njohjes së Ali ibn Ebu Talibit a.s. Në të vërtetë, gjer në vitet e fundit kur në Zagreb u botua « Nehxhul-Belaga », vepra më e madhe-kapitale e Aliut a.s, pak diç gjithë-përfshirëse mund të lexohej për Aliun a.s. Mirëpo, tani përpara nesh gjendet një dyzinë ngjarjesh, thëniesh dhe raportesh përkatësisht qëndrimesh të Aliut a.s. ndaj ndodhive aktuale të kohës së tij, të cilat plotësisht na e pasqyrojnë personalitetin e tij, rolin e tij në çastet e para të shpalljes si dhe vendin e tij në përhapjen e Islamit. Në figurën e Aliut a.s gjithëkund fund e maje njohim njërin ndër kolosët më të mëdhenj të fesë i cili në çdo çastë ishte i gatshëm ta jepë edhe jetën e tij për ngadhënjimin e Islamit. Aliu a.s ishte ai që pa asnjëfarë ngurrimi dhe frike, ashtu qetë pa thënë asnjë fjalë pranoi të flejë në shtëpinë dhe në shtratin e Muhammedit s.a.v.s në natën e komplotit të mushrikëve që kishin për qëllim mbytjen e të Dërguarit të Allahut xh.sh. Duke e lexuar këtë libër mjaft ineteresant do të hasim në një numër bukur të madh të zbatimit të zemërgjesisë së Aliut a.s, si dhe të heroizimit dhe guximit për të cilat tek ne në gjuën boshjake pak ose fare nuk është shkruar. (Fatkeqësisht hiç disa përjashtime, e njëjta gjë mund të thuhet dhe konstatohet edhe tek ne shqiptarët në të gjitha trojet etnike, vërej e përkth). Duke e lexuar librin, sa vijnë e më tepër e njohim Aliun a.s. në të vërtetë ai sa më shumë vjen duke na u bërë i afërt. Vdekja e tij tragjike në Kufe të Irakut, është pjesë e historisë të cilës i janë qasur mjaft studjues, veçanërisht historianët e Irakut.

- Dr.med Saade Kanso për përkthimin dhe shkrimin e këtij libri ka shfrytëzuar edhe një numër të madh shkrimesh të autorëve tanë të njohur boshnjakë, si p.sh Xhemaludin Çausheviqit, Mehmed Hanxhiqit, Osman Nuri Hanxhiqit etj.
- Nga gjithë këto burime ai përzgjodhi atë që për lexuesin tonë është më interesante dhe në këtë mënyrë na ofroi mundësi që gjer tani nuk i kemi patur. Leximi i këtyre teksteve na i zbardhi ngjarjet, njerëzit, rrethanat e asaj kohe, kohën e Pejgamberit të All-llahut xh.sh Muhammedin s.a.v.s. lexuesi mbetet herë-herë i mahnitur me karakterin dhe elanin a pashoq të individëve të ndryshëm të asaj periudhe kohore.
- Këto janë ngjarje që gjithsesi thellë do të ngelin në kujtesën e gjithkujt, e posaçërisht të lexuesit të ri, ngase ata ishin ditët vendimtare për Islamin, muslimanët si dhe zhvillimin e njerëzimit në përgjithësi. Kjo ishte kohë kur u vendosën themelet e forta dhe të paluhatshëm të fesë sonë të lartësuar Islamit, kohë kur fatkeqësisht humbën kokat edhe muslimanët tanë të parë e më të mirë... Gjithë kjo shpui në fitoren përfundimtare dhe bëri që Islami të përhapet me një shpejtësi ta paparë gjer atëherë në mbarë rajonet e njohuratë botës së atëhershme. As vdekja e Ali ibn Ebu Talibit a.s e as ajo e Pejgamberit tonë të fundit Muhammedit s.a.v.s nuk i hamendën e as që i zbrapsën ata që guximshëm vazhduan marrjen e teritoreve të reja të botës nën ombrellën e Islamit.
- Islami u përhap në Afrikën Veriore, u formua një mretëri e posaçme Islame në territorin e Shpanjës së sotme. (fjala është për Andaluzinë, vërejt e përkth). Njëkohësisht dhe me të njëjtin ritëm Islami përhapej edhe në Bizantin e atëhershëm, Siri, Palestinë dhe gjetiu drejt Azisë, Afganistanit, Indisë...
- Dhe qartë e vërtetë shohim se këto ishin vepra dhe aksione të cilat i ndihmoi All-llahu xh.sh ngase bota e atëhershme i priste me mirëseardhje « pushtuesit » dhe Islamin gjë që gjer atëherë një gjë e tillë nuk ishte e njohur në botën e atëhershme-qoftë në shpejtësinë e përhapjes qoftë në atë të dëshirës së fortë, gjë e cila është shënuar me « pushtimet »islame.
- Si ta shpjegojmë këtë? Islami është fe e All-llahut xh.sh-Shpallje e cila është e liruar nga të gjitha përcaktimet e paqarta si dhe ndalesat. Nisur nga kjo muslimanët e rinj e pranonin Islamin si fe plotësisht të qartë dhe të afërt me logjikën e njeriut, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për njeriun e thjeshtë (të paarsimuarin, analfabet) apo për njeriun i cili veçmë kishte fituar dituri e cila ngritej mbi besimet që ishin aktuale në viset ku jetonte.
- Sipas përcaktimeve të Islmait monoteizmi (Njëshmëria e All-llahut-Teuhidi, vërejt e përkth) sihte shpallur në mënyrën më të thjeshtë dhe racionale e cila fare lehtë ishte e qartë dhe e afërt për çdo njeri të arsyeshëm. Formulimi i parë dhe kryesor i Islamit ishte (dhe akoma edhe më tej mbetet, vërejt e përkth) kelimei-shehadeti i cili përmban këtë fjali : »Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, ndërsa Muhammedi është rob i All-llahut dhe i Dërguari i Tij ». Këtë formulim të qartë dhe të vetëm të Islamit e pranonte çdo kush që e dëgjonte. Këtu nuk kishte më asnjë luhatje teologjike e as kurthë, dhe gjithçka që mund të përmbledhej në periudhën e hershme, rra në ujë, doli nga skena e botës, ra vetë nga vetvetja përpara mendimit të qartë dhe të vërtetë të islamit.

*Prof. Edib MUFTIQ*

## **DUAJA E MËNJGJESIT (SABAHUT):**

*Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit!*

- O All-llah! O Ai i Cili e zgjat gjuhën e mëngjesit në të folurit e gdhirjes së saj, dhe zgjidh terin e natës nga erësira, dhe ke përsosur kupën e qiellit duke e stolitur hijshëm, dhe ke lëshuar ndriçimin e diellit nëpërmjet rrezeve të tij shkëlqyese! O Ai i Cili ke treguar Qenien Tënde me anë të Qenies, dhe je i pastër (larg) nga ngjashmëria me krijesat Tua dhe ke tejkaluar madje çdo cilësi të përafërt të tyre me Tënden! O Ai i Cili je afër çdo ndodhie, larg nga të koturit e syve, dhe din se çfarë do të ndodh para se të ndodh! O Ai i Cili më ven në gjumë në djepin e mbrojtjes Tënde dhe bamirësisë, dhe largon prej meje dorën e keqe me anë të dorës Tënde dhe sundimit Tënd! Qoftë bekimi, o All-llah, në argumentin Tënd në natën më të errët, dhe mbi atë që mbahet fort pas lidhjeve me Ty, mbahet pas fisnikërisë së gjatë dhe është fisnik i pastër nga maja e supeve gramit të fortë, dhe ec me hapa të fortë rrugës së vërtetës në kohën e duhur! Gjithashtu edhe mbi prejardhjen e tij, të çmuar, të zgjedhur, të devotshëm! Dhe hap për ne o All-llah, fletët e dyerve të mëngjesit me çelësat e mirësisë dhe përparimit! Dhe më mbështjell o All-llah, me teshat më të mira të udhëzimit dhe pastërtisë! Mbjell, o All-llah pashë Madhërinë Tënde, burim të modestisë në kopshtin e ujit tim! Bëj o All-llah që nga frika prej Teje nga thellësia e syve të mi të rrjedhin lotët e pikëllimit! Drejtoe o All-llah shtegut të drejtë mos gatishmërin time! O All-llahu im! Nëse Mëshira Jote nuk nis me sukses të mirë (bukur), atëherë kush tjetër pos Teje mundet të më çojë drejt Teje nëpërmjet rrugës së qartë? Dhe nëse Mëshira Jote nuk u prin udhëheqjes së dëshirave dhe shpresave të mia, kush do ta anulojë nxitjen e urrejtjes sime? Nëse ndihma Jote më braktis nga beteja kundër shpirtit dhe shejtanit, atëherë zhgënjimi në Ty do të më shpie atje ku mbretërojnë vështirësitë dhe privimet e ndryshme? O Ai e vij drejt teje duke kërkuar mbrojtje dhe strehim nga epshet e tepërta, dhe kapem në gishtërinjtë e dashurisë time për Ty, o Krijuesi im i Vetëm. Ndaj, fali dhe m'i anashkalo o All-llah gjynahet që i kam bërë dhe më ruaj e mbro nga mugullimi i gjendjes sime! Po në të vërtetë, Ti je Zotëriu im, Mbrojtësi im, Vendsterhimi im dhe Shpresa ime! Ti je caku i kërkimit dhe ngutjes sime drejt Teje në këtë dhe në atë botë! O All-llahu im! Si mund ta largosh nevojtarin e varfër i cili tek Ti kërkon strehim nga gjynahet e tij duke ikur? Apo si ta pikëllosh kërkuesin e udhëzimit i cili vjen në pragun Tënd duek vrapuar? Apo si ta refuzosh të etshmin i cili niset përplot shpresë drejt burimit Tënd-për ta shuar etjen? Burimet e tua janë furnizuese të pashtershme të atyre që dëshirojnë ta shuajnë etjen; Dhe dyert e Tuan janë të hapura gjithnjë për kërkuesin dhe atë që e dëshiron faljen. Ti o Zot je caku i të kërkuarit dhe objekt i shpresës! O All-llahu im, ja ku të dorëzohem plotësisht me shpirtin tim; Unë i tëri u jam nënshtruar mëshirës dhe faljes (magfiritit) tënd! Ja, ku po të vij, po të dorëzohem me të gjitha epshet që i flakërrova teje dhe gjithë kështu i tëri të dorëzohem Ty dhe mirësisë e mëshirës Tënde. Ndaj, bëje o All-llah që ky mëngjes të më jetë i ndriçuar me udhëzimin Tënd, më jep sigurinë në fe, në botën tjetër (ahiretin), kurse natën o Zot-bëje mburojë timen prej dinakërisë së dushmanëve dhe fortifikatë ndaj nxitjeve të epshit!

- Vërtet, Ti je i Gjithfuqishëm ndaj asaj që dëshiron. Ti i jep mbretëri atij që don, dhe ia merr mretërinë po atij që don, Tij e ngren atë që dëshiron ta ngresh dhe e ulë atë që dëshiron ta ulësh. Në dorën Tënde është e mira, në të vërtetë. Ti je mbi të gjithë i Gjithëpushtetshëm. Ti e mbështjell natën me ditën ashtu siç e mbështjell ditën me natën, Ti i ngjall të vdekurit ashtu siç i vdes të gjallët dhe e furnizon kë dëshiron pa asnjëfarë kompenzimi. Nuk ka Zot tjetër përveç Teje, Lavdërimi qoftë për Ty o All-llah! Kush

është ai që e ka njohur caktimin Tënd e të të mos frikësohet? Ti ke bashkuar me Fuqinë Tënde, të ndarë, dhe e ke shkëputur me Madhërinë Tënde ndriçimin, dhe e ke zbardhë me Fisnikërinë tënde terrin (errësirën) e natës. Dhe ke bërë që të rrjedhin ujërat nga gurët e fortë, të ëmbla dhe të tharrëta, dhe ke bërë që nga retë e shiut të lëshohet uji i begatshëm (bereketshëm). Dhe i ke krijuar Diellin dhe Hënë si llamba ndriçuese që shndërritin. Asgjë nuk e ke krijuar pa caktim dhe gjithçka ka qëllimin e vet. Ndaj, o Ti që je Një i Vetëm dhe që vetëm Ty të takon lavdërimi dhe madhërimi, Ti që krijove robët e tu të cilët e shijojnë vdekjen dhe i zhduk kur të dëshirosh, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij të devotshme!

- Dhe dëgjo lutjen time, pranoje duanë time, dhe shkatërroi dushmanët e mi! Dhe bëje realitet me Mirësinë Tënde shpresën dhe dëshirën time! O më i Miri prej atyre që largon dëmin dhe Shpresë në çdo vështirësi e mbështetës i Pashoq; unë po të drejtohem Ty për nevojat e mia, ndaj mos më ler pa dhuratat e Tua dhe m'i dyfysho ato! O Bujar! O Bujar! O Bujar! Pasha gjithmëshirën tënde, o Mëshiruesi i më të mëshirshmëve! Dhe qoftë gjithnjë bekimi Jot mbi krijesën Tënde më të mirë Muhammedin dhe gjithë familjen e tij të ndershme! Amin!

## **DUAJA E KUMEJLIT:**

### **PËRMBAJTJA:**

*Bismil-lahirr-rrahmani-rrahim*

*Në emër të All-llahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

### **All-llahume Sali-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed.**

O Zot, Ty të lutem që me mëshirën tënde ke përfshirë gjithë çka ekziston! Dhe, me forcën tënde ke mposhtur çdo send, së cilës i përulet gjithçka dhe me të cilën çdo send e kë vënë në vend të vet. Me fuqinë tënde që ke mposhtur çdo send dhe me madhërinë tënde, me të cilën nuk e arrin dot asgjë, dhe me madhështinë tënde që plotëson gjithçka! Të lutem Ty, që me pushtetin tënd ke vënë në sundim tëra sendet dhe me madhështinë tënde të përjetshme, pas shkatërrimit të çdo sendi, dhe me emrat tu që ke mbushur tëra shprazëtitë, e me dijen tënde që përfshin gjithçka që ekziston dhe me dritën tënde që përfshin gjithçka që ekziston, dhe me dritën tënde që ndriçon gjithçka që ekziston, O dritë e gjithndritshme, o i Pari i të parëve dhe i mbrami i gjithë të mbramëve.

### **M'i fal mëkatet.**

O Zot, m'i fal mëkatet të cilat dënimi Yt mund t'i përfshijë! M'i fal mëkatet që m'i anulojnë dhuntitë, m'i fal mëkatet që më pengojnë nga lutja! O Zot, m'i fal mëkatet që më sjellin fatkeqësi, m'i fal mëkatet që ma këpusin shpresën! O Zot, falmi të gjitha mëkatet që i kam bërë me dije e pa dije! O Zot, Ty të afrohem me lutje e përmendje dhe kërkoj ndihmën tënde, mundësoma me mirësinë tënde të jem afër Teje, të jem mirënjohës Ty dhe të kem dashuri ndaj lutjeve që të drejtohen Ty. O Zot, të lutem me përlutje, të lutem me gjuhën e të përkulurit që të lutet për mëshirë e për falje! Të lutem bëm të kënaqur me fatin tim dhe gjendjen në të cilën ndodhem! O Zot, të lutem i raskapitur dhe të përulur i ngarkuar me dëshirë dhe shpresa që Ti të m'i realizosh. O Zot, e madhe është madhëria Yte, pozita Yte dhe urtia Yte janë të paarritshme, Urdhëri Yt është i qartë, Mbifuqia Yte është prezente dhe asaj nuk mund t'i iket. O Zot, nuk gjej askënd t'i falë mëkatet e mia dhe të veprat e mia të pamira e t'i shndërrojë në të mira. Nuk ka Zot tjetër, përveç Teje! Ty të lartësojë dhe të falënderojë! Kam bërë mëkat ndaj vehtes ngase prej mosdijes e kam lënë ibadetin-të falurit-për çka kam pasur shpërblimin tënd. O Zot, sa e save ua ke falur mëkatet dhe ua ke mbuluar veprat e këqia, i ke shpëtuar, e sa e sa i ke ruajtur nga fatkeqësitë, e shumë mirësi që i ke afruar nuk i kam merituar. O Zot, fatkeqëia ime është e madhe, sepse në të më kë shtyrë gjendja ime e keqe dhe m'i ka kufizuar veprat e mia, më kanë penguar zinxhirët e mi dhe më kanë ndaluar nga veprat e mira. Më ka mashtruar kjo botë me verbësinë e saj, më ka mashtruar shpirti im lakmues. O Zot, Madhërisë tënde i lutem që mos ta refuzojë lutjen time për shkak të veprave të mia të këqia, dhe mos më turpëro me fshehtësinë që Ti e di, mos e shpejtëso dënimin tim për shkak të asaj që kam bërë në vetmi, si edhe për shkak të veprave të mia jo të mira që i kam bërë nga harresa a mosdija, nga epshi apo moskujdesi, dhe Ju i Zot i Madhërueshëm, bëhu i mëshirshëm ndaj meje! O Zot, cilin kam për të lutur unë përveç Teje, të më zbulojë atë që e kam bërë të keqe të keqe dhe t'i vijë keq për atë që kam bërë. O Zot, a është lëshuar mbi mua dënimi Yt për shkak të epsheve të shpirtit tim dhe dëgjueshmërisë ndaj armikut i cili më verbëroi dhe më përfitoi me plotësimin e dëshirave, për çka i kalova kufinj të dhe nuk i respektova

urdhërat tuaja! Për gjithçka të jam mirënjohës dhe i dorëzohemvullnetit dhe dënimit tënd! O Zot, Të dorëzohem me përluljen time për shkak të teprimit. Pendohem thellë! Heqi dorë nga mëkatet! Të lutem për falje! Pendohem dhe i pranoj gabimet, i dëgjueshëm dhe i përlulur. Nuk mund të iki nëse nuk e pranon pendimin tim dhe nuk më merr në mëshirën Tënde.

O Zot, pranoje pendimin tim dhe ki mëshirë, falmi mëkatet dhe më shliro prej ashpërsisë së vargojve që po gjendem. O zanafillës i krijesës time, ki mëshirë për trupin tim të dobët, lëkurën e ndijshme dhe eshtrat e paqëndresë! O Krijuesi im, më ke mundësuar të mendoj, më ke edukuar, më ke furnizuar, udhëzomë të bëj vepra të mira dhe të jem fisnik! O Zot, O Krijuesi im, a po më mundon në zjarrin tënd, edhe pse besoj në Njësinë Tënde dhe të kam pranuar në zemër, dhe gjithmonë të përmendi me gjuhën time dhe të dua fort, pasi të kam njohur dhe të jam falur me përlulje ndaj Madhërisë tënde. O Zot, a do ta largosh atë që e ke afruar, a do ta përzashë atë që e ke pranuar, a do ta leshë në mundime atë ndaj të cilit ke qenë i mëshirshëm dhe prej të cilit je i kënaqur? Të kisha me ditë, o Zot, o Krijuesi im, a do të lëshojsh zjarrin në fytyrat që kanë bërë sexhde para Madhërisë Tënde? Edhe në gjuhërat që kanë thënë të vërtetën për Ty, dhe kanë qenë mirënjohës ndaj Teje, dhe ndaj gjithë të dëgjueshmëve që janë kujdesur për vendin e ibadetit dhe me përlulje të kanë shprehur pendim?

O Krijuesi im Bujar, kemi dëgjuar dhe nuk kemi dyshim në mirësinë Tënde. Ti i dinë dobësitë e mia dhe dënimet e kësaj bote dhe mundimet e përditshme. Këto mundime janë të lehta dhe afatshkurta. Si do t'i përballojë ato afatgjatat dhe mundimet e rënda në atë botë, ku nuk ka lehtësime, e që me siguri sikurse edhe të kësaj bote nuk janë fryt i hidhërimit Tënd, hakmarrjes dhe pakënaqësisë. O Zot, si do të jetë puna ime, si rob i Yti i pafuqi, i përlulur, i pavlerë, modest dhe i mjerë? O Zot, O Krijuesi im, përse kërkoh strehim tek Ti, prej çka po iki, përse çajë nga mundimet e rënda, të pandërprera, nga dënimi me të cilin dënon armiqtë tu, Ti i dallon mirë ata që e meritojnë mirësinë Tënde, më fal! Nëse përjetojë dënimin Tënd si do ta përballoj ndarjen prej teje? O Zot, më fal nëse molisem në nxehtësinë e zjarrit tënd nuk mund të shikoj bujarinë tënde, e si të jem banor i zjarrit kur kam shpresë se do të më falësh? O Zot, betohem sinqerisht se nëse më lejon të flas, do të bëj këtë me zë sikur ata që kërkojnë ndihmë, do të çajë me ngashërim dhe so të thërrasë, po ku je o mik i besimtarëve, cak i fundit i atyre që të njohin, o i dashur i zemrave të sinqerta, o Zot i tëra botërave! Qofsh lavdëruar dhe i lartësuar, a do të dëgjosh në xhehennem zërin e robit besimtarë që është mbyllur aty për shkak kundërvënies dhe shijon mundimet mundimet e xhehennemit për shkak të mosdëgjimit, që është ndërmjet shtresave të xhehennemit dhe veprave të këqia, por që klithin me shpresë të madhe në mëshirën Tënde dhe të thërrasin me gjuhën e besimtarëve të besimit në një Zot dhe të lusin duke shpresuar në mëshirën e pakufishme tënden. O Zot, si do të qëndrojnë në mundime shpresa për mirësinë Tënde? Për mëshirën Tënde? E si, nëse e djeg zjarri, do të shpëtojnë shpresa në Mirësinë Tënde, kur Ti e dëgjon zërin e tij dhe e sheh pozitën e tij? Ose e sheh se si e përfshinë rrëmuja e xhehennemit, kur ti i din dobësitë e tij, e si mundohet në shtresa të xhehennemit kur ti e din besnikërinë e tij, ose si e pengojnë melekët e xhehennemit e ai të thërret o Krijuesi im! Kërkon mirësinë tënde ta lirosh nga xhehennemi, e ti e len aty. Larg është mendimi i tij për Ty! Nuk është kjo ajo që mendon për mirësinë tënde, nuk i ngjan kjo asaj që ke premtuar për besimtarët tu. Është, pra e sigurtë se nuk i ke dënuar mosbesimtarët tu rreptë e që gjithmonë të mbesin në këtë dënim, sepse po të mos ishin ata Ti do ta kishe bërë të ftohtë zjarrin dhe askënd nuk do ta kishe vënë në zjarrë. Por, premtimi Yt është i shenjtë! Ke vendosur ta mbushish zjarrin me mosbesimtarë, njerëz ose xhinë, të cilët do

të mbesin aty përgjithmonë. Ti je bëmirës shumë i madh! Na ke shpërblyer gjithmon me ato dhe ke thënë: « A janë të barabartë ata që besojnë me ata që nuk besojnë »? O Zot, të lutem që me fuqinë tënde me të cilën ke përfshi çdo send dhe i ke vënë vulë, më fal në këtë natë e në këtë moment tëra mëkatet që i kam bërë dhe të gjitha paudhët që i kam bërë, çdo punë të ligë që e kam fshehur, çdo mosdije që e kam fshehur apo e kam shprehur, çdo punë të ligë që e kanë shënuar Kiramun Katibinët, përcjellësit e mi fisnikë, që i ke autorizuar të shënojnë gjithçka bëj, e që i ke bërë dëshmitarë në krahët e mi-Ti më ke përcjellur përmes tyre dhe je dëshmitarë edhe i asaj që ata mund të mos e kenë parë, dhe, me mëshirën tënde ke pranuar që ndonjë send të shmanget, dhe e ke plotësuar fatin tim me mirësi që Ti e jep, edhe vepër të mirë që e ke do edhe mirësinë që e shpërndanë edhe furnizimin që e afron edhe mëkatin që e fal edhe gabimin që e mbulon.

O Zot, (tri herë), O Krijuesi im, o Ti që ke në dorë jetën time, Ti që e din dëmin dhe modestinë time. Ti që je i gjithdijshëm për dobësitë e mia dhe varfërinë time, O Zot (tri herë), të lutem Ty me madhështinë e bukurinë e emrave të Tu dhe cilësive të larta, më oriento që kohën time, natë edhe ditë, ta çojë duke të kujtuar Ty, që gjithmon të jem në shërbim tëndin dhe veprat e mia dhe lutjet e përditshme të jenë të pranuar tek Ti! Më bën që përjetë të shërbej Ty, o Zot që je mbështetja ime, Ty që të ankoem për gjendjen time.

O Zot, O Zot, O Zot, ritmi plagët e mia në shërbimin tënd, forcoam zemrën time në vendosmëri, më fal seriozitet për përlujde ndaj Teje dhe që gjithmonë të Shërbejë Ty, derisa të nisem rrugës së atyre të cilët të janë afuar më së shpejti! Të shpejtoj kah Ti bashkë me ata që e bëjnë këtë! Të dëshiroj të jem afër Teje me gjithë ata që këtë e dëshirojnë dhe të afrohem me sinqeritetin më të madh, të të frikësohem me vetëdije të plotë dhe të vendosem bashkë me besimtaërt afër Teje.

O Zot, pengoje atë që më dëshiron ndonjë të keqe, kush dëshiron të më mendojë mos lejo dhe bënë mua robin Tënd më të lumtur! Më afro tek Ti dhe më bën të dashur, dhe nga bujaria Yte më dhuro, me fisnikërinë tënde më mëshiro, me mëshirën Tënde më mbro! Bëre fjalën time të dëshiruar në kujtimin Tënd, zemra ime le të lodhet nga dashuria Yte, kij mëshirë e të përgjigjem Ty, më ruaj nga mëkatet dhe falmi gabimet e mia!

O Zot, ke urdhëruar që robët Tu të të adhurojnë, dhe vetëm Ty të të luten, por u ke garantuar se edhe do t'u përgjigjesh! Kah Ti, O Zot, e kam drejtuar fytyrën time, o Krijuesi im, i kam shtrirë duartë e mia, pra përgjigju me madhërinë Tënde në lutjen time! Plotësomi dëshirat e mia, mos ma humb shpresën, më ruaj nga të këqiat e armiqtëve të mi, njerëz apo xhinë qofshin!

Ti që mund t'i përgjigjesh atij i cili nuk ka asgjë tjetër përveç lutjes, Ti që mund të bësh çdo gjë, Ti emri i të cilit është ilaç kurse kujtimi për Ty shërim, përlujde ndaj Teje pasurim, mëshiroje atë, pasuria e të cilit është vetëm lutja, e arma e tij është vaji! Ti që shpërndanë mirësi e që i largon mundimet, Ti je dritë e të vetmuarëve në terr, past bekimin Muhammedi, dhe familja e Muhammedit, vepro me mua si të duash Ti, e jo ashtu siç kam bërë unë.

Bekimi i All-llahut qoftë mbi Muhammedin-Profetin e Tij dhe prijësit mbarë nga familja e tij, paçin shpëtimin!



P.S. Ky libër me ndihmën e All-llahut nga kroatishtja në gjuhën shqipe u përkthye më 23 ramazan 1423, përkatësisht 28 nëntor 2002, në Tetovë.

(përkthyesi)

P.P.S. Në fund, të dashur lexues, le të lexojmë një « El-Fatiha » për shpirt të të gjithë atyre që mundësuan ta shoh dritën e botimit ky libër posaçërisht All-llahu xh.sh e shpërbleftë me Xhennet...

---

Tekstet e prezentuara domosdoshmërisht nuk përfaqësojnë politikën e redaksisë të Dielli.net!  
[dielli@dielli.net](mailto:dielli@dielli.net)